



MUJORI

Përzgjedhje

III

Janar-Shkurt

Përktheu

Atë Justin Anthimiadhi

Botim i Manastirit të Hirshëm të Paraklitit
(Ngushëllimtarit)
Oropos-Atikë, Greqi, 2015

Titujt e origjinalëve: “Μηναῖον Ἰανουαρίου” dhe “Μηναῖον
Φεβρουαρίου”

Jepet si dhuratë

© Manastiri i Hirshëm i Paraklitit, Oropos-Atikë, Greqi

*Duhet të kihen gjithmonë parasysh Udhëzimet në fillimin
e volumit të parë, si p.sh. se “Në Leximet biblike të Dhiatës
së Vjetër mbajmë qëllimisht, me vetëdije gabimet letrare që ajo ka”.*

*O shenjtore të Perëndisë, ndërmjetoni për ata që
bashkëpunuan me shpirt dhe u lodhën për himninin tuaj.*

*Me ndërmjetimet e shenjtoreve të tu, o Perëndi,
mëshirona dhe shpëtona. Amin.*

Lejohet kopjimi i citimeve biblike, por të referohet burimi.

Ἐπιτρέπεται ἡ ἀντιγραφὴ τῶν βιβλικῶν παραπομπῶν μὲ μόνη τὴν ἀναφορὰ
τῆς πηγῆς.

Copyrighting of biblical quotes are permitted; it is necessary only
to reference the source.

Разрешается выписка библейских цитирований; необходимо сделать
ссылку на источник.



1 JANAR

Rrethprerja e Zotit tonë Jisu Krisht dhe kujtimi i atit tonë ndër shenjtorët Vasili i Madh.

Tipikon

Nëse bie e diel, të shtunën në Mbrëmësore. Thirrtores: 4 ngjallësore, të dyja Idhiomelet e së kremtes në 3, dhe 3 të shenjtorit. Lavdi i shenjtorit. Tani Hyjlindësore dogmatike e tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni. Leximet. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi i shenjtorit. Tani i së kremtes. Përlëshoret: ngjallësore, e shenjtorit dhe e së kremtes.

Të dielën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmi 50, Kanuni Triadik dhe Litia e shenjtorit. Lavdi dhe Tani i së kremtes: Nuk ndjeu turp fq. 4. Himnet Triadike. Trishenji. Përlëshorja e së kremtes. Në Mëngjesore, nga një ngjallësore, një e shenjtorit dhe një e së kremtes. Pas Po-

lieleit, Ndenjësoret e Mujorit. Bekimtores. Ipakoia. Shkallesat e tingullit dhe Proqimeni. Kanunet: ngjallësor, i së kremtes dhe i shenjtit (nga 4 për çdo Kanun). Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia ngjallësore dhe Ndenjësoret e shenjtorit dhe të së kremtes. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e shenjtorit dhe Sinaksari. Zbritësoret e dyfishta; dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor. Në vend të Më të nderuarën, psalet Ode IX e së kremtes dhe e shenjtorit me Madhështimet. Të dyja Zbritësoret e Odes IX. Dërgimësoret: ngjallësore, e shenjtorit dhe e së kremtes. Lavdërimet: 4 ngjallësore dhe 4 të së kremtes. Lavdi i shenjtorit. Tani i së kremtes. Dhoksologjia e Madhe. Sot erdhi.

Në Liturgji, Antifonet e së kremtes, por, pas Hyrjes, “që u ngjalle prej së vdekurish”. Përlëshoret: ngjallësore, e së kremtes dhe e shenjtorit. Kontaqi Zoti i të gjithave (kërkoje pas Odes III fq. 13), dhe në vazhdim Liturgjia e Vasilit të Madh. Në diptikët psalet Madhështia e shenjtorit.

Kungatore Lavdëroni. Në vend të Pamë dritën, Përlëshorja e së kremtes.



NË MBRËMËSORE

*Pas Qëndrimit të parë të Psaltrit (Lum ai njeri),
Thirrto*

Idhiomele të së kremtes

Ting. Tërth. IV I Anatoliut

Shpëtimtari nga mëshira për gjindjen e njerëzve denjoi mbështjellje shpërgënsh. Nuk i erdhi ndot nga rrethprerja mishërisht të tetëditëshmit nga nëna, të panisëshmit nga Ati. Atij, o besnikë, le t'i thërresim: Ti je Perëndia yn', mëshirona.*

(2x)

I njëjti I Anatoliut

Nuk ndjeu turp Perëndia i tërëmirë kur u rrethpre në mish, por na dha të gjithëve veten e tij si arketip dhe shembull¹ për shpëtim; sepse bërësi i Ligjit i zbaton kanunet e Ligjit, si dhe ato që u predikuan nga profetët për atë. Ti që të gjitha i mban në pëllëmbë² dhe u mbështolte në shpërgënsh, o Zot, lavdi më ty.

Të shenjtorit

Ting. IV O eks ipsistu klithis

Ti që, o atë, mban emër mbretërie,* priftërin' e Mbretit Krisht, Kombin e tij të shenjt',^{3*} e ke kullotur me

shkencë ti,* filozofi pra* të zbukuroi ty me kurorë, rreth* mbretërie,⁴ o Vasil, mbreti i mbretërve* dhe pushtetari i çdo gjëje,*⁵ Biri që është* edhe kuptohet bashkë me Atin Prind* gjithnjë dhe është* bashkë pa fillim; përgjëroju atij, ty të lutemi,* shpirtrat të na ndriçojë,* t'i shpëtojë si i dhembshuri.

I lavdëruar me veshje priftërore* plot me gaz e shpalle Ungjillin e Mbretëris',*⁶ e predikove, burove ti* pra mësimdhënie* Orthodhoksie për Kishën, o Vasil;* duke u ndriçuar me to, ne theologojm',* tani lëvdojmë pra një Hyjni* që është' në Atin* e plotpushtetshëm, të vetëmlindurin* Fjal' Perëndie* edhe Shpirtin Hyjnor, persona të tre të pandarë kurr';* luti që të shpëtojnë,* shpirtrat tanë t'i shkëlqejnë fort.

Ti që je bashkë me kore engjëllore,* o Vasil, dhe rri me to, ngaqë e pate zili* mënyrën, jetën e tyre, at',* i imitove* plot me shkëlqim edhe me sinqeritet,* kur mish kishe ende, trup dhe shoqëroheshe* me sa atëherë gjendeshin* mbi dhenë, por ti* si i pamish ishe; lutju Krishtit Zot,* që sa shijojnë* mësimdhëniet e tua të hyfrymëzuara, nga çdo kurth,* errësirë, padije* t'i shpëtojë dhe ndriçojë fort.

Lavdi

Ting. Tërth. IV I Anatoliut

Pasi u dashurove, o oshënar, me urtësinë dhe preferove mbi të gjitha gjërat të jetoje bashkë⁷ me Perëndinë, le përmes jetës sate mendimin e vdekjes, siç duhej; sepse me pasuri virtyti ia nënshtrove shpirtit gjithë mentalitetin e mishit,⁸ meqë pasionet e mishit me lodhje vetëpërmbytjeje i hoqe⁹ për hir të vetes; me studimin e ligjit hyjnor e ruajte të paskllavëruar gradën e lartë të shpirtit; ndaj si urreve mish, botë dhe botësundues,¹⁰ duke qëndruar pranë Krishtit, kërko për shpirtrat tanë përdëllimin e madh.

Tani

Injëjti I Anatoliut

Shpëtimtari nga mëshira për gjindjen e njerëzve denjoi mbështjellje shpërgënesh. Nuk i erdhi ndot nga rrethprerja mishërisht të tetëditëshmit nga nëna, të panisëshmit nga Ati. Atij, o besnikë, let' i thërresim: Ti je Perëndia yn', mëshirona.*

Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës dhe Leximet.

Këndimi i Gjenezës

(17.1-2,4-7,9-12,14)

Iu pa Zoti Abramit dhe i tha: “Unë jam Perëndia yt; ji i pëlqyeshëm përballë meje dhe bëhu i paqortueshëm; dhe do ta vendos dhiatën time mes meje dhe mes teje, dhe do të

të shumëfishoj fort, dhe do të jesh atë shumice kombesh, dhe nuk do të quhet më emri yt Abram, por do të jetë emri yt Abraham, sepse të vendosa si atë kombesh të shumtë, dhe do të të shumëfishoj tepër e më tepër, dhe do të të vendos për kombe, dhe mbretër nga ti do të dalin, dhe do ta siguroj dhiatën time mes meje dhe mes teje dhe në mes të farës sate pas teje, në gjeneratat e tyre në dhiatë të përjetshme, që të jem Perëndia yt dhe i farës sate pas teje.” Dhe tha Perëndia tek Abrahami: “Dhe ti, dhiatën time do ta ruash, ti dhe fara jote pas teje, në gjeneratat e tyre; dhe kjo është dhiata që do të ruash mes meje dhe mes jush, dhe mes farës sate pas teje, në gjeneratat e tyre. Do të rrethprietet çdo mashkull tuaj. Dhe do të rrethprisni mishin e lafshës suaj dhe do të jetë shenjë dhiate mes meje dhe jush, dhe fëmijë tetë ditësh do të rrethprietet prej jush, çdo mashkull në gjeneratat tuaja. Dhe mashkull i parrethprerë, që nuk do të rrethprietet në mishin e lafshës së tij në ditën e tetë, do të shfaroset ai shpirt nga fisi i tij, se shpërbëhu dhiatën time.”

Këndimi i Fjalëve të urta

(8.22-30)

Zot më ndërtoi si fillimin e udhëve të tij në punët e tij. Para jete më themeloi, në fillim para se të bënte tokën, dhe para se të bënte avushat,

para se të dalin burimet e ujërave. Para se të mbështeten male dhe para gjithë kodrave më lind. Zot bëri vende dhe të pabanuara, dhe skajet e tokës që banoen nën qiellin. Kur përgatiste qiellin, isha bashkë me të edhe kur e caktonte fronin e tij mbi erëra, kur të fuqishme i bënte retë e sipërme dhe kur i vendoste *si* të sigurt burimet e tokës nën qiellin, dhe kur të forta i bënte themelet e tokës, isha pranë tij duke rregulluar. Unë *urtësia* isha ajo për të cilën ngazëllohej, dhe përditë dëfrehesha në faqen e tij në çdo kohë.

Këndimi i Urtësisë së Solomonit

(Përzgjedhje)

Goja e të drejtit pikon urtësi, ndërsa buzë burrash dinë hire. Goja e të urtëve studion urtësi dhe drejtësia i shpëton nga vdekja. Pasi mbaroi në burrë i drejtë, nuk humbet shpresë, sepse lindet bir i drejtë për në jetë dhe në të mirat e tij do të vjelë fryt drejtësie. Dritë *do të jetë* tek të drejtët përgjithmonë dhe nga Zoti do të gjejnë hir dhe lavdi. Gjuha e të urtëve di të mira dhe në zemrën e tyre do të prehet urtësi. I do Zoti zemrat oshënare dhe të pranueshëm prej tij *janë* gjithë të paqortueshmit në udhë. Urtësi Zoti ndriçon fytyrë të mençuri; sepse arrin tek ata që e dëshirojnë para se të njihet dhe me lehtësi vëzhgohet nga ata që e duan. Ai që mëngoi për atë nuk do të

lodhet dhe ai që nuk fjeti për atë, shpejt do të jetë pa merak; sepse ajo lëviz rreth e rrotull duke kërkuar të denjë për atë, dhe në rrugë u shfaqet atyre me dashamirësi. Asnjëherë nuk do të mbizotërojë mbi urtësinë ndonjë e keqe. Prandaj dhe u bëra i dashuruar pas bukurisë së saj dhe e desha, dhe e kërkova që prej rinisë sime, dhe kërkova ta marr nuse për veten time; sepse Zoti i të gjithave e deshi atë; sepse është njohëse e mistereve të diturisë së Perëndisë dhe zgjedhëse e veprave të tij. Lodhjet e saj janë virtyte dhe ajo *na* mëson mençuri dhe urtësi, drejtësi dhe burrëri, nga të cilat asgjë *tjetër* nuk është më e vlefshme në jetë për njerëzit. Dhe nëse dikush aspiron eksperiencë të shumtë, di të lashta dhe të supozojë të ardhshmet. Di me saktësi strofa fjalësh dhe zgjidhje enigmash. Paranjeh çudi dhe mrekulli, dhe përfundime kohërash dhe motesh. Dhe për të gjithë është këshilltar i mirë; sepse ka pavdekësi në të dhe lavdi në shoqërinë e fjalëve të saj. Prandaj shkova tek Zoti dhe iu luta, dhe thashë me gjithë zemrën time: O Perëndi i etërve dhe Zot i mëshirës, që i bëre të gjitha me fjalën tënde dhe që me urtësinë tënde e bëre njeriun që të zotërojë mbi krijesat që u bënë prej teje dhe që të drejtojnë botën me oshënari dhe drejtësi, jepmë mua urtësinë që ulet pranë froneve të tua dhe mos më shpërfill

nga shërbëtorët e tu; sepse unë *jam* shërbëtori yt dhe biri i shërbëtores sate. Dërgoje atë nga banesa jote e shenjtë dhe nga froni i lavdisë sate, që duke qenë bashkë me mua të më mësojë se çfarë është e pëlqyeshme para teje, dhe që të më udhëheqë në dituri dhe të më ruajë në lavdinë e saj; sepse mendimet e të vdekshmëve janë të gjitha frikacake dhe të pasigurta idetë e tyre.

*Në Liti Idhiomele
Ting. III I Gjermanoit*

Pasi Krishtin, burimin e jetës, e bëre banor brenda shpirtit tënd përmes sjelljes sate të kulluar, o Vasil hyshfaqës, i burove botës lumenj¹¹ dogmash besëmira; duke u vaditur prej tyre populli besnik i Kishës i ofron fryt buzësh¹² që i rrëfejnë hirin, atij që e lavdëroi kujtimin tënd në jetë të jetës.

Injëjti I Gjermanoit

Kur miroja e Hirit u derdh¹³ mbi ty, të leu që të celebrash Ungjillin¹⁴ e mbretërisë⁶ së qiejve,¹⁵ o Vasil hyshfaqës; sepse pasi u bëre era e këndshme e Krishtit, me erën e njohjes së tij¹⁶ e mbushe globin; prandaj duke i pranuar me dashamirësi zërat e shërbyesve të tu, kërko për ne që të nderojmë përdëllimin e madh.

Injëjti I Bizantit

Duke veshur stolinë priftërore,¹⁷ o

Vasil, luftëtar i Trinisë, qëndrove pranë fronit gjyqësor, duke rrezikuar në front për besimin; dhe pasi tregove rezistencë atletike, turpërove inatin e krahinarit arrogant nëpërmjet pushtetit të pabesisë; dhe kur kërcënonte me prerje të përbrendshmesh, me gatishmëri e preferove këtë; dhe meqenëse u bëre dëshmor sipas predispozicionit, e vure kuroren e fitores prej Krishtit, që ka përdëllimin e madh.

Lavdi

Ting. Tërth. II I Bizantit

Uderdh Hiri në buzët e tua,¹⁸ o atë oshënar, dhe je bërë bar i Kishës së Krishtit¹⁹ duke i mësuar dhentë e lo-gjikshëm, që të besojnë në Trininë e bashkëqenshme në një Hyjni.

Tani

Ting. Tërth. IV I Anatoliut

Shpëtimtari nga mëshira për gjindjen e njerëzve denjoi mbështjellje shpërgënsh. Nuk i erdhi ndot nga rrethprerja mishërisht të tetëditëshmit nga nëna, të panisëshmit nga Ati. Atij, o besnikë, le t'i thërresim: Ti je Perëndia yn', mëshirona.*

Pasvargje Idhiomele

Ting. I I Bizantit

O bletë e hyjshme dhe e shenjtë e Kishës së Krishtit, Vasil i tërëlumur; si e armatose veten tënde ti me thumbin e mallëngjimit hyjnor, i pla-

gose rëndë blasfemitë e herezive të hyjurryera, dhe shpirtrat e besimtarëve i pasurove me ëmbëlsinë e besimit të mirë; dhe tani që kalon mes livadheve të hyjshme të kullotjes së pacenuar, kujtona dhe ne duke qëndruar pranë Triadhës së bashkëqenshme.

Injëjti I Vasil Monakut

Varg: Goja ime do të flasë urtësi dhe studimi i zemrës sime mençuri.

Thithe si sfungjer virtytet e gjithë shenjtoreve, o ati ynë Vasil: butësinë e Moisiut,²⁰ zellin e Ilias,²¹ pohimin e Petros,²² theologjinë e Joanit,²³ si Pavli nuk pushove së thirruri: Kush sëmuret dhe nuk sëmurem? Kush skandalizohet dhe unë nuk digjem?²⁴ Prandaj duke ndenjuri bashkë me ta, përgjërohu që të shpëtojnë shpirtrat tanë.

Ting. II I Joan Monakut

Varg: Gojë e një të drejti do të studiojë urtësi dhe gjuha e tij do të flasë gjykim. Pasi studiove natyrën e gjërave dhe pe nga çdo anë paqëndrueshmërinë e të gjithave, gjete si të vetmen të palëvizshme atë që përmbinatyrshëm është Krijuesi i universit; tek ai duke u ngjitur gjithnjë e më shumë, hodhe poshtë mallin për të paqenat; ndërmyeto që të arrijmë edhe ne mallin hyjnor, o Vasil hyjshfaqës.

Lavdi

Ting. Tërth. II I Bizantit

Ti që hirin e çudive nga qielli e more, dhe mashtrimin e idhujve e qortove me dogmat, je lavdi dhe bazament kryepriiftërinjsh, o Vasil i tërëlumur, dhe shembulli i mësimdhënies për të gjithë Etërit; duke pasur guxim tek Krishti, përgjëroju atij që të shpëtohen shpirtrat tanë.

Tani

Ting. Tërth. IV I Anatoliut

Nuk ndjeu turp Perëndia i tërëmirë kur u rrethpre në mish, por na dha të gjithëve veten e tij si arketip dhe shembull¹ për shpëtim; sepse bërësi i Ligjit i zbaton kanunet e Ligjit, si dhe ato që u predikuan nga profetët për atë. Ti që të gjitha i mban në pëllëmbë² dhe u mbështolte në shpërgënj, o Zot, lavdi më ty.

Përlëshore e shenjtit

Ting. I

Në tërë dhenë doli zëri yt,²⁵ që priti fjalën tënde, me të cilën dogmatise hyjnisht, madhërove natyrën e gjërave, stolise zakonet e njerëzve; priftëri mbretërie,³ at' oshënar, lutju Krishtit Perëndi, të na dhurohet përdëllimi i madh.

Lavdi dhe Tani

E së kremtes I njëjti

Fytyrë njerëzore more pa ndryshuar, duke qenë Perëndi²⁶ nga substanca, o Zot mëshirëplotë; dhe duke mbu-

shur Ligjin,²⁷ rrethprerje mishërore denjon duke dashur që të pushosh errësirën²⁸ dhe të tërheqësh mbulesën²⁹ e pasioneve tona; lavdi mirësisë sate, lavdi dhembshurisë sate, lavdi denjimit tënd të patreguar, o Fjalë.*

Përlëshim

Ai që ditën e tetë denjoi të rrethprietet në mish për shpëtimin tonë, Krishti Perëndia ynë i vërtetë...

Në fund të Shërbesës së Mesnatës, Përlëshore: Fytyrë njerëzore.



NË MËNGJESORE

Në Perëndi është Zoti, Përlëshorja e shenjtë dy herë dhe e së kremtes një herë.

Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësore Ting. Tërth. I Ton sinánarhon Logon
Si stoli mbretërore të Kishës shenjtin ton',* Vasilin ta lavdërojmë të gjithë si një thesar,* pasuri të dogmave që nuk shteron;* se përmes tyre na mëson* që Trininë ta nderojmë në njësi të bashkuar,* në substancë, porse të ndarë në hipostaza, tre persona hyjnisht.

Lavdi

Ting. I Ton tafon su Sotír

Vasil i urtë rri* pran' Triadhës së Shenjtë,* ndaj lyp që të arrijmë në

ditën e Gjyqit,* të marrim ne himnuesit, që nderojmë kujtimin tënd* përdëllim dhe hir,*³⁰ dhe zbutje, ndjesë mëkatesh,* që të lavdërojm'* me shpirt e gojë të vetmin,* Jisu njeri-dashësin.

Tani *I së kremtes I njëjti*

Krijuesi i madh,* Zotëria i botës,* që lart me Atin është dhe Shpirtin e Shenjtë* rrethprietet si një foshnjë ditën e tetë mbi dhë; vërtet* veprat që ti bën* jan' të çuditshme,³¹ hyjnore,* o Zot, se për ne* rrethpritesh, meqë përmbushja* e Ligjit²⁷ dhe vula je.

Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësore Ting. Tërth. IV Tin sofian qe Logon

Urtësinë mistike që s'ka shprehi,* kaq të pasur e nxore, siç Zoti do;* të gjith've u dhe thesar,* rrjedha plot me Orthodhoksi,* që zemrat e besnikëve po i dëfrenj' hyjnisht,* ndërsa me denjësi mbysin dogmat e pabesis';* ndaj me që të dyja dhe me djersë për besën* u shfaqe një luftëtar* i pamposhtur i Shën Trinis',* hierark shën* Vasil me nam;* ndërmjeto te Zoti yt Krisht,* të na dhurojë ky ndjesën* e fajeve* ne që bëjmë kujtimin tënd fort të shenjt' me mall.

Lavdi *I njëjti*

Tani *I së kremtes Ting. IV Epefanis símeron*

Njeridashja jote, Zot,* është avushë,* ndaj ke veshur pamjen ti* fytyrë robi²⁶ dhe në mish* rrethprerje prite, dhe i dhuron* gjinisë mbar' përdëllimin tënd kaq të madh.

Pas Polieleit

Ting. Tërth. IV Tin sofian qe Logon

Me fuqinë e fjalës së hyjshme krejt* herezitë e errëta i përmbys,* vithise dhe çdo tërbim* të Ariosit, shën Vasil,* o hierark, se e predikove tek njerëzit* si Perëndinë Shpirtin, dhe kur shtrive duart gjer'* vrave kundërshtarët³² dhe dëbove të falur* të rremin si adhurim* të Savelit, dhe mendësi* të Nestorit* e zhduke krejt;* ndërmjeto te Zoti yt Krisht,* të na dhurojë ky ndjesën* e fajeve* ne që bëjmë kujtimin tënd fort të shenjt' me mall.

Lavdi *Ingjashëm*

U bë shkallë hyjnore për ngjitjen lart*³³ për ne hiri i fjalëve që ti the,* të hyjshme, të shenjta dhe* lartësia mistike krejt;* trumbetë shpirtërore fitove dhe me këtë* na shpalle mësimdhëniet e shenjta; fushove pra* në një vend të blertë³⁴ dhe i more shpërblimet* e luftës që kreve ti,* o Vasil hierark me nam,* ati ynë* dhe oshënar;* ndërmjeto te Zoti yt Krisht,* të na dhurojë ky ndjesën* e fajeve* ne që bëjmë kujtimin tënd fort të shenjt' me mall.

Tani *Hyjlindësore Ingjashëm*

Meqë mori mish Bërësi botëror,* Zoti ynë nga mitra jote pa cen,* o e paqortueshme,* të tregoi ty mbrojtëse* për gjindjen, ndaj përikim drejt teje të gjithë ne,* kërkojmë ndjesë, falje, o Zonjë, si dhe çlirim* nga tortura, derti dhe mundim i përherëshëm,* nga çdo keqtrajtim që bën* bot'sunduesi,¹⁰ shtypësi,* ndaj thërrasim* me zë te ti:* Ndërmjeto tek Zoti yn' Krisht,* që të dhurojë ky ndjesën* e fajeve* tek ata që i falen Birit tënd me besim.

Shkallesat. Antifoni i parë i Ting. IV

Proqimieni Ting. IV

Goja ime do të flasë urtësi dhe studimi i zemrës sime mençuri.

Varg: Dëgjoni këto gjithë kombet.

Ungjilli. Psalmi 50.

Lavdi. Me ndërmjetimet e hierarkut.

Tani. Me ndërmjetimet e Hyjlindëses.

Përdëllemë, o Perëndi. *Dhe Idhiomeli.*

Lavdi

Ting. Tërth. II I Bizantit

U derdh hiri në buzët e tua,¹⁸ o atë oshënar, dhe je bërë barí i Kishës së Krishtit¹⁹ duke i mësuar dhentë e lojikshëm, që të besojnë në Trininë e bashkëqenshme në një Hyjni.

Kanunet: i së kremtes dhe i shenjtorit.

Ode I

Kanuni i së kremtes

(*Me varg: Lavdi më ty, o Perëndia yn'...*)

Poezi e Stefanit

Ting. II

Irmosi: Dhefte lai

»Popuj të gjith',* ejani që t'i këndojm' Perëndis'* pra Krishtit, që si »ndau detin, udhëhoqi popullin që e »çliroi* nga zgjedha e Egjiptit, se u »lëvdua fort.

Dita e tet'* ikonizim të së ardhmes na sjell,* dhe pasurohet, dhe shkëlqen me varfërinë tënde,³⁵ o Krisht, të vullnetshme* në të Zot, u rrethpreve ti Ligjërisht në mish.

Rrethprerjen pret* ditën e tetë pas lindjes së tij* Jisui Krisht dhe hijen e saj sot pushon,²⁸ dhe lind dritën, lavdin e hirit* të ri, me mirënjohje e adhurojmë pra.

Kanuni i shenjtit Injëti

(*Me varg: O shenjt i Perëndisë...*)

Poezi e Joan Damaskinoit

Kushdo që do* dhe do përpiqet të pleksë lavdi* për ty, Vasil, do duhej që të kishte zërin tënd, por, o atë, durona* dhe jepna hir të bollshëm të të himnojmë ty.

Hovet në mish* plot me pasione që tiranizonj',* i edukove ti me dashuri dhe mall që kishe për filozofinë,* ndaj rri në mbretëri pa cen, atë shën Vasil.

Udhën e gjat'* e të vështir' të virtytit ke bër',* arrite pra në udhën që nuk ka trazim dhe është e shtruar në bazën* q'ellore; për të gjithë shembull, Vasil, u pe.

Preve në shpirt* edhe në trup veset, o shën Vasil,* dobishëm përmes shpatës që të dha ty Shpirti³⁶ dhe veten tënde e solle* porsi flijim dhe holokaust tek Zoti yt.

Atë ke qen'* misti i gjërave që s'shprehen dot,* dhe i mësove kryepriftëris' së mbretit³ gjëra mistike të Krishtit* dhe dritën e Trinisë qartë na shndrite ti.

Hyllindësore

Kush vallë mund* që të rrëfejë, të flas' denjësisht* për zëniën tënde mbi mendim? Se Perëndinë linde në mish, e Tër'shenjtë* si shpëtimtar për ne të gjithë u shfaq ai.³⁷

Zbritësore: Vithi anekálipse

»E teri, e thau fare detin* dhe në »për steré të tijt' i shpuri,* dhe me »valat i përmyti kundërshtarët Zoti »i madh,* i fuqishm' i lufteve, nder »dhe lavdi më ty.*

Tjetra: Stivi thalasis

»Shkoj nëpër detin më këmbë Izraeli edhe në bregun arriti i palagur, »po kalor'sinë armike egjiptiane Zoti »e përmbysi në një varr prej valësh

»me çudi dhe tmerr, me të djathtën
»e fortë.^{38*}

Ode III

I së kremtes

Irmosi: Steréoson imás

»**F**orcona, sigurona, o Zot, në ty,*
»pra ti që ke vrrarë me dru mëkatin,*³⁹
»edhe frikën tënde na e mbill* në
»zemrat tona, që të lavdërojnë ty.

Kur Fjala e mbiqenshme Zot mori mish,* pushoi krejt Ligjin kur u rrethpre ky* dhe na dha aparka plot me hir* dhe një fillim jete pa cen me plot bekim.

Meqë përmbushte Ligjin²⁷ dhe s'qe aspak* armik Perëndie kur mori mish pra* Krishti, qart' u shfaq edhe kërkon* pas tetë ditësh të rrethpriet me vullnet.

I shenjtiti I njëjti

Umbushe, o Vasil me çdo njohuri,* jo thjesht me arsim tokësor që shkelet,* por më shumë me arsim nga lart* dhe më të mirë, u pe pra shkëlqim mbi dhé.

Me frikë Zoti, atë, brumoseshë* nga ku lind fillimi i urtësisë,*⁴⁰ pra u bëre me krah, o Vasil,* me miqësin' e urtis'⁷ më të mirë ti.

Mbi vepër hipe, o Vasil, urtësisht,* e shfaq veprën bazë për teorinë* më

të hyjshme edhe qartësisht* mësove dijen mistike të gjërave.

Përkon me ditëlindjen e Krishtit Zot,* o atë, shkëlqen, shndrit kujtimi yt tok;* pikërisht misterin e saj ti* me mësimdhëniet e tua na e zbulon.

Hyjlindësore

Pa farë zë në bark Perëndinë ti,* e lind pa shpjegim të mishëruar,* e dëlir'; s'guxojnë ta vështrojnë* fuqit' në qiell, e Virgjër gjithnjë pa cen.

Zbritësore: Iskín o dhidhús

»**A**i që u jep fuqi besnikëve dhe »mbretërve* dhe ballin e tyre lartë- »son,*⁴¹ ka lindur prej Hyjlindëses, »dhe vjen për pagëzim tani, pra ejani »dhe thirrini:* Si ty, o Perëndi, s'ka »tjetër shenjt askund* dhe veç teje »nuk ka asnjë të drejt', o Zot.^{42*}

Tjetra: Osi paleón

»**N**e që shpëtuam nga leqet e ar- »mikut dhe nga thonj luanësh t' egër, »të tërbuar, le ta çelim gojën⁴³ dhe »le të këndojmë fjalë melodie, këngë »lavdërimi, se na dha shpëtim Zoti i »pakursyer.*

Ndenjësore

Ting. Tërth. IV Tin sofian qe Logon

Predikues i dritës së shenjtë je,* çele gojën për fjalën e Perëndis',* ke nxjerrë urti⁴⁴ dhe mbjell* nëpër botë mentalitet* të perëndishëm, se

miratove vërtet dogmat* e Etërve, prandaj sipas Pavlit u shfaqe ti* mbrojtës, luftëtar bese⁴⁵ si dhe qytetar tok* me engjëjt, i lumur fort,* shok i tyre u pe, Vasil,* o hyjshfaqës* dhe at' i madh;* ndërmjeto te Zoti yt Krisht,* të na dhurojë ky ndjesën* e fajeve* ne që bëjmë kujtimin tënd fort të shenjt' me mall.

Lavdi

Ting. III Thias pisteos

E vadite ti* planetin mbarë* me mësimin tënd* porsì me ujë,* o Vasil, i mbolle dogmat e besës ti,* se Krishti ynë, burimi i jetës,⁴⁶ Zot* u preh vërtet brenda teje; atij iu lut* meqë ke guxim, i hyjfrymëzuar, pranë tij,* që përdëllim të madh të na dhurojë ne.

Tani *I së kremtes I njëjti*

I Parthénos símeron

Zoti i të gjithave* duron rrethprerje për ne sot* edhe si i mirë pret* mëkatet, fajet e çdokujt.* Jep tani* shpëtim për botën; dhe lart në qiell* tok gëzon* shën hierarku pra dritësjellës* i Ndërtuesit të botës,* Vasili misti hyjnor i Krishtit Jisu.

Ode IV

I së kremtes

Irmosi: Isakíkoa Kírie tin akóin

»**K**am dëgjuar dëgjimin e ekonomisë sate Perëndi, Zot,* dhe të lavdërova, o njeridashës ty.

Tërësitë e kombeve pushuan së rrethpreri që atëherë kur u rrethpre vullnetarisht Krishti që shpëton me anën e Hirit.

E teta, në të cilën u rrethpre Zoti Krisht, ikonizon jetën e pambaruar të së ardhmes.

I shenjtit I njëjti

Ashtu si Nusja, Kisha, stoliset me lindjen e Krishtit, kështu zbukurohet edhe në kujtimin tënd, o i tërëlumur.

Duke u mburrur se ishe fëmijë i Perëndisë, o Vasil, me besim të drejtë, nuk ule Hyjni në krijesë.

Duke bërë aleancë me Perëndinë, u pe i paposhtëruar, o Vasil, ti që përuleshe në të gjitha tek urdhri i tij.

Nga Perëndia iu dhe Kishës si hendek dhe mur i fortifikuar, o Vasil i tërëlumur.

I pe te kundërshtarët si sëpatë prerëse dhe zjarr që shfaroste mashtrimin,⁴⁷ o atë Vasil.

Hyjlindësore

Oe pacenuar, të përgjërhem i ty, që zure pa farë Perëndinë, të ndërmjetosh përherë për shërbëtorët e tu.

Zbritësore: Akícoe Kírie fonís

»**D**ëgjoj zërin tënd, o Zot, Joan

»Pagëzori,* që po thërret nëpër
 »shkretëtirë,*⁴⁸ se ti gjëmove përmbi
 »ujërat⁴⁹ e shumta dhe e* deklarove
 »Birin tënd;* pra me Shpirtin Shenjt'
 »frymëzohet plotësisht dhe të thë-
 »rret:* O urtësi e Perëndisë,⁵⁰ o Zoti
 »Krisht.*

Tjetra: Pirsó katharthís

»I paqësuar prej një zëri të shenjtë
 »këndon profeti për lindjen njerëzore,
 »dhe i frymëzuar po lëçit me bujë Fja-
 »lën e panisshme që u mishërua dhe
 »dërrmoj përdhé fuqinë e armiqve.^{51*}

Ode V

I së kremtes

Irmosi: O tu fotós horigós

»Ti, Zoti, dhënësi i dritës⁵² dhe endë-
 »si i shekujve,⁵³ na udhëzo në dritën
 »e urdhrave të tu,⁵⁴ sepse veç teje
 »nuk njohim tjetër Perëndi.^{54a}

»Ti si foshnjë përmbushe Ligjërish Lig-
 »jin, kur dole pa shpjegim si Zot nga
 »nëna e virgjër dhe nuk nënçmove të
 »veshësh pamjen e njerëzve.

»Ajo që lindi Izraelin ngjau me natë,⁵⁵
 »sepse e deshte hijen Ligjore.²⁸ Kri-
 »shti, drita e botës⁵⁶ u shfaq, kur prej
 »saj shkëlqeu.

I shenjtit Injëjti

»Kisha sot kremton festë të dyfishtë
 »me të vërtetë: atë të rrethprerjes së
 »Zotit si foshnjë, që u pa mbi dhé,³⁷

dhe kujtimin e shërbyesit të urtë dhe
 »tri herë të lumur.

»Drita e pakuptueshme, Krishti, pasi
 »u preh në ty, o oshënar, të tregoi tek
 »bota llambadhe ndriçuese; prandaj
 »himnojmë kujtimin tënd, o Vasil.

»Nuk ishte as Moisiu ligjvënës, as
 »Josifi⁵⁷ grurëmatës si ti para Ligjit,
 »sepse u tregove, o Vasil, ti vetë gos-
 »tari i mishit hyjnor.

»Gjenezën e gjithçkaje që zbehtësisht
 »u shkrua përgjatë historisë në Sina
 »prej Moisiut, ti vetë duke e interpre-
 »tuar nga thesare të hyjshme, e zhvi-
 »llove tek të gjithë, o Vasil i tërëlumur.

Hyjlindësore

»Te ti që linde Krishtin, Krijuesin e
 »Gjithësisë, thërrasim: Gëzohu, o e ku-
 »lluar, gëzohu ti që na linde dritën,⁵⁶
 »gëzohu ti që mbajte Perëndinë e pa-
 »nxënshëm.

Zbritësore: Iisús o zoís horigós

»Kryetari i jetës Jisuj⁵⁸ vjen ta lajë
 »fajin e Adamit të parëgatuar.⁵⁹ Ndo-
 »nëse ishte Perëndi dhe ndonëse
 »s'kishte nevojë për pagëzim, pagë-
 »zohet në Jordan për mëkatet tona.
 »Kështu me ne pajtohet⁶⁰ dhe na fali
 »paqen që kapërcen çdo mendje.^{61*}

Tjetra: Ehthré zofodhus

»Shpirt' i Shenjtë na ka larë prej

»çdo helmi të armikut t' errët edhe
 »të pabesë, dhe na ka drejtuar n'
 »udhën e vërtetë, që na shpie në dë-
 »frim të paafruar, q' e fitojn' ata që
 »ka pajtuar Zoti.^{60*}

Ode VI

I së kremtes

Irmosi: Avisos amartimatton

»**A**vushë e fundme mëkatesh më
 »rrethoi, por si profetin Jona, nxirre
 »lart nga prishja,^{61a} o Zot, o Zot, jetën
 »time.

Mori fund Ligji, që atëherë kur
 Krishti,⁶² pasi u bë foshnjë dhe u
 tregua përbushës i Ligjit, denjoi
 rrethprerje dhe zgjidhi mallkimin e
 Ligjit.⁶³

Të shtunat dhe rrethprerja, tërbimi
 i hebrenjve, me shenjë e Krishtit
 që u shfaq, pushuan dhe shkëlqeu
 pranvera e Hirit.

I shenjtit I njëjti

Ushqeve me mbushulli shpirtra të
 varfrish të tretur nga uria⁶⁴ dhe i mbu-
 she me çdo hare hyjnore zemrat e të
 zijosurve, o Vasil.

Ushqeve me ushqim qiellor shpirtra
 të uritur,⁶⁵ sepse fjala jote është bukë
 engjëjsh,⁶⁶ grurëdhënës i shkëlqyer i
 së cilës u bërë,⁵⁷ o Vasil.

Me zellin e bletës për punë,⁶⁷ o Vasil,

qëmtove lulen e çdo virtyti, dhe si u
 bërë mjeshtër në të, lumërohesh.

Nxitove të shkëputesh nga bota dhe
 të jetosh bashkë me Perëndinë,⁶⁸
 prandajpërmestëpaqëndrueshmeve
 dhe të rrjedhshmeve pushtove si i ur-
 të, o atë Vasil, të qëndrueshmet.

Hyllindësore

Një ferrë në Sina që komunikonte pa
 u djegur me zjarr,⁶⁹ të parashkruan
 si nënë të gjithmonëvirgjër ty, o Mari
 Perëndilindëse e panusëruar.

Zbritësore: I foní tu Logu

»**L**ajmëtar' i Fjalës, kandil i dritës⁷⁰
 »që na sjell agimin, del përpara diellit
 »në shkretëtirë dhe i fton të gjithë të
 »pendohen⁷¹ dhe të pagëzohen, se
 »ja ku vjen⁷² Zoti Jisu, që ta shpëtojë
 »botën prej mëkateve.*

Tjetra: Imertón ekséfine

»**B**ir të përmallshëm me zë të
 »mallëngjyer, Ati^{72a} prej q'ellit e pro-
 »klamoj Jisunë: Ky tha është' Biri i
 »bashkëpanisshëm, që shkëlqen si
 »diell përmbi njerëzinë, Fjal' e Perën-
 »dis' »që u mishërua.*

Kontaqi

Ting. IV Epefanis símeron

Bazë që nuk tundet dot* u pe për
 Kishën,* zotësi që s'vidhet kurr'* u
 ndan të gjithëve, vulos* nëpërmjet
 dogmave që ti the,* qiellrrëfytes Vasil

oshënar me nam.

Shtëpia

Kana e mençurisë, goja e urtësisë,⁷³ baza e dogmave, Vasili i madh u shkëlqen të gjithëve mendërisht. Ejani pra, dhe le të qëndrojmë në shtëpinë e Perëndisë⁷⁴ duke soditur nxehtësisht, duke u kënaqur me çuditë e tij dhe të llamburitur nga vezullimi dhe drita e tyre, le të ngrohemi me anën e shpirtit pastrues të jetës duke imituar besën, ngrohtësinë dhe përulesinë e tij; përmes këtyre u tregua shtëpia e Perëndisë të vërtetë, atë e himnojmë duke i thirrur: Qiellrrëfytes Vasil oshënar me nam.

Sinaksari

Muaji janar, që ka 31 ditë. Dita ka 10 orë dhe nata 14 orë.

Më 1 të të njëjtit muaj, kremtojmë Rrethprerjen sipas mishit të Zotit dhe Perëndisë, dhe Shpëtimtarit tonë Jisu Krisht.

Vargje: Kur u rrethpre Krishti, u pre Ligji,/ dhe kur u pre Ligji, hyri Hiri.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atit tonë ndër shenjtorët, Vasilit të Madh, kryepiskopi i Qesarisë së Kapadokisë.

Vargje: Edhe pse vdiq, jeton Vasili në Zotin,/ jeton dhe pranë nesh, se flet nga librat.

O Vasil, vdiqe në të parën e janarit. Në të njëjtën ditë, martiri i shenjtë

Theodhoti mbaron me shpatë.

Vargje: Theodhoti thotë: Nuk do duroj, nëse nuk do pritem/ në kokë për hir të Perëndisë.

Në të njëjtën ditë, shën Grigori, i ati i shën Grigor Theologut, mbaron në paqe.

Vargje: Prej shtëpisë sate ke si pasuri lavdëruesin e fundit tënd,/ o atë, fëmijë prej kofshës sate.^{74a}

Me ndërmjetimet e tyre të shenjta, o Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII

I së kremtes

Irmosi: Ikonos hrisis

»**K**ur adhurohej një ikonë e artë në »fushën Dheira,⁷⁵ të Tre Djemtë e tu »shkelën urdhër tepër të pafe, dhe »kur u vunë brenda zjarrit, duke u »freskuar psalnin: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.

Ditëlindja e Krishtit është e shkëlqyer dhe e tërëndritshme, dhe përshkruan disi sot misterin e ripërtëritjes të së ardhmes, sepse me urdhër Ligjor Shpëtimtari rrethpritet, jo si Perëndi, por si i vdekshëm dhe si përmbushja e Ligjit.²⁷

Duke përmbushur Ligjin,²⁷ Bërësi i Ligjit vullnetarisht sot rrethpritet në mish, duke bërë rrethprerjen e dimrit⁷⁶ të mëkatit dhe duke dhuruar thi-

rrjen: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.

I shenjtit Injëti

U shfaq Biri si ikona e Atit,⁷⁷ dhe Shpirti, si e Birit, ndërsa ti, o Vasil, pasqyra e panjollë⁷⁸ e Shpirtit, dhe shtëpia e tërë Trinisë;⁷⁹ i lumur kujtimi yt, dhe ata që e lavdërojnë lavdërohen reciprokisht.⁸⁰

Pasi e zhyte ti mendjen në thellësitë e pakonceptueshme të Perëndisë, dhe pasi mblodhe margaritarin e çmuar të diturisë, pasurove botën me urtësi dhe e mësove të thërrasë: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.

O bashkim mendjesh, bashkëmoshatarë të hyjshëm, si një shpirt i pandarë në dy trupa, te Grigori Vasili, dhe te Vasili Grigori, të bashkëlidhur me mallëngjim të perëndishëm, tani përgjërojeni Krishtit për grigjën tuaj.

U shfaqe atë jetimësh, mbrojtës vejushash, pasuri të varfrish, ngushëllim të sëmurësh,⁸¹ qeverisja e pasanikëve, shkop pleqërie, edukim rinie dhe kanun virtyti për monakët, o Vasil.

Meqë pastrove mendjen nga çdo njollë balte, o Vasil, studiove shpirtëroret bashkë me Shpirtin⁸² që e dëshiroje; ndaj duke përhimmuar Triadhën, thërrisje me guxim: I bekuar

je, o Perëndi i etërve tanë.

Hyjlindësore

O e kulluar, Moisiu në malin Sina si ferrë që ndizej⁶⁹ të parashikonte ty, që prure pa u djegur lavdinë e pakufishme të esencës së parrëfyeshme, një nga hipostazat e shenjta të së cilës u bashkua brenda teje me trashësi mishi.

Zbritësore: Neus efsevis

»**D**jemat mu në zjarr një erë prej
»vese vërshëlluese çuditërisht në
»mes të furrës të pangarë i ruajti me
»ndihmën e engjëllit;⁸³ pra në mes të
»flakës të vesuarit përhimnonin me
»zë të madh: Zot i forcave, o Perëndi
»i etërve lart në q'ell je i bekuar.^{83a}*

Tjetra: Eflexe rithro

»**N**ë mes të lumit i përvëloj dragonjtë
»ai që Tre Djemtë i shpëtoj prej furrës,
»duke shuar zjarrin me^{83b} vesën prej
»q'ellit, dhe kështu mëkatet edhe
»njollat tona Shpirti Shenjt' i lau në
»valët e Jordanit.*

Ode VIII

I së kremtes

Irmosi: Ton arito sofia

»**F**jalën Perëndi që me urtësi të
»parrëfyeshme i sistemoi të gjitha⁸⁴
»dhe që nga mosqenia i bëri në të
»qenët,⁸⁵ e bekonit, o veprat e Zotit,
»Zotin.

Në ditën e tetë rrethprietet si foshnjë Zoti dhe pranon quajtjen Jisu, sepse është Shpëtimtari dhe Zoti i botës.⁸⁶

Me ditëlindjen e Krishtit u bashkëlidh denjësisht në të tetën ditë kujtimi i tërëlavdëruar i hierarkut. Duke e lartësuar këtë kujtim, himnojmë Zotin.

I shenjtit I njëjti

Atë që me përkujdesje të pashprehshme i dhuroi botës Vasilin si dritë shpresëtarie dhe trumbetë theologjje, e bekon, o veprat e Zotit, Zotin.

Atë që me energji të gratshme banoi tek Vasili i urtë dhe me anën e tij u theologua shpresëtarisht, e bekon, o veprat e Zotit, Zotin.

Ne që pa pushim shijuar fjalët e tua të hyjshme, duke bërë panair për kujtimin tënd, o Vasil, thërrasim: E bekon, o veprat e Zotit, Zotin.

I dërgove botës rrezet e fjalëve që ndriçojnë për të respektuar një natyrë të Trinisë, o Vasil, duke thirrur: E bekon, o veprat e Zotit, Zotin.

Hyjlindësore

Fjalën Perëndi të parajetshme dhe të pamot, që doli prej Atit dhe në fund lindi prej virgjëreshe, e bekon, o veprat e Zotit, Zotin.

Zbritësore: Mistirion parádhokson

Himnojmë, bekojmë dhe i falemi Zotit.
»Çudi që nuk ka dot tregim na
»shfaqti furra e Babilonës përmes
»vesës⁸³ së q'ellit;* se kështu dhe
»lum' i Jordanit e priti zjarrin qiellor
»të Krishtit,* dhe e pagëzoj* Krijetarin e Krijesës,* pra e bekojmë
»dhe e* përmbilavdërojmë përherë
»dhe përjetë.*

Tjetra: Elefthera men

»Tërë Krijesa çlirohet⁸⁷ dhe gëzohet.
»Bij të dritës⁸⁸ bëhemi ne, bijt' e
»natës. Vetëm po helmohet djall' i
»errësirës.¹⁰ Pra le ta bekojmë Shpëtimtarin ton' ne gjithë popujt që
»ishim të mjeruar.*

Ode IX

(Më të nderuarën nuk stihologohet)

I së krentes

Irmosi: I ton pro iliu fostira

O shpirt, madhështoje Marinë e nderuar* dhe të lavdëruar mbi forcat engjëlllore.*

»Trupëzove ti Perëndinë,* para diellit ndriçues është;* si diell lindi
»dhe na erdhi trupërisht* nga një bark virgjëror me një mënyrë që
»s'e shprehim dot;* o e dëlirë plot
»bekim,* të madhështojmë, o Hyjlin-dëse.

(2x)

[Nëpër enoritë nuk psalen Madhështimet që i kemi brenda kllapave katrore, të cilat

shoqërojnë përsëritjen e tropeve/.

O shpirt, madhështoje atë që mishërisht sipas Ligjit u rrethpre pra. **K**ushtet e natyrës së tërë* kapërceu Krishti edhe lind* mbimendërisht nga një e virgjër dhe në mish* po rrethprietet siç urdhëron, flet Ligji, germat e këtij;*^{88a} na shfaqet dhe tregohet pra* qartë zbatuesi i Ligjit ky.²⁷

O shpirt, madhështoje atë që në të tetën rrethprerje mori në mish. **M**blidhuni ju për panairin* shenjtërisht për emrin zotëror* të lavdëruar, se u quajt sot Jisu* Krishti krejt përrëndishëm; le ta madhërojmë tok me të* kujtimin kryepriftëror,* pra të Vasilit hierark me nam.

/Sot pritet në mish si foshnj'* Zoti dhe përmbush* Ligjin²⁷ që kish vënë vetë.

Sot Zoti u rrethpre në mish dhe Jisu u quajt, na solli pra shpëtimin./

I shenjtit Injëti

O shpirt, madhështoje të madhin ndër shenjtorët, Vasilin hierarkun. **S**i një qengj i Kryebariut*⁸⁹ me besnikëri i shkove pas,* në gjurmët jetëprurëse të tij,¹ Vasil,* se tiranit ia dorëzove shpirtin tënd, o ati yn'* si përluftar i ndritshëm trim,* ti, o i tërëlum, për Kishën ton'.

O shpirt, madhështoje Vasilin, shenjt i madh, kryeprift nga Qesaria. **K**ur i neveritshmi tirani* pa sistemin plot nur, hijeshi* të Kishës së Jisuit Krisht, Vasil i urt',* të stoliset nga kryepriftëria jote, krejt u shtang* dhe ra se nuk duronte dot* lavdin e Shpirtit brenda teje ky.

/O shpirt, madhështoje ndriçuesin e madh, të shkëlqyer të planetit.⁹⁰

O shpirt, madhështoje atë që zbukuroi fort Kishën e krishterë./

Lavdi

O shpirt, madhështoje Zotin Perëndinë, Trininë e lavdishme, të Shenjt' e të pandarë.*

Ti u denjësove për fronin* e apostujve, o shën Vasil,* për tendën e patrikëve, për korin mbar'* të profetëve dhe të athloforëve të Krishtit Zot,* për prehjen e të drejtëve,* si adhrues i Triadhës, mist.

Tani

O shpirt, madhështoje Marinë që shpëtoi të gjithë ne nga nëma.

Vetëm Zoti që më të lartat* i strehon në ujërat⁹¹ edhe,* o e dëlir', frenon çdo det, avusha than,* pasi mori prej teje mish, nga Bethlehemi po shpejton* dhe vjen në lumë, në Jordan* Krishti, të pagëzohet trupërisht.

Zbritësore: Apori pasa glosa

O shpirt, madhështoje* Zonjën e nderuar mbi forcat engjëllore.*

»**A**snjë gjuhë në botë* s'të këndon
»dot pas vlerës;* dhe turbullohet
»mendja e gjith' engjëjve për ty, o
»Virgjëreshë.* Po na prit me mirësi
»pas besës që të kemi,* se ti e di
»fort mirë që kemi mall për ty* edhe
»të madhështojmë përherë, mbrojtj'
»e besnikëve.*

Tjetra: O ton ipër nun

O shpirt, madhështoje Marinë që shpëtoi të gjithë ne nga nëma.

»**O** çudi pa fund e lindjes përmbi
»mendjen, nus' e ndritëshme dhe
»Nën' e lavdëruar, me të cilën kemi
»marr' shpëtim të plotë, pra për
»mirëbërjen të duartrokasim dhe
»këndime përhirimi të blatojmë.*

*Dërgimësore e shenjtit**En Pnévmati to ieró*

Mbulesën krejt të shpirtit tënd* e rrethpreve, o atë,* se deshe fort filozofin',* dhe u shfaqe në botë* përmes çudish si dielli,*⁹⁰ adhurues i Trinis'* dhe mist i së Tërëshenjtës,* o i urtë shën Vasil;* mendjet e besnikëve* i shndrite dhe i shkëlqeve.

E së kremtes Injëti

Rrrethpritet mishërisht si foshnj'* po në ditën e tetë* zbatuesi i Ligjit²⁷ pra* që ndërtoi çdo kohë.*⁵³ Mbështillet me shpërgënj si ne* dhe me

gji ushqehet ky,* që si Perëndi mban çdo gjë* me fuqi² që s'ka kufi,* dhe gjithçka e bën sakaq* përmes vullnetit të tij thjesht'.

*Lavdërime**Ting. Tërth. I Heris askitikón*

Rrrethprerje mban në mish, pra në trup* ai që lindi parrëfyeshëm nga Ati* pa prerje, pa rrjedhje, Fjala që mbetet brenda Hyjnis',* që ndryshim s'pëson kurrë si Perëndi,* Zot, prej Perëndie Zot.* Sipas Ligjit, ai që është* mbi ligj, të gjithë* nga mallkimi i Ligjit⁶³ ne* na shpëton, kështu* na dhuroi bekim nga lart;*⁵² ndaj duke lartësuar bashkëzbritjen e tij të shenjt',* të përmbimirë, himnojme edhe me ëndje e mburrim pra;* i lypim të jepet* përdëllimi edhe hiri i madh tek shpirtrat tan'.

Kur me rilindjen në pagëzim* të hyjshëm ti u adoptove prej Zotit tënd,* pohove, o oshënar, Fjalën, Birin e Perëndis',* që për nga natyra është ky vërtet* përpara nga shekujt, Zot* i bashk'qenshëm, bashk' pa fillim;* i mbylle gojë* pa fre të hereetikëve* me shkëlqim që kish* fjala jote, ndaj po banon* lart, brenda mbretërive edhe tok mbretëron tani* me Krishtin mbret nga natyra dhe veçantia përjetësisht,* i cili për botën* pasurisht shpërndan mëshirën e madhe si dhe hir.

Hyre në tempullin qiellor,*⁹² si hierark i hyjshëm, duke i veshur krejt* fillimet e urtësisë, praktikë dhe teori* si stoli të shenjtë, dhe meshon tani,* o atë i tërëlum* oshënar, në altar suprem,* me Perëndi rri* qëndron pranë, dhe celebron* ti Meshim Hyjnor* të palëndshme; ndaj, o Vasil,* tepër i dhembshur, na kujto ne që bëjm' kujtimin tënd* të gjith'nderuar, të hyjshëm, dhe përgjehrohu fort Krishtit Zot,* që botës i jep ky* hirin edhe përdëllimin e madh, shpëtim nga lart.

Meqë me çdo mënyrë ke qen'* ti që fëmijë afër Zotit, edhe më tej* i tëri i dedikuar si prift, shkëlqeve me drit'* ti prej urtësisë përmbi çdo urti;* e shpalle fort diturin'* e të qenëve, dhe shpjegon* me flakërim zjarr* dhe rrëfen rendin në gjithçka;* çështjen pra e bën* njohuri më të hyjshme, shenjt;* ndaj të pohojm' fuqishëm si mësues hyjfolës ty,* si dritëprurës, ndriçues për Kishën, dhe e himnojmë ne* Jisu Krishtin tonë,* që tek bota përdëllimin e madh e jep dhe hir.

Lavdi *I shenjtit*

Ting. Tërth. II I Bizantit

U derdh hiri në buzët e tua,¹⁸ o atë oshënar, dhe je bërë barí i Kishës së Krishtit¹⁹ duke i mësuar dhentë e lo-gjikshëm, që të besojnë në Trininë e bashkëqenshme në një Hyjni.

Tani *I së kremtes*

Ting. Tërth. IV I Anatoliut

Shpëtimtari nga mëshira për gjindjen e njerëzve denjoi mbështjellje shpërgënsh. Nuk i erdhi ndot nga rrethprerja mishërisht të tetëditëshmit nga nëna, të panisëshmit nga Ati. Atij, o besnikë, le t'i thërresim: Ti je Perëndia yn', mëshirona.*

Dhoksologjia e Madhe dhe

Përlëshorja Fytyrë njerëzore.

Në Liturgji (e Shën Vasilin), Tipiket dhe nga Kanuni i së kremtes Ode III, dhe i shenjtit Ode VI.

Nëse do, thua Antifonet e së kremtes:

Antifoni i parë

Varg a): Brohorisni për Zotin tërë dheu. Me ndërmjetimet e Hyjlindëses.

Varg b): Psalini pra emrit të tij.

Me ndërmjetimet.

Varg c): Rrëfeni gjithë mrekullitë e tij.

Me ndërmjetimet.

Varg d): Thojini Perëndisë: Sa të frikshme janë veprat e tua.

Me ndërmjetimet.

Lavdi *dhe* Tani

Me ndërmjetimet.

Antifoni i dytë

Varg a): Le të dëfrejnë qiejt dhe le të ngazëllohet dheu.

Shpëtona, o i Bir i Perëndisë, që u rrethpreve mishërisht.

Varg b): Këndojini Zotit, psalini emrit të tij.

Shpëtona.

Varg c): Nga Sioni hijeshia e bukurisë së tij.

Shpëtona.

Varg d): Perëndia ynë në qiell dhe në dhé të gjitha sa deshi i bëri.

Shpëtona.

Lavdi *dhe* Tani
O i vetëmlindur.

Antifoni i tretë

Varg a): Mëshirat e tua, o Zot, përjetë do t'i këndoj.

Fytyrë njerëzore.

Varg b): Do ta lëçit të vërtetën tënde në gojën time.

Fytyrë njerëzore.

Varg c): Deshe drejtësi dhe urreve paligjësi.

Fytyrë njerëzore.

Hyrtores. Ejani t'i falemi... Shpëtona... që u rrethpreve mishërisht.

Përlëshoret: e së kremtes, e shenjtit dhe e Kishës. Kontaqi Zoti i të gjithave (*kërkoje pas Odes III fq. 13*). *Në diptikët, Madhështimi i shenjtit: Ting. Tërth. II Tin timioteran:* Ta nderojm' të gjithë ndriçuesin* që shkëlqen, pra mistin e Jisuit nga dhé i shenjt',* nga Kapadhokia,* madje nga Qesaria,* Vasilin qiellshfaqës të madh të Krishtit Zot. *Kungatore* Lavdëroni. *Në vend të Pamë dritën, Fytyrë njerëzore.*

CITIME

¹ I Petr. 2.21

² Est. 4.17b(c); Jov 9.19; Ps. 94(95).4

³ I Petr. 2.5,9

⁴ Is. 62.3

⁵ I Tim. 6.15; Apok. 17.14; 19.16

⁶ Matth. 4.23; 9.35; 24.14; Mark. 1.14

⁷ Urt. Sol. 8.2-3,9,16

⁸ Rom. 8.6,7,27

⁹ Kol. 3.5

¹⁰ Ef. 6.12

¹¹ Joan 7.38

¹² Fjal. Urt. 18.20; 19(Mas. 31.31); Osea 14.3; Hebr. 13.15

¹³ Kënga 1.3

¹⁴ Rom. 15.16

¹⁵ Matth. 5.3 etj.

¹⁶ II Kor. 2.14-16

¹⁷ I Esd. 4.54

¹⁸ Ps. 44(45).3

¹⁹ Vep. 20.28

²⁰ Num. 12.3

²¹ III [I] Mbret. 19.10,14

²² Matth. 16.16

²³ Joan 1.1

²⁴ II Kor. 11.29

²⁵ Ps. 18(19).5

²⁶ Fil. 2.6-7

²⁷ Matth. 5.17

²⁸ Kol. 2.17; Hebr. 8.5; 10.1

²⁹ II Kor. 3.13-16

³⁰ I Tim. 1.2; II Tim. 1.2; Tit. 1.4; Hebr. 4.16; II Joan 3

³¹ Tobit 12.22; Sirak 11.4; Apok. 15.3

³² Eks. 17.11

³³ Gjen. 28.12

³⁴ Ps. 22(23).2

³⁵ II Kor. 8.9

³⁶ Ef. 6.17

³⁷ I Tim. 3.16

- 38 Ps. 117(118).16
 39 I Petr. 2.24
 40 Fja. Urt. 1.7; 9.10; Sirak 1.14(16)
 41 I Mbret. [Sam.] 2.10
 42 I Mbret. [Sam.] 2.2
 43 I Mbret. [Sam.] 2.1
 44 Ps. 44(45).2
 45 II Tim. 2.3-9
 46 Ps. 35(36).10; Jer. 2.13; 17.13
 47 Ligji i Dytë 4.24; 9.3
 48 Is. 40.3; Matth. 3.3; Mark. 1.3; Joan 1.23
 49 II Mbret. [Sam.] 22.14-17; Ps. 17(18).
 14-17; 28(29).3
 50 I Kor. 1.24
 51 Abak. kap. 3
 52 Jak. 1.17
 53 Hebr. 1.2
 54 Is. 26.9; Ps. 118(119).35
 54a Is. 26.13
 55 Osea 4.5
 56 Joan 8.12; 9.5
 57 Gjen. 47.12-14
 58 Vep. 3.15
 59 Gjen. 3.16-24
 60 Rom. 5.10; II Kor. 5.18-20; Ef. 2.15-16
 61 Fil. 4.7
 61a Jona 2.6-7
 62 Rom. 10.4
 63 Gal. 3.13
 64 Ligji i Dytë 32.24; Judith 7.14
 65 Ps. 106(107).9; Jer. 38(31).25
 66 Ps. 77(78).25
 67 Fja. Urt. 6.8a
 68 Fil. 1.23
 69 Eks. 3.2-5
 70 Joan 5.35
 71 Matth. 3.2; Mark. 1.4; Lluk. 3.3
 72 Joan 1.27
 72a Ps. 109(110).3
 73 Fja. Urt. 9.1-4
 74 Ps. 133(134).1; 134(135).2
 74a Gjen. 46.26; 49.10; Gjyq. 8.30
 75 Dan. 3.1
 76 Kënga 2.12-13
 77 II Kor. 4.4; Kol. 1.15
 78 Urt. Sol. 7.26
 79 Joan 14.23
 80 I Mbret. [Sam.] 2.30
 81 Jov. 29.12-15; 31.16-20; Sirak. 4.10
 82 Vep. 15.28
 83 Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 25-26
 83a Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 2
 83b Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 23-25
 84 Joan 1.3; Rom. 11.36
 85 Rom. 4.17
 86 Joan 4.42; II Petr. 3.2
 87 Rom. 8.21
 88 Lluk. 16.8; Joan 12.36; I Thes. 5.5
 88a Rom. 2.29; 7.6; II Kor. 3.6
 89 I Petr. 5.4
 90 Fil. 2.15
 91 Ps. 103(104).3
 92 Apok. 14.17; 16.17



E DIELA PARA THEOFANISË

1. Nëse bie në 2, 3 ose 4 të muajit:

Të shtunën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 6 ngjallësore dhe 4 Parakremtore (Këngë parakremtore sot; kërkoi në 2 të muajit fq. 26). Lavdi (Vjen drejt Jordanit; kërkoi në 2 të muajit fq. 27). Tani Hyjlindësore dogmatike e tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi dhe Tani (O Joan Pagëzor; kërkoi në Pasvargjet e Lavdërimeve në 2 të muajit fq. 44). Përlëshoret: ngjallësore (Në Mëngjesore 2 herë) dhe Parakremtore (Përgatitu, Zabulon; kërkoi në 2 të muajit fq. 28).

Të dielën në Shërbesën e Mesnatës, në fund Përlëshorja (Përgatitu, Zabulon). Në Mëngjesore, Kanunet: ngjallësor dhe Parakremtor i ditës (i 2, 3 ose 4 të muajit me varg: “Lavdi më ty, o Perëndia yn’.”). Pas Odes III, Ndenjësores (O Fjal’ e pakuptueshme; kërkoi në 2 të muajit fq. 33) një herë. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia ngjallësore dhe Sinaksari i ditës. Zbritësoret E teri, e thau; dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor. Dërgimësoret: ngjallësore dhe Parakremtore (Si rrjedha e një lumi ty; kërkoi në 2 të muajit fq. 43). Lavdërimet: 4 ngjallësore dhe 4 Parakremtore (Paraprini, Forcat e engjëjve; kërkoi në 2 të muajit fq. 43). Lavdi Eothinoni. Tani E Përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji, Tipiket. Lumërimet: 4 të tingullit dhe 4 nga Ode VI e Kanunit Parakremtor. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore, Parakremtore dhe e kishës. Kontaqi Në Jordan afrohet sot; (kërkoi në 2 të muajit fq. 37). Apostulli dhe Ungjilli i së Dielës Para Theofanisë.

2. Nëse bie në 5 të muajit:

Të shtunën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 6 ngjallësore dhe 4 Parakremtore (Këngë parakremtore sot; kërkoi në 2 të muajit fq. 26). Lavdi (Vjen drejt Jordanit; kërkoi në 2 të muajit fq. 27). Tani Hyjlindësore dogmatike e tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi dhe Tani Ting. IV Në lumin Jordan Krishti, Perëndia ynë, vjen drejt pagëzimit duke dashur që të na pastrojë nga paligjësitë tona me shfaqjen e tij, si i vetëm i mirë dhe njeridashës. Përlëshoret: ngjallësore (Në Mëngjesore 2 herë) dhe Parakremtore (e së sotmes) Mbrapa kthehej.

Të dielën, në Shërbesën e Mesnatës, në fund Përlëshorja (Mbrapa kthehej). Në Mëngjesore, Kanunet: ngjallësor dhe Parakremtor (i së sotmes) Te pagëzimi vjen Krishti fq. 53 me varg: “Lavdi më ty, o Perëndia yn’...” Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia Ngjallësore. Ndenjësores Parakremtore (një herë) Në rrjedha lumi

vjen (fq. 56). Pas Odes VI, Kontaqi. Shtëpia dhe Sinaksari (të gjitha të së 5-tës). Zbritësoret E teri, e thau; dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor. Dërgimësoret: ngjallësore dhe Parakremtore (Si rrjedha e një lumi ty; kërkoje në 2 të muajit fq. 43). Lavdërimet: 4 ngjallësore dhe 4 Parakremtore (O popuj, kini gaz; kërkoji në Pasvargjet e së sotmes - fq. 65- duke përsëritur të parën). Lavdi (O Joan Pagëzor; kërkoje në Pasvargjet të Lavdërimeve të sotme, po aty). Tani E Përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji. Tipiket. Lumërimet: 4 të tingullit dhe 4 nga Ode VI e Kanunit Parakremtor. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore, Parakremtore (Mbrapa kthehej), dhe e kishës. Kontaqi i ditës së sotme (Në Jordan afrohet sot). Apostulli dhe Ungjilli i së Dielës Para Theofanisë. Pas Uratës mbrapa Amvonit (para Emri i Zotit), Ajazma e Madhe (fq. 98) dhe në fund Emri i Zotit.

Hahet vaj dhe verë.



MË 2 TË TË NJËTIT MUAJ

Parakremtja e Theofanisë dhe kujtimi i atit tonë ndër shenjtoret Silvestrit, papa i Romës, dhe i atit tonë oshënar Serafimi në Sarov.

NË MBRËMËSORE

Thirrto

Parakremto

Ting. IV Os jeneon en mártisin

Këngë parakremto sot* plot me shpresë t'i psalim ne* pagëzimit shumë të shenjt' të Zotit Krisht;* ka për të ardhur me mish te Pararendësi si njeri,* do kërkojë pagëzim* shpëtimtar për ribërjen prap'* që të gjithë pra* që ndriçohen me besë në mënyrë të hyjnueshme të marrin pjesë në të Tërëshenjtin Shpirt.

Krishti shfaqet me madhësi,* Perëndia dëftehet qart'* – siç kish shkruar krejt hapur shën Davidi¹ mbret, – * te shërbëtori po vjen edhe kërkon pagëzimin pra,* me gaz, lumë ti Jordan* mbushu, dete dhe tokë bashk',* male, kodra tok* dhe me zemrat e njerëzve tani kërceni² duke pritur dritë mendore si dhe hare, shpëtim.

Meqë lumi i paqes³ je,* o i Tërëfuqishëm Zot,* je përrua plot me shijim edhe dëfrim,⁴* siç u përshkrua, si rryma lumi do të të presin ty,* kur

i zhveshur do të vish* e do futesh, ti që mbështjell* qiellin me re,*⁵ ti që zhveshe gjith' ligësinë e armikut edhe me mosprishje na veshe ne të dhëlindurit?

Të shenjtit

Ting. Tërth. IV

O tu paradhoksu thávmatos

Duke feksur, o Silvestër atë hierark, shenjtërisht* prej shkëlqimit si kryepriest* shndrite besimtarët nur* me mësim dritëprurës ti* të adhuroni Njësinë në natyr',* substancën trihipostate dhe kështu* dëbove terrin larg,* herezinë; ndaj festojm' kujtimin tënd* dritëmbajtës sot me gaz dhe bëjmë panair.

O hyjmbajtës shën Silvestër, porsishtyllë zjarri u pe* kur po shkoje me shenjtëri* para popullit të shenjt';* si re që hijesonte⁶ lart* ishe, kur nxirrje besnikët nga çdo kurth,* mashtrimi egjiptian, i sillje drejt* në tokën e hyjshme* me mësimet që aspak s'kishin gabim;* ndaj kujtimin tënd të hyjshëm e nderojmë ne.

E oshënarit I njëjti

Gjurme, hap të oshënarëve ke ndjekur që në rini,* ndoqe pa devijim aspak* sjelljen engjëjlore, shenjt,* dhe jetove si i trupit,* pra u pe enë e çmuar, Serafim,* pasi pastrove nga çdo të lëndshme ti* shpirtin dhe trupin tënd,* o i lumur, ndaj dhe ne

kujtimin tënd* dritëprurës kremtë-rojme, mburrim Zotin Krisht.

Lavdi dhe Tani

Ting. Tërth. II I Bizantit

Vjen drejt Jordanit Krishti, e vërta-ta,⁸ që të pagëzohet prej Joanit, edhe i thotë atij: Unë kam nevojë të pagëzohem prej teje, dhe ti po vjen drejt meje? Nuk guxoj unë, kashta, të prek zjarrin; ti më shenjtëro, o Zot, me shfaqjen tënde hyjnore.

Pasvargje Idhiomele

Ting. I E Joan Monakut

E shkëlqyer ishte e kremtja që kaloi, por më e shkëlqyer, o Shpëtimtar, kjo që vjen; ajo kishte si ungjillëzues një engjëll,⁹ dhe kjo gjeti Pagëzorin si përgatitës; në të parën, kur derdheshin gjakra, Bethlehemi vajton-te¹⁰ për mospasjen fëmijë, në të dytën, duke u bekuar ujërat, bëhet e njohur kolimvithra si me shumë fëmijë; atëherë yll i lajmëroi Magët, ndërsa tani Ati të tregoi tek bota; o Zot, që u mishërove dhe që vjen¹¹ përsëri faqeza, lavdi më ty.

Ting. II E Andrea Jerusalemasit

Varg: Për këtë do të të kujtoj nga toka e Jordanit dhe e Ermoniimit.

Sërish Jisui im pastrohet në Jordan, ose më mirë, pastron mëkatet tona, sepse vjen me të vërtetë drejt pagëzimit duke dashur të lajë plotësisht dorëshkrimin¹² e Adamit, dhe i tho-

të Joanit: Eja shërbe, o Pagëzor, kapitullin e misterit të huaj; eja, shtri dorën tënde shpejt dhe prek kryet e atij që dërmoi kafkën e dragoit¹³ dhe çeli Parajsën që mbylli shkelja¹⁴ nëpërmjet shijimit të drurit dikur, nga mashtrimi i gjarprit.¹⁵

Ting. III E Andrea Jerusalemasit

Varg: Të panë ujëra, o Perëndi, të panë ujëra dhe u frikësuan.

E hijshme ishte e kremtja që kaloi, e lavdëruar është dita e pranishme. Në atë, Magët i falen Shpëtimtarit, ndërsa në këtë, një shërbëtor i ftuar e pagëzoi Zotin. Atje barinj në fusha panë dhe çuditëshin, këtu zëri i Atit shpallte Birin e vetëmlindur.

Lavdi dhe Tani

I njëjti I Andrea Jerusalemasit

Ejani, gjithë besëmirët, dhesitëlëmë Judenë, le të kalojmë shkretëtirën e Jordanit dhe le të shikojmë sot atje atë që për ne u shfaq në mish,¹⁶ të kërkojë pagëzimin në rrjedhat e Jordanit, ndërsa Pagëzorin, të tërhiqet dhe të thërrasë me frikë: “Nuk guxoj të vë dorën, pëllëmbë balte në zjarr. Jordani dhe deti ikën, o Shpëtimtar, dhe u kthyen mbrapa,¹⁷ dhe si unë do të vë dorën mbi kreun tënd, të cilit i tremben Serafimët? U largua Jordani sapo priti gëzofin e Ilias nëpërmjet Eliseut,¹⁸ si nuk do të zhytet në kaos dhe në thellësi duke të parë ty të zhveshur brenda

çurkave? Si nuk do të më djegë ai duke u bërë i tëri i zjarrtë nga ti?” I thërret Jordani Joanit: “Pse vonon, o Pagëzor, të pagëzosh Zotin tim? Pse pengon pastrimin e të shumtëve? Shenjtëroi gjithë Krijesën, lëre që të më shenjtërojë edhe mua, edhe natyrën e ujërave, sepse për këtë u shfaq.”

Përlëshore Parakremtore

Ting. IV Kateplaji Iosif

Përgatitu, Zabulon* dhe hijeshohu, Nefthalim,* ti, o lumë, o Jordan*¹⁹ qëndro me gaz, kërcim, mikprit* pra Zotin tonë që po vjen të pagëzohet;* ki hare Adam me stërnënën tok,* mos e fshihni ju veten si dikur,* kur ishit në Parajsë,²⁰ se kur ju pa* të zhveshur,²¹ Krishti u shfaq; deshte* që ju t’ju veshë* stolin’ e parë,*²² botën ta rinovojë.

Lavdi *Përlëshore e oshënarit*

Ting. IV Tahí prokatálave

E ndoqe me përkushtim Krishtin tënd që në rini* dhe në shkretëtirën e Sarovit si i patrup me lutje dhe me kreshmim,* o atë u ushtrove,* Serafim oshënar ti,* u duke shërbëtori i së Virgjërës Zonjë,* se prite hir nga Ngushëllimtari; të lumërojm’.

Tani *Përsëri Përlëshore*

Parakremtore



NË PASDARKË

Triodi që ka Akrostihidhë: “Të hënën”.

Ting. II

Ode I

Irmosi: To tin ávaton

»**T**i këndojmë Zotit që me urdhërin
»e tij* të perëndishëm thau detin e
»trazuar fort,* që s’kalohej nga as-
»kush;* edhe udhëhoqi në të me
»këmbë popullin* e Izraelit, se u lav-
»dërua lavdërisht.²³

Bashkëzbritja e parrëfyeshme e Ndërtuesit, që më parë shkëlqeu nga e Virgjëra, ndriçoi botën. Përsëri vetë Krishti vjen në Jordan, që të kryejë tani një mister tjetër për rigatimin e huaj të vdekatarëve.

Pararendësi, zëri i Fjalës, vjen tani drejt Jordanit që të shërbejë në një punë të frikshme, sepse erdhi Krishti i pasur me Hyjni, ta pasurojë përmes Shpirtit me dhuratën e pagëzimit Adamin e varfëruar.²⁴

Ode VIII

Irmosi: Efrikse pedhon evagón

»**U** drodh nga trupi i dëlir’,* që njësoj
»me shpirtin e tre Djemve ishte*
»dhe kishte frikë zjarr* i palodhur,
»që me lënd’ pa fund u ndez*²⁵
»kur u fishk pra flaka që ish ngjallur
»gjithnjë;* ky himn përherë* po kë-
»dohej shpirtërisht* së bashku, ju*
»gjith’ veprat, Zotin himnoni* dhe e

»Iartësoni atë në gjithë jetët.²⁶

Duke ardhur tek Pagëzimi Krishti, Fjala, u thotë atyre që mbetën në topitje plogështie: Do t'ju njoh sigurisht si enët e mia të zgjedhura,⁷ nëse do të shënohet në ju vula e dhuratës sime që shkëlqen dritë të trefishtë; sepse për këtë erdha, duke dhuruar një udhë të re shpëtimi dhe jetë lirie.

“Ajo që po kryhet tani në ty është kundër rendit natyror, sepse më e vogla bekohet vullnetarisht nga më e madhja;²⁷ ndaj kam frikë të prek kryen tënd,” i thirri Pararendësi Çlirimtarit, “sepse nuk lejohet që kashtë t'i afrohet zjarrit; ndaj më mirë, ti shenjtëro shërbëtorin tënd.”

Dhe Dhiodhi, që ka Akrostihidhë:

“Të martën”.

Ting. i njëjtë

To dhógmati to tiranikó

Pasi të shkundim gjumin e dembelizmit shpirtëror, me vigjilencë zemre²⁸ le t'i thërrasim atij që vjen të pastrojë shpirtin në rrëke: E bekon, ju veprat e Zotit, Zotin.²⁶

Praktika le të jetë e mjaftueshme²⁸ brenda nesh me teori të lartë shpirti, që të shfaqur hijshëm në të dyja, të thërrasim për atë që i pastron të gjithë: E bekon, ju veprat e Zotit, Zotin.²⁶

Si të stolisim²⁸ me logjikë praktike talentin përmes punës së dyfishtë, le ta sjellim si shërbëtorë besërisht, o besnikë, tek Zoti që e dha,²⁹ i cili po vjen të pagëzohet për rigatim shpirtash.

Irmosi: To dhógmati to tiranikó

»Tre Djemtë që nuk iu bindën dot*
»dekretit që tirani kishte shpallur,*
»duke u hedhur në furrë me zë*
»Iavdëronin Perëndin’;* ju, o veprat
»e Zotit, të gjithë bekojeni.²⁶

Ode IX

Irmosi: Emegálinas Hristé

»E nderove pa kufi* Virgjërëshën
»e pacenuar,* o Zoti Krisht Perën-
»di;*³⁰ se u mishërove prej saj nga
»forma,* prandaj ne besnikët me
»mirënjohje po thërresim:* Eni lu-
»mërojeni* Zonjën* ton’ Mari dhe
»madhështojeni.^{31*}

Pasi të shtyjmë tej çdo njollë pasioni, le të ngremë mendim të arsyeshëm denjësisht për pagëzimin hyjnor; sepse erdhi Ndërtuesi duke u pagëzuar në rrëke, që të dhurojë një pastrim të huaj dhe që t’u tregojë të gjithëve një ndryshim të ri.

Duke parë drejt Krishtit që përulet vullnetarisht deri edhe në trajtë shërbëtori,³² le të përulemi tani nën dorën e tij të pushtetshme,³³ të lartësuar ne bashkë shpirtërisht, që ta

nderojmë me punë të pastra atë që pagëzohet.

Tjetri: I ton ahóriton Theón

Duke e hedhur poshtë ndotjen e rëndë të mëkatit, le të paraqitemi të pastër te Zoti që i pastron të gjithë me anën e rrjedhave të hyjshme.

Të pastruar me rrëketë e lotëve, ejani t'i afrohemi Krishtit që vjen të pagëzohet në lumin Jordan.

Ne që kremtuam me Magët dhe barinj të në lindjen tënde, o Shpëtimtar, tani që po vjen të pagëzohesh, na prano ne që të nderojmë ty.

Irmosi: I ton ahóriton Theón

»**B**ota e tërë nuk e nxë* Perëndinë, »Zotin Krisht,* po në gji e pate si »birin tënd;* të himnojmë, o Mari Vir- »gjëreshë.*



NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësores
Ting. II Ton tafon su Sotír*

E veshe, o Jisu,* varfërinë²⁴ që kisha;* vjen dhe me robërit e bashkon veten tënde;* kërkon nga shërbëtori yt pagëzim, njeridashës Zot;* ndaj kur ty të pa* Joani thirri: Si unë* do të pagëzoj ty Perëndi që s'ke njo-llë,*³⁴ o i përmbimirë Krisht.

Lavdi dhe Tani *Ingjashëm*

Me mirësi do vij'* Krishti në rrjedha lumi* pra në Jordan të realizojë ringjalljen* dhe rigatimin ton' me hir në to, o Pararendës shenjt,* prite me gëzim* edhe në ujërat laje* Zotin, se kështu* si njeridashës i vetëm* pëlqeu si Shpëtimtar.

*Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësores
Ting. IV Tahí prokatálave*

I pasuri Zot prej mirësisë me mbushulli,* si u varfërua²⁴ krejt për ne që u varfëruam që në fillim mjerisht,* sepse nuk u përmbajtëm,*²¹ vjen të shkelë mbi rrjedhat* në Jordan, duke dashur dukshëm të pagëzohet;* përuljen e tij të skajshme³⁵ le ta himnojmë ne.

Lavdi dhe Tani
Ingjashëm

Përmbushet sot thënia që tha Isaia me zë:* "Gatitjani udhën Perëndisë, shtigje ndërtoni ju për të Hyjshmin Zot,"*³⁶ se shën Joan i madhi,* siç u tha, kjo trumbetë* që donte shkretëtirën, dha zë; ndaj tok të rendim* të shohim të gjithë gjëra paradoksale krejt.

Kanunet: Parakremtor dhe i oshënarit

Ode I

Kanun Parakremtor, që ka Akrostihidhë sipas rendit alfabetik (pa Irmoset).

Poezi e Josifit.

*Ting. II**Irmosi: To tin ávaton*

»T'i këndojmë Zotit që me urdhërin
 »e tij* të perëndishëm thau detin
 »e trazuar fort,* që s'kalohej nga
 »askush;* edhe udhëhoqi në të me
 »këmbë popullin* e Izraelit, se u lav-
 »dërua lavdërisht.²³

Pararendësi nga shkretëtira vjen, se
 ndien* ardhjen e Krishtit dhe thërret
 me zë të madh, haptas:* U afrua
 dhe u shfaq* madhërisht çlirimi,³⁷
 pendohuni të gjithë ju* edhe pastro-
 huni me ujë, edhe lahuni.

Në furtunën e mëkatit mbytem,
 Fjalë Zot* pa fillim tok me Atin, më
 pastro të gjith' mua* me spërkatje,
 me pendim;* jep me pagëzimin tënd
 te besnikët përgjithnjë* çlirim nga
 dhembshuria jote që kufi nuk ka.

Meqë dritën pe pa perëndim, shkël-
 qe, o dhé,* toka e Zabulonit, siç u
 shkrua,³⁸ se ja ku* u afrua në rrëke,*
 në Jordan; himno me zë Perëndinë
 mbi çdo gjë:*³⁹ Le ta himnojmë Zo-
 tin, se u lavdërua fort.²³

Pararendësi hyjfolës kur e pa me
 sy* turmën e tërë njerëzve që vinin,
 thoshte pra:* Kush ju këshilloi ju*
 që t'i arratiseni zemërimit që po
 vjen? Ndaj bëni fryt pendimi⁴⁰ dhe
 shpëtohuni me hir.

Kanuni i hierarkut, që ka Akrostihidhë:
 "Më jep hirin, që të të himnoj me
 besim, o i lum. Josifi".

Ting. Tërth. IV I qekomeni tin átomon

Të birësoi me hir ty, o shën Silvestër,
 Ati Zot Perëndi,*⁴¹ se të pastër jetën
 ti* e kishe dhe meqë me shndritje
 të hyjnueshme u bëre i shkëlqyer
 shpirtërisht,* drejt Dritës shkove
 edhe the:* T'i këndojmë Zotit ne, se
 u lëvdua lavdërisht.²³

Me shpirt bujar i pushtove pa-
 sionet,⁴² e nënshtrove me edukim*
 asketik, i urti shenjt,* tek shpirti
 mishin, dhe u bëre një banesë për
 Trininë me lavdi, përkule krejt* ti fry-
 mët djallëzore tmerr* edhe psalje:
 Zotit t'i këndojm', se u lëvdua fort.²³

Iu binde ligjit hyjnor perëndishëm, i
 stolisur me urtësi,* njohjen e Shkri-
 mit të Shenjt'* me frymëzim hyjnor,
 mësove të vërtetën tek të urtët midis
 grekëve, prandaj* pohonin Atin, Bi-
 rin dhe* Shpirtin, duke thirrur: Zotit
 t'i këndojmë, se ka lavd.²³

Hyjlindësore

Që t'i bashkojë të poshtmet me sa
 jan' lart, i vetmi Zot mbi gjithçka*
 hyri në të shenjtin bark* që dasmë
 s'njohu dot; u pa më pas me formë
 mishi³² dhe mesmurin e armiqësis*
 e shkatërroi, ndaj na dha* jetën dhe
 çlirim të shenjt', dhe ndërmjetoi për
 paqen.⁴³

*I oshënarit**Ting. i njëjtë Igrán dhiodhefsas*

U duke mik engjëjsh të hyjshëm lart,* ndaj në qiell, o i hyjlëvduar shën Serafim,* për të gjithë lutu pa pushim ti* sa përmbi tokë festojmë kujtimin tënd.

Pasi ngrite kryqin e Krishtit Zot* me gjith' shpirt mbi supe që fëmijë, o Serafim,* me mendim të zjarrtë ti e ndoqe*⁴⁴ me asketizëm të rreptë, shenjt oshënar.

Çdo lidhje me tokën për buze ti* me mundim e lodhje je pastruar, o oshënar,* ndaj je enë drite qiellore* dhe të ka bërë të afërm Jisui Krisht.

Hyjlindësore

Shkëlqeve, o shenjt, në asketizim,* siç do Zoti, atë Serafim, u denjove pra* dhe shpesh pe Hyjlindësen e vetme* të virgjër që ty të mbushi me hir të shenjt'.

*Ode III**Parakremtor**Irmosi: Steréoson imás*

»**F**orcona, sigurona, o Zot, në ty,*^{44a}
»pra ti që ke vvarë mbi dru mëka-
»tin,*^{44b} edhe frikën tënde mbillna
»ti* në zemrat tona, që të lavdërojnë
»ty.

U shfaq me madhështi Krishti, po

thërret* Joani, dhe shkel mbi Jordan, mbi ujë;* të nxitojmë ta mikpresim ne* me pastërti mendjesh, që të ndriçohemi.²⁸

Meqë kërkoje, o Perëndia im,* atë që në vend të përpjetë humbi,*⁴⁵ veshe varfërin²⁴ e pasur fort,* o Çlirimtar i çdokujt, vjen për pagëzim.

Tani le të kërcejë qiell e dhé,* për botën bamirësi pagëzohet* dhe shumicën e mëkateve* që bëmë pa fund e mbyt krejt në ujëra.

I hierarkut: Ton fovon su Kírie

Kur zotërove pastërti mendjeje, u bërë hierark, pasi pranove krezmim të shenjtë,⁴⁶ prandaj, o atë hyjprurës të lartësojmë.

E shpalle si Perëndi në mish me prova logjike atë që shtriu pëllëmbët në kryq, dhe asgjësive arrogancë judenjsh, o i tërëlumur.

Meqë u bërë tepër i madh në çudi, largon shkeljet dhe pastron sëmurdjet e atyre që të kërkojnë me besim, o Silvestër hyjmendës.

Hyjlindësore

Oe Tërëshenjtë, mbete pas shtatzenisë virgjëreshë e kulluar, sepse linde Fjalë Perëndi që ngjau me ne,³² përveç mëkatit.

I oshënarit: Uranias apsidhos

Serafim i shkëlqyer me llamburi prej Hyjnis',* si i pastër në shpirt drejt thoje që më par' ç'do ndodhnin,* shikoje sa ishin larg,* o oshënar, si të ishin* të pranishme, nëpërmjet Shpirtit të Tërëshenjt'.

Ti banove, o atë, në shkretëtirën Sarov* dhe u pe si engjëll mbi dhé me lodhje e me mundim;* i pasur je me dhunti,* kudo u hap fama jote* tek të gjithë, shenjt oshënar, Serafim i madh.

Udhëhiqeshe nga Hiri zotëror, i drejton,* atë Serafim, pra të gjithë drejt gjendjes më të lart',* i lum, me fjalë të shenjt'* shpirtin dhe mendjen e murgjve* te përsosmëria e ngre lart drejt Perëndis'.

Hyllindësore

Je, o nënë e virgjër, mbështetje për çdo besnik,* shërbëtorin tënd denjësove, të shenjtin Serafim* për hir hyjnor dhe dhunti;* me përgjërimit e tija* më çliro nga terri i errët, çdo skllavëri.

Irmosi: Uranias apsidhos

»**P**erëndi që apsidë bëre në q'ell si »çati,*⁴⁷ ti që je ndërtues i Kishës,^{47a}
»mirë më siguro* në dashurinë që »ke;* je maja e çdo dëshire,* nje- »ridashës, edhe mbështetja për çdo »besnik.

*Ndenjësove**E hierarkut: Tin softian qe Logon*

Naushfaqesilum' plotshpresëtari,* hierarku i Zotit, Silvestër shenjt;* me rrjedhjet e dogmave* që ke shpallur ujite krejt* tër' dhenë⁴⁸ e pastrove me shira çudish çdo ves,* dhe denjësisht përrua shijimi ke trashëgim;* ndaj pasi u mblodhën, o i hyjshëm për ty sot* me këngë të mburrim ty* besërisht dhe me përkushtim* të thërrasim* me zë të madh:* Ndërmjeto te Zoti yt Krisht,* të na dhurojë ky ndjesën* e fajeve* ne që bëjmë kujtimin tënd fort të shenjt' me mall.

*Lavdi dhe Tani**I njëjti Anestis ek nekrón*

O Fjal' e pakuptueshme, Zot i padukshëm,* prej Atit linde mbi natyrë dhe* mbi mendje,* por prapë s'e ndryshove atë që ishe, nga Virgjëresha del,* vjen, pagëzohesh brenda rrjedhjes tani në Jordan në mish, o Krisht,* se si Zot të pëlqeu ta shpëtosh gjininë njerëzore.

[Nëse do, pas Ndenjësores Na u shfaqe si lumë, psal Ndenjësoren e oshënarit, pra:

*Lavdi**Ting. IV Tahí prokatálave*

Me Hirin e Shpirtit Shenjt u pasurove pa fund,* me vetëpërmbajtje të përsosur e ke pastruar mendjen; u pe ndriçim,*⁴⁹ shpresëtari, parathe* dhe tregove të ardhmen,* ndreqe

dhe rregullove ti etikën, prandaj çon* te Zoti sa të afrohen, o Serafim i lum.

Tani *Parakremtor*
I njëjti (I përkthyesit)

I vetmi i pamëkat drejt pagëzimit po vjen,* ai që aspak s'ka njollë,³⁴ i përsosuri, Krishti dhe Perëndia Zot.* Sot do pastrohet gjoja,* ndaj në lumin Jordan vjen,* që t'i tregojë vlerën pagëzimit të shenjtë;* pra shembull dhe tip përulësie ai na jep.]

Ode IV
Parakremtor

Irmosi: Elilithas ek Parthenu

»Ke ardhur nga një e virgjër jo si
»ndërmjetues, jo si engjëll, por vetë
»Zoti⁵⁰ i mishëruar dhe më shpëtove
»mua njeriun e tërë; pra ty të thërras:
»Lavdi fuqisë sate, o Zot.

Çuditet për mbërritjen tënde Pararendësi tepër i madh, o Jisu mirëbërës, dhe duke u ndrojtur të thërret: Duke qenë ti zjarr, o Zot, mos më digj plotësisht mua që jam bar.

O Joan, duke më parë të qëndroj vullnetarisht në këto ujëra tani, afrohu dhe pagëzo, që ta realizoj te gjinia e njerëzve hirin me anën e ujit.

O Perëndia im, të njoha Diell që fshihet në trup si në re; si pra zhvishesh, duke u mbështjellë me ujërat tani?

- thërriste Joani i habitur.

Duke u zhveshur unë, natyra e njerëzve ndriçohet dhe pranon çlirimimin nga errësira e mëkatit dhe prej së larti vesh këmishën⁵¹ e hyjshme të paprishjes.

I hierarkut: Isakikoa Kirie

U tregove, o atë Silvestër, hierark i hyjzënë, duke mirosur priftërinj⁵² në Shpirtin Hyjnor dhe duke ndriçuar popuj, o tepër i hyjshëm.

Me bashkëpunimin e Shpirtit dëbove sëmundje, shërove pasione të pashërueshme, o i tërëpasur, dhe i ktheve nga mashtrimi të marrët.

O Silvestër, kur përzure gënjimimin e herezive, e kullote grigjën në blerimin⁵³ e njohjes së hyjshme, duke buruar ujëra shpresëtarie.

Hyjlindësore

O Vajzë e virgjër, m'i shëro traumat e zemrës dhe drejto lëvizjet e shpirtit tim tek vullnetet e Perëndisë.

I oshënarit I njëjti

U duke në Rusi shembull kallogjerësh me rrezatimin e jetës, pasi imitove mundjet e oshënarëve të vjetër, o Serafim.

Tek e pastrove fuqishëm zemrën tënde në kreshmë, lot dhe lutje, u

bëre tenda e dritës qiellore, o atë.

Përderisashkëlqevenësytëeshpirtit me luftë asketizmi të hyjshëm, u denjësove, o Serafim hyjmenës, të parashikosh qartësisht të ardhmen.

Hyjlindësore

Oe Tërëshenjtë e tërëpaqortueshme, ti që linde Fjalën Perëndi në mënyrë të parrëfyer, më çliro me hirin tënd nga mendimet dhe sjellja jashtë logjikës.

Ode V

Parakremtor

Irmosi: O tu fotós horigós

»**T**i, Zoti, dhënësi i dritës⁵⁴ dhe »endësi i shekujve,⁵⁵ na udhëzo në »dritën e urdhrave të tu,⁵⁶ sepse veç »teje nuk njohim tjetër Perëndi.^{56a}

Pararendësi i shenjtë, duke thirrur “Pendohuni, u afrua mbretëria e Perëndisë”,⁵⁷ u shfaq nga shkretëtira, duke na rifituar ne që u shkretuam.

Ligji i vjetër dhe tërësia e shenjtë e profetëve thotë: Erdhi Krishti duke na rigatuar me anën e pagëzimit të hyjshëm ne, që u vjetruam për shkak të shkeljeve⁵⁸ të shumta.

Joani thotë: Sot shikoj gjëra të huaja dhe të frikshme! Tani doli burimi i pavdekësisë që të kërkojë pagëzimin e hyjshëm nga një pikë e vogël.

I hierarkut: Ina ti me aposo

Me thurjet e fjalëve të tua shpërndave çdo lidhje të kotë,⁵⁹ dhe të lidhurit të mashtrimit të bashkëlidhe me besimin hyjnor, duke u hapur atyre mendjen me shtjellimin e Shkrimeve,⁶⁰ o hierark i lumur.

O atë, zemra jote u bë e paqortueshme me anën e të drejtave të Zotit⁶¹ të përbashkët; meqë e dëshirove atë, zotërove mbi mishin dhe pasi u pasurove me hir çudish, shëron sëmundje dhe trauma shpirtrash tejet të rënda.

Me ilaçet e efektshme të fjalëve të tua, si mjek me Hirin hyjnor të Shpirtit të nderuar, ndalove dhe përzore sëmundjen shpirtshkatërruese të herezisë së tmerrshme të të marrit hidhur, e cila hante zemra,⁶² o hyjprurës.

Hyjlindësore

Gëzohu, o e vetmja që linde të fuqishmin pa kufi kur u varfërua²⁴ në mish; gëzohu, rimëkëmbja e botës së rënë, o e tërëpaqortueshme; gëzohu, zgjidhja e trishtimit; gëzohu, shpëtimi i besimtarëve; gëzohu, fronti i Perëndisë krejt i lartë.⁶³

I oshënarit: Fótison imás

O atë, linde në Rusi si diell i ri në kohët e fundme, duke llamburitur te të gjithë shkëlqimin e virtyteve.

Falë ngritjeve⁶⁴ të vazhdueshme drejt Perëndisë dhe lutjeve të forta, u lartësove drejt teorive të palëndshme, o oshënar.

Duke qenë i tëri i hyndriçuar në pamje, o i lumur Serafim, shfaqje shkëlqimin tënd të hyjnueshëm fshehur brenda shpirtit.

Hyjlindësore

Vrit, o e kulluar, mentalitetet e mishit⁶⁵ tim, ti që linde jetën e përjetshme⁶⁶ dhe më udhëhiq drejt udhës së jetës.

Ode VI Parakremtor

Irmosi: Avisos amartimaton

»**A**vushë e fundme mëkatesh më
»rrethoi, por si profetin Jona nxirre
»lart nga prishja,^{66a} o Zot, o Zot, jetën
»time.

Na hidh si shi zgjidhje mëkatesh, o njeridashës, ti që nga mëshira e madhe i vithise fajet e të dhélinurve në rrjedhat e Jordanit.

Duke qenë, o Krisht, det drejtësie, del tani në lumin Jordan që ta zhytësh dragoin⁶⁷ dhe ta lash shkëlqjen e Adamit.

Duke qenë me të vërtetë, o Krisht, rrëkeja e paprishjes, si do të të mbajnë rrëke lumi?, - thërriste Prodhromi

duke e lavdëruar dhembshurinë tënde të shumtë.

I hierarkut: Tin dhéisin ekheó

E lidhe ti* përmes lutjes sate, at',* dhe burgose përgjithmonë dragoin;*⁶⁸ i tmerrshmi djall* më nuk doli me smirë* të prishte sa po afroreshin tek ai,* si derë vure dhe si lloz*⁶⁹ vulën, shenjën e Kryqit të Zotit Krisht.

Në mbarë dhen'* doli fjala, zëri yt,* që si mjaltë, o i tërëlum rrodhi* dhe në çdo skaj* të planetit⁷⁰ ndriçoi* shkëlqimi i mësimdhënieve që ti the* dhe transparenca në çudi* dhe fanitja e hyjshme e punëve.

O hierark* fort i lumur, plot dhunti* dhe karizma kaq të hyjshme buron ti* me pasuri* si shi që rrjedh përherë* prej Shpirtit të Tërëshenjt'⁷¹ gjithëbërës Zot;* me hir, sa vijnë pra te ti* me besim sinqerisht, i shëron sakaq.

Hyjlindësore

Kuptuan drejt,* o e Virgjër, thellësin'* e misterit tënd profetët hyjfolës;* profetikisht* e paralajmëruan* të llamburitur në Shpirtin e Tërëshenjt';* si pamë shfaqjen e këtij* me hare, gaz tani po besojmë ne.

I oshënarit I njëjti

Pasi kishe,* atë Serafim, dhunti*

për çudi porsi dhuratë prej Zotit,* sa janë keq* në sëmundje të hidhur,* ti i shëron, frymët e ligësisë flak*⁷² edhe u jep të gjithëve,* o hyjprurës shenjt, ndihmë dhuron vërtet.

U shfaqe ti* pra në ditët e fundme,* oshënar, gjiganti në asketizëm,* dhe për dhunti* të mëdha zotërore* u denjësove; e mbushe me mrekulli* Rusinë mbarë që me lavd* të nderon, Serafim çudibërës shenjt.

E lartë, at',* dhe e mrekullueshme* jeta jote engjëllore u shfaq, ndaj* respekt të madh* kishin për ty të gjithë,* si qytetarët, arkondët dhe mbretërit,* se mbreti i të gjithave,* Krishti, o Serafim, të lëvdoi fort.

Hyllindësore

U duke qart'* më e gjer' se qiejtë,* ngaqë mbajte ti në bark të panxënin* në Gjithësi* dhe me trup e ke lindur;* shpejt më çliro nga shtrëngimi i veseve,* dhe sulmi i pasioneve* të lloj-llojshme, o Vajzë e Tërëshenjt'.

Irmosi: Tin dhéisin ekheó

»Do derdh lutjen* para Zotit Perëndi* dhe atij do t'i tregoj hidhërimet* »që kam,⁷³ sepse* shpirti im është »mbushur* me çdo të keqe dhe jeta »po shkon në Hadh;*⁷⁴ pra si Jonai »lutem un':* Jetën time nga prishja »ti ngrije, Zot.^{66a}

Kontaqi Parakremtor

Ting. IV Epefanis símeron

Në Jordan afrohet sot,* mbreti i q'ellit,* Shpëtimtari Zoti Krisht,* dhe shën Joanit i thërret:* Mos u trondit, por më pagëzo;* vij për shpëtimin e gjindjes së njerëzve.*

Shtëpia

Nuk këmbëngul, o Pagëzor, të tejkalosh kufijtë, nuk të them: "Thuamë sa u thua të paudhëve dhe si i këshillon mëkatarët";⁷⁵ vetëm pagëzomë duke heshtur dhe duke pritur rrjedhojat e pagëzimit; sepse do të kesh për këtë një gradë që nuk ka qenë ndër engjëjt;⁷⁶ se do të të bëj më të madh nga gjithë profetët;⁷⁷ sepse askush nga ata nuk më pa qartas, por në simbole, në hije dhe ëndrra,⁷⁸ ndërsa ti më sheh të qëndrosh para teje vullnetarisht; për Adamin vij, për shpëtimin e gjindjes së njerëzve.

Të Tjera të hierarkut:

Kontaqi

Ting. IV Ta ano zitón

Pasi me urti* nga Zoti mbushe gojën plot* e shpalle te ne* fort njohjen e Trinisë Zot* edhe e rrëzove posht' mosbesimin ti të tiranëve* me hobe⁷⁹ nga fjalët që the;* prandaj përgjëroju Perëndisë për ne.

Shtëpia

Kur u pasurove me katedrën e ko-

rifeut të apostujve, u dëftëve meshtar shumë i mrekullueshëm i Perëndisë, duke zbukuruar, mbështetur dhe madhëruar me dogma të hyjshme Kishën; dhe si yll dritërezatues duke feksur me llamburitje virtytesh, na mëson të respektojmë Triadhën si një Hyjni të pandarë, dhe i përzure herezitë e keqdashësve, o Silvestër i tërëurtë; prandaj përgjëroju Perëndisë për ne.

Sinaksari

Më 2 të të njëjtit muaj, kujtimi i atit tonë ndër shenjtorët Silvestri, papa i Romës.

Vargje: Ngjall kaun e vrarë duke turpëruar magjistarin Zamvri,/ ai që jeton, edhe pse i vdekur, Silvestri, papa i Romës.

Nxjerr frymë me shpirt Silvestri, gjatë mëngjesit të dytë.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atit tonë oshënar Serafimi në Sarov.

Vargje: Sikundër Adami para rënies, o Serafim,/ kishe miqësi me bishat dhe me dëborën.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i hieromartirit të shenjtë Theagjeni.

Vargje: O Theagjen, hidhu në mes të detit,/ ku nëse do mbytesth, do notosh brenda qiellit.

Në të njëjtën ditë, shenjtorët Theopempti dhe Theodhota, nëna e Anar-

gjendëve të shenjtë, mbarojnë në paqe.

Vargje: Kur Perëndia dërgoi Mendje të flakta, këto erdhën/ që ta zgjidhnin Theopemptin nga pranga mishi.

Me sëmundje e përshkove jetën, o Theodhota,/ ti që linde në jetë zgjidhës sëmundjesh.

Në të njëjtën ditë, oshënar Marku i shurdhër, mbaron në paqe.

Vargje: Marku nuk dëgjoji fjalë tokësore,/ duke nxjerrë veshët nga toka edhe para se të braktiste tokën.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirit të shenjtë Vasili nga Ankaraja.

Vargje: Vrumbullimë, hapje gojësh, kafshim bishash të egra/ nuk e frikësonin butësinë e Vasilit.

Në të njëjtën ditë, shën Sergji, mbaron me shpatë.

Vargje: S'është e mundur të themi, as të lajmërojmë/ me sa hare Sergji u pre në krye.

Në të njëjtën ditë, shën Theopisti, mbaron me hedhje gurësh.

Vargje: Të vret, o Theopist besimtar, me gurë/ shumica e të pabesëve nga mendimi i keq.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atit tonë oshënar çudibërës Kozma, kryepiskop i Konstandinopojës, i cili është në Manastirin e respektuar të

Horasë.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirit të ri të shenjtë Zorzi georgjan.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i shën Julianës, hegjemone e Lazarev të Ruisë.

Me ndërmjetimet e tyre të shenjta, o Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII

Parakremtor

Irmosi: Ikonos hrisis

»Kur adhurohej një ikonë e artë
»në fushën Dheira,⁸⁰ të Tre Djemtë
»e tu shkelën urdhër tepër të pafe,
»dhe kur u vunë mu në mes të zjarrit,
»duke u freskuar psalnin: I bekuar je,
»o Perëndi i etërve tanë.

O Krisht, duke më veshur me stoli të hyjshme mua të zhveshurin²¹ nëpërmjet këshillës së të fëlliqurit,¹⁵ preferove të ecësh në ujëra i zhveshur për hir të pasurisë së mirësisë; përhimnoj dhembshurinë tënde dhe i falemi ekonomisë sate të çuditshme.

O Krisht, cila është kjo ekonomia jote e shumtë për ne? Çfarë varfëri?²⁴ Çfarë bashkëzbritje e parrëfyeshme dhe përmbimendore? - tha Joani kur të pa të zhvishesh dhe të urdhërosh që të pagëzohesh prej tij.

E ndeze, o Krisht, si kandil, mishin tënd të nderuar në mes të Jordanit, dhe kërkove ikonën⁸¹ e handakosur në pasione dhe në mëkat; dhe kur e gjete,⁸² e zbukurove me pagëzimin tënd, o i mirë, prandaj të himnojme.

I hierarkut: I ek tis Iudheas

I drejtë si feniks lulëzove fryte drejtësie⁸³ në shtëpinë e Zotit,⁸⁴ o atë; ata që të nderojnë, me këto ushqehen duke psalur: O Perëndi i etërve tanë, i bekuar je.⁸⁵

Lavdia jote mbetet përjetë, o atë, dhe kujtimi yt⁸⁶ tok me gjithë të drejtët; bashkë me ta kujtona ne që këndojmë besërisht: O Perëndi i etërve tanë, i bekuar je.⁸⁵

Hierarku i lavdëruar, duke shkëlqyer nga ndriçimi i Shpirtit, shpërndau errësirën e së keqes dhe i llamburiti gjithë ata që thërrasin: O Perëndi i etërve tanë, i bekuar je.⁸⁵

Hyllindësore

O Vajzë e përmbiadmiruar, e kische në bark atë që është para gjithë jetëve, i cili ngjau me ne³² nga dhembshuria e tejskajshme, që t'i shpëtojë ata që psalin: O Perëndi i etërve tanë, i bekuar je.⁸⁵

I oshënarit Injëjti

Ata që rendin me besë te lipsanet e tua të respektueshme, o Serafim

oshënar, marrin shëndet dhe çdo shërim shpirti dhe trupi, duke lavdëruar Krishtin që të ka lavdëruar ty.

Me fjalët e tua të perëndishme, ata që përiknin, o atë, në palestrën tënde, njihnin mistikërisht gjërat hyjnore dhe udhëzoheshin drejt udhe të drejtë duke thirrur: O Perëndi i etërve tanë, i bekuar je.⁸⁵

Duke qenë i tëri i bashkuar me dritën e palëndshme, o Serafim oshënar, parathe tek të pranishmit ikjen tënde drejt Shpëtimtarit, o hyjprurës, dhe me lavdi të shumtë u ngjite lart.

Hyjlindësore

Pasi linde ligdhënës jashtë ligjeve natyrore, o Virgjëreshë e pacenuar, më çliro shpejt nga ligji i së keqes⁸⁷ me mbrojtjen tënde të ngrohtë dhe drejtësoje mendjen time përmes ligjit të pendimit.

Ode VIII

Parakremtor

Irmosi: Ton en kamino tu pirós

»**A**të që zbriti në kamin',* që të ishte tok me Djemtë e hebrenjve,* »Perëndinë që ktheu në vesë flakë »dhe zjarr*⁸⁸ himnojeni vepra, se »është Zot,* përbilartësoni atë në gjithë jetët.²⁶

Ishte si zëri i dikujt që thërriste³⁶

sheshit Joani, kur erdhi në shkretëtirë, duke i kthyer zemrat⁸⁹ që pendoheshin nxehtësisht, që ta lavdëronin Shpëtimtarin dhe Zotin, i cili shfaqej në Jordan.

Je përrua shijimi,⁴ ti që bëre dete dhe burime; dhe si hyn në ujëra, çfarë kërkon të lash, ti, larja dhe pastrimi i gjithë atyre që të himnojnë përjetë, o Krisht?

Po vjen të pagëzohesh në rrymat e Jordanit, o Zot, se kërkon t'i ftohësh rrjedhjet e së keqes së armikut, t'i frenosh detet e pasioneve, dhe t'u burosh besnikëve zbutje dhe falje.

O Bërës i stinëve dhe viteve,⁹⁰ pasi u bëre në kohë⁹¹ nga dhembshuria, ti që ndriçove pa mot nga Ati i parapakohshëm, mbërrite që t'i lash në rrjedhat e Jordanit fajet kronike të të gjithëve.

I hierarkut: Nikité tiranu

Pasi theologove, o atë, një natyrë të Hyjnisë unike, që kuptohet në tre persona, psalje pa pushim: Bekoni, ju gjithë veprat, Zotin, dhe e përbilartësoni në gjithë jetët.²⁶

U shpalle mësuesi i vërtetë i së vërtetës, o atë; prandaj qortove mashtrimin e dredhisë pseudonime, duke psalur: Bekoni, ju gjithë veprat, Zotin, dhe e përbilartësoni në gj-

thë jetët.²⁶

O hyjmist, u pe korife sistemi të hyjshëm dhe e stolise fronin e korifeut të nxënësve duke thirrur: Bekoni, ju gjithë veprat, Zotin, dhe e përmbilartësoni në gjithë jetët.²⁶

O atë, meqenëse e stolise shumë zemrën tënde me virtyte të perëndishme, u zbukurove i tëri, dhe u bashkove me rendet e sipërme duke thirrur: Bekoni, ju gjithë veprat, Zotin, dhe e përmbilartësoni në gjithë jetët.²⁶

Hyllindësore

Gjeneratat e njerëzve duke pasuar fjalët e tua të hyjshme, të lumërojnë ty,³¹ gjithmonë të lumurën dhe psalin: Bekoni, ju gjithë veprat, Zotin, dhe e përmbilartësoni në gjithë jetët.²⁶

I oshënarit: Ton vasilea

Në tërë dhenë doli zëri⁷⁰ i virtyteve të tua dhe Kisha e tërë e orthodhoksëve të lavdëron, o hyjmbajtës.

Nga Rusia e ndriçon botën në Shpirtin e Shenjtë me rrezet mistike të sjelljes sate, o atë oshënar.

Me fuqinë e hyjnueshme ke bërë udhën⁹² e asketizmit dhe shkove në vende qiellore⁹³ me ngazëllim, o atë.

Hyllindësore

O Virgjëreshë e kulluar, zemrën time të fëlliqur pastroje krejt nga mendime të pavend dhe shkëlqemë me ndriçimin e pendimit.

Irmosi: Ton Vasilea

»**M**bretin në qiejt,* që mbar' ushtrit'
»engjëllore* e himnojnë edhe ju him-
»noni,* dhe e lartësoni gjithnjë në të-
»rë jetët.

Ode IX

Parakremtor

Irmosi: Ton ek Theú Theón Logon

»**T**a madhështojmë me një zë, o bes-
»nikë, me himne* Fjalën e Perëndisë,
»Zotin⁹⁴ Krisht,* që parrëfyeshëm
»mori për ne* mish nga Nëna e vir-
»gjër, e shenjtë; vjen të rinovojë pra*
»krejt Adamin, që kur hëngri,¹⁵ ra në
»prishje mizorisht.

O mirëbërës, Joani kur të pa duke ardhur* drejt tij dhe t'i kërkoi pagëzim* përulësisht, fort i tëri u drodh,* dhe u shtang, nuk guxonte me dorë të të prekte ty, o Zot* që prek malet dhe nxjerrin tym,⁹⁵ se i plotfuqishmi je.

Të madhërojmë me himne si Zot dhe shpëtimtar ty,* shndritjen e lavdit që e shndriti fort* Ati⁹⁶ për sa nëpër terr uleshin⁹⁷,* brenda natë mundimesh, ty Diellin pa perëndim, o Krisht,* që po vjen t'i shkëlqesh që

të gjith' me pagëzimin tënd.

Meqë sheh pafrytësinë tënde kazma e vdekjes* që rri në rrënjë, kërcënon⁹⁸ për ty,* prerjen, si pemë pa vlerë, o shpirt;* mos qëndro më i pafryt, por thirri Perëndisë nxehtësisht* me pendim: Mëkatova përpara teje, më shpëto.

Dëgjuan zemrat e shkreta zërin që po thërriste:*³⁶ Kini dëfrim se erdhi Krishti Zot* dhe te të gjithë dhuron falje ky.* Shenjtërohuni, o det e dhé, burime, fusha me lumenj,* ju lëndina me sferën e tërë, ngazëllohuni.

I hierarkut: Kirios Theotokon

Me zell e kremtërove* veten, o i lumur,* duke i vrarë pëlqimet,⁹⁹ u bëre flijim* i mirëpritur për Zotin Jisu që vdiq për ne.

Si korife i hyjshëm* ndër shenjtorë, etër,* e shpalle dogmën hyjnore, i mbylle kështu* çdo gojë krejt të pabesë të heretikëve.

Me koret e patrupa* ti u ngjite, atë,* kundër armiqve pa trup¹⁰⁰ triumfove me lavd,* hyjmenës dhe hierark, Silvestër me zë e nam.

Hyjlindësore

Ma mirëso ti shpirtin* që e keq-trajtoi* mëkati, o Virgjëreshë që ke mirësi,* se linde Krishtin e mirë dhe

Perëndinë Zot.

I oshënarit Injëjti

Lipsani yt i shenjtë,* o i tërëlumur,* buron rrëke me shërime për çdo besimtar* që i afrohet, hedh shira fort të hyjnueshëm.

Kur pe të Tërëshenjtën* me hare u mbushe,* ndërsa tani që shikon ti shkëlqimin e saj,* o Serafim, përgjëroju gjithnjë asaj për ne.

Iri mes oshënarësh,* o i tërëlumur* shën Serafim, përtërite të moçmin njeri*¹⁰¹ nga çdo pasion; si dhuratë prite këtë himnim.

Hyjlindësore

Hyjlindëse, himnojme* rrezatimin tënd ne,* me shpirt thërresim, e tërëdëlirë, te ti:* Gjithnjë çlirona nga errësira e veseve.

Irmosi: Kirios Theotokon

»**H**yjlindëse të themi,* të pohojmë »ne që* shpëtuam, o e kulluar e vir- »gjër me ty,* me koret e të patrupve »të madhështojmë tok.

Dërgimësore

Jinekes akutisthite

Jehon një zë që po thërret:*³⁶ O male lart kërceni ju,*² dhé e gjini njerëzore,* se Fjala që nuk ka nisje* si ne njeri u bë me mish* edhe po vjen për në Jordan* ta pagëzojnë duar

pra* që vetë ky i gatoi,* ta zhdukë shkeljen e botës.

Ingjashëm

Si rrjedha e një lumi ty* do të të presin, o i Mir',* që bëre detin, lumenshtë* dhe nga mosqenia¹⁰² i nxore?* Si kokën tënde të pacen* do guxojë ta prekë, Zot,* dora e Pararendësit?* Himnojm' me tmerr lartësinë* e varfëris' sate,²⁴ Fjalë.

Lavdërime, që kanë Akrostihidhë deri në 5 të këtij muaji: "Këngë e Theofanit për Dritat".

Ting. Tërth. II E angjeliqé

Paraprin, Forcat e engjëjve, nga fshati* Bethlehem tek rrjedhat e lumit të Jordanit.* Braktise shkretëtirën,* dil dhe eja ti, o Joan.* Ki gaz edhe hijeshohu, lumë, dhe ngazëllohu dhé, se Krishti vjen ta lajë krejt* mëkatin e Adamit, si i dhembshur dhe shpëtimtar.

Ejani me gojë të pastra dhe me shpirtra* të qëruar mistikërisht, që të kalojmë* nga Bethlehem i tashmë* drejt Jordanit me Krishtin tok,* duke psalur për atë me gaz; çdo fis edhe çdo komb besërisht ju thërrisni tani:* Je i bekuar, Perëndi që erdhe,¹ lavdi më ty.

Ësht' i madh, i frikshëm misteri që po kryhet:* Si ne Perëndia u bë njeri,³² edhe pse* nuk njohu faj, më-

kat ky,*³⁴ dhe kërkon i pafajshmi sot* që të pagëzohet prej Joanit në lumin e Jordanit. Ta lartësojmë me zë:* Je i bekuar, Perëndi që erdhe,¹ lavdi më ty.

Lulja nga Davidi¹⁰³ prej Virgjëreshës lindi,* Krishti, në rrëket' e Jordanit vjen t'i lajë* në ujëra mëkatet* e stëratit, ndaj, o Adam,* hidhu dhe kërce, tok me të, Eva, dëfre; o qiell ki gaz; popuj, të themi me zë:* Je i bekuar, Perëndi që erdhe,¹ lavdi më ty.

Lavdi Injëjti

Dora e tij dridhet, ka frikë të të prekë,* por gaz ka Joani përbrenda shpirtit, kur sheh* se ti nga mirëdashja* kokën tënde, o Zot, e ul* se ti veshe formë shërbëtori,³² që ta shpëtosh prej robërisë njerin' që thërrret:* Je i bekuar, Perëndi që erdhe,¹ lavdi më ty.

Tani Injëjti

Mistikisht tani tërë dheu gaz të ketë,*¹⁰⁴ malet le të hidhen profetikisht me hir lart;*² siç është shkruar, ktheje,* o Jordan, rrjedhën¹⁷ frikë ki* para Perëndisë, Zotit Krisht, se pasi u bë njeri, ka ardhur t'i lajë për ne* të gjithë njerëzit nga gjëma, faji adamian.

Pasvargje Idhiomele Ting. Tërth. II

E Gjermanoit

U bë më e hijshme se dielli e kremtja e Lindjes së Krishtit, e cila shkoi. Tregohet e shkëlqyer dhe plot nur ajo që po vjen, e Epifanisë së tij. Në atë barinj me engjëj duke lavdëruar, i falen një Perëndie që u bë njeri; në këtë Joani sapo preku Zotin me dorën e djathtë, thoshte me tmerr: Shenjtëromë mua dhe ujërat, i vetmi që ke përdëllimin e madh.

E të njëjtit

Varg: Për këtë do të të kujtoj nga toka e Jordanit dhe e Ermoniimit.

Përgatitu, o lumë Jordan, se ja ku mbërrin Krishti Perëndi të pagëzohet prej Joanit që kryet e padukshme të dragonjve t'i dërrmojë me anën e Hyjnisë në ujërat e tu.^{104a} Ngazëllohu, o shkretëtirë e Jordanit,¹⁰⁵ ju male hidhuni me hare,² se erdhi jeta e përjetshme⁶⁶ për të rithirrur Adamin. O zë i dikujt që buçet, o Joan Pararendës, thirr: Përgatisni udhët e Zotit dhe rrugët e tij i bëni të drejta.³⁶

E Bizantit

Varg: Të panë ujëra, o Perëndi, të panë dhe u frikësuan.

Le të ngazëllohet shkretëtira e Jordanit dhe le të lulëzojë si zambak,¹⁰⁵ sepse zëri i dikujt që thërret u dëgjua në të: Përgatisni udhën e Zotit.³⁶ Se ai që malet i ngriti me balancë dhe livadhet me peshore,¹⁰⁶ dhe që të gjitha i mbush si Perëndi,¹⁰⁷

pagëzohet nga një rob. Filloi të varfërohet²⁴ ai që dhuratat e pasura i fal.⁵⁴ Dëgjoi Eva: “Në trishtime do të lindësh fëmijë”,¹⁰⁸ por tani dëgjoi Virgjëresha: “Gëzohu, o hirplote, Zoti është me ty”,¹⁰⁹ ai që ka përdëllimin e madh.

Lavdi *dhe* Tani*Ting. Tërth. IV I Anatoliut*

O Joan Pagëzor, që në mitër më njohe mua,¹¹⁰ qengjin,¹¹¹ në lumë më shërbe, me engjëj më adhuro; shtri dhe prek me pëllëmbën tënde kokën time të pacenuar; dhe kur do shikosh malet të tremben¹¹² dhe Jordanin të jetë i kthyer,¹⁷ së bashku me ta thirr: O Zot i mishëruar nga një e virgjër për shpëtimin tonë, lavdi më ty.

Dhe të tjera si zakonisht.

CITIME

¹ Ps. 117(118).27

² Ps. 113(114).4,6

³ Is. 48.18

⁴ Ps. 35(36).9

⁵ Ps. 146(147).8

⁶ Eks. 13.21; 14.24; 16.10; Num. 9.15

⁷ Vep. 9.15

⁸ Joan 14.6

⁹ Lluk. 2.9

¹⁰ Matth. 2.16-18

¹¹ Abak. 2.3; Matth. 11.3; Lluk. 7.19-20

¹² Kol. 2.14

- 13 Gjen. 3.15
 14 Gjen. 3.24
 15 Gjen. 3.1-6
 16 I Tim. 3.16
 17 Eks. 14.21; Jis. N. 3.16; Ps. 113(114).3,5
 18 IV [II] Mbret. 2.14
 19 Is. 9.1 (8.23); Matth. 4.15
 20 Gjen. 3.10
 21 Gjen. 3.7
 22 Lluk. 15.22
 23 Eks. 15.1
 24 II Kor. 8.9
 25 Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 22-23
 26 Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 34
 27 Hebr. 7.7
 28 Matth. 25.1-7
 29 Matth. 25.14-23
 30 Lluk. 1.49
 31 Lluk. 1.48
 32 Fil. 2.6-7
 33 I Petr. 5.6
 34 Is. 53.9; Joan 8.46; Hebr. 4.15; I Petr. 2.22
 35 Fil. 2.8
 36 Is. 40.3; Matth. 3.3; Mark. 1.3; Lluk. 3.4; Joan 1.23
 37 Lluk. 21.28
 38 Is. 9.2; Matth. 4.16
 39 Rom. 9.5
 40 Matth. 3.7-8; Lluk. 3.7-8
 41 Rom. 8.15-16; Gal. 4.5-6; Ef. 1.5
 42 IV Makk. 1.5-6,9,19; 2.24; 7.18
 43 Joan 17.2-3; Ef. 2.14-17; Kol. 3.15
 44 Matth. 10.38; 16.24; Mark. 8.34; 10.21; Lluk. 9.23
 44a Ps. 17(18).3; 70(71).3
 44b I Petr. 2.24
 45 Matth. 18.12; Lluk. 15.4
 46 I Joan 2.20,27
 47 Gjen. 1.7; Is. 40.22
 47a Ef. 2.20-21
 48 Gjen. 2.6-14
 49 Fil. 2.15
 50 Is. 63.9
 51 Joan 19.23
 52 Eks. 28.37(41); 30.30; Lev. 7.35-36(25-26)
 53 Ps. 22(23).1-2
 54 Jak. 1.17
 55 Hebr. 1.2
 56 Is. 26.9
 56a Is. 26.13
 57 Matth. 3.2; Mark. 1.4
 58 Dan. Suz. 52
 59 Is. 58.6
 60 Lluk. 24.32; Vep. 17.3
 61 Ps. 118(119).80
 62 II Tim. 2.17
 63 Is. 6.1
 64 Ps. 83(84).6
 65 Rom. 8.6-7
 66 Joan 1.4; 11.25; 14.6
 66a Jona 2.6-7
 67 Apok. 20.2-3
 68 II Petr. 2.4
 69 Neh. 3.15
 70 Ps. 18(19).5
 71 I Kor. 12.4
 72 Matth. 10.8
 73 I Mbret. [Sam.] 1.15; Ps. 141(142).3
 74 Ps. 87(88).4
 75 Lluk. 3.7-14
 76 Mal. 3.1; Matth. 11.10; Mark. 1.2; Lluk. 7.27
 77 Matth. 11.11; Lluk. 7.28

- ⁷⁸ I Mbret. [Sam.] 28.6,15; Joel 3.1
(2.28); Dan. 1.17
- ⁷⁹ I Mbret. [Sam.] 17.40,50; 25.29
- ⁸⁰ Dan. 3.1
- ⁸¹ Gjen. 1.26-27; 5.1; 9.6; Urt. Sol.
2.23; Sirak 17.3
- ⁸² Lluk. 15.8-9
- ⁸³ Fil. 1.11; Jak. 3.18
- ⁸⁴ Ps. 91(92).13-14
- ⁸⁵ Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 2,28
- ⁸⁶ Ps. 111(112).6; I Makk. 3.7
- ⁸⁷ Rom. 7.23-25; 8.2
- ⁸⁸ Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 25-26
- ⁸⁹ Lluk. 1.16-17
- ⁹⁰ Vep. 17.26
- ⁹¹ Gal. 4.4
- ⁹² II Tim. 4.7
- ⁹³ Joan 14.2
- ⁹⁴ Joan 1.1
- ⁹⁵ Ps. 103(104).32
- ⁹⁶ Urt. Sol. 7.26; Hebr. 1.3
- ⁹⁷ Is. 9.2; Matth. 4.16
- ⁹⁸ Matth. 3.10; Lluk. 3.9
- ⁹⁹ Kol. 3.5
- ¹⁰⁰ Ef. 6.12
- ¹⁰¹ Rom. 6.6; Ef. 4.22; Kol. 3.9
- ¹⁰² Rom. 4.17
- ¹⁰³ Is. 11.1
- ¹⁰⁴ Ps. 95(96).11; Is. 49.13
- ^{104a} Ps. 73(74).13
- ¹⁰⁵ Is. 35.1-2
- ¹⁰⁶ Urt. Sol. 11.20; Is. 40.12
- ¹⁰⁷ Ef. 1.23
- ¹⁰⁸ Gjen. 3.16
- ¹⁰⁹ Lluk. 1.28
- ¹¹⁰ Lluk. 1.41
- ¹¹¹ Is. 53.7; Joan 1.29,36; Vep. 8.32;
I Petr. 1.19
- ¹¹² Jer. 4.24



MË 5 TË TË NJËJTIT MUAJ

Parakremtja e Theofanisë dhe kujtimi i martirëve të shenjtë Theopempti dhe Theonai, dhe i oshënares Singlitiqia.

Tipikon

Nëse Theofania bie të dielën, të shtunën (sot, pra në datën 5) në Mëngjesore, në Lavdërimet, Lavdi dhe Tani (jo Duke i shërbyer, por: O Joan Pagëzor – kërkoje në Lavdinë e Pasvargjeve të Lavdërimeve të së 5-tës; fq. 66). Dhoksologjia e Madhe dhe Përlëshorja (Mbrapa kthehej krejt dikur; fq. 49).

Në Liturgji, Tipiket. Lumërimet nga Kanuni Parakremtor: 4 nga Ode III dhe 4 nga Ode VI. Pas Hyrjes: Ejani t'i falemi..., o i çuditshëm ndër shenjtoret. Përlëshoret: Parakremtoje (Mbrapa kthehej krejt dikur), e kishës dhe Kontaqi i së sotmes (Në Jordan afrohet sot). Apostulli dhe Ungjilli i së Shtunës para Theofanisë. Të meriton. Kungatore: Lum ata që i zgjodhe. Pamë dritën. Pas Uratës prapa Amvonit (pa thënë Emri i Zotit), Ajazma e Madhe: Idhiomelet Zër' i Zotit mbi ujërat etj.

Hahet vaj dhe verë.

Të shtunën në Mbrëmësore (nuk lexohet Psaltiri), pas Leximit të fundit, menjëherë Apostulli dhe Ungjilli. Le të themi. Bëna të denjë, o Zot. Le ta plotësojmë. Pasvargjet etj.



NË MBRËMËSORE

*Thirrtoje**Ting. IV Os jeneon en mártisin*

Theopemptin dhe Theonan'* mjaft të urtë ne ti himnojm',* se iu bindën dogmave të Jisuit Krisht,* çdo adhurim të paligjkshëm shfuqizuan shkëlqyeshëm* të vërtetin adhurim* e nderuan plot me besim* dhe pohuan fort* para faqe tiranësh një Zot edhe Perëndi, ndaj për këtë u kurorëzuan nga lart me lavd.

O martirë me nam të madh,* çdo shijim, prehje dhe lavdi,* që pëlqim shkaktojnë, joshje dhe kotësi,* por që shpejt vyshken, ndaj i braktisët si të përkohshme ju,* dhe u ngjitet tok me zell* pas thesarit pra më të madh,* pas Jisuit Krisht,* dhe iu sollët si trëndafila erëkëndshëm, u kurorëzuar në të paprishurën Mbreteri.

Botën mbarë urreyet fort,* dhe mbi botën u patë ju* të bashkuar me Kish' të parëlindurish;*² dhe bashkëpsalët me engjëjt këngë edhe himnim pa cen* para Perëndisë Zot,*³ duke ndenjur përballë tij,* si rrëzuar ju* çdo mashtrim të paligjshëm idhujsh, edhe mposhtët me martirizimin mani tiranësh me trimëri.

*Të oshënares**Ting. I Ton uranion tagmaton*

E dëshirove lavdinë vërtet të Etërve* për çmimin që nuk prishet* aspirove, ndaj dole,* ike nga të ëmbla dhe trupin tënd* dorëzove në çdo mundim* dhe merr tani ti shpërbliet e lodhjeve* dhe me Krishtin bashkë mbretëron.⁴

Ai që Jovin dha, kur e kërkoi pra dikush,* ndaj deshi që dhe ti pra* zjarr të ndizesh si ari,*⁵ la që trupi të pësojë dhunim* nga dinaku;⁶ por ngasësin,* duke duruar sëmundje, e mposhte krejt,* ndaj kurorën e fitores vë.

Kur bukurinë e pashme të dhëndrit Jisu Krisht* e deshe, dëshirove* të martohesh me të tok;* ndaj me lodhje asketizmi dhe mund,* me të mirat e shumta ti* qënke stolisur, dhe po mbretëron me të*⁴ brenda nusërores lart tani.

Lavdi *dhe* Tani*Ting. Tërth. II I Gjermanoit*

Përgatitu, o lumë Jordan, se ja ku mbërrin Krishti Perëndi të pagëzohet prej Joanit që kryet e padukshme të dragonjve t'i dërrmojë⁷ me anën e Hyjnisë në ujërat e tu.^{7a} Ngazëllohu, o shkretëtirë e Jordanit;⁸ ju male hidhuni lart me hare,⁹ se erdhi jeta e përjetshme¹⁰ për të rithirrur Adamin. O zë i dikujt që buçet, thirr, o Joan

Pararendës: Përgatisni udhët e Zotit dhe rrugët e tij i bëni të drejta.¹¹

*Pasvargje**Ting. Tërth. II**Triimeros anestis Hristé*

O dhé dhe tokësorë ju tok* gëzohuni¹² dhe hidhuni,* ja përroi* i shijimit¹³ në Jordan,* në lumë pagëzohet, than derdhjen e së keqes* edhe buron ndjes' të hyjnueshme.

Varg: Për këtë do të të kujtoj nga toka e Jordanit dhe e Ermoniimit.

Edhe pse dritëdhënësi Zot* nevojë s'ka për pagëzim,* Jisu Krishti,* shkel në rrjedha, në Jordan,* se do që t'i ndriçojë sa janë brenda territ.*¹⁴ Le ta mikpresim me gatishmëri.

Varg: Të panë ujëra, o Perëndi, të panë dhe u frikësuan.

Si veshe formë robi,¹⁵ o Krisht,* ti merr nga robi pagëzim* brenda lumit* në Jordan, dhe na çliron* nga skllavëri e shkeljes së moçme¹⁶ na ndriçon¹⁷ ne* dhe na pastron, na lan, na shenjtëron.¹⁸

Lavdi *dhe* Tani*Ting. Tërth. II I Bizantit*

Le të ngazëllohet shkretëtira e Jordanit dhe le të lulëzojë si zambak,⁸ sepse zëri i dikujt që thërret u dëgjua në të: Përgatisni udhën e Zotit.¹¹ Se ai që malet i ngriti me balancë dhe livadhët me peshore,¹⁹ dhe që të gjitha

i mbush si Perëndi,²⁰ pagëzohet nga një rob. Filloi të varfërohet²¹ ai që dhuratat e pasura i fal.^{21a} Dëgjoi Eva: “Në trishtime do të lindësh fëmijë”.²² Por tani dëgjoi Virgjëresha: “Gëzohu, o hirplote, Zoti është me ty”,²³ ai që ka përdëllimin e madh.

Përlëshore

Ting. IV Kateplaji Iosif

Mbrapa kthehej krejt dikur* lumi Jordan me një gëzof* të profetit Elise,* pasi Ilia u ngjit lart;* u ndanë ujërat pra në dy pjesë më dysh,* dhe iu bë si udhë përmbi steré*²⁴ udh' e lëngshme pra si ikonizim* për ne vërtet, si tip për pagëzimin;* me të përshkojmë ne jetën,* kalimin që rrjedh.* U shfaq qart' Krishti* në Jordan, shenjtëron uj'.



NË PASDARKË

Kanuni që ka Akrostihidhë (pa Irmoset e katër Odeve të para): “Dhe sot e psal të shtunën e madhe”.

Ting. Tërth. II

Ode I

Irmosi: Kímati thalasis

»**Z**otin, që një herë* në valët e detit »e mbyti ndjekësin,*^{24a} në një varr »sot e shtrijn'* Djemt' e çliruar prej »zgjedhës,* porsì vajzat ne po mbli- »dhemi* dhe thërresim besërisht: »Lavdi të lavdëruarit.^{25*}

O Zot, Perëndia im, do të të psal himn dritëquajtur dhe këngë para-kremtore ty, që me Theofaninë hyjnore më rilind mistikisht dhe më risjell tek shkëlqimi i hyjshëm.

Lart para jete dhe poshtë para pak kur u paraqite, duke të parë të përmbibotshmet dhe ato që janë rreth tokës, çuditëshin dhe e përhimnonin bashkëzbritjen tënde përmbi mendim.

Që t'i mbushësh me lavdinë tënde të gjitha, e zbraze veten tënde deri në formë robi;¹⁵ dhe tani për kul si rob kokën nën pëllëmbën e robit, duke dhuruar rigatimin dhe pastrimin tim.

Ode III

Irmosi: Se ton epí idhaton

»**T**i që steren' e vare* mbi ujërat pa »asnjë far' mbështetje*²⁶ Krijesa e »tmerruar të pa të lindur në shpell' »tani,* dridhej dhe thirri me çudi: »S'ka tjetër shenjt si ti,* ti je Zot²⁷ i »madh i jetëve.*

Më parë u tregove disi profetëve simbolet e Theofanisë sate; por tani kur u shfaqe, misteret e fshehura ua bëre të njohura sot njerëzve nëpërmjet energjive, duke shpërndarë rilindje të re.

I shtriu Jordani me tmerr ujërat si shpinë, që ta pranojë Ndërtuesin që

pagëzohej trupërisht, i cili i shenjtëron të gjithë që thërrasin.¹⁸ S'ka tjetër shenjt përveç teje, Zot.²⁷

Pagëzimin u jep Krishti si furnizim të madh për shpëtim atyre që ndiejnë shkëlqimin e tij hyjnor, të cilët psalin me hare: S'ka tjetër shenjt përveç teje, Zot²⁷ njeridashës.

Ode IV

Irmosi sipas: Tin en stavró su

»**A**rdhjen tënde drejt pagëzimit
»duke e paraparë Abakumi, thërriste
»i shtangur: I hipe në det kuajt e tu
»duke trazuar ata ujëra të shumtë,²⁸
»o Shpëtimtar.

Kur u shfaqe madhërisht në trup, toka u shenjtërua, ujërat u bekuan, qielli u ndriçua dhe gjinia e njerëzve u çlirua nga tirania e hidhur e armikut.

Me anën e një fjale hyjnore, tani Pararendësi vjen nga shkretëtira drejt Jordanit duke thënë: Pendohuni, u afrua Mbretëria e Qiejve,²⁹ e cila i thërret të gjithë për lavdinë e Perëndisë.

Ai që më parë e ktheu detin në steré³⁰ dhe gurroi burime nga i thepisuri,³¹ e bën tani rrëkajën e Jordanit shkritore fajesh me zjarrin e Shpirtit.

Ode V

Irmosi sipas: Theofanias su Hristé

»**K**ur Isaia e pa dritën e paperën-
»dueshme të Theofanisë sate, që u
»bë te ne nga simpatia, qëmenatë
»mëngoi³² dhe thërriste: Ju të ndri-
»çuar erdhët, lahuni dhe pastrojeni³³
»si shpirtin, edhe trupin qartazi në-
»përmjet ujit të hyjshëm dhe Shpirtit.

Iripërtërit në zjarr, Shpirt³⁴ dhe ujë të dhëlindurit, pasi u bërë Adam i ri,³⁵ ti Gatuesi, dhe kryen një rilindje të huaj dhe rigatim të çuditshëm pa thyerje dhe fondëri, duke i rinovuar me pagëzim hyjbërës.

Me anën e Shpirtit rinovon shpirtra, ndërsa me anën e ujit trupin, duke rigatuar njeriun, qenien e gjallë të përbërë; sepse si mjek trupash dhe shpirtrash, sjell dobishëm me përkujdesje të urtë ilaçet e përshtatshme tek i dyfishti.

Pasi dole nga nënë pa shtrat burri, ti që linde nga Ati para jetëve, mbërrite tek ai që lindi nga një shterpë,³⁶ duke kërkuar si njeri pagëzim; mirëpo nga uji mistikërisht nëpërmjet Shpirtit e bërë me shumë fëmijë Kishën e pafrytshme më parë, o Spëtimtar.

Ode VI

Irmosi sipas: Sineskethi al u kateskethi

»**U**kap, por nuk u zotërua nga frika
»Pagëzori i hyjshëm; sepse megj-

»thëse druajti t'i afrohej bari zjarrit,
 »kur dëgjoi "Lër tani", rendi duke
 »përmbushur urdhrin si shërbëtor,
 »dhe dëgjoi zë hyjnor nga lart që
 »dëshmonte Birin e parajetshëm.

U regjistrove duke iu bindur institucioneve të Qesarit,³⁷ por nuk u skllavërove; sepse megjithëse vullnetarisht tërhiqesh dhe paguan dy dhrahmitë³⁸ duke na dhënë ngushëllim për robërinë, por tani na çlirove ne të shiturit te ligji i mëkatit,³⁹ dhe na denjësove për birësim.⁴⁰

Mmbretëron, por jo sipas botës, duke qenë nga natyra Mbret; ndonëse linde sipas mishit nga fisi i Davidit⁴¹ dhe e more fronin e mbretërisë së tij,⁴² o Shpëtimtar, e ke të përhershëm pushtetin, duke mbretëruar tok me Atin, gjithmonë para jetëve dhe në jetët bashkë me Shpirtin.

Arkondi i botës⁴³ qëmoti u mbiquajt edhe mbreti i atyre që janë në ujëra; por mbytet me pastrimin tënd dhe rrëzohet si Legjioni në liqen;⁴⁴ ndërsa krijimin e duarve të tua, që u skllavërua prej tij, e vlerësove për liri me dorën tënde të fuqishme, o Shpëtimtar.

Ode VII

Irmosi sipas: Afraston thavma

»Çudi e pashprehshme! Ai që në
 »furrë shpëtoi nga flaka Djemtë

»oshënarë, përkul kryen dhe kërkon
 »pagëzimin nga rob i pastruar
 »ata që thërrasin: Çlirimtar, Perëndi
 »je i bekuar.

Pritet më parë rryma jordaniane me anën e gëzofit,²⁴ që paraikonizonte pagëzimin tënd, përmes të cilit grisit këmisha e pasioneve⁴⁵ dhe përpunohet veshje paprishjeje⁴⁶ për ata që thërrasin: O Krisht Perëndi, je i bekuar.

Rrëke e pasur! Sepse kur priti brenda saj të pagëzuarin Krijues, u tregua burim rrjedhjeje jetëprurëse për shpëtimin e neve që psalim: Çlirimtar, Perëndi je i bekuar.

Duke ikonizuar simbolikisht vdekjen e hyjshme me zhytje të trefishtë në ujë, varrosemi tok me Krishtin në pagëzim,⁴⁷ duke u kunguar në ngritjen e triditshme⁴⁸ dhe duke i thirrur Krishtit: Je i bekuar.

Një është Hiri i Atit, i Birit dhe i Shpirtit, që i përsos ata që pranojnë besërisht dhuratën e pagëzimit hyjnor dhe që morën pushtet birësimi⁴⁰ për të thirrur: O Perëndi, je i bekuar.

Ode VIII

Irmosi sipas: Ekstithi friton urané

»Shtangu i frikësuar, o qiell,⁴⁹ dhe le
 »të lëkunden themelet e dheut;⁵⁰ se
 »pse ja ku mbështillet me ujë ai që

»dogji më parë me ujëra flijimin e një
»të drejti paradoksalisht.⁵¹ O Djema
»e bekon, priftërinj e himnoni, popull
»e lartësoni⁵² përherë dhe përjetë.

Vjen Krishti që t'u japë të gjithë besë-
mirëve çlirim me anën e pagëzimit;
sepse në të e pastron Adamin, e lar-
tëson të rënë, e turpëron tiranin që
e vithisi, i çel qiejt, tërheq Shpirtin
Hyjnor dhe dhuron kungimin e papi-
shjes.

Pushoi mashtrimi i armikut, sepse
zëri i dikujt që thërret në shkretëtirë
buçet: "Hijeshojeni udhën e Zotit",
dhe urdhëron: "I bëni të sheshta të
gjitha rrugët e tij";⁴¹ sepse gryka e
ulët, natyra e njerëzve, lartësohet;
ndërsa mal dhe kodër keqdashësish
ulet.⁵³

O dhurata paradoksale! O Hir hyjnor
dhe durim i pashprehshëm! Sepse
ja ku me ujë më pastron, me zjarr
më ndriçon dhe me Shpirt Hyjnor³⁵
më përsos Gatuesi dhe Zoti tani në
Jordan, kur veshi pa mëkat natyrën
time.

Ode IX

Irmosi sipas: Mi epodhiru mu miter

»**M**os vajtoni kot, o njerëz, përgjegjës
»të këqijash, duke u mbytur me leqe
»dëshpërimi, por me kataniks shpirti,
»le të vijmë afër atij, që si i vetmi i
»pastër, i pastron të gjithë dhe jep

falje përmes pagëzimit.

O Fjalë e Perëndisë, u bëre i çudit-
shëm mbi mendje më parë me lin-
djen tënde të huaj nga e Virgjëra; por
tani madhërohesh duke kryer mister
të madh paradoksalisht me pjesë-
marrjen e nderuar: E bën kolimvi-
thrën me shumë fëmijë me anën e
Shpirtit Hyjnor.

Toka u shenjtërua me lindjen tënde
të shenjtë, o Fjalë, kur qiej bashkë
me yj rrëfenin lavdinë tënde;⁵⁴ por
tani u bekua natyra e ujërave kur u
pagëzove në mish, dhe gjindja e të
dhëlindurve u rikthye përsëri tek ari-
stokracia e mëparshme.

Le të ngazëllohet i tërë dheu, qielli
le të dëfrejë,⁵⁵ bota le të hidhet lart,
lumenjtë le të duartrokas, bu-
rimet dhe liqenet, avusha, dete le
të gëzohen së bashku; sepse erdhi
Krishti që ta pastrojë Adamin dhe ta
shpëtojë me pagëzim hyjnor.



NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së parë, Ndenjëso

Ting. I Horós angelikós

(=Ton tafon su Sotír)

Dëfre, o lum' Jordan,* se te ti duke
dashur* vjen Bërësi i çdo gjëje,
pret pagëzimin* nga dorë robi si i

dhembshur; gëzohu pra, o Adam,* dhe kërceni tok* me Evën tënde, stërnënën:* Perëndia Krisht* i Përmbimiri ka ardhur,* çlirimi⁵⁷ i Gjithësis'.

Lavdi *dhe* Tani

I ngjashëm

Edhe pse Zoti Krisht* është përrua shijimi,*¹³ po del të pagëzohet në rrjedhat e lumit,* me rrjedhjet e pavdekësisë kërkon ky të më ujit'.* Kur e pa atë* me tmerr Joani thërriste:* Dorën si ta shtrij* mbi kokën që fort e druan,* çdo anë e rruzullit.

Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjëso

Ting. III Tin oreótita

Të gjithë ta himnojm'* të Mirin Perëndi* të fortmëshirshmin Zot* të pakuptueshmin,* që mishërisht u bë i varfër²¹ dhe vjen drejt pagëzimit,* dhe që rigatim për ne* përmes tij bën; ta madhësojm'* bashkëzbritjen e atij,* duke thirrur nga shpirti thell',* me zemër ngazëlluese: Lavde* Theofanisë sate, o Krisht.

Lavdi *dhe* Tani

I ngjashëm

O Zot i dhembshur fort,* do zhvishesh mishërisht,* në lumë, në Jordan* Adamin që u zhvesh⁵⁸* se ti do që ta veshësh me stoli lavdi; ç'mrekulli pra!* Uji si do të të pres'* ty që vendet e sipërme* i strehon me ujëra,* siç u shkrua,⁵⁹ ndaj gjithë

ne* himnojmë, o Jisu mirëbërës,* Theofaninë tënde, o Krisht.

Kanunet: Parakremtor me Irmoset në 6, i oshënares në 4 dhe i martirëve në 4.

Ode I

Kanuni Parakremtor

Poezi e Josifit

Ting. I

Irmosi sipas: Hristós jenate

»**K**ur Izraeli nga robëri e hidhur u çlirua, si në sterë* përshkoi atë që s'shkelej dot* edhe sheh se armiku »zhytet; këndon pra me gaz te Zoti,* »që me krah të lartë⁶⁰ bën çudi, se »ka lavdi.

Te pagëzimi vjen Krishti, në Jordan hyn Perëndia, në ujëra* varros fajet tona si i mir'* Krishti Zot; le ta përhimnojmë atë me hare në zemër,* se me krah të lartë⁶⁰ bën çudi, se ka lavdi.

Le të pikojnë hare edhe gëzim përherë retë lart me dëfrim* Jisui Krisht në Jordan po vjen,* që të na zhytë brenda ujit të tij çdo lumë të fajit,* duke na dhuruar shndritjen që të gjithëve.

Ja drita⁶² shfaqet me madhështi, ja zbutja⁶³ po tregohet sot haptazi,* ja vjen Shpëtimtari për ata* që rrinë nëpër terr, t'i feksë me drita;¹⁴ po le ta presim* me hare e gaz dhe

mendje të pastruara.

I oshënares

Ting. II

Dhefte laí

E dëshiroj* me himn kujtimin tënd ta lavdëroj* dhe ta kurorëzohj dhe pse nuk di muzikë dhe jam i tëri i ndotur;* ndaj lutu dhe më jep ti fjal' të dëlir', urti.

Mendje dhe shpirt* drejt lartësisë hyjnore i ngre;* kur gjendjen e avushës të së mirës dhe shijimin e saj krejt e njohe,* nga gjërat dhe nga fisi ti u largove shpejt.

Ngrije gjithnjë* mendjen drejt të Shumëlartit Zot ti,* e lehtësoje trupin me mundime, dhe pse poshtë ish ngjitur me tokën* që bota e lakmon, por deshe fort lavd të madh.

Hyjlindësore

Mbeti siç qe* dhe kur nga barku yt mori trup, mish,* dhe na dhuroi ç'ishim më par',⁶⁴ edhe pse ne ishim nga balta,^{64a} Hyjnënë,* pasi nga fajet, shkeljet ky na çliroi krejt.

I martirëve

Ting. i Rëndë

Asomen to Kirio

Ejani, o shpresëtarë, me një zë ta festojmë kujtimin tepër të lartësuar të athloforëve, duke lavdëruar Krishtin me këngë shpirtërore.⁶⁵

Athloforët e Krishtit dhe përluftarët e fortë të besimit, pasi u armatosën kundër pabesisë, fituan fuqishëm kundër armiqsh.

Përndjekësi i pabesë dhe i huaj për besën e Krishtit, i cili u ndez nga mania kundër athloforëve, u asgjësua me anën e besës, i rremi në besim.

Hyjlindësore

Grigjën që e fitove, o Hyjnënë, shpëtoje nga çdo nevojë, duke lypur Shpëtimtarin dhe Perëndinë tonë.

Ode III

Parakremtor

Irmosi sipas: To pro ton eonon

»**S**'duhet kurr' i vdekshmi* të kre-
»nohet kur ka pasuri e urti,* por kur
»besim i ka ky Zotit⁶⁶* dhe me zë
»orthodhoks fort* kështu psal drejt
»Krishtit Perëndi* gjithnjë: Mbështet-
»më mbi gur të sigurt,* përmbi ur-
»dhrat që na dhe.

Biri që u ul tok* para jete me Atin dhe Shpirtin në fron,* tani në fund u mishërua* nga e Virgjëra siç di,* Jisui, dhe vjen për pagëzim* dhe ne të gjithë me larjen e shenjt'* na dhuron pavdekësi.

Meqë Krishti deshte* t'i varroste mëkatet në lumin Jordan* drejt rrymës si i dhembshur po vjen,* dhe ne që ishim prishur* përmes pagëzimit

na shpëton,* na rigatuan porsì Pe-
rëndi,* edhe na dhuron plot hir.

Zhivshesh ti me dashje* dhe mbë-
shtjell mirë zhveshjen e turpshme që
kish* stëratì yn', Adami,⁵⁸ dhe po* e
mbështjell veten tënde* me valët e
lumit ti, o Krisht* që më të lartat me
ujë shtrehon,⁵⁹ o përdëllimtar unik.

I oshënares: Steréoson imás

S'kurseve fare mishin, edhe pse ky*
shtrëngohej pa masë nga shumë
plagë,* pra me lodhjet e stërvitjeve*
e zmbrapse mbrapa satanin, nga-
cmuesin.

Ke preferuar ecjen tepër të ngusht',*
shkaktaren e jetës që nuk njeh pri-
shje* udh' të gjerë ke shpërfillur
krejt,*⁶⁷ pra më të keqen sipas nje-
rëzve me mend.

Ti lulen e fytyrës së ngrohtë fort* e
shkrive me mund, vetëpërmbajtje,*
dhe me lodhjen, lotët si rrëke,* ti fla-
kërimin e syve e shuaje.

Hyllindësore

Si, o e paqortueshme, Fjala Zot* që e
mishërove ti pagëzohet?* Shembull
për pastrim pa ndotje la,* kërkonte
mishin ta lante nga çdo njoll' ky.

I martirëve: Estereothi i kardhia mu

Mbrojtësit e shpresëtarisë dhe të

besimit, athloforët e hyjshëm, le t'i
mburrim, Theopemptin dhe Theona-
në e kënduar.

Meqenëse martirët e mëdhenj të
Krishtit u shfaqën kanun, model
dhe shembull, u bënë udhëzuesit e
shenjtorëve drejt luftimit.

Duke e pasur zili jetën e tyre të
virtutshme, dëshmorët duke qën-
druar kolektivisht mbi podium, thërri-
snin: Të gjithë jemi të krishterë!

Hyllindësore

Linde nga një e Virgjër pa shpjegim,
u shfaqe si deshe nga mirësia dhe
e rinovove botën, o Zot njeridashës.

Irmosi: Estereothi i kardhia mu

»**U** siguraa zemra ime në Zotin, u
»lartësua briri im në Perëndinë tim
»dhe u zgjerua goja ime mbi armiqtë
»e mi.⁶⁸

Ndenjësores e oshënares

Ting. Tërth. I Ton sinánarhon Logon

Kapërceve, o nënë, në lodhje mur-
gjërit* ndaj rri në qiell, në vend të
shënuar⁶⁹ edhe shijon,* dhe je mbu-
shur me lavdin' më të shkëlqye-
shme* se si përshkove burrërisht*
udhën fort të ashpër, kore mbi të
përkohshmet triumf* dhe me lavd
engjëjsh po kungon tashmë, se në
jetë ngjave krejt me ata.

Lavdi *I martirëve**Ting. I Ton tafon su Sotir*

Upe si hierark* i dërguar prej Zotit* mbi dhënë poshtë, si hierark në të lartat* përmes dënimesh dhe torturash, se shkele drejt urdhrat ti* të tiranëve* dhe thirre: Vetëm Jisuit* nder i jap se ky* në lum' Jordan i varrosi* mëkatet e njerëzve.

Tani *Parakremtor**Ingjashëm*

Në rrjedha lumi vjen* se kërkon pagëzimin* nga mirëdashja shiu i madh dhe Joani* i hyjshmi Pararendës duke u shtangur i tha atij:* Njollë s'ke aspak,*^{69a} si do të të pagëztoj pra?* Dorën si ta shtrij* mbi kokën që po shkaktonte tmerr* në botën e tërë pra.

*Ode IV**Parakremtor**Irmosi sipas: Ravdhos ek tis rizis*

»Kishte dëgjuar qëmoti Abakumi,
»i mrekullueshmi yt, dëgjimin tënd,
»o Krisht, dhe thërriste me frikë:
»Perëndia nga Themani do të arrijë
»dhe shenjtori nga mali i dendur,
»hijeplotë që t'i shpëtojnë të mirët e
»tu;⁷⁰ lavdi fuqisë sate, o Zot.

Nxirrni ujë⁷¹ jete, sepse ja ku arriti tani lumi i paqes⁷² me të vërtetë, që t'i thajë ujërat e turbullta të pabesisë dhe që t'u burojë ndriçimin atyre që këndojnë: Lavdi fuqisë sate, o Zot.

Dëfre, o shkretëtirë që kisha etje⁸ më parë, natyra e tërë e njerëzve; tani u shfaq përroi i shijimit¹³ duke zgjidhur thatësinë e mëkatit në rrëketë e Jordanit. Atij i këndojmë besërisht: Lavdi fuqisë sate, o Zot.

Zëri i dikujt që thërriste profetikisht kumboi në mendjet e shkreta duke thënë: Përgatisni udhë të drejta¹¹ për Krishtin që vjen të na ripërtërijë me pagëzim ne që u vjetëruam. Vendimin e lashtë⁷³ ai e zgjidh.

I oshënares: Elilithas ek Parthenu

Duke u dalluar për sa u përket bukurive të trupit, u bëre për shumë njerëz shkaktare e shikimit të palumtur; prandaj kur e prishe veten tënde, u kungove me bukurinë hyjnore.

Durove si Jovi mundimin e trupit, nuk lëshove fjalë që tërhiqte vdekjen;⁷⁴ dhe pasi iu binde kohës dhe natyrës, u ngrite drejt banimi të hyjshëm.

Uizolove nga të afërmit, prindërit dhe pronat, duke u pajisur me Krishtin, të vetmin unik, pasurinë e pavjedhshme dhe të pashpenzueshme; me të u pe pjesëmarrësja e lavdisë nga lart.

Hyjlindësore

Lindja jote çliroi Adamin nga prishja, sepse zënia u bë mbi njeri, pa prishje njeribërëse; prandaj më çliro, o Vaj-

zë, nga prishja e të këqijave.

I martirëve: Isakíkoa tin akoín

Martirët e mëdhenj të Krishtit ujitën mbarë botën me fjalë të perëndishme dhe asgjësuan mashtrimin.

Me të vërtetë athloforët gjetën pasuri të pavjedhshme dhe përbuzën pasuri, lavdi dhe shkëlqim të të mbi-dheshmeve.

Athloforët e Krishtit, si u blinduan me armën e Krishtit, me të rrëzuan të gjithë brutalitetin e tiranit.

Hyllindësore

O nënë e pacenuar, e bekuar, Virgjëreshë e kulluar, shpëto nga çdo peripeci ata që të himnojnë.

Ode V

Parakremtor

Irmosi sipas: Theós on irinis

»**O** Krisht, shkëlqej dritën e pa-
»perëndueshme në zemrat e atyre
»që të himnojnë me besim, duke na
»dhuruar paqen tënde⁷⁵ mbi men-
»dje,⁷⁶ që duke rendur nga nata e
»paditurisë drejt ditës së porosive të
»tua, të të lavdërojmë, o njeridashës.

Duke qenë mbret paqeje, o Krisht,⁷⁷ zbertheve mesmurin e armiqësisë,⁷⁸ kur u duke mbi tokë me ngjashmëri mishi,¹⁵ prandaj Joani sapo pa ar-

dhjen tënde, shtangej me frikë, teksa urdhërohej të vendoste dorën mbi ty.

Duke nxituar që t'i dërmojë kryet e dragojve,^{7a} Krishti mbërrin tani në ujëra, dhe i thërret Pagëzorit që trembet: Shtrije dorën tënde dhe preke kokën time, dhe hidhe poshtë frikën, duke kryer çka të urdhërohet.

Dikur një profet deklaronte në Shpirtin Hyjnor hirin e pagëzimit kur i goditi me gëzof rrjedhat e Jordanit. Ato u ndanë²⁴ duke na hapur udhë për rilindjen e hyjshme të Krishtit, që u shfaq në këto.

I oshënares: O tu fotós horigós

Oe urtë, je bërë tempulli i Fjalës që banon në shpirtra të kulluar, sepse ti e hijeshove bukurinë e shpirtit tënd në ushtrime të shumta asketizmi, o e tërëlavdishme.

Me shumë lodhje e vrave mishin⁷⁹ me bukurinë e të kuqit tënd me hir natyror, më shumë duke e hijeshuar me dritën e virtyteve ikonën e shpirtit, e cila shkëlqente hirshëm.

Pasi e dogje materialin e trupit me dashurinë për Krishtin në shpirtin tënd, tani me të vërtetë ngazëllohesh në mënyrë të palëndshme së bashku me engjëjt e palëndët duke soditur Perëndinë.

Hyjlindësore

Kreu i besëmirëve,⁸⁰ ai që lindi vërtet pa mbjellje nga mitra jote, i dërrmoi tani kokat e dragojve që kishin fole në rrjedha.^{7a}

I martirëve: I orthrizontes, Loje

Athloforët e urtë, ushtarët e besimit pranuan kurora, pasi kolektivisht fituan me burrëri kundër torturave të armiqve të paligjshëm.

As përkëdhelje, as mashtrim, as lavdia e tokësoreve nuk mundi ta prishte udhën tuaj të besës,⁸¹ o atletë, ndaj ngazëllohuni.

Duke qëndruar pa pushim tok me engjëj pranë fronit³ të lavdisë së Zotit, ndërmjetoni që t'u jepet zbutje mëkatesh atyre që ju himnojnë me besim.

Hyjlindësore

Oe Tërëshenjtë, Virgjëreshë hirplote, që linde brenda kohës Fjalën mbi mendim, lypi atij që t'i shpëtojë shpirtrat tanë.

*Ode VI**Parakremtor**Irmosi sipas: Splahnon Ionán*

»**P**o rrethohem ngusht'* nga pa-
»sionet pa mbarim* në mes të kë-
»qijash piqem, digjem zjarr* si në
»peshk të madh,* më nxirr, o Perëndi
»si Jonanë dikur* nga çdo prishje;

»kam besim, më jep çlirim vesesh,*
»kështu* me zë lavdi dhe me shpirt*
»të vërtetë për ty të flijoj,⁸² o Zot.

Shumë dhembshuri^{83*} Krishti Zoti shfaq për ne* dhe vjen si një skllav,¹⁵ i pandryshueshmi;* po vjen tek një rob* dhe kërkon pagëzim, njerëzinë rrëmben,* e çliron nga robëri, por Pararendësi* trembet* edhe druhet pa kufi,* se habitet me ardhjen e tij të shenjt'.

Si rrëke në lum'* do të të pranojnë pra* ty zjarrin që s'ka kufi, që vjen tani?* Dhe si engjëjt lart* pra në qiell do shohin të zhvishesh mbi dhe?*

Si Joani dorën do ta shtrijë, Zot, mbi ty,* Fjalë* parapafillim, pa mot,* që prej dheut e bëre^{64a} o Perëndi.

Det u nda më dysh,* ikën³⁰ edhe shpall kështu* kalimin e hyjshëm të një populli* që do ish i ri;* e krijoi kur erdhi në lumë me mish* Krishti që ka nxjerrë rrjedha me çudi në gur,* ujë;*³¹ ta lëvdojm' atë si Zot * që e ngriti dërrmimin e njerëzve.

I oshënares: En aviso ptesmaton

Kur shkëlqeve me dritën e Shpirtit Shenjt',* zmbrapse çdo kënaqje të orekseve në mish,* sepse mall edhe dashuri* për të mirat të kishte plagosur ty.

Pra më fort se fosfori kujtimi yt* sot

po llamburit, dhe errësirë me stuhi* në shpirt ky i ndriçoi nur;* bukuri për asketët, murgeshat je.

Modesti të dëlirë ke ruajtur,* sepse dëshiroje dhomën e paprishshme lart;* nga dashuria për Krishtin,* që është dhëndri i huaj, u ndeze zjarr.

Hyllindësore

Që të mbushemi ne me lavdi dhe nder,* Zoti i lavdisë⁸⁴ erdhi te dikush pa lavd,* se Biri yt porsi njeri* lahej dhe lavdëronte pra njerëzit.

I martirëve: O Ionás ek kilias

Martirët duke u stërvitur në stadium, shfuqizuan mashtrimin e idhujve dhe zhdukën çdo pabesi nga toka me anën e atletizmit të tyre.

Armiku dhe përndjekësi i besimit rreshtoi shërbyesit e tij me shpata të zhveshura, që t'ju vrisnin hidhërisht si qengja ju, o martirë të lavdëruar.

Sapo patë ju, kori i shenjtorëve, tiranët e armatosur me shpatë, thërrisnit pa pasur frikë: Jemi ushtarët e Krishtit,⁸⁵ o gjykatës.

Hyllindësore

Mos pusho së lypuri Perëndinë që linde pa shpjegim, o Perëndilindëse, që të shpëtojnë nga rreziqet ata që të himnojnë, o e Gjithmonëvirgjër e kulluar.

Irmosi: O Ionás ek kilias

»**J**onai prej barku Hadhi thërriste:
»Nxivre nga prishja jetën time;⁸² ndër-
»sa ne të thërrasim: o Shpëtimtar i
»tërëfuqishëm, mëshirona.

Kontaqi Parakremtor

Ting. IV Epefanis símeron

Në Jordan afrohet sot,* mbreti i q'ellit,* Shpëtimtari Zoti Krisht,* dhe shën Joanit i thërret:* Mos u trondit, por më pagëzo;* vij për shpëtimin e gjindjes së njerëzve.*

Shtëpia

Nuk këmbëngul, o Pagëzor, të tejkaloosh kufijtë, nuk të them: "Thuamë sa u thua të paudhëve dhe këshillon mëkatarët";⁸⁶ vetëm pagëzomë duke heshtur dhe duke pritur rrjedhojat e pagëzimit; sepse do të kesh për këtë një gradë që nuk ka qenë ndër engjëjt;^{86a} se do të të bëj më të madh nga gjithë profetët;⁸⁷ sepse askush nga ata nuk më pa qartas, por në simbole, në hije dhe ëndrra,⁸⁸ ndërsa ti më shikon të qëndroj para teje vullnetarisht; për Adamin vij, për shpëtimin e gjindjes së njerëzve.

Sinaksari

Më 5 të të njëjtit muaj, kujtimi i martirëve të shenjtë Theopempti dhe Theonai.

Vargje: Le të thotë Theopempti si mbaron:/ Mbaroj si atlet, me kokë të prerë prej shpate.

Theona martiri thërriste psalmikisht:/ Më vunë në gropën më të poshtme.⁸⁹

Në të pestën, Theopempti la këtë jetë me shpatë.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i shën Singlitiqisë.

Vargje: Singlitiqia sapo la skllavëri jete,/ është bashkë me shërbëtorë të zgjedhur të Perëndisë në qiell.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atit tonë oshënar Grigori në Akrita.

Vargje: Grigori, meqë feksi tejet me virtyte,/ pasi u shpërngul shkëlqyeshëm, ka pasuri lavdie të madhe.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atit tonë oshënar Fostiri.

Vargje: Më të vërtetë Fostiri u pa shkëlqim/ me dritën e jetës dhe të çudive.

Në të njëjtën ditë, martiri i shenjtë Sais, mbaron pasi e hodhën në det.

Vargje: Saisi thotë: Erdha në thellësi deti,⁹⁰ si u shmanga/ nga thellësitë e mashtrimit që mbytin.

Në të njëjtën ditë, martiri i shenjtë Theoidhi mbaron duke u shkelur prej xhelatëve.

Vargje: Këmbët që shkelin trupin e Theoidhit/ shtrydhnin shpirtin në tor-kun e qiellit.

Në të njëjtën ditë, oshënore Domnina mbaron në paqe.

Vargje: Mundimi poshtë i mishit, o Domnina,/ të fal ty trashëgiminë e sipërme.

Në të njëjtën ditë, oshënore Tatjana mbaron në paqe.

Vargje: Tatjana, pasi u shkri qëmoti me kreshmë,/ tani është me engjëj, miqtë e kreshmës.

Në të njëjtën ditë, martiri i ri, oshënar i shenjtë Romano i nga Karpenisi, mbaron me shpatë në Bizant në vitin 1694.

Vargje: Me të vërtetë luftoi fuqishëm Romano i,/ pasi pranoi fuqi të paluftueshme prej Perëndisë.

Me ndërmjetimet e tyre të shenjta, o Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII

Parakremtor

Irmosi sipas: I Pedhes efsevia

»**U** futën si në nusërore në flakën
 »e pashuar të furrës qëmoti Djem që
 »nga shpresëtaria iu treguan shenjtore
 »Perëndisë; dhe psalnin me një
 »zë himn melodikisht: O Perëndi i
 »etërve, i bekuar je.⁹¹

U duk madhërisht Krishti, shpëtimi, duke dhuruar ndriçim. Le të ngazëllohet qielli,⁵⁵ ndërsa retë le të spërkasin drejtësi⁶¹ me të vërtetë tek ata

që thërrasin: O Perëndi i etërve, i bekuar je.⁹¹

Shtëllungën që parapa Gjedeoni, e cila pikoi plot një legen ujë,⁹² deklaronte qartas, o Krisht, pagëzimin tënd, të cilin pasi të pagëzohesh, do t'ua japësh atyre që këndojnë: O Perëndi i etërve, i bekuar je.⁹¹

Kur me kripë shëroi Eliseu ujërat që shkaktonin mospasje fëmijësh,⁹³ e paraikonizoi kolimvithrën me pasjen e mbarë të fëmijëve; kështu do të jetë mistikisht për ata që këndojnë: O Perëndi i etërve, i bekuar je.⁹¹

I oshënares: Antítheon próstagma

Kundërshtari, duke menduar keq, imagjinonte se do ta zbuste tensionin e shpirtit tënd nëpërmjet sëmundjeve, por u ndesh me Jov martirik dhe të urtë;⁹⁴ prandaj u zbraps duke u plagosur nga durimi i dhimbjeve të tua.

Shpirti yt i mbushur me sjelljet më të mira dhe të perëndishme, nga furtuna e jetës u ankorua tani në liman të qetë, ku u parapërgatit pushimi i pësimeve të tua të shumta, o e urtë.

Kur ishe në kinov, urtësisht udhëzove që të mos ndryshonin vendin asnjëherë, sepse pasoja bëhet shkak për dëm të madh; nuk neglizhove të sjellësh dobi⁹⁵ me të vërtetë te murgeshat me fjalë e me punë.

Hyjlindësore

Me shenjë mbi mendim nga Biri yt natyra e ujërave më lan nga mëkati; sepse pastrimi i Perëndisë, bërësit të dritës,⁹⁶ i pastron të ndoturit me shumë shkelje, o Vajzë hyjnuse.

I martirëve: Káminon qeomenin

Pranuat bashkërisht mbarim martirizimi, duke u vrarë me shpatë tok me gra dhe fëmijë, kur i thërrisnit Krishtit: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.⁹¹

Gëzoheshin shenjtorët duke parë veten e tyre të mbarojnë me shpatë dhe thërrisnin besërisht: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.⁹¹

Tërbimi i të pabesëve u zhduk nga dheu dhe perënditë ranë përdhë, dhe u dërrmuan me anën e pohimit dhe të qëndrueshmërisë së hyjshme të martirëve.

Hyjlindësore

Shpëtoje grigjën tënde nga çdo përipeci, o e kulluar e tërëpacenuar, si mbrojtja e vetme e gjinisë sonë, o Perëndilindëse e bekuar, e tërëhimnuar.

Ode VIII

Parakremtor

Irmosi sipas: Thávματος iperfiús

»**Q**ëmoti kamina flakëvesuese
»tregoi një simbol mrekuillie mbi

»mendim, sepse zjarri nuk dogji
 »Djem të rinj, duke paradeklaruar
 »lindjen hyjnore pa farë të Krishtit
 »nga një e virgjër; ndaj duke për-
 »himnuar, le të këndojmë: Le ta be-
 »kojë mbarë Krijesa Zotin dhe le ta
 »përbilartësojë në gjithë jetët.

Le t'i drejtojmë Zotit himnim me zë të lartë; erdhi, u duk, shkel mbi ujëra dhe zhvishet ai që e mbështjell qiellin me re,⁹⁷ dhe pagëzohet duke na pastruar ne që këndojmë: Le ta bekojë mbarë Krijesa Zotin dhe le ta përbilartësojë në gjithë jetët.

Le të arrijmë mendërisht drejt Jordanit që të shikojmë në të një shfaqje madhështore, sepse po vjen Jisui, ndriçimi, dhe përkulet në pëllëmbën e shërbëtorit që këndon me tmerr: Le ta bekojë mbarë Krijesa Zotin dhe le ta përbilartësojë në gjithë jetët.

Qymyrin që parapa Isaia,⁹⁸ pasi u ndez në ujërat e Jordanit, do djegë bashkë edhe tërë lëndën e mëkateve, dhe do t'iu japë të dërrmuarve rigatimin; prandaj duke himnuar le të këndojmë: Le ta bekojë mbarë Krijesa Zotin dhe le ta përbilartësojë në gjithë jetët.

I oshënares: Ton en kamino tu pirós

Ti, o e lumur, dëshiroje të arrish në dheun e të butëve⁹⁹ me të vërtetë,

ku banojnë përjetë rende engjëjsh, oshënarësh, asketësh dhe virgjërshash që përhimnojnë Krishtin përjetë.

Duke u dalluar nga gjithë të tjerat për sa i përket bukurisë natyrore, u kujdese për shpirtin që të fitosh me mençuri mbi të gjitha pasionet shpirtërore; prandaj pasi shove bukuri trupi, e ndeze me asketizëm shpirtin tënd.

Duke pasur mendje të pafjetur drejt Perëndisë nga gatishmëria e shpirtit, vure në gjumë përfundimisht, o e lavdëruar, manovrat e mashtruesit,¹⁰⁰ shpikësit të të këqijave; dhe tani që fjete, jeton përjetë.

Hyjlindësore

Duke dashur Biri yt t'i rilindë të vdekshmit, nxiton drejt Jordanit si njeri, o e kulluar, që të pagëzohet pa ndotje, nga dhembshuria e skajshme, duke e zhytur tërë ndotjen e së keqes së njerëzve.

I martirëve: Ton monon ánarhon

Duke pohuar mbretin e lavdisë, të vetmin të dhembshur, athloforët e urtë pranuan çmimet e fitores duke thirrur me guxim: O popull, përbilartësoni Krishtin përjetë.

Fuqishëm rezistuan kundër tiranëve athloforët e Krishtit me trimëri në

betejë, pasi fituan mbi mashtrimin e idhujve, duke thirrur guximshëm: O popull, përmbilartësoni Krishtin përjetë.

Porsi diamante ushtarët trima, kur fituan ndaj kërcënimeve dhe torturave të tiranëve, thërrisnin me hare: Himnoni, o priftërinj, o popull, përmbilartësoni Krishtin përjetë.

Hyllindësore

Të vetmin të dhembshur, Fjalën e parajetshme që lindi në fund prej Virgjëreshe dhe shpëtoi gjininë e njerëzve, himnojeni, o priftërinj, o popull, përmbilartësojeni në gjithë jetët.

Irmosi: Ton monon ánarhon

»**T**ë vetmin të pafillim, mbretin e
»lavdisë, që e bekojnë fuqitë e qiejve
»dhe e kanë frikë rendet e engjëjve,
»himnojeni, o priftërinj, popull, për-
»mbilartësojeni në gjithë jetët.

Ode IX

Parakremtor

Irmosi sipas: Mistirion ksenon

»**I** fshehtë misteri* i Zonjës së vir-
»gjër krejt,* se ajo u shfaq qiell,
froni* drit'prurës dhe keruvik,¹⁰¹
»si dhe dhom' nusërore*¹⁰² e Zotit
»të plotfuqishëm, Perëndi. Prandaj
»besërisht* e madhështojmë, e lëv-
»dojmë ne.

Mister të çuditshëm,* të huaj, pa-
radoksal* shoh, se vjen Jisui me da-
shje* në lum' Jordan dhe thërret tek
Joani kështu pra:* Të djabatën ma
jep si hua, o mik, mua që i veprojt*
popullit tim gjëra të frikshme fort.

Le të lulëzohen* të shkretat po në
Jordan.*⁸ Ju që rrini në errësi,*¹³
kërceni lart pasi patë një dritë të
madhe* që shndriti mbi ju, pra Kri-
shti që në Galile¹⁴ po mbërrin* dhe
pagëzim në mish denjon ai.

Dëfre, o Jordan¹⁰³ ti,* kërce, hidhu, o
Joan,* dhe tani ki gaz mbarë bota,*
se ja ku Krishti u shfaq madhërisht
edhe zhvishet* dhe merr pagëzimin
duke veshur njerëzinë me petk,*
stoli paprishjeje, me jetë plot.

Hyllindësore

Pa prishje ke zënë* të pakoncept-
tueshmin;* lind mbi mendje dhe mbi
natyrë* atë që bëri me dashje çdo
gjë qart' me fjalë;*¹⁰⁴ atij, o e tërë-
paqortueshme, iu lut ti gjithnjë,* si
Perëndi, që të shpëtohem.

I oshënares: Anarhu jenítoros

Ndriçove ti veten tënde, o e lavdë-
ruar fort,* me kurorë asketi, dhe
virgjëria plot* hijeshi dhe nur, të
dhuroi, prandaj dyfish* të kurorëzon
Dhëndri ty të plagosurën* nga një
mall dhe dashuri për të.

Nuk të turpëroi, o Singlitiqi modeste krejt,* shpresa¹⁰⁵ jote në zemër për gjëra të pritshme,* se prej Shpëtimtarit për lodhjet tani shijon* dhe gëzon shpërblime, meqë praktikove drejt* çdo mënyrë asketike ti.

Si forcë, mbështetje Krishtin kishë veshur,¹⁰⁶ o e thjesht',* dhe përmbys ke vithisur padrejtësinë ti,* vetullën¹⁰⁷ e djallit që foli në lartësi;*¹⁰⁸ me kuror' fitoreje pra të stolisi ty* Krishti që jep për fitoret çmim.

Hyjlindësore

Në ty reshti rënia e stëratit, se fuqi më s'ka* të vazhdojë, të ecë, se plotësisht u mbyt* ligësia me pagëzimin e Birit tënd,* ndaj të lavdërojmë, se shkak i pastrimit je,* i çlirimit, pra të mburrim ne.

I martirëve: Tin ipër fisin mitera

Kur athloforët e Krishtit i shkelën të gjithë idhujtarët me anën e besës, e kryen më shpresëtari udhën⁸¹ e hyjshme dhe e fuqizuan besimin.

Meqenëse athloforët e Krishtit i shpërfillën të gjitha tokësoret me anën e besës, pasi kryen kolektivisht atletizmin me gatishmëri, fituan shërim nga Perëndia.

Kur athloforët u veshën përmes be-

sës me kryqin e Zotit si me parzmore, rrëzuan me burrëri rreshtat e armikut dhe morën kurora.¹⁰⁹

Hyjlindësore

Ti që zure në bark Fjalën e panxënshme dhe na e linde pa mbjellje, përgjëroju gjerësisht që të shpëtojë shpirtrat tanë.

Irmosi: Tin ipër fisin mitera

»**N**e besimtarët me këngë ma-
»dhërojmë detyrimisht nënën për-
»mbi natyrë dhe Virgjëreshën sipas
»natyrës, të vetmen të bekuar mes
»grash.¹¹⁰

Dërgimësore e martirëve

O uranón tis astris

O hierark Theopempt,* nga Perëndia ty fuqi* t'u dërgua në tortura* dhe përmes saj fitove ti* si bashkatlet Theonanë* në bes'; tani tok ju mburrim.

Parakremtore

Ti që nga një e virgjër* në Bethlehem shkëlqeve fort* trupërisht, rend drejt Jordanit* të na lash ndyrësin' tani;* ndriçon sa janë në terr pra* me pagëzimin e hyjshëm.

Lavdërime

Ting. Tërth. II E angjeliqé

Pse, Prodhrom, dyshim ti ke për ekonominë* që bëj për shpëtimin e çdo njeriu mbi dhé,* të vjetrat lër,

mendo ti* të tanishmet, i ki besim* Zotit Perëndi që bashkëzbriti, dhe eja më shërbe, se erdha porsì Perëndi* që të shpëtoj stëratin, pra Adamin që poshtë ra.

Duke ngritur mbi supe fajet tona,¹¹¹ o Krisht,* erdhe tek rrëket' e Jordanit, o Jisu Zot;* i druhem ardhjes sate* kaq të frikshme; si urdhëron* të të pagëztoj ty që arrite të më pastrosh, dhe si kërkon pagëzimin nga un'?* se pagëzimi gjithë njerëzit i pastron mbi dhé.

Fjala s'e shpjegon dot natyrën time, se si* veshja formë robi¹⁵ dhe dola drejt Jordanit;* mos ki dyshim aspak ti,* eja pa tmerr, afrohu ti,* dhe mbi kokën time ta vendosësh të djathtën tënde dhe kështu thirr: Ai që u shfaq* është' i bekuar; Perëndia ynë, lavdi më ty.

Oh! Përmbi logjikën është' varfëria jote* dhe pa masë, Fjalë e Perëndisë, të di* që veshje ti Adamin,* se për mua të erdhi keq;* dhe sa kanë dalë nga Adami i përtërit; i bindem urdhrit tënd, them pra me bes':* Je i bekuar, Perëndi i shfaqur, lavdi më ty.

Lavdi *Ingjashëm*
Parakremtor

Duke i shërbyer me tmerr Joani Zotit,* ka hare në shpirt dhe thërret i ngazëlluar:* Tër' brezat e stëratit*

tok me mua gëzohuni;* erdhi pritja jonë,¹¹² ka mbërritur pra Krishti në Jordan që ky ti pastrojë të gjith'* nga faji dhe mëkati i Adamit, i dhembshuri.

Tani *Ingjashëm*

Psalini, o popuj, të lindurit nga nëna* krejt e virgjër, që në Jordan u pagëzua,* le t'i thërrasim: O mbret* i Krijesës së tër', na jep* dhe na çmo që pa dënim me besë ne të arrijmë me ndërgjegje të pastër, pa cen* në ngjalljen e triditshme dhe të shenjt' prej së vdekurish.

Pasvargje

Ting. II Ikos tu Efrathá

O popuj, kini gaz,* se drita ka shkëlqyer,* se ja ku erdhi mbreti* i Izraelit, pritja* e gjithë kombeve¹¹² mbi dhé.

Varg: Për këtë do të të kujtoj nga toka e Jordanit dhe e Ermoniimit.

Sa janë përmbi dhé* e pan' në mish Hyjninë,*¹¹³ tani ka lindur Hiri* për ne të gjithë, dritë* për shpirtrat në pusí u shfaq.¹⁴

Varg: Të panë ujëra, o Perëndi, të panë ujëra dhe u frikësuan.

Shërbeji o profet,* si Pararendës Fjalës,* si mik i ngushtë dhëndrit,*¹¹⁵ si dielli agimit* dhe dritës ti porsì kandil.⁶²

Lavdi *dhe* Tani

Ting. Tërth. IV I Anatoliut

O Joan Pagëzor, që në mitër më njohe mua,¹¹⁶ qengjin,¹¹⁷ në lumë më shërbe, me engjëj më adhuro; shtri dhe prek me dorën tënde kokën time të pacenuar; dhe kur do shikosh malet të tremben¹¹⁸ dhe Jordanin të jetë i kthyer,¹¹⁹ së bashku me ta thirr: O Zot i mishëruar nga një e virgjër për shpëtimin tonë, lavdi më ty.

Dhe të tjera si zakonisht

CITIME

¹ I Kor. 6.17

² Hebr. 12.23

³ Apok. 14.3

⁴ II Tim. 2.12

⁵ Ps. 65(66).10; Fja. Urt. 17.3; Urt. Sol. 3.6

⁶ Jov 1.11-12; 2.5-6

⁷ Gjen. 3.15

^{7a} Ps. 73(74).13

⁸ Is. 35.1-2

⁹ Ps. 113(114).3-6

¹⁰ I Joan 1.2; 5.20

¹¹ Is. 40.3; Matth. 3.3; Mark. 1.3; Lluk. 3.4; Joan 1.23

¹² I Kron. 16.31; Ps. 95(96).11; 96(97).1; Is. 49.13

¹³ Ps. 35(36).9

¹⁴ Is. 9.2; Matth. 4.16; Lluk. 1.79

¹⁵ Fil. 2.7

¹⁶ Gjen. 3.6

¹⁷ Joan 1.9

¹⁸ I Kor. 1.2; Ef. 5.26; Hebr. 2.11

¹⁹ Urt. Sol. 11.20; Is. 40.12

²⁰ Ef. 1.23

²¹ II Kor. 8.9

^{21a} Jak. 1.17

²² Gjen. 3.16

²³ Lluk. 1.28

²⁴ IV[II] Mbret. 2.11-14

^{24a} Eks. 14.27-28

²⁵ Eks. 15.1

²⁶ Ps. 135(136).6; Jov 26.7

²⁷ I Mbret. [Sam.] 2.2; II Mbret. [Sam.] 7.22

²⁸ Abak. 3.15

²⁹ Matth. 3.2

³⁰ Eks. 14.21-22; Ps. 65(66).6 etj.

³¹ Eks. 17.6; Num. 20.11; Ligji i Dytë 8.15; Ps. 113(114).8

³² Is. 26.9

³³ Is. 1.16

³⁴ Matth. 3.11; Lluk. 3.16

³⁵ I Kor. 15.47

³⁶ Lluk. 1.7

³⁷ Lluk. 2.2-4

³⁸ Matth. 17.24

³⁹ Rom. 8.15,23; Gal. 4.5

⁴¹ Rom. 1.3

⁴² Lluk. 1.32; Vep. 2.30; Ps. 131(132).11

⁴³ Ef. 6.12

⁴⁴ Mark. 5.9-13; Lluk. 8.30-33

⁴⁵ Juda 23

⁴⁶ I Kor. 15.53-54

⁴⁷ Rom. 6.3

⁴⁸ Rom. 6.4; Kol. 2.12

⁴⁹ Jer. 2.12

⁵⁰ Ps. 81(82).5; Is. 13.13; 24.18

⁵¹ III[I] Mbret. 18.33-38

⁵² Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 59-65

⁵³ Lluk. 3.5

- 54 Ps. 18(19).2
 55 I Kron. 16.31; Ps. 95(96).11; Is. 48.13
 56 Ps. 97(98).8
 57 I Kor. 1.30
 58 Gjen. 3.7
 59 Ps. 103(104).3
 60 Eks. 6.1 etj.
 61 Is. 45.8
 62 Joan 1.4; 8.12
 63 I Joan 2.2; 4.10
 64 Gjen. 1.26-29
 64a Gjen. 2.7; Ps. 102(103).14
 65 Ef. 5.19; Kol. 3.16
 66 I Mbret. [Sam.] 2.10
 67 Matth. 7.13-14
 68 I Mbret. [Sam.] 2.1
 69 Joan 14.2
 69a Is. 53.9; Joan 8.46; I Petr. 2.22
 70 Abak. 3.1,3,13
 71 Is. 12.3
 72 Is. 66.12
 73 Gjen. 3.16-19
 74 Jov 3.11, 21-23
 75 Joan 14.27
 76 Fil. 4.7
 77 Gjen. 14.18; Hebr. 7.2
 78 Ef. 2.14
 79 Gal. 5.24; Kol. 3.5
 80 Ef. 1.22; 4.15; 5.23; Kol. 1.18
 81 II Tim. 4.7
 82 Jona 2.10
 83 Kol. 3.12
 84 I Kor. 2.8
 85 II Tim. 2.3
 86 Matth. 3.7-10; Lluk. 3.7-14
 86a Mal. 3.1; Matth. 11.10; Mark. 1.2; Lluk. 7.27
 87 Matth. 11.11; Lluk. 7.28
 88 I Mbret. [Sam.] 28.6,15; Joel 3.1 (2.28); Dan. 1.17
 89 Ps. 87(88).7
 90 Jona 2.4
 91 Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 2
 92 Gjyq. 6.37-38
 93 IV[II] Mbret. 2.19-22
 94 Jov 2.10
 95 Fil. 3.1
 96 Gjen. 1.3
 97 Ps. 146.8
 98 Is. 6.6
 99 Ps. 36(37).11
 100 Ef. 6.11
 101 Jez. 10.1
 102 Ps. 18(19).6
 103 Is. 35.2
 104 Gjen. 1.3-24; Ps. 148.5
 105 Rom. 5.5
 106 Fja. Urt. (Mas. 31.25)
 107 Fja. Urt. kap. 24 (Mas. 30.13); Is. 10.12
 108 Ps. 72(73).8
 109 I Petr. 5.4
 110 Lluk. 1.29
 111 Is. 53.4; Joan 1.29
 112 Gjen. 49.10
 113 I Tim. 3.16
 114 Tit. 2.11
 115 Joan 3.29
 116 Lluk. 1.41
 117 Is. 53.7; Joan 1.29,36; Vep. 8.32; I Petr. 1.19
 118 Jer. 4.24
 119 Eks. 14.21; Jis. N.3.16; Ps. 113(114).3,5



THEOFANIA SHËRBESA E ORËVE TË MËDHA

Kryhet më 5 janar (pas Mëngjesores së 5 janarit) së bashku me Mbrëmësoren e Madhe dhe Liturgjinë e Shën Vasilit. Por kur Theofania bie të dielën ose të hënën, Orët e Mëdha kryhen të premtën, pa Mbrëmësoren e Madhe dhe Liturgjinë. Atëherë Mbrëmësorja kryhet një ditë para Theofanisë. Pas Leximeve, pa Le t'i lutemi, Apostulli dhe Ungjilli. Le të themi etj. Pasvargjet Kur të pa, fq. 108 etj. Liturgjia e Shën Vasilit kryhet në 6 janar.



ORA E PARË

Prifti: I bekuar është Perëndia ynë. Lavdi më ty, o Perëndi. O mbret qiellor.

Lexuesi: Trishenjti, etj.

Prifti: Se jotja është mbretëria.

Lexuesi: Amin. Mëshiro, o Zot (12x).

Lavdi dhe Tani. Ejani t'i falemi. *Dhe menjëherë Psalmet.*

Psalmi 5

Vëru veshin fjalëve të mia, o Zot, kuptoje klithmën time, vëri re zërit të përgjërimit tim, o mbreti im dhe Perëndia im, sepse drejt teje do të lutem, o Zot; në mëngjes do ta dëgjosh zërin tim, në mëngjes do të qëndroj para teje dhe do të më mbikëqyrësh; meqenëse ti nuk je Perëndi që do paligjësi, nuk do të

rrijë pranë teje ai që vepron dinakëri, as nuk do të qëndrojnë të paligj përballë syve të tua. I urreve të gjithë ata që bëjnë paligjësi, do t'i shfarosësh gjithë ata që flasin gënjeshtren. Burrë gjaku dhe të djallëzuar e neverit Zoti, ndërsa unë, në shumicën e mëshirës sate do të hyj në shtëpinë tënde, do t'i falem tempullit tënd të shenjtë me frikën tënde. O Zot, udhëhiqme në drejtësinë tënde për shkak të armiqve të mi, drejtoje para teje udhën time. Se nuk ka në gojën e tyre *ndonjë* të vërtetë, zemra e tyre është e kotë, varr i hapur është laringu i tyre, me gjuhët e tyre intrigonin. Gjykoji ata, o Perëndi. Rrënçin nga planet e tyre; sipas morisë së pabesive të tyre nxirri jashtë ata, se të hidhëruan fort, o Zot. Dhe u dëfrefshin të gjithë ata që shpresojnë në ty; përjetë do të ngazëllohen dhe do të fushosh ndër ta, dhe do të mburren në ty të gjithë ata që duan emrin tënd; se ti do ta bekosh të drejtin; o Zot, si me armë mirëdashjeje na kurorëzove.

Psalmi 22

Zoti më kullot dhe nuk do të më privojë nga asgjë. Në vend blerimi, atje më fushoi. Mbi ujë prehjeje më ushqeu, shpirtin tim e ktheu. Më udhëhoqi në udhë drejtësie për emrin e tij; sepse edhe nëse do të ec mes hije vdekjeje nuk do të kem frikë të keqija, sepse ti me mua je.

Purteka jote dhe shkopi yt, këto më ngushëlluan. Përgatite para meje tryezë, përballë atyre që më shtrëngojnë. Vajose me vaj kryen tim dhe potiri yt më deh si tepër të fortë; dhe mëshira jote do të më ndjekë gjithë ditët e jetës sime; dhe *kështu* të banuarit e mi *do të jenë* në shtëpinë e Zotit në gjatësi ditësh.

Psalmi 26

Zoti është ndriçimi im dhe shpëtimtari im, cilit do t'i kem frikë? Zoti është mbrojtësi i jetës sime, nga kush do të trembem? Kur afroheshin kundër meje ata që bënë të këqija, që t'i hanin mishrat e mi, ata që më shtrëngonin dhe armiqtë e mi, këta u shfuqizuan dhe ranë. Në qoftë se do të rreshtojë kundër meje rreshtim, nuk do të frikësohet zemra ime. Nëse do të ngrihet kundër meje luftë, në atë unë shpresoj. Një gjë kërkova nga Zoti, këtë do ta kërkoj: të banoj në shtëpi Zoti gjithë ditët e jetës sime, të sodit hijeshinë e Zotit dhe të vizitohet tempullin e tij të shenjtë; se më fshehu në tendën e tij, në ditën e të këqijave të mia më mbuloi, në fshehjen e tendës së tij, në gur më lartësoi; dhe tani, ja tek lartësoi kokën time mbi armiqtë e mi. Qarkova dhe flijoja në tendën e tij flijim himnimi dhe brohoritjeje, do t'i këndoje dhe do t'i psal Zotit. Dëgjo, o Zot, zërin tim, që thirra, mëshiromë dhe dëgjomë. Ty të tha zemra ime:

Zotin do kërkoj. Të kërkoj fytyra ime; fytyrën tënde, o Zot, do kërkoj. Mos e kthe mënjane fytyrën tënde prej meje dhe mos devijoj në inat nga shërbëtori yt. Ndhmësi im bëhu, mos më dëbo dhe mos më braktis, o Perëndi Shpëtimtar; se ati im dhe nëna ime më braktisën, ndërsa Zoti më mori. Vëmë ligj, o Zot, në rrugën tënde dhe udhëzomë në udhë të drejtë për shkak të armiqve të mi. Mos më dorëzo në shpirtrat e atyre që më shtrëngojnë; se ngritën kundër meje dëshmitarë të padrejtë dhe gënjeu padrejtësia për hirin e saj. Besoj se do t'i shikoj të mirat e Zotit në dhé të gjallësh. Prit me durim Zotin, bëhu burrë dhe le të fuqizohet zemra jote, dhe prit me durim Zotin.

Lavdi *dhe* Tani

Alilua, Alilua, Alilua, Lavdi më ty, o Perëndi (3x). Mëshiro, o Zot (3x).

Lavdi

Mbrapa kthehej krejt dikur lumi Jordan me një gëzof të profetit Elise, pasi Ilija u ngjit lart; u ndanë ujërat pra në dy pjesë më dysh, dhe iu bë si udhë përmbi sterë¹ udh' e lëngshme pra si ikonizim për ne vërtet, si tip për pagëzimin; me të përshkojmë ne jetën, kalimin që rrjedh. U shfaq qart' Krishti në Jordan, shenjtëron uj'.

[Nëse Orëte Mëdha nuk bëhen pikërisht një ditë para së kremtes, atëherë gjatë gjithë Orëve të Mëdha nuk lexohet Përlëshorja

Mbrapa kthehej, *por* Përgatitu, Zabulon dhe hijeshohu, Nefthalim, ti, o lum' Jordan,² qëndro dhe me kërcim mikprit me gaz atë që vjen të pag'zohet, pra Zotin tonë; ki hare Adam me stërnën ton', mos e fshihni ju veten si dikur, kur ishit në Parajsë,³ se kur ju pa të zhveshur,⁴ Krishti u shfaq; deshte pra që t'ju veshë stolin' e parë,⁵ botën ta rinovojë./

Tani *Hyllindësore*

Si të të quajmë, o Hirplote? Qiell, se linde diellin e drejtësisë;⁶ parajsë, se çele lulen e paprishjes; virgjëreshë, se mbete e paprishur; nënë e kulluar, se pate në prehrin tënd të shenjtë bir, Perëndinë e të gjithave;⁷ atij lypi që të shpëtohen shpirtrat tanë. (*)

Dhe psalim Idhiomelet: Ting. Tërth. IV

Sot bekohet natyr' e ujërave, dhe çahet Jordani, dhe qëndron rrjedhjen e valëve të tij, duke parë Zotin të lahet.*

Përsëri i njëjti pa varg.

Pastaj, Ting. i njëjtë:

Varg: Për këtë do të të kujtoj nga toka e Jordanit dhe e Ermoniimit.

Si njeri erdhe në lumë, mbreti Krisht, dhe nxitohesh të marrësh pag'zim shërbëtori, o i mir', prej duarve të Pararendësit për mëkatet tona, o njeridashës.*

Varg: Të panë ujëra, o Perëndi, të panë ujëra dhe u frikësuan.

Përsëri i njëjti

Lavdi *Ting. i njëjtë*

Te zëri i atij që bërtiste në shkretëtirë; Gatitni udhën e Zotit;⁸ erdhe, o Zot, si more fytyr' robi⁹ duke lypur pagëzim, ti që s'njohe mëkatë.¹⁰ Të panë ujërat dhe u trembën;¹¹ u tremb bashkë me to dhe Pararendësi dhe thirri duke thënë: Si do ta ndriçojë dritën kandili?¹² Si do të dorëzojë Zotin shërbëtori? Bekomë mua dhe ujërat, o Shpëtimtar, që ngre mëkatin e botës.^{13*}

Tani *I njëjti*

Dhe menjëherë Proqimeni i Profecisë: Ting. IV

Gjëmoi Zoti mbi ujëra të shumtë.

Varg: Do të të dua, o Zot, fuqia ime.

Këndimi i profecisë së Isaias

(Kap. 35)

Këto thotë Zoti: Dëfre, o shkretëtirë që ke etje, le të ngazëllohet shkretëtirë, dhe le të lulëzohet si zambak. Do të lulëzohet dhe do të gëzohet me pyllin, dhe do të ngazëllohen të shkretat e Jordanit; dhe lavdia e Libanit ia dha asaj, dhe nderi i Karmilit. Dhe populli im do të soditë lavdinë e Zotit dhe lartësinë e Perëndisë. Forcohuni, o duar të ligështuara, dhe gjunjë të paralizuara. Ngushëlloni dhe thojuni të

dekurajuarve në mendje “Forcohuni dhe mos u frikësoni; ja ku Perëndia ynë shpërblen me gjykim dhe do të shpërblejë, ai do vijë dhe do të na shpëtojë”. Atëherë do të hapen sy të verbërish dhe veshë të shurdhërish do të dëgjojnë. Atëherë do të hidhet i çali porsi dre dhe e fuqishme do të jetë gjuhë memecësh, se u ça në shkretëtirë ujë, dhe grykë e thellë në tokën që ka etje; dhe do të jetë toka e thatë në kënetë dhe në tokën e etur, burim uji do të jetë. Atje do të ketë hare shpendësh, banesë cicërimash, kallami dhe kënetë. Do të jetë atje udhë e pastër dhe udhë e shenjtë do të quhet. Nuk do të kalojë dot atje *ndonjë* i papastër, as do të ketë atje udhë të papastri, ndërsa të shpërngulurit do të ecin mbi të dhe nuk do të humbasin. Dhe nuk do të ketë atje luan, as *ndonjë* nga bishat e dëmshme nuk do të ngjitet në të, as do të haset atje, por do të ecin në të të çliruar dhe të mbledhur për Zotin. Dhe do të kthehen, dhe do të arrijnë në Sion me hare dhe ngazëllim, dhe do të ketë gaz të përjetshëm sipër kryes së tyre, sepse mbi kryen e tyre do të ketë himnim dhe ngazëllim, dhe hare do t’i pushtojë. U arratis vuajtje, trishtim dhe rënkim.

Dhe menjëherë Apostulli:

Këndimi i Veprave të Apostujve
(13.25-32)

Në ato ditë, si përmbushte Joani

udhën e tij, thoshte: Cilin më pandehni të jem unë? Nuk jam unë, por ja ku vjen pas meje ai të cilit nuk jam i denjë këpucën e këmbëve të tij ta zgjidh. O burra vëllezër, bijtë e gjinisë së Abrahamit dhe sa ndër ju e kanë frikë Perëndinë, tek ju fjala e këtij shpëtimi u dërgua; sepse ata që banojnë në Jerusalem dhe arkondët e tyre, pasi e injoruan atë dhe zërat e profetëve që çdo të shtunë lexohen, kur e gjykuan, i përmbushën. Dhe ndonëse nuk gjetën asnjë faj për vdekje, kërkuan nga Pilati që të vritej. Dhe sapo kryen të gjitha ato që ishin shkruar për atë, pasi e zbritën prej drurit, e vunë në varr. Por Perëndia e ngriti atë prej së vdekurish. Ai u pa për shumë ditë tek ata që u ngjitën bashkë me të nga Galilea në Jerusalem, të cilët janë dëshmitarët e tij drejt popullit. Dhe ne ju ungjillëzojmë premtimin që u bë tek etërit, se Perëndia e përmbushi këtë tek ne, bijtë e tyre, duke ngjallur Jisuin.

Ungjilli sipas Mattheut.

Pastaj:

Lexuesi: Hapat e mi drejtoji sipas fjalës sate dhe të mos më sundojë çdo paligësi. Çliromë nga shpifje njerëzish dhe do t’i ruaj porosinë e tua. Fytyrën tënde shfaqë mbi shërbëtorin tënd dhe mësomë të drejtat e tua.¹⁴ Le të mbushet goja

ime me lavdërimin tënd, o Zot, që ta himnoj lavdinë tënde, gjithë ditën madhështinë tënde.¹⁵

Trishenjti, etj.

Prifti: Se jotja është.

Lexuesi: Kontaqi

Në Jordan afrohet sot, mbreti i q'ellit, Shpëtimtari Zoti Krisht, dhe shën Joanit i thërret: Mos u trondit, por më pagëzo; vij për shpëtimin e gjindjes së njerëzve.*

Mëshiro, o Zot (40x).

O Krisht Perëndi, që adhurohesh e lavdërohesh në çdo kohë e në çdo orë, në qiell e mbi dhé, zemërgjerë, zemërdhembshur, mëshirëplotë, që do të drejtët dhe mëshiron mëkatarët, që i thërret të gjithë në shpëtim me zotimin e të mirave të pritme, ti o Zot, prit lutjet tona në këtë orë dhe drejto jetesën tonë sipas porosive të tua. Shenjtërona shpirtrat, pastrona trupat, ndreqna mendimet, pastrona mendjet dhe shpëtona prej çdo hidhërimi, të keqeje dhe helmi. Mbrona me engjëjt e tu të shenjtë, që duke u ruajtur dhe duke u udhëhequr prej ushtrisë së tyre, të arrijmë të baresim te bashkimi i besës dhe te njohja e lavdisë sate të paafruar, se i bekuar je në jetë të jetëve. Amin.*

Mëshiro, o Zot (3x). Lavdi dhe Tani.

Më të nderuarën se Keruvimet dhe më të lavdëruarën pa krahasim se Serafimet, që pa u cenuar linde

Fjalën Perëndi, me të vërtetë Hyjlindësen, ty të madhërojmë.

Beko, o atë, në emrin e Zotit.

Prifti: Perëndia na dhembshuroftë dhe na bekoftë...

Dhe urata:

O Krisht, dritë e vërtetë, që ndriçon dhe shenjtëron çdo njeri që vjen në botë,¹⁶ u shënoftë mbi ne drita e fytyrës sate,¹⁷ që të shikojmë në të dritën e paafrueshme;¹⁸ dhe drejto hapat tanë¹⁴ në veprimin e porosive të tua, me ndërmjetimet e nënës sate të tërëpacenuar dhe të gjithë shenjtoreve. Amin.*



ORA E TRETË

Ejani t'i falemi.

Psalmi 28

I sillni Zotit, o bijtë e Perëndisë, i sillni Zotit bij deshësh. I sillni Zotit lavdi dhe nder, i sillni Zotit lavdi emri të tij; faljuni Zotit në oborrin e tij të shenjtë. Zë Zoti mbi ujërat. Perëndia i lavdisë gjëmoi. Zoti gjëmoi mbi ujëra të shumtë. Zë Zoti në forcë, zë Zoti në madhësi. Zë Zoti që dërrmon kedra dhe do të dërrmojë Zoti kedrat e Libanit, dhe do t'i hollojë ato, si viçin, Libanin, dhe i dashuri do të jetë si bir rinoqerontësh. Zë Zoti që ndërpret flakë zjarri. Zë Zoti që tund

shkretëtirë dhe do ta tundë Zoti shkretëtirën e Kadhisë. Zë Zoti që përsos dre dhe do të zbulojë pyje; dhe në tempullin e tij çdo njeri thotë lavdi. Zot në stuhi do të banojë dhe do të ulet Zot mbret përjetë. Zoti fuqi te populli i tij do të japë. Zot do të bekojë popullin e tij në paqe.

Psalmi 41

Me atë mënyrë që dëshiron fort drenusha mbi burimet e ujërave, kështu dëshiron fort shpirti im drejt teje, o Perëndi. Pati etje shpirti im drejt Perëndisë të gjallë. Kur do të arrij dhe do të shikohem në fytyrën e Perëndisë? U bënë lotët e mi për mua bukë, ditë dhe natë, kur më thuhej çdo ditë: Ku është Perëndia yt? Këto kujtova dhe derdha mbi veten shpirtin tim; se do kaloj në vend tende të çuditshme, deri në shtëpinë e Perëndisë me zë ngazëllimi dhe lavdërimi të një zëri që feston. Përse je i trishtuar, o shpirti im, dhe përse më trazon? Shpreso mbi Perëndinë, se do ta lavdëroj; se është shpëtimi i fytyrës sime dhe Perëndia im. Tek unë shpirti im u trazua; për këtë do të të kujtoj nga dheu i Jordanit dhe Ermoniimit, nga mal i vogël. Avushë thërret avushë në zërin e ujëvarave të tua. Të gjitha lartësimet dhe dallgët e tua mbi mua kaluan. Gjatë ditës do të porositë Zoti përdëllimin e tij dhe gjatë natës do këndohet këngë tek ai nga unë, lutje tek Perëndia i

jetës sime. Do t'i them Perëndisë: Përkrahësi im je; përse më harrove? Dhe përse i zymtë ec, kur shtrëngon armiku im? Në thërrmim e sipër të kockave të mia, talleshin me mua armiqtë e mi, pikërisht kur më thonin çdo ditë: Ku është Perëndia yt? Përse je tepër i trishtuar, o shpirti im, dhe përse më trazon? Shpreso mbi Perëndinë, se do ta lavdëroj; se është shpëtimi i fytyrës sime dhe Perëndia im.

Psalmi 50

Përdëllemë, o Perëndi, sipas përdëllimit tënd të madh dhe sipas dhembshurive të tua të shumta shuaje paudhësinë time. Lajmë krejt prej paudhësisë sime dhe pastromë prej mëkatit tim. Se unë e njoh paudhësinë time dhe mëkati im është përpara meje kurdoherë. Te ti vetëm mëkatova dhe të keqen e bëra përpara teje, kështu që ti je i drejtë në fjalët e tua dhe i kthjellët në gjykimin tënd. Se ja tek u zura në paudhësi, dhe në mëkate më lindi nëna ime. Se ja tek deshe të vërtetën, të patreguarat dhe të fshehtat e urtësisë sate m'i tregove. Spërkatmë me hisop, dhe do të pastrohëm, lajmë dhe do të bëhem më i bardhë se dëbora. Bëmë të dëgjoj gëzim e ngazëllim, dhe do të më gëzohen eshtrat e dobësuarat. Ktheje fytyrën tënde nga mëkatet e mi, dhe shuaji gjithë paudhësitë e mia. Krijë zemër

të pastër tek unë, o Perëndi, dhe përtërit frymë të drejtë në thellësitë e zemrës sime. Mos më hidh larg fytyrës sate, dhe mos e hiq prej meje Shpirtin tënd të Shenjtë. Jepma prapë ngazëllimin e shpëtimit tënd dhe forcomë me frymë sunduese. Do t'ju mësoj të paligjive udhët e tua, dhe të pabesët do të kthehen te ti. Shpëtomë prej gjakrash, o Perëndi, Perëndia i shpëtimit tim, gjuha ime do të lavdërojë me gëzim drejtësinë tënde. O Zot, çel buzët e mia, dhe goja ime do të lëçitë lavdinë tënde. Se po të kishe dashur therore do të kisha prurë, por ty s'të pëlqejnë therore me djegie të plotë. Therore ndaj Perëndisë është shpirti i dërrmuar; zemrën e dërrmuar dhe të përlurur Perëndia nuk do ta përbuzë. Bëji të mirë, o Zot, Sionit, sipas mirëdashjes sate; dhe le të ndërtohen muret e Jerusalemit. Atëherë do të të pëlqejë therore drejtësie, dhurata dhe therore me djegie të plotë. Atëherë do të sjellin viçër mbi altarin tënd.*

Lavdi *dhe* Tani

Aliluia, Aliluia, Aliluia, Lavdi më ty, o Perëndi (3x). Mëshiro, o Zot (3x).

Lavdi

Mbrapa kthehej krejt dikur lumi Jordan me një gëzof të profetit Elise, pasi Ilija u ngjiti lart; u ndanë ujërat pra në dy pjesë më dysh, dhe iu bë si

udhë përmbi sterë¹ udh' e lëngshme pra si ikonizim për ne vërtet, si tip për pagëzimin; me të përshkojmë ne jetën, kalimin që rrjedh. U shfaq qart' Krishti në Jordan, shenjtëron uj'.

Tani *Hyjlindësore*

O Hyjlindëse, ti je hardhia e vërtetë¹⁹ që nxore frytin e jetës; të lypim, ndërmjeto, o Zonjë, bashkë me apostujt dhe gjithë shenjtoret, që të mëshirohen shpirtrat tanë.

Dhe psalim Idhiomelet:

Ting. Tërth. IV

Utmerrua tani dor' e djathtë e Pararendësit dhe Pagëzorit dhe profeti që u nderua më tepër se profetët; se pa ty, qengjin e Perëndisë, që ngre mëkatet e botës,¹³ dhe i përmbledhur prej agonisë, thërriste: Nuk guxoj të prek, o Fjalë, kryet tënd; ti bekomë dhe ndriçomë, o mëshirëplot', se ti je jeta²⁰ dhe drita¹⁶ dhe paqja e botës.^{21*}

Përsëri i njëjti pa varg

Pastaj, Ting. IV:

Varg: Për këtë do të të kujtoj nga toka e Jordanit dhe e Ermoniimit.

Trinia, Perëndia yn', na e shfaqti veten e saj sot pandarë; se Ati i thirri të Birit dëshmin' e qartë; Shpirti fluturoi prej qiellit si pëllumb; Biri i uli kryet e pacenuar Pararendësit, dhe si u pagëzua, shpëtoi gjindjen njerëzore

prej robërisë si njeridashës.*

Varg: Të panë ujëra, o Perëndi, të panë ujëra dhe u frikësuan.

Përsëri i njëjti

Lavdi *Ting. Tërth. I*

Kur erdhe me trup në Jordan, o Zot, ngaqë deshe të pagëzoheshe me fytyrë njeriu,⁹ o Jetëdhënës, që të na ndriçosh ne t' arratisurit si mëshirëplot' duke na shpëtuar prej çdo dinakërie dhe laku të dragojt, u dëshmove prej Atit, dhe Shpirt' i perëndishëm të qëndroi sipër me fytyrë pëllumbi. Po vendosu në shpirtrat tanë, o njeridashës.*

Tani *Injëjti*

*Dhe menjëherë Proqimëni i Profecisë:
Ting. IV*

Të panë ujëra, o Perëndi.

Varg: Zë Zoti mbi ujërat.

Këndimi i profecisë së Isaias

(1.16-20)

Këto thotë Zoti: «Lahuni dhe të pastër bëhuni; hiqni dinakëritë tuaja prej shpirtrave tuaj përballë syve të mi; pushoni nga dinakëritë tuaja; mësoni të bëni mirë, kërkoni fort gjykim, shpëtoni atë që i bëjnë padrejtësi, gjykoni jetim dhe drejtësoni vejushë. Dhe ejani, dhe le të dialogojmë,» thotë Zoti, «dhe në qofshin mëkatet tuaja si purpur, si dëborë do të zbardh; dhe në qofshin

si të kuqe, si lesh do të zbardh. Dhe nëse doni, dhe nëse do të më dëgjoni, të mirat e dheut do të hani; ndërsa nëse nuk doni, as nuk do të më dëgjoni, thikë do t'ju hajë»; sepse goja e Zotit i foli këto.

Dhe menjëherë Apostulli:

Këndimi i Veprave të Apostujve

(19.1-8)

Në ato ditë u bë që, kur Apollo ishte në Korinth, pasi Pavli përshkoi vendet e sipërme, erdhi në Efes; dhe si gjeti disa nxënës, tha drejt tyre: Po Shpirt të Shenjtë morët kur besuat? Dhe ata thanë drejt atij: Por as dëgjuam nëse ekziston Shpirt i Shenjtë. Dhe tha drejt atyre: Në çfarë pra, u pagëzuat? Dhe ata thanë: Në pagëzimin e Joanit. Dhe tha Pavli: Joani pagëzoi pagëzim pendimi, duke i thënë popullit që t'i besonin atij që vinte pas këtij, domethënë Krishtit Jisu. Dhe sapo dëgjuan, u pagëzuan në emrin e Zotit Jisu. Dhe pasi vuri mbi ta Pavli duart, erdhi Shpirti i Shenjtë mbi ta, edhe flisnin gjuhë, edhe profetizonin. Dhe ishin të gjithë burra, rreth dymbëdhjetë. Dhe si hyri në sinagogë, vepronte me guxim për tre muaj duke dialoguar dhe duke bindur për gjëra rreth Mbretërisë së Perëndisë.

Ungjilli sipas Markut.

Pastaj:

Lexuesi: Zoti Perëndi është i bekuar, i bekuar Zoti, ditë pas dite; le të na drejtojë udhën mbarë Perëndia i shpëtimit tona, Perëndia ynë, Perëndia i shpëtimit.²²

Trishenjtë, etj.

Prifti: Se jotja është.

Lexuesi: Kontaqi

Në Jordan afrohet sot, mbreti i q'ellit, Shpëtimtari Zoti Krisht, dhe shën Joanit i thërret: Mos u trondit, por më pagëzo; vij për shpëtimin e gjindjes së njerëzve.*

Mëshiro, o Zot (40x).

O Krisht Perëndi, që adhurohesh e lavdërohesh në çdo kohë e në çdo orë, në qiell e mbi dhé, zemërgjerë, zemërdhembshur, mëshirëplotë, që do të drejtët dhe mëshiron mëkatarët, që i thërret të gjithë në shpëtim me zotimin e të mirave të pritme, ti o Zot, prit lutjet tona në këtë orë dhe drejto jetesën tonë sipas porosive të tua. Shenjtërona shpirtrat, pastrona trupat, ndreqna mendimet, pastrona mendjet dhe shpëtona prej çdo hidhërimi, të keqeje dhe helmi. Mbrona me engjëjt e tu të shenjtë, që duke u ruajtur dhe duke u udhëhequr prej ushtrisë së tyre, të arrijmë të baresim te bashkimi i besës dhe te njohja e lavdisë sate të paafruar, se i bekuar je në jetë të jetëve. Amin.* Mëshiro, o Zot (3x). Lavdi dhe Tani. **M**ë të nderuarën se Keruvimet

dhe më të lavdëruarën pa krahasim se Serafimet, që pa u cenuar linde Fjalën Perëndi, me të vërtetë Hyjlin-dësen, ty të madhërojmë.

Beko, o atë, në emrin e Zotit.

Prifti: Perëndia na dhembshuroftë dhe na bekoftë...

Dhe urata:

O Zot Perëndi, atë i tërëfuqishëm, Zot bir i vetëmlindur, Jisu Krisht edhe Shpirti i Shenjtë, një Hyjni, një fuqi, mëshirëplotë mua mëkatarin dhe me gjykimet që ti i di, shpëtomë mua shërbëtorin tënd të padenjë, se i bekuar je në jetë të jetëve. Amin.*



ORA E GJASHTË

Ejani t'i falemi.

Psalmi 73

Përse, o Perëndi, më zbrapse përfundimisht, u inatos zemërimi yt kundër deleve të kullotjes sate? Kujto sinagogjinë tënde, që e fitove që nga fillimi. Çlirove shkopin e trashëgimisë sate, këtë mal, Sion, ku fushove në të. Ngriji duart e tua kundër krenarive të tyre përfundimisht, sa dinakëri bëri armiku në shenjtëroren tënde; dhe u mburrën ata që të urrejnë në mes të së kremtes sate. Vunë shenjat e tyre si shenja, dhe nuk njohën, si në dalje,

lart. Si në pyll drunjsh, me kazma priten dyert e saj kolektivisht, në sëpatë dhe smilar e çanë plotësisht atë. E dogjën në zjarr shenjtëroren tënde, përdhé përdhosën tendën e emrit tënd. Thanë në zemrën e tyre fafaret e tyre kolektivisht: Ejani dhe të pushojmë absolutisht të gjitha festat e Perëndisë nga dheu. Shenjat e tyre nuk i pamë; s'ka profet më dhe ne nuk do të na njohë më. Deri kur, o Perëndi, do të shajë armiku, do të acarojë kundërshtari emrin tënd përfundimisht? Pse e zbrapse mënjanë dorën tënde dhe të djathtë tënde nga mesi i gjirit tënd përfundimisht? Ndërsa Perëndia, mbreti ynë, para jetëve bëri shpëtim në mes të dheut. Ti e fuqizove në fuqinë tënde detin, ti dërrmove krerët e dragonjve mbi ujin. Ti dërrmove kreun e dragoit, e dhe atë ushqim te popujt, tek etio-pianët. Ti çave burime dhe përrenj, ti thave lumenj itham. E jotja është dita dhe e jotja është nata; ti përsose ndriçim dhe diell; ti i bëre të gjitha të bukurat e tokës, verë dhe pranverë, ti i bëre. Kujtoje atë. Armik shau Zotin dhe popull i pamend acaroi emrin tënd. Mos u dorëzo bishave shpirt që të lavdëron; mos i harro shpirtat e të varfërve të tu përfundimisht. Mbikëqyr në dhiatën tënde, sepse u mbushën vendet e errësuarat të tokës nga shtëpi të paligjsh. Le të mos zbrapset i ulur

dhe i turpëruar, i varfër dhe i vobektë do ta himnojme emrin tënd. Ngrihu, o Perëndi, gjykoje gjyqin tënd; kujto sharjen tënde nga një i marrë tërë ditën; mos e harro zërin e shërbyesve të tu. Krenaria e atyre që të urrejnë u ngjit përherë.

Psalmi 76

Me zërin tim drejt Zotit thirra, me zërin tim drejt Perëndisë dhe më vuri re. Në ditën e shtrëngimit tim Perëndinë e kërkova me duart e mia natën përballë atij dhe nuk u mashtrova. Refuzoi të ngushëllohej shpirti im. Kujtova Perëndinë dhe dëfrevë. Reflektova dhe u dekurajua shpirti im. Arritën gardat sytë e mi, u trazova dhe nuk fola. Studiova ditë të lashta dhe vite të përhershme kujtova dhe studiova. Natën bashkë me zemrën time reflektoja dhe gërmonte shpirti im. Mos vallë përjetë do të më zbrapsë Zoti dhe nuk do të shtojë që të ketë mirëdashje më? Apo përfundimisht përdëllimin e tij do ta presë? *Ai* pushoi fjalë nga brezi te brezi? Mos vallë do të harrojë të dhembshurojë Perëndia? Apo do t'i përmbajë në zemërimin e tij dhembshuritë e tij? Dhe thashë: Tani fillova; ky ndryshim është i së djathtës të të Shumëlartit. I kujtova punët e Zotit, se do t'i kujtoj që nga fillimi të çuditshmet e tua. Dhe do të studioj në gjithë punët e tua dhe në veprimtaritë e tua do të reflektoj. O

Perëndi, në shenjtëroren është udha jote. Cili Perëndi është i madh si Perëndia yn'. Ti je Perëndi që bën çudira. E bëre të njohur ndër popuj fuqinë tënde; e çlirave në krahun tënd popullin tënd, bijtë e Jakovit dhe të Josifit. Të panë ujëra, o Perëndi, të panë ujëra dhe u frikësuan, u trazuan avusha. Shumicë zërash ujërash, zë dhanë retë; sepse shigjetat e tua ecin, zëri i bubullimës sate është në rrotë. Ndriçuan vetëtimat e tua në botë, u tund dhe e tmerruar u bë toka. Në det udhët e tua dhe rrugët e tua në ujëra të shumtë, dhe gjurmët e tua nuk do të njihen. E udhëzove si dele popullin tënd në dorën e Moisiut dhe të Aaronit.

Psalmi 90

Ai që banon në ndihmën e të Shumëlartit, në strehën e Perëndisë të qiellit do t'i kalojë netët. Do t'i thotë Zotit: Ndhimësi im je dhe përikja ime, o Perëndia im, dhe do të shpresoj mbi të. Sepse ai do të të shpëtojë nga kurthi i gjahtarëve dhe nga fjala trazuese. Në shpinën e tij do të të hijesojë dhe nën krahët e tij do të shpresosh; si me armë do të të rrethojë e vërteta e tij. Nuk do të frikësohesh nga frika natën, nga shigjeta që fluturon ditën, nga gjëja që në errësirë ec, nga ndodhi dhe demoni i mesditës. Do të bjerë nga krahu yt një mijë dhe dhjetë mijë nga e djathta jote, por te ti nuk do

të afrohen; veçse me sytë e tu do të kuptosh dhe shpagim mëkatarësh do të shikosh. Sepse ti, o Zot, je shpresa ime. Të Shumëlartin e vure si përikjen tënde. Nuk do të vijë afër teje të këqija dhe kamzhik nuk do të afrohet në tendën tënde. Se engjëjt e tij do t'i urdhërojnë për ty, që të të ruajnë në gjithë udhët e tua; mbi duart do të të ngrenë, se mos vallë pengon në gur këmbën tënde; mbi nepërkë dhe mbi gjarpër helmues do të hipësh dhe do të shkelësh luan dhe dragua. Se tek unë shpresoi dhe do ta shpëtoj; do ta mbuloj, se e njohu emrin tim. Do të thërrasë drejt meje dhe do ta dëgjoj, me të jam në shtrëngim; do ta shpëtoj dhe do ta lavdëroj. Me gjatësi ditësh do ta mbush dhe do t'i tregoj shpëtimin tim.

Lavdi *dhe* Tani

Aliluia, Aliluia, Aliluia, Lavdi më ty, o Perëndi (3x). Mëshiro, o Zot (3x).

Lavdi

Mbrapa kthehej krejt dikur lumi Jordan me një gëzof të profetit Elise, pasi Ilia u ngjit lart; u ndanë ujërat pra në dy pjesë më dysh, dhe iu bë si udhë përmbi sterë¹ udh' e lëngshme pra si ikonizim për ne vërtet, si tip për pagëzimin; me të përshkojmë ne jetën, kalimin që rrjedh. U shfaq qart' Krishti në Jordan, shenjtëron uj'.

Tani *Hyjlindësore*

Meqë s'kemi guxim nga mëkatet tona të shumta, atij që lindi prej teje ti lypi, o Hyjlindëse Virgjëreshë; se ka fuqi të madhe lutja²³ e nënës për mirëdashjen e Zotit. Mos zhvështro përgjërime mëkatarësh, o e tërëthjeshtë, se është përdëllyes dhe mund të shpëtojë²⁴ ai që denjoi të pësojë për ne.

Dhe psalim Idhiomelet:

Ting. Tërth. IV

Kështu i foli Zoti Joanit: Profet, eja pagëzomë mua që të krijova, që ndriçoj më hir dhe i qëroj të gjithë; prek kryet tim të hyjshëm dhe mos hezito. Profet, eja tani, se erdha të mbush çdo drejtësi.²⁵ Ti pra mos hezito aspak, se nxitohem të humbas armikun e fshehur nën ujërat, kryetarin e errësirës²⁶ duke shpërblyer tani botën prej grackave të tij, duke falur si njeridashës jetën e amëshuar.^{27*}

Përsëri i njëjti pa varg.

Pastaj, Ting. Tërth. II:

Varg: Për këtë do të të kujtoj nga toka e Jordanit dhe e Ermoniimit.

Sot nxitohet të marrë fund profecia psalmike, se deti – thotë – pa dhe iku, Jordani u kthye prapë përpara faqes së Zotit, faqes së Perëndisë të Jakovit,²⁸ i cili erdhi të presë pagëzim prej shërbëtori; që dhe ne duke i

shpëlarë prej ndyrësisë pagane të ndriçojmë shpirtrat tanë.*

Varg: Të panë ujëra, o Perëndi, të panë ujëra dhe u frikësuan.

Përsëri i njëjti

Lavdi *Ting. Tërth. I*

Përse i qëndron ujërat e tua, o Jordan, përse e kthen prapë rrjedhjen dhe nuk shkon përpara n' udhën tënde të natyrshme? Se nuk mund të duroj, – thotë, – zjarrin që përvëlon;²⁹ mahnitem dhe frikësohem nga denjimi i përtëjshëm, se nuk kam zakon të shpëllaj të paqmin, nuk mësova të fshij të pamëkatshmin, po të spastroj enët e ndotura. Gjembat e mëkateve më mëson t'i djeg Krishti që pagëzohet te mua; Joani dëshmon me mua; zëri i Fjalës⁸ thërrret: Ja Qengj' i Perëndisë, që ngre mëkatin e botës.¹³ Atij, o besnikë, le t'i thërresim: O Perëndi që u fanepse³⁰ për shpëtimin ton', lavdi më ty.*

Tani *I njëjti*

Dhe menjëherë Proqimeni i Profecisë:

Ting. IV

Zë Zoti mbi ujërat.

Varg: I sillni Zotit, o bijtë e Perëndisë.

Këndimi i profecisë së Isaias

(12.3-6)

Këto thotë Zoti: Nxirrni ujë me ngazëllim prej burimeve të shpëtimit. Dhe do të thuash në atë ditë: "Him-

noni Zotin, thirrni emrin e tij, lajmëroni ndër kombet të lavdishmet e tij. Himnoni emrin e Zotit, se të larta bëri; i lajmëroni këto të gjithë dheut. Ngazëllohuni dhe dëfrehuni ju që banoni në Sion, se u lartësua i Shenjti i Izraelit në mes të tij.”

Dhe menjëherë Apostulli:

Këndimi i letrës së Pavlit te Romakët
(6.3-11)

Vëllezër, sa u pagëzuam më Krishtin Jisu, në vdekjen e tij u pagëzuam. U varrosëm pra bashkë me të me anën e pagëzimit në vdekje, që sikurse u ngrit Krishti prej së vdekurish me anën e lavdisë së Atit, kështu edhe ne në risi jete të ecim. Sepse, nëse u bëmë të shartuar përmes përngjasimit me vdekjen e tij, do të jemi edhe të ngjalljes, duke ditur këtë, se njeriu ynë i vjetër u bashkëkryqëzua, që të asgjësohet trupi i mëkatit, që të mos i shërbejmë më mëkatit; sepse ai që vdiq, u drejtësua nga mëkati. Edhe nëse vdiqëm bashkë me Krishtin, besojmë se do të rrojmë bashkë me të, duke ditur se Krishti, pasi u ngrit prej së vdekurish, nuk vdes më, vdekje nuk e mbizotëron më; sepse me vdekjen që vdiq, vdiq vetëm një herë në lidhje me mëkatin, ndërsa me jetën që jeton, jeton për Perëndinë. Kështu edhe ju, llogariteni veten tuaj se jeni të vdekur për mëkatin, por të gjallë për Perëndinë, në Krishtin Jisu, Zotin tonë.

Ungjilli sipas Markut.

Pastaj:

Lexuesi: Shpejt le të na arrijnë dhembshuritë e tua, o Zot, se u varfëruam tejet; ndihmona, o Perëndi, Shpëtimtari ynë, për lavdinë e emrit tënd. O Zot, çlirona dhe zbutu për mëkatet tona për emrin tënd.³¹

Trishenjti, etj.

Prifti: Se jotja është.

Lexuesi: Kontaqi

Në Jordan afrohet sot, mbreti i q'ellit, Shpëtimtari Zoti Krisht, dhe shën Joanit i thërret: Mos u trondit, por më pagëzo; vij për shpëtimin e gjindjes së njerëzve.*

Mëshiro, o Zot (40x).

O Krisht Perëndi, që adhurohesh e lavdërohesh në çdo kohë e në çdo orë, në qiell e mbi dhé, zemërgjerë, zemërdhembshur, mëshirëplotë, që do të drejtët dhe mëshiron mëkatarët, që i thërret të gjithë në shpëtim me zotimin e të mirave të pritme, ti o Zot, prit lutjet tona në këtë orë dhe drejto jetesën tonë sipas porosive të tua. Shenjtërona shpirtrat, pastrona trupat, ndreqna mendimet, pastrona mendjet dhe shpëtona prej çdo hidhërimi, të keqeje dhe helmi. Mbrona me engjëjt e tu të shenjtë, që duke u ruajtur dhe duke u udhëhequr prej ushtrisë së tyre, të arrijmë të baresim te bashkimi i besës dhe te

njohja e lavdisë sate të paafruar, se i bekuar je në jetë të jetëve. Amin.*

Mëshiro, o Zot (3x). Lavdi dhe Tani.

Më të nderuarën se Keruvimet dhe më të lavdëruarën pa krahasim se Serafimet, që pa u cenuar linde Fjalën Perëndi, me të vërtetë Hyjlin-dësen, ty të madhërojmë.

Beko, o atë, në emrin e Zotit.

Prifti: Perëndia na dhembshuroftë dhe na bekoftë...

Dhe urata:

O Perëndi dhe Zot i fuqive³² dhe Krijuesi i çdo krijese, që nga dhembshuria e mëshirës sate të paimagjinueshme, Birin tënd të vetëmlindur, Zotin tonë Jisu Krishtin,³³ e dërgove poshtë për shpëtimin e gjinisë sonë dhe që përmes Kryqit të tij të çmuar grise dorëshkrimin e mëkateve tona dhe me të triumfove mbi autoritetet dhe pushtetet³⁴ e errësirës, ti, o Zot njeridashës, prano edhe këto kumtime falënderuese dhe lypëse nga ne mëkatarët dhe shpëtona nga çdo shkelje shkatërrimtare dhe të errët, dhe nga të gjithë armiqtë e dukshëm dhe të padukshëm, që kërkojnë të na keq-trajtojnë; mbërthe me frikën tënde mishrat³⁵ tanë dhe mos i devijo zemrat tona në fjalë ose në mendime ligësie,³⁶ por me mallëngjimin tënd plagos shpirtrat tanë, që duke vështruar gjithnjë te ti dhe duke u udhëhequr nga drita jote, duke të

parë ty, dritën e përrjetshme dhe të paafrueshme,¹⁸ të të drejtojmë pa pushim lavdërimin dhe falënderimin ty, Atit pa fillim bashkë me Birin tënd të vetëmlindur³³ dhe me Shpirtin tënd të Tërëshenjtë, të mirë dhe jetëbërës, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.



ORA E NËNTË

Ejani t'i falemi.

Psalmi 92

Zoti mbretëroi, hijeshi veshi, veshi Zoti fuqi dhe u ngjesh; sepse e stabilizoi botën, e cila nuk do të tundet. Është gati froni yt që nga atëherë, që nga jeta ti je. «Ngritën lumenjtë, o Zot, i ngritën lumenjtë zërat e tyre; do t'i ngrenë lumenjtë thërrmimet e tyre nga zërat e ujërave të shumtë.» Janë të çuditshme ngritjet e detit, i çuditshëm është në të lartat Zoti. Dëshmitë e tua u bënë tejet besnike. «Shtëpisë sate i përket shenjtërim, o Zot, në gjatësi ditësh.»

Psalmi 113

Në daljen e Izraelit nga Egjipti, e popullit të Jakovit nga një popull barbar, u bë Judea shenjtërorja e tij, Izraeli, pushteti i tij. Deti pa dhe iku, Jordani u kthye mbrapa. Malet u hodhën si desh dhe kodrat si

qengja delesh. “Ç’është me ty, o det, që ike, dhe ti, o Jordan, që u ktheve mbrapa? o male, që u hodhët si desh dhe kodra si qengja delesh?” Prej fytyre Zoti u tund dheu, prej fytyrës së Perëndisë të Jakovit, që e ktheu gurin në liqene ujërash dhe të thepisurin në burime ujërash. “Jo ne, o Zot, jo ne, por emrit të jepi lavdi, për mëshirën tënde dhe të vërtetën tënde; që të mos thonë ndonjëherë kombet ‘Ku është Perëndia i tyre?’”. Ndërsa Perëndia ynë në qiell dhe në dhé të gjitha sa deshi i bëri. Idhujt e kombeve janë argjend dhe ar, punë duarsh njerëzish. Gojë kanë dhe nuk do të flasin, sy kanë dhe nuk do të shikojnë, veshë kanë dhe nuk do të dëgjojnë, hundë kanë dhe nuk do të nuhasin, duar kanë dhe nuk do të prekin, këmbë kanë dhe nuk do të ecin, nuk do të thërrasin në laringun e tyre. Të ngjashëm me ta u bëshin ata që i bëjnë dhe të gjithë që kanë besim mbi ta. Shtëpi Izraeli shpresoi mbi Zot; ndihmësi dhe mbrojtësi i tyre është. Shtëpi Aaroni shpresoi mbi Zot; ndihmësi dhe mbrojtësi i tyre është. Ata që e kanë frikë Zotin shpresuan mbi Zot, ndihmësi dhe mbrojtësi i tyre është. Zoti pasi na kujtoi, na bekoi. E bekoi shtëpinë e Izraelit, e bekoi shtëpinë e Aaront. Bekoi ata që e kanë frikë Zotin, të vegjëlit bashkë me të mëdhenjtë. Shtoftë Zoti mbi ju dhe mbi bijtë tuaj. Qofshit të bekuar ju prej Zotit, që

bëri qiellin dhe dheun. Qielli i qiellit i përket Zotit, ndërsa tokën e dha tek bijtë e njerëzve. “Jo të vdekurit do të të himnojnë, o Zot, as të gjithë që zbresin në Hadh,” por ne që jetojmë do ta bekojmë Zotin që nga tani dhe gjer në jetë.

Psalmi 85

Përkule, o Zot, veshin tënd dhe dëgjomë, se i varfër dhe i vobektë jam unë. Ruaje shpirtin tim, se oshënar jam; shpëtoje shërbëtorin tënd, o Perëndia im, i cili shpreson te ti. Mëshiromë, o Zot, se drejt teje do të thërres tërë ditën. Dëfreje shpirtin e shërbëtorit tënd, sepse drejt teje e ngrita shpirtin tim. Se ti, o Zot, je i mirë dhe i butë, dhe i shumëmëshirshëm te të gjithë që të thërresin. Vëri veshin, o Zot, lutjes sime dhe vëre zërin e përgjërimit tim. Në ditën e shtrëngimit tim thirra drejt teje, se më dëgjoje. S’ka të ngjashëm me ty ndër perënditë, o Zot, dhe s’ka gjë të barabartë sipas punëve të tua. Të gjithë kombet sa bëre, do të vijnë dhe do të falen para teje, o Zot, dhe do të lavdërojnë emrin tënd, se i madh je ti dhe bën mrekulli, ti je Perëndi i vetëm. Udhëhiq më, o Zot, në udhën tënde dhe do të ec në të vërtetën tënde; u dëfreftë zemra ime që ta ketë frikë emrin tënd. Do të të lavdëroj, o Zot Perëndia im, me gjithë zemrën time dhe do ta lavdëroj emrin tënd për-

jetë; se përdëllimi yt është i madh mbi mua dhe e shpëtove shpirtin tim nga Hadhi më i poshtëm. O Perëndi, të paligj u ngritën mbi mua, dhe mbledhje të fuqishmish kërkuan shpirtin tim dhe nuk të vunë ty para tyre. Dhe ti, o Zot Perëndia im, je i dhembshur dhe përdëllyes, zemërgjerë dhe i shumëmëshirshëm dhe i vërtetë. Mbikëqyr mbi mua dhe mëshiromë, ia jep pushtetin tënd shërbëtorit tënd dhe shpëtoje birin e shërbëtores sate. Bëj me mua një shenjë për të mirë dhe le të shohin ata që më urrejnë dhe le të turpërohen, sepse ti, o Zot, më ndihmove dhe më ngushëllove.

Lavdi *dhe* Tani

Aliluia, Aliluia, Aliluia, Lavdi më ty, o Perëndi (3x). Mëshiro, o Zot (3x).

Lavdi

Mbrapa kthehej krejt dikur lumi Jordan me një gëzof të profetit Elise, pasi Ilia u ngjit lart; u ndanë ujërat pra në dy pjesë më dysh, dhe iu bë si udhë përmbi sterë¹ udh' e lëngshme pra si ikonizim për ne vërtet, si tip për pagëzimin; me të përshkojmë ne jetën, kalimin që rrjedh. U shfaq qart' Krishti në Jordan, shenjtëron uj'.

Tani *Hyjlindësore*

Ti që linde për ne prej Virgjëreshës dhe durove kryqëzim, o i mirë; që plaçkove vdekjen me vdekje dhe

rrëfeve ngjalljen si Perëndi, mos i zhvështro ata që gatove me dorën tënde, trego njeridashjen tënde, o mëshirplot. Prit Hyjlindësen që të lindi të ndërmjetojë për ne dhe shpëto, o Shpëtimtari ynë, një popull të dëshpëruar.*

Dhe psalim Idhiomelet:

Ting. i Rëndë

Ishte çudi të shikoje Krijuesin e qiellit e të dheut të zhveshur në lumë duke pritur si rob pagëzim prej robi për shpëtimin tonë; dhe vallet e engjëjve mahniteshin prej frike dhe prej gazi, me të cilët t' adhurojmë; shpëtona, o Zot.*

Përsëri i njëjti pa varg.

Pastaj, Ting. II:

Varg: Për këtë do të të kujtoj nga toka e Jordanit dhe e Ermoniimit.

Kur shikonte Pararendësi Zotin e lavdis³⁷ të vejë tek ai, u thërriste popujve: Ja ai që shpërblen botën erdhi nga prishja; ja ai që na shpëton prej hidhërimit; ja ai që fal ndjesë mëkatesh³⁸ erdhi mbi dhë prej Virgjëreshës së kulluar nga mëshira; dhe në vend të shërbëtorëve bën bij të Perëndis';³⁹ dhe në vend të errësirës ndriçon gjindjen njerëzore me ujin e pagëzimit të tij të hyjshëm. Eni pra, me një zë le ta lavdërojmë bashk' me Atin e me Shpirtin e Shenjt'.*

Varg: Të panë ujëra, o Perëndi, të panë ujëra dhe u frikësuan.

Përsëri i njëjti

Lavdi dhe Tani

Ting. Tërth. I

Ky Idhiomel lexohet fillimisht me shpresëtari dhe me melodi nga kanonarku në mes të kishës dhe pastaj psalet nga dy koret.

Dorën tënde që preku kryet e paplakur të Zotit (3x),/ me të cilën na e rrëfeve dhe me gisht,¹³/ ngrije për ne tek ai, o Pagëzor, meqë ke guxim të shumtë,/ se më i madh se gjith' profetët u dëshmove prej tij⁴⁰/ dhe syt' e tu të cilët panë Shpirtin e Tërëshenjt' që zbriti në formë pëllumbi,/ ngriji tek ai, o Pagëzor, duke iu lutur të bëhet hirplot',/ dhe eja qëndro bashkë me ne (3x),/ duke shiluar himnin e duke u vënë në krye të panairit.*

Dhe menjëherë Proqimeni i Profecisë:

Ting. III

Zoti është ndriçimi im dhe shpëtimtari im.

Varg: Zoti është mbrojtësi i jetës sime.

Këndimi i profecisë së Isaias

(49.8-15)

Këto thotë Zoti: “Në kohë të mirëpritur të dëgjova dhe në ditë shpëtimi të ndihmova, dhe të gatova, dhe të dhashë, dhe të vura në besëlidhje kombesh që ta stabilizosh dheun dhe që të trashëgosh trashëgimi të shkretuara, duke thënë tek ata që janë në pranga: ‘Dilni;’ dhe atyre që

janë në errësirë: ‘Zbulohuni.’ Në të gjitha udhët do të kullosen dhe në gjithë rrugët do të jetë kullota e tyre. Nuk do të urëtohen, as do të eten, as do t'i godasë ata vapa, as dielli; por ai që i përdëllen, do t'i ngushëllojë, dhe nëpërmjet burimesh ujërash do t'i udhëheqë. Dhe do të vë çdo mal në udhë dhe çdo rrugë në kullotje për ata.” Ja tek ata nga larg do vijnë; këta nga veriu dhe deti, ndërsa të tjerë nga toka e persianëve. Le të dëfrehen qiejt dhe le të ngazëllohet dheu; le të çajnë malet hare dhe kodrat drejtësi, sepse e mëshiroi Perëndia popullin e vet dhe të përluriturit e popullit të vet i ngushëlloi. Ndërsa Sioni tha: ‘Më braktisi Zoti, dhe Zoti më harroi.’ Mos vallë do ta harrojë një grua fëmijën e saj? Ose, që të mos mëshirojë pjellat e barkut të saj? Dhe nëse do t'i harrojë një grua, por unë nuk do të të harroj,” thotë Zoti i Gjithëpushtetshëm.

Dhe menjëherë Apostulli:

Këndimi i letrës së Pavlit te Tito

(2.11-14; 3.4-7)

O bir Tito, u shfaq hiri i Perëndisë, hiri shpëtimtar për gjithë njerëzit, duke na edukuar që, pasi të mohojmë pabesinë dhe dëshirat e botës, mençurisht dhe drejtësisht dhe shpresëtarisht të rrojmë në këtë jetë, duke pritur shpresën e lumur dhe dukjen e lavdisë së Perëndisë të madh dhe shpëtimtarit tonë, Jisuit

Krisht, që dha veten e tij për ne, që të na çlirojë nga çdo paligjësi dhe të pastrojë për veten e tij *një* popull të zgjedhur, të zellshëm për punë të mira. Dhe kur mirësia dhe njerdashja e shpëtimtarit tonë Perëndi u shfaq, jo prej punëve në drejtësi që bëmë ne, por sipas përdëllimit të tij, na shpëtoi me banjë rilindjeje dhe ripërtëritjeje Shpirti të Shenjtë, që derdhi mbi ne pasurisht me anë të Jisuit Krisht, shpëtimtarit tonë, që pasi të drejtësohemi përmes hirit të tij, të bëhemi sipas shpresës trashëgimtarë jeteje të përjetshme.

Ungjilli sipas Llukait.

Pastaj:

Lexuesi: Mos na dorëzo pra, në fund, për emrin tënd të shenjtë dhe mos e shpërndaj dhiatën tënde, dhe mos e largo mëshirën tënde nga ne, për Abrahamin, të dashurin prej teje dhe për Isaakun, shërbëtorin tënd dhe Izraelin, të shenjtin tënd.⁴¹

Trishenjtë, etj.

Prifti: Se jotja është.

Lexuesi: Kontaqi

Në Jordan afrohet sot, mbreti i q'ellit, Shpëtimtari Zoti Krisht, dhe shën Joanit i thërret: Mos u trondit, por më pagëzo; vij për shpëtimin e gjindjes së njerëzve.*
Mëshiro, o Zot (40x).

O Krisht Perëndi, që adhurohesh e lavdërohesh në çdo kohë e në çdo orë, në qiell e mbi dhé, zemërgjerë, zemërdhembshur, mëshirëplotë, që do të drejtët dhe mëshiron mëkatarët, që i thërret të gjithë në shpëtim me zotimin e të mirave të pritme, ti o Zot, prit lutjet tona në këtë orë dhe drejto jetesën tonë sipas porosive të tua. Shenjtërona shpirtrat, pastrona trupat, ndreqna mendimet, pastrona mendjet dhe shpëtona prej çdo hidhërimi, të keqeje dhe helmi. Mbrona me engjëjt e tu të shenjtë, që duke u ruajtur dhe duke u udhëhequr prej ushtrisë së tyre, të arrijmë të barësim te bashkimi i besës dhe te njohja e lavdisë sate të paafruar, se i bekuar je në jetë të jetëve. Amin.*

Mëshiro, o Zot (3x). Lavdi *dhe* Tani. **M**ë të nderuarën se Keruvimet dhe më të lavdëruarën pa krahasim se Serafimet, që pa u cenuar linde Fjalën Perëndi, me të vërtetë Hyjlindësen, ty të madhërojmë.

Beko, o atë, në emrin e Zotit.

Prifti: Perëndia na dhembshuroftë dhe na bekoftë...

Dhe urata:

O Zot Jisu Krisht, Perëndia ynë, që e zgjerove zemrën në paudhësitë tona dhe që na solle deri në orën e tanishme, në të cilën i varur mbi drurin jetëbërës, i shtrove kusarit mirënjohës udhën drejt hyrjes në Parajsë dhe me vdekjen, vdekjen

e asgjësive, le të të vijë keq dhe për ne, shërbëtorët e tu mëkatarë dhe të padenjë; se mëkatuam dhe bëmë paudhësi⁴² dhe nuk jemi të denjë të ngremë sytë tanë dhe të shikojmë në lartësinë e qiellit, se braktisëm udhën e drejtësisë sate dhe ecëm në vullnetet e zemrave tona; por i përgjrohemi mirësisë sate të paimagjinueshme: Kursena, o Zot, sipas shumicës së mëshirës sate⁴³ dhe shpëtona për emrin tënd të shenjtë, se u shteruan në kotësi ditët tona;⁴⁴ nxirrna nga dora e kundërshtarit dhe falnai mëkatet, dhe vrit mentalitetin tonë mishor,⁴⁵ që duke hedhur tej njeriun e vjetër,⁴⁶ të veshim të riun,⁴⁷ dhe të jetojmë për ty, Zotin dhe kujdestarin tonë; dhe kështu, duke shkuar pas urdhëresave të tua, të përfundojmë në prehjen e amshuar, ku është banesa e të gjithë atyre që dëfrehen;⁴⁸ se ti je me të vërtetë ngazëllimi i vërtetë dhe hareja e atyre që të duan, o Krisht Perëndia ynë, dhe ty ta drejtojmë lavdinë bashkë me Atin tënd pa fillim dhe Shpirtin tënd të Tërëshenjtë, të mirë dhe jetëbërës, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

*Përlëshimi i Vogël dhe menjëherë Mbrëmësorja e Madhe dhe Liturgjia e Vasilit të Madh. [Por në manastiret para Përlëshimit thuhet edhe Tipiket hima:
Psalmi 102*

Beko, o shpirti im, Zotin dhe të gj-

thë të brendshmet e mia emrin e tij të shenjtë. Beko, o shpirti im, Zotin dhe mos i harro gjithë shpërblimet e tij; atë që është i butë në gjithë paligjësitë e tua; atë që shëron gjithë sëmundjet e tua; atë që çliron nga prishja jetën tënde, që të kurorëzon me mëshirë dhe dhembshuri; atë që mbush me të mira dëshirën tënde. Do të ripërtëritet si e shqiponjës rinia jote. Bën lëmosha Zoti dhe gjykim për të gjithë që u bëjnë padrejtësi. Ia bëri të njohura udhët e tij Moisiut, bijve të Izraelit dëshirat e tij. I dhembshur dhe përdëllyes është Zoti, zemërgjerë dhe i shumë mëshirshëm. Nuk do të zemërohet përfundimisht, as përjetë s'do të mbajë mëri. Nuk na bëri sipas paligjësive tona, as sipas mëkateve tona s'na shpagoi, sepse sipas lartësisë së qiellit nga dheu e fuqizoi Zoti përdëllimin e tij mbi ata që e kanë frikë. Sa distancohet lindja nga perëndimi, aq i largoi nga ne paligjësitë tona. Sikurse dhembshuron një atë bij, dhembshuroi Zoti ata që ia kanë frikën; se ai njohu gatimin tonë, kujtoi se jemi dhé. Njeriu, porsi bar janë ditët e tij, porsi lulja e arës, kështu do të fishket, se frymë kaloi në të dhe nuk do të jetë, dhe nuk do të dijë më vendin e tij; ndërsa përdëllimi i Zotit është që nga jeta gjer në jetën mbi ata që ia kanë frikën, dhe drejtësia e tij mbi bij bijsh, që ruajnë dhiatën e tij dhe kujtojnë porositë e tij për t'i

bërë. Zoti në qiell e bëri gati fronin e tij dhe mbretëria e tij i zotëron të gjitha. Bekoni Zotin gjithë engjëjt e tij, të fortë në forcë që bëni fjalën e tij, që ta dëgjoni zërin e fjalëve të tij. Bekoni Zotin gjithë fuqitë e tij, shërbyesit e tij që zbatoni vullnetin e tij. Bekoni Zotin gjithë veprat e tij, në çdo vend të sundimit të tij. Beko, o shpirti im, Zotin.

Lavdi

Psalmi 145

Lavdëro, o shpirti im, Zotin, do të lavdëroj Zotin në jetën time. Do të psal për Perëndinë tim derisa të jem. Mos kini besim tek arkondë, tek bij njerëzish, në të cilët nuk ka shpëtim. Do të dalë fryma e tij dhe do të kthehet në tokën e tij. Atë ditë do të humbin gjithë mendimet e tij. Lum ai që Perëndia i Jakovit është ndihmësi i tij, shpresa e tij është mbi Zotin, Perëndinë e tij; që bëri qiellin dhe dheun, detin dhe gjitha në to; atë që ruan të vërtetë përjetë; që bën gjykim për ata që u bëjnë padrejtësi; që u jep ushqim të uriturve. Zoti zgjidh të lidhurit, Zoti urtëson të verbër, Zoti ngre të thyer, Zoti do të drejtë, Zoti i ruan proslitet. Jetim dhe vejshë do të marrë përsipër dhe udhë mëkatarësh do të zhdukë. Do të mbretërojë Zoti përjetë, Perëndia yt, o Sion, brez pas brezi.

Tani

O i vetëmlindur Bir³³ dhe Fjalë e Perëndisë, që je i pavdekshëm dhe denjove për shpëtimin tonë të trupëzohesh prej Hyjllindëses së shenjtë dhe gjithmonë Virgjëreshës Mari duke u bërë njeri pa ndryshuar; që u kryqëzove për ne, o Krisht, Perëndi, dhe shkele vdekjen me vdekje; që je një prej Trinisë së Shenjtë dhe lavdërohesh bashkë me Atin dhe me Shpirtin e Shenjtë, shpëtona.*

*Lumërimet*⁴⁹

Në mbretërinë tënde kujtona, o Zot, kur të vish në mbretërinë tënde.⁵⁰
Lum të varfrit në shpirt, sepse e tyre është mbretëria e qiejve.
Lum ata që janë në zi, sepse ata do të ngushëllohen.
Lum të butët, sepse ata do të trashëgojnë dhenë.
Lum të uriturit dhe të eturit për drejtësi, sepse ata do të ngopen.
Lum përdëllimtarët, sepse ata do të përdëllehen.
Lum të pastrit në zemër, sepse ata Perëndinë do ta shohin.
Lum paqebërësit, sepse ata bij Perëndie do të quhen.
Lum të përndjekurit për drejtësi, sepse e tyre është mbretëria e qiejve.
Të lumtur jeni kur t'ju poshtërojnë e t'ju përndjekin, e të thonë çdo fjalë dinake kundër jush duke gënjyer për shkakun tim.
Gëzohuni e ngazëllohuni, sepse pa-

ga juaj është e shumtë në qiejt.

Lavdi *dhe* Tani

Kujtona, o Zot, kur të vish në mbretërinë tënde.⁵⁰

Kujtona, o Kryezot, kur të vish në mbretërinë tënde.⁵⁰

Kujtona, o i Shenjtë, kur të vish në mbretërinë tënde.⁵⁰

Kori qiellor të himnon dhe thotë: Shenjt, Shenjt, Shenjt, Zoti Sabaoth, qielli dhe dheu *janë* plot me lavdinë tënde.^{51.*}

Varg: Afrohuni drejt atij dhe ndriçohuni, dhe fytyrat tuaja nuk do të turpërohen dot.

Kori qiellor të himnon dhe thotë: Shenjt, Shenjt, Shenjt, Zoti Sabaoth, qielli dhe dheu *janë* plot me lavdinë tënde.^{51.*}

Lavdi

Kori i engjëjve dhe i kryeengjëjve të shenjtë, bashkë me të gjitha fuqitë qiellore të himnon dhe thotë: Shenjt, Shenjt, Shenjt, Zoti Sabaoth, qielli dhe dheu *janë* plot me lavdinë tënde.^{51.*}

Tani

Besoj në një Perëndi, Atë të tërëfuqishëm, krijues të qiellit dhe të dheut dhe të gjithë të dukurave dhe të padukurave. Dhe në një Zot, Jisu Krishtin, Birin e Perëndisë, të ve-

tëmlindurin, që lindi prej Atit përpara gjithë shekujve. Dritë prej drite, Perëndi të vërtetë, prej Perëndie të vërtetë, të lindur, jo të bërë, që ka të genët një me Atin, me anën e të cilit u bënë të gjitha. Që për ne njerëzit dhe për shpëtimin tonë, zbriti prej qiejve, dhe u trupëzua prej Shpirtit të Shenjtë dhe Virgjëreshës Mari dhe u bë njeri. Dhe u kryqëzua për ne në kohën e Pontit Pilat, dhe pësoi e u varros. Dhe u ngjall të tretën ditë sipas Shkrimeve. Dhe u ngjit në qiejt dhe rri në të djathtë të Atit. Dhe do të vijë përsëri me lavdi të gjykojë të gjallët dhe të vdekurit, mbretëria e të cilit nuk do të ketë mbarim. Dhe në Shpirtin e Shenjtë, Zot, jetëbërës, që buron prej Atit, që adhurohet e lavdërohet bashkë me Atin e me Birin, që foli me anën e profetëve. Në një Kishë të shenjtë, katolike dhe apostolike. Pohoj një pagëzim për ndjesën e mëkateve. Pres ngjalljen e të vdekurve. Dhe jetën e ardhshme të amshuar. Amin.

Lër, ndje, fal, o Perëndi, shkeljet tona me dashje dhe pa dashje, me vepra e me fjalë, me dije e pa dije, natën e ditën, me mendje e me mendime; të gjitha falnai, si i mirë dhe njeridashës.

Ati ynë që je në qiejt, u shenjtëroftë emri yt, ardhhtë mbretëria jote, u bëftë dëshira jote si në qiell ashtu edhe

mbi dhé. Bukën tonë të përditshme jepna neve sot; dhe falna fajet tona, sikurse edhe ne ua falim fajtorëve tanë; dhe mos na shtjer në ngasje, po shpëtona nga i ligu.

Prifti: Se jotja është mbretëria dhe fuqia dhe lavdia, e Atit, e Birit dhe e Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve.

Lexuesi: Kontaqi

Në Jordan afrohet sot, mbreti i q'ellit, Shpëtimtari Zoti Krisht, dhe shën Joanit i thërret: Mos u trondit, por më pagëzo; vij për shpëtimin e gjindjes së njerëzve.*

Mëshiro, o Zot (*12x*).

Emri i Zotit qoftë i bekuar (*3x*).

Dhe Përlëshimi i Vogël.]

CITIME

¹ IV [II] Mbret. 2.11-14

² Is. 9.1 (8.23); Matth. 4.15

³ Gjen. 3.10

⁴ Gjen. 3.7

⁵ Lluk. 15.22

⁶ Mal. 4.2

⁷ Rom. 9.5

⁸ Is. 40.3; Matth. 3.3; Mark. 1.3; Lluk. 3.4; Joan 1.23

⁹ Fil. 2.7

¹⁰ Joan 8.46

¹¹ Ps. 76(77).17

¹² Joan 5.35

¹³ Is. 53.4,7; Joan 1.29

¹⁴ Ps. 118(119).133-135

¹⁵ Ps. 70(71).8

¹⁶ Joan 1.4,9; 8.12; 9.5

¹⁷ Ps. 4.7

¹⁸ I Tim. 6.16

¹⁹ Joan 15.1

²⁰ Joan 11.25; 14.6; Kol. 3.4; I Joan 1.2; 5.12

²¹ Ef. 2.14

²² Ps. 67(68).20-21

²³ Jak. 5.16

²⁴ Hebr. 5.7; 7.25; Jak. 4.12

²⁵ Matth. 3.15; 5.17

²⁶ Ef. 6.12

²⁷ Joan 6.27; 10.28; 17.2

²⁸ Ps. 113(114).3-7

²⁹ Ligji i Dytë 4.24; 9.3; Hebr. 12.29

³⁰ I Tim. 3.16

³¹ Ps. 78(79).8-9

³² Sof. 2.9 etj.

³³ Joan 1.14,18; 3.16,18; I Joan 4.9

³⁴ Kol. 2.14-15

³⁵ Ps. 118(119).120

³⁶ Ps. 140(141).4

³⁷ I Kor. 2.8

³⁸ Vep. 5.31

³⁹ Joan 15.15

⁴⁰ Matth. 11.11; Lluk. 7.28

⁴¹ Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 10-11

⁴² Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 5

⁴³ Neh. 13.22

⁴⁴ Ps. 77(78).33

⁴⁵ Rom. 8.6; Kol. 3.5

⁴⁶ Rom. 6.6; Ef. 4.22; Kol. 3.9

⁴⁷ Ef. 4.24; Kol. 3.10

⁴⁸ Ps. 86(87).7

⁴⁹ Matth. 5.3-12

⁵⁰ Lluk. 23.42

⁵¹ Is. 6.3



MË 6 TË TË NJËTIT MUAJ

Theofania e shenjtë e Zotit, Perëndisë
dhe Shpëtimtarit tonë Jisu Krisht.

*Nëse Theofania bie të dielën, nuk
psalet asgjë ngjallësore.*

MBRËMËSORJA E MADHE
DHE LITURGJIA E SHËN VASILIT

Dhjaku: Beko, o Zot.

Prifti: E bekuar është mbretëria.

I pari (ose Lexuesi): Ejani t'i falemi.
Dhe Psalmi Nistor. (Nuk lexohet Psaltiri).

6 Thirtore Ting. II Të Joan Monakut

Dritën ton', që ndriçoi çdo njeri,¹ kur
pa Pararendësi të vijë për t'u pagëzuar,
i gëzohej shpirti dhe i dridhej dora;
e tregon² dhe u thotë popujve: Ja ai
që shpërblen Izraelin, ai që na çliron
nga prishja. O Krisht i pamëkatshëm,
Perëndia ynë, lavdi më ty.*

(2x)

Kur pagëzohej shpërblyesi ynë prej
një robi dhe dëshmohej prej zbritjes
së Shpirtit, u tmerruan duke parë
ushtrit' e engjëjve; dhe një zë u su-
all prej Atit nga qielli: Ky, të cilin
Pararendësi dorëzon, është Biri im i
dashur, i cili më pëlqeu. O Krisht Pe-
rëndia ynë, lavdi më ty.*

(2x)

Valët e Jordanit pritën ty burimin,
dhe Ngushëllimtari zbriti në formë
pëllumbi; ul kryet ai që uli qiejtë;³
i thërret e i këlthet balta artistit.
Përse më urdhëron ato që janë për-
mbi fuqinë time? Unë kam nevojë
për pagëzimin tënd. O Krisht i pamë-
katshëm, Perëndia ynë, lavdi më ty.*

Duke dashur të shpëtosh njeriun e
arratisur, denjove të marrësh fytyrë
robi;⁴ se duhej ti, Zoti dhe Perëndia,
të merrje përsipër mëkatet tona për
ne; se, si u pagëzove trupërisht, o
Shpërblyes, na vlerësove për ndje-
sën; prandaj po të thërresim: O
Krisht mirëbërës, Perëndia ynë, lavdi
më ty.*

Lavdi *dhe* Tani

Ting. II I Bizantit

Iule kryet Pararendësit, dërrmove
krerët e dragonjve,⁵ qëndrove ndër
valët, ndriçove Gjithësinë që të të
lavdërojë, o Shpëtimtar, ty, dritën e
shpirttrave tanë.*

*Hyrje me Ungjillin si zakonisht, kur
Mbrëmësorja ka Ungjill. O dritë gazmore.
Dhe menjëherë:*

I. Këndimi i Gjenezës

(1.1-13)

Në fillim bëri Perëndia qiellin dhe
tokën; dhe toka ishte e padukshme
dhe e pabërë, dhe errësirë ishte mbi
avushën, dhe Shpirt Perëndie sillej

mbi ujin. Dhe tha Perëndia: “Le të bëhet dritë. Dhe u bë dritë.” Dhe pa Perëndia dritën se *ishte* e mirë dhe ndau Perëndia mes dritës dhe mes errësirës. Dhe e quajti Perëndia dritën “ditë” dhe errësirën e quajti “natë;” dhe u bë mbrëmje, dhe u bë mëngjes, një ditë. Dhe tha Perëndia: “Le të bëhet mbështetje në mes të ujit dhe le të ndajë në mes ujin dhe ujin.” Dhe u bë kështu. Dhe bëri Perëndia mbështetjen dhe ndau Perëndia në mes të ujit që *ishte* nën mbështetjen dhe në mes të ujit që *ishte* sipër mbështetjes. Dhe e quajti Perëndia mbështetjen “qiell” dhe pa Perëndia se *ishte* e mirë; dhe u bë mbrëmje, dhe u bë mëngjes, dita e dytë. Dhe tha Perëndia: “Le të mbli-dhet uji që është nën qiellin në një grumbull dhe le të shikohet stereja.” Dhe u bë kështu, dhe u mblodh uji që *ishte* nën qiellin në mbledhjet e tyre dhe u pa stereja; dhe e quajti Perëndia sterenë “tokë” dhe sistemet e ujërave i quajti “dete”; dhe pa Perëndia se *ishte* e mirë. Dhe tha Perëndia: “Le të nxjerrë toka filiz bari, që mbjell farë sipas gjinie dhe sipas ngjashmërie, dhe pemë pjellore që bën frut, fara e të cilit të jetë brenda atij sipas gjinie mbi tokë.” Dhe u bë kështu. Dhe nxori toka filiz bari, që mbjell farë sipas gjinie dhe sipas ngjashmërie, dhe pemë pjellore që bën frut, fara e të cilit është brenda atij sipas gjinie mbi tokë; dhe pa

Perëndia se *ishte* e mirë; dhe u bë mbrëmje, dhe u bë mëngjes, dita e tretë.

Menjëherë psalet tropari që vijon më pas (U fanepse në botë), por në manastiret lexohen edhe Leximet II dhe III.

II. Këndimi i Eksodit (14.15-18,21-23,27-29)

Tha Zoti drejt Moisiut: “Përse thërret drejt meje? Folu bijve të Izraelit dhe le të nisen. Dhe ti ngri shkopin tënd dhe shtriye dorën tënde mbi detin, dhe çaje atë, dhe le të hyjnë bijtë e Izraelit në mes të detit në të thatë. Dhe ja ku unë do ta ashpërsoj zemrën e Faraonit dhe të shërbyesve të tij, dhe të të gjithë egjiptianëve, dhe do të futen mbrapa tyre, dhe do të lavdërohem në Farao dhe në gjithë ushtrinë e tij, dhe në karrocat, dhe në kuajt e tij. Dhe do të njohin tërë egjiptianët se unë jam Zot, kur do të lavdërohem në Farao dhe në karrocat, dhe në kuajt e tij.” Dhe tendosi Moisiu dorën e tij mbi detin dhe e vuri Zoti detin në erë të vrullshme jugu tërë natën dhe e bëri detin *si* sterë dhe u ça uji. Dhe hynë bijtë e Izraelit në mes të detit në të thatë, dhe uji *ishte* për ata mur nga e djathta dhe mur nga e majta. Dhe i ndoqën egjiptianët dhe hynë mbrapa tyre i gjithë kali i Faraonit dhe karrocat, dhe hipësit në mes të detit. Dhe e tendosi Moisiu dorën mbi detin

dhe u rimëkëmb uji rreth mëngjesit në vend. Dhe egjiptianët ikën nën ujin, dhe shkundi Zoti egjiptianët në mes të detit. Dhe pasi u rikthye uji, mbuloi karrocat dhe hipësit, dhe gjithë fuqinë e Faraonit, që hynin mbrapa tyre në det; dhe nuk mbeti nga ata asnjë, ndërsa bijtë e Izraelit ecën nëpërmjet të thatës në mes të detit.

III. Këndimi i Eksodit (15.22-27; 16.1)

Ingriti Moisiu bijtë e Izraelit nga Deti i Kuq dhe i udhëhoqi ata në shkretëtirën e Surit; dhe ecnin tri ditë në shkretëtirë dhe nuk gjenin ujë për të pirë. Dhe erdhën në Meranë dhe nuk mundeshin të pinin ujë nga Mera, sepse ishte i hidhur; prandaj emri i atij vendi u mbiquajt Hidhërim. Dhe murmuriste populli kundër Moisiut duke thënë: “Ç’të pimë?” Dhe thirri Moisiu te Zoti dhe i tregoi atij Zoti një dru, dhe e futi atë brenda ujit dhe u ëmbëlsua uji. Atje i vendosi atij të drejta dhe gjykime dhe atje e provoi atë dhe i tha: “Nëse do ta dëgjosh me dëgjim Zotin, Perëndinë tënd dhe të pëlqyera para atij do t’i bësh, dhe do t’i vendosësh në vesh porositë e tij, dhe do t’i ruash të gjitha të drejtat e tij, çdo sëmundje që e solla mbi egjiptianët, nuk do ta sjell mbi ty, sepse unë jam Zoti, Perëndia yt që të shëroj ty.” Dhe erdhën në Elim, dhe ishin atje dymbëdhjetë burime

ujërash dhe shtatëdhjetë trungje feniksësh; dhe fushuan atje pranë ujërave. Dhe u ngritën nga Elimi dhe erdhi gjithë mbledhja e bijve të Izraelit në shkretëtirën e Sinit, që është mes Elimit dhe mes Sinait.

*Pastaj duke u ngritur ne, psalim
Troparin
Ting. Tërth. I*

U fanepse në botë ti që krijove botën, që të ndriçosh ata që rrinin n’ errësirë,⁶ njeridashës, lavdi më ty.*

Varg a): Perëndia na përdëlleftë dhe na bekoftë, shfaqte fytyrën e tij mbi ne dhe na mëshiroftë.

Që të ndriçosh ata që rrinin n’ errësirë, njeridashës, lavdi më ty.

Varg b): Që të njohin nëpër tokë udhën tënde, në gjithë kombet shpëtimin tënd.

Që të ndriçosh ata që rrinin n’ errësirë, njeridashës, lavdi më ty.

Varg c): Le të të lavdërojnë popuj, o Perëndi, le të të lavdërojnë popujt mbarë; toka dha frutin e saj.

Që të ndriçosh ata që rrinin n’ errësirë, njeridashës, lavdi më ty.

Varg d): Na bekoftë Perëndia, Perëndia ynë, na bekoftë Perëndia; dhe le ta kenë frikë atë të gjithë anët e dheut.

Që të ndriçosh ata që rrinin n’ errësirë, njeridashës, lavdi më ty.

Lavdi *dhe* Tani

Përsëri Tropari i tërë

Pastaj Këndimi V (IV Mbretërve 2.6-14) dhe menjëherë Tropari që vijon më pas (Te mëkatarët dhe kumerqarët), por në manastiret lexohen të gjitha sipas radhës së mëposhtme.

IV. Këndimi i Jisuit të Naviut
(3.7-8,15-17)

Tha Zoti drejt Jisuit: “Në këtë ditë filloj që të të lartësoj përballë gjithë bijve të Izraelit, që të njohin se, siç isha me Moisiun, kështu do të jem edhe me ty. Dhe tani porositi priftërinjtë që ngrënë Arkën e Dhiatës, duke thënë: ‘Sapo do të hyni mbi një pjesë të ujit të Jordanit, dhe në Jordan do të qëndroni.’ Dhe si ecnin priftërinjtë që ngrinin Arkën mbi Jordanin dhe u lyen në një pjesë të ujit të Jordanit (ndërsa Jordani mbushej në tërë shtratin e tij, si në ditë korrijeje grurësh); dhe ndaluan ujërat që zbrisnin nga lart në një mpiksje, që distancohej shumë, shumë larg deri në një pjesë të Karjatharimit; ndërsa ai që zbriste, zbriti në detin arab, detin e kriperave, deri në fund shteroi. Dhe populli qëndronte përballë Jerikosë. Dhe qëndruan priftërinjtë që ngrinin Arkën e Dhiatës së Zotit mbi të thatë në mes të Jordanit; dhe gjithë bijtë e Izraelit kalonin përmes të thatës, derisa përfundoi gjithë populli së kaluari Jordanin.

V. Këndimi i IV Mbretërve
(2.6-14)

Itha Ilija Eliseut: “Rri pra këtu, sepse Zoti më ka dërguar deri në Jordan.” Dhe tha Eliseu: “Rron Zoti dhe rron shpirti yt, nëse do të të lë.” Dhe ecën që të dy. Dhe pesëdhjetë burra nga bijtë e profetëve *erdhën* dhe qëndruan përballë nga larg, ndërsa që të dy qëndruan mbi Jordanin. Dhe mori Ilija gëzofin e tij dhe e mbështolli, dhe goditi ujin; dhe u nda uji këtej dhe andej, dhe kaluan që të dy përmes të thatës. Dhe ndodhi që kur kalonin ata, dhe tha Ilija drejt Eliseut: “Kërko ç’të bëj për ty para se të ngjitem *lart* prej teje.” Dhe tha Eliseu: “Le të bëhen pra ato që ke në shpirtin tënd të dyfishta mbi mua.” Dhe tha Ilija: “U ashpërsove të kërkosh; nëse do të më shikosh të ngjitem *lart* nga ti, dhe do të jetë kështu, ndërsa nëse nuk do të *shikosh*, nuk do të bëhet.” Dhe ndodhi që kur ata ishin duke ecur, ecnin dhe flisnin; dhe ja ku një karrocë zjarri dhe kuaj zjarri, dhe i ndanë mes tyre të dy, dhe u ngjit Ilija në stuhi si në qiell. Dhe Eliseu shikonte dhe thërriste: “Atë, atë, karrocë Izraeli dhe hipës i tij.” Dhe nuk e pa më. Dhe kapi rrobat e tij, dhe i grisi më dysh. Dhe e ngriti gëzofin e Ilias, i cili ra nga lart mbi Eliseun, dhe u kthye Eliseu, dhe qëndroi mbi buzë të Jordanit dhe mori gëzofin e Ilias, i cili ra nga lart mbi të dhe e goditi ujin,

dhe nuk u nda, dhe tha: “Ku është Perëndia i Ilias afo?” Dhe i goditi ujërat dhe u çanë këtej dhe andej, dhe kaloi Eliseu.

VI. Këndimi i IV Mbretërve

(5.9-14)

Erdhi Nemani, prijës i mbretit të asirianëve në kalë dhe karrocë, dhe qëndroi mbi derën e shtëpisë së Eliseut. Dhe dërgoi Eliseu lajmëtar drejt atij duke thënë: “Si të ecësh, lahu shtatë herë në Jordan dhe do të kthehet mishi yt te ti, dhe do të pastrohesh.” Dhe u zemërua Nemani, dhe iku, dhe tha: “Ja, thashë se tek unë patjetër do të dalë dhe do të qëndrojë, dhe do të thërrasë në emrin e Perëndisë së tij, dhe do të vendosë dorën e tij mbi vendin, dhe do ta mbledhë lebrën. Nuk është më i mirë Avana dhe Farfari, lumenjtë e Damaskut mbi të gjithë ujërat e Izraelit? Pasi të ec, nuk do të lahem në to dhe nuk do të pastrohem?” Dhe devijoi dhe iku me zemërim. Dhe iu afruan shërbëtorët e tij dhe folën drejt atij: “Fjalë të madhe foli profeti drejt teje? Nuk do të bësh? Dhe që tha drejt teje: ‘Lahu dhe pastrohu?’ Dhe zbriti Nemani, dhe u zhyt në Jordan shtatë herë sipas fjalës së Eliseut, dhe u rikthye mishi i tij si mish fëmije të vogël dhe u pastrua.

*Tropari Ting. Tërth. II
(fillon psalti i dytë)*

Te mëkatarët dhe kumerqarët nga shumicë e mëshirës sate u fanepse, o Shpëtimtari ynë, se ku tjetër kishte për të ndritur drita jote, veçse tek ata që rrinin n’ errësir’?⁶ Lavdi më ty.*

Varg a): Zoti mbretëroi, u vesh me hijesi.

Se ku tjetër kishte për të ndritur drita jote, veçse tek ata që rrinin n’ errësir’? Lavdi më ty.

Varg b): Ngritën lumenjtë, o Zot, i ngritën lumenjtë zërat e tyre.

Se ku tjetër kishte për të ndritur drita jote, veçse tek ata që rrinin n’ errësir’? Lavdi më ty.

Varg c): Të çuditshme ngritjet e detit, i çuditshëm në të lartat Zoti.

Se ku tjetër kishte për të ndritur drita jote, veçse tek ata që rrinin n’ errësir’? Lavdi më ty.

Varg d): Shtëpisë sate i përket shenjtërim, o Zot, në gjatësi ditësh.

Se ku tjetër kishte për të ndritur drita jote, veçse tek ata që rrinin n’ errësir’? Lavdi më ty.

Lavdi dhe Tani

Përsëri Tropari i tërë

Pastaj Këndimi VI (IV Mbretërve 5.9-14) dhe menjëherë dhjaku: Le t’i lutemi Zotit. Priifti: Se i shenjtë je. Himni Trishenjtor (Por në manastiret lexohen të gjitha sipas radhës së mëposhtme).

VII. Këndimi i profecisë së Isaias

(1.16-20)

Këto thotë Zoti: “Lahuni dhe të pastër bëhuni; hiqni dinakëritë tuaja prej shpirtrave tuaj përballë syve të mi; pushoni nga dinakëritë tuaja; mësoni të bëni mirë, kërkoni fort gjykim, shpëtoni atë që i bëjnë padrejtësi, gjykoni jetim dhe drejtësoni vejushë. Dhe ejani të dialogojmë,” thotë Zoti, “dhe në qofshin mëkatet tuaja si purpur, si dëborë do të zbardh; dhe në qofshin si të kuqe, si lesh do të zbardh. Dhe nëse doni, dhe nëse do të më dëgjoni, të mirat e dheut do të hani; ndërsa nëse nuk doni, as nuk do të më dëgjoni, thikë do t’ju hajë;” sepse goja e Zotit i foli këto.

VIII. Këndimi i Gjenezës

(32.1-10)

Pasi pa lart Jakovi, pa rreshtim Perëndie të ishte rreshtuar, dhe e takuan engjëjt e Perëndisë. Dhe tha Jakovi kur i pa: “Rreshtim Perëndie është ky;” dhe e quajti emrin e atij vendi Rreshtime. Dhe dërgoi Jakovi lajmëtarë para tij drejt Isavit, vëllai i tij, në tokën Siir, në vendin e Edomit. Dhe u porositi atyre duke thënë: “Kështu do t’i thoni zotit tim Isav: ‘Kështu thotë shërbëtori yt Jakovi: Bashkë me Lavanin banova pranë dhe vonova deri tani, dhe m’u bënë qe dhe gomarë, dhe dele, dhe shërbëtorë dhe shërbëtore; dhe dërgova që të lajmëroj zotin tim Isav, që të

gjejë shërbëtori yt hir përballë teje.” Dhe u kthyen lajmëtarët drejt Jakovit, duke thënë: “Erdhëm drejt vëllait tënd Isav, dhe ja që ai vjen në takim me ty dhe katërqind burra tok me të.” Dhe u frikësua Jakovi fort, dhe s’dinte ç’të bënte; dhe ndau popullin që kishte me vete, dhe qetë, dhe gamilet, dhe delet në dy rreshtime. Dhe tha Jakovi: “Nëse do vijë Isavi në një rreshtim dhe do ta presë, do të jetë rreshtimi i dytë për shpëtim.” Dhe tha Jakovi: “O Perëndi i atit tim Abraham dhe Perëndi i atit tim Isaak, Zot, ti që më the ‘Vrapo në dheun e lindjes sate dhe do të të bëj mirë’, le të më mjaftojë nga çdo drejtësi dhe nga çdo e vërtetë që i bëre shërbyesit tënd; sepse vetëm me këtë shkopin tim kalova këtë Jordan.”

IX. Këndimi i Eksodit

(2.5-10)

Zbriti bija e Faraonit që të lahej mbi lumin dhe shërbëtoret e saj ecnin pranë lumit. Dhe sapo pa shportën në kënetë, pasi e dërgoi shërbëtoren, e ngriti; dhe pasi e hapi, sheh një fëmijë që po qante në shportë dhe e kurseu atë bija e Faraonit, dhe tha: “Nga fëmijët e hebrenjve është ky.” Dhe i tha motra e tij bijës së Faraonit: “Do që të të thërres *ndonjë* grua mëndëse nga hebrenjtë dhe do të të mëndë fëmijën?” Dhe tha bija e Faraonit: “Ec.” Dhe kur erdhi e reja, thirri nënën e fëmijës. Dhe

tha tek ajo bija e Faraonit: “Ma mbaj këtë fëmijë dhe ma mënd, dhe unë do të të jap pagesën.” Dhe e mori gruaja fëmijën dhe e mëndte. Dhe kur u rrit fëmija, e futi drejt bijës së Faraonit dhe iu bë asaj për bir, dhe e mbiquajti emrin e tij Moisi duke thënë: “Prej ujit e ngrita atë.”

X. Këndimi i Gjyqtarëve

(6.36-39)

Tha Gjedeoni drejt Perëndisë: “Nëse ti shpëton me dorën time Izraelin, sikundër fole, ja unë, vë shtëllungën e leshit në lëmë. Në qoftë se vesë do të jetë vetëm mbi shtëllungën dhe mbi tërë tokën thatësirë, do të njoh se do ta shpëtosh me dorën time Izraelin, sikundër fole.” Dhe u bë kështu; dhe mëngoi të nesërmen dhe shtypi shtëllungën, dhe pikoi vesë nga shtëllungja, një legen plot me ujë. Dhe tha Gjedeoni drejt Perëndisë: “Se mos pra zemërohet inati yt në mua, dhe do të flas një herë akoma: Do të provoj edhe një herë prapë pra në shtëllungë, dhe le të bëhet thatësira vetëm mbi shtëllungën, dhe mbi tërë tokën le të bëhet vesë.” Dhe bëri Perëndia kështu atë natë; dhe u bë thatësirë mbi shtëllungën vetëm, dhe mbi tërë tokën u bë vesë.

XI. Këndimi i III Mbretërve

(18.30-39)

Tha Ilia drejt popullit: “Ejani drejt meje.” Dhe erdhi i gjithë populli drejt

atij. Dhe mori Ilia dymbëdhjetë gurë, sipas numrit të fiseve të Izraelit, siç foli Zoti tek ai duke thënë: “Izrael do të jetë emri yt.” Dhe ndërtoi gurët në emër Zoti dhe shëroi altarin e shkallmuar krejtësisht, dhe bëri një det që mbante dy masa fare përreth altarit. Dhe stivoi copat e prera mbi altarin që bëri dhe copëtoi holokaustin, dhe vuri mbi copat e prera, dhe stivoi mbi altarin, dhe tha: “Më merrni katër shtamba uji dhe derdhni mbi holokaustin dhe mbi copat e prera.” Dhe kështu bënë. Dhe tha: “Bëjeni për së dyti.” Dhe e bënë për së dyti. Dhe tha: “Bëjeni për së treti.” Dhe e bënë për së treti. Dhe ecte uji rreth altarit dhe detin e mbushi me ujë. Dhe thirri fort Ilia te qielli, dhe tha: “O Zot, Perëndia i Abrahamit dhe Isaakut, dhe Izraelit, më dëgjo, o Zot, më dëgjo sot në zjarr, dhe le të njohë i gjithë ky popull se ti je Zot, Perëndia i Izraelit dhe unë jam shërbëtori yt, dhe për ty kam bërë këto vepra. Më dëgjo, o Zot, më dëgjo në zjarr, dhe le të njohë ky popull se ti je Zoti Perëndia dhe ti e ktheve zemrën e këtij populli mbrapa.” Dhe ra zjarr prej Zotit nga qielli dhe hëngri plotësisht holokaustet dhe copat e prera, dhe ujin që ishte në det, edhe gurët, dhe dheun i lëpiu zjarri. Dhe ra i gjithë populli mbi faqen e tij dhe thanë: “Me të vërtetë Zoti Perëndia, ky është Perëndia.”

XII. Këndimi i IV Mbretërve
(2.19-22)

Thanë burrat e qytetit Jeriko drejt Eliseut: «Ja, të banuarit e qytetit është i mirë, siç zotëria *juaj* shikon, dhe ujërat janë dhimbjeprurës dhe toka bëhet pa fëmijë.» Dhe tha Eliseu: “Ma merrni *një* shtambë të vogël, të re dhe vendosni atje kripëra.” Dhe morën, dhe e sollën drejt tij. Dhe doli Eliseu në daljen e ujërave dhe hodhi atje kripë dhe tha: Këto thotë Zoti: «I shërova ujërat, dhe nuk do të ketë më prej andej vdekje dhe ndonjë që të shterohet nga fëmijët.» Dhe u shëruan ujërat deri në këtë ditë sipas fjalës së Eliseut që foli.

XIII. Këndimi i profecisë së Isaias
(49.8-15)

Këto thotë Zoti: “Në kohë të mirëpritur të dëgjova dhe në ditë shpëtimi të ndihmova, dhe të gatova, dhe të dhashë në besëlidhje kombesh që ta sigurosh dheun dhe që të trashëgosh trashëgimi të shkretuara, duke thënë tek ata që janë në pranga: ‘Dilni;’ dhe tek ata që janë në errësirë të zbulohen.” Në të gjitha udhët do të kullosen dhe në gjithë rrugët do të jetë kullota e tyre. Nuk do të urëtohen, as do të eten, as do t’i godasë ata vapa, as dielli; por ai që i përdëllen do t’i ngushëllojë, dhe nëpërmjet burimesh ujërash do t’i udhëheqë. Dhe do të vë çdo mal në udhë dhe çdo rrugë në kullotje

për ata. Ja, ata nga larg vijnë; këta nga veriu dhe ata nga deti, ndërsa të tjerë nga toka e persianëve. “Dëfreni, o qiej, dhe le të ngazëllohet dheu.” Le të çajnë malet hare, sepse e mëshiroi Perëndia popullin e vet dhe të përlulit e popullit të vet i ngushëlloi. Ndërsa Sioni tha: “Më braktisi Zoti, dhe Zoti më harroi.” Mos *vallë* do ta harrojë *një* grua fëmijën e saj, që të mos i mëshirojë pjellat e barkut të saj? “Dhe nëse do t’i harrojë *një* grua, por unë nuk do të të harroj,” thotë Zoti.

Dhe menjëherë

Dhjaku: Le t’i lutemi Zotit.

Prifti: Se i shenjtë je.

Himni Trishenjtor dhe vazhdon
Liturgjia Hyjnore.

Proqimëni i Apostullit Ting. III

Zoti është ndriçimi im dhe shpëtimtari im.

Varg: Zoti është mbrojtësi i jetës sime. Këndimi i letrës së parë të Pavlit te Korinthianët

(9.19-27)

Vëllezër, edhe pse isha i lirë nga të gjitha, e robërova veten te të gjithë që të fitoj më të shumtët. Edhe u bëra për judenjtë si judeas, që t’i fitoj judenjtë; për ata që janë nën ligj, si nën ligj, që t’i fitoj ata që janë nën ligj; për të paligjët, si i paligj – ndonëse nuk isha i paligj për Perëndi, por i

ligjshëm për Krishtin – që të fitoj të paligj. U bëra për të dobëtit si i dobët, që të fitoj të dobëtit; për të gjithë u bëra gjithçka që me çdo mënyrë të shpëtoj disa. Edhe këtë e bëj për ungjillin, që të bëhem bashkëkungues i tij. Nuk e dini se ata që në stadium vrapojnë, të gjithë vrapojnë, por një e merr çmimin? Kështu vraponi, që të merrni. Edhe kushdo që përpiqet, e përmban veten nga të gjitha; ata pra, që të marrin kurorë të prishshme, ndërsa ne, të paprishshme. Unë pra kështu vrapoj, jo si në paqartësi, kështu bëj mundje, jo sikur rrah erë, por e mendoj trupin tim dhe e edukoj si skllav, mos vallë pasi të predikoj tek të tjerë, unë vetë të bëhem dështues.

Alilua. *Ting. III*

Nxori zemra ime fjalë të mirë.

Varg: I pashëm në bukuri më shumë se bijtë e njerëzve.

Ungjilli sipas Llukait. Dhe Liturgjia e Shën Vasilit që mbetet. Kungatore: Lavdëroni Zotin. Pamë dritën. Para Emri i Zotit bëhet:

SHËRBESA E AJAZMËS SË MADHE

Bëhet gjithmonë pas Liturgjisë së

Vigjiljes.

Menjëherë pas Uratës prapa Amvonit, d.m.th. para ikonës së Krishtit (“O Zot që bekon ata që të bekojnë”), dalim në Kollimvithrën me llambadhe, temjanicë etj.,

duke psalur Idhiomelet:

Ting. Tërth. IV

Të Sofronit, patriarkut të Jerusalemit

Zër’ i Zotit mbi ujërat⁷ thërret duke thënë: Eni të gjithë merrni Shpirt urtësie, Shpirt mençurie, Shpirt frike Perëndie,⁸ të Krishtit që u faneps.*

Sot bekohet natyr’ e ujërave, dhe çahet Jordani dhe qëndron rrjedhjen e valëve të tij, duke parë Zotin të larget.*

Si njeri erdhe në lumë, o mbreti Krisht, dhe nxitohesh të marrësh pagëzim shërbëtori, o i mirë, prej duarve të Pararendësit për mëkatet tona, o njeridashës.*

Lavdi *dhe* Tani

Te zëri i atij që bërtiste në shkretëtirë; Gatitni udhën e Zotit;⁹ erdhe, o Zot, si more fytyrë robi⁴ duke lypur pagëzim, ti që s’njohë mëkatë. Të panë ujërat dhe u trembën¹⁰ bashkë me to dhe Pararendësi, dhe thirri duke thënë: Si do ta ndriçojë dritën kandili? Si do të dorëzojë Zotin shërbëtori? Bekomë mua dhe ujërat, o Shpëtimtar, që ngre mëkatin e botës.^{2*}

Dhe menjëherë Leximet.

Urata e mëposhtme thuhet prej priftit pa zë kur lexohen Leximet e Ajazmës. Nëse ka dhjak, lexohet kur ai thotë Paqësoret.

Urata, vepër e patriarkut Gjermano
O Zot Jisu Krisht, Bir i vetëmlindur, që je në gjirin e Atit,¹¹ Perëndia i vërtetë,¹² burimi i jetës¹³ dhe i pavdekësisë, drita prej dritës, që erdhe në botë ta ndriçosh,¹ shkëlqena mendjen me Shpirtin tënd të Shenjtë dhe pritna duke të ofruar madhështinë dhe falënderimin për veprat e tua të mëdha, të çuditshme që prejete, dhe për ekonominë tënde shpëtimtare që u realizua në shekujt e fundit;¹⁴ në të, duke veshur brumin tonë të pafuqishme dhe të varfër¹⁵ dhe duke bashkëzbritur në masat e robërisë,⁴ ti, mbret i të gjithëve, denjove edhe të pagëzohesh në Jordan nga dorë shërbëtore; që pasi të shenjtërosh natyrën e ujërave, ti i pamëkatshëm, të na hapësh udhën e rilindjes nëpërmjet ujit dhe Shpirtit,¹⁶ dhe të na rivendosësh në lirinë e parë. Duke kremtuar kujtimin e këtij misteri hyjnor, të përgjrohemi, o Zot njeridashës: Spërkat mbi ne shërbëtorët e tu të padenjë, sipas premtimit tënd hyjnor, ujë pastrues,¹⁷ dhuratën e dhemshurisë sate, që të bëhet e mirëpritur prej mirësisë sate kërkesa e ne mëkatarëve, mbi këtë ujë, dhe që nëpërmjet këtij, bekimi yt të na falet neve dhe gjithë popullit tënd besnik, për lavdinë e emrit tënd të shenjtë dhe të adhuruar. Se ty të përket tërë lavdia, nderimi dhe adhurimi, bashkë me Atin tënd pa fillim dhe Shpirtin tënd të Tërë-

shenjtë, të mirë dhe jetëbërës, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Leximet:

Këndimi i profecisë së Isaias

(35.1-10)

Këto thotë Zoti: “Dëfre, o shkretëtirë që ke etje, le të ngazëllohet shkretëtirë, dhe le të lulëzohet si zambak. Do të lulëzohet dhe do të gëzohet me pyllin, dhe do të ngazëllohen të shkretat e Jordanit; dhe lavdia e Libanit ia dha asaj dhe nderi i Karmilit.” Dhe populli im do të soditë lavdinë e Zotit dhe lartësinë e Perëndisë. Forcuhuni, o duar të ligështuara, dhe gjunjë të paralizuara. Ngushëlloni të dekurajuarit në mendje. Forcuhuni dhe mos u frikësoni; ja ku Perëndia ynë shpërblen me gjykim dhe do të shpërblejë, ai do vijë dhe do të na shpëtojë. Atëherë do të hapen sy të verbërish dhe veshë të shurdhërish do të dëgjojnë. Atëherë do të hidhet porsi dre i çali dhe e fuqishme do të jetë gjuhë memecësh, se u ça në shkretëtirë ujë, dhe grykë e thellë në tokën që etet; dhe do të jetë toka e thatë në kënetë dhe në tokën që etet, burim uji do të jetë. Atje do të ketë hare shpendësh, banesë kallami dhe kënetë. Atje do të jetë udhë e pastër dhe udhë e shenjtë do të quhet. Nuk do të kalojë dot atje *ndonjë* i papastër, as do të ketë atje udhë të papastër, ndërsa të shpërngulurit do të ecin mbi të dhe nuk

do të humbasin. Dhe nuk do të ketë atje luan, as *ndonjë* nga bishat e dëmshme nuk do të ngjitet në të, as do të haset atje, por do të ecin në të të çliruar dhe të mbledhur për Zotin. Dhe do të kthehen, dhe do të vijnë në Sion me hare, dhe *do të ketë* gaz të përjetshëm sipër kryes së tyre, sepse mbi kryen e tyre *do të ketë* himnim dhe ngazëllim, dhe hare do t'i pushtojë. U arratis vuajtje, trishtim dhe rënkim.

Këndimi i profecisë së Isaias

(55.1-13)

Këto thotë Zoti: “Ju që po eteni, ecni mbi ujë; dhe sa s’keni argjend, si të ecni blini, dhe hani, dhe pini pa argjend e pa çmim verë dhe të majmë. Pse jepni çmim argjendi atje ku nuk ka bukë dhe mundimin tuaj jo për ngopje? Dëgjomëni mua dhe do të hani të mira, dhe do të shijojë në të mira shpirti juaj. Vini veshin dhe ejani pas udhëve të mia. Dëgjomëni dhe do të rrojë në të mira shpirti juaj. Dhe do t’ju vendos dhiatë të përjetshme, të shenjtat besnike të Davidit. Ja, dëshmi ndër kombet e dhashë atë, *Davidin*, udhëheqës dhe urdhërues ndër kombet. Ja, kombe që nuk të njohin, do të të thërrasin; dhe popuj që nuk të dinë, do të përikin te ti për Zotin, Perëndinë tënd, të shenjtit të Izraelit, se të lavdëroi.” Kërkoni Zotin, dhe duke e gjetur, thirrni. Kur do t’ju

afrohet, le ta braktisë i pabesi udhët e tij dhe burri i paligj, mendimet e tij, dhe le të kthehet drejt Zotit, dhe do të mëshirohet, se do t’i lërë me shumicë mëkatet tuaja. “Se nuk janë mendimet e mia si mendimet tuaja, as udhët e mia si udhët tuaja,” thotë Zoti. “Po sa distancohet qielli prej dheut, aq distancohet udha ime nga udhët tuaja dhe mendimet tuaja nga mendimi im. Se sikundër do të zbresë shiu a dëbora prej qiellit dhe nuk do të kthehet derisa ta dehë dhenë dhe do të lindë, dhe do të mbijë, dhe do t’i japë farë atij që mbjell, dhe bukë për ngrënie; ashtu do të jetë fjala ime që do të dalë prej gojës sime, nuk do të kthehet derisa të kryhen sa desha dhe *derisa* t’i përmbush me sukses udhët e mia dhe porosinë e mia. Se me ngazëllim do të dilni dhe me hare do të mësoni. Se malet dhe bregoret do të kërcejnë duke ju pritur me gaz dhe gjithë drutë e arës do të trokasin me degët. Dhe në vend të dushkut do të ngjitet qiparis dhe në vend të shkozës do të ngjitet mersini, dhe do të jetë Zoti në emër dhe në shenjë të përjetshme dhe nuk do të shterohet.”

Këndimi i profecisë së Isaias

(12.3-6)

Këto thotë Zoti: “Nxirrni ujë me ngazëllim prej burimeve të shpëtimit. Dhe do të thuash në atë ditë: Himnoni Zotin, thirrni emrin e tij, laj-

mëroni ndër kombet të lavdishmet e tij. Himnioni emrin e Zotit, se të larta bëri; i lajmëroni këto të gjithë dheut. Ngazëllohuni dhe dëfrehuni ju që banoni në Sion, se u lartësua i Shenjti i Izraelit në mes të tij.”

*Apostulli:
Proqimeni Ting. III*

Zoti është ndriçimi im dhe shpëtimtari im.

Varg: Zoti është mbrojtës i jetës sime. Këndimi i letrës së parë të Pavlit te Korinthianët

(10.1-4)

Vëllezër, nuk dua të injoroni që etërit tanë të gjithë ishin nën re, edhe të gjithë përmes detit kaluan, edhe të gjithë në Moisi u pagëzuan në re e në det, edhe të gjithë po atë ushqim shpirtëror hëngrën, edhe të gjithë po atë pije shpirtërore pinë; se pinin nga guri shpirtëror që vinte pas; edhe guri ishte Krishti.

Këndimi i Ungjillit të Shenjtë sipas Markut

(1.9-11)

Në atë kohë, erdhi Jisui prej Nazaretit të Galilesë dhe u pagëzua prej Joanit në Jordan. Dhe menjëherë, duke u ngjitur nga uji, pa të çahen qiejt dhe Shpirtin si pëllumb të zbresë mbi të. Dhe zë u bë prej qiejve: Ti je Biri im i dashur, që më pëlqeu.

Dhe menjëherë:

Dhjaku: Me paqe le t'i lutemi Zotit.

- Për paqen që lartazi dhe për shpëtimin e shpirtëve tanë, le t'i lutemi Zotit.

- Për paqen e tërë botës, qëndrimin e mirë të Kishave të shenjta të Perëndisë¹⁸ dhe për bashkimin e të gjithëve, le t'i lutemi Zotit.

- Për këtë shtëpi të shenjtë dhe për ata që hyjnë brenda në të me besë, shpëtimtari dhe frikë Perëndie, le t'i lutemi Zotit.

- Për Kryepiscopin tonë (*aksh*), të nderuarën presviteri dhe dhjakonatën më Krishtin, për tërë klerin dhe popullin, le t'i lutemi Zotit.

- Për Republikën e Shqipërisë, qeverinë, ushtrinë dhe gjithë popullin, le t'i lutemi Zotit.

- Për këtë qytet (*ose manastir të shenjtë, ose vend*), çdo qytet dhe vend, dhe për ata që banojnë ndër to me besë, le t'i lutemi Zotit.

- Për erëra të mira, begati të pemëve të dheut, dhe për kohë me paqe, le t'i lutemi Zotit.

- Për ata që lundrojnë, që udhëtojnë, për të sëmuret, vuajtësit, robërit dhe për shpëtimin e tyre, le t'i lutemi Zotit.

- Që të shenjtërohet ky ujë me fuqinë dhe energjinë, dhe përmbiardhjen e Shpirtit të Shenjtë, le t'i lutemi Zotit.

- Që të zbresë mbi këto ujëra energjia pastruese e Trinisë së përmbiqen-shme, le t'i lutemi Zotit.

- Që t'iu dhurohet hiri i çlirimit, be-

kimi i Jordanit, le t'i lutemi Zotit.

- Që të ndriçohemi me ndriçim njohjeje¹⁹ dhe shpresëtarie me përmbiardhjen e Shpirtit të Shenjtë, le t'i lutemi Zotit.
- Që të bëhet ky ujë dhuratë shenjtërimi, zgjidhës mëkatesh, për shërim shpirti e trupi dhe i përshtatshëm për çdo dobi, le t'i lutemi Zotit.
- Që të bëhet ky, ujë që kërcen për jetë të amshuar,²⁰ le t'i lutemi Zotit.
- Që të tregohet ky zbrapsës i çdo tinëzie armiqsh të dukshëm dhe të padukshëm, le t'i lutemi Zotit.
- Për ata që nxjerrin dhe marrin për bekim shtëpish, le t'i lutemi Zotit.
- Që të bëhet ky, pastrim shpirttrash e trupash për të gjithë ata që nxjerrin besërisht dhe kungohen prej tij, le t'i lutemi Zotit.
- Që të vlerësohemi të mbushemi me shenjtërim përmes kungimit të këtyre ujërave, me shfaqjen e padukshme të Shpirtit të Shenjtë, le t'i lutemi Zotit.
- Që të dëgjojë Zoti Perëndia zërin e përgjërimit²¹ tonë, të ne mëkatarëve, dhe të na mëshirojë, le t'i lutemi Zotit.
- Që të shpëtojmë prej çdo hidhërimi, zemërimi, rreziku dhe nevoje,²² le t'i lutemi Zotit.
- Përkrahna, shpëtona, mëshirona dhe ruajna, o Perëndi, me hirin tënd.
- Të Tërëshenjtën, të pacenuarën, të përmbibekuarën, të lavdëruarën Zonjën tonë Hyjlindëse dhe gj-

thmonë Virgjërën Mari, bashkë me gjithë shenjtoret duke kujtuar, veten tonë dhe njëri-tjetrin, dhe gjithë jetën tonë, Krishtit Perëndisë le t'ia parashtrijmë.

Meqenëse dhjaku i ka plotësuar tashmë Paqësoret, prifti fillon me zë të lartë Uratën, për ta dëgjuar i gjithë populli.

Urata, vepër e Sofronit, patriarkut të Jerusalemit

[por sot, më 5 janar; nuk thuhet pjesë e parë e Urates që vijon, pra prifti filon nga: "I madh je, o Zot, dhe të

çuditshme." Urata e plotë thuhet nesër].

O Trini e përmbiqenshme, e përmbimirë, e përmbiperëndishme, e tërëfuqishme, tërëgjithëshikuese, e padukshme, e pakuptueshme, krijuese e esencave mendore dhe e natyrave të arsyeshme, mirësia nga natyra, dritë e paafrueshme,²³ që ndriçon çdo njeri që vjen në botë,¹ ndrit dhe te mua shërbëtori yt i pavyer, ndriçomi sytë e mendjes, që të guxoj të përhimnoj mirëbërjen dhe fuqinë e pamatur. Le të bëhet i mirëpritur përgjërimit im për popullin që ndodhet pranë; që të mos ndalojnë fajet e mia të mbërrijë këtu Shpirti yt i Shenjtë; po lejomë pa dënim të të thërres e të them dhe tani, o i përmbimirë: Të lavdërojmë, o Zot njeridashës i tërëfuqishëm, mbret i parajetshëm; të lavdërojmë ty, ndërtuesin dhe krijuesin e Gjithësisë; të lavdërojmë

ty, Bir i vetëmlindur i Perëndisë,¹¹ pa atë prej nëne, dhe pa nënë prej Ati; se në të kremten e mëparshme të pamë foshnjë,²⁴ ndërsa në të tanishmen, të shohim të përsosur ty, Perëndinë tonë, që u fanepse,²⁵ i përsosur prej të përsosuri. Sepse sot na erdhi koha e së kremtes, dhe kor shenjtorësh kishëron me ne, dhe engjëj kremtojnë bashkë me njerëz. Sot Hiri i Shpirtit të Shenjtë, në formë pëllumbi, erdhi përmbi ujërat. Sot Dielli i paperëndueshëm lindi dhe bota ndriçohet me dritën e Zotit. Sot hëna feks bashkë me botën me rreze të shkëlqyera. Sot yjet dritëpamëse me hijeshinë e shkëlqimit zbukurojnë botën. Sot retë i vesojnë njerëzimit shi drejtësie prej qiellit.²⁶ Sot i pandërtuari dorëzohet duke dashur prej krijesës së vet. Sot Profeti dhe Pararendësi i vjen Zotit, por qëndron pranë me tmerr, duke parë bashkëzbritjen e Perëndisë drejt nesh. Sot rrjedhat e Jordanit në shërime kthehen me praninë e Zotit. Sot me rrëke mistike gjithë Krijesa vaditet. Sot fajet e njerëzve me ujërat e Jordanit shuhen. Sot Parajsa u çel për njerëzit, dhe Dielli i drejtësisë²⁷ llamburit për ne. Sot uji i hidhur i kohës së Moisiut, kthehet në ëmbëlsi për popullin²⁸ me praninë e Zotit. Sot u shkarkuam nga vajtimi i vjetër²⁹ dhe si Izrael i ri shpëtuam. Sot prej errësirës u çliruam dhe me dritën e hyjdijes ndriçohemi.

Sot mjegulla e botës pastrohet me shfaqjen e Perëndisë tonë.²⁵ Sot ndrit si llambë e gjithë Krijesa nga lart. Sot mashtrimi u asgjësua dhe ardhja e Zotit na bën udhë shpëtimi. Sot të sipërmet kremtojnë bashkë me të poshtmet, dhe të poshtmet kuvendojnë me të sipërmet. Sot panairi i shenjtë dhe zëmadh i orthodoksëve ngazëllohet. Sot Zoti te pagëzimi nxiton, që ta ngrëjë drejt lartësisë njerëzimit. Sot i papërkuluri shërbëtorit të tij i përkulet, që prej robërisë të na çlirojë. Sot mbretëri qiejsh fituam, sepse mbretëria e Zotit nuk do të ketë mbarim.³⁰ Sot dhé dhe det ndanë gazin e botës, dhe bota me hare është mbushur. Të panë ujëra, o Perëndi, të panë ujëra dhe u frikësuan.¹⁰ Jordani u kthye mbrapa³¹ kur pa zjarrin e Hyjnisë të zbresë trupërisht³² dhe të hyjë në të. Jordani u kthye mbrapa³¹ duke parë Shpirtin e Shenjtë në formë pëllumbi të zbresë dhe të fluturojë rreth teje. Jordani u kthye mbrapa³¹ duke parë të padukurin të dukur, ndërtuesin të mishëruar, Zotin me pamje robi.⁴ Jordani u kthye mbrapa³¹ dhe malet kërcyen³³ duke parë Perëndinë në mish;²⁵ dhe retë dhanë zë³⁴ duke admiruar të mbërriturin, dritë prej drite, Perëndi të vërtetë prej Perëndie të vërtetë, duke parë panairin zotëror sot në Jordan; dhe se zhyti në Jordan vetë vdekjen e mosbindjes²⁹ dhe gjembin e mashtrimit, dhe li-

dhjen e Hadhit, dhe se i dhuroi botës pagëzim shpëtimi. Prandaj dhe unë shërbëtori yt mëkatar dhe i pavyer, duke rrëfyer madhësitë e çudive të tua,³⁵ i shtrënguar nga frika, të thërres zemërdërrmuar:

Dhe me zë më të lartë:

I madh je, o Zot, dhe të çuditshme janë veprat e tua,³⁶ dhe asnjë fjalë nuk do të mjaftojë për himnin e çudive të tua (3x). [*Kori në çdo herë thotë: Lavdi më ty, o Perëndia ynë, lavdi më ty*]. Se ti, duke dashur, si bërë të gjitha nga mosqenia në të qenët,³⁷ e përmban Krijesën me pushtetin tënd, dhe me providencën tënde qeveris botën. Ti, kur e plekse Krijesën prej katër elementesh, e kurorëzove qarkun e motit³⁸ me katër stinë. Përpara teje dridhen të gjitha fuqitë mendore; ty të himnon diell, ty të lavdëron hënë, ty të luten yjet,³⁹ ty të bindet drita, ty të kanë frikën avusha, ty të shërbejnë burimet. Ti e ndeve qiellin pors i lëkurë,⁴⁰ ti e stabilizove dhenë mbi ujërat,⁴¹ ti vure rërën si mur rreth detit,⁴² ti derdhe erën për të marrë frymë, ty të meshojnë fuqitë engjëjlore, koret e kryeengjëjve ty të falen; Keruvimet me shumë sy⁴³ dhe Serafimet me gjashtë krahë, duke qëndruar rreth e përçark e duke fluturuar rrotull, mbulohen plotësisht nga frika e lavdisë sate te paafruar.⁴⁴ Se ti, duke qenë Perëndi i papërshkruar, pa nisje dhe i pashprehshëm, er-

dhe mbi dhë pasi more pamje robi dhe pasi u bërë në ngjashmëri njerëzish;⁴ se nuk duroje, o Zot, nga zemërdhembshuria jote,⁴⁵ të shikoje gjindjen e njerëzve të tiranizohej prej djallit, por erdhe dhe na shpëtove. E rrëfejmë hirin, e shpallim mëshirën, nuk e fshehim mirëbërjen. I çlirove brezat e natyrës sonë, shenjtërove mitër virgjërore me lindjen tënde. Tërë Krijesa të himnoi kur u fanepse. Se ti, Perëndia ynë, mbi dhë u pe²⁵ dhe me njerëzit u shoqërove;⁴⁶ ti dhe rrjedhat e Jordanit i shenjtërove, duke u dërguar poshtë prej qiellit Shpirtin tënd të Tërëshenjtë, dhe krerët e dragonjve që kishin bërë fole atje i dërrmove.⁵

Ti pra, o Mbret njeridashës, ji i pranishëm dhe tani me përmbi-ardhjen e Shpirtit tënd të Shenjtë dhe shenjtëroje këtë ujë (3x) [*Kori në çdo herë thotë: Amin. Ndërkohë prifti bekon ujin*]. Dhe jepi hirin e çlirimit, bekimin e Jordanit; bëje burim paprishjeje, dhuratë shenjtërimi, zgjidhje mëkatesh, largim sëmundjesh, shkatërrim demonësh, të paafruar për fuqitë kundërshtarë, të mbushur me fuqi engjëjlore, që të gjithë sa nxjerrin dhe kungohen, ta kenë për pastrim shpirtrash dhe trupash, për shërim pësimesh, për bekim shtëpish dhe të përshtatshëm për çdo dobi. Se ti je Perëndia ynë, që me anë uji dhe Shpirti¹⁶ përtërite natyrën tonë të vjetëruar prej më-

katit. Ti je Perëndia ynë, që me anë uji mbyte mëkatin në kohën e Noes.⁴⁷ Ti je Perëndia ynë, që nëpërmjet detit çlirove prej robërisë së Faraonit, me anën e Moisiut, gjindjen hebraike.⁴⁸ Ti je Perëndia ynë, që çave gurin në shkretëtirë, dhe rrodhën ujëra, dhe përmbytën përrenj dhe popullin tënd që etej e nginje.⁴⁹ Ti je Perëndia ynë, që me ujë dhe me zjarr, me anën e Ilias, shkarkove Izraelin nga mashtrimi i Baalit.⁵⁰

Ti dhe tani, o Zot, shenjtëro këtë ujë me Shpirtin tënd të Shenjtë (3x). *[Kori në çdo herë: Amin. Ndërkohë prifti bekon ujin]*. Jepu të gjithëve sa prekin, sa lyhen e kungojnë, shenjtërimin, bekimin, pastrimin dhe shëndetin. Dhe shpëto, o Zot, shërbëtorët e tu, të parët tanë. Ruaji nën hijen tënde me paqe; nënshtro nën këmbët e tyre çdo armik dhe kundërshtar; falju gjithë kërkesat e tyre për shpëtim dhe jetë të amshuar. Kujto, o Zot, kryepiskopin tonë *(aksh)* dhe gjithë presviterinë dhe dhjakonatën më Krishtin, dhe çdo rreshtim priftëror, dhe popullin që rri rrotull, dhe vëllezërit tanë që mungojnë për shkaqe të arsyeshme, dhe mëshiroi ata dhe ne sipas mëshirës sate të madhe; që dhe me elemente, dhe me engjëj, dhe me njerëz, dhe me të dukshme e të padukshme, të lavdërohet emri yt i tërëshenjtë bashkë me Atin e me Shpirtin e Shenjtë, tani e përherë e në jetë të

jetëve. Amin.

Prifti: Paqe në të gjithë

Kori: Dhe në shpirtin tënd.

Dhjaku: Kryet tanë le t'ia ulim Zotit.

Kori: Ty, o Zot.

Dhe priftit thotë këtë Uratë pa zë:

Përkul, o Zot, veshin tënd^{50a} dhe dëgjona, ti që në Jordan denjove të pagëzohesh dhe shenjtërove ujërat; dhe bekona të gjithë ne, që me anën e uljes së qafave tona, tregojmë shenjen e robërisë; dhe bëna të denjë të mbushemi me shenjtërimin tënd me anën e marrjes dhe të spërkatjes së këtij uji; dhe na u bëftë, o Zot, për shëndet shpirti dhe trupi.

Dhe me zë të lartë:

Se ti je shenjtërimi i shpirtave dhe i trupave tanë, dhe ty ta drejtojmë lavdinë, falënderimin dhe faljen, bashkë me Atin tënd të pafillim dhe Shpirtin tënd të Tërëshenjtë, të mirë dhe jetëbërës, tani e përherë e në jetë të jetëve.

Kori: Amin.

Dhe menjëherë prifti duke bekuar ujërat në formë kryqi, zhyt kryqin e çmuar, duke e zbritur dhe ngritur drejt, dhe duke psalur:

Ting. I

Në Jordan kur pagëzohesh, o Zot, falja e Trinis' u shfaq; se zëri i prindit të dëshmonte Bir të tij të dashur duke të quajtur; edhe Shpirti në formë pëllumbi e siguronte vërtetësinë e fjalës. O Krisht Perëndi,

që u fanepse²⁵ dhe ndriçove botën, lavdi më ty.*

(3x)

Dhe spërkat gjithë popullin me ujë duke psalur:

Kontaqi

Ting. IV Epefanis símeron

U fanepse me lavdi* në tërë botën,* edhe drita jote sot,* na u shënuar me çudi,*⁵¹ pra të himnojmë ne me kuptim:* Erdhe u duke, o drit' e paafrueshme.^{23*}

Të krishterët duke ardhur dhe duke puthur kryqin e çmuar spërkatën prej priftit, ndërkohë psalet:

Idhiomeli Ting. Tërth. II

Le të himnojmë, o besnikë, përmasat e ekonomisë së Perëndisë për ne, se për shkak të rënies sonë, duke u bërë njeri, pastrohet me pashtrimin tonë në Jordan, ai që është i vetmi i pastër dhe i pacenuar, duke më shenjtëruar mua dhe ujërat, dhe kokat e dragonjve duke i thyer mbi ujë;⁵ le të nxjerrim pra ujë, me ngazëllim,⁵² o vëllezër; se hiri i Shpirtit, atyre që nxjerrin besërisht, u jepet padukurisht nga Krishti Perëndi, dhe Shpëtimtari i shpirtave tanë.

Pas kësaj: Emri i Zotit. Le t'i lutemi Zotit. Bekimi dhe mëshira e Zotit.

Dhe Përlëshim. Ai që denjoi të pagëzohet prej Joanit në Jordan për shpëtimin tonë, Krishti Perëndia ynë

i vërtetë... Me uratat.

[Nëpër manastire para Me uratat e etërve tanë, lexohet edhe:

Psalmi 33

Do të bekoj Zotin në çdo kohë, përgjithmonë do të jetë lavdërimi i tij në gojën time. Në Zotin do të lavdërohet shpirti im. Le të dëgjojnë të butë dhe le të dëfrehen. Madhëroni Zotin bashkë me mua dhe le të lartësojmë emrin e tij së bashku. E kërkova shumë Zotin dhe më dëgjoi, dhe nga të gjitha shtrëngimet më çliroi. Afrohuni tek ai dhe ndriçohuni, dhe fytyrat tuaja nuk do të turpërohen dot. Ky i varfër thirri dhe Zoti e dëgjoi, dhe nga të gjitha shtrëngimet e tij e shpëtoi. Do të fushojë engjëll Zoti rreth atyre që ia kanë frikën dhe do t'i çlirojë. Shijoni dhe shihni se është i mirë Zoti; i lumur ai burrë që shpreson tek ai. Kini frikë Zotin gjithë shenjtorët e tij, sepse nuk ka privim tek ata që e kanë frikë. Të pasurit u varfëruan dhe u urituan, por ata që kërkojnë Zotin nuk do të pakësohen nga çdo e mirë. Ejani, o bij, dëgjomëni, frikë Zoti do t'ju mësoj. Kush është njeriu që do jetë, që do të shikojë ditë të mira? Ndale gjuhën tënde nga e keqja dhe buzët e tua që të të mos flasin dinakëri. Shmangu nga e keqja dhe bëj të mirë, kërko paqe dhe ndiqe atë. Sytë e Zotit janë mbi të drejtë dhe veshët e tu në lutjen e tyre. Dhe fytyra e Zotit është mbi ata

që bëjnë të këqija, që të shfarosë prej dheut kujtimin e tyre. Thirrën të drejtët dhe Zoti i dëgjoi, dhe nga të gjitha shtrëngimet e tyre i çliroi. Zoti është afër të thyerve në zemër dhe të përlulurit në shpirt do t'i shpëtojë. Të shumta janë shtrëngimet e të drejtëve, dhe nga të gjitha këto do t'i çlirojë Zoti; ruan Zoti gjithë eshtrat e tyre, asnjë prej tyre nuk do të dërrmohet. Vdekje mëkatarësh është e keqe dhe ata që urrejnë të drejtin do të fajtojnë. Do të çlirojë Zoti shpirtrat e shërbëtorëve të tij dhe nuk do të fajtojnë të gjithë që shpresojnë në të.

Me uratat.]

[Shërbesa e Bekimit të Ujërave, d.m.th. hedhja e Kryqit në det etj., bëhet ditën e nesërme. Shih pas Liturgjisë së ditës së nesërme fq. 120].



NË MËNGJES

*Në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmi 50
[vazhdon Shërbesa e Mbrëmësorës, që
mbeti nga dje, pra:]*

Në Liti Idhiomele

Ting. IV I Kozma Monakut

Ai që vesh dritë si rrobë⁴⁰ denjoi të bëhet për ne si ne. Rrëke jordaniane sot vesh, duke mos pasur nevojë ai vetë për to për pastrim, por duke e rregulluar në veten e tij rilindjen për hirin tonë. O çudi! Pa zjarr rishkrin,

dhe rigatuan pa dërrmim, dhe i shpëton ata që ndriçohen në të, Krishti Perëndia dhe Shpëtimtari i shpirtrave tanë.

I njëjti

Ti që në Shpirt dhe në zjarr pastron⁵³ mëkatin e botës, duke të parë Pagëzori të vish drejt tij, i frikësuar dhe i trembur, thërriste duke thënë: Nuk guxoj të mbaj kokën tënde të pacenuar; ti më shenjtëro me epifaninë tënde, o Zot, i vetëm njeri-dashës.

I njëjti

Ejani t'i imitojmë virgjëreshat e mençura; ejani ta mirëpresim Zotin që u duk, se doli si dhëndër⁵⁴ drejt Joanit. Jordani sapo të pa u frikësua dhe mbeti.³¹ Joani thërriste: "Nuk guxoj të mbaj kokë të pavdekshme." Shpirti zbriste në formë pëllumbi që t'i shenjtërojë ujërat; dhe u dëgjua një zë nga qielli: "Ky është Biri im, që erdhi në botë, që ta shpëtojë gjininë e njerëzve." O Zot, lavdi më ty.

I njëjti

Pagëzohet Krishti dhe ngrihet nga uji, sepse ngre bashkë me veten e tij botën; dhe shikon qiejt të çahen, të cilët Adami i mbylli për veten e tij dhe për të mëpasshmit e tij; dhe Shpirti dëshmon për Hyjninë, sepse vrapon pranë të njëjtës; dhe zë nga qielli u dëgjua, se nga atje është ai

që dëshmohej, Shpëtimtari i shpirtave tanë.

I njëjti

Dridhej dora e Pagëzorit kur preku kokën e pacenuar. U kthye lumi Jordan mbrapa,³¹ duke mos guxuar të të shërbejë; sepse atij që i erdhi turp nga Jisui i Naviut,⁵⁵ si do të ishte e mundur të mos frikësohej nga Bërësi i tij? E përmbushe të gjithë ekonominë, o Shpëtimtari ynë, që ta shpëtosh botën me Epifaninë tënde, o i vetëm njeridashës.

[Nëse Liturgjia e Shën Vasilin u krye dje, atëherë edhe Pasvargjet që vijnë më pas konsiderohen si pjesa e Litisë, pra tani nuk thuhet Lavdi në Idhiomelin që vijon menjëherë, as Tani në Idhiomelin që vijon më pas, as Vargjet e Pasvargjeve Deti pa; Ç'është me ty].

Lavdi

Ting. Tërth. IV I Joan Monakut

O Zot, duke dashur të përmbushësh ato që përcaktove që prej jete, nga e gjithë Krijesa more shërbyesit e misterit tënd: nga engjëjt, Gabrielin,⁵⁶ nga njerëzit, Virgjëreshën; nga qiejt, yllin;⁵⁷ dhe nga ujërat, Jordanin; në të shleve paudhësinë e botës, o Shpëtimtari ynë, lavdi më ty.

Tani

I njëjti I Anatoliut

Sot Krijesa ndriçohet; sot të gjitha

dëfrejnë, qielloret njëkohësisht bashkë me tokësoret.⁵⁸ Engjëj dhe njerëz përzihen, sepse atje ku ka prani mbreti, është i pranishëm edhe rendi. Le të rendim pra për në Jordan, le ta shohim të gjithë Joanin si pagëzon krye të pabërë nga dora dhe të pamëkatshme; ndaj duke kënduar me zë apostolik, le të thërrasim njëzëri: U shfaq Hiri i Perëndisë, Hiri shpëtimtar për gjithë njerëzit,⁵⁹ duke feksur dhe duke u dhënë besimtarëve përdëllimin e madh.

Pasvargje

Ting. II I Anatoliut

Kur të pa Joani te lumi Jordan të vish tek ai, thoshte: O Krisht Perëndi, përse erdhe te shërbëtori, o Zot, pa patur njollë? Dhe në emrin e kujt të të pagëzoj? të Atit? Po atë e ke me vete; të Birit? Po ai je vetë me trup; të Shpirtit Shenjt'? Po këtë vetë di t'ua japësh besnikëve me gojë,⁶⁰ o Perëndi që u fanepse,²⁵ mëshirona.*

Varg: Deti pa dhe iku, Jordani u kthye mbrapa.

Të panë ujërat, o Perëndi, të panë ujërat dhe u frikësuan,¹⁰ se lavdinë tënde nuk mundin ta shikojnë me sy as Keruvimet, as Serafimet,⁴⁴ por rrinë me⁶¹ frikë dhe lavdërojnë fuqinë tënde;⁶² me të cilët, o mëshirëplot lajmërojmë lavdërimin tënd duke thënë: O Perëndi që u fanepse,²⁵ mëshirona.*

Varg: Ç'është me ty, o det, që ike, dhe ti, o Jordan, që u ktheve mbrapa?

Sot Krijuesi i qiellit e i dheut vjen me trup në Jordan duke lypur pagëzim i pamëkatëshmi që ta pastrojë botën nga gënjeshtria e armikut, dhe pagëzohet Zot i Gjithësisë prej një robi dhe i fal gjindjes njerëzore pastrim me anë uji; atij le t'i thërresim: O Perëndia ynë që u fanepse,²⁵ lavdi më ty.*

Lavdi dhe Tani

Ting. Tërth. II I Theofanit

Diellin prej Virgjëreshës duke shikuar kandil i ndritshëm⁶³ prej beronje⁶⁴ të lypë pagëzim në Jordan, me frikë dhe me gaz i thërriste: Ti bekomë, o Zot, me Epifaninë tënde të hyjëshme.*

[Nëse Mbrëmësorja kryhet pa Liturgjinë e Shën Vasilit, ajo kryhet si zakonisht dhe jo e ndarë në dy pjesë; (shih fq. 68) pas Tani përlëshoje shërbetorin tënd, lexohet Kanuni që është në Pasdarkë pas Mbrëmësorës së 5 të muajit: Kímati thalasis (shih fq. 49). Pastaj Trishenjtí, Përlëshorja edhe Përlëshimi].

Trishenjtí dhe Përlëshorja tri herë. (Por në Shërbesën e Mesnatës thuhet vetëm një herë.)

Përlëshore Ting. I

Në Jordan kur pagëzohesh, o Zot, falja e Trinis' u shfaq; se zëri i prindit të dëshmonte Bir të tij të dashur

duke të quajtur; edhe Shpirti në formë pëllumbi e siguronte vërtësinë e fjalës. O Krisht Perëndi, që u fanepse²⁵ dhe ndriçove botën, lavdi më ty.*

(3x)



NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë,
Ndenjësores*

Ting. III Tin oreótita

Kur ti, o Shpëtimtar,* u shfaqe në Jordan,* u pagëzove, Krisht,* prej Pararendësit* dhe Bir i dashur u dëshmove, si i bashkëpanisshëm* tok me Atin qartazi* u zbulove; dhe Shpirti Shenjt* zbriti mbi ty; në këtë* u ndriçua; thërresim pra:* Lavdi, nder Perëndisë që është* tri hipostaza në Triadhë.

Lavdi dhe Tani

I njëjti

*Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësores
Ting. IV Kateplaji Iosíf*

Pse habitesh kur shikon,* ti o Jordan? Thotë se sheh* Zotin zhveshur, druhem fort* nga i padukuri gjithnjë.* Si ish e mundur të mos kisha unë frikë* edhe të mos zhytesha! Kishin frik'* engjëjt kur e pan', qielli u shtang,*⁶⁵ u tremb dhe dheu, detet fort u drodhën,* gjithë sa duken dhe

sa s'duken.* U shfaq pra Krishti* të shenjtërojë* në Jordan për ne ujin.

Lavdi *dhe* Tani
I njëjti

*Pas Polieleit, Ndenjësove
Ting. IV Tahí prokatálave*

O Krisht Perëndia ynë, shenjtërove në lum'* rrëket' e Jordanit dhe dërmive forcën e fajit kur e përkule ti* veten poshtë pëllëmbës* së Joan Pagëzorit,* gjindjen e njerëzisë e shpëtove nga rrengu;* shpëtoje pra botën tënde, të përgjërhem.

Lavdi *dhe* Tani
I njëjti

*Shkallesat. Antifoni i parë i Ting. IV
Proqimeni Ting. IV*

Deti pa dhe iku, Jordani u kthye mbrapa.

Varg: Ç'është me ty, o det, që ike, dhe ti, o Jordan, që u ktheve mbrapa?

Ungjilli. Psalmi 50.

Lavdi *Ting. II*

Të gjitha sot le të ngazëllohen, se Krishti u faneps në Jordan.*

Tani *I njëjti*

Përdëllemë, o Perëndi. *Dhe Idhiomeli.*

Ting. Tërth. II I Theofanit

Fjala Perëndi u shfaq me trup²⁵ te gjindja e njerëzve. Qëndroi të pagëzohet në Jordan dhe Pararendësi

i thoshte: Si të ndej dorën dhe të prek kryet që mban Gjithësinë?⁶⁶ Megjithëqë je lindur si foshnjë prej Marisë, po unë të di Perëndi të parajetëshëm; ecën mbi dhé ti që himnohesh prej Serafimeve;⁴⁴ dhe unë robi, nuk kam mësuar të pagëzoj Zotin. O Zot i pakuptueshëm, lavdi më ty.*

Kanunet

Ode I

*Kanuni i zotit Kozma, që ka Akrostihidhë:
"Pagëzim: Pastrim të dhëlindurish nga mëkati".*

Ting. II

Irmosi: Vithú anekálipse pithmena

»**E**teri, e thau fare detin* dhe nëpër »steré të tijt' i shpuri,* dhe me valët »i përmyti kundërshtarët Zoti⁴⁸ i »madh,* i fuqishm' i lufteve, nder »dhe lavdi më ty.*

Adamin e prishur rigatuan* nëpërmjet rrëkeve të Jordanit,* kokat e dragonjve që atje fole kishin, i dërrmon*⁵ Zoti, mbret i jetëve,⁶⁷ se u lëvdua fort.

Iveshur me mish lëndor që mban zjarr* jolëndor Hyjnie Zoti, Krishti* që u mishërua prej një virgjëreshe dhe në Jordan* me rrëketë vishet krejt, se u lëvdua fort.

Ai që fsheh ndotjen e njeriut,* për

të në Jordan ky u pastrua,* pasi ngjau duke dashur me të,⁴ dhe pse mbeti siç ish,* shndrit të errësuarit,⁶ Zoti me plot lavdi.

Kanuni tjetër jambik i Joan Damaskinoit, që ka Akrostihidhë të brendshme me vargje heroelegjike: "Biri i mirë i tërëmbretit sot, si e dogji mëkatin, e varros në rrjedhje, pasi e goditi me pishtar të pacenuar; të hyjndritshëm Shpirti; ndërsa hir u jep himnuesve të melodive mirëdashëse."

Ting. II

Irmosi: Stivi thalasis

»**S**hkoj nëpër detin më këmbë Izraeli
»edhe në bregun arriti i palagur, po
»kalorësinë armike egjiptiane Zoti
»e përmbysi në një varr prej valësh⁴⁸
»me çudi dhe tmerr, me të djathtën
»e fortë.^{68*}

Kur prej shkretisë* në rrëket' e Jordanit* erdhi agimi* dritëprurës për botën,* o mbret i qiellit, qafën e perkule* që paraatin ta rrëmbesh ti nga terri*⁶⁹ dhe që ta pastros* nga çdo njollë Krijesën.

Fjalë pa nisje,* qenien që faji prishi*⁷⁰ sot e varrose* tok me veten në rrjedha,*⁷¹ e rinovove dhe e kalon përtej kur* prite nga Ati zë të fortë pashprehshëm:* Ka të barabart'* Biri qenien me mua.

Zbritësore: Vithú anekálipse pithmena

dhe Stivi thalasis

Eteri, e thau

dhe

Shkoj nëpër detin

Ode III

Irmosi: Iskín o dhidhús

»**A**i që u jep fuqi besnikëve dhe mbre-
»tërve* dhe ballin e tyre lartëson,*⁷²
»ka lindur prej Hyjlindëses, dhe vjen
»për pagëzim tani, pra ejani dhe
»thirrini:* Si ty, o Perëndi, s'ka tjetër
»shenjt askund* dhe veç teje nuk ka
»asnjë të drejtë, Zot.⁷³

O Kisha e Krishtit, ishe shterpë përpara mjerisht*^{73a} dhe s'kishe fëmijë, sot dëfre,* se lindën për ty bij me ujë dhe me Shpirt¹⁶ edhe thërrasin me besim, me zë të madh:* Si ty, o Perëndi, s'ka tjetër shenjt askund* dhe veç teje nuk ka asnjë të drejtë, Zot.⁷³

Thërret Pararendësi me zë të madh nëpër shkreti:* Për Krishtin dhe Perëndinë ju* e bëni gati udhën edhe shtroni rrugë në të sheshta,⁹ duke thirrur me besim:* Si ty, o Perëndi, s'ka tjetër shenjt askund* dhe veç teje nuk ka asnjë të drejtë, Zot.⁷³

Kanuni jambik

Irmosi: Osi paleón

»**N**e që shpëtuam nga leqet e ar-
»mikut dhe nga thonj luanësh t'egër
»të tërbuar, le ta çelim gojën⁷⁴ dhe
»le të këndojmë fjalë melodie, këngë

»lavdërimi, se na dha shpëtim Zoti i
»pakursyer.*

Djalli që u shfaq* porsì bishë e egër* qëmoti, dhe mbolli vdekjen në Krijesë,* që ta dërmojë* vetë kokën e kobshme,*²⁹ kundër Zotit ky sulmon, i cili erdhi* si agim,⁷⁵ me mish;* humbi kështu satani.

Zoti e tërheq* tër' natyrën që bëri,*⁶⁰ që ishte mbyllur në burg,⁶⁹ në bark tirani,* sërish e rilind ky * nëpërmjet rigatimit* njerëzor. E madhe vepra! Se ka ardhur* ta shpëtojë krejt* nga leqet e armikut.

Zbritësore: Iskín o dhidhús dhe Osi paleón

Ai që u jep
dhe

Ne që shpëtuam

Ipakoia

Kur me anën e Epifanisë sate e ndriçove Gjithësinë, atëherë deti i kripur i pabesisë iku⁵⁵ dhe Jordani që rridhte poshtë u kthye³¹ duke na lartësuar drejt qiellit; prandaj përmes lartësisë së porosive të tua hyjnore, ruajna, o Krisht Perëndi, me ndërmjetimet e Perëndilindëses dhe mëshirona.

Ode IV

Irmosi: Akíkoe Kírie fonís

»**D**ëgjoj zërin tënd, o Zot, Joan
»Pagëzori,* që po thërret nëpër

»shkretëtirë,*⁹ se ti gjëmove përmbi
»ujërat⁷⁶ e shumta dhe e* deklarove
»Birin tënd;* pra me Shpirtin Shenjt'
»frymëzohet plotësisht dhe të thë-
»rret:* O urtësi e Perëndisë,⁷⁷ o Zoti
»Krisht.*

Predikuesi thërret: Kush pa diell të shndritshëm prej natyre të pastrohet, që unë të të laj me ujëra ty, vezullim lavdie, karakter Ati⁷⁸ të përhershëm, dhe ndonëse jam kashtë, ta prek Hyjninë tënde me zjarr? Se ti je Krishti, urtësi dhe fuqi Perëndie.⁷⁷

Kur Moisiu të hasi, e shfaqti disi shpresëtarinë e perëndishme që kishte, sepse sapo të ndjeu ty të thërrasësh nga ferra, menjëherë e ktheu faqen;⁷⁹ dhe unë si do të të shoh haptas, a si do të vë dorën mbi ty? Se ti je Krishti, urtësi dhe fuqi Perëndie.⁷⁷

Duke zotëruar shpirt mendor dhe i nderuar me logjikë, druham nga të pafrymë, sepse në qoftë se do të të pagëzoj, do të më jetë akuzues mal që nxirrte tym nga zjarri,⁸⁰ det që iku në dy drejtime⁴⁸ dhe ky Jordan që u kthye,³¹ se ti je Krishti, urtësi dhe fuqi Perëndie.⁷⁷

Kanuni jambik

Irmosi: Pirsó katharthís

»**I** paqësuar prej një zëri të shenjtë
»këndon profeti për lindjen njerëzore,

»dhe i frymëzuar po lëçit me bujë Fjalën e panisshme që u mishërua dhe »dërrmoj përdhé fuqinë e armiqve.^{81*}

Meqenëse, o Fjala e tërëndritshme e Atit,⁸² u dërgove, erdhe që të shkatërrosh që nga rrënja marrëdhënien e keqe e të natshme, dhe mëkate njerëzish, si dhe të heqësh nga rrjedhje Jordani me anën e pagëzimit tënd, bij të ndritshëm, o i lumur.

Kur e vështroi vetë Fjalën e tërëlavdëruar predikuesi, i thërret Krijesës fuqishëm: Ky, edhe pse është para meje, por i dyti sipas mishit,⁸³ shkëlqeu me pushtet hyjnor në të njëjtën formë, që të heqë mëkatin tonë tejet armiqësor.

Duke na sjellë drejt kullotjeje jetëpurëse, Fjala Perëndi na rrëmben si gjueti teksa vrapon kundër fole dragonjsh. Si fitoi mbi shumë leqe dhe me thembër mbi atë që e godet krejtësisht gjininë,⁵ duke e lidhur me pranga, shpëton Krijesën.

Zbritësore: Akikoe Kírie fonís dhe Pirsó katharthís

Dëgjo zërin

dhe

I paqësuar prej zëri

Ode V

Irmosi: Iisús o zoís arhigós

»**K**ryetari i jetës Jisuj⁸⁴ vjen ta lajë

»fajin e Adamit të parëtreguar.²⁹
»Ndonëse ishte Perëndi dhe ndonëse »s'kishte nevojë kurr' për pastrim, »pagëzohet në Jordan për mëkatet tona. Kështu me ne pajtohet⁸⁵ dhe na fali paqen që kapërcen çdo mendje.^{86*}

Kur u mblodhën popuj pa kufi të pagëzoheshin nga Joani, ai qëndroi në mes dhe u thërriste të pranishmëve: O të pabindur, kush ju tregoi që t'i shmangeni zemërimin të ardhshëm? Bëni fryte të denja⁸⁷ për Krishtin, sepse duke qenë ai tani i pranishëm, dhuron paqe.⁸⁸

Bujku dhe Bërësi duke qëndruar në mes⁸⁹ si një nga të gjithë, pushton zemra dhe duke përdorur lopatë pastruese ndan tërëurtësisht lëmin⁵³ mbarëbotëror, duke djegur pafrytshmërinë dhe duke dhuruar jetë të përjetshme tek ata që bëjnë fryte të mira.

Kanuni jambik

Irmosi: Ehthru zofodhus

»**S**hpirt' i Shenjtë na ka larë prej çdo »helmi të armikut t' errët edhe të pa- »besë, dhe na ka drejtuar n' udhën e »vërtetë, që na shpie në dëfrim të pa- »afruar, q' e fitojn' ata që ka pajtuar »Zoti.^{85*}

Duke parë Bërësi atë që e rregullon me gishtërinj⁶⁰ të jetë në errësirën

e fajeve me pranga të pashmangshëm,⁹⁰ e rimëkëmb, pasi e ngriti lart rreth supeve; dhe tani në furtuna me shumë rrjedhje e lan nga turpi i vjetër i dobësisë së Adamit.²⁹

Me shpresëtari le të vrapojmë fuqishëm te burimet e pacenuara të rrjedhjes shpëtimtare, që të sodisim Fjalë nga një e pacenuar, të ofrojë ujë të nxjerrë nga pusi për etje të perëndishme⁹¹ dhe të shërojë me butësi sëmundje bote.

Zbritësore: Iisús o zoís arhigós dhe

Ehthru zofodhus

Kryetari i jetës

dhe

Shpirit' i Shenjtë

Ode VI

Irmosi: I foní tu Logu

»Lajmëtar' i Fjalës, kandil i dritës⁶³
»që na sjell agimin, del përpara diellit
»në shkretëtirë dhe i fton të gjithë të
»pendohen⁹² dhe të pagëzohen, se
»ja ku vjen⁸⁹ Zoti Jisu, që ta shpëtojë
»botën prej mëkateve.*

Pasi lindi pa far' prej Atit Perëndisë, lind pa njollë* prej Virgjëreshës Krishti. Na mëson Prodhromi,* se s'mundet që të zgjidhet dot rripi⁹³ i Fjalës, pra lidhja me ne;* se i çliron nga çdo mashtrim* të dhélindurit dhe u jep shpëtim.

Pagëzon në zjarrin e fundit Krishti⁵³ sa s'i binden këtij* si Perëndi dhe Fjalë ta mendojnë s'duan,* ndërsa ripërtërit përmes ujit në Shpirit,¹⁶ me hir sa e njohin,* se është' Hyjnia, dhe çliron* nga mëkate si dhe paudhësi.

Kanuni jambik

Irmosi: Imertón ekséfine

»**B**ir të përmallshëm me zë të
»mallëngjyer, Ati⁹⁴ prej q'ellit e pro-
»klamoj Jisunë: Ky tha është' Biri i
»bashkëpanisshëm, që shkëlqen si
»diell përmbi njerëzinë, Fjal' e Perën-
»disë që u mishërua.*

Doli prap' habitshëm nga luani ujur* shenjt i profet që tri mbrëmje ky kalbej keq* në thellësirë.*⁹⁵ Tek të gjith' parashfaqit* ky rilindjen⁹⁶ dhe shpëtimin prej dragoit* njerivrasësit,* gjatë kohës së fundme.

Kur në qiell plot me drit' u hapën dyert* misti sheh Shpirtin që po vjen prej Atit dhe* mbetet në Fjalën* e tërëpacenuar,* vjen pashprehshëm si i bashkëqenshëm me të;* popujve u thot'* të vrapojnë tek Zoti.

Zbritësore: I foní tu Logu dhe Imertón ekséfine

Lajmëtar i Fjalës

dhe

Bir të përmallshëm

Kontaqi

Ting. IV Epefanis símeron

U fanepse me lavdi* në tërë botën* edhe drita jote sot* na u shënua me çudi,*⁵¹ pra të himnojmë ne me kuptim;* erdhe u duke, o drit' e paafreshme.^{23*}

Shtëpia

Në Galilenë e kombeve, në vendin e Zabulonit dhe në tokën e Nefthalimit, siç tha profeti, një dritë e madhe vezulloi, Krishti. Te të errësuarit u pa agim i ndritshëm⁶ që vetëtin nga Bethlehem, ose më mirë Zoti, Dielli i drejtësisë,²⁷ nga Maria i lind rrezet botës mbarë. Prandaj të gjithë ne të zhveshurit që jemi prej Adamit,⁷⁰ eja-ni ta veshim atë⁹⁷ që të ngrohemi; sepse si strehë të zhveshurish dhe shkëlqim të errësuarish erdhe, u duke, o drit' e paafreshme.²³

Sinaksari

Më 6 të të njëjtit muaj, Theofania e shenjtë e Zotit dhe Perëndisë, dhe Shpëtimtarit tonë Jisu Krisht.

Vargje: Pagëzimi i Krishtit, që grisi qiejt,/ fut brenda ata që nuk e ndotin. Pagëzoi në lumë Pararendësi Krishtin në të gjashtë.

Atij lavdia dhe pushteti në jetë të jetëve. Amin.

Ode VII

Irmosi: Neus efsevis

»Djemat mu në zjarr një erë prej
»vese vërshëllenjëse çuditërisht në

»mes të furrës të pangarë i ruajti me
»ndihmën e engjëllit;⁹⁸ pra në mes të
»flakës të vesuarit përhimnonin me
»zë të madh: Zot i forcave, o Perëndi
»i etërve lart në q'ell je i bekuar.^{99*}

Fuqitë e engjëjve ishin të pranishme si në qiell në Jordan me tmerr dhe habi, duke soditur bashkëzbritjen kaq të madhe të Perëndisë; si ai që mban bazën e sipërme të ujërave¹⁰⁰ qëndroi trupmbajtës në ujëra, Perëndia i etërve tanë?

Dikur paraikonizonin çudinë e pagëzimit re dhe det, në të cilat pagëzohej nga ligjvënësi populli¹⁰¹ i mëparshëm përmes kalimit.⁴⁸ Pra një det ishte parafigurim uji dhe një re, Shpirti. Duke u përkryer me ta thërrasim: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.⁹⁹

Të gjithë besimtarët, në atë përmes të cilit morëm përsosmërinë, duke theologuar pa heshtur, tok me engjëjt le të lavdërojmë Atin, Birin dhe Shpirtin e Shenjtë; sepse kjo është Trini, e bashkëqenshme në hipostaza, porse është një Perëndi, të cilit i psalim: O Zot i etërve dhe Perëndi, i bekuar je.⁹⁹

Kanuni jambik

Irmosi: Eflexe rithro

»Në mes të lumit i përvëloj dragonjtë
»ai që Tre Djemtë i shpëtoj prej furrës,

»duke shuar zjarrin me¹⁰² vesën prej
»q'ellit, dhe kështu mëkatet edhe
»njollat tona Shpirti Shenjt i lau në
»valët e Jordanit.*

O Krisht, e ndalove flakën e çu-
ditshme asiriane vërshuese që të
pikturonte ty, dhe e cila u kthye në
vesë;¹⁰² ndaj tani veshe me ujë fla-
kërues një rrëmbyes shumë të keq
që fshihej, i cili ftonte drejt udhe
rrëshqitëse.

Kur qëmoti u ça Jordani, kalon
përmes ngushticës populli izrae-
lit,⁵⁵ duke të parashkruar ty të tërë-
pushtetshmin që shpejt e përçon Kri-
jesën tani në rrjedhje, drejt udhës së
parrjedhshme dhe më të mirë.

E dimë se më parë e fute mizorisht
përmytjen gjithëshfarosëse për
prishjen e të gjithave;¹⁰³ oh, sa të
mëdha dhe të huaja zbulon, ndërsa
tani e mbyte, o Krisht, mëkatin për
mirëqenie dhe shpëtim njerëzish.

*Zbritësore: Neus efsevis dhe Eflexe
rithro*

Djemat mu në zjarr
dhe
Në mes të lumit

Ode VIII

Irmosi: Mistirion parádhokson

»**Ç**udi që nuk ka dot tregim na
»shfaqi furra e Babilonës përmes
»vesës⁹⁸ së q'ellit;* se kështu dhe

»lum' i Jordanit e priti zjarrin qiellor të
»Krishtit,* dhe e pagëzoj* Krijetarin
»e Krijesës,* pra e bekojmë dhe e*
»përmbilavdërojmë përherë dhe për-
»jetë.*

Itha Çlirimtari Pararendësit: Zmbraps
çdo frikë dhe bindmu, afrohu tek unë
si Krishti, sepse ky jam nga natyra;
jepu urdhrit tim dhe më pagëzo mua
që bashkëzbrita, mua që më bekojnë
popuj dhe më përmbilartësojnë në
gjithë jetët.

Porsa Pagëzori i dëgjoji fjalët e Zotit,
i trembur shtrin pëllëmbën, por si
preku me dorë kokën e Gatuesit, i
thërriste të pagëzuarit: Më shenjtëro,
sepse Perëndia im je ti, që të bekojnë
popuj dhe të përmbilartësojnë në gj-
thë jetët.

U bë në Jordan zbulimi i Trinisë,
se kjo është natyra e përmbipe-
rëndishme. Ati thirri: "Ai që pagë-
zohet është Biri im i dashur". Shpirti
ishte i bashkëpranishëm tok me të
ngjashmin, të cilin e bekojnë popuj
dhe e përmbilartësojnë në gjithë jetët.

Kanuni jambik

Irmosi: Elefthera men i ktisis

»**T**ërë Krijesa çlirohet¹⁰⁴ dhe gëzo-
»het. Bij të dritës¹⁰⁵ bëhemi ne bijt'
»e natës. Vetëm po helmohet djall'
»i errësirës.¹⁰⁶ Pra le ta bekojmë
»Shpëtimtarin tonë gjithë popujtë që

»ishim të mjeruar.*

Tre hyjfaqës që freskoheshin me zjarr,⁹⁸ manifestonin qartas natyrën më të lartë që shkëlqeu tërëndritshëm me shenjtërime të trefishta, e cila me përzjerje njerëzore djeg në vesë të gjithë mashtrimin asgjësues, gjëja e uruar.

Le të vishet me të bardha çdo natyrë tokësore që tani u lartësua nga rënia prej qiejve; sepse e larë në rryma që rrjedhin me anën e Fjalës që i mban të gjitha, iku nga fajet e mëparshme, si u la tërëndritshëm.

Zbritësore: Mistirion parádhokson dhe Elefthera men i ktisis

Himnojmë, bekojmë ... Çudi që nuk ka dot tregim

dhe

Tërë Krijesa çlirohet

Ode IX

(Më të nderuarën nuk stihologohet)

Irmosi: Aporí pasa glosa

O shpirt, madhështoje* Zonjën e nderuar mbi forcat engjëllore.*

»**A**snjë gjuhë në botë* s'të këndon
»dot pas vlerës;* dhe turbullohet
»mendja e gjith' engjëjve për ty, o
»Virgjëreshë.* Po na prit me mirësi
»pas besës që të kemi,* se ti e di fort
»mirë që kemi mall për ty* edhe të
»madhështojmë përherë mbrojtj' e
»besnikëve.*

[Nëpër enoritë nuk psalen Madhështimet që i kemi brenda kllapave katrore, të cilat shoqërojnë përsëritjen e tropareve.]

[O shpirt, madhështoje atë që në Jordan* erdhi që të pagëzohet.]

O shpirt, madhështoje atë që prej Prodhromit e mori pagëzimin.

O David, eja shpirtërisht pranë të ndriçuarve dhe këndo: Tani ejani te Perëndia me besë dhe ndriçohuni. Ky i varfëri thirri,¹⁰⁷ Adami i rën', se atë e dëgjoji Zoti ndër valët e Jordanit dhe e përsëriti të prishurin.*

[O shpirt, madhështoje atë që u dëshmuar për zërit prindëror lart.]

O shpirt, madhështoje të njëjtin e Triadhës, i cili uli qafën dhe mori pagëzimin.

Isaia thot': Lahuni dhe pastrohuni, largoni ligësitë nga faq' e Zotit;¹⁰⁸ ata që kanë etje për ujë, shkoni tek uj' i gjallë.¹⁰⁹ Se Krishti do të spërkatë ujë që përsërit¹¹⁰ ndër ata që i rendin pranë me besë, dhe i pagëzon me Shpirt për jetën e pamplakur.*

[Profet, tek unë eja dhe shtrije dorën tënde dhe pagëzomë shpejt ti.]

Tani, profet ti, lëre dhe eja pagëzomë,* se duke dashur vij të përmbush çdo drejtësi un'.¹¹¹

Le të mbahemi, o besnikë, me hirin dhe me shilën. Se sikundër ikën

pernikun hebrenjtë qëmoti duke gjakësuar prahun,¹¹² kështu dhe për neve kjo lanjëtoje e hyjshme e përlindjes do të jetë eksodike; s'andejmi kemi për të parë dhe dritën e paperënduar të Trinisë.*

Kanuni jambik

Irmosi: O ton ipër nun

Sot Jisui Zot ul* kryet nënë dorën e shën Joan profetit.

»**O** çudi pa fund e lindjes përmbi
»mendjen, nus' e ndritëshme dhe
»Nën' e lavdëruar, me të cilën kemi
»marr' shpëtim të plotë, pra për
»mirëbërjen të duartrokasim dhe
»këndime përhirimi të blatojmë.*

[**S**ot në Jordan, në çurka Joani pagëzon Zotin tonë Jisu Krishtin.

Sot brenda rrjedhjesh Zoti varros paudhësinë e njerëzve dhe jep hir.

Sot Zoti Krisht dëshmohej nga lart, se është Biri i dashur, nga i Ati.

Sot Zoti ynë erdhi ta shenjtërojë edhe natyrën mbar' të ujit.

Sot Zoti pagëzimin e merr ky pra nga duart e shën Joan Prodhromit.]

Lavdi

O shpirt, madhështojë pushtetin e Trinisë trihipostate edhe përherë të pandarë.

Idim' ato që iu rrëfyen Moisiut me ferrën si të vepruara pas rregullash të huaja,⁷⁹ se ashtu shpëtoi Virgjëresha e skuqur kur lindi mirëbërësin dritë

tësjellës, i cili u prit ndër valët e Jordanit.*

Tani

O shpirt, madhështojë atë që na shpëtoi nga nëma, të Dëllirën.

E lyen duke perfektuar natyrën njerëzore,¹¹³ o mbret i panisshëm, duke e spastruar me kungimin e Shpirtit¹¹⁴ dhe valët e kulluara; dhe triumfove përmbi fuqinë kryelartë¹¹⁵ t' errësirës,¹⁰⁶ të cilën tani na e këmbeve me jetën e pafundme.*

Zbritësore: Apori pasa glosa dhe O ton ipër nun

O shpirt, madhështojë* Zonjën e nderuar mbi forcat engjëllore.*

Asnjë gjuhë

dhe

O shpirt, madhështojë atë që na shpëtoi nga nëma, të Dëllirën.

O çudi pa fund

Dërgimësore

Epesképsato imas

Shpëtimtari na u shfaq,^{*25} pra Hiri, e vërteta krejt,* brenda Jordanit në rrëke,* sa flinin pra në terr, në hi,* këta i shndriti⁶ me shkëlqim,* sepse erdhi, u shfaq te ne drita që s'ka afrim.²³

(3x)

6 Lavdërime Idhiomele

Ting. I Të Gjermanoit patriark

Dritë prej drite shkëlqeu në botë

Krishti, Perëndia ynë që u faneps;²⁵ atij, o popuj, le t'i falemi.*

(2x)

Si të të nderojmë, o Krisht, si të ka hije, ne shërbëtorët, ty Zotin? Se na përsërite ndër ujëra të gjithë ne.*

Ti, o Shpëtimtari ynë, kur u pagëzove në Jordan, shenjtërove valët, i dorëvënë prej pëllëmbës së shërbëtorit dhe duke shëruar pësimet e botës. I madh është misteri i ekonomisë²⁵ sate, o Zot njeridashës, lavdi më ty.*

Drita e vërtetë u shfaq¹ dhe u falndriçim të gjithëve. Pagëzohet me ne Krishti, që është përtej çdo pas-tërtie; hedh shenjtërimin tek uji dhe bëhet spastrim' i shpirtrave¹¹⁰ tanë. Fenomeni është i dhëshëm, po koncepti është përmbi qiejtë; me larje shpëtim,¹¹⁶ me ujë shpirt,¹⁶ me zhytje në ujë bëhet ngjitja jonë te Perëndia. Të çuditshme janë veprat e tua,³⁶ o Zot, lavdi më ty.*

Injëti I Andreas Jerusalemasit

Ai që vesh qiellin me re,¹¹⁷ mbështillet sot me valët e Jordanit, dhe mbaron spastrimin tim ai që ngre mëkatin e botës;² dhe prej Shpirtit lartazi dëshmohet si Bir i vetëmlindur i Atit¹¹ të lartë; atij le t'i thërresim: O Krisht Perëndia ynë që u fanepse²⁵ dhe na shpëtove, lavdi më ty.*

Lavdi

Ting. Tërth. II I Anatoliut

Urrethove me ujërat e Jordanit, o Shpëtimtar, ti që vishesh me dritën si rrobë;⁴⁰ dhe i ule kryet Pararendësit, ti që mate qiellin me pëllëmbë,¹¹⁸ që ta kthesh botën nga mashtrimi dhe të shpëtosh shpirtrat tanë.*

Tani

Ting. II I Anatoliut

Sot Krishti erdhi në Jordan për t'u pagëzuar. Sot Joani prek kryet e Zotit. Fuqit' e qiejve u shtangën⁶⁵ duke parë misterin e mahnitshëm.¹¹⁹ Deti pa dhe iku, Jordani duke parë kthehej prapë,³¹ dhe ne të ndriçuarit thërresim:

Kori A: Lavdi Perëndisë që u faneps²⁵ dhe u pa mbi dhënë, e ndriçoi botën.^{1*}

Dhe vazhdimi i Dhoksologjisë së Madhe (dmth. nga Vargu i dytë.)

*Në Liturgji, Antifonet
Antifoni i parë*

Varg a): Në daljen e Izraelit nga Egjipti, e shtëpisë së Jakovit.

Me ndërmjetimet e Hyjlindëses.

Varg b): U bë Judea shenjtërorja e tij. Me ndërmjetimet e Hyjlindëses.

Varg c): Deti pa dhe iku, Jordani u kthye mbrapa.

Me ndërmjetimet e Hyjlindëses.

Varg d): Ç'është me ty, o det, që ike, dhe ti, o Jordan, që u ktheve mbrapa?

Me ndërmjetimet e Hyjlindëses.

Lavdi *dhe* Tani

Me ndërmjetimet e Hyjlindëses.

Antifoni i dytë

Varg a): Desha, sepse do ta dëgjojë Zoti zërin e përgjërimit tim.

Shpëtona, o i Bir i Perëndisë, që u pagëzove prej Joanit në Jordan, ne që të psalim Aliluia.

Varg b): Se e ule veshin e tij tek unë, dhe në ditët e mia do të thërres.

Shpëtona.

Varg c): Më rrethuan dhimbje vdekjeje, rreziqe Hadhi më gjetën.

Shpëtona.

Varg d): Mëshirues dhe i drejtë është Zoti, dhe Perëndia ynë mëshiron.

Shpëtona.

Lavdi *dhe* Tani
O i vetëmlindur.

Antifoni i tretë

Varg a): Lavdëroni Zotin se është i mirë, se përdëllimi i tij është në jetë. Në Jordan kur pagëzoheshe.

Varg b): Le të thotë pra shtëpi Izraeli se është i mirë, se përdëllimi i tij është në jetë.

Në Jordan kur pagëzoheshe.

Varg c): Le të thotë shtëpi Aaroni se është i mirë, se përdëllimi i tij është në jetë.

Në Jordan kur pagëzoheshe.

Varg d): Le të thonë të gjithë që e kanë frikë Zotin, se është i mirë, se përdëllimi i tij është në jetë.

Në Jordan kur pagëzoheshe.

Hyrtore

I bekuar është ai që vjen në emrin e Zotit. Perëndi është Zoti dhe u shfaq ndër ne. Shpëtona.

Përlëshorja. Kontaqi U fanepse me lavdi. Në vend të Trishenjitit, Sa u pagëzuat. Në vend të Të meriton, O shpirt, madhështoje Zonjën e nderuar. Asnjë gjuhë. Kungatore U shfaq Hiri i Perëndisë, që shpëton të gjithë njerëzit. Në vend të Pamë dritën, Përlëshorja. Pas Uratës mbrapa Amvonit (para Emri i Zotit) bëhet Ajazma e Madhe (Zër' i Zotit etj.), siç u shkrua dje, pas Orëve të Mëdha dhe Liturgjisë së Shën Vasilit (Vendi më i saktë për Ajazmën e Madhe në ditën e sotme është para fillimit të Liturgjisë, por zakonisht bëhet tani, në fund të Liturgjisë, që të evitohet rrëmuja dhe që të lehtësohen më shumë besimtarët [Më përpara pihet Ajazma e Madhe (Uji i Bekuar) dhe pastaj hahet nafora]. Le të himnojmë, o besnikë; Emri i Zotit. Përlëshim.



SHËRBESA E BEKIMIT TË UJËRAVE
(Hedhja e Kryqit)

Kryhet nëse afër kishës ka det ose liqen, lumë ose depozitë ujërash etj.

Pas mbarimit të Liturgjisë dhe Ajazmës, shkojmë me litani në vendin e caktuar

duke psalur (fq. 98):

Zër' i Zotit mbi ujërat.
Sot bekohet natyr' e ujërave
Si njeri erdhe në lumë

Lavdi *dhe* Tani
Te zëri i atij që bërtiste

Dhjaku: Dhe që të bëhemi të denjë
për të dëgjuar Ungjillin e Shenjtë...

Këndimi i Ungjillit të Shenjtë sipas
Markut
(1.9-11)

Në atë kohë, erdhi Jisui prej Nazaretit
të Galilesë dhe u pagëzua prej Joanit
në Jordan. Dhe menjëherë, duke u
ngjitur nga uji, pa të çahen qiejt dhe
Shpirtin si pëllumb të zbrësë mbi të.
Dhe zë u bë prej qiejve: Ti je Biri im i
dashur, që më pëlqeu.

Dhe menjëherë

Dhjaku: Me paqe le t'i lutemi Zotit.

- Për paqen që lartazi dhe për shpëtimin e shpirtrave tanë, le t'i lutemi Zotit.

- Për paqen e tërë botës, qëndrimin e mirë të Kishave të shenjta të Perëndisë¹⁸ dhe për bashkimin e të gjithëve, le t'i lutemi Zotit.

- Për Kryepiscopin tonë (*aksh*), të nderuarën presviteri dhe dhjakonatën më Krishtin, për tërë klerin dhe popullin, le t'i lutemi Zotit.

- Për Republikën e Shqipërisë, qeverinë, ushtrinë dhe gjithë popullin,

le t'i lutemi Zotit.

- Për këtë qytet (*ose manastir të shenjtë, ose vend*), çdo qytet dhe vend, dhe për ata që banojnë ndër to me besë, le t'i lutemi Zotit.

- Për erëra të mira, begati të pemëve të dheut, dhe për kohë me paqe, le t'i lutemi Zotit.

- Për ata që lundrojnë, që udhëtojnë, për të sëmuret, vuajtësit, robërit dhe për shpëtimin e tyre, le t'i lutemi Zotit.

- Që të shenjtërohet ky ujë me fuqinë dhe energjinë, dhe përmbiardhjen e Shpirtit të Shenjtë, le t'i lutemi Zotit.

- Që t'iu dhurohet hiri i çlirimit, bekimi i Jordanit, le t'i lutemi Zotit.

- Që të tregohet ky zbrapsës i çdo tinëzie armiqsh të dukshëm dhe të padukshëm, le t'i lutemi Zotit.

- Që të dëgjojë Zoti Perëndia zërin e përgjërimit²¹ tonë, të ne mëkatarëve, dhe të na mëshirojë, le t'i lutemi Zotit.

Prifti: Dëgjona, o Perëndi, Shpëtimtari ynë, shpresa e të gjithë anëve të dheut dhe atyre që ndodhen larg në det; dhe i mëshirshëm, i mëshirshëm tregohu, o Zot, për mëkatet tona dhe mëshirona. Se ti je Perëndi mëshirues dhe njeridashës dhe ty ta drejtojmë lavdinë, Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve.

Kori: Amin.

Prifti: Paqe në të gjithë

Kori: Dhe në shpirtin tënd.

Dhjaku: Kryet tanë le t'ia ulim Zotit.

Kori: Ty, o Zot.

Dhe priftit thotë këtë Uratë pa zë:

Përkul, o Zot, veshin tënd^{50a} dhe dëgjona, ti që në Jordan denjove të pagëzohesh dhe shenjtërove ujërat; dhe bekona të gjithë ne, që me anën e uljes së qafave tona, tregojmë shenjën e robërisë: dhe bëna të denjë të mbushemi me shenjtërimin tënd me anën e marrjes dhe të spërkatjes së këtij uji; dhe na u bëftë, o Zot, për shëndet shpirti dhe trupi.

Dhe me zë të lartë:

Se ti je shenjtërimi i shpitrave dhe i trupave tanë, dhe ty ta drejtojmë lavdinë, falënderimin dhe faljen, bashkë me Atin tënd të pafillim dhe Shpirtin tënd të Tërëshenjtë, të mirë dhe jetëbërës, tani e përherë e në jetë të jetëve.

Kori: Amin.

Prifti duke psalur Përlëshoren Në Jordan kur pagëzohesh, o Zot, hedh Kryqin në ujëra.

Kori e përsërit Përlëshoren dy herë.

Dhjaku: Le t'ia lutemi Zotit.

Kori: Mëshiro, o Zot.

Prifti: Bekimi dhe mëshira e Zotit ardh të mbi ju.

Prifti bën Përlëshimin:

Ti që denjove të pagëzohesh prej Joanit në Jordan për shpëtimin tonë, o Krisht Perëndia ynë, me ndërmjetimet e Zonjës sonë të pacenuar,

Hyjlindëses dhe gjithmonë Virgjërës Mari, me fuqinë e Kryqit të çmuar dhe jetëbërës, me mbrojtjet e Fuqive qiellore të çmuara dhe të patrup, me përgjërimet e të nderuarit, të lavdëruarit profetit, pararendësit dhe pagëzorit Joan, të apostujve të shenjtë, të lavdëruar dhe të dëgjuar, të atit tonë ndër shenjtorët Nikollës, kryepiskopit të Mirës së Likisë, çudibërës dhe mbrojtësit të lundruesve, të martirëve të shenjtë, të lavdëruar dhe mundës të shkëlqyer, të etërve tanë oshënarë dhe hyjprurës, të Hyjprindërve të shenjtë e të drejtë Joakimit dhe Anës dhe të gjithë shenjtorëve të tu, bëje të mirëpritur lutjen tonë; dhurona ndjesën e fajeve¹²⁰ tona; mbulona me hijen e krahëve të tu;¹²¹ dëbo nga ne çdo armik dhe kundërshtar; paqësona jetën; mëshirona, o Zot, ne dhe botën tënde, dhe shpëto shpirtat tanë si Perëndi i mirë, njeridashës dhe i mëshirshëm.

Me uratat e etërve tanë të shenjtë, o Zot Jisu Krisht Perëndi, mëshirona dhe shpëtona.

Kori: Amin.

CITIME

¹ Joan 1.4,9; 8.12; 9.5

² Is. 53.4,7; Joan 1.29,36

³ Ps. 17(18).10; 143(144).5

⁴ Fil. 2.6-7

⁵ Gjen. 3.15; Ps. 73(74).13

- ⁶ Is. 9.2; Matth. 4.16; Lluk. 1.79
⁷ Ps. 28(29).3
⁸ Is. 11.2-3; Ef. 1.17
⁹ Is. 40.3; Matth. 3.3; Mark. 1.3; Lluk. 3.4; Joan 1.23
¹⁰ Ps. 76(77).17
¹¹ Joan 1.14,18; 3.16,18; I Joan 4.9
¹² Joan 17.3; I Joan 5.20; Apok. 3.7,14
¹³ Ps. 35(36).10; Jer. 2.13
¹⁴ Hebr. 1.1; I Petr. 1.20
¹⁵ II Kor. 8.9
¹⁶ Vep. 1.5
¹⁷ Jez. 36.25
¹⁸ Vep. 16.5
¹⁹ II Kor. 4.6
²⁰ Joan 4.14
²¹ Ps. 27(28).2
²² Sof. 1.15
²³ I Tim. 6.16
²⁴ Lluk. 2.12,16
²⁵ Ps. 117(118).27; I Tim. 3.16
²⁶ Is. 45.8
²⁷ Mal. 4.2 (3.20)
²⁸ Eks. 15.23-25
²⁹ Gjen. 3.16-24
³⁰ Lluk. 1.33
³¹ Ps. 113(114).3,5
³² Kol. 2.9
³³ Ps. 113(114).4
³⁴ Ps. 76(77).18
³⁵ I Kron. 16.9; Ps. 9.2 etj.; Sirak 17.8
³⁶ Ps. 76(77).12,14-15; 85(86).10
³⁷ Rom. 4.17
³⁸ Ps. 64(65).12
³⁹ Ps. 148.3; Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 39
⁴⁰ Ps. 103(104).2
⁴¹ Ps. 135(136).6
⁴² Jer. 5.22
⁴³ Jez. 1.18; 10.12
⁴⁴ Is. 6.2
⁴⁵ Lluk. 1.78
⁴⁶ Varuk 3.38
⁴⁷ Gjen. 7.17
⁴⁸ Eks. 14.21-30
⁴⁹ Eks. 17.6; Ps. 73(74).15; 77(78).15-16,20; 113(114).8
⁵⁰ III [I] Mbret. 18.38-40
^{50a} IV [II] Mbret. 19.16; Ps. 85(86).1; Is. 37.17; Varuh 2.16
⁵¹ Ps. 4.7; Is. 9.2; Matth. 4.16
⁵² Is. 12.3
⁵³ Matth. 3.11-12; Lluk. 3.16-17
⁵⁴ Matth. 25.1-10
⁵⁵ Jis. N. 3.15-17
⁵⁶ Lluk. 1.26
⁵⁷ Matth. 2.2
⁵⁸ Ps. 95(96).11; Is. 49.13
⁵⁹ Tit. 2.11
⁶⁰ Gjen. 2.7
⁶¹ Jez. 10.8-18
⁶² Is. 6.3
⁶³ Joan 5.35
⁶⁴ Lluk. 1.7,36
⁶⁵ Jer. 2.12
⁶⁶ Est. 4.17b
⁶⁷ Eks. 15.18 etj.; I Tim. 1.17
⁶⁸ Ps. 117(118).16
⁶⁹ I Petr. 3.19
⁷⁰ Gjen. 3.1-7
⁷¹ Rom. 6.4; Kol. 2.12
⁷² I Mbret. [Sam.] 2.10
⁷³ I Mbret. [Sam.] 2.2
^{73a} I Mbret. [Sam.] 1.2,5-6
⁷⁴ I Mbret. [Sam.] 2.1

- ⁷⁵ Lluk. 1.78
⁷⁶ II Mbret. [Sam.] 22.14-17; Ps. 17(18).14-17; 28(29).3
⁷⁷ I Kor. 1.24
⁷⁸ Urt. Sol. 7.26; Hebr. 1.3
⁷⁹ Eks. 3.2-6
⁸⁰ Eks. 19.18; 20.18; Ps. 103(104).32; 143(144).5
⁸¹ Abak. kap. 3
⁸² Joan 1.1-4
⁸³ Matth. 3.11; Mark. 1.7; Lluk. 3.16; Joan 1.15,27,30
⁸⁴ Vep. 3.15
⁸⁵ Rom. 5.10; II Kor. 5.18-20; Ef. 2.15-16
⁸⁶ Fil. 4.7
⁸⁷ Matth. 3.5-8; Mark. 1.5; Lluk. 3.7-8
⁸⁸ Joan 14.27
⁸⁹ Joan 1.26
⁹⁰ Fja. Urt. 5.22
⁹¹ Joan 4.11-14
⁹² Matth. 3.2; Mark. 1.4; Lluk. 3.3
⁹³ Mark. 1.7; Lluk. 3.16; Joan 1.27
⁹⁴ Ps. 109(110).3
⁹⁵ Jona 2.1,11
⁹⁶ Matth. 12.40
⁹⁷ Rom. 13.14; Gal. 3.27
⁹⁸ Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 25-26
⁹⁹ Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 2
¹⁰⁰ Ps. 103(104).3
¹⁰¹ I Kor. 10.1-2
¹⁰² Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 23-25
¹⁰³ Gjen. 7.17-23
¹⁰⁴ Rom. 8.21
¹⁰⁵ Lluk. 16.8; Joan 12.36; I Thes. 5.5
¹⁰⁶ Ef. 6.12
¹⁰⁷ Ps. 33(34).6-7
¹⁰⁸ Is. 1.16
¹⁰⁹ Is. 55.1
¹¹⁰ Jez. 36.25
¹¹¹ Matth. 3.15; 5.17
¹¹² Eks. 12.7,13
¹¹³ I Joan 2.20,27
¹¹⁴ II Kor. 13.13
¹¹⁵ Kol. 2.15
¹¹⁶ Tit. 3.4-6
¹¹⁷ Ps. 146(147).8
¹¹⁸ Is. 40.12
¹¹⁹ Lluk. 5.26
¹²⁰ Ef. 1.7
¹²¹ Ps. 16(17).8; 60(61).5



MË 7 TË TË NJËJTIT MUAJ

Mbledhja e profetit të çmuar, të lavdëruar, Pararendësit dhe Pagëzorit Joan.

Tipikon

Nëse bie e diel, të shtunën në Mbrëmësore, nuk lexohet Psaltiri. Thirrtores: 4 ngjallësore, 3 të së kremtes dhe 3 të shenjtit. Lavdi i shenjtit. Tani Hyjlindësore dogmatike e tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimëni i Madh. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi i shenjtit. Tani (i mëpasshëm,) i së kremtes. Përlëshoret: ngjallësore, e shenjtit dhe e së kremtes.

Të dielën, në Shërbesën e Mesnatës, në fund, Përlëshorja e së kremtes. Në Mëngjesore, pas Stihologjisë së parë dhe të dytë, nga 2 Ndenjësore ngjallësore dhe 1 e shenjtit në vend të Hyjlindësoreve. Bekimtores. Ipakoia. Shkallesat dhe Proqimëni i tingullit. Kanunet: ngjallësor; i pari i së kremtes (me varg Lavdi më ty, o Perëndia ynë) dhe i shenjtit. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia ngjallësore dhe Ndenjësoret. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e shenjtit, dhe Sinaksari. Zbritësoret jambike (Shkoj nëpër detin); dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor. Në vend të Më të nderuarën, Ode IX e Kanunit të parë të së kremtes dhe e shenjtit. Zbritësore O shpirt, madhështoje Zonjën; O çudi pa fund. I shenjtë është (3x) dhe Dërgimësoret: ngjallësore, e shenjtit dhe e së kremtes. Lavdërimet:

4 ngjallësore dhe vetëm 4 të së kremtes (me vargje në dy të fundit, vargjet e Pasvargjeve si zakonisht, d.m.th. kur përveç Lavdërimeve ngjallësore psalen edhe Lavdërime të tjera). Lavdi i shenjtit. Tani E Përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji, Antifonet e së kremtes, por Hyrtore: Ejani t'i falemi... që u ngjalle prej së vdekurish. Në vend të Trishenjtit, Sa u pagëzuar. Apostulli dhe Ungjilli i shenjtit. Në vend të Të meriton, O shpirt, madhështoje Zonjën; O çudi pa fund. Kungatore Në kujtim të përjetshëm (ose dhe Lavdëroni). Në vend të Pamë dritën, Përlëshorja e së kremtes.



NË MBRËMËSORE

Thirrtores të së kremtes

Ting. II Të Joan Monakut

Dritën ton', që ndriçoi çdo njeri,¹ kur pa Pararendësi të vijë për t'u pagëzuar, i gëzohej shpirti dhe i dridhej dora; e tregon² dhe u thotë popujve: Ja ai që shpërblen Izraelin, ai që na çliron nga prishja. O Krisht i pamëkatshëm, Perëndia ynë, lavdi më ty.*

Kur pagëzohej shpërblyesi ynë prej një robi dhe dëshmohej prej zbritjes së Shpirtit, u tmerruan duke parë ushtrit' e engjëjve; dhe një zë u sull prej Atit nga qielli: Ky, të cilin Pararendësi dorëzon, është Biri im i

dashur, i cili më pëlqeu. O Krisht Perëndia ynë, lavdi më ty.*

Valët e Jordanit pritën ty burimin dhe Ngushëllimtari zbriti në formë pëllumbi; ul kryet ai që uli qiejtë;³ i thërret e i këlthet balta artistit: Përse më urdhëron ato që janë përmbi fuqinë time? Unë kam nevojë për pagëzimin tënd. O Krisht i pamëkatshëm, Perëndia ynë, lavdi më ty.*

Të shenjtit

Ting. I Panëfimi mártires

Joan Pararendës famëmadh* Pagëzor i Zotit Krisht,* o i hyjzënë të lumërojmë, Krishtin mburrim pra,* që të uli kryet* në Jordan dhe shenjtëroi gjindjen dhe natyrën e njerëzve; prandaj ti ndërmjeto* të dhurojë ky te shpirtrat tan'* paqesim si edhe përdëllim të madh.

Nga lart, o Prodhrom i urtë pe,* lavdin e pashprehshëm dot* të Atit, Birin në ujëra; të Tërëshenjtin Shpirt* e pe teksa erdhi* si pëllumb, që, o Joan, pastronte dhe ndriçonte çdo skaj mbi dhé, ndaj të këndojmë ty* si mist qiellor të Shën Trinis'* dhe nderojmë panairin tënd hyjnor.

Joan Pararendës, Pagëzor,* i forcuar plot me hir* prej Krishtit, qengjin që ngre të gjitha fajet përmbi dhé* e tregove,² dhe sot* dyshen e dishepujve të tu ti e bashkove me të⁴ i

ngazëlluar; lyp prej tij* të dhurojë ky te shpirtrat tan'* paqesim si edhe përdëllim të madh.

Lavdi

Ting. Tërth. II I Bizantit

O kandil⁵ i mishëruar, Pararendësi i Shpëtimtarit, lastari i shterpës,⁶ miku⁷ i atij që lindi nga një e virgjër, të cilit me kërcim në bark iu fale⁸ dhe e pagëzove në rrymat e Jordanit; ndërmjeto tek ai, lutemi, o profet, që të arratisemi nga shtrëngatat e ardhshme.

Tani

I njëjti I Theofanit

Fjala Perëndi u shfaq me trup⁹ te gjindja e njerëzve. Qëndroi të pagëzohet në Jordan dhe Pararendësi i thoshte: Si të ndej dorën dhe të prek kryet që mban Gjithësinë?¹⁰ Megjithëqë je lindur si foshnjë prej Marisë, po unë të di Perëndi të parajetëshëm; ecën mbi dhé ti që himnosh prej Serafimeve;¹¹ dhe unë robi, nuk kam mësuar të pagëzoj Zotin. O Zot i pakuptueshëm, lavdi më ty.*

Hyrje. Proqimeni i Madh.

Ting. i Rëndë

Perëndia yn' në qiell dhe në dhé të gjitha sa deshi i bëri.

Varg a): Në daljen e Izraelit nga Egjipti, e shtëpisë së Jakovit nga një popull barbar.

Perëndia yn' në qiell.

Varg b): Deti pa dhe iku, Jordani u kthye mbrapa.

Perëndia yn' në qiell.

Varg c): Ç'është me ty, o det, që ike, dhe ti, o Jordan, që u ktheve mbrapa? Perëndia yn' në qiell.

Pasvargje

Ting. IV 'Edhokas simíosin

Kur, o Zot, të pa Joani Pagëzor t'i afroheshe* krejt u shtang, dhe të thirri ty* me frikë si shërbëtor,* mirënjohës kështu:* Ç'është Shpëtimtari im kjo përulësi, o Krisht,* dhe ç'është kjo varfëri¹² që veshe ti* i dhembshur, që njeriun e rrëzuar ta ngresh në qiell lart,* kur e veshe me pasuri* mirësie dhe përdëllim?

Varg: Deti pa dhe iku, Jordani u kthye mbrapa.

“**M**os ki frik', por eja sot me tmerr shërbemë, se po përmbush* një mister”, kundërshtoi, tha* tek shën Pararendësi* Zot i Gjithësisë* Shpëtimtari, “se që ta përtëris Adamin at',* që u dërrmua, ndaj brenda rrjedhave* të lumit në Jordan po pagëzohem porsì njeri, si ti,* dhe pse sipas natyrës jam* i përsosur, pa pikë cen.

Varg: Ç'është me ty, o det, që ike, dhe ti, o Jordan, që u ktheve mbrapa?

“**K**ush nga të dhéindurit pa që të lahet drit', dielli?”* kundërshtoi Joani

shenjt;* “atë që me re mbështjell* qiellin,¹³ të zhvishet,* pra atë që bën dhe krijon burime dhe lumenj,*¹⁴ të shkelë mbi ujëra, o Zoti im?*" Habitem me ekonominë tënde që nuk rrëfehët dot;* mos rëndo shërbëtorin tënd* ti me urdhra të frikshme fort.”

Lavdi

Ting. IV I Bizantit

Si i dashuruar pas Shpirtit dhe porsì dallëndyshe hyjfolëse i Hirit, e lajmërove fuqishëm ekonominë e Mbretit që lindi ndritshëm nga një e kulluar për gjininë e njerëzve, për rithirjen e vdekatarëve, o Pararendës, duke dëbuar fundin e moraleve të zymtë dhe duke drejtuar zemrat e atyre që pagëzoheshin me pendim, të merrnin jetë të përjetshme,¹⁵ o i lumur i hyjzënë.

Tani

I njëjti I Kozma Monakut

Ejani t'i imitojmë virgjëreshat e mençura; ejani ta mirëpresim Zotin që u duk, se doli si dhëndër¹⁶ drejt Joanit. Jordani sapo të pa u frikësua dhe mbeti.¹⁷ Joani thërriste: Nuk guxoj të mbaj kokë të pavdekshme. Shpirti zbriste në formë pëllumbi që t'i shenjtërojë ujërat; dhe u dëgjua një zë nga qielli: Ky është Biri im që erdhi në botë ta shpëtojë gjininë e njerëzve. O Zot, lavdi më ty.

Përlëshore Ting. II

Kujtimi i të drejtit shoqërohet me lavdërime,¹⁸ por për ty do të mjaftojë dëshmia e Zotit, o Pararendës,¹⁹ sepse u dëfteve me të vërtetë dhe më i nderuar se profetët,^{19a} meqë u denjësove dhe ta pagëzosh në rryma të predikuarin; prandaj, pasi u luftove tejet për të vërtetën,²⁰ u ungjillëzove me hare dhe atyre që ishin në Hadh, Perëndi të zbuluar në mish,⁹ që ngre mëkatën e botës² dhe na jep përdëllimin e madh.



NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësore
Ting. I Tu lithu sfrajstheshtos*

Kur lindi nga Maria e virgjër Jisu Krishti* edhe në Jordan prej Joanit e mori pagëzimin,* mbi të zbriti Shpirt i Tërëshenjt',* i cili porsi një pëllumb u shfaq;* pra profeti tok me engjëj kështu i tha,* i thirri: Lavdi me ty, Krisht,* lavde pranisë sate dhe lavdi,* nder mbretërisë sate, Zot,* dhe ekonomisë sate, i vetmi që na do ne.

Lavdi dhe Tani
*I njëjti**Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësore
Ting. IV Epefanis símeron*

Pagëzori famëmadh* të pa në rrymat* e Jordanit, se deshe* të pa-

gëzohesh, ti, o Krisht,* me ngazëllim po thërriste pra:* Erdhe, u shfaqe, o drit' që s'afrohesh dot.²¹

Lavdi dhe Tani
*I njëjti**Psalmi 50.*

*Kanunet: i pari i së kremtes me Irmoset
në 8 dhe i shenjtit në 6.*

*Kanuni i shenjtit, që ka Akrostihidhë: "O
Pagëzori i Krishtit, pranoji lavdërimet e mia".*

*I Theofanit.**Ting. II**Ode I**To tin ávaton*

Më shpëto mua, o Pagëzor, arri, sepse* mbytem thell' në furtunën e pasionit,²² ndërmjeto,* se je en' e shenjtë ti,* e nderuar edhe e pastër e pafajësis'* dhe iu kushtove që kur ishe foshnjë në fillim.²³

Me gaz, engjëlli që ish pran' Zotit, o Joan,* atit tënd Zaharia, që i respektuar ish* kur po celebronte ky* të ungjillëzoi të barabart' me engjëjt ty,* si mik i Zotit, Pagëzor, o shenjt i tërëlum.

Ishe mbushur plot me Shpirt të Shenjtë,²⁴ o profet,* që kur po mbahehe në bark nënor²³ përbrenda ti,*²⁵ me kërcim, me hov gazmor* dhe me hijeshi lajmërove frytin virgjëror,* atij iu fale, o i respektuar

Pagëzor.⁸

Pararendësin hyjfolës të hyjnueshëm,* që pagëzoi Krishtin nëpër rrjedhat në Jordan,* njerëzve u hapi udh',* të pashkelur më parë e të huaj, shteg të ri*²⁶ për jetën, le ta mburrim Pagëztorin shën Joan.

Hyllindësore

Ti, o tempulli hyjnor i virgjëris' së shenjt',* Fjalën Zot Perëndi në bark e kishe; sa rendim,* e dëlirë, te ti pra,* dhe të ftojme ty, na shpëto me ndërmjetimin tënd,* shfaros çdo sulm rreziqesh, o e paqortueshme.

Zbritësore: Stivi thalasis

»Shkoj nëpër detin më këmbë
»Izraeli edhe në bregun arriti i
»palagur, po kalorësinë armike egjiptiane Zoti e përmbysi në një varr
»prej valësh me çudi dhe tmerr, me
»të djathtë e fortë.²⁷*

Ode III

Tis písteos en petra me

Joan, ke thyer turpin e shterpësisë*⁶ dhe Birin virgjëror dhe hyjnor e njohë;* u hodhe me hare dhe gëzim për brenda barkut të nënës, Pagëzor⁸ i Krishtit Zot * mist i Hirit që rri në tendë engjëjsh lart.

Ti udhët e Jisuit i përgatite,*²⁸ profet, kur para faqes së tij²⁹ ke ecur,* se

si kandil⁵ e shfaqë në botën mbar' shndritjen e lavdis' së Atit³⁰ që u duk me trup,*⁹ shfaqë përmes ujit, i shquar mbi çdo bir.¹⁹

Ti linde si agim që u lajmëronte* atyre që po rrinin në errësi,* pra Diell drejtësie,³¹ lëçitës dhe Pararendës ti u bëre për shpëtimin ton',* thojë: Me bes' shkoni te Krishti për çlirim.

Hyllindësore

Si prite ngazëllimin e patreguar,* pa farë zure Zotin tënd që rrithirri,* hyjnënë e nderuar, planetin mbarë, me zë i themi: Tjetër shenjt nuk ka, o Zot,* përveç teje dhe s'ka të drejtë si je ti.³²

Zbritësore: Osi paleón

»Ne që shpëtuam nga leqet e
»armikut dhe nga thonj luanësh
»t'egër, të tërbuar, le ta çelim gojën³³
»dhe le të këndojmë fjalë melodie,
»këngë lavdërimi, se na dha shpëtim
»Zoti i pakursyer.*

Ndenjësore

Ting. I Ton tafon su Sotír

Në rrjedha lumi vjen* se e do pagëzimin* nga mirëdashja shiu i madh dhe Joani* i hyjshmi Pararendës duke u shtangur i tha atij:* Njollë s'ke aspak,*^{69a} si do të të pagëzoi pra?* Dorën si ta shtrij* mbi kokën që po shkakton tmerr* në botën e tërë pra.

Lavdi *dhe* Tani

Ting. IV Kateplaji Iosif

Zbriti me vullnet mbi dhé,* u mishërua pra për ne,* vetëdeshi Krishti Zot,* pra Perëndia që s'kuptojm',* edhe duroi ndriçimi yn' pagëzimin;* fliste pra kështu Pararendësi* duke thirrur: O Shpëtimtari im,* nuk do guxoj ta prek dot kokën tënde,* si shoh që nuk të kuptoj, o Zot;* Lavdi ty, Fjalë,* që rregullove* çdo gjë për të mirë.

Ode IV

Imnó se akoi

U dërgove prej Zotit që të lash me ujë ata që ishin ndotur duke hijeshuar që ta pranonin Krishtin që ngre mëkatin² dhe e dëbon mashtrimin me shkëlqim hyjditurie, o i tërënderuar.

Përgjëroju, o i lum, që e pagëzove Krishtin në rrjedhat e Jordanit, që të shërohesh nga helmi i kafshimit të dragoit; në këtë lumë Shpëtimtari e dërrmoi dinakërinë e dragonjve që kishin bërë fole atje.

I zbukuruar me urtësi Perëndie, dole përpara, o krishtepredikues, sepse u bërë zëri i dikujt që thërriste: "Pendohuni!"³⁵ Si profet parathe atë që të tregonte ty mbi të gjithë njerëzit.¹⁹

Duke nxitur për jetë të huaj dhe të

pashkelur nga njerëzit, qëndrove mbi ujërat e Jordanit, o i tërëshkëlqyer, që ta dëgjosh zërin e Atit dhe të soditësh prani Shpirti.

Hyjlindësore

Zoti që i gatoi të gjitha, ai vetë gahet sipas nesh, sepse pasi hyri në mitrën tënde të tërëshenjtë, o e Tërëkulluar, veshi formën e njerëve³⁶ dhe shpëtoi ikonën e tij.³⁷

Zbritësore: Pirsó katharthís

»**I** paqësuar prej një zëri të shenjtë
»këndon profeti për lindjen njerëzore,
»dhe i frymëzuar po lëçit me bujë
»Fjalën e panisshme që u mishërua
»dhe dërrmoj përdhë fuqinë e armiqve.^{38*}

Ode V

O fotismós ton en skoti

I shkëlqyer me vezullime virtyti të mbinatyrshëm, si prej mësimi mistik qiellor, qëndrove pranë rrjedhës së Jordanit duke pagëzuar dhe pastruar me anën e ujit ata që të vinin ty me besim në shpirt, o Pararendës.

Meqenëse kishe për ta pagëzuar dritën e pastër dhe të pacenuar, u tregove enë pastërtie, sepse prej tij u zgjodhe më i madh se të gjithë¹⁹ dhe më i nderuar nga profetët,^{19a} duke qenë se u vlerësove ta shikosh të profetizuarin.

Pararendësi që u dërgua para faqe Zotit²⁹ dhe u tregonte njerëzve udhët e drejta,²⁸ prek duke u trembur kokën e Zotit dhe pagëzon duke thënë: Tjetër Perëndi veç teje nuk njoh.³⁹

Hyjlindësore

O Virgjëreshë, Biri yt u dëftua qartazi Bir Perëndie, se kryen si Perëndi vepra vetëm me vullnetin e tij,⁴⁰ ndaj të gjithë të quajmë Hyjlindëse me të vërtetë dhe unike; sepse tjetër nënë Perëndie nuk njohim.

Zbritësore: Ehthrú zofodhus

»**S**hpirit i Shenjtë na ka larë prej »çdo helmi të armikut t'errët edhe »të pabesë, dhe na ka drejtuar n' »udhën e vërtetë që na shpie në »dëfrim të paafruar, q'e fitojn' ata »që ka pajtuar Zoti.^{41*}

Ode VI

En aviso ptesmaton

Dole ti porsi zëri²⁸ i Fjalës Zot* dhe si ylli i mëngjesit linde, Pagëzor,* e parashpalle qartazi* Krishtin, Diellin e drejtësisë pra.³¹

Përkujdesjet mbi dhé i shpërfille ti,* roke shpresë qiellore si thesarin tënd;* i tërëpasur, o Joan* si një engjëll²⁹ përshkove mbi dhé jetën.

Meqë ishe në mes të dy dhiatave,* ne të dimë vulën e profetëve të gjith';*⁴² të shpallim Pararendësin,*

Pagëzorin e Krishtit, shpëtimit ton'.

Hyjlindësore

Zënia jote shpjegim, Zonjë, s'ka vërtet,* njihet dhe besohet nga çdo shpresëtar besnik,* nuk shprehet dhe s'ka konceptim* lindja jote, hyj-nënë e vetme ti.

Zbritësore: Imertón ekséfne

»**B**ir të përmallshëm me zë të »mallëngjyer, Ati⁴³ prej q'ellit e pro- »klamoj Jisunë: Ky tha është Biri i »bashkëpanisshëm, që shkëlqen si »diell përmbi njerëzinë, Fjal' e Pe- »rëndisë që u mishërua.*

Kontaqi

Ting. Tërth. II

I frikësuar nga prania jote trupore, Jordani kthehej me tmerr, ndërsa duke përbushur shërbimin shpirtëror, Joani nga frika druhej. Rendet e engjëjve çuditëshin duke të parë të pagëzohesh me mish në rrjedha; dhe të gjithë që ishin në errësirë ndriçoheshin duke të përhimnuar ty që u duke dhe i ndriçove⁴⁴ të gjitha.

Shtëpia

Adamit që u verbua në Eden iu duk Diell në Bethlehem dhe hapi bebëzat e tij, pasi i lau në ujërat e Jordanit; të ziut dhe të errësuarit i lindi dritë e pashueshme; s'ka më për të natë,⁴⁵ por të gjitha janë ditë, mëngjesi i plotë⁴⁶ u bë për të, sepse siç është

shkruar, u fsheh në mbrëmje.⁴⁷ Gjeti të gdhirë që e ngrinte. Ai që ra drejt mbrëmjes,⁴⁷ u çlirua nga stuhia dhe arriti tek agimi që u duk dhe i ndriçoi të gjitha.

Sinaksari

Më 7 të të njëjtit muaj, Mbledhja e Profetit të shenjtë, të lavdëruar, Pararendësit dhe Pagëzorit Joan; për më tepër, rastisi dhe transferimi i dorës së tij të tërëçmuar dhe të shenjtë drejt qytetit mbretëror.

Vargje: Si do të të himnojë gjuha ime ty, o Predikues,/ që gjuha e Krishtit të thotë më të madh se të dhë-lindurit?¹⁹

Ra kujtimi i Prodhromit të respektuar në të shtatën.

Me ndërmjetimet e Pararendësit tënd, o Krisht, Perëndia ynë, mëshirona dhe shpëtona. Amin.

Ode VII

Vatos en ori

Si e celebreve pagëzimin dhe i mbarove misteret që kishin lidhje me Perëndinë, të cilat t'u dhanë qartazi, u solle si flijim duke u therur si qengj i patëkeq;² për këtë së bashku me ty psalim njëzëri: I bekuar është Perëndia i etërve tanë.⁴⁸

Pasi u bëre Ilia i ri,⁴⁹ o Pararendës, me guxim kritikon hapur edhe mbretër që bënë paligjësi,²⁰ duke e treguar

jetën tënde të palëndshme si ai,⁵⁰ o i trillumur; për këtë së bashku me ty psalim, o profet: I bekuar është Perëndia i etërve tanë.⁴⁸

O Pararendës, më i madh se profetët¹⁹ dhe apostujt e Krishtit, meqenëse të ra në short çmim hyjnor, ti u pe qartazi plotësimi i Ligjit⁴² dhe aparkë hiri të ri; për këtë së bashku me ty psalim, o i trillumur: I bekuar është Perëndia i etërve tanë.⁴⁸

Hyjlindësore

Le të himnojme me himnime ne të gjithë denjësisht, plot me besë Zonjën e tërëshenjtë dhe hyjpritëse, se kish në bark Perëndi të vetëmlindur⁵¹ që na u pa ne njerëzve; atij ne besnikët i psalim njëzëri: I bekuar je Perëndia i etërve tanë.⁴⁸

Zbritësore: Efekse rithro

»**N**ë mes të lumit i përvëloj dragonjtë ai që Tre Djemtë i shpëtoj
»prej furrës, duke shuar zjarrin
»me⁵² vesën prej q'ellit, dhe kështu
»mëkatet edhe njollat tona Shpirti
»Shenjt i lau në valët e Jordanit.*

Ode VIII

Káminos poté

Ti që u duke mbi tokë i barabartë me engjëjt përmes sjelljes sate të ndryshme, dhe më i lartë se të gjithë,¹⁹ o Joan i tërëlumtur, të mburrim gëzueshëm duke thirrur: E bekonit, ju gji-

tha veprat, Zotin.⁵³

Njohe mistikisht, o profet, një substancë Hyjnie në tri hipostaza të bashkësubstancshme, sepse me anën e zërit të Prindit dhe me prani Shpirti e njohe të pagëzuarin si Fjalën e përjetshme të Perëndisë.

Si agim mendor që lajmëronte Diellin që lindi nga një e Virgjër, vrapove përpara prej një sterileje,⁶ o Joan i tërënderuar; dhe e predikove Qengjin që ngre mëkatën e botës² nga njeridashja.

O i lum, që tani na mbikëqyr nga lart, me ndërmjetimet e tua na ruaj ne që ndjekim predikimin tënd dhe qëndrojmë me këmbëngulje tek mësimdhëniet e tua të perëndishme dhe te dogmat e tua shpëtimtare, o Pararendës i tërëpasur.

Hyjlindësore

Oe tërëkulluar, e zure pashprehshëm vezullimin e parajetshëm të lavdisë së Atit,³⁰ Fjalën e panisshme, që kuptohet se është që në fillim,⁵⁴ dhe që tani është bërë prej teje pa ndryshuar, i parëlinduri i Krijesës.⁵⁵

Zbritësore: Elefthera men i ktisis

»**T**ërë Krijesa çlirohet⁵⁶ dhe gëzohet. »Bij të dritës⁵⁷ bëhemi ne, bijt' e »natës. Vetëm po helmohet djall' »i errësirës.⁵⁸ Pra le ta bekojmë

»Shpëtimtarin tonë gjithë popujtë që »ishim të mjeruar.*

Ode IX

(Më të nderuarën nuk stihologohet)

Ode IX e së kremtes me Madhështimet, dhe e shenjtit me varg: "O Pagëzor i Krishtit, ndërmjeto për ne".

I ton pro iliu fostira

Zëri pararendës tregon² qart'* nëpër shkretëtirë²⁸ Fjalën Zot,* që erdhi mishërisht te ne; dhe me gëzim* hijeshohet ta pagëzojë ky atë që është këtu,* dhe përmes besës i pastron* shpirtrat nga fajet dhe nga çdo mëkat.

Ligji edhe Hiri të shfaqin* të nderuar mes atyre⁵⁹ ty;* vulos të parin⁴² dhe të dytin e fillon;* nga të gjithë profetët Fjala Zot të preferonte ty,*¹⁹ tani çdo dukuri mbi dhé* ke kapërcyer, i nderuar je.

Tok me kore engjëjsh dëfrehet* shenjti që tregoi jetën pra* të bararat' me jetë të palëndësh lart* dhe ka gaz duke qenë pranë fronit zotëror me ta.* Kërkon për sa e lavdërojn'* falje për fajet si edhe shpëtim.

Hyjlindësore

Lindje njerëzore denjoi* dhembshurisht edhe u bë njeri* për hir të njerëzve, pra njeridashësi* nga natyra dhe Çlirimtari për të gjithë mirësisht* nga barku yt krejt virgjëror,* Vajzë e

tërëlum, hyjnë në je.

Zbritësore: O ton ipër nun

»O çudi pa fund e lindjes përmbi
»mendjen, nus' e ndritëshme dhe
»Nën' e lavdëruar, me të cilën kemi
»marr' shpëtim të plotë, pra për
»mirëbërjen të duartrokasim dhe
»këndime përhirimi të blatojmë.*

Dërgimësore e shenjtit

Jinekes akutisthite

Të shpalli Zoti ty profet* të lartë
përmbi çdo profet*^{19a} dhe më të
madhin ndër njerëz* që gratë lindën
mbi dhenë,*¹⁹ se ti atë që çdo pro-
fet* edhe Ligji e parathan'* Krishtin
Zot, ti e pe në mish,* ndaj duke e pa-
gëzuar* u shfaqe pra më i çmuar.

E së kremtes

Epesképsato imas

Shpëtimtari na u shfaq,*⁹ pra Hiri,
e vërteta krejt,* brenda Jordanit në
rrëke,* sa flinin pra në terr, në hi,*
këta i shndriti⁴⁴ me shkëlqim,* se-
pse erdhi, u shfaq te ne drita që s'ka
afirim.²¹

6 Lavdërime Idhiomele

Ting. I Të Gjermanoit

Dritë prej drite shkëlqeu në botë
Krishti, Perëndia ynë që u faneps;⁹
atij, o popuj, le t'i falemi.*

(2x)

Si të të nderojmë, o Krisht, si të ka

hije, ne shërbëtorët, ty Zotin? Se na
përsërite ndër ujëra të gjithë ne.*

Ti, o Shpëtimtari ynë, kur u pagë-
zove në Jordan, shenjtërove valët,
i dorëvënë prej pëllëmbës së shër-
bëtorit dhe duke shëruar pësime të
botës. I madh është misteri i ekono-
misë⁹ sate, o Zot njeridashës, lavdi
më ty.*

Drita e vërtetë u shfaq¹ dhe u fal-
ndriçim të gjithëve. Pagëzohet me
ne Krishti, që është përtej çdo pas-
tërtie; hedh shenjtërimin te uji dhe
bëhet spastrim' i shpirtave⁶⁰ tanë.
Fenomeni është i dhëshëm, po kon-
cepti është përmbi qiejtë; me larje
shpëtim,⁶¹ me ujë shpirt,⁶² me zhytje
në ujë bëhet ngjitja jonë te Perëndia.
Të çuditshme janë veprat e tua,⁶³ o
Zot, lavdi më ty.*

I njëjti I Andrea Jerusalemasit

Ai që vesh qiellin me re,¹³ mbështillet
sot me valët e Jordanit, dhe mbaron
spastrimin tim ai që ngre mëkatin e
botës;² dhe prej Shpirtit lartazi dësh-
mohet si Bir i vetëmlindur i Atit⁵¹ të
lartë; atij le t'i thërresim: O Krisht
Perëndia ynë që u faneps⁹ dhe na
shpëtove, lavdi më ty.*

Lavdi

Ting. Tërth. II I Bizantit

Engjëll²⁹ nga dhimbjet e lindjes së
shterpës dole, o Pagëzor,⁶ dhe si ba-

nove në shkretëtirë që nga shpërgënjtë, vula e të gjithë profetëve u tregove;⁴² sepse atë që ata panë me mënyra të shumëllojshme dhe e parashpallën enigmatisht, u vlerësove ta pagëzosh në Jordan; dhe dëgjove zë atëror nga qielli, i cili dëshmonte se ishte Biri; dhe e pe Shpirtin në formë pëllumbi që shtrinte zërin mbi të pagëzuarin; pra, o më eprori i të tërë¹⁹ profetëve, mos pusho së ndërmjetuari për ne që besërisht kryejmë kujtimin tënd.

Tani

Ting. II I Anatoliut

Sot Krishti erdhi në Jordan për t'u pagëzuar. Sot Joani prek kryet e Zotit. Fuqit' e qiejve u shtangën⁶⁴ duke parë misterin e mahnitshëm.⁶⁵ Deti pa dhe iku, Jordani duke parë kthehej prap',¹⁷ dhe ne të ndriçuarit thërresim:

Kori A: Lavdi Perëndisë që u faneps⁹ dhe u pa mbi dhënë, e ndriçoi botën.^{1*}

Dhe vazhdimi i Dhoksologjisë së Madhe (dmth. nga Vargu i dytë).

Në Liturgji, Antifonet e së kremtes dhe Hyrtorja e saj. Në vend të Trishenjtit, Sa u pagëzuat. Në vend të Të meriton, O shpirt, madhështoje Zonjën e nderuar; O çudi pa fund. Kungatore: Në kujtim të përjetshëm. Në vend të Pamë dritën, Në Jordan kur pagëzoheshe.

CITIME

¹ Joan 1.4,9; 8.12; 9.5

² Is. 53.4,7; Joan 1.29,36

³ Ps. 17(18).10; 143(144).5

⁴ Joan 1.37

⁵ Joan 5.35

⁶ Lluk. 1.7,36

⁷ Joan 3.29

⁸ Lluk. 1.44

⁹ Ps. 117(118).27; I Tim. 3.16

¹⁰ Est. 4.17b

¹¹ Is. 6.2

¹² II Kor. 8.9

¹³ Ps. 146(147).8

¹⁴ Ps. 73(74).15; 103(104).10; 106(107).35; 113(114).8; Is. 41.18

¹⁵ I Tim. 6.12

¹⁶ Matth. 25.1-10

¹⁷ Ps. 113(114).3,5

¹⁸ Fja. Urt. 10.7

¹⁹ Matth. 11.11; Lluk. 7.28

^{19a} Matth. 11.9; Lluk. 7.26

²⁰ Matth. 14.4-10; Mark. 6.18-28

²¹ I Tim. 6.16

²² Matth. 14.30

²³ Lluk. 1.5-20

²⁴ Lluk. 4.1; Vep. 6.3,5; 7.55; 11.24

²⁵ Jer. 1.5; Gal. 1.15

²⁶ Eks. 14.29 etj.

²⁷ Ps. 117(118).16

²⁸ Is. 40.3; Matth. 3.3; Mark. 1.3; Lluk. 3.4; Joan 1.23

²⁹ Mal. 3.1; Matth. 11.10

³⁰ Hebr. 1.3

³¹ Mal. 4.2 (3.20); Is. 61.11

³² I Mbret. [Sam.] 2.2

- 33 I Mbret. [Sam.] 2.1
34 Is. 53.9; Joan 8.46; I Petr. 2.22
35 Matth. 3.2
36 Fil. 2.6-7
37 Gjen. 1.26-27; 5.1; 9.6; Urt. Sol. 2.23; Sirak 17.3
38 Abak. kap. 3
39 Is. 26.13
40 Gjen. 1.3-24; Ps. 148.5
41 Rom. 5.10; II Kor. 5.18-20; Ef. 2.15-16
42 Matth. 11.13; Lluk. 16.16
43 Ps. 109(110).3
44 Is. 9.2; Matth. 4.16; Lluk. 1.79
45 Apok. 21.25; 22.5
46 Ps. 45(46).6
47 Gjen. 3.8
48 Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 28
- 49 III [I] Mbret. 17.1; 18.18
50 III [I] Mbret. 19.8
51 Joan 1.14,18; 3.16,18; I Joan 4.9
52 Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 23-25
53 Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 34
54 Joan 1.1
55 Kol. 1.15
56 Rom. 8.21
57 Lluk. 16.8; Joan 12.36; I Thes. 5.5
58 Ef. 6.12
59 Joan 1.17
60 Jez. 36.25
61 Tit. 3.4-6
62 Vep. 1.5
63 Ps. 76(77).12,14-15; 85.10
64 Jer. 2.12
65 Lluk. 5.26



E DIELA PAS THEOFANISË

Të shtunën në Mbrëmësore, pas Katholicës së Parë të Psaltirit, Thirrtoret: 6 të tingullit dhe 4 të së kremtes (Dritën ton' fq. 90). Lavdi O Zot, duke dashur (Kërkoje në Lavdi i Litisë fq. 108) Tani Hyjlindësore dogmatike e tingullit. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi dhe Tani Sot Krijesa ndriçohet (Kërkoje në Tani i Litisë fq. 108). Përlëshoret: ngjallësore dhe e së kremtes. Përlëshim: Ai që denjoi të pagëzohet prej Joanit në Jordan për shpëtimin tonë dhe u ngjall prej së vdekurish, Krishti...

Të dielën, në Shërbesën e Mesnatës, në fund Përlëshorja e së kremtes. Në Mëngjësore, Ndenjësore ngjallësore dhe në vend të Hyjlindësoreve, Ndenjësoret e së kremtes. Kanunet: ngjallësor dhe i pari i së kremtes. Pas Odes III, Ndenjësore Paskremtoje. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia ngjallësore dhe Sinaksari. Zbritësoret Shkoj nëpër detin; dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor. Më të nderuarën. Dërgimësoret: ngjallësore dhe e së kremtes. Lavdërimet: 4 ngjallësore dhe 4 të së kremtes (me Vargje në dy të fundit Deti pa dhe iku, Jordani u kthye mbrapa, dhe Ç'është me ty, o det, që ike, dhe ti, o Jordan, që u ktheve mbrapa?) Eothinoni. E Përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji Antifonet e së kremtes, por në Hyrje: ...Shpëtona..., që u ngja-

lle prej së vdekurish. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore, e së kremtes dhe e kishës. Kontaqi: U fanepse. Trishenjti, Apostulli dhe Ungjilli i së Dielës pas Theofanisë. Të meriton. Kungatore Lavdëroni. Pamë dritën.



MË 8 TË TË NJËTIT MUAJ

Kujtimi i atit tonë oshënar Gjergji Hozeviti dhe i nënës sonë oshënore Domnika.

NË MBRËMËSORE

Thirrtoje të oshënarit

Ting. IV Os jeneon en mártisin

Akropolin e shpirtit tënd* nuk e tundën, i lumur Gjergj,* sulme nga mendimet, se shfaqe si beden* asketizim të qëndrueshëm, e ruajte veten ti* pa dëmtim, pa ndonjë plag'* prej armikut të hidhur vrer,* dhe qëndrove pran'* Perëndisë të Gjithësisë, ndaj si fitimtar me lavd të madh je kurorëzuar dhe me triumf.

Gjatësia e udhës dhe* ashpërsia e trevave* mallin tënd si zjarr s'mundën ta paralizojn'* në ecjen tënde drejt Perëndisë, kur more rrugën ti,* në këtë vend ku dikur* shkelën këmbët e Zotit Krisht,*¹ nuk përtove kurr'* të shkosh me shumë mund e asketizëm në Sionin qiellor,² pra në

mbretërinë e sipërme.

Lage tokën me lot rrëke,* dashurinë që zemra kish* na e shfaqe, atë, kështu me kataniks,* edhe me flokët nënkëmbësen e Zotit e fshije³ krejt;* e mendoje si prezent,* që të shihte, ai që ti* dëshirove fort;* mendërisht kape gjurmët e tij përmes teorish hyjnore, o i lavdishëm, dhe shndrite-she në shpirt.

Të oshënares: Edhokas simiosin

Linde që nga Lindja dhe në Perëndim shkove porsi yll* vezullues; shkëlqeve fort* me rrezet e punëve* të virtytshme, nënë* oshënare tepër e pasur, llamburite ti* mendje besnikësh me shenja e çudi* që shndritin, ndaj të lumërojmë, lartësojmë kujtimin tënd,* madhërojmë dhe Krishtin Zot,* që me nder të lëvdoi ty.

Të plagosi dashuria,⁴ mallëngjimi për Krishtin Zot,* o Domnika me nam të madh;* e ndoqe atë, pasi* e mohove lavdin* e pavlerë edhe të ulët, çdo kënaqësi në jetë dhe çdo shijim, çdo epsh në mish,* prandaj në dhomë plot me dritë të vendosi Jisui yt* njeridashës, i ëmbli Krisht,* Shpëtimtari i shpirtave.

Brenda teje rigatoje ti pësimet e Bërësit,* Zotit tënd, u dallove pra* porsi një krijim logjik* që formoi Fjala,* dhe përmes saj, o virgjëreshë,

korrigjoje drejt* çdo devijim, marrëzi që vesi sjell;* ndaj sipas shëmbëllimit⁵ shkove drejtpërdrejt dhe kështu u pe* zbukurim, hir autentik,* i vërtetë, zëmadhe ti.

Lavdi *dhe* Tani

Ting. I I Andrea Jerusalemasit

Ai që vesh qiellin me re,⁶ mbështillet sot me valët e Jordanit, dhe mbaron spastrimin tim ai që ngre mëkatin e botës;⁷ dhe prej Shpirtit lartazi dësh-mohet si Bir i vetëmlindur i Atit⁸ të lartë; atij le t'i thërresim: O Krisht Perëndia ynë që u fanepse⁹ dhe na shpëtove, lavdi më ty.*

Pasvargje

Ting. Tërth. II E angjeliqé

O Jisui im, Zot, je vetvetiu drita* dritëdhënëse, çdo njeri e ndrit¹⁰ me dritën;* në pagëzim e ndrite* në rrëket' e Jordanit ti;* drita je e njëqenshme me Atin, dhe që prej saj shndrit çdo krijesë, o Krisht, dhe thërret:* Je i bekuar Perëndi i shfaqur,⁹ lavdi më ty.

Varg: Deti pa dhe iku, Jordani u kthye mbrapa.

Ejani të lajm' shqisat mendërisht që me lavd * fort të hyjshëm të ngopemi si përmes mishit* dhe kur të shohim Krishtin* pagëzimin në mish të marr',* kryet e të ligut t'i dërrmojë¹¹ me zgjuarsin, le t'i thërrasim me himne kështu:* Je i bekuar Perëndi i

shfaqur,⁹ lavdi më ty.

Varg: Ç'është me ty, o det, që ike, dhe ti, o Jordan, që u ktheve mbrapa?

Rrjedhje krejt jetike na jep, Zot, në Jordan ti* dhembshurisht, sepse jemi djegur fort nga etja* për ty, o njeridashës;* ndaj si pim' nga burimi yt* dritëdhënës edhe i pavdekshëm, o Krisht, të psalim që të gjithë me mall dhe hare:* Je i bekuar Perëndi i shfaqur,⁹ lavdi më ty.

Lavdi *dhe* Tani

Ting. II I Anatoliut

Kur të pa Joani te lumi Jordan të vesh te ai, thoshte: O Krisht Perëndi, përse erdhe te shërbëtori, o Zot, pa patur njollë? Dhe me emrin e kujt të të pagëzoj? të Atit? Po atë e ke me vete; të Birit? Po ai je vetë me trup; të Shpirtit Shenjt'? Po këtë vetë di t'ua japësh besnikëve me gojë,¹² o Perëndi që u fanepse,⁹ mëshirona.*

Përlëshore e së kremtes



NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësove
Ting. IV Kateplaji Iosif*

E kalonte popullin* në lumë brenda në Jordan* tok me Arkën e Zotit* Jisui që e kishte prind* Naviun,¹³ dhe mirëbërjen kështu skiconte,* që për-

mbushje pra në të ardhmen gjen.* Ky kalim mistik na ikonizon* në Shpirt një riformim dhe një rilindje* krejt të papërgënjeshtueshme.* U duk qart' Krishti * të shenjtërojë* në Jordan për ne ujin.

Lavdi *dhe* Tani

I njëjti

*Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësove
Ting. Tërth. IV Anéstis ek nekrón*

Jisui pagëzim merr, shkëlqen mbarë botën.*^{13a} Me zë dëshmoi Ati, nga lart tha:* "Ky është* Biri im që pëlqeva, atë dëgjoni, ai shndrit rruzullin."* Kur priti pagëzim shpëtoi porsi Perëndi me dhembshuri,* edhe çliroi gjindjen njerëzore. O Jisu, lavdi ty!

Lavdi *dhe* Tani

I njëjti

Kanunet: i së kremtes, i oshënarit dhe i oshënares.

Ode I

Kamuni i oshënarit

Ting. IV

Anikso to stoma mu

Fillimit të urtësisë, pra Jisuit, i lyp ti hir* që gojën ta çel, o Gjergj që ta këndoje denjësisht,* dhe pse s' kam dhunti* muzike, festën tënde,* kujtimin, me himne të hyjshme, me gaz t'i psal.

Jetove mbi dhé si i patrup, i madhi ti; që këtu* me koret e engjëjve pra u bashkove dhe psal* himnin trishenjt-or*¹⁴ për Bërësin Zot, ndaj pret* ndriçimin e tij që të bën të shkëlqyer fort.

Shpërfille krejt botën me mendime mbitokësore, Gjergj;* në tokën e Krishtit Zot, asketizove, pastaj* u shpërngule ti* në vend pa cen, u lidhe* me koret e të parë lindurve,¹⁵ o i urt’.

Hyjlindësore

Ja gojën e çel për ty, o e dëlirë, se desha fort* të të psal; urtin’ enipostate¹⁶ linde për ne;* por i ndotur jam,* të të himnoj s’kam forcë* siç duhet, kërkoj ndihmë pra, e kulluar krejt.

*Kanuni i oshënares, që ka Akrostihidhë:
“Fëmijën e bukur, Domnikën, tani e mburr. Josif”.*

Ting. II

En vithó katéstroke poté

I dhe krahë shpirtit me vullnet,* mall të perëndishëm, ti që ke lavdi,* fluturoje pra mbi çdo lak,* kurth mishor, Donika e thjesht’, ndaj lyp dhe me ndërmjetimin tënd më çliro* mua që si gjah u kapa brenda kurtheve të gjarprit djall.

Me gëzim e ndiqje Krishtin pas,* duke gjurmësuar ligjin krejt hyj-

nor;* u radhite me virgjëri* pa qortim, e tërëthjeshtë, me koret e virgjëreshave përgjithnjë,* ndaj të mbledhur të nderojmë me besim të admirueshmen.

Në të dëmshmin gjumë kurrë s’re,* por në vepra drite të shkëlqyer ti* e pafjetur u duke pra,* o e lavdëruar, dhe u shpërngule në dritë pa përrëndim aspak* të rrethojnë rreze prej andej; sa të himnojnë shndrit me to.

Hyjlindësore

E paprishur mbete mbi mendim,* e dëlirë para lindjes, dhe në të* dhe pas saj, shën Domnika pra* ty të dëshiroi, o nën’ e Zotit, në Shpirtin Shenjt; pa prishje u soll* i vjen mbra-pa teje Tërëmbretit,¹⁷ Birit tënd, o Zonjë që s’ke cen.

Ode III

I oshënarit: Tus sus innologus

Me lotët e tu u lave ti, e pastrove pra mishin nga çdo balt’,* ves tokësor edhe me to si rrjedhë lumi ke mbytur* me asketizëm vrullin, rrymën e demonëve, o shën Gjergj.

I drejtë dhe oshënar, pa njollë¹⁸ u shqove në sjellje, i hyjlum,* pa masë u ushtrove ti në lodhje e asketizim* si trashëgim jet’ pa mundim, ke marrë, o Gjergj i urtë fort.

Të kapi ty dashuri hyjnore për vendet e shenjta në Sion,* shkove, qëndrove pra atje, i tërëlumur përgjithnjë,* deri në vdekje, duke shtypur mishin tënd përmes lodhjeve.

Hyllindësore

Drejtoje himnuesin tënd, Vajzë, në rrugë pendimi, se kam faj* dhe mëkatova pa justifikim, ti linde Fjalën Zot,* në mbarë botën na pastron paudhësitë,¹⁹ hyjnë në, ky.

I oshënare: Eksínthisen i érimos

Lundruetit në det të madh* i shpëtove kur dërgove vaj në det ti me bekim,* e shndërrove shtrëngatën në bunac'* o nënë shën Domnika, që ke dhembshuri.

Me pamje drite engjëlli* ty të lajmëroi te kryepiskopi, kur erdhe* në qytet mbretëror me shenj' nga lart,* se feksje prej shkëlqimit jolëndor, hyjnor.

Me velin e përmbajtjes ti* si të fluturoje në mospasje vesesh; kur në port* pra mbërrite, u bëre si liman* për sa rrëshqitën thellë në të keqe, nën'.

Hyllindësore

Fuqi më jep në dobësi* ti që linde forcën e të Shumëlartit,²⁰ se ajo* ekzistencë u jep të gjithave* dhe madhëron kujtimin e Domnikës tok.

Irmosi: Eksínthisen i érimos

»**U**lulëzuasi zambak* shkretëtira,^{20a}
 »Kisha e gjith' kombeve që shterpë
 »ish,* me pranin' tënde, Perëndia
 »im;* në të u siguria zemra ime
 »fort.^{20b}

Ndenjësores e oshënares

Ting. IV Tahí prokatálave

Domnika, për Krishtin kishe ti dëshirë dhe zell,* për dhëndrin tënd, ndaj e kryqëzove mishin me veset,²¹ more kështu kuror'* paprishjeje²² që s'fishket;* tok me kor engjëllor lart* u numërove, nënë oshënare; mos hesht pra* për sa të lëvdojnë ndërmjeto, ti që ke lavdi.

Lavdi *dhe* Tani

I së kremtes I njëjti

O Krisht Perëndia ynë, shenjtërovet në lum'* rrëket' e Jordanit dhe dërmovet forcën e fajit kur e përkule ti* veten poshtë pëllëmbës* së Joan Pagëzorit,* gjindjen e njerëzisë e shpëtove nga rrengu;* shpëtoje pra botën tënde, të përgjërhem.

Ode IV

I oshënarit: O kathímenos en dhoksi

Duke u ushqyer me sedër, me keshmë si me gjellë, o i lumur, tani të dëfryer ia tregove shpirtin tënd Bërësit të të gjithave, që të ftoi të gëzuar drejt shijimit të hyjshëm, të sipërm.

Ushfaqe si qiell i shkëlqyer me punët si me yje, duke mbajtur si ndriçues Zotin që e llamburit shpirtin tënd si hënë dhe e tregon pjesëmarrës të lavdisë,²³ të cilën e ka pranë.

Duke zbritur Zoti për ne nga qielli, e gjen Sionin si dhomë²⁴ me të vërtetë të hyjshme; kur ti fushove në këtë me mallëngjim, e përdore si shkallë dhe u ngjite në Sionin e sipërm.²

Hyjlindësore

Ai që ulet gjithmonë në gjirin e Mbjellësit,²⁵ u pa të ulet tani pa u përshkruar në parakrahët e tu, pasi të tregoi ty lindësen pas lindjes gjithmonë të virgjër dhe vërtet të pa-prishur.

I oshënares: Elilithas ek Parthenu

Shkëlqeve ndriçim shërimesh duke dëbuar stuhinë e errët të pasioneve dhe kolonat e demonëve; dhe i llamburite të gjithë që të afrohen besërisht, o Domnika.

Dhëndër, mbret qiellor të lavdëron, o e lavdëruar, përballë atij që mbretëron mbi tokë, i cili habitet për jetën tënde të panjollshme dhe për çuditë e tua.

ODonika, Zoti, meqë dëgjon lutjet e tua, të sinjalizon që më parë qartazi një vend, ku ngrite më pas shkollë,

pasi i largove frymët e ligësisë.²⁶

Hyjlindësore

Me lindjen tënde hyjnore, Adami zhveshi këmishat e vdekjes²⁷ dhe veshi stolinë që pleksi vetëm Fjala, kur trupëzohej në barkun tënd.

Ode V

I oshënarit: Eksesti ta simpanta

Ushtangën engjëj dhe çdo bashkësi oshënarësh me të vërtetë, kur shikonin pathyeshmërinë e mundeve të tua dhe ashpërsinë e jetës, sepse ti kur lodheshe për të arritur virtyte ishe si gur pa jetë.

Ja ku në çdo shpirt shkëlqeu i tërëmadhi duke na mbushur të gjithë me derdhje drite dhe duke na çliruar nga stuhia e errët e pasioneve, dhe lëviz tani si diell tejet i pastër në lëvizje shpëtimtare.

Ubëre i huaj për atdheun tënd, o Gjergj i urtë, sepse deshe më shumë se të afërmit me lidhje gjaku, Krishtin,²⁸ i cili u bë i huaj për hir të njerëzve; pra ke qenë i denjë për të,²⁸ duke u vlerësuar për Hirin nga lart.

Hyjlindësore

Ezbukurove, o e pacenuar, tërësinë e të vdekatarëve, sepse ti u tregove më e gjerë se madhështia qiellore kur linde Fjalën Perëndi, i cili i tendosi qiejt si lëkurë²⁹ dhe gatoi njerëz.

I oshënares: O tu fotós horigós

Si kultivove dhe hape kanalin shpirtëror me parmëndën e lutjeve, shumë pjellor e korre frytin që ruhet në magazina të hyjshme, o e kulluar.

Duke e ndriçuar mendimin tënd të pastër, i shikoje me fuqinë e Shpirtit gjithëbërës të largëtat si të afërta, dhe parathoshe përfundimin e gjërave që do të ndodhnin.

Me fuqinë e Shpirtit një klerik të përsos me krezmin hyjbërës të shërbimit duke të urdhëruar të kullotësh shpirta të hyjnueshëm, o Domnika e hyjurtë.

Hyjlindësore

O Zotlindëse, ke lindur Zotin e shenjtë të gjithçkaje, të cilin e deshte nga shpirti Domnika, ndaj sundon absolutisht mbi pasione prishëse, duke të himnuar, o e Virgjër.

Ode VI

I oshënarit: Evóise protipón

I thirre fort* Perëndisë me lot pa pushim si shi;* nga kjo jetë* të shpëton, si prej peshku të madh plot tmerr* në burim pa dallgë* të çon, ku rrjedh gjithnjë hyjnizim, shpëtim.

Të bëri ty,* o i lum, kor virtytesh, si mur katror* të patrembur* nga shigjetat e djallit, armik mendor,* por ti je i fortë,* ndaj dhe je fitimtar mbi

ngacmuesin.

Në vend të shenjt'* shpejt vrapove si qengj, pra në Hozeva,* dhe praktikën* e përdore si shkop,³⁰ në Eden me të* i drejtove delet* që banonin atje për ushtrim,virtyt.

Hyjlindësore

Në barkun tënd* si njeri Zoti ndenji, shpërfilli tej,* e dëlirë,* çrregullsitë dhe shkeljet që bëra un',* ndaj më denjësoi* për amshimin në tenda që s'prishen kurr'.

I oshënares: En aviso ptesmaton

Ngrite tempull të hyjshëm dhe profetik* të profetit shenjt, hyjmen-dës Zaharia ti;* me të, Domnika e hyjurt',* po kërcen brenda tempullit qiellor.

U pe rrymë e bollshme shërimesh, rrjedh'* që lan zjarr pësimesh edhe shenjtërim buron,* o vajz' me emër zotëror,* virgjëreshë hyjnuse, e pastër je.

Dhëndri yt, Zoti, o e kënduar fort,* pranë tij të merr e fut,³¹ sepse e mirë je,* e bukur³² dhe e ndershme ti,* dhe shkëlqen me ndriçim virgjërie fort.

Hyjlindësore

Porsi foshnjë si unë u bë për ne,* o e Tërëshenjt' hyjnuse, i përsosuri;* përmes teje më rinovon* mua që u

vjetrova në huq e ves.

Irmosi: En aviso ptesmaton

»Nga avushë mëkatesh rrethohem
»un',* ndaj thërras pafundësin' e
»mirësis' që ke,* e cila s'gjurmësohet
»dot;* lutem, nxirrme nga prishja, o
»Zoti im.³³

Kontaqi i së kremtes

Sinaksari

Më 8 të të njëjtit muaj, kujtimi i nënës sonë oshënare Domnika.

Vargje: Sapo e la tokën Domnika qiellmendëse,/ u ngjit në qiej, si dëshi.

Domnikën e mori në të tetën natë e errët vdekjeje.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atit tonë oshënar Gjergj Hozeviti.

Vargje: Për Gjergjin që mbolli me lot/ është koha të korrë me kënaqësi.³⁴

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirëve të shenjtë Julianit dhe Vasilisës, dhe atyre që ishin me ta, Kelsit dhe Andonit.

Vargje: Për Julianin dhe Vasilisën që dergjen nga shpata,/ dergjen shumë çmime.

E pret shpata kreun e Kelsit/ dhe bashkë me këtë kre, edhe atë të Andonit.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i hieromar-

tirit të shenjtë Karteri.

Vargje: Mundu, o Karter, kundër zjarrit dhe shtizës,/ duke treguar durimin tënd në këto dy mundje.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atit tonë ndër shenjtorët Kirit, kryepiskopit të Konstandinopojës. Mbledhja e tij bëhet në Manastirin e nderuar të Horas dhe në Kishën e Madhe ditën e diel.

Vargje: O Krishti im, Kiri që copëtonte mishin tënd,/ sapo u nda nga mishi qëndron pranë fronit tënd.

Në të njëjtën ditë, shën Atiki, patriarku i Konstandinopojës, mbaron në paqe.

Vargje: Sapo kapërceve lëndën e tërë të mishit/ arrin, o Atik, i tëri si mendje, drejt Mendjeve.

Në të njëjtën ditë, profeti i shenjtë Samea Elamitasi, mbaron në paqe.

Vargje: Samea nuk jep më në tokë orakull për të ardhmen,/ sepse është lart ai, trekëmbëshi profetik.

Në të njëjtën ditë, shën Agathoni mbaron në paqe.

Vargje: Sa u preha në shpirt, o Agathon,/ edhe vetem kur kujtova fundin tënd paqësor.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirëve të shenjtë të Krishtit Theofilit dhjak dhe Eladhit laik.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martires së re Parthena.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atit tonë oshënar Makar Makrisi nga hebrëjtë.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirit oshënar Grigor Çudibërësit, në Lavrën e Shpellave të Kievit.

Me ndërmjetimet e tyre të shenjta, o Perëndi, mëshirona dhe shpëtona. Amin.

Ode VII

I oshënarit: Uk elátrefsan

Nuk u epe te mendimet satanike kur shtypeshe prej lodhjeve të asketizmit; se meqë nuk kishe mendje endacake, por të drejtuar te Zoti që mund të shpëtojë,³⁵ hodhe poshtë çdo sulm.

Vrave të gjitha gjymtyrët e tua mbi tokë³⁶ me fjetjet përtokë, me agripnitë dhe kreshmët e tua; dhe tani jeton jetën e pacenuar dhe të palodhshme, o i lumur, duke lypur për ne që të himnojmë me mallëngjim.

Dëshirove tej mase ta shikosh dhe t'i falesh varrit të të Qenit³⁷ gjithmonë, o i urtë; dhe kur shkove në të, e mendove si diçka të mirë, që nëpërmjet asketizmi, të vdesësh tok me atë që vdiq nga dhembshuria, o

oshënar.

Hyjlindësore

Nuk adhuruan Krijesën ata që të njohën ty të kiske në bark Ndërtuesin, por duke e ditur Perëndi³⁸ të vërtetë Fjalën që shkëlqeu prej teje, o Vajzë, thërrasin: O Zot dhe Perëndi i etërve, i bekuar je.³⁹

I oshënares: Antítheon próstagma

Mendja jote u bë dritëpamëse, duke u hyjnizuar përherë në saje të prirjes drejt Hyjnisë; si rrjedhim e shmange dashligësinë e mishit duke psalur, o e hyjurtë: Je i bekuar dhe i përmbilavdëruar.

Perëndi i përmbisubstancshëm, i prehur në ty, të zbulon mistere hyjnore, sepse sheh një engjëll të shenjtë që erdhi dhe shenjtëroi natyrën e ujërave në Shpirt, o modeste.

Meqenëse u bërë tempull i Shpirtit Hyjnor,⁴⁰ duke qenë në kishën e shenjtë, dëgjove një zë të të mësonte mistere hyjnore dhe largimin e mbretit nga trupi, o e thjeshtë.

Hyjlindësore

Fuqia, himnimi dhe shpëtimi im është Zoti,⁴¹ që të parazgjodhi ty si nënë të tërëkulluar dhe nuse të panusëruar; mos resht së ndërmjetuari gjithnjë tek ai për shërbëtorët e tu, o e pacenuar.

*Ode VIII**I oshënarit: Pedhas evajis*

Nuk u dhe aspak dremitje qepallave të tua, as gjumë syve të tu, o atë, derisa e punove veten si tendë të përshtatshme dhe të bukur të të Gjithëpushtetshmit,⁴² të cilin e himnojnë dhe e përmbilartësojnë tërë veprat në gjithë jetët.⁴³

E gjete prehjen⁴⁴ e mundimeve të panumërta, o i tërëlumur, Parajsën, të cilën parapërgatiti Zoti⁴⁵ si mbretëri të përbashkët për ata që e dëshiruan fort me shpirt dhe thërrasin pa pushim: Himnojeni dhe përmbilartësojeni Krishtin në jetët.⁴³

Të gjeti manastiri i Hozevasë ty si kanun dhe shembull tepër të përpiktë, që përdor çdo lloj vepre të virtytshme, o mburrje oshënarësh, Gjergj i urtë; për këtë, pasi jetuan përrëndishëm, kërcejnë me ty në gjithë jetët.

Hyjlindësore

I thjeshti në natyrë hyjnore u pa prej teje, o Hyjnënë, vërtet i kombinuar nga mëshira e parrëfyeshme, si e vendosi në Hyjninë e tij mishin nga gjaku yt; prandaj duke të njohur Perëndilindëse, të përhimnojnë në gjithë jetët.

I oshënares: Ton en kamino tu pirós

E stolitur me viryte dhe e hijeshuar

me xhufkë⁴⁶ mrekullish, rende lart drejt nusërores³¹ së bukur të mbretit Krisht, o Domnika, duke psalur dhe duke e përmbilartësuar në jetët.

O shqerrë e çmuar që shkove pas Krishtit,⁴⁷ pas bariut të pastër,⁴⁸ fushove, o e shenjtë, në avllinë⁴⁹ qiellore ku jetojnë bashkë delet e shquara me ngazëllim.

Kur mësove me shenjen gjithëbërëse të Perëndisë lënien e tendës sate, i sillje me shpirt tepër të pastër himn mirënjohës Shkakut të të gjithave, në duart e të cilit dorëzove shpirtin tënd.⁵⁰

Hyjlindësore

Perëndia i përmbisubstancshëm, merr esencë për hirin tonë nga të përbrendshmet e tua, duke kërkuar të të ripërtëritë nga keqardhja dhe përdëllimi esencën e prishur, i lavdëruari në gjithë jetët.

Irmosi: Ton en kamino tu pirós

»**A**të që zbriti në kamin',* që të »ishte tok me Djemtë e hebrenjve,* »Perëndinë që ktheu në vesë flakë »dhe zjarr*⁵¹ himnojeni vepra, se »është Zot,* përmbilartësoni atë në »gjithë jetët.⁴³

*Ode IX**I oshënarit: Apas jjenis*

Atë i mahnitshëm e ke shpërfillur

çdo shijim në jetë ti* për lavd qiellor, shijim,* me lot të shumtë edhe me keqtrajtim* luftove që ta shuash furrën e pasioneve,* Gjergj i çmuar,* zbukurim i murgjve je* dhe stoli e të gjithë asketëve.

O i tërëurt' tani ti vërtet përballë Perëndisë rri,* që nxitove ta fitosh* që më përpara me asketizmin tënd* dhe qart' shijon shkëlqimet e atij, na jep ndriçim* ne të gjithë* që të përhimnojmë ty* dhe në gjërat hyjnore dhuro kungim.

Pasi ke shpëtuar prej errësirës që ka jeta, o zëmadh,* dhe rri pranë Perëndis'* tridiellor të Gjithëpushtetshëm Zot,* në rresht të sipërm, o i lum, edhe shijon dritën* që dërgohet* prej andej, shkëlqena ne* që ty të himnojmë me gaz dhe zell.

Hyjlindësore

Donte Perëndia mua të tërin të më hyjnizonte krejt,* ndaj me ty bashkohet ky* i tëri, dhe mister i ri që s'e njeh* askush aspak, çuditërisht zë fill; pa prishje lind* virgjërisht ti,* shfaqet Zot me mish,⁹ Mariam;* ne e mburrim dhe siç the, të lumërojm'.⁵²

I oshënares: Ton ek Theú Theón

Kore të shenjta i panë të pranishmit në fjetjen* tënde fort të nderuar; me psalmim* e melodi paraprinin,⁵³ me

hymn* shpirtin tënd e drejtonin në tendë madhështore ku jehon,* o e famshme, një zë prej atyre që kremtojn'⁵⁴ me gaz.

U shfaqë degë pjellore dhe e shenjt' e hardhisë;*⁵⁵ mbive bistak ti shenjtërisht për ne,* o shën Domnika, që verë buron,* që shëron shpirtrat edhe dëfren çdo zemër⁵⁶ të himnuesve* që me bes' të nderojnë dhe kataniks në shpirt u sjell.

Me ndërmjetimet e tua, o Domnika, shpëtona* nga çdo pësim trupor dhe njoll' në shpirt,* nga çdo kurthim i armikut dinak* ne që nën strehën tënde me mall përikim dhe kremtojmë pra* festën tënde të hyjshme, si dhe të respektuar fort.

Të lavdërojmë të gjithë si një turtull të zgjedhur,* si reze diellore që ndriçon* çdo njeri pors i ullinj, kedër ti,* dhe si nuse të bukur të Krishtit, si një pëllumbesh' të thjesht',*⁵⁷ o Domnika, që emri yt ka kuptimin "zotëror".

Hyjlindësore

Për mua, Zot, të të vijë keq kur të më gjykosh ti* kurrë mos më dëno mua në zjarr,*⁵⁸ në zemërimin tënd mos më qorto⁵⁹* fort të lyp Virgjëresha që ty të mbajti kur shtatzënë ish,* tërësi engjëjlore, rreshtime oshënarësh tok.

Irmosi: Ton ek Theú Theón Logon

»**T**a madhështojmë me një zë, o
»besnikë, me himne* Fjalën e Pe-
»rëndisë, Zotin⁶⁰ Krisht,* që pa rrë-
»fyer ka marrë për ne* mish nga
»Nëna e virgjër, e shenjtë; vjen të
»rinovojë pra* krejt Adamin, që kur
»hëngri,⁶¹ ra në prishje mizorisht.

Dërgimësore

Epesképsato imás

Tokësoret i përbuz,* e thjeshtë, me-
që vyshken shpejt,* me zell si zjarr
për Krishtin tënd;* i dëshirove qiejt
lart,* atje nuk priset kurrë gjë,*
kurore të paprishur pra Zoti ty të
dhuron.²²

Dhe e së kremtes

Pasvargje

Ting. II Ikos tu Efrathá

Kryhet mister i madh,* i frikshëm,
pagëzohet* Zoti i Gjithësisë* prej
dorës së një robi* për larjen e të
vdekshmëve.

Varg: Deti pa dhe iku, Jordani u kthye
mbrapa.

Ati thërriste lart:* Ai që pagëzohet*
im Bir i dashur është,* tani me mish
në rrjedhat* dhe rrymat e Jordanit
hyn.

Varg: Ç'është me ty, o det, që ike, dhe
ti, o Jordan, që u ktheve mbrapa?

Zotin me robërit* kur panë të ngja-

sojë* rreshtimet engjëllore,* në rrje-
dha të pagëzohej,* himnonin me çu-
di e tmerr.

Lavdi *dhe* Tani

I ngjashëm

Erdhi drejt në Jordan* ndriçimi dhe
çlirimi,* të mblidhemi për festën*
me hijeshi, për larje* dhe për pa-
strim, ju ejani.

Dhe të tjera si zakonisht.

CITIME

¹ Ps. 131(132).7

² Gal. 4.26

³ Lluk. 7.38,44; Joan 11.2; 12.3

⁴ Kënga 2.5; 5.8

⁵ Gjen. 1.26-27; 5.1; 9.6; Urt. Sol.
2.23; Sirak 17.3

⁶ Ps. 146(147).8

⁷ Is. 53.4,7; Joan 1.29,36

⁸ Joan 1.14,18; 3.16,18; I Joan 4.9

⁹ Ps. 117(118).27

¹⁰ Joan 1.4; 8.12

¹¹ Gjen. 3.15

¹² Gjen. 2.7

¹³ Jis. N. 3.15-17

^{13a} Joan 1.4,9; 3.19; 8.12; 9.5; 12.46

¹⁴ Is. 6.3

¹⁵ Hebr. 12.23

¹⁶ I Kor. 1.24,30

¹⁷ Ps. 44(45).15

¹⁸ I Thes. 2.10

¹⁹ I Joan 1.7,9

²⁰ Lluk. 1.35

- 20a Is. 35.1-2
 20b I Mbret. [Sam.] 2.1
 21 Gal. 5.24
 22 I Kor. 9.25
 23 I Petr. 5.1
 24 Ps. 131(132).14
 25 Joan 1.18
 26 Ef. 6.12
 27 Gjen. 3.21
 28 Matth. 10.37
 29 Ps. 103(104).2
 30 Ps. 22(23).1,4
 31 Matth. 25.10
 32 Kënga 6.4
 33 Jona 2.7
 34 Ps. 125(126).5
 35 Hebr. 5.7
 36 Kol. 3.5
 37 Eks. 3.14
 38 Rom. 1.25
 39 Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 2
 40 I Kor. 6.19
 41 Ps. 117(118).14
 42 Ps. 131(132).4-5
 43 Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 34
 44 Matth. 11.29
 45 Matth. 25.34
 46 Ps. 44(45).10,14
 47 Joan 10.4,27
 48 Zah. 13.7; Matth. 26.31; Mark. 14.27;
 Joan 10.14; Hebr. 13.20; I Petr. 2.25
 49 Joan 10.16
 50 Lluk. 23.46
 51 Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 25
 52 Lluk. 1.48
 53 Eks. 15.20-21
 54 Ps. 41(42).5
 55 Joan 15.1,5
 56 Ps. 103(104).15
 57 Kënga 2.10,13
 58 Matth. 13.41-42; 25.41
 59 Ps. 6.2
 60 Joan 1.1
 61 Gjen. 3.1-6



MË 11 TË TË NJËJITIT MUAJ

Kujtimi i atit tonë oshënar Theodhos Qinovjarkut.

Tipikon

Nëse bie e shtunë, thuhet Apostulli i oshënarit dhe Ungjilli i së Shtunës pas Theofanisë.

Nëse bie e diel (pas Theofanisë), të shtunën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 4 ngjallësore, 3 Paskremtore (Shih si jam i veshur: Pasvargjet e sotme, por me vargjet e Thirrtoreve) dhe 3 të oshënarit. Lavdi Paskremtor (I ule kryet Pararendësit: Tani i Thirrtoreve). Tani Hyjlindësore dogmatike e tingullit të javës. Hyrja. O dritë gazmore. Proqimëni. Leximet e oshënarit. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi i oshënarit dhe Tani që pason (Paskremtor). Përlëshoret ngjallësore, e oshënarit dhe e së kremtes.

Të dielën, në Shërbesën e Mesnatës, në fund Përlëshorja e së kremtes. Në Mëngjesore, pas Stihologjisë së parë dhe të dytë, nga 2 Ndenjësore ngjallësore dhe 1 e së kremtes në vend të Hyjlindësoreve. Pas Polieleit, Ndenjësore (pas Polieleit) e oshënarit dhe Paskremtore e tij. Bekimtoret. Ipakoia. Shkallesat dhe Proqimëni i tingullit. Kanunet: ngjallësor, një i së kremtes dhe i oshënarit. Pas Odes III, Ndenjësore e oshënarit dhe Paskremtore e tij. Pas Odes VI, Kontak, Shtëpia ngjallësore dhe Sinaksari i ditës. Zbritësoret Shkoj nëpër detin; dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor. Më të nderuarën.

Dërgimësoret: ngjallësore, e oshënarit dhe Paskremtore e tij. Lavdërimet: 4 ngjallësore dhe 4 të së kremtes (6 janar) me vargje në dy të fundit a) Deti pa dhe iku; b) Ç'është me ty, o det, që ike, (kur festohet më madhërisht oshënarit, në vend të Lavdërimeve të së kremtes, psalen ato të oshënarit). Lavdi Eothinoni. Tani E përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji, Tipiket dhe Lumërimet: 4 të tingullit dhe 4 nga Ode VI e Kanunit të së kremtes. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore, e së kremtes, e oshënarit dhe e kishës. Kontak i së kremtes. Apostulli i oshënarit dhe Ungjilli i së Dielës pas Theofanisë. Të meriton. Kungatore Lavdëroni. Pamë dritën.



NË MBRËMËSORE

Pas Qëndrimit të parë të Psaltirit (Lum ai njeri),

Thirrtoret Të Theofanit

Ting. Tërth. I 'Osie pater

Atë hyjprurës Theodhos oshënar famëm madh,* në jetën e përkohshme luftove ashpër, me zell,* me himne, agripni dhe me kreshmë, prandaj* ishe për bindësit e tu shembull ti*¹ dhe tani kërcen tok* me të patrup në qiell,* dhe lavdëron Krishtin pa pushim,* pra Perëndinë prej Perëndis' çlirimtar,* që kryet uli posht* te Pagëzor Joani* kështu natyrën mbar' të ujit* shenjtëroi;* pra Fjalës

lutju, përgjëroju fort, o oshënar,* të dhurojë te Kisha e tij* bashkim mendjesh dhe paqe² dhe përdëllim të madh.^{2a}

(2x)

Atë hyjprurës Theodhos oshënar të gjeti,* siç deshi ty me zemër të pastër Hiri hyjnor* i Shpirtit Tërëshenjt' dhe fushoi më ty* si drit' pa cen; me energjinë e saj* je lëvduar hirshëm,* dhe lavdëron pa hesitur* në dy substanca një Bir, Krishtin* që pagëzohet prej dorës së Prodhromit* edhe dëshkohet nga* zëri i Atit të tij,* edhe dërrmon në lum' dragonjtë* e padukshëm;* atij pra lutju, përgjëroju fort, o oshënar,* të dhurojë te Kisha e tij* bashkim mendjesh dhe paqe² dhe përdëllim të madh.^{2a}

(2x)

Atë hyjprurës Theodhos oshënar, natyrisht,* për jetë fort të lumur u vlerësove, sepse* e gjete me ushtrimin, dëlirësinë;* shkove në jetën lart kur ende rroje,* si i përshëndete* të gjitha; edhe po psal* me të patrupët ti pa pushim*³ për Krishtin që nga e Virgjëra mori mish* pashprehshëm në Jordan* në rrjedhë mbyti fajet,* mëkatin ton' me pagëzimin* prej Joanit,* atij pra lutju, përgjëroju fort, o oshënar,* të dhurojë te Kisha e tij* bashkim mendjesh dhe paqe² dhe përdëllim të madh.^{2a}

Lavdi

Ting. II I Anatoliut

O atë oshënar, dëfryen shpirtin tënd të hyjshëm si qytet të Perëndisë të gjallë⁴ vrullet e lumit⁵ të ujit të faljes,⁶ që kaloi Jordanin dhe u buroi gjithë anëve fjalën e shpresëtarisë, pra të Krishtit Perëndi; atij përgjëroju, o Theodhos i tërëlumur, që të shpëtojnë shpirtrat tanë.

Tani

I njëjti I Bizantit

Iule kryet Pararendësit, dërrmove krerët e dragonjve,⁷ qëndrove ndër valët, ndriçove Gjithësinë që të të lavdërojë, o Shpëtimtar, ty, dritën e shpirtrave tanë.*

Hyrje. O dritë gazmore. Proqimëni i ditës dhe Leximet.

Këndimi i Urtësisë së Solomonit

(3.1-9)

Shpirtrat e të drejtëve janë në dorë Perëndie dhe nuk do t'i prekë torturë. U dukën në sytë e të pamendëve se vdiqën dhe u konsiderua keqtrajtim dalja e tyre dhe ecja nga ne dërrmim, por ata janë në paqe; sepse edhe nëse para faqes së njerëzve do të ndëshkohen, shpresa e tyre është plot pavdekësi; dhe pasi do të edukohen me pak mundime, do të fitojnë mirëbërje të mëdha, sepse Perëndia i provoi dhe i gjeti të denjë për veten. Si ar në shkritore i provoi

ata dhe si holokaust flijimi i pranoi ata; dhe në kohën e shqyrtimit të tyre do të ndriçojnë dhe si shkëndija në kallam do të vrapojnë. Do të gjykojnë kombe dhe do të sundojnë popuj, dhe do të mbretërojë në ata Zoti ndër shekuj. Ata që kanë besim në të do të kuptojnë të vërtetën dhe besimtarët me dashuri do të qëndrojnë me durim pranë tij, sepse ka hir dhe mëshirë ndër oshënarët e tij dhe mbikëqyrje mbi të zgjedhurit e tij.

Këndimi i Urtësisë së Solomonit

(5.15-23; 6.1-3)

Të drejtët jetojnë përjetë dhe në Zotin është paga e tyre, dhe përkujdesja e tyre pranë të Shumëlartit. Për këtë do ta marrin mbretërinë e hijeshisë dhe kurorën e bukurisë nga dorë Zoti, sepse me të djathtën do t'i mbulojë dhe me krahun do t'i mbrojë. Do të marrë si armatim zellin e tij dhe do të mobilizojë me armë Krijesën për mbrojtje armiqsh. Do të veshë si korracë drejtësi, dhe do të veshë si helmetë gjykim pa hipokrizi. Do të marrë si mburojë të pamposhtur oshënarí dhe do të mprehë zemërim të prerë për shpatë; dhe do të bashkëluftojë me atë bota kundër të marrëve. Do të ecin suksesshëm tek qëllimi predha rrufesh, dhe si nga një hark i plotë rrethi nga retë do të hidhen në shenjë dhe nga ze-

mërimi që hedh gurë do të hidhen breshëri të plota. Do të indinjohet kundër tyre ujë deti, ndërsa lumenj do të përmytin papritur. Do t'u kundërvihet atyre erë fuqie dhe si stuhi do t'i ajrojë ata si grurë, dhe do të shkretojë gjithë dheun paligësi dhe keqbërje do të përmbysë frone dinastish. Dëgjoni, pra, o mbretër, dhe bëhuni të mençur, mësoni, o gjykatës të anëve të dheut. Vëreni veshin ju që sundoni shumicë dhe që jeni mburrur mbi turma kombesh, se ju dha nga Zoti sundimi dhe dinastia nga i Shumëlarti.

Këndimi i Urtësisë së Solomonit

(4.7-15)

I drejti, nëse do të arrijë të vdesë, do të jetë në prehje; se pleqëri e çmuar nuk është pleqëria shumëvjeçare, as u mat me numër vitesh. Dhe thinjat janë mençuri te njerëzit dhe mosha e pleqërisë është jetë e panjolllosur. Meqë u bë i pëlqyeshëm te Perëndia, u dashurua, dhe ndërsa jetonte në mes mëkatarësh, u transferua. U rrëmbye, që e keqja të mos ndryshojë mençurinë e tij ose dinakëria të mos mashtrojë shpirtin e tij. Sepse joshja e së keqes errëson të mirat dhe ëndja e dëshirimit e ndryshon mendjen e patëkeq. Duke u përsosur në pak kohë, mbushi vite të gjata. Se shpirti i tij ishte i pëlqyeshëm në Zotin, prandaj vrapoi nga mesi i ligësisë. Por popujt duke

parë dhe duke mos kuptuar, as duke mos vënë në mendje një gjë të tillë; sepse ka hir dhe mëshirë ndër të zgjedhurit e tij dhe mbikëqyrje ndër oshënarët e tij.

Pasvargje Paskremtore

Ting. IV Edhokas simíosin

«Shih si jam i veshur me ikonën tënde⁸ që bëra un',^{*9} se mbi mend u përula fort,»^{*} tha Krishti; «pra sa çudi^{*} që tani përkulem^{*} nën të djathtën tënde me ty si bashkëshërbëtor^{*} edhe po zhvishem, dhe uji më mbështjell,^{*} o mik, se desha si i dhembshur Zot, ata që u zhveshën krejt,^{*10} me paprishje¹¹ përjetësisht^{*} që t'i vesh me lavdi e nder.»

Varg: Deti pa dhe iku, Jordani u kthye mbrapa.

Mitër të pranoi ty, po mbeti prap' e padjegur dot,^{*} kur u pe mishërisht në trup;^{*} kamina që s'dogji Djemt',^{*11a} e ikonizoi,^{*} nga larg, ndërsa un' kashita, mbi ty si përmbi një zjarr,^{*} do t'i vendos duart, o Jisui im;^{*} të kanë frikë qielloret dhe të dheshmet të gjitha tok,^{*} o i tërëfuqishëm Zot,^{*} Shpëtimtari i shpitrave.

Varg: Ç'është me ty, o det, që ike, dhe ti, o Jordan, që u ktheve mbrapa?

Zoti tha: «Në rrjedhat e Jordanit lamë, në ujë ti^{*} dhe pse s'kam njollë plotësisht;^{*} natyra e njerëzve^{*} që u

ndot e tëra^{*} kur Adami ra në mëkat edhe paudhësi,^{*} do përtërihet përmes pastrimit tim;^{*} ky pagëzim do bëhet për të vdekshmit mbarë rilindje pra^{*} përmes ujit dhe Shpirtit¹² Shenjt'.^{*} Shpëtimtar Zot, lavdi më ty.

Lavdi

Ting. Tërth. IV I Studitit

Turmat e murgjve të nderojnë ty, profesorin, o Theodhos, ati ynë, sepse nëpërmjet teje ne mësuam të ecim në udhë vërtet të drejtë;¹³ i lum je, se i shërbeve Krishtit dhe triumfove mbi fuqinë e armikut,¹⁴ o shok engjëjsh, që banon në të njëjtën tendë me oshënarë dhe të drejtë; tok me ta ndërmjeto te Zoti që të mëshirohen shpitrat tanë.

Tani

I njëjti I Joan Monakut

Ushtritë e engjëjve shtangeshin duke të parë sot në Jordan të qëndrosh i zhveshur në ujëra, o Shpëtimtar, të përkulësh kokën tënde të pacenuar dhe të pagëzohesh prej Joanit; sepse kur u varfërove vullnetarisht, bota u pasurua;¹⁵ o Zot, lavdi më ty.

Përlëshore

Ting. Tërth. IV

Me lot të derdhur si rrëke shkretëtirën e that' e vadite për lërim dhe me vajtim dhe psherëtim' gjer njëqind herë pemë mblodhe¹⁶ për

çdo mundim. U shfaqe pra si yll dhe e ndriçove botën me çdo çudi¹⁷ Theodhos i shenjtë, at' oshënar, lutju Zotit Krisht Perëndi të shpëtohen shpirtrat tanë.*

Lavdi *dhe* Tani

I së kremtes



NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësove

Paskremtore

Ting. IV Kateplaji Iosif

E kalonte popullin* në lumë brenda në Jordan* tok me Arkën e Zotit* Jisui që e kishte prind* Naviun,¹⁸ dhe mirëbërjen kështu skiconte,* që përmbushje pra në të ardhmen gjen.* Ky kalim mistik na ikonizon* në Shpirt një riformim dhe një rilindje* krejt të papërgënjeshtueshme.* U duk qart' Krishti * të shenjtërojë* në Jordan për ne ujin.

Lavdi *dhe* Tani *I njëjti*

Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësove

Paskremtore I njëjti

Koha e Theofanis',* në lumë Zoti na u shfaq* në Jordan, ndaj ejani* të nxjerrim ujë, o besnik',*¹⁹ pra falje fajesh se Krishti në mish na erdhi;* delen e rrëmbyer prej bishave* e kërkoi, dhe kur e gjeti ky,*²⁰ e futi

dhembshurisht prap' në Parajsë* me përdëllim edhe simpati.* U duk qart' Krishti* brenda Jordanit* edhe botën e shndriti.

Lavdi *dhe* Tani *I njëjti*

Pas Polieleit, Ndenjësove e oshënarit

Ting. III Thias pïsteos

Atë oshënar* kur lart i ngrite* duart shenjtërisht,*²¹ u pe si shtyllë* dritëprurëse, i feksur prej rrezeve* të lutjes sate, se mendjes i dhe ti krah'* të fluturojë në qiell, u bëre pra* pjesëmarrës në mistere dhe shndrite; ndaj kërkon* nga Krishti të na japë përdëllim të madh.^{2a}

Lavdi *dhe* Tani

Paskremtor I Parthenos simeron

Erdhi Zoti në Jordan,* u pagëzua në ujë* prej Prodhromit fort të shenjt'* dhe nga lart Ati dëshmonte,* tha kështu:* "Ky është im Bir i dashur", ndërsa* Shpirt i Shenjt'* u duk me formë të huaj mbi të,* pra porsi pëllumb i pastër;* kështu mësuam të gjithë Shën Trinin'.

Shkallesat. Antifoni i parë i Ting. IV

Proqimieni Ting. IV

E çmuar është para Zotit vdekja e oshënarit të tij.

Varg: Me çfarë do ta shpërblejmë Zotin për të gjitha që na shpërbleu?

Ungjill oshënarit (Kërkoje në

Mëngjësoren e shën Savës, 5 dhjetor).

Psalmi 50.

Lavdi. Me ndërmjetimet e oshënarit. Tani. Me ndërmjetimet e Hyjlindëses. Përdëllemë, o Perëndi. *Dhe Idhiomeli.*

Ting. Tërth. II

O atë oshënar, në gjithë tokën do-
li zëri²² i arritjeve të tua, prandaj në
qiejt gjete shpërblim²³ për lodhjet e
tua; asgjësive batalionet e demo-
nëve, arrite rreshtimet e engjëjve,
jetën e të cilëve e kishe zili në mënyrë
të paqortueshme; duke pasur guxim
ndaj Krishtit Zot, kërko paqe për
shpirtrat tanë.

*Kanunet: i së kremtes në 8 bashkë me
Irmoset, dhe i oshënarit në 6.*

Kanuni i oshënarit

Ting. Tërth. II

Ode I

En vithó katéstroke

Si i urti general për ne* atë Theo-
dhos, siç vlen për Perëndin',* fillo
këngën për Zotin Krisht,* që ka
ardhur për shpëtim botëror dhe e
lavdëroi kujtimin tënd* fort të shenj-
të me lavdi dhe madhështi të tij që
s'ka kufi.

Pararendësi i Krishtit Zot* doli
prej shkretisë aaronike,* bir nga
Elisabeta qe,* pra filiz i saj, ndërsa
Theodhosi, prej Shpirtit në kolimvi-
thër lind* dhe e ndjek pas Zotin; qy-

tetar i shkretëtirës ky u bë.

Gjith' tërbimi i Sinagogjis'* së izra-
elitëve ra me gjithsej,* sapo Krishti
merr pagëzim* brenda rrjedhash,
kurse në Kish' u mboll jet' e barabartë
me engjëjt lart.* E përshkove krejt
pa kthim, o atë Theodhos i tërëlum.

Përmes asketizmit ti u pe* pjesë-
marrës në pësimin e atij* që kun-
goi pra kryq për ne,* denjesisht me
ngjalljen e tij ke ngjarë,²⁴ dhe bashkë-
trashëgimtar i denj'* i lavdisë së hyj-
nueshme je bërë, Theodhos i shenjt'.

Hyjlindësore

Një kor vajzash të hyjshme këndon*
perëndishëm: Zonjë dhe Hyjlindëse,*
je mes grave e bukur ti,*²⁵ e stolisur
nëpërmjet zbukurimesh hyjnie, se
linde mbi mendim* Fjalën që bën
çdo gjë plot me bukuri²⁶ edhe stolis
gjithçka.

Zbritësore: Vithú anekálipse pithmena

Eteri, e thau

Ode III

Eksínthisen i érimos

Ai që i strehon me uj'* më të lartat,
Zoti,²⁷ mishërisht mbështillej me
rrëke* në Jordan; në të u mbështet
gjithnjë* edhe u sigurua zemra ime
fort.²⁸

Ai që shndriti në Jordan* dritën e

hyjnueshme te vdekatarët përmbi dhé* fryt të mirë ndërgegjeje të shfaq* edhe bekimi ty prej Atit, Theodhos.

E le, o oshënar, çdo gjë* edhe botën, duke imituar zhveshjen e Zotit* që u bë në Jordan, o Theodhos,* u veshe me virtytet siç do Krishti yn'.

E ngrite përmbi supin tënd* kryqin e Jisuit²⁹ shpëtimtar vrapove, Theodhos,* për në varrin e tij porsì një dre* që rend për në burime³⁰ shpëtimtare shpejt.

Hyjlindësore

U shtangën, e dëlirë krejt,* batalionet e patrup, dhe zemrat e gjith' njerëzve* u tmerruan në lindjen tënde, pra* me besë të nderojmë si Hyjlindëse.

Zbritësore: Iskín o dhidhús

Ai që u jep

Ndenjësores e oshënarit

Ting. Tërth. IV Tin sofian qe Logon

E stolise siç duhet për Perëndin'* shpirtin tënd përmes lodhjes me përgjërime,* me vetëpërmbajtje ti,* pra me engjëj u bëre shok;* karizmat e çudive vërtet i fitove shpejt* dhe mrekullisht shëron sa me bes' të nderojnë ty;* turmat e demonëve i zbraps, i dëbon larg,*³¹ shërime dhuron me hir*³² te të vdekshmit, o

Theodhos,* o hyjprurës* me lavd të madh;* ndërmjeto te Zoti yt Krisht,* të na dhurojë ky ndjesën* e fajeve* ne që bëjmë kujtimin tënd fort të shenjt' me mall.

Lavdi *Injëjti*

Tani *Paskremtor*

Me rrëketë Jordani shërben me nder,* dor' të prishshme Joani shtrin dhe tendos,* kur në pagëzim u pe* mishërisht, i padukshëm Zot,* por lumi kthehej mbrapa¹⁸ nga frika, teksa ai,* profeti, të paprishshmin e prekte me tmerr e ankth;* o qengj Perëndie³³ dhe burim jete gjithnjë,*³⁴ vërtet shenjtërove ti* njerëz, dete, burimet mbar',* se Triadha* shkëlqeu fort;* lart të quan Prindi ty Bir,* ndërkohë zbret edhe Shpirti* i Tërëshenjt';* lavdi ty, o Trini, që ke përdëllim, pushtet.

Ode IV

Elilithas ek Parthenu

Në ujëra i dërrmove krerët e dragonjve,³⁵ dhe me anën e Shpirtit më ripërtërite mua, njeriun e tërë, o Fjala e Perëndisë; për këtë të thërras: Lavdi fuqisë sate, o Zot.

Duke imituar pëkulësinë e shkëlqyeshme dhe bindjen e Krishtit që e përkuli³⁶ kokën para Pararendësit, o atë Theodhos, u ngrite drejt kullës së palëkundur të virtyteve.

Meqë i shërbeve Virgjëreshës dhe nënës së Krishtit Perëndi, e pranove Hirin e paluftueshëm të Shpirtit, o atë Theodhos, dhe rrëzove keqdashëset të padukshme.

Shpella e kënduar e Magëve kur të priti, të tregoi dhuratëprurës³⁷ që sillje besim dhe dashuri me shpresë³⁸ te Krishti që u pagëzua për ne, o Theodhos.

Duke u forcuar prej pësimeve të Zotit Krisht, me mallëngjim duroje në vuajtje martirizimin e ndërgjegjes,³⁹ duke mundur botësunduesin e errët,⁴⁰ o atë Theodhos.

Hyllindësore

Zure në barkun tënd pa farë Zotin dhe e mbajte në barrë atë që shpëton botën me ndërmjetimet e tua; prandaj të thërrasim: Gëzohu, o Zonjë e gjithmonëvirgjër.

Zbritësore: Akikoe Kírie fonís su

Dëgjoi zërin tënd

Ode V

Mesitis Theú

Meqenëse e ndeze mendjen për atë që na ripërtëriti urtësisht në rrjedha, e mbështetje me mjete varrëse trupin e munduar përmes asketizmit, o Theodhos i tërëlum.

Duke e bërë gjithnjë jetën studim të vdekjes dhe duke nxituar të shpërngulesh drejt atij⁴¹ që na u shfaq në mish,⁴² e ndërtove varrin për veten, o Theodhos.

O atë Theodhos, duke imituar vdekjen vullnetare të Krishtit,⁴³ nxënësi yt i lavdëruar Vasil, përoron varrin e ri i ngazëlluar.

Hyllindësore

O Perëndilindëse e tërëkulluar, ja ku në bark mbajte mbi arsye Krishtin Perëndinë, sikundër Isaia paratha,⁴⁴ dhe përmbi natyrë e linde, o hyjnënë.

Zbritësore: Iisús o zoís arhigós

Kryetari i jetës Jisu

Ode VI

En aviso ptesmaton

O Krisht, pavdekësi na dhurove ti*⁴⁵ përmes ngjalljes sate; shërbëtori yt Vasil* me famë shfaqet si i gjall',* edhe pse tashmë ishte i vdekur ky.

Pagëzohet ai që botën pastron,* Zoti që u bë për mua si jam unë pra;* në dy natyra, o i lum* Theodhos shenjt, e shpalle në predikim.

Theodhos atë, krojet e lotëve* të tu plot pikuan ëmbëlsi gëzuese* për Krishtin që i ktheu krejt* në hare lotët e miroprurseve.

Hyjlindësore

Zonjë, më denjëso ti për dhembshuri,* se në bark e kishe Fjalën krejt të dhembshurin,* që njerëzit shpëtoi ky* nga çdo prishje me gjakun e vet hyjnor.

Zbritësore: I foní tu Logu

Lajmëtar i Fjalës

*Kontaqi**Ting. Tërth. IV Ti ipermaho*

I mbjellë thellë* në avllit' e Zotit tënd Jisu* ke lulëzuar*⁴⁶ plot virtyte qartë dhe me hir,* bij shumëfishove pra nëpër shkretëtirë,*⁴⁷ i vadite ti me lot si shi, o oshënar,* o barí i vathëve të hyjshme të Hyjnis',* ndaj thërrasim ne:* G'zohu, o Theodhos atë.

Shtëpia

Ishe njeri në natyrë, o atë, por u pe bashkëqytetar me engjëjt; meqenëse jetove si i patrup mbi tokë, o i urtë, hodhe poshtë tërë përkujdesjen e mishit,⁴⁸ prandaj dëgjon nga ne:

Gëzohu, o fëmijë i një ati shpresëplot,/ gëzohu, o dega e një nëne besëmire.

Gëzohu, o popullues mbarëbotëror i shkretëtirës./ gëzohu, o ndriçues i shumëndritshëm i planetit.¹⁷

Gëzohu, se që prej rinisë ndoqe Krish-tin,/ gëzohu, se fishke krejtësisht kënaqësitë e mishit.

Gëzohu, o shkak shpëtimi për mur-

gjit,/ gëzohu, mjet ngushëllimi për ata që neglizhojnë.

Gëzohu, ti që shpëtove shumë njerëz nga mashtrimi,/ gëzohu, ti që dhuron kroje çudish.

Gëzohu ti që kreve përkujdesjen e të varfërve,/ gëzohu, mbrojtësi dhe çli-ruesi ynë.

G'zohu, o Theodhos atë.

Sinaksari

Më **11** të të njëjtit muaj, kujtimi i atit tonë oshënar, Theodhos Qinovjarku, profesorit të shkretëtirës.

Vargje: Meqenëse Theodhosi ishte kryetar jete të përbashkët,/ kur vdiq, ishte dëm i përbashkët për murgjit.

Në të njëmbëdhjetën braktisi jetë shkatërruese Qinovjarku.

Në të njëjtën ditë, Mbledhja e dhjetë mijë engjëjve të shenjtë; kremtohet brenda tempullit martirik të shën Anastasisë, në Emvolet e Dhomninit; dhe kujtimi i shën Stefanit në Plakidhiane dhe i shën Theodorit dhe i Agapiut arkimandrit.

Në të njëjtën ditë, shën Mairi vdes duke u torturuar.

Vargje: Mairi thërriste duke qenë në tortura:/ Mos u frikëso, o Mair; goditu dhe kurorëzohu.

Në të njëjtën ditë, oshënar Vitali mbaron në paqe.

Vargje: Ndonëse ia dhe shpirtin Zotit,/

të kanë frikë shpirtrat e ligësisë.

Me ndërmjetimet e tyre të shenjta, o Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII

Antítheon próstagma

Ti që bashkëlidhe me pagëzimin tënd rrëketë që digjnin mëkatin dhe flakën që freskonte^{11a} gjini njerëzore, o Zot, Fjala e Perëndisë, Perëndi i përmbilartësuar, je i bekuar dhe i përmbilavdëruar.

O oshënar, themelove mandër shpëtimtare shpirtrash, pasi ia ofrove veten si temjan, si holokaust atij që e bëri furrë Jordanin, dhe pasi more flakë qiellore si simbol të pagënjeshhtërt të aprovimit hyjnor.

Meqë u shfaq Hiri, o oshënar, u tërhoqën para strategjisë sate punët e Moisiut,⁴⁹ sepse pasi shkatërrove armiq të padukshëm, populli yt trashëgon një qytet qiellor,⁵⁰ o i tërëfamshëm.

Pasi e sigurove veten tënde si bane-së për atë që varrosi mëkatin në rrëke, ndërtove tempull të hyjpëlqyer dhe vure ligj të sillje këngë të pandërprerë me zëra në shumë gjuhë.

Duke imituar guximin e Djemve, poshtërove kërcënim të përzjarrtë tirani,⁵¹ duke kryesuar, o atë Theo-

dhos, Kishën e Krishtit, i cili u pa të kryqëzohet për të në mish vullnetarisht.

Hyjlindësore

Vetëm ti tregove zënie të tërë-papërlyer, lindje të pacenuar, duke mbetur e virgjër, sepse zure Perëndi që është mbi të gjitha, i cili u bë njeri për shpëtim dhe çlirim⁵² besnikësh, o e kulluar.

Zbritësore: Neus efsevís

Djemat mu në zjarr

Ode VIII

Káminos poté pirós

Dikur një kaminë në Babiloni i ikonizoi rrjedhat e Jordanit, duke djegur kundërshtarë⁵³ përmes pagëzimit, ndërsa freskonte besimtarët^{11a} që thërrisnin: E bekon i gjithë veprat e Zotit Zotin.⁵⁴

Meqë u shpërngule nga pasione mishore para shpërnguljes nga jeta, o Theodhos, i dukesh të riut në thellësitë e tokës dhe e nxjerr nga ujëra këtë që thërriste: E bekon i gjithë veprat e Zotit Zotin.⁵⁴

Bekimi i Krishtit të pagëzuar në rrjedha, bekimin që dhanë duart e tua, u bë urdhër tepër i hyjshëm për të thatën, ujë tejet frytdhënës dhe diell që ngroh; sepse një kokërr kthehej pa mbjellje në grurë tepër të gratshëm.

Kur hyre nën errësirën⁵⁵ mendore të dritës tepër hyjnore, o Theodhos, dhe more në zemër pllaka të shkruara me gisht Perëndie,⁵⁶ dogmat e besimit ua solle nxënësve si libër jete,⁵⁷ o i tërëlumur.

Gruaja që imitoi besimin e pathyer të gjakrrjedhëses, sapo e preku leckën, e largoi pasionin⁵⁸ sikundër errësira me anën e ndriçimit që kishe brenda, sepse u bëre enë e zgjedhur⁵⁹ për Krishtin e shfaqur.

Kur të pamë ty, o Krisht, Perëndi prej Perëndie, të shfaqur trupërisht,⁴² në mënyrë të parrëfyeshme e njohim Atin tënd të padukshëm dhe Shpirtin tënd të Shenjtë, duke thirrur: E beko ni gjithë veprat e Zotit Zotin.⁵⁴

Hyjlindësore

Ti zure në mitër pa farë atë që është i pandarë nga Ati, i cili u soll si perëndiburrë, dhe e linde si Perëndi, njëkohësisht dhe njeri, prandaj të njohim si shpëtim i të gjithëve ne.

Zbritësore: Mistirion parádhokson

Çudi që nuk ka dot tregim

Ode IX

Anarhu jenítoros

Të katërt Sinodet sipas numrit që kanë ungjijt' * e Jisuit, i shpalle me zell martirësh ti, * duke derdhur gjak në ndërgjegje, u shfaqe pra, *

oshënar dëshmor i pagjakshëm për besën ton', * o hyjmendës Theodhos me nam.

Dënoi drejt drejtësia të padrejtin denjësisht: * Internohej ai para internimit tënd, * dhe nga buzët me blasfemi gjyqi nxori shpirt * besëkeq edhe e privoi nga jeta k'tu, * pra armikun kundër Jetës,⁶⁰ at'.

Meqë e kujtojmë mësimdhënien tënde, Theodhos, * Krishtin e predikojmë në dy substanca ne, * njohim dy vullnetet e tij nga natyrat, pra * dhe dy energji, dy liri që ka në vendim, * që u pagëzua mishërisht.

Sipas emrit tënd ke qenë dhënie fort e mirë ti * pra nga Ati i dritave⁶¹ dhe u shfaqe krejt * mjek për shpirtrat edhe për trupat, si dhe ushqim, * pije për sa shkriheshin,⁶² rrob' për të zhveshurit, *⁶³ për ata që ranë, ngri tje lart.

O shenjt, mos resht kurrë të kujdesesh për grigjën që ke, * oshënar, dhe premtimin kujto, që mbajmë ne * si spirancë,⁶⁴ shpresën e ngulur porsin në gur * që s'ka çarje, o Theodhos; ty të kemi shenjt * ndërmjetues para Krishtit Zot.

Hyjlindësore

Agim mëngjesor të gjetëm⁶⁵ ne në jet' që ngjan me nat', * vezulloje me

rrzet e virgjërisë ti;* na zbulove lindjen e Diellit krejt mendor* të drejt'sisë,⁶⁶ Vajzë hyjnënë me nder të madh,* ndaj të gjithë të nderojmë ty.

Zbritësore: Aporí pasa glosa

Asnjë gjuhë në botë

Dërgimësore

Jinekes akutísthite

O Theodhos, shenjt oshënar,* ti mendjen e pastrove krejt* nga çdo rrëmuje dhe çdo ves;* shfaqjet hyjnore që ndritën* prite fuqishëm prej Trinis'* në tri drita mbi dritë,* i tërëlumur, je lavdi* për çdo asket; mos pusho tash* të ndërmjetosh, o hyjprurës.

E së kremtes E ngjashme

Oh, ç'punë krejt hyjnore bën,* i plotpushtetshmi Shpëtimtar:* Je Perëndi para jetës,* dhe pse në mitrën të virgjër* ke hyre pa ndryshim aspak,* pra u bërë mish dhe më pas* lave në ujë, në Jordan,* o Zot, natyrën e gjindjes* nga ndotja, shkeljet e shpirtit.

Lavdërimi

Ting. Tërth. I Heris askitikón

Meqë e bërë, o Theodhos,* më parë veten për virtytet hyjnore ti* banesë, u denjësove të rrish në kishën e shenjt'* të së Tërëshenjtës dhe ta vizitosh,* se deshe që ta shikosh* llamburitjen e Perëndis';⁶⁷ tani

sheh hirin* bukurin' që nuk shprehet dot* që stolis vërtet* tenda që themeloi fort,* o oshënar, i Larti,⁶⁸ ku vendos për banim atje* ata që shohin drejt tij me gatishmëri; lyp atë, o shenjt,* që të na dhurohet* ne mëshirë, përdëllimi i madh^{2a} për shpirtrat tan'.

Veten si e pastrove ti fort* me asketizëm, lodhje, i tërëlumur shenjt,* u bërë pra imitues i Zotit tënd, ndaj kështu* e shërove gruan që ty rrobat pak* t'i preku, o Theodhos;*⁵⁸ i ushqeve sa treteshin* në shkretëtirë* në uri⁶² nga thesari yt* që s'shteron aspak;* sipas emrit u bërë ti* dhënia e Perëndis' dhe shpalle besën, Orthodhoksin',* duke shpërfillur manin' e tiranit, o oshënar me nam;* lyp Krishtin të kenë* shpirtrat tanë përdëllimin e madh^{2a} dhe hir prej tij.

Flakën e dashurisë që vlon* dhe të përzjarrtë, pa lëkundje për Perëndin'* e ndeze dhe si shpërblim more një pishtar qiellor* që të lajmëronte ty pëlqim hyjnor,* që tempullin shenjtëror* si punishte për çdo virtyt,* për edukim dhe* ndreqje shpirtrash ta themelosh;* ndaj me besë ti* e fillove dhe ngrite lart;* trupi yt i përvuajtur atje prehet dhe ka nder* më shumë se varret e tjera të oshënarëve, o i lum;* lyp të na dhurojë* përdëllim të madh^{2a} për

shpirtrat, o atë, Krishti Zot.

O Theodhos, kalove vërtet* deri në tendën e çuditshme dhe në shtëpin* e Zotit dhe Perëndisë me ngazëllim dhe me gaz* në shpirt; zë krentuesi⁶⁹ jehon atje,* o atë, pra me qëllim* të dëgjosh himn me ëmbëlsi* dhe të shijosh fort* prehje, kënaqësi, hare* që nuk shprehet dot,* se ato vetëm, o i lum,* i dëshirove plot me mall, kështu vrave mishin⁷⁰ tënd;* drejt tyre pra ke arritur i zbukuruar me drejtësi;* lyp Krishtin të kenë* shpirtrat tanë përdëllimin e madh^{2a} dhe hir prej tij.

Lavdi

Ting. II I Anatoliut

Shkalla e virtyteve u dëftua shembull për ata që janë mbi dhé. Le ta lavdërojmë atë si bukuri asketësh, se si asketizoi me të vërtetë sikurse Andoni i madh, pasi shfaqti përlësi të pamasë dhe kulloti popullin e tij besërisht, e futi në mandër të shenjtë ku qëndron kori i shenjtoreve; ndaj le të thërrasim gjerësisht: Mos e harro edhe tani grigjën tënde, o i tërëlumur Theodhos, por me ndërmjetimet e tua drejt Zotit na shpëto, të përgjërrohemi.

Tani

Injëjti I Anatoliut

Sot Krishti erdhi në Jordan për t'u pagëzuar. Sot Joani prek kryet e

Zotit. Fuqit' e qiejve u shtangën⁷¹ duke parë misterin e mahnitshëm.⁷² Deti pa dhe iku, Jordani duke parë kthehej prapë,⁷³ dhe ne të ndriçuarit thërresim:

Kori A: Lavdi Perëndisë që u faneps⁷⁴ dhe u pa mbi dhënë, e ndriçoi botën.⁷⁵

Dhe vazdimi i Dhoksologjisë së Madhe (dmth. nga Vargu i dytë).

Në Liturgji, Tipiket dhe nga Kanuni i oshënarit, Ode III dhe VI. Kontaqi i së krentes U fanepse me lavdi. (shih fq. 115). Të meriton. Kungatore: Në kujtim të përjetshëm. Pamë dritën.

CITIME

¹ II Thes. 3.9; I Tim. 4.12; Tit. 2.7; I Petr. 5.3

² Vep. 9.31

^{2a} Num. 14.19 etj.

³ Is. 6.3

⁴ Jis. N. 3.10 etj.

⁵ Ps. 45(46).5

⁶ Jez. 47.3

⁷ Gjen. 3.15; Ps. 73(74).13

⁸ Gjen. 1.26-27; 5.1; 9.6; Urt. Sol. 2.23; Sirak 17.3

⁹ Gjen. 2.7

¹⁰ Gjen. 3.7

¹¹ I Kor. 15.53-54

^{11a} Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 25-26

¹² Joan 3.5

¹³ Is. 40.3; Matth. 3.3; Mark. 1.3;

Lluk. 3.4; Joan 1.23; Vep. 13.10

- 14 Kol. 2.15
 15 II Kor. 8.9
 16 Matth. 13.8; Mark. 4.8; Lluk. 8.8
 17 Fil. 2.15
 18 Jis. N. 3.15-17
 19 Is. 12.3
 20 Ps. 118(119).176; Matth. 18.12-13;
 Lluk. 15.4-5
 21 I Tim. 2.8
 22 Ps. 18(19).5
 23 Matth. 5.12; Lluk. 6.23,25
 24 Rom. 6.5; II Kor. 1.7; I Petr. 5.1
 25 Kënga 5.9,17 (6.1)
 26 Gjen. 1.31
 27 Ps. 103(104).3
 28 I Mbret. [Sam.] 2.1
 29 Matth. 16.24; Mark. 8.34; Lluk. 9.23
 30 Ps. 41(42).2
 31 Matth. 17.21
 32 I Kor. 12.9
 33 Is. 53.7; Joan 1.29,36; Vep. 8.32;
 I Petr. 1.19
 34 Jer. 2.13; 17.13
 35 Ps. 73(74).13-14
 36 Fil. 2.7-8
 37 Matth. 2.1,11
 38 I Kor. 13.13
 39 II Kor. 1.12
 40 Ef. 6.12
 41 II Kor. 5.6-9
 42 I Tim. 3.16
 43 Joan 10.18
 44 Is. 7.14
 45 II Tim. 1.10
 46 Ps. 91(92).14
 47 Is. 54.1; Gal. 4.27
 48 Rom. 13.14
 49 Eks. 17.8-13
 50 Hebr. 13.14
 51 Dan. 3.13-19
 52 Lluk. 1.68; Rom. 3.24; I Kor. 1.30;
 Ef. 1.7; Kol. 1.14
 53 Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 24
 54 Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 34
 55 Eks. 20.21; Sirak 45.5
 56 Eks. 31.18; Ligji i Dytë 5.22; 9.10
 57 Fil. 4.3; Apok. 3.5; 13.8; 20.15
 58 Matth. 9.20-22; Mark. 5.25-29;
 Lluk. 8.43-44
 59 Vep. 9.15
 60 Joan 11.25; 14.6; Kol. 3.4; I Joan
 1.2; 5.12,20
 61 Jak. 1.17
 62 Ligji i Dytë 32.24; Judith 7.14
 63 Jov 31.19-20; Is. 58.7; Jez. 18.7,16
 64 Hebr. 6.19
 65 Osea 6.4
 66 Mal. 4.2 (3.20)
 67 Ps. 26(27).4
 68 Hebr. 8.2
 69 Ps. 41(42).5
 70 Gal. 5.24; Kol. 3.5
 71 Jez. 2.12
 72 Lluk. 5.26
 73 Ps. 113(114).3,5
 74 Ps. 117(118).27; I Tim. 3.16
 75 Joan 1.4,9; 8.12; 9.5



MË 12 TË TË NJËJTIT MUAJ
Kujtimi i martires së shenjtë Tatjana.

NË MBRËMËSORE

Thirtore Paskremtore
Ting. II Ote ek tu ksilu se

Himnin* paskremtor, besnikë, ne,* mendërisht të pastër krejt Krishtit të pagëzuar tani,* t'i këndojmë, se ka ardhur në Jordan me mish,* ky gjithnjë është tok me Atin edhe me Shpirtin* në natyrën e Hyjnisë; tek Joani thërret:* Eja, Pagëzor, pagëzomë,* dua që ta laj pra natyrën* njerëzore, si i mirë, nga çdo njoll'.

“**O** Krisht,* të shërbejnë ty me tmerr,* tërë rendet, koret e engjëjve, se je mbret Perëndi,* nuk guxojnë Keruvimet të të shohin dot;* por ti më urdhëron ta prek un' kokën hyjnore,* ndonëse jam kashtë,” po thërret Joani shenjt.* «Frikë më shtrëngon që të tërin* mos më djegë zjarri pa masë* nga Hyjnia jote plot me tmerr, o Zot.»

“**E**rdha* nga e Virgjëra me trup* për të rigatuar Adamin mbarë në rrjedh', në Jordan”* i përgjigjet pra Joanit Çlirimtari Zot.* «M'u afro pranë ti, si Krishtit, ky pikërisht jam* prej natyrës, o Joan, më pagëzo mishërisht;* do dërrmoj dragonjt' e atjeshëm,* krerët e atyre,¹ se si Zot* po e ngre mëkatin mbarëbotëror.»²

Të shenjtore Të ngjashme

Sapo* ke shkëlqyer pasurisht* me ndriçim prej Shpirtit të Shenjtë, urreve çdo pasuri,* deshe vetëm pasurinë qiellore lart,* qartas veshe ti qëndrueshmëri martirike* dhe drejt lodhjeve hiperbolike ece shpejt,* ndaj përdhé armikun e hodhe;* thure për fitore kurora,* o Tatjana e hyjlumur dhe me nam.

Flakën* e mëkatit shove krejt,* erën e fëlliqur të mishit me vesë Shpirti Hyjnor,* bashkëpunëtori yt, e lumur, e dëlir',* ishte ky, ndaj u mbylle gojën bishave, ndërsa* trupin dhe, kur ty në stadium të nxorën pra,* si burr' në tortura; vithise* pra armikun edhe kurora* për fitore thure, o Tatjana ti.

Shpatë,* zjarr, uri a torturim,* ngasje dhe shtrëngime, asnjë lloj dënimi nuk çmprehën dot,* o martire, dashurinë tënde për Zotin,*³ se me zemër të zjarrt' atë kërkoje, e doje,* ndaj shpërfille për një çast të gjitha sa duken;* brenda nusërores së hyjshme* ti fushove, se ishte nuse* e Jisuit Shpëtimtarit Tërëmbret.

Lavdi *dhe* Tani

Ting. Tërth. II I Kozma Ajiopolitit
Natyra e gjithë të dhëlindurve duke të parë ty Krijuesin të zhveshur në ujëra të kërkosh pagëzimin, ndryshonte nga frika dhe habitej, ndërsa Pro-

dhromi shtrëngohej nga tmerri duke mos guxuar të të afrohej ty; deti iku, Jordani frenoi rrymën, malet u hodhën lart⁴ duke të parë dhe fuqitë e engjëjve shtangeshin duke thënë: Oh, ç'mrekulli! Shpëtimtari zhvishet, duke dashur të veshë njerëzit me shpëtim dhe rigatim.

Pasvargje

Ting. Tërth. II E angjeliqé

Zotit t'i thërrasim profetikisht: U shfaqe* te neti Ndërtuesi shpëtimtar, o Fjalë;* dërrmove, o Krisht, gojë* e dragonjve në lum¹ Jordan* dhe të verbrit ti me dritën tënde plot i shkëlqeve si i dhembshur, i mirë gjithnjë;* Je i bekuar Perëndi i shfaqur,⁵ lavdi më ty.

Varg: Deti pa dhe iku, Jordani u kthye mbrapa.

Forcë pagëzimi yt na dha ndaj armiqve,* se me mall nderojmë ekonominë tënde,* që e zbatove, Fjalë,* duke dashur, kur zgjidhe ti* njerëzit prej nëmës që përshkoi në bot' kur doli nga Edeni,⁶ prandaj psalim ne:* Je i bekuar, Perëndi i shfaqur,⁵ lavdi më ty.

Varg: Ç'është me ty, o det, që ike, dhe ti, o Jordan, që u ktheve mbrapa?

Ne që në Adamin u veshëm me këmishë* prej lëkure vullnetarisht dikur nga rënia,*⁷ në rrjedhat e Jordanit,* pasi t'i kemi zhveshur krejt*

sot në pagëzimin e Jisuit Zot, tok me engjëj t'i thërrasim me theologji:* Je i bekuar, Perëndi i shfaqur,⁵ lavdi më ty.

Lavdi *dhe* Tani

Ting. Tërth. II I Theofanit

Le të himnojmë, o besnikë, përmasat e ekonomisë së Perëndisë për ne, se për shkak të rënies sonë, duke u bërë njeri, pastrohet me pastrimin tonë në Jordan, ai që është i vetmi i pastër dhe i pacenuar, duke më shenjtëruar mua dhe ujërat, dhe kokat e dragonjve duke i thyer mbi ujë;¹ le të nxjerrim pra ujë, me ngazëllim,⁸ o vëllezër; se Hiri i Shpirtit atyre që nxjerrin besërisht u jepet padukurisht nga Krishti Perëndi, dhe Shpëtimtari i shpirtrave tanë.

Përlëshore e së kremtes



NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së parë, Ndenjëso

Ting. IV Kateplaji Iosif

Pse habitesh kur shikon,* ti o Jordan? Thotë se sheh* Zotin zhveshur, druhem fort* nga i padukuri gjithnjë.* Si ish e mundur të mos kisha unë frikë* edhe të mos zhytesha! Kishin frik'* engjëjt kur e pan', qielli u shtang,*⁹ u tremb dhe dheu, detet fort u drodhën,* gjithë sa duken dhe sa s'duken.* U shfaq pra Krishti* të

shenjtërojë* në Jordan për ne ujin.

Lavdi *dhe* Tani
I njëjti

*Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësove
Ting. Tërth. IV Anestis ek nekrón*

Jisui pagëzim merr, shkëlqen mbarë botën.*¹⁰ Me zë dëshmoi Ati, nga lart tha:* “Ky është* Biri im që pëlqeva, atë dëgjoni, ai shndrit rruzullin.”* Kur priti pagëzim shpëtoi porsì Perëndi me dhembshuri,* edhe çliroi gjindjen njerëzore. O Jisu, lavdi ty.

Lavdi *dhe* Tani
I njëjti

Kanunet i së kremtes dhe i shenjtore.

Kanuni i shenjtore
Ode I
Ting. II
Dhefte laí

Me dhëndrin tënd* krejt të kulluar qëndron me lavdi,* me hijeshi dëshmorësh e stolisur, o martire; kërkon ndjes’ mëkatesh,* çlirim nga prishja e shpirtit për sa të përhimnojn’.

Shpërfille krejt* tër’ pasuritë që prishen mbi dhé,* se me dëshirë ti kërkoje pasuri që s’prishet në qiej, por mbetet;*¹¹ me gaz në stadium dëshmorësh, martire hyn.

Ece pa frik’* në kamxhikime, tortura, llahtar,* në dhimbje të larmishme, sepse bashkëpunëtor kishe Hirin dhe ndihmën*¹² prej Krishtit, Shpëtimtarit, që të forconte ty.

Hyjlindësore

Mbajte në bark,* Vajzë, burimin që derdh apati,* pafajshmëri; shëromë mua të plagosurin nga pasionet, rrëmbemë* prej zjarrit të përjetshëm, se vetëm ti ke hir.

Ode III

Tis písteos en petra me

Se tundi pìrgun, kullën e zemrës sate* furtuna që u mblodh me tortura, tmerre,* se qe bazuar, o famëmadhe, mbi gur,¹³ mbi dashurin’ e Krishtit; i thërrisje ti:* Nuk ka shenjt përveç teje, o Zot Perëndi.¹⁴

Idha krah’ me fuqi dobësisë sate* ai që dobësin’ njerëzore veshi;* dragoin që s’ka forcë pra e rrëzove përdhé;¹⁵ thërrisje, o martire, besërisht:* Nuk ka shenjt përveç teje, o Zot Perëndi.¹⁴

Ithave ti përrenjt’ e paligjësisë*¹⁶ me rrjedhjen lum të gjakut tënd, o e lumur;* shijon tani përroin e prehjes¹⁷ edhe banon në dritë që s’ka perëndim; thërret:* Nuk ka shenjt përveç teje, o Zot Perëndi.¹⁴

Hyllindësore

Mbi mendjen është zënia dhe lindja jote,* se linde ti atë që me fjalë ndriti*¹⁸ çdo shekull;¹⁹ se çliroi nga marrëzia çdo skaj mbi dhé, o Vajzë që nuk njohe burr';* lyp atë përherë që të shpëtohem.

Irmosi: Tis písteos en petra me

»**O** Zot, më ke* forcuar mbi gur¹³
 »të besës,* dhe gojën ma* zgjerove
 »përmbi armiqtë,*²⁰ se u gëzua men-
 »dja ime kur psalja: Nuk ka të shenjt'
 »si Perëndia yn' i madh* dhe nuk ka
 »të drejtë veç teje, Zoti im.¹⁴

*Ndenjëso**Ting. I Ton tafon su Sotir*

E gatshme ishe ti,* o Tatjana e thjeshtë,* e kishe pra zili vdekjen edhe pësimin* pa cen aspak të Krishtit që dashurove, i ndoqe pas* gjurmët e atij,*²¹ fitove dhom' nusërore* lart ndër qiejtë,* ke veshur lavd të pavdekshëm,* kurorë që s'prishet dot.²²

*Lavdi dhe Tani**Ingjashëm*

Në rrjedha lumi vjen* se kërkon pagëzimin* nga mirëdashja shiu i madh dhe Joani* i hyjshmi Pararendës duke u shtangur i tha atij:* Njollë s'ke aspak,*²³ si do të të pagëztoj pra?* Dorën si ta shtrij* mbi kokën që po shkakton tmerr* në botën e tërë pra.

*Ode IV**Imnó se akoi*

Tatjana duke sjellë gjendjen e bukur të shpirtit përmes hijeshisë së shpresëtarisë dhe për më tepër duke shkëlqyer paradoksalisht me dritën e martirizimit, hyn të banojë me Dhëndrin e pastër.²⁴

Engjëj qiellorë që u dërguan nga Perëndia për ndihmën²⁵ tënde, i goditën me verbëri të paligjshmit që rripnin me hekur fytyrën tënde, o martire, dhe u çuditën me durimin tënd.

Duke e predikuar ligjërisht Krishtin triumfove mbi të paligjë dhe iu solle atij si flijim pa cen, i mirëpritur²⁶ dhe tepër i përsosur duke thirrur: O Shpëtimtar, them duke të dashur ty.

Hyllindësore

Në gji të qetë më drejto, o e Tërëshenjtë hyjnuse, sepse dimëroj llahtarshëm në shtrëngatë dhe pështjellim të mëkatit që fryhet nga erërat e frymëve të liga²⁷ që më shtrëngojnë.

*Ode V**O fotismós ton en skoti*

Pasi prite në bark frikë Perëndie, linde paradoksalisht frymë pohimi shpëtimtar²⁸ dhe martirizimi, o trimëshë në shpirt, dhe luftove me forcë dhe triumfove kundër pu-

shteteve kundërshtare.²⁷

Duke imituar pësimin tënd të nderuar dhe të lumur ajo që u bashkua me ty pa pasion, pëson me gatishmëri duke u copëtuar në gjymtyrë, o Krisht jetëdhënës, dhe thërret: Tjetër Perëndi veç teje nuk njoh.²⁹

Shkëlqen me rreze të ndritshme duke prurë e ngazëlluar llambadhen e Shpirtit të Shenjtë, dhe llamburit zemrat e besnikëve duke shpërndarë errësirën e mëkatit, o martire athlofore e tërërespektuar e Krishtit.

Hyjlindësore

Ore e ndritshme e Diellit, llamburitmë me shkëlqim që shpërndan errësirën time të shkeljeve; ma jep dorën mua që u ngula në lëndë mëkati; ngrimë mua të rrafshuarin ti, rimëkëmbja e vetme e Adamit të rënë.

Ode VI

En aviso ptesmaton

Kur të njohu të shtrirë përmbi dru ty,* varjen e duron bashkë me rrjepjet gjak në trup* nga malli yt, o Perëndi* i fuqishëm, martirja modeste krejt.

Egërsirat e tmerrshme të kishin nder* kur në stadium të panë të luftosh si trim,* të imitoje plot me zell,* o zëmadhe, martiren e par'

Theklën.

Erdhën engjëj së larti në burgun tënd* dhe me dritë ty të shndritën, të çliruan pra* nga dhimbjet, të lëvduan fort* porsì shqerrë të Zotit Krisht Perëndi.

Hyjlindësore

Gjithëbërësi të zgjodhi nga çdo brez,* bukuria e Jakovit³⁰ je, o Vajzë ti,* të deshi ty që s'ke qortim* dhe u shfaq pasi lindi prej teje ky.

Irmosi: En aviso ptesmaton

»**N**jë avushë mëkatesh po më rrethton,* ndaj thërras un' mirësinë »tënde që s'ka fund,* e cila s'gjurmësohet dot;* lutem, nxirrme nga »prishja, o Zoti im.³¹

Kontaqi

Ting. IV Epefanis simeron

Ufanepse me lavdi* në tërë botën* edhe drita jote sot* na u shënua me çudi,*³² pra të himnojmë ne me kuptim.* Erdhe u duke, o drit' e paafrueshme.^{33*}

Sinaksari

Më 12 të të njëjtit muaj, kujtimi i martires së shenjtë Tatjana.

Vargje: Shpata i shkaktoi kurorë të përkryer/ kryes së Tatjanës së shkëlqyer në të gjitha.

Në të dymbëdhjetën prenë qafën e Tatjanës.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirit të shenjtë Petro Avesalamit.

Vargje: Meqenëse u zhurit në zemër me dëshirë të hyjshme,/ Petro jep frymë me ëndje mbi qymyr.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirit të shenjtë Merti.

Vargje: Meqë dëshiron Perëndi të shumëlartë dhe të vetëm të pushtetshëm,³⁴/ kamxhikohet Merti shumë fuqishëm.

Në të njëjtën ditë, tetë martirët e shenjtë nga Nikea mbarojnë me shpatë.

Vargje: Vdes me shpatë një kor tetësh në numër,/ duke dashur të gjejë jetën e shekullit të tetë.

Në të njëjtën ditë, martirja e shenjtë Efthasia mbaron me shpatë.

Vargje: Vetë Perëndisë, Shpëtimtarit të botës/ i ofron nga shpata kokën e vet Efthasia.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atit tonë oshënar Ilia çudibërës.

Vargje: U tregua një tjetër Ilia çudibërës³⁵/ ky Ilia, me të vërtetë çudibërës.

Me ndërmjetimet e tyre të shenjta, o Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII

Antítheon próstagma

Duke u shpuar dhunshëm me shpatë, o e pamposhtur, pësive me durim të skajshëm heqjen e gjinjve, dhe i dogje, o martire, me zjarr qiellor ata që nuk donin të adhuronin Perëndi, të cilin e himnon tërë Krijesa duke e lavdëruar.

O Krisht, duke e prurë në zemër e gjithëkënduara zjarrin e hyjshëm të dashurisë sate, nuk e kishte frikë zjarrin bashkëshërbëtor, duke ikonizuar burrërinë dhe qëndrueshmërinë e Djemve të mëparshëm.

T'u nënshtrua egërsi bishash; tejkalove pa trauma gojët e hapura të luanëve,³⁶ sepse Perëndi të lavdëroi ty që e lavdërove³⁷ dhe përmbushje në mishin tënd pësimet e tij,³⁸ o e tërëfamshme.

Hyjlindësore

Ti që linde jetë enipostate, e cila e zhduku qartazi me vdekje vdekjen, vriti pasionet e mishit tonë, që ty të nderojmë me besim si Perëndilindëse e përmbilavdëruar, o e kulluar.

Ode VIII

Ton en kamino tu pirós

E stolisur me virtyte, u zbukurove me hijeshitë e martirizimit, dhe e shkëlqyer me nurin e pavdekësisë, o

Tatjana hyjmenuese, u bashkove me Dhëndrin më të bukur se të gjithë njerëzit.³⁹

Duke shkëlqyer me lavdinë e shndritjes hyjnore, e lavdëroje në burg bashkë me shërbyes pa trup Bërrësin, duke mbetur e paafreshme për gjithë ata që mbaheshin prej errësirës së mashtrimit.

Dërrmimi i gjymtyrëve të tua i bëri pluhur makinacionet e armikut; rrjedhja e gjakut i thau përrrenjtë¹⁶ e vështirë të ateizmit, o e thjeshtë, dhe na u tregua det mrekullish.

Hyjlindësore

Ti që linde mbi logjikë Perëndinë e dhembshur dhe shpëtimtar për ne, shpëtona dhe dhembshurona, duke na tërhequr nga djegësira e zjarrtë e mendimeve dhe veseve, me përgjërimit e tua, o Virgjërnënë e kulluar.

Irmosi: Ton en kamino tu pirós

»**A**të që zbriti në kamin',* që të ishte tok me Djemtë e hebrenjve,* »Perëndinë që ktheu në vesë flakë »dhe zjarr*⁴⁰ himnojeni vepra, se »është Zot,* përmbilartësoni atë në »gjithë jetët.⁴¹

Ode IX

Ton ek Theú Theón Logon

Ty të dënon me dënim shpate mi-

zori gjykatës* pas kaq torturash; ngritjen tënde lart* duartrokiti rreshtim engjëllor,* me të djathtën e fortë kurorë, o martire, të ka vën'*⁴² Krishti, se ligjërisht ti luftove⁴³ në aren' për të.

Ja, tok me grupet e ndritshme të martirëve je ti,* kaq shumë pranë Perëndisë Zot;* çka shohin engjëj i sheh, dhe banon,* si e virgjër, modeste, me Dhëndrin tënd në nusëroren lart,* dhe i lyp të shpëtohen ata që të lëvdojn' me mall.

Si një burim të vulosur ne të shpallim, si kopsht ty* rrotull i mbyllur,⁴⁴ si një dedikim* fort të nderuar, si nuse të shenjt',* të paprishshme të Krishtit, therore dhe flijim, si pëllumbesh'* mjaft të bukur⁴⁵ të Zotit të botës, o Tatjana ty.

Hyjlindësore

Shpëtona dhe dhembshurona, dhe na ruaj nga dëme,* nga sulmet që ngren' kombet kundër nesh,* se të nderojmë me mall besërist,* meqë zbutesh prej zërave tanë, të kërkujmë nxehtësisht,* se përikja e vetme, o Zonja jonë, je për ne.

Irmosi: Ton ek Theú Theón Logon

»**T**a madhështojmë me një zë, o »besnikë, me himne* Fjalën e Perëndisë, Zotin⁴⁶ Krisht,* që pa rrëfyer »ka marrë për ne* mish nga Nëna

»e virgjër, e shenjtë; vjen të përtëritë
»pra* krejt Adamin, që kur hëngri,⁴⁷
»ra në prishje mizorisht.

Dërgimësore
Epefani o Sotir

Ke duruar torturim,* se kishe mall
për Krishtin tënd;* e zhduke me bu-
rrëri ti* fuqin' e djallit, me besim* të
lumërojmë për këtë* ne të gjith', o
Tatjana, hyjmentëse me guxim.

Kremtore E ngjashme

Shpëtimtari na u shfaq,*⁵ pra Hiri,
e vërteta krejt,* brenda Jordanit në
rrëke,* sa flinin pra në terr, në hi,*
këta i shndriti³² me shkëlqim,* se-
pse erdhi, u shfaq te ne drita që s'ka
afirim.³³

Pasvargje
Ting. Tërth. II E angjeliqé

OJisui im, dritë je prej drite, kështu*
na ndriçove plot me shkëlqimin tënd
që s' thuhet;* më parë u verbuam*
në Eden pra nga gjarpri ne;* duke
par' me llamburitjen tënde tani ndri-
çimin⁴⁸ në Jordan, psal çdokush
besërisht:* Je i bekuar Perëndi i
shfaqur,⁵ lavdi më ty.

Vargje: Deti pa dhe iku, Jordani u
kthye mbrapa.

Oshikues Shpirti, mist, pararendës
gazi,* administrator i mistereve⁴⁹ të
frikshme,* kërko prej Fjalës që ti*
pagëzove, siç deshi vet',* të na jepet

ndjes', çlirim mëkatesh gjithnjë ne
që shpresëtarisht po i psalim me
zë:* Je i bekuar Perëndi i shfaqur,⁵
lavdi më ty.

Vargje: Ç'është me ty, o det, që ike,
dhe ti, o Jordan, që u ktheve mbrapa?
Le t'i ngremë lart mençurisht, o
besimtarë,* zemrat dhe me vrap të
shpejtojmë në Jordan tok,* Krijue-
sin ta shohim* mishërisht duke ma-
rrë pra* pagëzim nga shën Joani,
bashkë me të ne me thelogji le t'i
psalim me himn:* Je i bekuar Pe-
rëndi i shfaqur,⁵ lavdi më ty.

Lavdi *dhe* Tani

I ngjashëm

Oekonomi e hyjnueshme mbi men-
dje!* Si qëndron Krijuesi me krijesën
bashkë?* Si poshtë saj ul kryet?*
Shembull përlulësie sjell* me këtë
veprim, për ne që shndritim pra
shpirtërisht, ndaj meloditë i psalim
me gaz:* Je i bekuar Perëndi i shfa-
qur,⁵ lavdi më ty.

Dhe të tjera si zakonisht.

CITIME

¹ Gjen. 3.15; Ps. 73(74).13

² Is. 53.4; Joan 1.29

³ Rom. 8.35

⁴ Ps. 113(114).3-6

⁵ Ps. 117(118).26-27; I Tim. 3.16

⁶ Gjen. 3.16-19

- ⁷ Gjen. 3.21
⁸ Is. 12.3
⁹ Jer. 2.12
¹⁰ Joan 1.4,9; 3.19; 8.12; 9.5; 12.46
¹¹ Lluk. 12.33
¹² II Tim. 2.1
¹³ Matth. 7.24-25; Lluk. 6.48-49
¹⁴ I Mbret. [Sam.] 2.2; II Mbret. [Sam.] 7.22
¹⁵ Apok. 12.8-9
¹⁶ Ps. 17(18).4; 73(74).15
¹⁷ Ps. 35(36).9
¹⁸ Gjen. 1.3-24; Ps. 148.5
¹⁹ Hebr. 1.2
²⁰ I Mbret. [Sam.] 2.1
²¹ I Petr. 2.21
²² I Kor. 9.25
²³ Is. 53.9; Joan 8.46; I Petr. 2.22
²⁴ Matth. 25.7-10
²⁵ Hebr. 1.14
²⁶ Lev. 1.3; Sirak. 35(32).6; Is. 56.7
²⁷ Ef. 6.12
²⁸ Is. 26.17-18
²⁹ Is. 26.13
³⁰ Ps. 46(47).5
³¹ Jona 2.7
³² Ps. 4.7; Is. 9.2; Matth. 4.16
³³ I Tim. 6.16
³⁴ Is. 9.6
³⁵ III [I] Mbret. 18.38 etj.
³⁶ Dan. 6.18,22
³⁷ I Mbret. [Sam.] 2.30
³⁸ Kol. 1.24
³⁹ Ps. 44(45).3
⁴⁰ Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 25
⁴¹ Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 34
⁴² Urt. Sol. 5.16
⁴³ II Tim. 2.5
⁴⁴ Kënga 4.12
⁴⁵ Kënga 2.10,13
⁴⁶ Joan 1.1
⁴⁷ Gjen. 3.1-6
⁴⁸ Ps. 35(36).10
⁴⁹ I Kor. 4.1



MË 14 TË TË NJËJTIT MUAJ

Kujtimi i Avave të shenjtë në Sina dhe Raitho.

Tipikon

Në këtë ditë bëhet Mbyllja e së kremtes së Theofanisë dhe psalen të gjitha të saj përveç Leximeve, Litisë dhe Polieleit (si zakonisht, kur s'ka Ungjill në Mëngjesore), ndërsa thuhet Sinaksari, Apostulli dhe Ungjilli i ditës si zakonisht.

Sinaksari

Më 14 të të njëjtit muaj, kujtimi i Avave të shenjtë, të vvarë në Malin Sina.

Vargje: Shpata janë ato që bënë këtu shumë vrasje,/ ndërsa ata që pësuan janë burra, miq virtyti.

Rreth katërmbëdhjetës bronzi vrau Avatë.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i tridhjetë e tre Etërve të shenjtë, që u vranë në Raitho.

Vargje: Sikurse më parë Rakela qante fëmijët,¹/ tani Raitho qan avatë e prerë me shpata.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atit tonë oshënar Theodhuli, biri i Nilit të Urtë.

Vargje: Theodhuli u duk i madh në virtyte,/ madje duke e imituar jetën e të atit.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atit to-

¹Jer. 38(35).15; Matth. 2.18

në oshënar Stefani, ndërtuesi i Manastirit të Hinolakut.

Vargje: U hap gropë varri për Stefanin e hyjshëm/ që ngriti Manastirin e Hinolakut.

Në të njëjtën ditë, martirja e shenjtë Agnia, mbaron pasi e hodhën në burg të errët.

Vargje: Kur të papastër vunë Agninë në shtëpi terri,/ i shkaktuan një shtëpi të tërëndritshme.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i shën Nines, ndriçuese e Ivrisë (Gjeorgjisë).

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atit tonë ndër shenjtorët Sava, Kryepiskopi i Serbisë.

Me ndërmjetimet e tyre të shenjta, o Perëndi, mëshirona. Amin.

Nëse bie e diel, të shtunën në Mbrëmësore, pas Kathismës së Parë të Psaltirit, Thirtoret: 4 ngjallësore dhe të 4 (në 6) të së kremtes. Lavdi i së kremtes. Tani Hyjlindësore dogmatike e tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi dhe Tani i së kremtes (i Pasvargjeve) Përlëshoret: ngjallësore. Lavdi i së kremtes. Tani i njëjti. Përlëshim: Ai që pranoi të pagëzohet prej Joanit në Jordan për shpëtimin tonë dhe u ngjall prej së vdekurish, Krishti...

Të dielën, në Shërbesën e Mesnatës, në fund Përlëshorja e së kremtes. Në Mëngjesore Ndenjësoret ngjallësore, por

në vend të Hyjlindësoreve, Ndenjësoret e së kremtes. Bekimtoret. Ipakoia. Shkallesat dhe Proqimëni i tingullit; dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor. Kanunet: ngjallësor dhe të dy të së kremtes bashkë me Irmoset e tyre. Pas Odes III, Ndenjësore O Krisht Perëndia yn' (Kërkoje në të kremten pas Polieleit shih fq. 110). Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia ngjallësore dhe Sinaksari. Zbritësoret e dyfishta. Në vend të Më të nderuarën, Ode IX e të dy Kanuneve të së kremtes me Madhështimet e tyre. I shenjtë është Zoti... (3x) dhe Dërgimësoret: ngjallësore dhe e së kremtes (2x). Lavdërimet: 4 ngjallësore dhe 4 të së kremtes (me vargjet në dy të fundit, Deti pa dhe iku, Jordani u kthye mbrapa dhe Ç'është me ty, o det, që ike, dhe ti, o Jordan, që u ktheve mbrapa?). Lavdi i së kremtes (U rrethove me ujërat). Tani E përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji, Antifonet e së kremtes. Në Hyrje I bekuar është ai që vjen..., Shpëtona... që u ngjalle pres së vdekurish. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore, e së kremtes dhe e kishës. Kontaqi i së kremtes. Trishenjtë. Apostulli dhe Ungjilli i së Dielës pas Theofanisë. Në vend të Të meriton, O shpirt madhështojë... O çudi pa fund. Kungatore U shfaq Hiri shpëtimtar i Perëndisë për të gjithë njerëzit. Në vend të Pamë dritën, Përlëshorja e së kremtes.

Shënim: Pas Mbylljes së Theofanisë, fillojmë të themi Zbritësoret dhe Kontaqin e Ipapantisë (Ti që e shenjtërove mitrën virgjërore me lindjen tënde dhe bekoje duart e Simeonit siç i kishte hije; arrite dhe tani dhe na shpëtove, o Krisht Perëndi; por paqësoje shtetin në luftëra dhe forcoji mbretërit që deshe, i vetëm njeridashës).



MË 16 TË TË NJËJTIT MUAJ

Falja e zinxhirit të çmuar të apostullit të shenjtë dhe të tërëfamshëm Petro.

NË MBRËMËSORE

*Thirrtores**Ting. IV Os jeneon en mártisi*

Kur u lidhe për Zotin Krisht* dhe u mbylle për të në burg,*¹ o apostull, lidhe mashtrimin, ndaj dhe ne* të lartësojmë me mall; zinxhirit tënd po i falemi* duke nxjerrë prej atij* plot shëndet trupi dhe shërim* dhe shpëtim në shpirt,* të lëvdojmë, o hyshikues shenjt, i barabart' me të patrupët, pra denjësisht që të gjithë ne.

(2x)

Dijen morën përmes teje* shumë fise prej kombeve,* që më parë lidheshin në padituri,* si një ikonë për ta u shfaq një enë që zbriti posht',* çdo lloj kafshe mbante kjo,*² o apostull me nam të madh,* ndaj të lavdëron* dhe i falet çdo brez zinxhirit me të cilin me plot zell dhe vetëmohim u lidhe për Krishtin Zot.

(2x)

E mohove në gjyqin ti,*³ por pas Ngjalljes së vdekurish* e himnove Krishtin, e predikove fort*⁴ në tërësitë e botës, o apostull, si Perëndi* dhe njeri, që mirësisht* me të vdekshmit kish shoqëri,* ndaj të lumërojm'* dhe me mall ne u falemi

zinxhirëve që vure për Jisunë, o i kënduar me nam të madh.

(2x)

Lavdi

Ting. Tërth. II I Bizantit

Sot Petroja, bazamenti i Kishës, guri i besimit,⁵ na vë përpara zinxhirin e tij të çmuar për shëndet shpirtëror; ejani të gjithë, duke e përqaftuar vargoin, le ta kurorëzojmë me këngë lavdëruese apostullin: Gëzohu ti, luftëtar i ngrohtë i besës, që me mendje të zjarrtë pohove me guxim të shumtë Krishtin si Bir Perëndie;⁴ gëzohu, hareja e botës dhe mbajtës i çelësave të mbretërisë së qiejve;⁶ furnizoi me hir ata që të nderojnë me përmallim dhe e përqaftojnë me dëshirë zinxhirin tënd të respektuar, se qëndron pranë fronit të Perëndisë^{6a} tërëmbretit, duke ndërmjetuar për ne shkelësit.

Tani *Hyjlindësore*

O Hyjlindëse, ti je hardhia e vërtetë,^{6b} që nxore frytin e jetës; të ly-pim ndërmjeto, o Zonjë, bashkë me apostullin dhe me gjithë shenjtorët, që të mëshirohen shpirtrat tanë.

*ose Kryqhyjlindësore**Triimeros anestis*

Kur shihte që po varej në dru* Hyjlindësja që s'kish qortim,* jetën tonë,* po thërriste me vajtim* si nënë: O im Bir edhe Perëndia im Zot,

shpëto ata që të himnojn' me mall.

Pasvargje

Ting. IV Edhokas simiosin

Le t'i falemi zinxhirit me të cilin u zgjidhën krejt* pra vargonjtë e ve-seve;*⁷ ka plot shenjtëri, respekt* si dhurim që s' shprehet* nga i tërë-urti shën Petro, dhe vërtet ai* prej tij pranoi hir të vazhdueshëm.* Prej Perëndisë ka dhunti të presë prangat e fajeve,* si pret Petroja shkelje, faj* dhe na nxjerr ne prej tmerreve.

Varg: Në gjithë dheun doli zëri i tij dhe në skajet e botës fjalët e tij.

Po shkëlqen, o korife fort i kënduar, zinxhiri yt* si një varg qiellor me nam;* përmes tij ne ngjitemi* nga posht', që prej dheut,* për në lartësi portash qiellore, o i urt',* i tërëndritshëm, dhe të afrohem i me besë, se ke çelësat e mbretërisë në dorëzim,*⁶ ndaj për ne hapna hyrjen krejt* shpëtimtare,⁸ me mirësi.

Varg: Qiejt tregojnë lavdi Perëndie.

Rreshtat engjëllorë, Petro, tok me njerëzit himnin tënd* me një zë po këndojnë sot,* se kur hyri engjëlli* dhe të tundi brinjën,* rendje para rojeve; prangat që të mbanin peng* i le⁹ si lidhje te sa të lidhën ty* dhe na i dhe vargonjtë si gëzim, dhe krimet që s'zgjidhen dot* ti i zgjidh, o i tërëurt'* korife famëmadh me nam.

Lavdi *Ting. Tërth. II*

Përsëri na mbledh në panair për dëfrim shpirtëror mbrojtësi i ngrohtë, Petroja, guri i besimit,⁵ duke na vënë përpara zinxhirin e tij të çmuar si një ngrënie e vyer në klinikë sëmundjesh, në ngushëllim të shtrënguarish, në liman të dimëruarish; ejani të gjithë ta përqafojmë dhe le t'i përgjrohemi atij që e lavdëroi të lidhurin me të: Me ndërmjetimet e tij, o Krisht, shpëto shpirtrat tanë.

Tani *Hyjlindësore*

Olin apothëmeni

Poshtë shkava me vullnet,* u bëra skllavi i kurthit* të mashtruesit, o Vajz'* dhe Hyjnuse, unë i mjeri, ndaj përik* te ndërmjetimi yt* fort i admiruar,* pranë mirësisë sate flakë, o e Tërëshenjt',* që qortim nuk ke kurrë; më çliro* nga prangat e shtrëngimeve* si edhe të ngasjeve; më shpëto* pra nga satanai dhe sulmet e tij, që të të lëvdoj,* të të himnoj, të të madhëroj* me mall, të të falem ty.

ose Kryqhyjlindësore

Triimeros anestis

O Krisht, kur të shikonte mbi kryq* të kryqëzoheshe ajo* që të lindi,* po thërriste me vajtim* si nën': Fëmija im, Zoti im, bir fort i ëmbël,* si po duron pësim të turpshëm ti?

Përlëshore Ting. IV

Ndonëse s'e braktise Romën, erdhe te ne përmes zinxhirëve të çmuar që mbajte, i parëfronshëm i apostujve; duke iu falur me besë lypim: Me anën e ndërmjetimeve të tua drejt Perëndisë, dhurona përdëllimin e madh.^{9a}



NË MËNGJESORE

Stihologjia e zakonshme dhe Kanunet: një i Oktoihut dhe dy të apostullit.

Ode I

Kanuni i parë i apostullit, që ka Akrostihidhë (pa Hyjlindësoret): "Iu falemi me mallëngjim prangave të Petros".

Ting. IV

Anikso to stoma mu

Mbështetemi, o i parëfronshëm, lavd i apostujve* të Krishtit, mbi gurin⁵ e pohimit tënd krejt hyjnor,*¹⁰ dhe u falemi* zinxhirëve të tu ne* me bes', se t'i lidhën ty duart pa cen aspak.

Të vuri ty, o apostull, Zoti si dëshmitar besnik* dhe autentik i mishërimit, që ta rrëfesh* dhe ta predikosh* guximin e tij, kryqin* me vdekjen dhe ngjalljen e tij shpëtimtare krejt.⁴

Tri herë mohove Krishtin pranë pe-

rëndivrasësve,* ashtu si njeri të thjesht',³ por jashtë s'dole dot ti* prej thelogjis'* që the më para, Petro,* se e predikove si Bir Perëndie, Zot.¹⁰

Këputi zinxhirët e mëkatit⁷ tonë, apostull ti,* me besë i falemi zinxhirit tënd plot me mall,* thyej bravat pra,*⁶ për ne hap mbretërinë* e sipërme, si zemërmirë, i dhembshur krejt.

Hyjlindësore

Fuqi nuk kam unë i fëlliqur jam, i përlyer keq,* të flas për ty, strehën e dëlirë të virgjëris',* ti që s'njohe burr',* ndaj më pastro përbrenda* shkrites së Shpirtit të Shenjtë, që të të mburr.

Kanun tjetër, që ka Akrostihidhë: "E lavdëroj Petron, bazën e dogmave.

Josif".

Ting. i njëjtë

Hori Israil

Kërcen dhe bën panair shpirtërisht* Kisha mbar' e Krishtit dhe të lëvdon besërisht me ziarr,* o apostull i lumur* dhe i parëfronshëm,* me për-mall e puth zinxhirin* e nderuar që ke mbajtur ti* kur ishe lidhur, dhe kështu lidhe tiranin fort.

O Petro, rrjetoje njerëzit ti* nga mashtrimi edhe i sillje si peshq te Krishti Zot,*¹¹ që të zgjodhi apostull,* vërtet korifeu* mes apostujve të gjithë,*

dhe pse ishe peshkatar i thjesht';* puthim zinxhirin që ty të lidhi me përkushtim.

Mbi besën si mbi themel vure ti* dhe ndërtove shpirtrin¹² e çdo besniku, shën Petro ti* dhe pasi shkatërrove* tempujt e mashtrimit,* ngrite kisha që me zë fort* të nderojnë, i gjithurt', i lum,* tok me ty dhe zinxhirin që mbajte në burgun tënd.

Hyjlindësore

Shteruan krejt tërë shpatat që kish* djalli, pra armiku dinak,¹³ e pa cen, e virgjër krejt,* që atëher', kur shtiza* shpoi Fjalën, Zotin,* që në barkun tënd pa njollë* kish banuar; ty të lyp tani:* Zemrën me dashurin' e tij t' ëmbël plagose ti.

Ode III

Uk en sofia

Itërëfamshëm,* për zinxhirin e keqbërësit që ty* mbret Irodhi të kish vën'* kur të dënoi,¹ tani Kisha jon'* të nderon, i falet pësimit tënd me besim.

Uzbukurua* me zinxhirin tënd më shumë se me ar* dhe stolisje të çmuar,*¹⁴ apostull, Kisha; e puth me përmall,* se për ty krenohet dhe mburret, o Petro shenjt.

Të dorëzoi* pra tetrarku mbret te katër katërshja* dhe të vuri në zin-

xhir,* të ruante për të vrarë, Petro,* por ty të çliroi me engjëjllin Krishti Zot.¹

Hir kanë marrë* prangat që prekën lëkurën¹⁵ tënde fort* të hyjnueshme me hir* dhe të nderuar, prandaj shenjtërojn'* gjithë që iu falen me besë, apostull shenjt.

Hyjlindësore

Ja ku u zgjidh krejt* njerëzimi nga nëma e lashtë¹⁶ krejt* dhe satani u shfaros,* se shkak mekati dhe rënie ish; *¹⁷ e dëlirë, linde bekimin e madh për ne.

Tjetri: Tokson dhinatón isthénise

Ishe,* o shën Petro tërësisht* me ndriçim të pastër krejt i bashkuar, u shfaqe pra* me kungimin hyjnor si dritë,* drit' e dytë që shndrit zemrat nur.

Bazë* e patundur dogmash je* si dhe korifeu midis apostujve, përforcim* je për ligjet e Krishtit, ndërsa* të paligjve u mësove ligj.

Zotin* që pësoi dhe me kryq* u kungua, ti në mish e lëçite me gjuh' të shenjt',*⁴ ndaj, o Petro, ne i nderojmë* prangat që të lidhën ty në burg.

Hyjlindësore

Sulmin* e pandalshëm, o hyjnën'*

dhe Perëndilindëse, vdekja deri në ty e kish,* Zonjë, se vetëm ti e linde* pra burimin e pavdekësis’.

Irmosi: Tokson dhinatón isthénise

»Harku* i të fortëve u tret* dhe të »dobësuarit janë ngjeshur me plot »fuqi,*¹⁸ ndaj në Zotin u sigurua* ze- »mra ime¹⁹ pa u tundur dot.

Ndenjësose

Ting. IV Tahí prokatálave

Ti tempull hyjnor u bëre për Trininë e Shenjt’,* e mbiperëndishme; sa të mburrin ty besërisht në tempullin tënd, i shndrit* dhe shenjtëroji, përmbush* çdo kërkesë që kanë,* jep zgjidhjen e skandaleve që sjell keq beliari,* o Petro apostull, lutju Krishtin Zot pa pushim.

Lavdi *I njëjti*

O ipsothís en to stavró

Të mburrim besërisht* porsi korifeun* e gjith’ apostujve* të urtë, ke kyçet* e mbretëris’ së qiejve;⁶ i puthim me mall,* me ndërgjegje të qëruar ne* prangat, Petro, që mbajte ti* si keqbërës, por kështu* na zgjidh ne nga keqdashja* e djallit, e armikut tinëzar;* lyp të shpëtojmë* prej tij, o apostull shenjt.

Tani *Hyjlindësore*

Ushfaqe më e gjer’* se qielli, dheu* dhe më e madhe se* Krijesa e dukshme* dhe e padukshme, më e lar-

të në krahasim* të pakrahasuar, nga engjëjt* nga të gjith’ Keruvimet dhe* Serafimet, se atë* që s’e mbajn’ gjerësitë* e qiejve e mbajte ti në bark;* lype, e paster, * që ne të shpëtohemi.

ose Kryqhyjlindësore

Ajo që mishërisht* së fundmi të lindi,* ti që prej Atit pa* fillim fare linde,* kur të pa varur përmbi kryq, thërriste, o Krisht:* O Jisu i shtrenjt’, i dashur fort,* kryqëzohesh nga njerëz* të paligj vullnetarisht* ti tani, që lëvdohesh* si Perëndi nga engjëjt; të himnoj,* ty zemërgjërën* edhe njeridashësin.

Ode IV

O kathímenos en dhoksi

Manteli perandorak dhe qyteti mbretëror ngjishet mendërisht me besë, o Petro, me zinxhirin e paçmuar, të cilit duke iu falur fizikisht, e puthin me mall dhe lartësojnë edhe fuqinë edhe mrekullitë e tua.

Në burg Irodhi të vuri në vargonj, që të të çonte në bashkësi hyjvrasëse, o apostull; por pasi shpëtove nga Hyjnia,¹ ua ke lënë prangat e tua shërbyesve të tu për falje.

Zinxhiri që të qarkoi, meqenëse u forcua kur preku trupin tënd të pacenuar dhe u hirësua, shenjtërim transmeton te ne të gjithë që i falemi

atij, o Petro i tërënderuar.

Me frikë dhe mallëngjim le të afrohem i dhe le të biem para prangave të Petros, duke ia sjellë apostullit përmes simboleve besimin, të siguruar se nderimi kalon tek ai.

Hyjlindësore

Duke zmbraurur çdo herezi, të përhimnojme ty Perëndilindëse, se linde Perëndi me trup; sepse Fjala²⁰ u shfaq, pasi gatoi brenda vetes së tij mish të gjallë nga gjaku yt.

Tjetri: Dhi agápisin iktirmon

Duke predikuar me oratori madhështitë e Zotit, i ktheve zemrat e hebrenjve të pabindur drejt besimi të perëndishëm,⁴ duke qenë ti bazamenti i besimit.

U njohën ecjet e tua mbi ujëra në saje të miqësisë hiperbolike me atë që eci mbi to, o Petro,²¹ dhe që t'i bëri të njohura udhët e hyjshme.²²

Duke e pasur klinikë për sëmundje të shumëllojshme zinxhirin tënd të hyjshëm, o i tërëlumur, e puthim atë duke të lartësuar besërisht.

E shenjtëron Romën, o Petro, me vendosjen e trupit të hyjshëm, dhe e ndriçon të Renë, e cila zotëron me besë zinxhirin tënd të vyer.

Hyjlindësore

O Zonjë e tërëpaqortueshme, mbreti i të gjithave u pa i njerëzuar, pasi banoi në mitrën tënde të shenjtë si në pallat mbretëror të gjerë.

Ode V

Nin anastísome profitikós

Ngri, hiq, o apostull prangat e mëkatit tim,⁷ të cilat janë mbi qafën time dhe më shtynë në prishje, se ke marrë pushtetin e Shpëtimtarit që të lidhësh dhe të zgjidhësh shkeljet.⁶

Pusho, o i tërëfamshëm, kryengritjen e kombeve; zgjidh skandalet e Kishës, duke dhënë njëmendjesinë, ti që për hir të saj u lidhe me zinxhir, të cilin e përqafojmë me besë.

Çliroji, o apostoll, nga robëria mendore ata që i falen besërisht zinxhirit tënd, dhe shpëtona në tenda qiellore,²³ të cilat të janë besuar⁶ si bariu dhe mësuesi ynë.

Ata që i drejtësoi Mësuesi yt me ndërmjetimin tënd të frikshëm, që të mbretërojnë mbi ne, o Petro apostull, ruaji me të djathtë tënde të fortë të qëndrojnë orthodhoksë, o i tërëfamshëm.

Hyjlindësore

Të pa dielli, o e tërëhimnuar, të jesh shumë më eprore nga vezullimet e tij; prej teje u pa Perëndia i mishëruar,

duke lartësuar drejt dritës së Hyjnisë së tij ata që të nderojnë.

Tjetri: Ton fotismón su Kírie

Të bashkëpamotshmin me Atin e predikove si Bir, me anën e zbulimit hyjnor, o i tërëfamshëm, dhe u vlerësove për lumërim nga një gojë e lumur.²⁴

Kur pe dritë që shkëlqeu në Thavor të mbulonte rrezet e diellit,²⁵ llamburite me dritën prej dritës, o Petro, dhe e njohe Krishtin si Perëndi.

E predikove Krishtin si të vdekur⁴ të triditshëm, për hir të të cilit vure zinxhirë, o Petro; pasi u denjësuam t'u falemi atyre, të lartësojmë shpresëtarisht.

Hyllindësore

Më lehtëso tani mua të rënduarin me ngarkesën e mëkateve të shumta, o e kulluar, duke më fuqizuar që ta mbaj zgjedhën tepër të lehtë të Krishtit.²⁶

Ode VI

Ilthon is ta vathi tis thalasis

Bashkësi apostujsh dhe fuqi qiellore sot dëfrehen* tok me tokësore, duke parë,* o Petro shenjt,* se nderojm' pësimin tënd;* shenjës së tij po i falemi.

Kor shenjtorësh po duartroket,

ndërsa ulëret brigada* e demonëve të frikësuar,* se, Petro, sheh* të nderojm' pësimin tënd;* shenjës së tij po i falemi.

Fjetën me praninë engjëllore ushtarët roje, o shenjt,* befasisht prej duarve të tua* zinxhirët ran';⁹ ndaj këto i puthim ne,* Petro, edhe lumërohemi.

Ngrite Tavithan' e vdekur,²⁷ ndërsa i vrave disi rojet,* të liroheshë ti nga zinxhirët;*⁹ çdo gjë që bën* përmbi mend, apostull, është,* besërisht të lavdërojmë pra.

Hyllindësore

Erdha në një dimër shkatërrimi, lumenj gabimesh pa mas'* më trazuan, por ti dhembshuromë,* o Zonja jon',* dhe në port të hyjshëm ti* më drejto, në falje dhe pendim.

Tjetri: Evóise protipón

Ti kryqëzim* mbrapsht durove paradoksalisht, kështu* përgatite* për një udh' qiellore lart këmbët drejt;* na forco të ecim* në të, o Petro, nxënësi i Krishtit Zot.

Jetove ti* tok me Jetën e të gjallëve edhe* qesh' i lidhur* për të, pra i dërrmove vargonjtë tër'* të beliarit, ndaj ne* i nderojmë zinxhirët që të lidhën.

Ti lyp Zotin* e Krijesës nga lart të dërgojë hir,* zbutje, paqe,* përdëllim tek ata që të mburrin ty,* o i tërëlumur,* si dishepull i tij i sinqert' vërtet.

Hyjlindësore

Stërati yn'* një këmishë lëkure të vdekshme krejt* kishte veshur,*²⁸ por Ndërtuesi vishet me të, o Zonj',* kur nga gjaku yt ky* mishërohet mbi mendje, e pacenim.

Irmosi: Evóise protipón

»Varrimin tënd* të triditshëm e »paraskiconte qart'* duke thirrur,* »kur në një peshk të madh lutej, o »Jisu,* shën Jona profeti:*^{28a} Mbret »i forcave,^{28b} prej prishjes më çliro.²⁹

Kontaqi

Ting. II Tin en presvies

Le ta nderojmë të parin ndër gjith' apostujt,* pra korifeun, Petron krejt të madh, mësues* i perëndishëm i së vërtetës son',* dhe me besim zinxhirin e tij ta puthim, që kështu* të marrim ne zgjidhjen e mëkateve.

Shtëpia

Nxënësin e madh dhe të lavdishëm të Zotit, cila gjuhë njerëzore do të mundë ta lartësojë denjësisht? Atë që Fjala Perëndi e lumëroi arsyeshëm,²⁴ cila mendje do ta lavdërojë? Meqë atë çka zotëron çdo njeri sipas mundësisë, detyrohet t'ia

ofrojë Krishtit, këtë pra do të përpiqem ta bëj. O krentimdashës, le ta kurorëzojmë të parëfronshmin me këngë, që kështu të marrim ne zgjidhjen e mëkateve.

Sinaksari

Më 16 të të njëjtit muaj, falja e zinxhirit të çmuar të apostullit të shenjtë dhe të lavdëruar Petro.

Vargje: O Petro, duke iu falur vargoit tënd të çmuar,/ më zgjidh nga vargu i gjatë i mëkateve.⁷

Në të gjashtëmbëdhjetën i falem vargoit të Petros.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirëve të shenjtë dhe vëllezërve Pepsipit, Elaspit dhe Mesipit, si dhe të gjyshes së tyre, Neonilës.

Vargje: Edhe pse janë kalorës sipas emrave,/ vrapojnë më këmbë trinjakët drejt flakës.

Është plakë, por duron zjarr të ndezur/ Neonila, si një e re e gjallë.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirit të shenjtë Danakti nga Iliria.

Vargje: Ta hoqën D-në bashkë me kokën, o Danakt,/ sepse pasi të prenë, u pe mbret qiellsundues.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i hiero-martirit të ri Damaskini, i cili u martirizua në Bullgari në 1771.

Me ndërmjetimet e tyre të shenjta, o

Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII

O dhasosas en piri

Ai që dukej se mbretëronte, por më saktë mbretërohej nga kënaqësia, duke bërë për judenjtë çfarë u pëlqente, të dënoi me pranga hekuri;¹ duke i nderuar ato, të përhimnojmë, o apostull.

Tërhiqet para teje, o nxënës i Krishtit, gjithë Krijesa, sepse me anën e fuqisë së Ngushëllimtarit detet u llogaritën të shkelshme,²¹ prangat si shtupa dhe portat e hekurta si kalim.¹

Bashkëshfuqizove magjistarë të rremë,^{29a} ngjalle të vdekur,²⁷ shërove të çalë³⁰ dhe të paralizuar,³¹ shëndoshe me hijen tënde të sëmure,³² përshkove porta të mbyllura dhe zhveshe prangat,¹ të cilave u falemi, o Petro.

Apostulli Petro, kali i Krishtit, pasi doli nga Palestina si nga pikënisja, dhe predikoi te bota, pushoi në Romën e mëparshme, ndërsa e dha tek e Reja zinxhirin, që t'i falemi.

Hy lindësore

Flaka kaldaikë, duke mos dëmtuar fare Djemtë,³³ e deklaronte risinë e shtatzënisë sate; prandaj, o Zonjë, me freskimin e ndërmjetimit tënd më shpëto mua, që flakërohem nga

shumë shkelje.

Tjetri: Avramiei poté

Tri herë e mohove Krishtin,³ prandaj me pyetje të trefishtë³⁴ shëron krimin tënd dhe të tregon mbështetje për shumë njerëz³⁵ që tundohen, o Petro i gjithëkënduar.

Meqenëse u lidhe me mall tepër të ëmbël për Krishtin, u kungove me pranga të ndryshme; prandaj i falemi me besim zinxhirit tënd që zgjidh pasione, o Petro.

O Petro, dëshmitar okular i Krishtit, lavdia e apostujve, duke përshkuar planetin si diell shumë i madh, thyen natë të thellë politeizmi.

U bërë lavdia e Krishtit, sepse e lavdërove në gjymtyrët e tua, o Petro i gjithëkënduar; prandaj të lartësojmë dhe zinxhirit që të lidhte i falemi.

Hy lindësore

Ai që zbriti mbi dhé si shi, o e Virgjër, vaditi me hyjdije tërë tokën^{35a} dhe të tregoi ty si më të çmuar se gjithë engjëjt, o e kulluar.

Ode VIII

Litrotá tu pantós

O Petro i lavdëruar, ligjvënës, barí dhe mësues i deleve të Krishtit,³⁴ çliroji nga vargonj mëkati⁷ ata që u falen zinxhirëve të tu besërisht dhe

që të himnojnë shpresëtarisht.

Dëbo ngacmime demonësh dhe zbut dimër mëkati, duke larguar sëmundje, rreziqe, shtrëngime dhe sulme barbarësh nga ata që i nderojnë zinxhirët e tu, o Petro.

O apostull, u hirësua çdo njeri që prek vargoin tënd të çmuar, duke u mbushur me shenjtërim, dhe këndon me gëzim: Gjithë ju vepra, bekon, himnoni Zotin.³⁶

Falja shpresëtare e zinxhirëve të tu të nderuar është mbi çdo kënaqësi gostie; sepse ti u bërë gostar i një hareje të tillë të hyjshme, o apostull.

Hyjlindësore

Si u zvarrit gjarpri dinak, me mendimet e këqija më internon nga shijimi,¹⁷ por engjëlli i mendimit të madh,³⁷ kur u bë njeri nga mitra jote, më bëri përsëri banor të Parajsës.

Tjetri: I njëjti

Duke kultivuar ara zemrash, o Petro, i bërë ato shumë pjellore për bujkun e Krijesës,^{6b} i cili të jep ty çelësat e hyjshëm, që të lidhësh dhe të gjidhësh krime.⁶

Të lumërojmë gjithmonë, o Petro apostull, dhe e puthim zinxhirin tënd, të cilin e mbaje si kriminel,

duke shfarosur kryetarin e së keqes dhe duke e lidhur me prangat e tua.

Duke ruajtur tërësinë e Kishës mbi gurin tënd të patundur të besimit,⁵ dëboji nga mesi skandalet, o Petro i lumur, dhe kërko për atë gjendje të paqtë.

I predikove bujshëm prangat dhe pësimin e pacenuar të atij që e lidhi Hadhin dhe vdekjen;⁴ për këtë, o i tërëlumur, shenjtërohemi duke e puthur zinxhirin tënd.

Triadik

Le të thërrasim si rreshtimet e sipërme me zëra trishenjtorë, duke e lavdëruar³⁸ tani Atin gjithëshkaktar, Birin dhe Shpirtin, një esencë, një fuqi, një energji.

Hyjlindësore

O Hyjnënë, profeti të parashkroi llambadar mendor, kandiler³⁹ hyjnor,⁴⁰ që ndriçoi ish të errësuarit prej nxirjeve të të këqijave të shumta.

Irmosi: Litrotá tu pantós

»Fuqplot', çlirimtar* për të gjithë »ne, te të rinj zbritë, se* mbanin »besën fort* mes flakës; i freskove »pra,*³³ i mësove të psalnin:* Ju gjithë »thë veprat,* e bekon, himnojeni »Zotin ton'.³⁴

Ode IX
Apas jijenís

Je plot ëmbëlsi, apostull, i tëri, kur të lavdërojmë ty,* është mbushur plot me gaz* çdo panair dhe festë e jotja, shenjt;* ndaj dhe tani shërbyesit e tu dëfreji ti,* shenjtëroji,* denjësoji me hare* ta kremtojmë kujtimin tënd famëmadh.

Thiej, o apostull, forcën e kombeve që na mësyjnë ne,* me fuqi të pamposhtur* që ke dhe, mbretit ton' ia nënshtro ata;* arkondët e armiqve ti me vëng në dor' e këmb',* pra tregoji* në qytetin tënd tani,* ku nderojmë zinxhirët e tu në trup.

Janë të vërteta fjalët e tua që me autoritet,* o Zot, the «Kush më beson,* do bëjë punë më të mëdha se un'»,*⁴¹ se kur jetonte, i shëronte thjesht me hijen ky* të sëmurët,*³² ndërsa me vargonjt' e tij* bën apostulli shume çudi tani.

Triadik

Atë krejt i Lartë, Bir dhe Ngushëllimtar, Trini me një nderim,* përmes përgjërimeve* të korifeut dhe gjith' apostujve,* në luftë bëhu aleat me mbretin përgjithnjë,* ndërsa gjendje* të patundur, pa tërmet* edhe paqe na jep për qytetin ton'.

Hyllindësore

Çdo i vdekshëm nuk arrin të himnojë

lindjen tënde të huaj;* fjalën e një engjëlli* që fluturoi nga lart, të psalim ty* me gaz: Gëzohu,⁴² o çlirim i njerëzve, ushqim* të vobektësh,* mbrojtje prej demonëve* dhe pas-trimi i njollave tona je.

Tjetri: O tokos su áfthoros edhihthi

Të largëtat që shpresoje, Petro, me bes', u denjove t'i shikosh lart,* edhe nga Perëndia njeridashës merr me gaz çmimin për çdo lodhje;* ikonizove* në mish ti pësimin tër'hyjnor.

Mban kycet e mbretëris' hyjnore,⁶ ndaj hyrjet e saj i hape⁸ për ne* që me besë mbi dhë të mburrim, Petro, edhe puthim vargonjt' e rëndë,* të respektuar,* që të vunë kur në burg ti re.

Kur ishe me Birin në Thavor u denjove që të dëgjoje zërin* atëror që e shpalli,²⁵ pasi Shpirti i nderuar të kish ndriçuar* zemrën e pastër* o shën Petro, paradoksalisht.

Për ne që me mall ty të nderojmë, e puthim zinxhirin tënd, o Petro,* me të cilin të lidhën, ti kërko pra zbutjen, zgjidhjen e çdo mëkati,* si dhe shijimin* qiellor, në Mbretërinë lart.

Hyllindësore

U bëre banesë drite, ndaj më shkëlqeqe mua, që po errësohem* nga të gjitha veprimet e armikut, nën' e vir-

gjër e Tërëshenjtë,* që me shpirt, besë,* o Vajz', të të madhështoj me lavd.

Irmosi: O tokos su áfthoros edhihthi
 »U shfaq e paprishshme lindja jo-
 »te; nga barku yt doli Perëndia,*
 »kur mbi tokë⁴³ u pa me mish edhe
 »u shoqërua me vdekatarët;*⁴⁴ të
 »madhështojmë* të gjith', o Perën-
 »dilindëse.

Dërgimësore
Jinekes akutísthite

S'të frymëzoi mish e gjak,* por Ati për thelogji,* Krishtin ta quash ti Birin* e Perëndisë të gjallë,* Ati²⁴ ndaj të dëshmoi ty* që më parë të lumur fort,* dhe sipas emrit tënd të tha,* o Petro, gur⁵ të paçarë* dhe bazamenti i Kishës.

Të njohim Virgjëresh' pa cen,* të tërëpaqortueshme* dhe nënë, se mbi natyrë* ke lindur Zot dhe njeri tok* dhe shtatzënia jote ish* krejt shpëtimi për sa këndojn'* me mallëngjim: Nder me falje,* lavd i ka hije Triadhës* Hyjnore të paku-fishme.

Lavdërime

Ting. Tërth. II Trímeros anestis

I falemi zinxhirit me bes',* nderojmë lodhjen, mundin tënd,* korife shenjt famëmadh, që bëre ti* në predikim, himnojmë dhe Krishtin jetëdhënës*

dhe mirëbërësin e shpirttrave.

(2x)

I tërëfamshëm, ngrite nga posht',* nga thellësi e pabesis'* njerëz me grep,* përmes predikimin tënd,*¹¹ dhe ne që të himnojmë me mall çlirona, Petro,* nga çdo mërzi me ndërmjetimin tënd.

Me ndërmjetimin tënd si me kyç* të hyjshëm,⁶ o i famshëm fort,* hijeshoji* hyrjet qiellore lart,* na i hap portat,⁸ se ke guxim për sa lëvdojnë* kujtimin tënd, si korife që je.

Lavdi *Ting. IV*

Me pyetjen e trefishtë "O Petro, a më do?", Krishti e korrigjoi mohimin e trefishtë; pra Simoni i tha njohësit të të fshehtave: "O Zot, ti i di të gjitha, njeh çdo gjë, ti di se të dua"; ndaj i tha Shpëtimtarit: "Kullot delet e mia, kullot zgjedhjen time, kullot qengjat e mi,³⁴ që i fitova për shpëtim me vetë gjakun tim".⁴⁵ Atij përgjëroju, o apostull i hyjlumur, që të na dhurohet përdëllimi i madh.^{9a}

Tani *Hyjlindësore*
Os jeneon en mártisin

Ndërmjetim i pafjetur je,* ngushëllim këmbëngulës tok* për ne pranë Zotit, o e dëlirë krejt;* ndaj i përgjum ngasjet, zbutëso tallazet, o Vajzë, ti* të të mjerit shpirtit tim,* ngushëllo zemrën time pra,* sepse

ka shtrëngim,* ty të lyp, hirësoje mendjen time të të lavdëroj siç duhet, të të himnoj siç e meriton.

ose Kryqhyjlindësore

Kur të pa, o bari⁴⁶ dhe qengj,*⁴⁷ të jesh varur mbi kryqin tënd,* shqerra që të lindi, si nënë me vajtim* të thoshte: Bir fort i dashur, si u vare në dru mbi kryq,* o Zot, Fjalë zemërgjer',* si dhe duart me këmbët tok* t'i gozduan ty* të paligjshmit, dhe derdhe gjakun tënd të pacenuar, të paçmuar, që ta shpëtosh njerëzinë ti.

Nëse do, psal Dhoksologjinë, ndryshe Pasvargjet e Oktoihut.

Lavdi

Ting. IV I Anatoliut

Denjësisht ke marrë nga Perëndia karizmat, o apostull i urtë, guri i besimit,⁵ si shkëmbim ia solle Ndërtuesit gjakun tënd porsì gjellë e ëmbël, o i gjithëfamshëm, dhe u tregove përmes Hirit çelësmbajtës i portave qiellore⁶ te të gjithë që të lavdërojnë me besë.

Tani *Hyjlindësore*
Edhokas simiosin

Shpiritin tim e torturon keq errësira e frikshme tmerr,* o hyjnuse me mirësi,* ndërsa bën të dridhet ky* dhe të shtanget gjyqi* me hetues djallin; prej tij çliromë me fuqi* ti, o e Virgjër, që dasmë s' njohe dot;*

renditmë në liman shpëtimi dhe në dritën pa perëndim* të shenjtoreve lart në q'ell,* ku ka gaz dhe hare gjithnjë.

ose Kryqhyjlindësore

Zonja e dëlirë krejt kur shihte Krishtin të vritej keq* duke vrarë mashtruesin,* bërtiste vajtueshëm, hidhërisht për Birin* që u lind prej mitrës së saj, dhe shtangej me çudi,* zemra e tij e gjer' e mahniti fort,* ndaj tha: Mos e harro ti shërbëtoren tënde, fëmija im* fort i dashur, mos u vono,* njeridashës, gëzimi im.

Dhe të tjera si zakonisht.

Në Liturgji, Tipiket dhe nga Kanuni i apostullit, Ode III dhe Ode VI. Kontaqi Ti që e shenjtërove (shih fq. 356). Kungatore: Në tërë dheun.

CITIME

¹ Vep. 12.3-11

² Vep. 10.11-12

³ Matth. 26.69-75; Mark. 14.66-72; Lluk. 22.54-61; Joan 18.16-27

⁴ Vep. 2.14-36; 4.8-12

⁵ Matth. 16.18

⁶ Matth. 16.19

^{6a} III [I] Mbret. 18.15

^{6b} Joan 15.1

⁷ Fjal. Urt. 5.22

⁸ II Petr. 1.11

⁹ Vep. 12.6-11

- ^{9a} Num. 14.19 etj.
¹⁰ Matth. 16.16
¹¹ Lluk. 5.10
¹² I Kor. 3.10; Ef. 2.20
¹³ Ps. 9.7
¹⁴ Ps. 18(19).11
¹⁵ Vep. 19.12
¹⁶ Gjen. 3.16-19
¹⁷ Gjen. 3.1-6
¹⁸ I Mbret. [Sam.] 2.4
¹⁹ I Mbret. [Sam.] 2.1
²⁰ Joan 1.14
²¹ Matth. 14.28-29
²² Ps. 67(68).25
²³ Lluk. 16.9
²⁴ Matth. 16.17
²⁵ Matth. 17.1-2; Mark. 9.2-3; II Petr. 1.18
²⁶ Matth. 11.28-30
²⁷ Vep. 9.40
²⁸ Gjen. 3.21
^{28a} Matth. 12.40
^{28b} Ps. 67(68).13
- ²⁹ Jona 2.7
^{29a} Vep. 8.18-24; 13.6-11
³⁰ Vep. 3.2-7
³¹ Vep. 9.32-34
³² Vep. 5.15
³³ Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 25-26
³⁴ Joan 21.15-17
³⁵ Lluk. 22.32
^{35a} Is. 55.10
³⁶ Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 34
³⁷ Is. 9.6
³⁸ Is. 6.3
³⁹ Eks. 25.30; 35.16; 38.13; 40.22;
Num. 4.9; 8.2
⁴⁰ Zah. 4.2-3
⁴¹ Joan 14.12
⁴² Lluk. 1.26-28
⁴³ I Tim. 3.16
⁴⁴ Varuh 3.38
⁴⁵ Vep. 20.28
⁴⁶ Joan 10.11,14; Hebr. 13.20; I Petr. 2.25
⁴⁷ Zah. 13.7; Joan 1.29,36; Apok. 5.6 etj.



MË 17 TË TË NJËJTIT MUAJ

Kujtimi i atit tonë oshënar dhe hyjprurës Andonit të Madh.

Tipikon

Nëse bie e diel, të shtunën në Mbrëmësore, Thirrtores: 6 ngjallësore dhe 4 të oshënarit. Lavdi i oshënarit. Tani Hyjlindësore dogmatike e tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimëni. Leximet. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi i oshënarit dhe Tani i tij. Përlëshoret: ngjallësore, e oshënarit dhe Hyjlindësore e tij.

Të dielën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Kanuni Triadik. Litia e oshënarit. Himne Triadike. Trishenjtë. Përlëshorja e oshënarit. Në Mëngjesore, Ndenjësore ngjallësore. Pas Polieleit, Ndenjësoret (pas Polieleit) e oshënarit. Bekimtores. Ipakoia. Shkallesat dhe Proqimëni i tingullit. Kanunet: ngjallësor dhe i oshënarit. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e oshënarit, dhe Ndenjësoret e tij. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia ngjallësore, dhe Sinaksari. Zbritësoret Fundin edhe burimin; dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor: Më të nderuarën. Dërgimësoret: ngjallësore, e oshënarit dhe Hyjlindësore e tij. Lavdërimet: 4 ngjallësore dhe 4 të oshënarit. Lavdi Eothinoni. Tani E përmbibekuar. Sot erdhë. Në Liturgji, Tipiket. Lumërimet: 4 të tingullit dhe 4 nga Ode VI e oshënarit. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore, e oshënarit dhe e kishës. Kontaqi Ti që e shenjtërove. Apostulli dhe Ungjilli i së di-

elës. Kungatore e së dielës.



NË MBRËMËSOREN E VOGËL

Thirrtores

Ting. II Ote ek tu ksilu se nekrón

O atë, kur e mbylle veten tënde i gëzuar në varr për dashurinë e Krishtit, duke duruar me qëndrueshmëri të hekurt dënimet e dëmonëve, me lutje dhe me hir i dëfteve mendimet e tyre më të pafuqishme se bryma; atëherë duartrokitën rendet e engjëjve duke thirrur: Lavdi atij që të forcon, o Andon.

(2x)

U dëfteve një lila tjetër, o i urtë, duke pasur nxënësit e tu të lavdëruar si Eliseun;¹ atyre ua le të dyfishtë hirin tënd, kur u rrëmbeve në eter si me karrocë;² prandaj duke jetuar në shpirt,³ tani ngazëllohesh tok me ta dhe i kujton të gjithë që kremtojnë me mallëngjim panairin tënd të respektuar, o Andon i tërëlumur.

Si Moisiu hyjshikues⁴ u fute me të vërtetë nën errësirë⁵ mendore te-orish, dhe në vazhdim e sodite atë që dëshiroje fuqishëm, dhe duke u lavdëruar në fytyrë me ndriçimin⁶ e tij, o atë, u udhëhoqe për në banesa shpëtimi;⁷ ndaj pasi u mblodhëm, o hyjmendës, thërresim me hare: La-

vdi Perëndisë tonë, që të fuqizoi.

Lavdi *Ting. II*

Le të nderojmë Andonin, engjëllin mbi tokë dhe njeriun e Perëndisë⁸ në qiej, bukurinë e kozmosit, shijimin e të mirave dhe të virtyteve, krenarinë e asketëve; sepse duke qenë i mbjellë në shtëpinë e Perëndisë, lulëzoi drejtësisht dhe si kedër në shkretëtirë shumëfishoi⁹ grigjat e deleve mendore të Krishtit me oshënarí dhe drejtësi.

Tani *Hyllindësore*

Oportë e pakaluar,¹⁰ e vulosur mistikisht, Hyllindëse e bekuar, prano lutjet tona dhe ia sill Birit tënd dhe Perëndisë, që t'i shpëtojë me anën tënde shpirtrat tanë.

Pasvargje

Ting. II Ikos tu Efrathá

Që nga shpërgënjtë nënorë u pe enë e shenjtëruar¹¹ dhe banesë e Shpirtit të Tërëshenjtë,^{11a} o Andon hyjprurës.

Varg: E çmuar është para Zotit vdekja e oshënarit të tij.

Me fuqinë e Kryqit pasi i turpërove me triumf dinakëritë e demonëve dredharakë, e shpalle me bujë lavdinë e Krishtit, o atë Andon.

Varg: I lumur ai burrë që ka frikë Zotin.

Ungrite si Ilija me karrocë të për-zjarrtë,² dhe u lidhe direkt me Tri-

ninë, o Andon i lumur, mbarëbotëror.

Lavdi *dhe Tani*

I ngjashëm

Lart koret të himnojnë bashkë me të poshtmet, o Perëndilindëse e virgjër, duke e lavdëruar pa pushim lindjen tënde të papërlyer.

Përlëshore

Duke imituar në mënyra



NË MBRËMËSOREN E MADHE

*Pas Qëndrimit të parë të Psaltritit
(Lum ai njeri),*

Thirrto

Ting. IV O eks ipsistu klithís

Illamburitur me rrezatim prej Shpirtit* kur të flaku zjarr dashuria hyjnore ty,* krahë i dha frymës sate kjo,* saqë e donte* atë që është' maja e dëshirave,* dole jashtë botës, përbuze, shpërfille mish* dhe gjak; me të ti u bërë një* përmes ushtrimit* dhe qetësis', ndaj u mbushe siç deshe* dhe i kërkove* më të mirat që na burojnë' prej andej, na shkëlqeve pra* porsí yll¹² vezullues* që shndrit shpirtrat tanë, o Andon.

(2x)

Ti që me Hirin e Shpirtit Shenjt' dërrmove* harqedheshigjeta demonësh,

dhe haptazi* te ne të gjithë zbulove qart'* keqdashjen, kurthet* e tyre, na ke mësuar hyjshëm krejt,* fekse me shkëlqimet e larta, ndriçues i madh;* për shkretëtirën stoli e par'* ke qenë, mjeku* për të sëmurët, plot me përvoje pra;* je i nderuar,* o Andon, edhe shembull me frymëzim për arsim të madh,* je edhe edukimi* për virtytet, oshënar me nam.

(2x)

I mbushur plot me karizma nga Hyjnia* Krishti si pasqyrë pa njollë¹³ të gjeti ty* për reflektime të shenjta krejt,* tek ti përçon tej* shum' vezullime prej dritës që sundon;* ndaj u pe burim i pashtershëm për çdo shërim,* ushqim kur binte zi,¹⁴ pije tok* si shi për njerëz* që kishin etje; madje shikoje thell'* gjendjet psikike* dhe me fjalë urtisht i përmirësoje për Zotin tënd;* lutju që të shpëtojë,* të shkëlqejë shpirtrat tanë nur.

I pastër edhe në shpirt, edhe në zemër,*¹⁵ engjëll tokësor dhe njeri qiellor, Andon,* ishe kanuni i saktë për* vetëpërmbytje* edhe mësues i virgjërisë ti;* meqë je me Zotin tënd edhe i sjell atij* dhoknologji që nuk ka pushim* bashkë me engjëjt,*¹⁶ tërë martirët dhe oshënarët tok* ne që gjithmonë* e kremtojmë kujtimin tënd të hyjnueshme, na çliro* nga

rreziqet e frikshme* dhe nga shkeljet që na vënë posht'.

Lavdi

Ting. Tërth. II I Sigeotit

Pasi e ruajte të paprekur "Sipas ikonës"¹⁷ dhe vure mendjen sunduese¹⁸ kundër pasioneve shkatërruese në mënyrë asketike, u ngjite sa ishte e mundur në "Sipas ngjashmërisë";¹⁷ sepse pasi e dhunove burrërisht natyrën, e nxite veten që ta nënshtrosh më të keqen poshtë më të mirës dhe t'ia skllavërosh mishin shpirtit; prandaj u dallove si majë monakësh, popullues shkretëtire, trajner i atyre që ecin mirë, kanun tepër i saktë virtyti; dhe tani në qiejt, pasi ikën pasqyrat,¹⁹ o Andon, vëzhgon kthjellët Trininë e Shenjtë, duke ndërmjetuar direkt për ata që të nderojnë me besë dhe mall.

Tani *Hyjlindësore*

Cili s'do të të lumërojë, o Hyjlindëse Virgjëreshë? Cili s'do të përhimnojë lindjen tënde të kulluar? Se biri yt i vetëmlindur që shkëlqeu prej Atit²⁰ pa mot, gjith' ai lindi prej teje së pastrës i mishëruar pa tregim; duke qenë prej natyre Perëndi dhe duke u bërë për ne njeri prej natyre, i pandarë në dy fytyra, por i njohur me dy natyra pa përzier. Atij lutju, o Zonj' e lumur, të mëshirohen shpirtrat tanë.*

Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës dhe Leximet.

Këndimi i Urtësisë së Solomonit
(3.1-9)

Shpirtrat e të drejtëve janë në dorë Perëndie dhe nuk do t'i prekë torturë. U dukën në sytë e të pamendëve se vdiqën dhe u konsiderua keqtrajtim dalja e tyre dhe ecja nga ne dërrmim, por ata janë në paqe; sepse, edhe nëse para faqes së njerëzve do të ndëshkohen, shpresa e tyre është plot pavdekësi; dhe pasi do të edukohen me pak *mundime*, do të fitojnë mirëbërje të mëdha, sepse Perëndia i provoi dhe i gjeti të denjë për veten. Si ar në shkritore i provoi ata dhe si holokaust flijimi i pranoi ata; dhe në kohën e shqyrtimit të tyre do të ndriçojnë dhe si shkëndija në kallam do të vrapojnë. Do të gjykojnë kombe dhe do të sundojnë popuj, dhe do të mbretërojnë në ata Zoti ndër shekuj. Ata që kanë besim në të do të kuptojnë të vërtetën dhe besimtarët me dashuri do të qëndrojnë me durim pranë tij, sepse ka hir dhe mëshirë ndër oshënarët e tij dhe mbikëqyrje mbi të zgjedhurit e tij.

Këndimi i Urtësisë së Solomonit
(5.15-23; 6.1-3)

Të drejtët jetojnë përjetë dhe në Zotin është paga e tyre, dhe përkujdesja e tyre pranë të Shumëlartit. Për këtë do ta marrin mbretërinë e hijeshisë

dhe kurorën e bukurisë nga dorë Zoti, sepse me të djathtën do t'i mbulojë dhe me krahun do t'i mbrojë. Do të marrë si armatim zellin e tij dhe do të mobilizojë me armë Krijesën për mbrojtje armiqsh. Do të veshë si korracë drejtësi, dhe do të veshë si helmetë gjykim pa hipokrizi. Do të marrë si mburojë të pamposhtur oshënarit dhe do të mprehë zemërim të prerë për shpatë; dhe do të bashkëluftojë me atë bota kundër të marrëve. Do të ecin suksesshëm tek qëllimi predha rrufesh, dhe si nga një hark i plotë rrethi nga retë do të hidhen në shenjë dhe nga zemërimi që hedh gurë do të hidhen breshëri të plota. Do të indinjohet kundër tyre ujë deti, ndërsa lumenj do të përmytin papritur. Do t'u kundërvihet atyre erë fuqie dhe si stuhi do t'i ajrojë ata si grurë, dhe do të shkretojë gjithë dheun paligësi dhe keqbërje do të përmbysë frone dinastish. Dëgjoni, pra, o mbretër, dhe bëhuni të mençur, mësoni, o gjykatës të anëve të dheut. Vëreni veshin, ju që sundoni shumicë dhe që jeni mburrur mbi turma kombesh, se ju dha nga Zoti sundimi dhe dinasti nga i Shumëlarti.

Këndimi i Urtësisë së Solomonit
(4.7-15)

I drejti, nëse do të arrijë të vdesë, do të jetë në prehje; se pleqëri e çmuar nuk është pleqëria shumëvjeçare,

as u mat me numër vitesh. Dhe thinjat janë mençuri tek njerëzit dhe mosha e pleqërisë është jetë e panjollosur. Meqë u bë i pëlqyeshëm te Perëndia, u dashurua, dhe ndërsa jetonte në mes mëkatarësh, u transferua. U rrëmbye, që e keqja të mos ndryshojë mençurinë e tij ose dinakëria të mos mashtrojë shpirtin e tij. Sepse joshja e së keqes, errëson të mirat dhe ëndja e dëshirimit e ndryshon mendjen e patëkeq. Duke u përsosur në pak kohë, mbushi vite të gjata. Se shpirti i tij ishte i pëlqyeshëm në Zotin, prandaj vrapoi nga mesi i ligësisë. Por popujt duke parë dhe duke mos kuptuar, as duke mos vënë në mendje një gjë të tillë; sepse ka hir dhe mëshirë ndër të zgjedhurit e tij dhe mbikëqyrje ndër oshënarët e tij.

Në Liti Idhiomele

Ting. II I Studitit

Pasi krijove mbi dhé palestër asketike, o oshënar Andon, çmprehe të tëra sulmet e pasioneve me rrjedhjen e lotëve të tu; jeta jote hyzënë u njoh te të gjithë si shkallë e hyjnueshme dhe e respektuar, që udhëzon lart në qiej;²¹ meqenëse në jetën tënde tregove fryte shpresëtarie, nëpërmjet tyre i shëron sëmundjet e pasioneve të atyre që të thërrasin besërisht: Gëzohu, o yll ndriçues si ar i Lindjes, llambadheprurës dhe barí i murgjve; gëzohu, o i kënduar, i

ushqyer më së miri i shkretëtirës dhe bazament i patundshëm i Kishës; gëzohu, o udhëzues i madh i të humburve; gëzohu, o mburrja jonë dhe ngazëllimi i hijshëm i botës.

I njëjti

Le të nderojmë Andonin, engjëllin mbi tokë dhe njeriun e Perëndisë⁸ në qiej, bukurinë e kozmosit, shijimin e të mirave dhe të virtyteve, krenarinë e asketëve; sepse duke qenë i mbjellë në shtëpinë e Perëndisë, lulëzoi drejtësisht dhe si kedër në shkretëtirë shumëfishoi⁹ grigjat e deleve mendore të Krishtit me oshënarí dhe drejtësi.

I njëjti

O atë oshënar, meqë që foshnjë praktikove me kujdes virtytin, u bëre instrumenti i Shpirtit të Shenjtë; dhe pasi more prej tij energjinë e mrekullive, binde njerëzit që të përbuzin të ëmblat; dhe tani që feks më pastër prej dritës hyjnore, ndriço edhe mendjet tona, o atë Andon.

Ting. III I Anatoliut

O oshënar Andon, kalove si i prehur në të palëndshmet jetesën djegëse dhe të moralshme të ushtrimit tepër të tensionuar; sepse kur e bashkove veten tënde shpirtërisht me më të shkretuarat, shkele plotësisht kutitë e zjarrta të shigjetave²² të demonëve; dhe meqenëse u lartësove mbi çdo

virtyt, rri bashkë me engjëj në mbretërinë e qiejve; prandaj ndërmjeto pranë Krishtit Perëndi, që të shpëtohen shpirtrat tanë.

Lavdi

Ting. Tërth. I I Studitit

O atë oshënar, sapo dëgjove zërin e Ungjillit të Zotit,²³ e le botën, duke e llogaritur për hiçgjë pasurinë dhe lavdinë; ndaj u thërrisje të gjithëve: «Doni Perëndinë dhe do të gjeni hir të amshuar; mos preferoni asgjë mbi dashurinë e tij, që kur të vijë në lavdinë e tij,²⁴ të gjeni prehje²⁵ bashkë me gjithë shenjtoret». Me përgjërimit e tij, o Krisht, ruaji dhe shpëtoji shpirtrat tanë.

Tani *Hyjlindësore*

Ty të lumërojmë, o Hyjlindëse e virgjër dhe të lavdërojmë ne besnikët siç të ka hije ty, qytetin e patundshëm dhe murin që s'çahet dot, mbrojtjen e pathyeshme dhe strehën e shpirtrave tanë.

Pasvargje

Ting. Tërth. I Heris askitikón

G'zohu, sepse u bërë epror* i çdo asketi edhe mbrojtës që s'mundesh dot,* sepse preve rrënjë vesesh dhe i durove me ngulm,* burrisht ti sulmet e demonëve;* i ke shfaqur me triumf*²⁶ dhe mashtrimet shpirtprishëse* dhe dobësitë* e atyre, dhe forcën tok* e pamposhtur kurr'*

bashkë me energjin' që ka* Kryqi;²⁷ me to u ngjeshe dhe fitove mbi cilindo* që nuk pranonte në mish pra epifaninë, e Krishtit Zot;* atij përgjëroju* të na japë përdëllimin e madh^{27a} për shpirtrat ky.

Varg: E çmuar është para Zotit vdekja e oshënarit të tij.

Shtyllë bazuar mbi çdo virtyt* të ndritshëm, dhe re hijesuese ti u pe* për sa Perëndinë shihnin, dhe paraprije në udh'*²⁸ për në qiell që nga dhé, o i hyjlum;* me shkopin e Kryqit ti* ndave detin²⁹ e veseve* dhe si e mposhte* me triumf Amalikun krejt,*³⁰ gjete ngjitjen pra* për në qiejt lart pa pengim* dhe trashëgim pa cen, prandaj qëndron tok me të patrup* pran' fronit të Shpëtimtarit³¹ Krisht më gëzim dhe me plot hare;* atij përgjëroju* të na japë përdëllimin e madh^{27a} për shpirtrat ky.

Varg: I lumur ai burrë që ka frikë Zotin.

G'zohu, në më të lartat, Andon,* me kore engjëjsh qiellore, o atë, flet,* se jetën e tyre mbi dhé e praktikove vërtet* kur ti krejt virtytin e zbatove drejt;* pasqyrë pa pikë njoll'* dhe i pastër¹³ u shfaqe ti* që prite rreze* dhe shkëlqime prej Shpirtit Shenjt,* o i pasur fort,* ndaj i feksur shikoje larg;* i paralajmëroje saktë sa do të ngjanin pas,* se i mësove nga shfaqja e ndritshme hyjshëm, mistikërisht,* prej Krishtit; atë lyp* të na

japë përdëllimin e madh^{27a} për shpirtat ky.

Lavdi

Ting. Tërth. IV I Sigeotit

Turmat e murgjve të nderojnë ty, profesorin, o Andon, sepse nëpërmjet teje ne mësuam të ecim në udhë vërtet të drejtë,³² i lum je, se i shërbeve Krishtit³³ dhe triumfove mbi fuqinë e armikut,²⁶ o shok engjëjsh, pjesëmarrës me Pavlin thivas; tok me ta ndërmjeto te Zoti që të mëshirohen shpirtat tanë.

Tani *Hyjlindësore*

Virgjëresh' e panusëruar që zure trupërisht Perëndinë pa tregim, nën' e Perëndisë së lartë, prit lutjet e shërbëtorëve të tu, o e gjithëpanjollëshme, ti që u fal të gjithëve paqësim mëkatesh, prit lutjet tona tani dhe lutu që të shpëtohen shpirtat tanë.*

Përlëshore

Ting. IV

Duke imituar në mënyra Ilian e zellshëm,³⁴ duke ndjekur pas Pagëzorin në udhë të drejta,³² o atë Andon, u bërë popullues i shkretëtirës dhe mbështete botën me lutjet e tua; prandaj ndërmjeto pranë Krishti Perëndi të shpëtohen shpirtat tanë.

Hyjlindësore

Misteri i fshehur prej jete dhe i

panjohur ndër engjëjtë u shfaq ndër të dheshmit me anën tënde, o Hyjlindëse; Perëndia që u mishërua me bashkim të papërzier dhe denjoi kryq për ne duke dashur, me të cilin ngjalli të parëtreguarin dhe shpëtoi prej vdekjes shpirtat tanë.*



NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së parë, Ndenjëso

Ting. Tërth. IV Tin sofian qe Logon

Si e lidhe me mallin për Krishtim Zot* shpirtin tënd dhe urreve çdo gjë mbi dhé,* jetove, o oshënar,* nëpër male dhe në shkreti,*³⁵ se e shijove drurin e dijes,³⁶ dhe ndrite fort* si engjëll; hyre si mist në vende që s'shkelen dot,* ndaj kur e kalove errësirën e mishit,* dëbove, i tërëlum,* errësirë demonësh tej,*³⁷ je epror ti,* ndër murgjit, at';* ndërmjeto te Zoti yt Krisht,* të na dhurojë ky ndjesën* e fajeve* ne që bëjmë kujtimin tënd fort të shenjt' me mall.

Lavdi *Injëjti*

Tani *Hyjlindësore*

Urtësinë³⁸ dhe Fjalën e zure ti* brenda barkut pa farë, pa djegie krejt;* e linde për botën ton'* sundimtarin e Gjithësis';* mban në pëqi atë që në dorë çdo gjë e mban,* pra Krijimtarin si dhe ushqyesin botëror;* ndaj, o

Virgjëreshë e tër'shenjtë, të lutem,* kur unë do rri përball'* faqes së Krijimtarit tim,*³⁹ të shpëtohem* nga çdo mëkat;* Zonj' e pastër dhe virgjëresh'* at'herë ndihmë dhe mbrojtje* ti më dhuro,* sepse, o e himnuar, mundesh të bësh sa do.⁴⁰

*Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësore
Ting. Tërth. I Ton sinánarhon Logon*

Ta nderojmë asketin e Zotit me himnim,* se vrau sulm edhe vrull të pasionit⁴¹ plot me durim,* me vendosmëri vërtet dhe me përmbajtje, ngulm;* e turpëroi me gjithsej* kundërshtarin, pra armikun me krenarit' që kishte,* dhe tani ndërmjeton te Krishti të përdëllehen shpirtat tanë me hir.

Lavdi *I njëjti*

Tani *Hyllindësore*

Ki gaz, derë e pashkelur,¹⁰ që profetët mbar'* të drejtë të parashpallën; na u tregove siç than';* mal të palatuar Danieli ty të tha,*⁴² edhe Davidi melodist,* Moisiu dhe të tjerët të quajtën ferr',⁴³ shtambë,*⁴⁴ shkop,⁴⁵ re,²⁸ portë¹⁰ dhe fron,⁴⁶ dhe mal mjaft i madh;⁴⁷ kështu të predikuan ty.

Pas Polieleit, Ndenjësore

Ting. Tërth. IV Tin sofian qe Logon

Kur braktise rrëmujën e jetës ti* dhe e ngrite, o atë, kryqin⁴⁸ mbi sup* në duart e Zotit tënd* veten tënde dhe

tërësisht* dhe dole jashtë mishit dhe botës, u bëre mik* si edhe shok i Shpirtit, ndaj zbraze qytete mbar'* dhe e popullove shkretëtirën, Andon shenjt,* me nxitjet që bëje drejt,* o hyjprurës, për zell hyjnor,* për dëshirën* e qiellit;* ndërmjeto te Zoti yt Krisht,* të na dhurojë ky ndjesën* e fajeve* ne që bëjmë kujtimin tënd fort të shenjt' me mall.

Lavdi

Ting. IV Epefanis símeron

I shkëlqyer me ndriçim* të paafruar,*⁴⁹ si një yll ndriçove krejt* në shkretëtirë, feksje pra* me mësimdhënie sa vinin pran',* atë Andon shenjt, me shpirt të patundur dot.

Tani *Hyllindësore*

Zure të njëqenëshmin,* të bashkëfronshmin,* e dëlir', me Atin prind,* kur erdhi Shpirti Tërëshenjt* nga lart me zë engjëllor;⁵⁰ o nën'* e Zotit Krisht, për Adamin rithirrje je.

*Shkallesat. Antifoni i parë i Ting. IV
Proqimeni Ting. IV*

E çmuar është para Zotit vdekja e oshënarit të tij.

Varg: Me çfarë do ta shpërblejmë Zotin për të gjitha që na shpërbleu?

Ungjilli. Psalmi 50.

Lavdi. Me ndërmjetimet e oshënarit. Tani. Me ndërmjetimet e Hyllindësës. Përdëllemë, o Perëndi. *Dhe Idhiomeli.*

Ting. Tërth. II I Anatoliut

O atë oshënar, në gjithë tokën doli zëri⁵¹ i arritjeve të tua, prandaj në qiejt gjete shpërblim⁵² për lodhjet e tua; asgjësive batalionet e demonëve, arrite rreshtimet e engjëjve, jetën e të cilëve e kishe zili në mënyrë të paqortueshme; duke pasur guxim ndaj Zotit, kërko paqe për shpirtrat tanë.

Kanunet, i Hyjlindëses dhe i oshënarit

Ode I

Kanuni i Hyjlindëses

Ting. Tërth. IV

Irmosi: Igrán dhiodhefsas

»Pasi kish kaluar det si steré* edhe
»u shpëtua nga inati egjiptian,*
»me zë Izraeli po thërriste:* Le t'i
»këndojm' Perëndis', Çlirimtarit ton'.

I mbytur prej ngasjeve si në det,*
më ty po përikij dhe prej teje kërkoj shpëtim,* o nënë dhe Zonjë Virgjëreshë,* prej çdo rreziku dhe zie shpëtomë ti.*

Pësimet mëmbushën me turbullim*
dhe shpirtin ma mbytën me mërzitje
dhe dëshpërim,* po ti qetësomë,
Virgjëreshë,* me ngushëllimin dhe
paqen e Birit tënd.*

Të lutem o Zonjë, o Shën Mari,* që
linde Jisuin, ti shpëtomë nga çdo rre-
zik,* më ty po përikij dhe të lutem,*

me tërë forcën e zemrës dhe shpirtit
tim.*

Se shpirti dhe trupi keq m'u sëmur,*
pra ti mëshiromë, edhe syrin mbi mua hidh,*
kujdesu për mua Virgjëreshë,* e mirë vetë dhe nën' e
të mirit Bir.*

Kanuni i oshënarit, që ka

*Akrostihidhë: "Është e drejtë ta
lavdërojmë Andonin e hyjshëm". I
Theofanit.*

Ting. Tërth. IV

Armatilatin Faraó

Meqë e more qartë jetën e
amshuar, të pavdekshme gjithnjë,*
ti u mbushe me lavd* që shkëlqen
trefish, ndaj përgjërohu të ndriçohet
fort* me shkëlqimin e Hirit pra fryma
ime e errët terr,* që të të himnoj de-
njësisht un' ty.

Ishe i ri në moshë trupi kur ti more
udh' të re për virtyt;* e përshkove pa
dëm,* pa rrezik, se bindeshe në ligj
të ri që Zoti dha,* Shpëtimtari dhe
ndoqe drejt porosi jetëdhënëse* që
na jep Ungjilli, Andon i lum.²³

Ifeksur, o i tërëurt', me dritë diellore
tri herë ti,* o i lum, shpërndave* si
pëlhurë merimange çdo tërbim, fu-
ri me vrull* të demonëve, bishave
gojëhapur,⁵³ torturë, mund,* se të
digjte malli për Perëndi.

Hyjlindësore

Meqë guximin ke si nënë Perëndie, mos pusho kurrë ti* që t'i përgjërohesh* Fjalës, Birit tënd të vetëmlindur, bashkëpafillim* tok me Atin e njëqenshëm dhe me Shpirtin, nga çdo rrezik* na shpëtoft'; të mburrim, Hyjlindëse.

Zbritësore: Herson avisotokon

»**F**undin edhe burimin e avushave
 »dielli një her' e pa se si mur u bënë
 »valët edhe shkoj Izraeli më këmbë
 »nëpërmes të detit përtej; me këng'
 »e brohori le ta këndojmë Zotin të
 »lavdëruar me lavdi.^{53a*}

*Ode III**I Hyjlindëses**Irmosi: Uranias apsidhos*

»**P**erëndi që apsidë bëre në q'ell si
 »çati,*⁵⁴ ti që je ndërtues i Kishës,⁵⁵
 »mirë më siguro* në dashurinë që
 »ke;* je maja e çdo dëshire,* njeri-
 »dashës, edhe mbështetja për çdo
 »besnik.

Si përkrahje dhe mbrojtje të jetës sime të kam,* ty o Virgjëresh' e kulluar, ti pra më qeveris,* dhe në liman të më çosh, se ti na fal çdo të mirë,* ti besnikët përgjithmon' i mbron, Hyjlindëse.*

Po të lutem, o Zonjë, ma qetëso shpirtin tim* dhe pushoma shqotën e zemrës, se më bie zali,* se ti o

Zonjë Mari, ke lindur Mbretin e Paqes,* Shpëtimtarin, Zotin Krisht, ti o Hyjlindëse.*

Mirëbërësin⁵⁶ linde, që bëri çdo mirësi,* pasurisht të gjitha të mirat jepna të gjithëve,* se ti në dorë e ke, se ti ke lindur të fortin,* Shpëtimtarin, Zotin Krisht, ti o Hyjlindëse.*

Me sëmundje të liga dhe çfarëdo pasion,* dërgjem un' i mjeri, o Zonjë, eja shëromë ti,* se s'të mungon asnjë gjë, i ke të gjitha të mirat,* je thesar për çdo shërim, ti o Hyjlindëse.*

I oshënarit: O stereosas kat' arhás

Me forc' në mendje si me nerv* edhe me vendosmërinë* fishke flakën e pasioneve, veshe* pra stolin' e hyjshme të mospasjes të së keqes ti* dhe rrobën e shpëtimit,*⁵⁷ atë Andon, oshënar i madh.

Përbuze hov të dobët krejt* demonësh me arrogancë* që sulmonin me vrull dhe imitonin* pamje bishash, sepse kishe si përkrahës Krishtin tënd,* që ka pushtet të plotë* në ndeshje,⁵⁸ o shën Andon me nam.

U shfaq Andoni fitimtar* dhe triumfues²⁶ hyjprurës,* mbi pushtete dhe arkondët e territ*³⁷ nëpërmjet përmbajtjes këmbëngulëse; ai u bë*

për çdo asket lavdia* dhe krenaria e murgjive ky.

Hyjlindësore

Ma ngri lart mendjen, sepse vdiq,* o e delirë, hov jepi,* energji nga jeta, o e kulluar,* që prej teje na u shfaq, dhe më drejto te jeta ti,* e vetmja që i zgjidhe* dyert e vdekjes për botën ton'.

Zbritësore: To steréoma ton epi si
»Zoti Krisht⁵⁹ që i mbron besnikët
»shpresëplotë, forcoje dhe mbroje
»Kishën^{59a} e bekuar, që e mbolle me
»vojtye dhe me gjakun tënd.^{60*}

Ndenjësore

Ting. Tërth. IV Tin sofian qe Logon

Kur e ngrite ti kryqin e Zotit Krisht* edhe si shkove deri në fund pas tij,*⁴⁸ s'e ktheve te bota mbrapsht,* i hyjurt', mendjen tënde ti,* por përmes lodhjes, mundit, përmbajtjes ke vvarë krejt* pasionet,⁴¹ bëre veten një tempull për Zotin tënd;*^{11a} ndaj porsi shpërblim ke marr' karizma, shëron⁶¹ pra* sëmundje edhe dëbon* frymë,⁶² o shën Andon i madh,* dhe hyjprurës,* o oshënar;* ndërmjeto te Zoti yt Krisht,* të na dhurojë ky ndjesën* e fajeve* ne që bëjmë kujtimin tënd fort të shenjt' me mall.

Lavdi *Injëjti*

Tani *Hyjlindësore*

Vajzë, Zonjë dhe nuse krejt e pacen*⁶³ e Krijuesit, nënë që burrë s'njeh,* na linde ne Çlirimtar,* o Hyjlindësë, enë je* e Shpirtit Shenjtë Ngushëllimtar;⁵⁰ por un' jam vërtet* bodrum i turpshëm paligjësish, jam me dijeni* lodër djalli, e tërëhimnuar, nxito pra,* shpëtomë nga çdo dhunim* që pësoj, dhe shndërromë krejt* në banesë* të ndritshme nur* të virtytit edhe dëbo* çdo re pasionesh prej meje;* më denjëso* të kungoj lartësi dhe dritë që s'perëndon.

Ode IV

I Hyjlindësë

Irmosi: Isakikoa Kírie

»**K**am dëgjuar misterin qart'* të
»ekonomis' sate dhe kuptova krejt*
»vepra që ke bërë⁶⁴ dhe prandaj*
»lavdërova un' hyjninë tënde, Zot.

Shën Mari o Hyjlindëse,* ti që linde Zotin, kapitenin ton',* zbutë shqotën e pësimeve,* qetësoi valët e mëkateve.*

Ne të gjithë të lutemi,* dhembshurinë tënde tregona pa vones',* ti që linde njeridashësin,* Krishtin Shpëtimtarin e besnikëve.*

Për shumicën e dhuratave,* të falënderojmë ne mirënjohësit,* me këndime lavdëruese,* nënë virgjëre-

shë dhe Hyjlindëse.*

Ty të kemi përkrahëse* dhe fortesë të patundur dhe mbrojtëse,* Virgjëreshë dhe Hyjlindëse,* na shpëto përherë prej rreziqeve.*

I oshënarit: Si mu iskís Kírie

Si e përdore shkallën e hyjshme të virtyteve, u ngjite drejt lart, o atë, dhe e sodite Perëndinë të mbështetur mbi të,²¹ i cili u shpërndante dhurata me dorë tepër të pasur kënduesve besërisht: Lavdi fuqisë sate, o njeridashës.

U dedikove i tëri tek Perëndia, o Andon i tërëurtë, duke u bashkuar i vetëm me të vetmin në saje të virtytit, dhe bisedoje, dhe denjësoheshe për theofani, hyjshfaqje, si i pastër, sepse kur u largove denjësisht prej tokës dhe tokësoreve, e gjete shijimin qiellor.

I pastër në mendje dhe në shpirt,¹⁵ o atë Andon i tërëpasur, zbulove mashtrimin shpirtshkatërrues, makinacionet, dredhitë e hidhura dhe fantazitë e keqdashësve; sepse kur pësove, mësove, dhe meqë mësove, i mëson tërësitë e monakëve.

Hyjlindësore

Perëndisë që u mishërua prej teje dhe mbeti pa ndryshim, ashtu siç ishte, dhe u bë natyrisht i barabartë

me Atin dhe me ty që e linde, i bashkëqenshëm, përgjëroju që t'u dhurojë ndjesë shkëlqesh dhe shpëtim shpirttrash atyre që të himnojnë me besë.

Zbritësore: Ekálipsen uranús

»**M**bulove me virtyte qiellin, o »Zoti⁴⁷ Krisht kur linde prej nënës virgjëreshë dhe⁶⁵ i shpure në Kishën^{65a} »si foshnjë në pëqi,⁶⁶ dhe i mbushe »të gjitha me lavdi⁴⁷ dhe brohori.*

Ode V

I Hyjlindësës

Irmosi: Fótison imás

»**N**dritna ti, o Zot,* përmes urdhrave »të tua⁶⁷ ne,* si dhe me krahun tënd »fuqiplot, të lart',*⁶⁸ o njeridashës, »na jep paqen tënde⁶⁹ përgjithnë.

Zemrën na e çel* me gëzim dhe ngazëllim, o Zonj',* falna gazin e pasosur tani,* sepse ke lindur ti shkaktarin e gëzimeve.*

Zonjë na shpëto,* Virgjëreshë dhe Hyjlindëse,* prej helmeve si dhe rreziqeve,* se ti ke lindur⁷⁰ Shpëtimtarin, paqepurësin.^{71*}

Mjegullën largo* të mëkateve Hyjlindëse* me dritën tënde jetëdhënëse,* sepse ke lindur diellin e parajetëshëm.*

Zonjë na shëro,* nga pësimet e

sëmundjeve,* na mëshiro edhe na vizito,* edhe shëndetin na dhuro me ndërmjetimin tënd.*

I oshënarit: Ina ti me aposo

U vlerësove, o i trillumur, të shikoje ngritjet e shpitrave të të pastërve dhe të të lumturve, sepse në ty banohte Perëndia⁷² i lumur, që i shikon të gjitha dhe që të ndriçonte,⁷³ të mësonte⁷⁴ dhe të urtësonte.

Krishti të ka dhuruar ty hir kundër sëmundjeve⁶¹ të shumëllojshme dhe pushtet kundër frymëve të ndryra,⁶² o atë i urtë, sepse pasi fitove mbi natyrën, more pjesë në karizmat e përmbinatyrshme të Shpirtit.

Hyjlindësore

Të lumërojmë ne që si pasuri të zotërojmë ty si mur, dhe që ruhemi nga mbrojtja jote, duke u mburrur për lavdinë tënde të hyjnueshme, sepse ti, o e Tërëshenjtë, buron nga zëllimin dhe harenë të shpirtit tanë.

Zbritësore: Os idhen Isaia simbolikós

»**T**ë pa shën Isaia simbolërisht mbi
»fron të lartë si Perëndi në Parajsën
»të rrethuar prej engjëjve,^{74a} dhe
»thoshte i mjeri me tmerr:⁷⁵ Ja e
»pashë Perëndinë si njeri, Zotin
»shpëtimtarin, që na ndrit dhe na pa-
»qëson.^{76*}

Ode VI

I Hyjlindëses

Irmosi: Tin dhéisin ekheó

»**D**o derdh lutjen* para Zotit
»Perëndi* dhe atij do t'i tregoj hi-
»dhërimet* që kam,⁷⁷ sepse* shpirti
»im është mbushur* me çdo të keqe
»dhe jeta po shkon në Hadh;*⁷⁸ pra
»si Jonai lutem un':* Jetën time nga
»prishja ti ngrije, Zot.

Atij iu lut,* se prej vdekjes na shpëtoi,* si u dha nën thonjt' e vdekjes dhe vetë,* prapë tani* shpirtin tim ta shpëtojë,* nga shkatërrimi i vdekjes dërrmonjëse* dhe nga armiku zemërlig,* Biri yt, Zoti yt, o Hyjlindëse.*

Si mbrojtëse* ty të di dhe rojtëse,* të sigurt, o Virgjëreshë, për jetën,* ti i shpërndan,* gjithë ngasjet e liga* edhe veprime demonësh na i dëbon,* pra ty të lutem si gjithnjë:* Ti shpëtomë prej gjithë pësimeve.*

Fortes' e mur,* ty të kemi Zonja jon',* dhe shpëtim për shpirtit tanë të plotë,* dhe ngushëllim* në mjerrimet,⁷⁹ o Zonjë,* dhe n' errësirën me dritë na ngazëllon;*⁸⁰ pra ti, o Zonjë, dhe tani,* nga pësimet, rreziqet ti na shpëto.*

Në shtrat tani* i sëmurë shtrirë jam* dhe për trupin tim shërim dot nuk gjendet,*⁸¹ vetëm pra ti,* që

ke lindur për botën* një Shpëtimtar dhe një mjek të sëmundjeve,* pra ty të lutem dhe tani:* Ti më ngri nga lëngatat Hyjlindëse.*

I oshënarit: Avisos amartión

Që me thonj të njomë ti,* o hyjprurës, more përsipër sjellje* të ligshme si atlet,⁸² e mbrojte deri në fund, prandaj* porsi fitimtar i hyjnueshëm prej mbretit të cdo gjeje,* prite kurorën e fitores ti.

Ty të kemi, o i lum,* para Zotit ndërmjetues të fortë,* për ne je kujdestar dhe luftëtar, mbrojtës, ndihmësi,* dashamirës plot butësi; na shpëto nga çdo lloj rreziku* dhe nga çdo ngasje dhe peripeci.

Hyjlindësore

Ngrite sigurisht, vërtet* tërë thelbin njerëzor që kish rënë,* kur brenda barkut kishe Bir pa mbjellje dhe shfaqej pra,* edhe pse ka faqe hyjnore, me Atin⁸³ i barabartë* pa u ndryshuar, o Hyjlindëse.

Zbritësore: Evóisé si

»**K**ur Simeoni të mori në krahët
»dhe pa shpëtimin për popullin, i gë-
»zuar⁸⁴ thirri:⁸⁵ Ti je Zot i madh e ti je
»Krishti.*

Kontaqi

Ting. II Ta ano zitón

Rrëmuajt në jet'* i zbrapse dhe

përshkove ti* kështu jetën tër'* si isihast; me çdo mënyr'* imitove, o oshënar i urtë, pra Pararendësin,*⁸⁶ ty të mburrim bashkë me të,* o ati i etërve, Andon shenjt i madh.

Shtëpia

Sapo dëgjove zërin e Krishtit, shkove pas porosive të tij, pasi u zhveshe nga pasuria dhe i hodhe poshtë të gjitha preokupimet për paratë,²³ pronat dhe shërbëtorët, si dhe dashurinë për motrën, o Andon hyjprurës; dhe duke komunikuar i vetëm në mënyrë tepër të pastër në shkretëtira me Perëndinë,³⁵ more hir diturie; ma dërgo atë mua, që kam për të të himnuar, o ati i etërve, Andon shenjt i madh.

Sinaksari

Më 17 të të njëjtit muaj, kujtimi i atit tonë oshënar Andoni i Madh.

Vargje: Qielli ka diçka më të madhe edhe se Mendjet,/ duke pasur Andonin, kryetarin e asketëve.

Në të shtatëmbëdhjetën e ngritën Andonin prej këtej.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atit tonë oshënar, hyjprurës dhe çudibërës Andoni i Ri, i cili asketizoi në Skitin e Verias.

Vargje: Andonin e ri ku duhet ta rreshtojmë,/ veçse pranë vetë Andonit të vjetër?

Në të njëjtën ditë, oshënar Ahilau mbaron në paqe.

Vargje: Arqilea me armë i pushton qytetet e poshtme,/ Ahilau me mundime pasurohet me qytetin e sipërm.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i mbretit Theodhosit të Madh.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirit të ri Gjergji në Janinë, i cili u martirizua në 1838.

Me ndërmjetimet e tyre të shenjta, o Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII

I Hyjlindëses

Irmosi: I ek tis Iudheas

»Tre Djem që nga Judea* për-
»funduan si robër në Babilonë di-
»kur,* me besën e Triadhës kan’
»shkelur flakë furre duke psalur me
»gaz e hir:* O Perëndi atëror,* o Zot
»je i bekuar.⁸⁷

Për shpëtimin e botës,* në pëqi virgjëror ke banuar ti, o Jisu,* dhe nënën Virgjëreshë, e cila të ka lindur, na e bëre ne mbrojtëse.* O Perëndi i etërve,* o Zot je i bekuar.^{87*}

Birit plot me mëshirë,* që ke lindur, o nën’ e kulluar, lutju për ne,* të na i ndjejë fajet dhe njollat shpirtërore, se thërresim me zë të madh:* O Perëndi i etërve,* o Zot je i bekuar.^{87*}

Thesarin e shpëtimit*⁸⁸ dhe burimin e paprishjes ty Hyjlindësen pra,* kështjellën e përikjes dhe derën e pendimit ua shfaqe besnikëve.* O Perëndi i etërve,* o Zot je i bekuar.^{87*}

Sa po vijnë me shum’ mall* edhe nën hijen tënde të gjith’sigurtë, o Zonj’,* denjo që të shërohen si shpirtrat e sëmurë k’shtu dhe trupat në vuajtje,* se Krishtin ton’ shpëtimtar,* për ne ti e ke lindur.*

I oshënarit: Theú singatávasin

Nofullat e tua janë shishe aromash,⁸⁹ që lëshojnë erë të mirë virtytesh dhe shpëtimi si nga një lulishte tek ata që thërresin me mallëngjim: I bekuar është Perëndia i etërve tanë.⁸⁷

O Atë, Hiri i Shpirtit të Tërëshenjtë⁹⁰ kur banoi në ty, të bëri dëbuesin e frymëve të djallëzisë dhe trajnerin e monakëve ty që thërret: I bekuar është Perëndia i etërve tanë.⁸⁷

Hyjlindësore

Le ta lavdërojmë Marinë e papi-këluar dhe të tërëshenjtë, sepse me anën e saj buron për ne, si prej përroit të mirësisë hyjnore, hiri i dhuratave mbimendore; ajo le të lumërohet tani nga ne me mendim shpresëplotë.

Zbritësore: Se ton en piri dhrosísanta
 »Hodhe vesën përmbi zjarr^{90a} për
 »Tre Djemtë, Shpëtimtar, edhe⁹¹
 »linde virgjërisht prej Hyjlindëses
 »Perëndi edhe Fjalë,^{91a} besërisht
 »të këndojmë, se i bekuar je ti, o
 »Perëndi edhe Zot.^{87*}

Ode VIII

I Hyjlindëses

Irmosi: Ton Vasilea ton uranón

»Mbretin në qiejt,* që gjith' ushtrit'
 »engjëllore* e himnojnë edhe ju hi-
 »mnoni,* dhe e lartësoni gjithnjë në
 »gjithë jetët.

Mos i harro kurr',* o Virgjëresh', sa
 të luten,* të himnojnë me bes' e me
 shpresë,* dhe të lartësojnë me zë
 për gjithë jetët.*

Ti i shëron krejt,* përher' e pa u
 kursyer,* gjith' ata që të luten, o Zo-
 një,* dhe të lartësojnë që linde Zotin
 tonë.*

Ti më shëron krejt* nga gjith' sëmundjet
 e shpirtit* dhe nga dhembjet
 e trupit, o Zonjë;* të të lartësoj pra,
 o Virgjëresh' hirplote.*

Ti i largon krejt* sulmet dhe ngasjet
 e liga,* dhe pësimet, o Zonjë e vir-
 gjër,* pra të lartësojmë me zë për
 gjithë jetët.*

I oshënarit: Eptaplasios káminon

Meqenëse fitove pagjumësinë në
 lutje, forcën në kreshmë, durimin
 në ngasje nëpërmjet pastërtisë së
 mendjes, jetove mbi tokë si engjëll
 dhe thërrisje për Perëndinë: O Djema
 e bekonit, popull përmbilartësoni në
 gjithë jetët.

Duke përdorur vazhdimisht përgjë-
 rime dhe lutje,⁹² vrapove sipër drejt
 Perëndisë, në të lartat, pasi u shma-
 nge nga leqet e demonëve; dhe si u
 çlirove nga tirania e tyre, o oshënar
 hyjmenës, këndon: O priftërinj hi-
 mnoni, popull përmbilartësoni në
 gjithë jetët.

Si u bëre Moisi i ri, e ngrite në shkret-
 tëtirë trofenë ndaj armiqve dhe
 kundërshtarëve,³⁰ duke paraprirë
 një popull, sistemin e asketëve, i
 cili thërret me hare dhe sjellje të
 thjeshtë: Zotin, o priftërinj e bekonit,
 popull e përmbilartësoni në gjithë
 jetët.

Hyjlindësore

O hyjnënë e tërëkulluar, shuaji tra-
 umat e shpirtit tim dhe shenjat e
 plagëve të mëkatit, duke i fshirë me
 burime nga brinja e Birit tënd,^{92a} dhe
 duke i pastruar me rrëke nga po ajo,
 se ty të këlthas, drejt teje përik dhe
 të kërkoj ty, Hirploten.

Zbritësore: Astekto piri enothentes

»Në flak' e në zjarr të bashkuar të
»Tre Djemat e bekuar të pangarë mu
»në mes të furrës të padjegur të kë-
»ndonin me lavdi: E bekonin Zotin të
»gjithë me⁹³ këngë dhe përjetë.*

Ode IX

I Hyjlindëses

Irmosi: Kirios Theotokon

»Hyjlindëse të themi,* të pohojmë
»ne që* shpëtuam, o e kulluar e vir-
»gjër me ty,* me koret e të patrupve
»të madhështojmë tok.

Shiko si qaj me lotë,* edhe më-
shiomë,* se ti ke fshirë çdo lot prej
fytirave,*⁹⁴ o Virgjëreshë dhe Zonjë
që linde Zotin Krisht.*

Gëzoje zemrën time,* Zonjë Vir-
gjëreshë,* se ti ke lindur gëzimin për
njerëzit,* dhe zhduke çdo helm me
ndjesën e gjith' mëkateve.*

Liman dhe mbrojtje bëhu,* Zonjë
Virgjëreshë,* kështjell' e mur i pa-
tundur, Hyjlindëse,* përikje, ndihmë
dhe mbrojtje e gjithë njerëzve.*

Me rrezet dhe me dritë* ndritna
Virgjëreshë,* edhe largo errësirën e
mendjeve*⁹⁵ t' atyre që të lëçitin Zo-
një Hyjlindëse.*

Shëromë Virgjëreshë,* se jam i
përmbysur,* edhe po dergjem^{95a} në

shtratin e vuajtjes,* po eja ngremë
dhe falmë shëndet edhe shpëtim.*

I oshënarit: Eksesti epi tuto

Arriti festa jote plot me ndriçim* o
Andon fort i lumur, ku ka hare edhe
dëfrim* brenda frymës, është' mbu-
shur me bollëk* me Shpirtin Shenjt
edhe me hir,* mbushur me aromë të
mirë, shndrit,* të kemi si kanun ty*
tani për asketizmin* dhe si ligjëvënës,
ndaj gëzohemi.

O atë i nderuar fort, mos pusho*
Çlirimtarit t'i lypësh për sa kremtojm'
shpresëtarisht* sot kujtimin tënd të
hyjnueshëm,* të na dhurojë falje,
ndjes'* shkëlqesh, të shpërndajë
karizma,⁹⁶ hir,* të japë nga lart mbro-
jtje,* shpëtim te shpirtat tanë* si
dhe çlirim në qiej në amshim.⁹⁷

E kishe jetën njësoj me engjëjt ti*
përmbi dhë, hijeshi engjëllorë ke
gjetur, sepse* more pjes' me ta në
shkëlqim hyjnor,* gëzohesh përgji-
thnjë me ta* si epror i murgjve dhe
si profet* i perëndishëm, atë,* dhe
si martir i shenjtë,* që mban kurorë
me triumf dhe lavd.

Hyjlindësore

E zure, o e virgjër, pa farë dot,* pa
vullnetin mishor aspak,⁹⁸ Bërësin
e çdo gjëje,* Fjalën, Perëndinë e
linde ti,* të dhemburat që nënat
kan'* gjatë lindjes s'i pate pra dhe

ne* të madhështojm', pohojmë* me gjuhë dhe me zemër,* se je Perëndilindësja me lavd.

Zbritësore: En nomo skiá qe grámati

O Hyjlindëse Mari,* shpres' e të krishterëve,* mbrona, ruajna se ti,* streha jon' e vetme je.*

»**Në** Ligjën dhe⁹⁹ shkronjën¹⁰⁰
 »faqëza shohim shembull të Zotit
 »Krisht; çdo djal' i parëlindur kish
 »prej Zotit hir¹⁰¹ edhe bekim, dhe ne
 »pra Fjalën që lindi si Bir i parë¹⁰² në
 »q'ell dhe djal' i parë përmbi dhé¹⁰³
 »me këndim e madhështojmë sot.*

Dërgimësore

Jineqes akutísthite

Një udh' të re që s'shkelej dot* prej njerëzve, hyjmendës ti,* që në rini e ke marrë* dhe nxehtësisht e përshtokove* deri në fund, pa kthim më pas,* se i bindeshe ligjit* të ri të Krishtit; profesor* i parë në shkretëtirë* je bërë, maja e murgjve.

Tjetër: En Pnévmati to ieró

U bërë ti ndriçuesi* i ndriçuesve,¹⁰⁴ kreu,* trajneri i monakëve,* o Andon, lavd në botë,* si gjeneral i guximshëm* na mëson shkëlqyeshëm* të mos kemi frikë sulmet* e demonëve, sepse* Krishtin kemi aleat,* që e vithisi mashtrimin.

Tjetër E ngjashme

Dhe pse në trup jetoje ti,* jetë

engjëjsh ke ndjekur* sikurse të mos ishe mish,* dhe në botë u shfaqe* ndriçues krejt i shkëlqyer,*¹⁰⁴ o Andon hyjprurës at';* për etërit je nder, mburrje,* për asketët bukuri;* ke treguar te gjithkush* lavdin' që kanë monakët.

Hyjlindësore

Hyllindëse e virgjër, je* shpres' e mirë për botën,* shtrëngatë na rrethon në jet'* me lëkundje, shtrëngime,* e lypim pra mbrojtjen tënde* që s'luftohet; na pusho* ti erërat e pasionit* dhe na fut në një li-man,* në vullnet vërtet hyjnor¹⁰⁵* të Perëndisë të lartë.

Lavdërime

Ting. Tërth. IV O tu paradhoksu thávmatos

More, atë oshënar Andon, zgjedhën e Krishtit mbi sup,*¹⁰⁶ e vithise kështu përmbys* përmes kryqit zotëror* krenarin' e satanit djall,* edhe me sjelljen e jetës sate ti* qytete ke bërë shkretëtirat pra,* o i fortlumur she-njt,* mburrja e asketëve, lyp Krishtin Zot* pa pushim për shpirtrat tan', të mëshirohemi.

Atë oshënar Andon, për jetën e vërtetë në Zot* mbylle veten në varr pa frik',* pa u trembur nga sulmet,* nga goditjet dhe zhurmat, gulm* të të fëlliqurit, i rrënove rrafsh* me lutjen tënde, o i duruar, shenjt* në

shpirt me trimëri* dhe i pari në shkreti, të gjithë pra* ty të lumërojm' tani, të mburrim me gëzim.

Me besim u mblodhëm ne të gjithë dhe të mburrim si murg,* si asket i Jisuit Krisht,* o Andon shenjti oshënar,* se kalove qart' me hare* në shkretëtirë, u bëre profesor* besnik atje, të thërrasim pra të gjith':* O atë fort i lum,* mburrja e monakëve, lyp pa pushim* Krishtin, çlirimtarin tonë të shpëtohem.

At' i Etërve, kërkove me zjarr edhe me dashuri* të panginjur dhe plot me mall* brenda shpirtit Krishtin tënd,* qarkulloje pra në shkreti,* duke e shmangur çdo zhurmë dhe trazim,* komunikojë i vetëm ti me të,* të Vetmin, drejtpërdrejt,* i bashkuar mendërisht me dritësim;* ndrit përmes tij shpirtat tan',* se të himnojmë ty.

Lavdi

Ting. Tërth. IV I Anatoliut

Pasi hipe në mjet qiellpërçues,² o i mrekullueshëm, e pushtove akropolin e virtyteve në saje të asketizmit, duke banuar në përmbitokësoret e Jerusalemit të sipërm,¹⁰⁷ që nga shkretëtira; dhe meqenëse i more çmimet denjësisht prej lodhjeve të luftërave, ngazëllohesh tok me batalionet qiellore, o i tërëlumur, si u bëre trashëgimtar i të mirave të

amshuara dhe banori i Mbretërisë;¹⁰⁸ pra ndërmjeto, o Andon hyjprurës, te Shpëtimtari i të gjithëve, që ta paqësojë botën dhe t'i shpëtojë shpirtat tanë.

Tani *Hyjlindësore*

O Zonjë, prit lutjet e shërbëtorëve të tu edhe çlirona ne nga çdo nevojë dhe pikëllim.

*Dhoksologjia e Madhe.
Në Liturgji, Tipiket dhe nga Kanuni
i oshënarit, Odet III dhe VI. Kontaqi
Ti që e shenjtërove (shih. fq.356).
Kungatore Në kujtim të përjetshëm.*

CITIME

¹ III [I] Mbret. 19.16

² IV [II] Mbret. 2.9-11

³ Gal. 5.25

⁴ Eks. 33.23

⁵ Eks. 20.21; Sirak 45.5

⁶ Eks. 34.29-30; II Kor. 3.7

⁷ Joan 14.2

⁸ Jis. N. 14.6; Gjq. 13.6-8 etj.

⁹ Ps. 91(92).13-14

¹⁰ Jez. 44.2-3

¹¹ Num. 4.15; 18.3; 31.6 etj.

^{11a} I Kor. 3.16; 6.19; II Kor. 6.16

¹² Dan. 12.3. Matth. 13.43

¹³ Urt. Sol. 7.26

¹⁴ Tobit 1.16; 4.16; Ps. 145(146).7; Is. 58.7,10; Jez. 18.7

¹⁵ Ps. 23(24).4

¹⁶ Is. 6.3

- ¹⁷ Gjen. 1.26-27; 5.1; 9.6; Urt. Sol. 2.23; Sirak 17.3
¹⁸ Ps. 50(51).14
¹⁹ I Kor. 13.12
²⁰ Joan 1.14,18; 3.16,18; I Joan 4.9; Hebr. 1.3
²¹ Gjen. 28.12-13
²² Ps. 7.14; Ef. 6.16
²³ Matth. 6.34; 19.21
²⁴ Matth. 25.31; Lluk. 9.26
²⁵ Ruth 1.9; Sirak 11.19; 22.13; 28.16; 30.34(33.25); 51.27
²⁶ Kol. 2.15
²⁷ I Kor. 1.18
^{27a} Num.14.19 etj.
²⁸ Eks. 13.21-22; 14.19; 19.9; 34.5; Num. 11.25; 14.14; Ligji i Dytë 31.15
²⁹ Eks. 14.16,21
³⁰ Eks. 17.13
³¹ Tobit 12.15; Matth. 18.10; Lluk. 1.19
³² Is. 40.3; Matth. 3.3; Mark. 1.3; Lluk. 3.4; Joan 1.23; Vep. 13.10
³³ Vep. 20.19; Rom. 14.18; Kol. 3.24
³⁴ III [I] Mbret. 19.10,14
³⁵ Matth. 14.13; 21.17; Mark. 1.35,45;6.31; Lluk. 4.42; 9.10; 21.37
³⁶ Gjen. 2.17
³⁷ Ef. 6.12
³⁸ I Kor. 1.24
³⁹ Dan. 7.10; Matth. 25.31-32
⁴⁰ Mark. 1.40
⁴¹ Kol. 3.5
⁴² Dan. 2.34-35
⁴³ Eks. 3.2-5
⁴⁴ Eks. 16.33; Hebr. 9.4
⁴⁵ Num. 17.23
⁴⁶ II Kron. 18.18; Is. 6.2; Jez. 1.13-26; 10.1; Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 32
⁴⁷ Abak. 3.3
⁴⁸ Matth. 16.24; Mark. 8.34; Lluk. 9.23
⁴⁹ I Tim. 6.16
⁵⁰ Lluk. 1.30-35
⁵¹ Ps. 18(19).5
⁵² Matth. 5.12; Lluk. 6.23,35
⁵³ Dan. 6.18; Hebr. 11.33
^{53a} Eks. 14.21-15.1 etj.
⁵⁴ Gjen. 1.7-8; Is. 40.22
⁵⁵ Ef. 2.20-21
⁵⁶ Vep. 10.38
⁵⁷ Is. 61.10
⁵⁸ Ps. 23(24).8
⁵⁹ IMbret.[Sam.]2.1; Ps.17(18).2; 70(71).3
^{59a} Vep. 16.5
⁶⁰ Vep. 20.28
⁶¹ Matth. 10.1b; I Kor. 12.9,28,30
⁶² Matth. 10.1a
⁶³ Kënga 4.7-8
⁶⁴ Abak. 3.1-2
⁶⁵ Ps. 131(132).8
^{65a} Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 30
⁶⁶ Lluk. 2.22-38
⁶⁷ Is. 26.9
⁶⁸ Eks. 32.11 etj.
⁶⁹ Joan 14.27
⁷⁰ I Kor. 1.30
⁷¹ Fil. 4.7
⁷² II Kor. 6.16
⁷³ Ps. 33(34).6
⁷⁴ Ps. 118(119).144,169; I Thes. 4.9
^{74a} Is. 6.1-3
⁷⁵ Is. 6.5
⁷⁶ Is. 9.6

- ⁷⁷ I Mbret. [Sam.] 1.15; Ps. 141(142).3
⁷⁸ Ps. 106(107).26
⁷⁹ II Mbret. [Sam.] 22.20; Ps. 4.2;
 117(118).5
⁸⁰ Joan 5.35
⁸¹ Ps. 37(38).4,8
⁸² II Tim. 2.5
⁸³ Joan 14.9
⁸⁴ Lluk. 2.30
⁸⁵ Jona 2.3,10
⁸⁶ Matth. 3.1-4; Mark. 1.4-6
⁸⁷ Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 2
⁸⁸ Is. 33.6
⁸⁹ Kënga 5.13
⁹⁰ II Kor. 13.13
^{90a} Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 26
⁹¹ Dan. 3.17
^{91a} Joan 1.1
⁹² Hebr. 5.7
^{92a} Joan 19.34
⁹³ Dan. kap. 3 Lutja e Azaria 34
⁹⁴ Apok. 7.17; 21.4
⁹⁵ Ef. 4.18
^{95a} Ps. 43(44).20
⁹⁶ I Kor. 12.4
⁹⁷ Hebr. 9.12
⁹⁸ Joan 1.13
⁹⁹ Kol. 2.17; Hebr. 8.4-5; 10.1
¹⁰⁰ Rom. 2.27,29; 7.6; II Kor. 3.6-7
¹⁰¹ Eks. 13.2,12,15; 34.19; Num.
 3.12; 8.16; 18.15
¹⁰² Hebr. 1.6
¹⁰³ Matth. 1.25; Lluk. 2.7
¹⁰⁴ Fil. 2.15
¹⁰⁵ Ps. 106(107).25,29
¹⁰⁶ Matth. 11.29-30
¹⁰⁷ Gal. 4.26
¹⁰⁸ Matth. 25.35



MË 18 TË TË NJËJIT MUAJ

Kujtimi i etërve tanë të shenjtë, kryepiskopëve të mëdhenj të Aleksandrisë, Athanasit dhe Kirilit.

Tipikon

Nëse bie e diel, të shtunën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 6 ngjallësore dhe 4 të hierarkëve. Lavdi i hierarkëve. Tani Hyjlindësore dogmatike e tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni. Leximet. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi si dhe Tani të hierarkëve. Përlëshoret: ngjallësore, e hierarkëve dhe Hyjlindësorja e tyre.

Të dielën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Kanuni Triadik, Litia e hierarkëve dhe Himne Triadike. Trishenjtë. Përlëshorja e hierarkëve. Në Mëngjesore, Ndenjësoret ngjallësore. Pas Polieleit, Ndenjësoret (pas Polieleit) e hierarkëve. Bekimtoret. Ipakoia. Shkallesat dhe Proqimeni i tingullit. Kanunet: ngjallësor dhe të dy të hierarkëve. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e hierarkëve, dhe Ndenjësoret e tyre. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia ngjallësore, dhe Sinaksari. Zbritësoret Fundin edhe burimin; dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor. Më të nderuarën. Dërgimësoret: ngjallësore dhe të hierarkëve. Lavdërimet: 4 ngjallësore dhe 4 të hierarkëve. Lavdi Eothinoni. Tani E përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji, Tipiket. Lumërimet: 4 të tingullit dhe 4 nga Ode VI e hierarkëve. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore, e hierarkëve dhe e kishës. Kontaqi Ti që

e shenjtërove. Apostulli i hierarkëve. Ungjilli i së dielës.



NË MBRËMËSORE

Pas Qëndrimt të parë të Psaltirit (Lum ai njeri),

Thirrtoret të shën Athanasit

Ting. IV Os jeneon en mártisin

Ke pësuar përndjekje plot* dhe durove rreziqe tmerr,* atë Athanas shenjt hyjfolës, derisa* e ke dëbuar mashtrimin besëkeq të Ariosit* dhe shpëtove grigjën ti,* prej besimit të tij të rrem',* se orthodhoksisht* dogmatise se Biri edhe Shpirti të njëqenshëm jan' me Atin, o celebrues i tërëlum.

Predikimi yt si rrufe* shndriti të errësuarit,* e largove gjithë mashtrimin si ushtar* që rrezikoje në front të par' për besën, o Athanas,* plot fuqi barí vërtet,* bazament i patundur dot* për Orthodhoksin'* pra, për Kishën¹ e Krishtit, ndaj të mbledhur të nderojm' melodikisht me hare, o shenjt i kënduar fort.

Uushtrove në çdo virtyt* me ngulm, atë, u leve ti* me krezmin të shenjtë² të Shpirtit, ishe qart'* një celebrues i hyjshëm fort, barí i vërtetë pra,* luftëtar i besës son',* Kisha mbarë ndaj e lëvdon,* gjithashtu feston,* o

i hyfrymëzuar, shenjtërisht kujtimin tënd, dhe Shpëtimtarit i falet dhe lart atë e ngre.

Të shën Kirilit Të ngjashme

Përmes dogmave djegëse* dhe të zjarrta që shprehe, shenjt,* digjet tërë lënda e herezis' si shkarpi*;³ në thellësin' e kuptimeve vithiset ushtri, armat'* të pabindurish⁴ në fe* dhe me dogmat që the urtisht* zbu-kurohet nur,* o Kiril, çdo dit' Kisha e besnikëve dhe të nderon me zë të madh, o i lumur, i mençur ti.

O Kiril i hyjnueshëm,* përmes oratoris' që kish* fjala jote, Kisha mbarë si me stoli* po zbu-kurohet, me hir,⁵ me hijeshi besërisht; nderon* me kushtim kujtimin tënd* të shënuar, të shenjt', të madh,* o lavd Etërisht* dhe shkëlqim për Orthodhoksinë, korifeu i Sinodit dhe përluftar i Zonjës së Tërëshenjt'.

Me purtekën e dogmave* që formove, dëbove tej* ujqërit mendorë,⁶ larg Kishës së Krishtit* dhe e rrethove ti me fortifikim, mur, e shfaqë pra* të paprekur tërësisht* para Zotit, atij iu lut,* orator Kiril,* të çlirohen nga prishja dhe rreziku sa kremtojnë plot me besë kujtimin tënd që gjithnjë ka nder.

Lavdi

Ting. Tërth. II I Kirilit, patriarkut të Konstandinopojës

Kryetarët e hierarkëve, majat e patriarkëve, ndriçuesit e tërëshkëlqyer të planetit,⁷ shfaqësit e kuptimeve të Krishtit duke u mbledhur, o kremtimdashës, le t'i mburrim me lartësime shpirtërore duke thënë: "Gëzohu, o Athanas i urtë, me emër identik të pavdekësisë, që Ariosin fjalaman si ujk e hodhe matanë grigjës⁶ së Krishtit me hobenë prej llastiku⁸ të dogmave të tua të hyjurta". "Gëzohu, o yll i tërëndritshëm, luftëtar i Gjithmonëvirgjërës, që me zë tepër të lartë e shpalle si Perëndilindëse në mes të mbledhjes së hyjshme në Efes, dhe rrëzove fjalët e kota të Nestorit, o Kiril i tërëlumur". "Gëzohuni, o burime theologjie, lumenjtë e hyjurtësisë, që rridhni përherë,⁹ ju kroje të dijes hyjnore; pra, o Etër tri herë të pasur, mos pushoni së ndërmjetuari pranë Krishtit për ata që me besim dhe mall bëjnë panairin tuaj të shenjtë dhe të tërëhyjnueshëm".

Tani *Hyjlindësore*

Cili s'do të të lumërojë, o Hyjlindëse Virgjëreshë? Cili s'do të përhimnojë lindjen tënde të kulluar? Se biri yt i vetëmlindur që shkëlqeu prej Atit¹⁰ pa mot, gjith' ai lindi prej teje së pastrës i mishëruar pa tregim; duke qenë prej natyre Perëndi dhe duke u bërë për ne njeri prej natyre, i

pandarë në dy fytyra, por i njohur me dy natyra pa përzier. Atij lutju, o Zonj' e lumur, të mëshirohen shpirtrat tanë.*

Hyrje. O dritë gazmore. Proqimëni i ditës dhe Leximet.

Këndimi i Ligjit të Dytë
(1.8-10; 15-17)

U tha Moisiu bijve të Izraelit: “Shikoni, e dorëzova para jush dheun; pasi të futeni, trashëgoni dheun, për të cilin Zoti iu betua etërve tanë, Abrahamit, dhe Isaakut, dhe Jakovit, se do t’ua jepte atyre dhe farës së tyre pas këtyre. Dhe iu fola juve në atë kohë, duke thënë: ‘Nuk do të mundem t’ju sjell unë vetëm. Zoti, Perëndia ynë ju shumoi dhe ja jeni sot si yjet e qiellit për sa i përket numrit. Zoti, Perëndia i etërve tanë ju shtoftë juve, si jeni, një mijë herë dhe ju bekoftë, sikundër ju foli juve.’ Dhe mora prej jush burra të urtë, dijetarë dhe të mençur, dhe i vura që të udhëheqin mbi ju, kryemijësja dhe kryeqindësja dhe kryepesëdhjetësja dhe kryedhjetësja dhe prokurorë te gjykatësit tuaj. Dhe i porosita gjykatësit tuaj në atë kohë duke u thënë: ‘Dëgjoni midis vëllezërve tuaj dhe gjykoni drejt midis burrit dhe midis vëllait të tij dhe midis proslinitit të tij. Nuk do të njohësh fytyrë në gjykim. Sipas të voglit dhe sipas të madhit do të

gjykosh. Nuk do të ulësh fytyrë njeriu, sepse gjykimi është i Perëndisë.”

Këndimi i Ligjit të Dytë
(10.14-18; 20-21)

U tha Moisiu bijve të Izraelit: “Ja, i Zotit, Perëndisë tënd është qielli dhe qielli i qiellit, dheu dhe të gjitha sa janë në të. Por Zoti parapëlqeu që t’i dojë etërit tanë dhe zgjodhi nga të gjitha kombet farën e tyre pas këtyre, juve, në këtë ditë. Dhe do rrethpitrni zemërgurtësinë tuaj, dhe qafën tuaj nuk do ta ashpëroni më. Sepse Zoti, Perëndia juaj, ky Perëndi perëndish dhe Zot zotërisht, Perëndia i madh, i fuqishëm dhe i frikshëm, i cili nuk admiron fytyrën, që nuk do të marrë dhuratë, që bën gjykim për proslinitin dhe jetimin, dhe të venë, dhe e do proslinitin, ka për t’i dhënë atij bukë dhe veshje. Zotin, Perëndinë tënd do ta kesh frikë dhe atë vetëm do të adhurosh dhe tek ai do të ngjitesh dhe në emrin e tij do të betohesh. Ai do të jetë krenaria jote dhe ai do të jetë Perëndia yt, që të bëri gjëra të mëdha dhe të lavdishme, këto që i panë sytë e tu.”

Këndimi i Urtësisë së Solomomit
(3.1-9)

Shpirtrat e të drejtëve janë në dorë Perëndie dhe nuk do t’i prekë torturë. U dukën në sytë e të pamendëve se vdiqën dhe u konsiderua keqtrajtim dalja e tyre dhe ecja nga ne dërrmim,

por ata janë në paqe; sepse edhe nëse para faqes së njerëzve do të ndëshkohen, shpresa e tyre është plot pavdekësi; dhe pasi do të edukohen me pak *mundime*, do të fitojnë mirëbërje të mëdha, sepse Perëndia i provoi dhe i gjeti të denjë për veten. Si ar në shkritore i provoi ata dhe si holokaust flijimi i pranoi ata; dhe në kohën e shqyrtimit të tyre do të ndriçojnë dhe si shkëndija në kallam do të vrapojnë. Do të gjykojnë kombe dhe do të sundojnë popuj, dhe do të mbretërojnë në ata Zoti ndër shekuj. Ata që kanë besim në të do të kuptojnë të vërtetën dhe besimtarët me dashuri do të qëndrojnë me durim pranë tij, sepse ka hir dhe mëshirë ndër oshënarët e tij dhe mbikëqyrje mbi të zgjedhurit e tij.

Në Liti Idhiomele

Ting. I I Gjerasimit të Aleksandrisë

Urtësia e Perëndisë,¹¹ shtrëngimet në botë dhe mundjet e armiqve i përgatiti si shkritore të çmuar, ku e sprovoi vlerësisht arin¹² tepër të pastër, Athanasin, hierarkun e tërëurtë, ndriçuesin e shkëlqyer të Aleksandrisë; dhe si e gjeti të denjë,¹³ e bëri si unazë për të djabatën¹⁴ e shenjtë, ndaj edhe shpirtin e tij të lumur e mori për vete si nuse,¹⁵ dhe dëfrehet me të në jetët.

I njëjti

Urtësia e Perëndisë¹¹ i fshehu mirë thesaret e saj brenda Kirilit; prandaj le të mos gërmojmë në dhé, të mos kujdesemi për thesare të prishjes dhe të mos nxitojmë të pasurohemi me to, sepse shijimi i tyre do të na jetë provizor; por duke shijuar përjetësisht thesaret e hyjurtësisë së Kirilit të trillumur, le t'i ruajmë në shpirtrat tanë.

I njëjti

Në fillim urtësia e Perëndisë,¹¹ pasi e kombinoi nga shpirti dhe trupi, gatoi njeriun, në të cilin të gjitha janë të çuditshme,¹⁶ por në rigatimin e ri, njeriun e lidhi me Perëndinë. Bashkimin e parrëfyeshëm dhe të pashpjegueshëm na e dorëzuan Mësuesit tepër të hyjshëm të Krishtit Perëndisë tonë, duke pohuar një hipostazë në kombinimin e Krishtit dhe dy vullnete, në po të njëjtën hipostazë. O dëgjim i huaj! O pamje e huaj! O ngazëllimi i huaj i shpirtrave!

Ting. III I Gjermanoit patriark

Trumbeta e madhe e Kishës, Athanasia i shumëvuajturi fitimtar, e mbledh sot Kishën për dëfrim. Me gëzim të gjithë ne, o besnikë, le të shkojmë të presim panairin e bariut të mirë,¹⁷ duke lavdëruar me himne lodhjet e tij të hyjshme, që falë ndërmjetimeve të tij të marrim prej Krishtit Perëndi përdëllimin e madh^{17a}.

Injëjti I të njëjtit

Lavdinë e madhe të priftërinjve, fitimtarin e pamundur, Athanasin, le ta lartësojmë hyjnisht; ai me fuqinë e Shpirtit¹⁸ preu kolonat e herezive, ngriti në mbarë botën trofetë e Orthodhoksisë duke numëruar besërisht misterin e Trinisë për atributet e personave, dhe nga ana tjetër, duke i lidhur në një pa trazim për shkak të njësimin të esencës; dhe duke theologuar si Keruvimet,¹⁹ ndërmjeton për shpirtrat tanë.

Lavdi *Ting. Tërth. II**I Gjerasimit të Aleksandrisë*

Ejani të dëfrejmë të gjithë bashkë ne të dhëlindurit me rastin e kujtimit të Mësueve tanë tepër të urtë, Athanasit dhe Kirilit; sepse ata si mundës të vlershëm për Perëndinë dhe luftëtarë shumë besnikë të së vërtetës, rezistuan besërisht kundër armiq të padukshëm dhe të dukshëm; prandaj në qiej Mbreti i të gjithave i kurorëzoi me kurorat e pavdekësisë së tij; dhe tani duke kërcyer me engjëj, e himnojnë pa pushim me këngë trishenjtorë²⁰ atë, të bashkëqenshëm në Trini.

Tani *Hyjlindësore*

O Hyjlindëse, ti je hardhia e vërtetë,^{20a} që nxore frytin e jetës; të lypim ndërmjeto, o Zonjë, bashkë me Mësuesit dhe me gjithë shenjtorët, që të mëshirohen shpirtrat tanë.

*Pasvargje**Ting. Tërth. I Heris askitikón*

G'zohu, o çift kryepriftërinjsh,* bazë, mbështetje jeni për shpresëtarët ju,* rrënimi i herezive, bedenat mjaft të mëdhenj* pra për Kishën, shtyllat e besimit ton',* themeli për çdo besnik* dhe barinj që kullosin drejt;* ju që e rritët* me virtyte të ndryshme pra* përmes dogmave* të hyjnueshme popullin,* shpallës të zjarrt' të Hirit, dhate ligje të tërësit'* e Krishtit, o udhëzues për në Parajs', hyrjet e saj lart;* kërkoni nga Zoti* që te shpirtrat të dërgojë ky përdëllim të madh.^{17a}

Varg: Goja ime do të flasë urtësi dhe studimi i zemrës sime mençuri.

G'zohu, o çift kryepriftërinjsh,* shëtitës nëpër qiell, engjëjt ju përmbi dhé,* shpëtimi i botës, gazi për njerëz, Mësuesit* e planetit, mjekët me përvojë plot* të shpirtit dhe trupit, pra* për sëmundje të ndryshme ju,* o përluftarët* e Jisu Fjalës dhe lumenj* që prej Shpirtit Shenjt* përgjithmonë burojnë hir;* faqen e mbarë dheut e vaditët²¹ me fjalë drejt,* jeni themel, theologë, siç Zoti do, flisni të lartat; kërkoni nga Zoti* që te shpirtrat të dërgojë ky përdëllim të madh.^{17a}

Varg: Priftërinjtë e tu, o Zot, do të veshin drejtësi dhe oshënarët e tu do të ngazëllohen.

G'zohu, o dyshe, o çift hyjnor,* je për kupolën tokësore, si diell ti* dhe rreze me llamburitje ndriçimi tridiellor,* çdo i errësuar të ka rishikim;* je lulla aromëmir'* e Parajsës, me plot stoli,* vërtet i madh ti,* o i urtë shën Athanas* dhe Kirili shenjt,* pra kutitë e Shpirtit Shenjt,*²² pllakat që i ka shkruar Perëndia,²³ gjinjt' që burojnë* qumësht shpëtimi, lavdi urtësie ju, përgjet mbrojtëse,* kërkoni nga Zoti* që të shpirtat të dërgojë ky përdëllim të madh.^{17a}

Lavdi *Ting. Tërth. IV*

Majat e hierarkëve dhe ndriçuesit plot dritë të rruzullit,⁷ le t'i lavdërojmë me himne, o besnikë, Athanasin tok me Kirilin dhe le t'i thërrasim ngazëllueshëm Krishtit: O Zot i dhembshur, jepi popullit tënd me ndërmjetimet e mësuesve, ndjesë mëkatesh dhe përdëllimin e madh.^{17a}

Tani *Hyjlindësore*

Virgjëresh' e panusëruar që zure trupërisht Perëndinë pa tregim, nën' e Perëndisë së lartë, prit lutjet e shërbëtorëve të tu, o e gjith'panjollëshme, ti që u fal të gjith've paqësim mëkatesh, prit lutjet tona tani dhe lutu që të shpëtohen shpirtat tanë.*

Përlëshore

Ting. III Thias pïsteos

Shndritët me veprim* Orthodhoksie,* shojtët keqbesim* prandaj u bëtë* fitimtarë triumfues; përmes besës* u pasuruan me çdo gjë dhe Kishën ton'* e zbukuruan mjaft, ndaj gjetët denjësisht* Perëndinë Krisht, që fal përmes lutjes suaj ndjes'* te ne të gjithë përdëllim të madh^{17a} gjithnjë.

Lavdi *dhe Tani*

Hyjlindësore

Ty që ndërmjetove për shpëtimin e gjindjes son' të përhimnojme, o Hyjlindëse Virgjëreshë, se duke denjuar pësimin e kryqit me trupin që mori prej teje, Biri yt dhe Perëndia ynë na çliroj prej prishjes si njeridashës.*



NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së parë, Ndenjëso

E shën Athanasit

Ting. Tërth. I Ton sinánarhon Logon

Athanasin e shenjtë, kopsht i dokrinave* të Shkrimit të frymëzuar nga lart,²⁴ që na udhëheq* në pendim dhe i duroi sprovat e pa fund,* siç duhet, o besnikë ne* ta nderojmë, sepse morëm prej tij shumicë dijesh,* gjithashtu ndërmjeton te Zoti të përdëllehen shpirtat tanë me hir.

Lavdi *dhe* Tani *Hyjlindësore*
Gëzohu, o der' e Zotit e pashkuar;²⁵
 gëzohu, o mur dhe mbrojtje e atyre
 që ikin te ty; gëzohu, o liman i
 padimëruar dhe e pamartuar; ti që
 linde trupërisht bërësin tënd dhe
 Perëndi, mos resht së ndërmjetuari
 për ata që përhimnojnë dhe
 adhurojnë Birin tënd.*

Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësores
E shën Kirilit

Ting. III Thias pisteos

Bazament hyjnor* i Kishës sonë,*
 atë shën Kiril,* u shfaqe; shkrove*
 dymbëdhjetëshin e fjalëve, ku qor-
 ton* Nestorin që kishte mendje të
 shtrembër mbrapsht,* dhe kryesisht
 ti e shpalle Hyjlindësen,* o i madh
 ndër oratorë; lyp Perëndinë Krisht*
 të na dhurojë përdëllim të madh^{17a}
 dhe hir.

Lavdi *dhe* Tani *Hyjlindësore*
Fron²⁶ i tërëart* i mbretit tonë*
 dhe Parajs' me hir* e lulëzuar* u
 tregove, o Hyjlindëse e pacen,* se
 mbajte Zotin në bark, ndaj përhap te
 ne* erë të mirë, karizma të hyjshme
 ti,* ndaj të gjithë ne të shpallim, të
 madhështojm' gjithnjë* vërtet si
 nënë Perëndie me lavdi.

Pas Polieleit, Ndenjësores e përbashkët
Ting. I Ton tafon su Sotir

Ta mburrim që të gjith'* Athana-
 sin, Kirilin* se kanë qenë pra* shë-

rbëtorët e hyjshëm* të Shën Trinisë,
 luftëtarët e besës, që thellësisht* me
 arsytim* të së vërtetës rrëzuan*
 denjësisht ushtrin**⁴ e heretikëve pa
 mend,* që Kishës s'i bindeshin.

Lavdi *dhe* Tani *Hyjlindësore*
Na ngri se ramë ne* në humner'
 dëshpërimi,* në tmerre, në trishtime
 dhe shkelje, o Vajzë;* shpëtim për
 mëkatarë je, ndihmë, mbrojtje me
 plot fuqi;* ndaj dhe na shpëton*
 ne shërbëtorët e tu ti,* Zonjë shën
 Mari,* o enë e respektuar* e Zotit
 Krisht Perëndi.

Shkallesat. Antifoni i parë i Ting. IV
Proqimeni Ting. IV

Priftërinjtë e tu, o Zot, do të veshin
 drejtësi dhe oshënarët e tu do të
 ngazëllohen.

Varg: Goja ime do të flasë urtësi dhe
 studimi i zemrës sime mençuri.

Ungjilli. Psalmi 50.

Lavdi. Me ndërmjetimet e Mësuesve.
 Tani. Me ndërmjetimet e Hyjlindëses.
 Përdëllemë, o Perëndi. *Dhe Idhiomeli.*

Ting. Tërth. II

Uderdh hiri në buzët tuaja,⁸ o etër
 oshënarë, dhe u bëtë barinj të Kishës
 së Krishtit duke i mësuar dhentë e
 logjikshëm, që të besojnë në Trininë
 e bashkëqenshme në një Hyjni.

Kanunet: i Hyjlindëses

*(shih fq. 197) bashkë me Irmoset në 6
dhe të hierarkëve në 8.*

Ode I

*Kanuni i shën Athanasit, që ka
Akrostihidhë (pa Hyjlindësoret):*

*“Athanasi është mburrja e
Orthodhoksisë”. I Theofanit.*

Ting. Tërth. IV

Armatilatin Faraó

Kur Athanasit lavdërim i sjell, vir-
tytin vetë unë lëvdoj;* më mir’ lavdë-
rimin* Perëndisë ia ofroj, se dha ai
tek njerëzit* pasuri të nderuar fort të
virtytit, të cilit ish* vula dhe ikona e
gjallë ky.

Me urtësi hyjnore ishe mbushur
dhe më shumë se dielli* shndritje,
oshënar ti,* dhe kështu jetoje, ka-
përceve ligj për lavdërim,* je mbi
mburrjet që pleksëm, por na duro ne
që të himnojm’,* dhe pse s’vlen si
duhet ky himn për ty.

Himn thurim siç e kemi për detyrë
për kujtimin tënd me lavdi,* por
si të paaftë,* dhe pse s’duhej, në
shumicën e himnimeve, o shenjt*
Athanas, të kërkojm’ të na jepet
falje dhe shumë hir* përmes teje
prej Shpirtit Perëndi.

Me vrull rinie i shfarose hovet e
pasionit që mishi ka;* në rininë
tënde* zotëroje mendje pleqërie të
qëndrueshme,* o i lum Athanas, se

me dashuri për urti me zell* gjithë
shqisat orientove drejt.

Hyjlindësore

Në gjenerata gjeneratash²⁷ thanë
gjëra të lavdishme për ty,*²⁸ që në
bark e mbajte* Fjalën Perëndi^{28a} dhe
mbete e kulluar, o Mari,* o Hyjlin-
dëse, ndaj ne të gjithë të lartësojmë
ty,* që pas Perëndis’ mbrojtja jonë
je.

*Kanuni i shën Kirilit, që ka
Akrostihidhë (pa Hyjlindësoret):*

*“Kirili është lirë teorish të
perëndishme”.*

Poezi e Joan Damaskinoit.

Ting. IV

Thalasis to erithreon

Si prite* nga Perëndia hirin²⁹
dritëdhënës, o Kiril,* u shfaqe si
ndriçues që shndrit tej;* na shkël-
qen vezullim logjik,* që siç e meri-
ton kujtimin tënd me gaz ta për-
himnojmë ne.

Umbushe* me dritësim prej Shpir-
tit, o Kiril i urtë fort,* se mbajte po-
rosit’ e Zotit Krisht,* u pastrove prej
veseve krejt,* vërtet shtëpi u bëre
për Trininë e mbiperëndishme³⁰ ti.

Meqë ti* u mbushe me guxim dhe
zell, Kiril shenjt famëmadh,* çdo
llomotitje heretike kot* të armiqve
ndaj Zotit tënd Krisht,* si prijës
i Orthodhoksisë i qortove ti pa

kompromis.

Hyjlindësore

I pari* ndër vdekatarët shkeli porosin' e Bërësit,* kur u mashtrua, ra fatkeqësisht,* nga shijimi larg ky u përzua,*³¹ por e rithirre, nënë virgjëresh', kur mbajta Çlirimtar në bark.

Zbritësore: Herson avisotokon

Fundin edhe burimin (*shih fq. 354*)

Ode III

I shën Athanasit: O stereosas kat' arhás

Pasi pastrove shpirt dhe trup,* o Athanas, nga çdo njollë,*³² tempull krejt i denjë për Perëndinë*³³ u tregove, plotësia e Trinis' u preh në ty,*³⁰ atë i tërëpasur* edhe hyjmist i mistereve.

E gjeti, atë, shpirtin tënd* siç dëshironte pra Hiri* i Ngushëllimtarit, krejt të pastruar* nga pasionet,³² edhe haptas energjit' e shenjta shfaq* përbrenda teje; të vë* pra si ndriçues në botë⁷ ty.

Për priftërintë je kanun,* si hierark, ndërsa jetën* udhëzues në praktike e kishe,* fjala jote ish për teori një shembull mjaft i gjall'* dhe mësimdhënia jote* ishte vërtet plot theologji.

Hyjlindësore

Upe, Hyjlindëse, më lart,* më sipër se Keruvimet* edhe Serafimet, ti vetëm prite* Perëndi të pacenuar brenda barkut, e dëlir',* o e panjollë; me himn* besnikët mbarë të lumërojn'.

I shën Kirilit: Efrénete epi si

Ifortë në Krishtin³⁴ tënd* makinacionet e dragoit të lig* i shfarose me fuqi,* si rrjet' merimange, o shën Kiril.

Ke shkundur nga shpirti yt* balt' vesesh kur rrëzove, o shën Kiril,* çdo gjë që po ngrihej lart* mendërisht, o atë, ndaj Krishtit Zot.³⁵

Ke shmangur fuqishëm, at',* çdo mirëqenie mishërore me dëm,* që vepron me tinëzi,* duke qen' atlet³⁶ i suksesshëm ti.

Hyjlindësore

Ty engjëlli Gabriel* të tha hare përmbi mendim, ndaj gëzo,* o tendë ti, ku Zotit Krisht* i pëlqeu që të fushojë pra.³⁷

Zbritësore: To steréoma ton epi si

Zoti Krisht

Kontaqi i shën Athanasit

Ting. II Tis ton ematon su

Dogmat e Orthodhoksisë i mbolle ti,* çrrënjose gjembat e besës së

remë bosh,* dhe shumëfishove far' bese³⁸ drejt,* o oshënar, përmes shiut të Shpirtit Shenjt,* prandaj të himnojme, o Athanas.

Ndenjësore e përbashkët
Ting. IV Tahí prokatálave

Përmes mësimdhënies ju shndritët planetin me hir,* o Etër me hyjurti edhe ndriçues⁷ me llamburitje të Kishës son',* tretët gjith' herezitë* e atyre që kishin* mendje të shtrembër, shojtët blasfemi dhe trazira,* ndaj si hierarkë ndërmjetoni që të shpëtojm'.

Lavdi *dhe* Tani *Hyjlindësore*
O nënë e Krishtit Zot, e Virgjër pa burrë krejt,* Mari e himnuar fort, hyjnuse, ndihma e shpresëtarëve, ti çliro* nga çdo rrezik e derti* dhe nevoje, o Zonjë* Hyjlindëse, e vetmja e dëlirë, sa rendim* me besë dhe mall nën strehën tënde dhe na shpëto.

Ode IV

I shën Athanasit: Si mu iskis Kírie
Fryma jetëprurëse e Shpirtit të Krishtit, e cila më parë erdhi hyjnisht nga lart në katin e sipërm dhe i mbushi nxënësit, pasi fryu³⁹ e tëra në ty, të tregon apostull të trembëdhjetë, o atë, që predikon besimin orthodhoks.

Duke u djegur tepër nga zelli i

perëndishëm, edhe para se të bëhesh kryetar, dhe duke luftuar me të tjerët në Sinodin e Nikeas, predikon Bashkëqenien; prandaj Krishti të evidenton si kryebari dhe Mësues të Kishës.

Kur të dorëzuan nga providenca hyjnore timonet e Kishës, o Athanas, si ndonjë sëpatë preve nga rrënja si gjemba, të gjitha gjepurat shpirtprishëse të heretikëve dhe kultivove urtësisht, duke vaditur, farën e fjalës.³⁸

Prej gjuhës sate të zjarrtë u dogji ndarja e degjeneruar e Ariosit dhe konfuzioni i Savelit, këto të këqija diametralisht, por të njëjta për sa i përket keqbesimit, dhe tok me ta çdo blasfemi heretike, o Athanas.

Hyjlindësore

Ti je krenaria e besnikëve, o e panusëruar, je mbrojtje, je edhe strehë të krishterësh, mur dhe liman, sepse sjell lutje te Biri yt, o e tërëpaqortueshme, dhe shpëton nga rreziqe ata që me besë dhe dëshirë të njohin si Perëndilindëse të kulluar.

I shën Kirilit: Eparthenta se idhusa
Krishti të vendos kryetar të Kishës së hyjshme, o atë Kiril hyjprurës, sepse të pa të kesh nënshtruar pasionet shpirtprishëse dhe të kesh mbizotëruar mbi mish me anë të

mendimit.⁴⁰

Si fëmijë i dashur, ke trashëguar virtytin atëror të Markut, dhe u bëre pasardhësi i fronit të hyjnueshëm, duke ndjekur gjurmët⁴¹ e ungjillorit.

Nga një anë u kullote si dele prej Krishtit, dhe nga ana tjetër si barí e kullote grigjën,⁴² o atë, me fjalët e tua shpirtushqyese, sikur e ushqeje me begati me barnat dhe lulet e Hirit.

Hyjlindësore

O nënë e tërëkulluar e Perëndisë, e pushove totalisht tiraninë e vdekjes që konsumonte, kur kishe në bark Jetën e paplakur; prandaj të thërresim: Gëzohu, o Virgjëreshë e tërëhimnuar.

Zbritësore: Ekálipsen uranús

Mbulove me virtyte

Ode V

I shën Athanasit: Ina ti me aposo

Duke pasur Krishtin të fliste nëpërmjet instrumentit tingëllues, pra gjuhës sate, o atë i lumur Athanas, qorton me shkrim herezinë e idhujve, duke udhëzuar dhe kthyer te Perëndia i vërtetë të humburit.

Turpërove me triumf, me fjalë dhe shkrime herezi shfarosëse, duke zbuar nga bota me prova të urta

mashtrimin e shumëllojtë dhe duke shpallur pa kundërshtim besimin orthodhoks, o atë i lumur.

Kisha e Krishtit, o atë i urtë Athanas, pati fat të të ketë Mësues vërtetë të madh ndër Mësuesish me shprehje jo të shtirë, pas apostujve, ti që sqaroje fjalën e paqortueshme të besës.

Hyjlindësore

Duke pasur guxim nënor para Birit tënd, o e Tërëkulluar, të përgjërrohemi të mos e shpërfillësh përkujdesjen tonë farefisnore, sepse ne të krishterët të vëmë para Zotit vetëm ty si zbutje dashamirëse.

I shën Kirilit: Si Kírié mu fos

Fjala jote, o Kiril, imiton rrymë të vrullshme vërtet, përrua të përmbushur, e cila devijon manovrat e besëkëqijve.

Vithise nga bazamenti në mënyrë të barabartë ndarjen e neveritshme të Ariosit dhe përzjerjen e fëlliqur të Savelit, o Kiril.

O Kiril, i ke lënë Kishës së Krishtit jo ar dhe thesare, por fjalët e tua pasuruese, porsi gurë të çmuar.

Hyjlindësore

O modeste, me të vërtetë karakteri i trajtës sate të shenjtë i largon

demonët, ndërsa besimtarët i shenjtëron dhe shpirtrat tanë i shpëton.

Zbritësore: Os idhen Isaia simbolikós

Të pa shën Isaia

Ode VI

I shën Athanasit: Ilásthiti mi Sotír

Qortove, i tërëlum,* me forcë Apolinarin e pamend, e trashë, u shfaq* si një mbjellës fare krejt të huaj,⁴³ të kotë pra* për logjikën, mendjen* njerëzore të Jisuit Krisht.

O oshënar, nxjerrim ne* besnikët rrjedh' më të ëmbël se vet' mjalti,⁴⁴ se kjo buron* porsì prej një gurre kur derdh rrymë logjike ti,* oshënar, nga buzët* prej burimi hiri⁵ që s' shteron.

Çuditet natyrshëm krejt* gjithkush që me urtësi studion thell' shkrimet e tua, at';* sheh që parazmbrapse si profet i përsosur ti* herezi që kishin* për t'u mbjellë në të ardhmen pra.

Hyjlindësore

Le të çlirohemi pra* nga shkeljet e rënda, o Hyjnënë e kulluar, ne krejt* dhe me përgjërimit tënd të gjejmë ndriçim hyjnor* nga ai që mori* mish prej teje, Bir i Perëndis'.

I shën Kirilit: Thiso si metá fonís

Me një mash'* një Serafim qymyr⁴⁵ dha te një profet,* ndërsa te Kisha e Krishtit* jep pastrim, i cili u bë

thëngjilli* përmes zjarrit* hyjnor, hyjmist, me duart e tua pra.

Vrave ti* jo fqinj të huaj porsì Samsoni trim,*⁴⁶ por gjithë dogmat tuhafë* edhe besëkeqe, atë Kiril shenjt;* jep pushtetin* te ne orthodoksët që të lëvdojm'.

Në Sinod* hyjnisht të mbledhur ishe i pari ti,* vithise krejt arrogancën* tmerrësisht luftuese të Nestorit* kundër Krishtit,* vërtet të nxiste zell për Hyjnënë, at'.

Hyjlindësore

O Hyjnën'* e virgjër, shndrit çdo anë të kozmosit* me lindjen tënde plot dritë,* e dëlir' u pe vetëm ti, e pastër* nga fillimi,* sepse e mbajte diellin krejt të drejt'.⁴⁷

Zbritësore: Evóisé si

Kur Simeoni

Kontaqi i përbashket

Ting. IV Epëfanis símeron

Hierarkë të mëdhenj,* me lavd të besës,* luftëtarë me guxim,* trimat e Kishës sonë ju* na mbron, na mbani, se këndojm':* Sa me besim të nderojm', Shpëtimtar, shpëto.

Shtëpia

O i dhembshur, pasi me dorën tënde të pakuptueshme dhe me fuqi të parrëfyeshme e bëre tani Kishën si

qiell, i tregove me të vërtetë vezullues të dy ndriçuesit, të hijeshuar dhe tepër të mëdhenj që llamburitën botën,⁷ tok me Athanasin e tërëurtë, Kirilin e hyjshëm; ndaj me përgjërimit e tyre, pasi të heqësh natën e armiqve, shpërndaje çdo mjegull, o Çlirimtar, dhe shkëlqej me dritën e frikshme tërësitë e besnikëve, që të thërrasin dhe të këlthasin: Sa me besim të nderojm', Shpëtimtar, shpëto.

Sinaksari

Më 18 të të njëjtit muaj, kujtimi i etërve tanë ndër shenjtorët Athanasit dhe Kirilit, patriarkët e Aleksandrisë.

Vargje: E quaj të gjallë Athanasin, dhe pse vdiq,/ sepse të drejtët rrojnë dhe pse të vdekur.⁴⁸

Krijesa sot ka kujtimin e ikjes së Kirilit,/ por jo të mbarimit të gjithmonëkujtuar.

Varrosën madhërisht lipsanin e Athanasit në të tetëmbëdhjetën.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martires së shenjtë Theodhula.

Vargje: Skllevërit e pseudoperëndive/ mendojnë se Theodhula vdiq përmes shpatës.

Në të njëjtën ditë, shenjtorja Kseni mbaron me zjarr.

Vargje: Krishti erdhi qëmoti që të vendoste zjarr në tokë.⁴⁹/ Kseni ushqyese duron zjarrin në mënyrë të

huaj.

Me ndërmjetimet e shenjtorëve të tu, o Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII

I shën Athanasit: Theú singatávasin

O atë me emrin e pavdekësisë, pasi e shpalle orthodhoksisht Fjalën të bashkënderuar e të bashkëfronshme me Atin, pra Birin e vetëmlindur,¹⁰ përsëri na mëson Shpirtin si të bashkëmbirë dhe të bashkësubstancshëm me Prindin dhe me Birin.⁵⁰

Prindi i pabesisë, kur të pa ty si mësues dhe predikues hyjtregues të dritës tridiellore, që u shpallje të gjithëve gjer në fundet e botës⁵¹ Orthodhoksinë, i ndërsente ngasjet kundër teje.

Rreziqet që pësove kur luftoje për shpresëtari, o i lumur, ishin të pamasë, gjithashtu edhe kurorat, të pakufishme, sepse ishe si diamant për ata që të godisnin, ndërsa si magnet i tërhiqje të gjithë drejt vetes.

Si flake tej dogma të koklavitura, të huaja për Kishën e Krishtit, theologove treshen e hipostazave, por në njësi Hyjnie, për të cilën psalje: I bekuar është Perëndia i etërve tanë.⁵²

Hyllindësore

Le ta lavdërojmë Marinë e pacenuar dhe të tërëshenjtë, sepse me anën e saj na buron tani hiri i dhuratave përmbi mendje si nga përroi i mirësisë hyjnore; po e lumërojmë me mendim besëmirë.

I shën Kirilit: En ti kamino avramiei

Në gadishullin Sina, qëmoti kur u fut Moisiu brenda errësirës,⁵³ mori Ligjin⁵⁴ e germës, i cili vriste,⁵⁵ o Kiril i lumur, ndërsa ti e ekspozove bukurinë e fshehur të Shpirtit.

Meqë legjislacioni u dha më parë me enigma si për foshnja, o atë, ti zbulove kuptimet si trëndafila të mbuluar me petale, pasi i shpjegove parafigurimet tepër qartazi.

O Kiril, na shqyrtove autentikisht punët e zorshme për të depërtuar të profetëve hyjpredikues dhe hyzënë, kur u frymëzove me Hirin e Shpirtit që i mbushi.⁵⁶

O atë Kiril, the duke theologuar, tri hipostaza në bashkim hyjnor, pa trazim dhe në ndarje të pandarë qartësisht, por të pandryshuara, në një esencë dhe Hyjni.

Hyllindësore

Ti që je tenda* e shenjtë dhe hyjnore e Zotit lart,*³⁷ ki gaz, se-

pse nëpërmjet teje u dha gaz,* o Hyllindëse, atyre që* thon': E bekuar midis grave ti je,¹¹ o e panjollëshme.

Zbritësore: Se ton en piri dhrosísanta

Hodhe vesën

*Ode VIII**I shën Athanasit: Eptaplasíos káminon*

O Athanas, lavdia e shkëlqyer e hierarkëve, shtylla e dritës,⁵⁷ bazamenti i Kishës,¹ përluftari i Trinisë, trumbeta e artë e thelogjisë, ligjshkruesi i përpiktë i jetës vetmitare, kremtofs bashkë me ne, duke edukuar plotësisht priftërinj dhe duke i sjellë Krishtit popuj për jetët.

Mbaje me të vërtetë emrin e pavdekësisë, sepse i tejkalove me logjikën njerëzit praktikë, ndërsa me saktësinë e jetës fitove mbi të sprovarit në fjalë; kapërceve majat e të dyve; prandaj pasi shkëlqeve falë virtytshmërisë së pakapërcyeshme, zotërove kujtim të pavdekshëm në jetët.

Nëpërmjet arritjeve të tua trime e paraqite më të shkëlqyer hierarkinë, o mist hyzënë; e syrgjynose mashtrimin përmes internimeve të tua të shpeshta për hirin e Trinisë, të cilën duke e predikuar thërrisje: Faljuni Atit, theologoni Birin, përhimnoni Shpirtin në gjithë jetët.

Hyjlindësore

Oe tërëkulluar, u bëre banesë drite të paperënduar, sepse linde dritë tek ata që ishin në errësirë dhe hije,⁵⁸ e cila i llamburit të gjitha me hir hyjnohjeje; asaj pa pushim ne besimtarët i këndojmë: O Djem beconi, priftërinj përhimnoni, popull përmbilartësoni në gjithë jetët.

I shën Kirilit: Hiras ekpetasas Dhaniil

Burimi i urtësisë⁵⁹ gurroi brenda teje vërtet si valë deti, sepse rrodhën nga barku yt lumenj të pashtershëm dogmash shpresëtare, o atë, siç paratha Krishti,⁶⁰ sepse veprat e tua hyjfolëse e tejkalojnë rërën.⁶¹

Pasi u tregove, o oshënar Kiril, bariu dhe Mësuesi i urtë i Kishës, shtjellove qartësisht dy Dhiatat; ajo duke pasur si spirancë dhe trashëgimi atërore fjalët e tua, thërret: E beconi, ju gjithë veprat e Zotit, Zotin.⁶²

Na mëson si të pandarë dhe të patrazuar bashkimin e parrëfyeshëm të Fjalës gjithëbërëse⁶³ që u mishërua për ne, o Kiril, duke u shmangur në mënyrë të barabartë të dyja devijimet e duke thirrur: E beconi, ju gjithë veprat e Zotit, Zotin.⁶²

Hyjlindësore

OMari, Zonja e gjithçkaje, me fuqinë tënde të pushtetshme çliroje shpirtin

tim të tërëmjerë, që u pushtua nga pasionet e egra të mishit dhe fajet tepër të turpshme, dhe jep zgjidhje shkeljesh dhe lavdi të papikëluar.

Zbritësore: Astekto piri enothenes

Në flak' e në zjarr

*Ode IX**I shën Athanasit: Eksesti epi tuto*

Shkëlqeu jeta jote porsi rrufe* mbi të gjithë sa dielli sheh; u derdh si bubullim'* zëri yt, sepse kishe frymëzim* vërtet nga lart, o atë, pra* s' shojti varri, shkaku për çdo harrim,* kujtimin tënd të shenjtë,* o Athanas mësues,* përmes doktrinës sate na drejton.

Tani feks më shkëlqyeshëm me ndriçim* vezullues dhe tridiellor; na dërgo qartësisht* si pasqyr' e kthjellët pra reflektim* me llamburitje që nga lart* te sa të himnojmë, na garanto,* dhe pse kërkesa jonë* e madhe, i lum, është* të denjë s'jemi kurrë për atë.

Të lypim vazhdimisht me himnime ty,* përgjërohu për Kishën që mbretit t'i jepet dhurim,* pra fitore falë Kryqit të Shenjt'* dhe te besimi orthodhoks* forcë kundër çdo herezie, dhe* shpëtim për ne dhe paqe* për botën, Athanas shenjt,* me rastin e kujtimit tënd, o at'.

Hyjlindësore

O Vajzë, vlerësomë që të arrij* në shpëtim, e dëlirë krejt, se linde ti shpëtimtar,* çlirimtar, më zgjidh prej vargonjve pra,* prej shkeljes,⁶⁴ se arrin tani* çdo gjë që do, se mban në gjirin tënd* për botën tërëmbretin,* të mirin, të përsosur* pa krahasim a barazim, a fjal'.

I shën Kirilit: Eva men to tis parakoís

Ngritjen që u lartësua kundër diturisë* së Hyjlindëses dhe Birit Krisht* e shembe,³⁵ o Kiril, fuqishëm,* pra dyshen ateiste të bijve kot,* që thoshte Nestori dhe gjithashtu trazim* natyrash sipas Akefalëve.

Në të lartat lartësohesh, atë fort i lum,* se me dritësim prej Hirit Shenjt'* dhe me fuqin' e mendjes sate* theologove një qenie në Trini* dhe Birin e mishëruar si Perëndi,* o përluftari i Hyjlindëses.

Mbikëqyr himnuesit nga lart, i dhembshur at'* dhe i butë; tek i miri mbret* edhe kryqprurës jep fitore,* dhe lartësoje me ndërmjetimin tënd* ti bririn⁶⁵ e orthodhoksëve, ngazëllo* sa madhështojnë pra kujtimin tënd.

Hyjlindësore

Zemra ime u shterpua, s'ka virtyt hyjnor,* o e tërëpacenuar ti,* o

Virgjëreshë, por të frytshme* tregojë ti që linde nga nëna shterp';* kështu desh Zoti që çdo gjë ndryshon në Shpirt,* të të himnoj të përhimnuarën.

*Zbritësore: En nomo skiá qe grámati***N**ë Ligjën dhe Shkronjën*Dërgimësore**Tis mathitës sinélthomen*

I lumur atë Athanas,* Kiril, hyjshfaqës, mistë* të tërëurtë, luftëtar'* të Shën Trinis' që është* mbi çdo hyjni, ju rrëzuar* Ariosin, Savelin* edhe Nestorin besëkeq,* t' errësuar dhe tok me ta çdo mashtrim* herezish të ndryshme dhe fe të rremë,* o hierarkë dhe barinj* të Zotit tonë Krishtit.

Hyjlindësore

Kandilin⁶⁶ ta himnojme ne* dhe malin⁶⁷ fort të shenjtë* të Zotit, shtambë,⁶⁸ ark',⁶⁹ tryez',⁷⁰ shkop,⁷¹ temjanicë,⁷² fron,²⁶ port'* dhe tempull,²⁵ dhe nusërore,*⁷³ pra Vajzën e kulluar,* Hyjlindësen e virgjër krejt,* se si u mishërua pa pik' trazim* prej saj mbinatyrshëm krejt Perëndia,* e hyjnizoi çka kish marr'* me një bashkim mbi fjalë.

*Lavdërime**Ting. I Ton uranion tagmaton*

Ejani, o kremtimdashës, të bëjmë

panair,* që ta nderojm' kujtimin* e Mësuesve plot lavd;* vetull' herezish pa fre shembën rrafsh* përmes Shpirtit Hyjnor ata;* me mësimdhënie hyjfolëse e forcojn'* dhe mbështesin Kishën e Krishtit.

Më rreze Orthodhoksie që të dy shndritën tok;* shkëlqyen përmes fjalës* porsì yje mendorë;* mbylli lllomotitje që neverit* Zoti Krisht, Athanasi at',* ndërsa Kirili e vuri Nestorin posht'* dhe Savelin kokëbosh, maniak.

Le t'i lëvdojmë me himne të zellshmit e Jisujt,*⁷⁴ pra dyshen e nderuar* të Mësuesve tanë,* flakën fort të zjarrt', Kirilin edhe* të qëndrueshmin Athanas,* se duke qen' tok në qiej, për ne gjithnjë* ndërmjetojnë pranë Perëndis'.

Me lutjet e hierarkëve fort të shenjtë, ti* o Krisht, nga lart vështroje,* vizito⁷⁵ grigjën tënde* që e zgjodhe, por kullotet përmes* lukunisë së ujqve bish'* dhe arrogancën e tyre mposhte tani,* se skandalet s'i pushuan kurr'.

Lavdi *Ting. Tërth. I*

Ejani, o tërësia e kremtimdashësve, ejani mbledhja e besnikëve, ejani koret e orthodhoksëve ta kurorëzojmë me këngë lavdërimesh dyshen e vyer për respekt të Mësuesve tanë;

sepse ata e vithisën me forcë rinore dhe me fuqinë e pangadhënyeshme të Shpirtit çdo errësirë herezie shumë të keqe dhe çdo mashtrim të keqdashësve, e ndriçuan kozmosin me llamburitje hyjnohjeje, dhe tani ndërmjetojnë për ne, që me besë kremtojmë kujtimin e tyre.

Tani *Hyjlindësore*

Ty të lumërojmë, o Hyjlindëse e virgjër dhe të lavdërojmë ne besnikët siç të ka hije ty, qytetin e patundshëm dhe murin që s'çahet dot, mbrojtjen e pathyeshme dhe strehën e shpirttrave tanë.

Dhoksologjia e Madhe.

Në Liturgji, Tipiket dhe nga Kanuni i shën Athanasit Ode III dhe të shën Kirilit Ode VI. Kontaqi Ti që e shenjtërove (shih fq 356). Kungatore: Në kujtim të përjetshëm.

CITIME

¹ I Tim. 3.15

² Eks. 30.25,30

³ Is. 47.14

⁴ Eks. 14.23-28; III Makk. 2.7

⁵ Ps. 44(45).3

⁶ Vep. 20.29

⁷ Fil. 2.15

⁸ I Mbret. [Sam.] 17.34

⁹ Urt. Sol. 11.6

¹⁰ Joan 1.14,18; 3.16,18; I Joan 4.9; Hebr. 1.3

- ¹¹ Lluk. 11.49; I Kor. 1.21,24; Ef. 3.10
¹² Urt. Sol. 3.6
¹³ Urt. Sol. 3.5
¹⁴ Sirak 49.11; Jer. 22.24
¹⁵ Urt. Sol. 8.2
¹⁶ Gjen. 1.27,31; 2.7
¹⁷ Joan 10.11,14
^{17a} Num.14.19 etj.
¹⁸ Lluk. 4.14; Rom. 15.13
¹⁹ Jez. 9.3
²⁰ Is. 6.3
^{20a} Joan 15.1
²¹ Gjen. 2.6
²² Eks. 24.12
²³ Eks. 31.18; Ligji i Dytë 9.10
²⁴ II Tim. 3.16
²⁵ Jez. 44.2-4
²⁶ II Kron. 18.18; Is. 6.1; Jez. 1.13-26;
 10.1; Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 32
²⁷ Lluk. 1.48
²⁸ Ps. 86(87).3
^{28a} Joan 1.1
²⁹ II Kor. 6.1
³⁰ Joan 14.23
³¹ Gjen. 2.17; 3.1-6,24
³² II Kor. 7.1
³³ I Kor. 3.16-17; II Kor. 6.16
³⁴ Ef.6.10; Fil.4.13; I Tim. 1.12; II Tim. 2.1; 4.17
³⁵ II Kor. 10.5
³⁶ I Kor. 9.25
³⁷ Lluk. 1.26-35
³⁸ Matth. 13.23; Mark. 4.14,20; Lluk. 8.11,15
³⁹ Vep. 2.2-3
⁴⁰ IV Makk. 1.3 etj.
⁴¹ I Petr. 2.21
⁴² Vep. 20.28; I Petr. 5.2
⁴³ Matth. 13.25
⁴⁴ Ps. 18(19).11
⁴⁵ Is. 6.6-7
⁴⁶ Gjq. kap. 14-16
⁴⁷ Mal. 4.2 (3.20)
⁴⁸ Urt. Sol. 5.15
⁴⁹ Lluk. 12.49
⁵⁰ Matth. 28.19
⁵¹ Eks. 9.16; Mark. 16.20
⁵² Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 2
⁵³ Eks. 20.21; Sirak 45.5
⁵⁴ Eks. 31.18; 34.28; Ligji i Dytë 4.13;
 5.22; 9.10-11; 10.4
⁵⁵ II Kor. 3.6
⁵⁶ II Petr. 1.21
⁵⁷ Eks. 13.21-22; Num. 14.14; Neh. 9.12
⁵⁸ Is. 9.2; Matth. 4.16; Lluk. 1.79
⁵⁹ Fja. Urt. 13.14
⁶⁰ Joan 7.38
⁶¹ Ps. 138(139).18
⁶² Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 34
⁶³ Joan 1.3
⁶⁴ Fja. Urt. 5.22
⁶⁵ I Mbret. [Sam.] 2.1,10; Ps 74(75).
 10; 88(89).18,25; 111(112).9;
 148.14; Sirak 47.5,11
⁶⁶ Eks. 25.30,37; 35.16; 38.13;40.22;
 Num. 4.9
⁶⁷ Abak. 3.3; Dan. 2.34-35
⁶⁸ Eks. 16.33; Hebr. 9.4
⁶⁹ Eks. 25.9-20,29; 38.1(37.1); 39.15;
 40.21; Ligji i Dytë 10.2; Hebr. 9.4
⁷⁰ Eks. 25.29; 39.18; 40.20; Lev. 24.6
⁷¹ Num. 17.23; Hebr. 9.4
⁷² Eks. 27.3; Lev. 16.2; Num. 17.11 (14.46)
⁷³ Ps. 18(19).6
⁷⁴ III [I] Mbret. 19.10,14; Vep. 22.3
⁷⁵ Ps. 79(80).15



MË 20 TË TË NJËJITIT MUAJ

Kujtimi i atit tonë oshënar Efttimi i Madh.

Tipikon

Nëse bie e diel, të shtunën në Mbrëmësore, Thirrtores: 6 ngjallësore dhe 4 të oshënarit. Lavdi i oshënarit. Tani Hyjlindësore dogmatike e tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimëni. Leximet. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi si dhe Tani të oshënarit. Përlëshoret: ngjallësore, e oshënarit dhe Hyjlindësore e tij.

Të dielën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Kanuni Triadik. Litia e oshënarit. Himne Triadike. Trishenjtë. Përlëshorja e oshënarit. Në Mëngjesore, Ndenjësore ngjallësore. Pas Polieleit, Ndenjësoret (pas Polieleit) e oshënarit. Bekimtores. Ipakoia. Shkallesat dhe Proqimëni i tingullit. Kanunet: ngjallësor dhe i oshënarit. Pas Odes III, Kontakti dhe Shtëpia e oshënarit, dhe Ndenjësorjat e tij. Pas Odes VI, Kontakti dhe Shtëpia ngjallësore, dhe Sinaksari. Zbritësoret Fundin edhe burimin; dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor: Më të nderuarën. Dërgimësoret: ngjallësore, e oshënarit dhe Hyjlindësore e tij. Lavdërimet: 4 ngjallësore dhe 4 të oshënarit. Lavdi Eothinoni. Tani E përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji, Tipiket. Lumërimet: 4 të tingullit dhe 4 nga Ode VI e oshënarit. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore, e oshënarit dhe e kishës. Kontakti Ti që e shenjtërove. Apostulli dhe Ungjilli i së dielës. Kungatore e së dielës.



NË MBRËMËSOREN E VOGËL

Thirrtores

Ting. I Ton uranion tagmaton

Duke fluturuar përqark në apsidë qiellore falë virtytit të perëndishëm, o atë oshënar i tërëlumur, u fute nën errësirën;¹ përmes saj vërtet u pe jo në enigma,² por në Hirin e Zotit, të pranosh shkëlqimet.

(2x)

Pasi ndriçove shpirt dhe mendje në saje të virtyteve, u shpërngule drejt qiellit, në mbretërinë e Krishtit, o Efttim i trilumur, duke i ofruar duajt e mundimeve të tua, se meqë u evidentove ndriçues ndër asketët, shijon shijimin e paplakur.

Me të vërtetë bashkëqenia, Trinia pa fillim, kur të besoi banesë³ Shpirti, të evidentoi ndriçues tepër të llamburitur, o Efttim hyjprurës, se meqë u lartësove mbi të gjitha të poshtmet që joshin për zili, gjete banim në qiej.⁴

Lavdi *Ting. II*

O atë oshënar, meqë që foshnjë e praktikove zellshëm virtytin, u bëre instrument i Shpirtit të Shenjtë; dhe si more prej tij energjinë e çudivë, i binde njerëzit të shpërfillnin të ëmblat; dhe tani i shkëqyer më me pastërti nga drita hyjnore, llamburiti edhe mendjet tona, o atë Efttim.

Tani *Hyjlindësore*

Të madhështojmë, o Perëndilindëse, duke thirrur: Gëzohu, o porta e mbyllur,⁵ përmes së cilës u hap për njerëzit Parajsa e moçme.

*Pasvargje**Ting. II Ikos tu Efrathá*

Me fuqinë e Kryqit pasi i turpërove me triumf dinakëritë e demonëve dredharakë, e shpalle me bujë lavdinë e Krishtit, o atë Efthim.

Varg: E çmuar është para Zotit vdekja e oshënarit të tij.

Ungrite si Ilia me karrocë të përzjarrtë,⁶ dhe u lidhe direkt me Trininë, o Efthim i lumur, mbarëbotëror.

Varg: I lumur ai burrë që ka frikë Zotin.

Duke mbajtur në duart e tua Kryqin e Zotit, o atë Efthim, i zhduke plotësisht fantazmat e demonëve.

Lavdi *dhe* Tani*Hyjlindësore*

Gëzohu, ti që e pranove gëzimin e botës, Krishtin jetëdhënës, që e pushoi trishtimin e stërnënës, o Virgjëreshë.

Përlëshore

Dëfre, o shkretëtirë.



NË MBRËMËSOREN E MADHE

*Pas Qëndrimit të parë të Psaltirit (Lum ai njeri)**Thirrto**Ting. I Panéfimi mártires*

Efthim, atë, engjëll qiellor* u dërgua që të jap'* lajm që më parë për lindjen tënde, siç u bë më par'* kur nga barku shterpë* mbiu shën Joani;⁷ se zelltar i tij u shfaqe dhe stampë, pa para dhe pa shtëpi,* pagëzor dhe malësor, o shenjt,* që shkëlqeve fort me mrekulli pa fund.

Si frut shterpësie mbive ti,* atë shën Efthim, u pe* si prind me shumë fëmijë, se shkretia që më par'* s' shkelej,⁸ pra u mbush plot* përmes farës sate shpirtërore, pra me murgj; përgjëroju Krishtit Zot tani për ne,* të dhurohet paqe dhe mëshir',* përdëllim i madh^{9a} për shpirtrat edhe hir.

E pakapërcyer ish vërtet* jeta jote, shën Efthim,* dhe besa jote krejt orthodhokse, se marshove ti* nga praktika, atë,* për në teorinë më eprore, se u bëre shtëpi urtie, meqë Krishtin Zot,* që është' njëri i Trinis' dhe ka* dy natyra, adhuroje; lyp për ne.

*Thirrto të tjera**Ting. IV O eks ipsistu klithís*

Ishenjtëruar nga barku nënor⁹ ishe;* dhe kur syri që sheh çdo gjë parapa në ty* dëshirën, prirjen për

lartësi,* për më të mirën,* dhe pa se drejt saj vrapoje ti pa kthim,* o i tërëlum, atëherë të lajmëron* si një dhuratë prej Perëndisë* me emër gazi,* kështu shpërbën zyrtësi të prindërve;* ndaj ti që foshnjë* i pëlqyer te mirëbërësi Zot, përparove drejt;* lyp atë t'i shpëtojë,* t'i ndriçojë shpirtrat tanë pra.

Pasqyrë pa njollë drite prej Hyjnisë* ishe dhe të gjeti ty Krishti, o shën Efthim,* të mbushur plot me dhunti të shenjt' * prej Perëndisë,* ndaj të shkëlqeu me vezullim hyjnor,* drit' nga llamburitja e vet,¹⁰ u pe dhe burim* shërimesh pa fund si dhe ushqim* në rast urie,* porsì me shi ti vaditje sa donin* kur kishin etje;* brenda shpirtrave shihje, i rregulloje me fjalë drejt;* lyp Jisun' t'i shpëtojë,* t'i ndriçojë shpirtrat tanë, pra.

Është kanun, karakter i sakt' virtyti* jeta jote e barabartë me engjëjt lart* për sa e zgjodhën përsosmërisht* të adhurojnë* pra Perëndinë, Efthim, që në praktik'* dhe në teori tok ke feksur; ti na mëson* me fjalën tënde plot hyjurti* ta adhurojmë* Triadhën, si dhe që Krishti është një* në dy natyra,* dhe të katër Sinodet që janë pas numrit ungjillor;* Zotin lyp t'i shpëtojë,* t'i ndriçojë shpirtrat tanë ky.

Lavdi

Ting. III I Theodor Sigeotit

Si iu dedikove Perëndisë që nga barku nënor si një tjetër Samuel,¹¹ o atë Efthim, u bëre sipas emrit gëzimi i besëmirëve, shkopi dhe bazamenti i monakëve dhe banesa e pastër e Shpirtit të Shenjtë; kërko për ne që të nderojmë përdëllimin e madh^{8a}.

Tani *Hyjindësore*

Si të mos admirojmë lindjen tënde të hyjbëshme, o e gjithënderuar, se pa njohur burr', o e kulluar, linde bir pa at' trupërisht, atë që lindi prej Atit para jetëve pa nënë, i cili s'pësoj fare ndryshim a trazim, a ndarje, por ruajti të thjeshtë cilësin' e secilës qenieje; prandaj, o Zonjë e nënë Virgjëreshë, atij iu lut të shpëtohen shpirtrat e atyre që të njohin me besë të drejtë për Hyjindëse.*

Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës dhe Leximet.

Këndimi i Urtësisë së Solomonit

(3.1-9)

Shpirtrat e të drejtëve janë në dorë Perëndie dhe nuk do t'i prekë torturë. U dukën në sytë e të pamendëve se vdiqën dhe u konsiderua keqtrajtimit dalja e tyre dhe ecja nga ne dërrmim, por ata janë në paqe; sepse edhe nëse para faqes së njerëzve do të ndëshkohen, shpresa e tyre është plot pavdekësi; dhe pasi do të edu-

kohen me pak *mundime*, do të fitojnë mirëbërje të mëdha, sepse Perëndia i provoi dhe i gjeti të denjë për veten. Si ar në shkritore i provoi ata dhe si holokaust flijimi i pranoi ata; dhe në kohën e shqyrtimit të tyre do të ndriçojnë dhe si shkëndija në kallam do të vrapojnë. Do të gjykojnë kombe dhe do të sundojnë popuj, dhe do të mbretërojnë në ata Zoti ndër shekuj. Ata që kanë besim në të do të kuptojnë të vërtetën dhe besimtarët me dashuri do të qëndrojnë me durim pranë tij, sepse ka hir dhe mëshirë ndër oshënarët e tij dhe mbikëqyrje mbi të zgjedhurit e tij.

Këndimi i Urtësisë së Solomonit

(5.15-23; 6.1-3)

Të drejtët jetojnë përjetë dhe në Zotin është paga e tyre, dhe përkujdesja e tyre pranë të Shumëlartit. Për këtë do ta marrin mbretërinë e hijeshisë dhe kurorën e bukurisë nga dorë Zoti, sepse me të djathtën do t'i mbulojë dhe me krahun do t'i mbrojë. Do të marrë si armatim zellin e tij dhe do të mobilizojë me armë Krijesën për mbrojtje armiqsh. Do të veshë *si* korracë drejtësi, dhe do të veshë *si* helmetë gjykim pa hipokrizi. Do të marrë *si* mburojë të pamposhtur oshënarí dhe do të mprehë zemërim të prerë për shpatë; dhe do të bashkëluftojë me atë bota kundër të marrëve. Do të ecin suksesshëm te qëllimi predha

rrufesh, dhe si nga një hark i plotë rrethi nga retë do të hidhen në she një dhe nga zemërimi që hedh gurë do të hidhen breshëri të plota. Do të indinjohet kundër tyre ujë deti, ndërsa lumenj do të përmbytin papritur. Do t'u kundërvihet atyre erë fuqie dhe si stuhi do t'i ajrojë ata si grurë, dhe do të shkretojë gjithë dheun paligësi dhe keqbërje do të përmbysë frone dinastish. Dëgjoni, pra, o mbretër, dhe bëhuni të mençur, mësoni, o gjykatës të anëve të dheut. Vëreni veshin, ju që sundoni shumicë dhe që jeni mburrur mbi turma kombesh, se ju dha nga Zoti sundimi dhe dinasti nga i Shumëlarti.

Këndimi i Urtësisë së Solomonit

(4.7-15)

I drejti, nëse do të arrijë të vdesë, do të jetë në prehje; se pleqëri e çmuar nuk është pleqëria shumëvjeçare, as u mat me numër vitësh. Dhe thinjat janë mençuri tek njerëzit dhe mosha e pleqërisë është jetë e panjollësuar. Meqë u bë i pëlqyeshëm te Perëndia, u dashurua, dhe ndërsa jetonte në mes mëkatarësh, u transferua. U rrëmbye, që e keqja të mos ndryshojë mençurinë e tij ose dinakëria të mos mashtrojë shpirtin e tij. Sepse joshja e së keqes errëson të mirat dhe ëndja e dëshirimit e ndryshon mendjen e patëkeq. Duke u përsosur në pak kohë, mbushi vite të gjata. Se shpirti i tij ishte i

pëlqyeshëm në Zotin, prandaj vrapoi nga mesi i ligësisë. Por popujt duke parë dhe duke mos kuptuar, as duke mos vënë në mendje një gjë të tillë; sepse ka hir dhe mëshirë ndër të zgjedhurit e tij dhe mbikëqyrje ndër oshënarët e tij.

Në Liti Idhiomele

Ting. II I Gjermanoit

U thoshte prindërve një engjell i Zotit: “Gëzohuni, sepse nga të përbrendshmet tuaja do të lindë fëmijë me emrin e gëzimit”. Dhe mbive në bark duke ua sjellë premtimin, dhe që nga shpërgënjtë u shoqërove me lutjen, o atë Efthim.

I njëjti I Studitit

O atë Efthim, i fortifikuar në mendje me njohuri të hyjshme, tejkalove kalimtarët, sepse nuk admirove asgjë nga tokësoret, duke u dukur në shtrëngime mendjelartë dhe të për trim, ndërsa në ushtrim dhe gëzim, i përlurur dhe i thjeshtë; dhe pasi përshkove urtësisht detin e paqëndrueshëm të jetës së tanishme, arrite në liman të qetë; përgjëroju Krishtit që të përdëllehen shpirtrat tanë.

I njëjti I të njëjtit

Shpërfille gjërat në jetë, o atë Efthim, sepse e dëshirove qytetarinë e sipërme;¹² i veshur me përlulësi, neverite pasuri, urreve shijim dhe

fitove vetëpërmbytje; largove padrejtësi dhe ndoqe drejtësi;¹³ ndaj, o atë oshënar, na kujto dhe ne gjatë lutjeve të tua oshënore drejt Zotit.

Lavdi

Ting. IV I të njëjtit

Shkëlqyen veprat e tua të mira¹⁴ si diell mbi tokë dhe në qiell, o shërbyes i Krishtit, Efthim, sepse na predikove orthodhoksisht besimin e vërtetë dhe të paqortueshëm të Krishtit; prandaj, o atë oshënar hyjprurës, përgjërohu në kujtimin tënd që të na dhurohet përdëllimi i madh.^{8a}

Tani *Hyjlindësore*

Ulu te lutjet e shërbëtorëve të tu, o e panjollshme, duke pushuar kryengritjet e mjerimeve tona, duke na shpëtuar nga çdo hidhërim, se ty vetëm të kemi spirancë të saktë e të sigurt,¹⁵ dhe kemi mbrojtjen tënde; mos u turpërofshim, o Zonjë, duke t’u lutur; shpejto në lutjet e atyre që të thërresin besërisht: Gëzohu, Zonjë, ndihma e të gjithëve, gazi, mbrojtja dhe shpëtim’ i shpirtrave tanë.*

Pasvargje

Ting. Tërth. I Heris askitikón

G’zohu, se ishe për Kishën ton’,* o oshënar Efthim, fillimi i gazit ti,* se me providencë Zoti me lindjen tënde ajo* zmbropsi gjithë sulmet heretike krejt,* ndaj të quan ty Efthim,* që

përkthehet gëzim, hare;* rreshtime engjëjsh,* pra esenca në qiell lart* me gaz mbusheshin,* se shkëlqeje në jetë, at’;* rri tok me ta dhe mbushesh plot ndriçim; shijon vezullim* të tërëpasur, hyjnor, shpëtimtar, ku ka prehje, lumturi;* tani lype Krishtin* të na japë përdëllimin e madh^{8a} për shpirtrat pra.

Varg: E çmuar është para Zotit vdekja e oshënarit të tij.

Thave përrënjt’ e paligjësis’*¹⁶ kur u mbështete mbi purtekën e Kryqit ti,* ujiteshe mendërisht nga përroi plot me shijim*¹⁷ të hyjnueshëm, prej gurre fort të shenjt’* që rrjedh në Parajsë,¹⁸ dhe* në shkreti, o i tërëlum,* shfaqe burime* shpëtimtare,¹⁹ o oshënar;* përmes rrymave* nga Shën Shpirti plehroheshe* dhe si feniks vrapove lart²⁰ drejt qiellit; shtyll’ u pe* me trajtë zjarri, hyjmendës, me vezullim edhe me ndriçim²¹* prej Krishtit; këtë lyp* që të japë përdëllimin e madh^{8a} për shpirtrat pra.

Varg: Lum ai burrë që ka frikë Zotin. **S**hkove vërtet në tendën e shenjt’,* të mrekullueshme të Zotit, o fort i lum,* me gaz dhe dëfrim, dhe deri në strehën e Perëndis’* ku ka zë dhe tingull nga kremtuesit,*²² o atë, që të dëgjosh* përhimnim të pëlqyeshëm,* të ëmbël edhe* të kungosh ngazëllim, Efthim,* që

nuk shprehet dot;* të kënaqesh sa s’thuhet dot,* vetëm të tilla gjëra deshe, ndaj vrave mishin²³ tënd,* me drejtësi të hyjnueshme i stolisur fitove k’to;* i lyp Krishtit tonë* që të japë përdëllimin e madh^{8a} për shpirtrat pra.

Lavdi *Ting. Tërth. I*

O atë oshënar, nuk iu dhe gjumë syve të tu, as dremitje qepallave të tua,²⁴ derisa shpirtin dhe trupin i çlirave nga pasionet dhe e përgatite veten tënde për banesë të Shpirtit, sepse pasi erdhi Krishti së bashku me Atin, bënë strehë³ te ti; dhe meqenëse u bërë shërbyes i Trinisë së njëqenshme, o Efthim, predikues i madh, ndërmjeto për shpirtrat tanë.

Tani *Hyjlindësore*

Ty të lumërojmë, o Hyjlindëse e virgjër dhe të lavdërojmë ne besnikët siç të ka hije ty, qytetin e pa-tundshëm dhe murin që s’çahet dot, mbrojtjen e pathyeshme dhe strehën e shpirtrave tanë.

Përlëshore Ting. IV

Dëfre, o shkretëtirë që nuk lind, ngazëllohu ti që nuk ke dhimbje të lindjes, sepse të shumëfishoi bij²⁵ burri i dëshirave²⁶ të Shpirtit, pasi i mbolli me shpresëtarë dhe i rriti me vetëpërmbytje për përsosmëri virtytësh. Me përgjërimet e tij, o Krisht

Perëndi, paqësoje jetën tonë.



NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së parë, Ndenjëso

Ting. IV Epefanis símeron

Drit' e paafrueshme*²⁷ të llamburiste,* ndaj si yll shkëlqeve ti* në shkretëtira, o Efthim;* me mësimdhënie i shndritje fort* ata që vinin te ti me shpirt, pa dyshim.

Lavdi *Ingjashëm*

Nga Egjipti fekse ti,* yll i mëngjesit;* llamburite kozmosin* virtutshmërisht me dritë plot;* dhe u shkëlqeve të gjithëve,* Efthim me lavd, dritën e asketizmit drejt.

Tani *Hyjlindësore*

Edëllir', e Virgjër krejt* përikim te ti* dhe nën strehën tënde ne,* pranoje lutjen tonë pra* dhe mos pusho që të ndërmjetosh* te Njeridashësi, që të shpëtohem.

Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjëso

Ting. Tërth. I Ton sinánarhon Logon

I mohove kujdesjet e jetës, more pra* përsipër jetën e engjëjve, shpirtin tënd shndrite ti* me përmbajtje, ndaj e prite hirin me bollëk;* Zoti e dha për mrekulli,* o Efthim hyjprurës dhe çudibërës; përgjërohu* për ne që besërisht të mburrim dhe e nde-

rojmë panairin tënd.

Lavdi *Injëjti*

Tani *Hyjlindësore*

Përdëllena, e Virgjër e tërëshenjtë ne* që po përikim te ti me besim, se ke dhembshuri,* dhe tani kërkojmë ndihmën tënde fort të ngroht',* se mundesh të shpëtosh vërtet* çdo njeri si nëna e të Fortlartit, Perëndisë,* e hyjhirshme, duke ndërhyrë me ndërmjetime nëne përgjithnjë.

Pas Polieleit, Ndenjëso

Ting. Tërth. IV Tin sofian qe Logon

Varfërin' e atij që për ne vërtet* lindi²⁸ prej Virgjëreshës, e more ti* mbi supe, gjykove pra* të përkohshmet si kashtë, pleh,* i lumur, si shijove nga pema e dijes fryt,*²⁹ o oshënar, u shfaqe mësues siç Zoti do,* për monakët, ndaj nxisje të gjithë për zellin* e sjelljes së engjëjve* dhe të njohjes së besës son',* çudibërës,* Efthim me nam;* ndërmjeto te Zoti yt Krisht,* të na dhurojë ky ndjesën* e fajeve* ne që bëjmë kujtimin tënd fort të shenjt' me mall.

Lavdi *Injëjti*

Tani *Hyjlindësore*

Ty të shpallim të lum çdo brez njerëzor*³⁰ si të vetmen që linde ti

Perëndi* në mish pafarisht, edhe* si të virgjër, sepse në ty* Hyjnia e përzjarrtë fushoi, dhe mënd si foshnj* Ndërtuesin dhe Zotin; gjinia e engjëjve* gjithë njerëzia tok lëvdojm' lindjen tënde* të tër'shenjtë denjësisht* dhe me një zë thërrasim pra* duke lypur* për ndërmjetim:* Lutju Zotit Krisht Perëndi* të na dhurojë ky ndjesë* të fajeve,* se i falemi lindjes sate pa cen me bes'.

*Shkallesat. Antifoni i parë i Ting. IV
Proqimëni Ting. IV*

E çmuar është para Zotit vdekja e oshënarit të tij.

Varg: Me çfarë do ta shpërblejmë Zotin për të gjitha që na shpërbleu?

Ungjilli. Psalmi 50.

Lavdi. Me ndërmjetimet e oshënarit. Tani. Me ndërmjetimet e Hyjlindëses. Përdëllemë, o Perëndi. *Dhe Idhiomeli.*

Ting. Tërth. II

O atë oshënar, në gjithë tokën doli zëri³¹ i arritjeve të tua, prandaj në qiejt gjete shpërblim^{31a} për lodhjet e tua; asgjësive batalionet e demonëve, arrite rreshtimet e engjëjve, jetën e të cilëve e kishe zili në mënyrë të paqortueshme; duke pasur guxim ndaj Zotit, kërko paqe për shpirtrat tanë.

Kanunet: i Hyjlindëses me Irmoset në 6 (shih fq. 197) dhe të dy të oshënarit në 8.

Ode I

*Kanuni i parë i oshënarit, që ka Akrostihidhë (bashkë me Irmoset):
“U shfaqe pasuri të dhëlindurish, o Efthim”. Poezi e Joan Damaskinoit.*

Ting. IV

Uk esti si ómios

E zgjidh zymtësinë e atyre që çuditërisht* të kan' mbirë me premtim* zotëror si një dhurat'* para lindjes, me emër gaz.

Shpërhalënderime Kisha me zë, se, o oshënar,* të pranoi si filiz* që më parë, lajmëtar* gazi, paqeje, prej Zotit.

Kanuni tjetër, që ka Akrostihidhë: “Me lutjet e tua, o i tërëlumur, shpërndafsh tek unë dritë”. Poezi e Theofanit.

Ting. Tërth. IV

Armatilatin Faraó

I gjithëlumur, duke lypur Zotin përmes përgjërimeve,* lutjeve³² të tua,* tej shpërndaje renë, errësirën e trishtimit tim,* se i mbushur me gaz je dhe gjallëri, dhe qëndron tani* pranë Tërëmbretit^{32a} mes qiejve.

Në gjithë Kishat na u shfaqe, oshënar, një Samuel tjetër ti,* Zoti të ka dhënë*¹¹ me njoftim përpara zënies sate; sipas emrit tënd* të përshtatshëm, o atë, me hijeshi drite dhe hare,* gaz edhe dëfrim për të tërë je.

Duke ndërhyr' me përgjërime, lutje,³³ prindërit e tu, o Efthim,* para Perëndisë* ty të marrin si dhurim të hyjshme, si lastar me drit'* që me lindjen njofton shndritjen e besimit krejt orthodhoks* si edhe qortimin e herezis'.

Ti që fëmijë, oshënar, u dedikove tek ai që të dha,*¹¹ pra te Perëndia;* shihje drejt atij, prej porosive jetëbërëse* udhëhiqeshe dhe besërisht u ngrite në lartësi,* ku virtytet janë me rrezatim.

Hyjlindësore

Duke të pasur, o Hyjnënë, mbrojtje s'do ta kemi frikë hordhi* nga armiqtë tanë* që luftojnë kundër nesh, se lavdërojmë me besim* Birin tënd, Perëndinë e cdokujt, Zotin që linde ti,* lyp atë për ne të shpëtohem.

Zbritësore: Herson avisotokon

Fundin edhe burimin (*shih fq. 354*)

*Ode III
Uk en sofia*

Oshënarinë* e shën Anës e kishte zili nëna* që të lindi, dhe të sjell'* blatim të gjallë te Zoti, siç ish* Samueli;¹¹ ky para lindjes të dha lavdi.

Duke u djegur* me mori dashurie për Zotin tënd,* me mendim fort shpresëtar,* i zotërove pasionet,³⁴ prandaj* hir i hyjshëm, o oshënar

shenjt, u preh në ty.

Tjetri: O stereosas kat' arhás

Nga shterpësia linde ti,* por bujk me fruta të shumta* plot sukses u pe; i preve ti gjembat* e besimit të pafe, o oshënar, dhe mbolle thell'* farë të perëndishme* shpresëtarie të mirë, shenjt.

Pasi u bëre meshëtar* vegimesh përbimendore* dhe mistike, o hyjprurës, ia solle* Krishtit të pabesët që besuan siç do vetë ky,* me mësimdhënien tënde,* at', më të mirat mësuan pra.

Duke përdorur mençuri,* mendim besnik,³⁵ o Efthim shenjt,* preferove ti më tepër nga gjërat* që shpejt rrjedhin edhe prishen, jetën dhe shijimin, at',* lart në amshim, kur vrave* mishin me vetëpërmbytje fort.²³

Me shpirt të ndezur dhe me plag',* nga mallëngjimi³⁶ për Krishtin* ti i shmange kurthet tejet të zjarra* të demonëve, o atë, dhe shkëlqeve me ndriçim* hir vesëprurës, dhe ndaj* shenjt çudipurës u bëre pra.

Hyjlindësore

Ti thëniet edhe profecit'* që than' profetët e hyjshëm* i vulose kur e linde Jisunë,* Fjalën që me ta po fliste dhe përbushi çdo fjalim*

hyjnor, o e bekuar,* e përhimnuar e vetmja je.

Zbritësore: To steréoma ton epí si

Zoti Krisht

Ndenjëso

Ting. Tërth. IV Tin sofian qe Logon

Me vaj vetëpërmbajtjeje mendërisht* ti fanarin e shpirtit e mbushe plot,* sepse dëshirove fort,* o hyjprurës shenjt oshënar* Eftim at', ardhjen gjithnjë të ndritshme të dhëndrit tënd;* dhe kreshmë mbajte, lutje pa gjumë, kështu dëfren* brenda nusërores;³⁷ e fitove shijimin* plot jetë gjithnjë vërtet,* denjësisht tok me energji* mrekullish pra* dhe hir nga lart;* ndërmjeto te Zoti yt Krisht,* të na dhurojë ky ndjesën* e fajeve* ne që bëjmë kujtimin tënd fort të shenjt' me mall.

Lavdi *Injëjti*

Tani *Hyjlindësore*

Shpirtin tim të përlur, e Virgjër krejt,* që tani turbullim ngasjesh jete ka,* dhe mbytet pa kapiten* në furtunë, dhe duket qart'* se është mbingarkuar me peshë mëkatesh ky,* dhe rrezikon të bjerë në fundin e Hadhit³⁸ posht',* shpejt arri, Hyjlindëse, dhe me ndërmjetimin* e ngroht' që bën, më shpëto* në të paqmin limanin tënd,* që me besë*

të të thërras:* Ndërmjeto tek Biri yt, Zot,* që të më japë faljen* e fajeve;* shërbëtor i padenjë jam, shpresë ty të kam.

Ode IV

Eklinas Hristé

Pasi e ruajte që nga shpërgenjtë mendjen që të mos ishte endacake, jetën e tregove si ngjitje drejt Perëndisë; me të u lidhe duke ecur nga fuqia te fuqia,³⁹ o atë.

U dashurove me përlulësinë e Krishtit, ndaj pasi u bërë shtegtar nga këtu drejt qytetit perëndipritës, bashkëkryqëzohesh vullnetarisht me atë që duroi kryq⁴⁰ për ty.

Kur zgjodhe të ushtrohesh ligjërisht,⁴¹ u zhveshe nga jeta, dhe pasi u ndeshe i zhveshur me kundërshtarin, përmes imitimit të Krishtit e ngrite në shkretëtirë trofenë.⁴²

Tjetri: Si mu iskís Kírie

Veten tënde të tërë ia kushtove Perëndisë, o atë, duke dëshiruar lavdi të pavdekshme, dhe drejt tij vrapove ngrohtësisht me sjellje të paqortueshme, me asketizëm dhe jetë tejet të shkëlqyer, dhe thërrisje pa u epur: Lavdi fuqisë sate, o Njeridashës.

Meqenëse, o oshënar, e deshe me gjithë fuqinë⁴³ burimin e mirësisë,

u bëre për asketët burim karizmesh të hyjnueshme, dhe i shëroje kur kishin etje, se sikurse qëmoti Moisiu në shkretëtirë, gurrove burime paradoksalisht,⁴⁴ o i tërëlumur.

Kur u shfaqe nga të fshehtat e Shpirtit, i çlirove fëmijët e skllaves⁴⁵ kur i rigatove me mënyrë të vyer si bij të Perëndisë me anën e pagëzimit të birësimit; duke qenë se e imitove jetën e Pararendësit të hyjshëm, u evidentove si pagëzor, o Efthim.

O Efthim, prej Perëndisë u bëre i njohur si i shkëlqyer nga Hiri tek ata që nuk njihnin,⁴⁶ sepse nuk duhej vërtet virtyti yt t'u shpëtonte dhe të fshihej në shkretëtirë; për këtë, Zoti i të gjithave të evidentoi te të gjithë si rrezatues dritëprurës.⁴⁷

Hyjlindësore

Gëzohu, o e thjeshtë; gëzohu, o Virgjëreshë e tërëpapakëluar; gëzohu, o mal hijeplotë⁴⁸ përmes hiri; gëzohu, o tendë;⁴⁹ gëzohu, o arkë;⁵⁰ gëzohu, o kandil⁵¹ që mban dritën hyjnore, sepse u bëre për ata që besojnë shkak gazi të pashprehshëm dhe hareje shpirtrash.

Zbritësore: Ekálipsen uranús

Mbulove me virtyte

Ode V

Asevís uk ópsonte

Ia nënshtrove veten ligjit të Perëndisë, sepse trupin tënd e keqtrajtove⁵² si vegël shpirti, o hyjprurës, duke ia nënshtuar shpirtit mentalitetin e mishit.⁵³

Përshkove i ngazëlluar udhën e jetës, dhe si ngjize frikë Perëndie, u linde shpëtim⁵⁴ të humburve, pasi shkëlqeve si diell mbuluar në shkretëtirë.

Tjetri: Ina ti me aposo

Paraprive asketë shpresëtarie në udhën qiellore, o atë Efthim, dhe i sillje drejt trashëgimisë⁵⁵ së pashkattërrueshme në të lartat, duke u treguar me shkëlqimin e Shpirtit shtyllë zjarri dhe reje.²¹

O atë, Krishti të dhuroi te bota si mjek tepër të dhembshur të sëmurësh, ushqyes paradoksal të uriturish, edukues të pamendësh,⁵⁶ urtësues mosmirënjohësish dhe përkrahës jetimësh dhe të varfrish.⁵⁷

U bëre i dhembshur, përdëllimtar, me predispozicion të përulur, duke prerë me mësimdhënie të perëndishme shkaqet e pasioneve, duke urtësuar dhe edukuar dishepujt e tu, dhe duke shëruar sëmundje shpirtrash, o atë.

Duke dërguar gjithkund rrezet e çudive të tua, i ndriçove të gjithë, dhe

si magnet tërhoqe drejt shkollave të tua, duke gatuar morale dhe duke lëvizur me pastërti shpirti brenda prirjeve të shpirtave.

Hyllindësore

Perëndilindëse të vërtetë të shpallim të gjithë, o hyjhirplote, ne që falë lindjes sate u çliruam nga lindja e prishshme dhe u rithirrëm përsëri drejt jetës më të mirë nga dhembshuria e Perëndisë tonë.

Zbritësore: Os idhen Isaia simbolikós

Të pa shën Isaia

Ode VI

Ilthon is ta vathi tis thalasis

Si qëmoti bijt' e skllaves⁴⁵ i adoptove përmes larjes* së rilindjes tashmë, o hyjprurës,* thërrmoje krejt* zgjedhën e robtimit ton'* përmes lutjeve të tua ti.

Të vendosi administrator, edukues fort të urtë* për të marrët⁵⁶ dhe debues shpirttrash* dredhie krejt,* kur fushoi qart' në ty,* o hyjprurës, Hir i Perëndis'.

Tjetri: Ilásthítí mi Sotír

Pranove prej Perëndis'* pushtetin e madh, e dinamik, dëbove turma, hordhi* demonësh të zinj terr, dhe të gjithëve sa me bes'* vinin, u shëroje*⁵⁸ shtrembërinë që vjen nga këta.

I lumur, me të vërtetë* u bëre, pasi fitove zinë ngazëlluese ti,* mospasjen që pasuron, Efthim, atë oshënar,* mbretëri në qiell*⁵⁹ përmes tyre trashëgove, shenjt.

Lavdinë, nderin mbi dhé,* që vëshket me lehtësi i zbrapse dhe shpërblim more pra,* i tërëlum, jetë të amshuar dhe trashëgim* pa cen; ndaj banove* sigurisht në tenda lart në q'ell.

Hyllindësore

Ti quhesh Zonja e fort'* të gjithë Krijesës, se përnjëmend linde ti Perëndi* vërtet, parrëfyeshëm; të gjitha i bëri ky* dhe i mban,⁶⁰ i ruan,* o e tërëpaqortueshme.

Zbritësore: Evóisé si

Kur Simeoni

Kontaqi

Ting. Tërth. IV Os aparhás tis fiseos

Krijesa gjeti gaz në lindjen tënde të nderuar fort* dhe në kujtimin tënd të hyjshëm ka hare* me mrekullit' e shumta pra,* oshënar, që bën; nga këto te shpirtat jep me pasuri, dhe njollat e mëkateve pastro, që të psalim tok: Aliluia.

Shtëpia

Kam frikë si do ta ofroj unë i mjeri himnimit nga zemra e plogësht dhe do ta lavdëroj Efthimin e madh? Por

duke pasur guxim te lutjet e tij do të përpiqem ta pleks këngën me ngazëllim dhe zell të shumtë, dhe do t'ju rrëfej të gjithëve sjelljen e tij dhe lindjen, dhe si prindërit e tij psalnin tok: Aliluia.

Sinaksari

Më 20 të të njëjtit muaj, kujtimi i atit tonë oshënar Efthimi i Madh.

Vargje: Ç'të përbashkët ka mes teje dhe jetës, o Efthim?/ Ngjitu drejt engjëjve, të cilët janë të huaj për jetën.

Në të njëzetën mbaroi nga jeta Efthimi prej brezi të mirë.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirëve të shenjtë Vasi, Efsevi, Eftihi dhe Vasilidhi.

Vargje: Duar xhelatësh presin duart e Vasit,/ duar të përdhosura, duar të shenjtëruara.

Ndonëse ia prenë me sëpatë Efsevit çdo gjymtyrë,/ ai mbetet i paplagosur në besimin orthodhoks.

E ndanë në tri pjesë Eftihin,/ që nderronte hyjnisht tre persona Perëndie. Duke mos dashur të përçahet nga grupi i atletëve,/ Vasilidhi u çua në bark.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirëve të shenjtë Inait, Pinait dhe Rimait.

Vargje: Le t'i pranojë ngrohtësia atletët e ftohjes,/ Inain, Pinain dhe Rimain të kristaltë.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i të lumurit Petro Doganieri.

Vargje: Më parë të ftoi për virtyt Krishti nga dogana,/ o Petro, ndërsa tani për shijim qielli.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirit të ri Zaharia nga Arta, i cili u martirizua në Patra në 1782.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atit tonë ndër shenjtorët Efthimi, kryepiskop i Bullgarisë.

Me ndërmjetimet e tyre të shenjta, o Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII

Nei tris en Vaviloni

Upe, o atë, brenda resë,¹ duke u mbuluar me zjarrin e përmbinatyrshëm dhe thërrisje si mist i perëndishëm: I bekuar je, o Zot, Perëndi i etërve tanë.⁶¹

Me mbushulli, o atë oshënar, ty të jep Bërësi i Natyrës gjëra përmbinatyrore, duke parashfaqur predispozicionet e shpirtave të atyre që u kunguan me mishin e Zotit⁶² tënd.

Duke adhuruar, o Efthim, një të vetëmlindur,⁶³ edhe pas mishërimit hyjnor, në dy natyra, thërrisje: I bekuar je, o Zot, Perëndi i etërve tanë.⁶¹

Tjetri: Theú singatávasin

O atë Efthim, e tregove jetën tënde stadium asketizmi dhe palestër shenjtërimi, duke u bashkuar më të patrurp përmes vetëpërmbytjes së skajshme dhe duke thirrur: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.⁶¹

Krishti të tregoi si shpatë me dy presa të mprehta,⁶⁴ që therje zemrat e armiqve dhe kolonat e demonëve, dhe që dëfrente thellë shpirtrat e atyre që psalnin: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.⁶¹

Imbushur me dritën tridiellore, o atë Efthim, u pe dritë e dytë, i formuar përmes kungatës me dritën e parë, dhe ua rrezatoje vezullimet atyre që psalnin: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.⁶¹

Hyllindësore

Linde si agim, duke pasur Diellin e drejtësisë,⁶⁵ që ripastron me rreze hyjnëjohjeje botën nga errësira e injorancës; atij i psalim: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.⁶¹

Zbritësore: Se ton en piri dhrosísanta

Hodhe vesën

*Ode VIII**Evajís Pedhas en ti kamino*

Pasi ia përkushtove Perëndisë veten e tërë dhe pasi e ndeze kaminën e ndërgjegjes, o Efthim, të gjithë jetën

me gëzim e ofrove si holokaust të paqortueshëm,⁶⁶ duke i kënduar Krishtit: Zotin e himnoni ju vepra dhe e përmbilartësoni në gjithë jetët.⁶⁷

Kur u adoptove prej hiri hyjnor, e more si short njohjen e të ardhshmeve, sepse meqë sundove mbi natyrë, kapërceve natyrë, duke rendur me paranjohje drejt përfundimit, dhe thërrisje: Zotin e himnoni ju vepra dhe e përmbilartësoni në jetë.⁶⁷

Tjetri: Eptaplasios káminon

Duke praktikuar vetëpërmbytje tepër intensive, o i tërëpasur, mbërrite në sjellje tejet të lartë, dhe u bërë enë që nxinte Shpirtin jetëbërës dhe karizmat që burojnë pasurisht prej andej, duke psalur pa u epur: O popull, përmbilartësoni në gjithë jetët.⁶⁷

Duke shtegtuar mbërrite në akropolin e Sionit; përfundove në banesat e përjetshme dhe pasi gjete trashëgimi qiellore në saje të lodhjeve të tua, psal tok me koret engjëjlore: O Djem bekoni, priftërinj përhimnoni, popull e përmbilartësoni Krishtin në jetët.

Porsi qiell me plot dritë i llamburite shkretëtirat, pasi i flake tej demonët me pamje të errët, dhe u bërë shtyllë plot shkëlqim deri në qiej,²¹ duke shkëlqyer vezullime mrekullibërëse dhe thërrisje pa pushim: O priftërinj

përhimnoni, popull e përmbilartësoni Krishtin në jetë.

Duke u stolisur gjatë gjithë jetës me punë fort të hyjnueshme, arrite virtytin më parësor duke u dalluar për saktësi dogmash, dhe u bërë mësues thelogjie të përpiktë dhe thërrisje pa ndërprerje: O priftërinj bekon, popull e përmbilartësoni Krishtin në jetë.

Hyjlindësore

O Zonjë, nuse e tërëpaqortueshme e Perëndisë, rrëmbeji nga robëria e pasioneve ata që përikin tek ti; dhe ua jep lirinë vetësunduese Kishave të orthodhoksëve që psalin me besë: O priftërinj bekon, popull e përmbilartësoni Krishtin në jetë.

Zbritësore: Astekto piri enothenes

Në flak' e në zjarr

Ode IX

Metá tokon se Agni

Meqë të kemi fatmirësisht burim shërimesh, si para vdekjes dhe pas saj në arkën e lipsanit, o oshënar, të lumërojmë si atlet fitues.

Mbretin në më të lartat bëje përkrahës të tokësorit kundër barbarëve dhe të kopesë sate kundër ngasjeve të shumëllojshme, o atë oshënar.

Tjetri: Eksesti epí tuto

Largimin për te Krishti, që doje fort,* Efthim atë, ta bëri të njohur si në lashtësi* kishte ndodhur me hyshikuesin*⁶⁸ shën Moisi;⁶⁹ virtyti yt* imitues të tij të kishte bër',* ndaj çave det pasionesh,* kalove pa pengesë* drejt tokës së premtuar⁷⁰ fitimtar.⁷¹

Drejt qiellit ku është' shkruar⁷² qartësisht* sjellja⁷³ jote, atdheu, mbi çdo virtyt si mbi karroc',* si zelltar Ilia⁶ shtegtove ti,* shenjt oshënar, dhe je tani* pranë Perëndisë; kujtona ne* që bëjmë panairin,* kujtimin tënd të hyjshëm* dhe dritëprurës besërisht me nder.

Qe jeta jote krejt e ndriçuar nur* engjëlllore, i lumur, hyjmendës dhe hyjfolës shenjt,* ndërsa shpirti yt ka shkëlqyer fort* dhe besa jote ish e mir',* se mësues dogmash u bërë ti* dhe shpallës, predikues* Orthodhoksie saktë,* hyjpamës atë oshënar Efthim.

Të vë dhe të tregoj si ndërmjetës ty* para Zotit, ndaj lyp dhe kërko për ne ndjes' fajesh ti,* edhe falje borxhesh, dhe shlyerje,* pra imitoje mirësi,* dhembshuri hyjnore, se shpresë kam* te ndërmjetimi yt, at',* kam zell edhe mbështetem* në të, Efthim hyjmendës oshënar.

Hyjlindësore

M'u bë ti pìrg shpëtìmi, o e dëlir',* që kolona demonësh zmbrops larg prej nesh edhe bllokun* mjaft rreziqe, ngasje edhe dëbon* tej sulme vesesh, na dhuron* begati karizmach të hyjshme krejt,* na jep liri të pastër,* e Tërëshenj të Zonjë,* o përlufteshë, mbrojtëse e nxehtë'.

Zbritësore: En nomo skiá qe grámati

O Hyjlindëse
dhe

Në Ligjën dhe Shkronjën

Dërgimësore

Jineqes akutísthite

Nga barku Perëndia Zot* të shenjtëroi, oshënar,* si Jeremian qëmoti*⁹ dhe Samuelin,¹¹ Eftim shenjt,* kur të tregoi ty profet,* at' hyjprurës edhe hjynor,* mrekullibërës; në një tend'* me engjëjt je, me ta lutu* për sa me bes' të himnojnë.

Tjetër E ngjashme

Si Pagëzori qe filiz* qëmoti nga një mitër shterp',* dhe për ty engjëll i hyjshëm,* për lindjen⁷ tënde dha lajmin;* u bëre shtamba e atij,* o Eftim malësor, pa streh',* pa pasje, pagëzor,⁷⁴ dhe shndrit* te ne të gjithë karizma;* ti shembull je për virtytin.

Hyjlindësore E ngjashme

Në një substanc' lind pa shpjegim*

Zot, o e paqortueshme,* me dy vullnete, natyra* Jisunë e varfëruar*²⁸ deri në kryq vullnetarisht,* o e Virgjër hyjnënë;* ai dhuroi pasurin'* që ka Hyjnia, na dha ne,* pra hyjnizim përmes Hirit.

Lavdërime

Ting. Tërth. IV O tu paradhoksu thávmatos

Atë oshënar Eftim, le tokësoret dhe ndoqe pas* Krishtin, se s'preferove kurr'* gjëra që po prishen⁷⁵ shpejt,* por ato që qëndrojnë* gjithnjë;* si në qytet ke banuar në shkreti,* ku shkatërrove mori demonësh krejt;* oh, kush ka zotësi* ta rrëfejë zjarrin që kish shpirti yt,* që për Zotin kishe përnjëmend, o famëmadh.

(2x)

Atë oshënar Eftim, u shfaqe ti kanun, krenari* murgjish dhe ëmbëlsi për ne* orthodhoksët, si ndriçim* i shkëlqyer për kozmosin,*⁴⁷ se kur banoje në shpell', s'të trembte dot* tmerr, frikësim nga armiku tinëzar;* oh, pra ç'dhunti që ke?!*⁷⁶ O i lum, me të e shkele qartësisht* vetullën e djallit krejt si fitimtar i madh.

Që të lartësohej shpirti yt drejt Perëndis', i dhe krah',* shën Eftim atë oshënar,* i pastrove me ushtrim* shqisat dhe përmes lutjeve* të pandërprera, u denjësove ti,* i të rëpasur për jetën që nuk vdes,* o i

kënduar fort,* zbulurim asketësh; Krishti me hare* të pranoi në banesë të palëndët⁷⁷ ty.

Lavdi

Ting. Tërth. IV I Sigeotit

Turmat e murgjive të nderojnë ty, profesorin, o Efthim, ati ynë, sepse nëpërmjet teje ne mësuam të ecim në udhë vërtet të drejtë,⁷⁸ i lum je, se i shërbeve Krishtit⁷⁹ dhe triumfove mbi fuqinë e armikut,⁸⁰ o shok engjëjsh, që banon në të njëjtën tendë me oshënarë dhe të drejtë; tok me ta ndërmjeto te Zoti që të mëshirohen shpirtat tanë.

Tani *Hylindësore*

O Zonjë, prit lutjet e shërbëtorëve të tu edhe çlirona ne nga çdo nevojë dhe pikëllim.

Dhoksologjia e Madhe.

Në Liturgji, Tipiket, dhe nga Kanuni i parë i oshënarit, Ode III dhe i dytit Ode VI. Kontaqi Ti që e shenjtërove (shih fq. 356). Kungatore: Në kujtim të përjetshëm.

CITIME

¹ Eks. 20.21

² Num. 12.8

³ Joan 14.23

⁴ II Kor. 5.1-2

⁵ Jez. 44.1-4

⁶ IV [II] Mbret. 2.9-12

⁷ Lluk. 1.11-19

⁸ Ps. 62(63).2

^{8a} Num. 14.19 etj.

⁹ Jer. 1.5; Gal. 1.15

¹⁰ Urt. Sol. 7.26

¹¹ I Mbret. [Sam.] 1.11

¹² Kol 3.1-2

¹³ Fja. Urt. 15.9; I Tim. 6.11; II Tim. 2.22

¹⁴ Matth. 5.16

¹⁵ Hebr. 6.19

¹⁶ Ps. 17(18).5

¹⁷ Ps. 35(36).9

¹⁸ Gjen. 2.6

¹⁹ Is. 12.3

²⁰ Sirak 24.14

²¹ Eks. 13.21; 14.24

²² Ps. 41(42).5

²³ Gal. 5.24; Kol. 3.5

²⁴ Ps. 131(132).4

²⁵ Is. 54.1; Gal. 4.27

²⁶ Dan. 9.23

²⁷ I Tim. 6.16

²⁸ II Kor. 8.9

²⁹ Gjen. 2.17

³⁰ Lluk. 1.48

³¹ Ps. 18(19).5

^{31a} Matth. 5.12; Lluk. 6.23,35

³² Vep. 1.14

^{32a} III [I] Mbret. 18.15

³³ Hebr. 5.7

³⁴ IV Makk. 1.3,5 etj.

³⁵ IV Makk. 16.1,4; 18.2

³⁶ Kënga 2.5; 5.8

³⁷ Matth. 25.1-10

³⁸ Fja. Urt. 16.25

³⁹ Ps. 83(84).6-8

⁴⁰ Gal. 2.20

- ⁴¹ II Tim. 2.5
⁴² Matth. 4.1-11; Mark. 1.12-13; Lluk. 4.1-12
⁴³ Ligji i Dytë 6.5; Matth. 22.37
⁴⁴ Eks. 17.6; Num. 20.11; Ligji i Dytë 8.15
⁴⁵ Gjen. 16.1-15; 25.12; Gal. 4.23-25
⁴⁶ Is. 65.1; Rom. 10.20
⁴⁷ Fil. 2.15
⁴⁸ Abak. 3.3
⁴⁹ Eks. 25.8 etj.; Num. 2.2; Ps. 45(46).5; 131(132).5; Hebr. 9.2
⁵⁰ Eks. 25.9-20; 38(37).1; Ligji i Dytë 10.2; Ps. 132(132).8; Hebr. 9.2
⁵¹ Eks. 25.30; 35.16; 38.13; 40.22; Num. 4.9; 8.2
⁵² I Kor. 9.27
⁵³ Rom. 8.6,7,27
⁵⁴ Is. 26.17-18
⁵⁵ Ps. 77(78).50,5
⁵⁶ Rom. 2.20
⁵⁷ Ps. 9.35
⁵⁸ Matth. 10.1; Mark. 6.7; Lluk. 9.1; 10.19-20
⁵⁹ Matth. 3.2 etj.
- ⁶⁰ Est. 4.17b; Ps. 94(95).4; Jov 9.19
⁶¹ Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 2
⁶² Joan 6.51
⁶³ Joan 1.14,18; 3.16,18; I Joan 4.9
⁶⁴ Fja. Urt. 5.4
⁶⁵ Mal. 4.2
⁶⁶ Lev. 3.1 etj.
⁶⁷ Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 34
⁶⁸ Eks. 33.23
⁶⁹ Ligji i Dytë 32.48-50
⁷⁰ Hebr. 11.9
⁷¹ Eks. 14.21-30 etj.
⁷² Lluk. 10.20
⁷³ Fil. 3.20
⁷⁴ Matth. 3.1,4; Mark. 1.4,6
⁷⁵ Matth. 9.9; Mark. 2.14; Lluk. 5.27-28
⁷⁶ I Tim. 4.14
⁷⁷ Joan 14.2-3
⁷⁸ Is. 40.3; Matth. 3.3; Mark. 1.3; Lluk. 3.4
⁷⁹ Rom. 6.18-19; 14.18
⁸⁰ Kol. 2.15



MË 21 TË TË NJËJTIT MUAJ

Kujtimi i atit tonë oshënar Maksim Omologjeti dhe i martirit të shenjtë Neofit.

NË MBRËMËSORE

*Thirrtoje të oshënarit**Ting. IV Os jeneon en mártisin*

O Maksim oshënar, atë* që ish bërë njeri për ne* nga mëshira, keqardhja e ke shpallur ti,* se e kuptojmë që dy veprimtari dhe vullnete ka;* mbylle gojët pa frenim* të të ndyrëve, thoshin se* një veprimtari* e vullnet kishte Krishti; i ndikoi djalli që krijoi gjithë të keqen¹ si dhe çdo shkatërim.

Atë, ti përmes kordave,* përmes dogmave që na the,* mbyte Pirron mendjekeq, llafazan, Maksim,* edhe durove përndjekje dhe shtrëngime, kur egërsisht* kamxhikoheshe, ndërsa* dorën tënde të hyjshme fort,* që drejt Perëndis'* gjithnjë ngrihej² dhe shkruante drejt dogmën superiore, tok me gjuhën e prenë, o i kënduar shenjt.

Si kallam shkruesi të shpejt',* që ish mprehur prej Shpirtit Shenjt,* atë, gjuha jote³ e shenjtë na u be,* shkruante bukur edhe me hir në pllakat e zemrave,*⁴ brenda nesh librin e plot'* të virtytit të hyjshëm krejt,*

dogma saktësisht,* mishërimin e Krishtit që fort deshi të na shfaqej neve me dy substanca, por me një hipostaz'.

*Të martirit**Ting. Tërth. IV O tu paradhoksu**thávmatos*

O çudi paradoksale krejt, pëllumb martirit të shenjt',* Neofitit, i flet me zë* njerëzor, kur zbriti posht'* nga të lartat; për hir të tij* shndrit plot me dritë një jetë identik* me engjëj, dhe me rini në forc' merr çmim.* Oh, veprat e mëdha* të atletit tënd pesëgarist, o Krisht;* si i dhembshur na shpëto me lutjet e atij.

O çudi paradoksale krejt, që foshnjë dhe në shpërgënj,* Neofiti i dituri,* bën të mrekullueshmet* me veprimin e Shpirtit Shenjt:* Ai prej gurit me lutje ujë nxjerr,*⁵ e ngre të vdekurën, pra të ëmën ky.* Oh, veprat e mëdha* të atletit tënd pesëgarist, o Krisht;* si i dhembshur na shpëto me lutjet e atij.

O çudi paradoksale krejt, si po ushtrohet me zell* Neofiti për Krishtin Zot,* shtang me trimëri armiq* me çudi mrekulluese,* në gjum' vë zjarrin kur futet brenda tij,* bisha të egra i shfaq të trembura;* oh, forc' që s'mposhtet dot,* për këtë fiton atleti admirim.* Na shpëto, o Perëndi, me lutjet e atij.

Lavdi *Ting. Tërth. II*

O atë oshënar, në gjithë tokën doli zëri⁶ i arritjeve të tua, prandaj në qiejt gjete shpërblim⁷ për lodhjet e tua; asgjësive batalionet e demonëve, arrite rreshtimet e engjëjve, jetën e të cilëve e kishe zili në mënyrë të paqortueshme; duke pasur guxim ndaj Zotit, kërko paqe për shpirtrat tanë.

Tani *Hyjlindësore*
Olin apothémeni

Nxirrmë nga ky peshk i madh,* nga barku i tij, nga faji* dredharak, ti që në bark* mbajte të panxënin, nga ngasjet më çliro,* prej stuhi, Zonja jon',* nga shtrëngatë⁸ fajesh* më rrëmbe dhe thaje detin e mëkateve që kam,* Vajzë e dëlirë, pusho, fashit* çdo rebelim demoniak,* besëlidhja jote e shenj' ka forc',* që të të lëvdoj pa pushim ty, pra të lumturën gjithnjë;* strehim, liman për të gjithë je,* që të vij në me besim.

ose Kryqhyjlindësore
Triimeros anestis Hristé

Kur nëna e dëlir', virgjëresh'* po shihte popullin e keq,* të paligjshëm* të të ngulte ty në dru* padrejtësisht, siç profetizoi Simeoni,* përbrenda saj plagosej hidhërisht.⁹

Pasvargje të Oktoihut

Lavdi

Ting. Tërth. IV I Sigeotit

Turmat e murgjve të nderojnë ty, profesorin, o Maksim, ati ynë, sepse nëpërmjet teje ne mësuam të ecim në udhë vërtet të drejtë;¹⁰ i lum je, se i shërbeve Krishtit¹¹ dhe triumfove mbi fuqinë e armikut,¹² o shok engjëjsh, që banon në të njëjtën tendë me oshënarë dhe të drejtë; tok me ta ndërmjeto te Zoti që të mëshirohen shpirtrat tanë.

Tani *Hyjlindësore*
I mártirés su Kírie

O Zonjë, më rrëmbe nga dora e dragoit që e vret njeriun,*¹³ të më gëlltitë më lufton ky¹⁴ plot me hipokrizi, të lutem pra,* i dërrmo dhëmballat e tij¹⁵ dhe shpërbëj* makinacionet, i shpëtuar pra* prej kthetrave të tij, fuqinë, pushtetin tënd un' ta madhëroj me shpirt.

ose Kryqhyjlindësore E ngjashme

Mëshqerra e panjollshme duke parë viçin¹⁶ që të varrej mbi dru* vullnetarisht, vajtonte dhe me klitma, me britma po thërriste: Mjer',* o bir i përmallshëm fort, ty populli* mosmir'njohës hebraik si të shpërblen,* se pa femij' do të më lërë larg teje, o bir i shumëdashur ti .

Përlëshore e oshënarit

Ting. Tërth. IV Orthodhoksias odhijé
Drejtues i Orthodhoksis',* je mësues për shpresëtari dhe thjeshtësi,*

për Kishën je ndriçues ti,* stoli e hyj-
frymëzuar për murgjit, o Maksim* i
urtë, gjithë ne* me mësimdhënien
tënde i shndrite, lira e Shpirtit
Shenjt;* ndërmjeto te Zotit tënd
Krisht,* të na shpëtojnë shpirtat pra.

Përlëshore e martirit

Ting. IV

Dëshmori yt, o Zot, në ndeshjen e
tij, fitoi kurorën e mosprishjes¹⁷ prej
teje, Perëndisë tonë, se duke patur
fuqinë tënde, i mposhti tiranët dhe
theu ambiciet e pafuqishme të de-
monëve. Me lutjet e tij, o Krisht Perë-
ndi, shpëto shpirtat tanë.*



NË MËNGJESORE

*Stihologjia e zakonshme dhe Kanunet:
një i Oktoihut dhe dy të shenjtoreve.*

Ode I

*Kanuni i oshënarit, që ka Akrostihidhë
(pa Hyjlindësoret): “Lavdërohet
Maksimi i tërëmadh”.*

Poezi e Joan Damaskinoit

Ting. Tërth. IV

Asomen to Kirio

Hirin e tër’ të Shpirtit* ma pikoftë
gjuha jote që rrjedh mjal’t* me ëndje,
sepse Hiri,* o i hyjshëm Maksim, ka
hyjfrymëzim.

Si zjarr u pe të ndizej* kundër herezi-

ve,¹⁸ atë fort i lum,* se si kallam i
prishe*¹⁹ përmes zellit të Shpirtit të
Tërëshenjt’.

Vunë përpara dogma* pa mend, me
synim pra të keq: Një vullnet.* Por
kjo u kritikua,* atë, përmes fjalime-
ve që ti the.

Hyjlindësore

Plot ëmbëlsi, dëshirë,* dritë që s’ka
perëndim i tëri²⁰ është* i miri pra që
deshi,* o Hyjnuse, të lindë prej bar-
kut tënd.

*Kanuni i martirit, që ka Akrostihidhë: “O
martir, të lavdëroj si bimën e re të Krishtit.
Josif”.*

Ting. i njëjti

Igrán dhiodhefsas

O shën Neofit, të himnojmë ty* si
filiz i ri i Krishtit Zot, që ke mbir’ në
kopsht,* në livadhin e dëshmorëve
ku,* i tërëlum, lulëzove fryt shpresë-
tar.

Meqë u tregove qartë, i lum,* ti
që foshnjë t’i përmbushësh fjalët
hyjnore krejt,* zgjodhe mençurisht
pjesën e mirë,^{21*} je bër’ drejtues për
sa binin në mashtrim.

Nga buzët e hyjshme pikoje ti*
ëmbëlsi²² hyjdijeje, hyjnisht ëmbëlso-
je pra,* o hyjmenës, shpirtat që
helmoi* djalli i huaj përmes ligësis’
së tij.

Hyлиндësore

Krejt e hyjnizove esencën ton',* pra të të dhëlindurve kur linde Krijuesin* nga natyra, ndaj ne të pohojmë,* o Virgjëreshë hyjnuse, Hyлиндësen.

*Ode III**I oshënarit: Si i to steréoma*

Maksimi u shfaq gjithkund* me gjak vërtet predikuesi,* martiri²³ pra* div i madh i besës* së sinqertë të Krishtit Zot.

Ubëre shtëpi pa njoll',* e denj' hyjnisht për filozofi,* me lodhje, mund* edhe asketizëm,* o i lumur Maksim me nam.

I lum atë shën Maksim* i adoptuar prej urtësis,* buron lumenj* gjuha jote, dogmat* besëmira të Krishtit tënd.

Hyлиндësore

Që udhë të na tregosh* që na çon te shenjtërimi drejt,* banove, Zot,* tërëshenjterisht ti* në një mitër të tërëshenjti'.

I martirit I njëjti

Pa plagë të ruante* të tërin Shpirti i pastër ty,* o famëmadh,* se u dorëzove* ti te Fjala e dhembshur krejt.

Kur turmat e popujve* besnikë panë se, o dëshmor,* prej vdekjes ti* ngjalle nënën tënde* Perëndinë

himnuan fort.

Të fton me zë gjallërisht* për udhët krejt shpëtimtare²⁴ ty,* o Neofit,* pëllumbesh' e ndritshme* me shkëlqim qiellor nga lart.

Hyлиндësore

Onënë e Perëndis',* gjithnjë gjinia e njerëzve* të psal himnim* me falënderime,* se nga ti ka pavdekësi.

Irmosi: Si i to steréoma

»**T**i je përforcim për ne* që po përi-
»kim te ti, o Zot;*²⁵ je drit' për sa*
»janë errësuar;*²⁶ ndaj dhe shpirti
»im të himnon.

*Ndenjësove e oshënarit**Ting. Tërth. I Ton sinánarhon Logon*

I durove përndjekjet për besën, o Maksim,* dëbove çdo herezi, dhe kur dora jote u pre* tok me gjuhën, prite, o i lumur atë ti* kurorë plot me hijeshi* për omologjin', pohimin tënd, Bërësi me dorë,* të dha;²⁷ pa pushim lyp tani që të përdëllejë shpirtrat tanë ky.

*Lavdi I martirit**Ting. IV O ipsothis en to stavró*

Mbiu lastar i ri* tani i bleruar* brenda në kopsht, livadh* martirësh të Krishtit,* pra athloforësh, dhe i solle Krishtit tënd fryt* dijeje të hyjshme; me këtë* po ushqehen sa të lëvdojn'* besërisht, o Neofit*

famëmadh dhe atlet trim* në shpirt; me lutjet që ti bën gjithnjë,* duke qëndruar* pran' Zotit^{27a} shpëtona ne.

Tani *Hyjlindësore*

Te ti, Hyjlindëse,* pas Zotit përik, rend,* te shtreha jote pra,* se është e shenjtë* dhe lyp i mjeri: E dëlirë, më mëshiro,* se mëkatet janë ngjitur lart,* më lart se koka ime²⁸ pra,* druhem, Zonjë, frikë kam,* nga dënimet; kërkoi* ti, o e thjeshtë, Birit tënd Jisu,* që të shpëtohem* prej tyre në gjyqin tim.

ose Kryqhyjlindësore

Ajo që mishërisht* së fundmi të lindi,* ti që prej Atit pa* fillim fare linde,* kur të pa varur përmbi kryq, thërriste, o Krisht:* O Jisu i shtrenjt', i dashur fort,* kryqëzohesh nga njerëz* të paligj vullnetarisht* ti tani, që lëvdohesh* si Perëndi nga engjëjt; të himnoj,* ty zemërgjërën* edhe njeridashësin.

Ode IV

I oshënarit: Isakikoa Kírie tin akoín su

Të dhëlindur të lavdërojnë dhe rende qiellorësh të admirojnë, sepse nëpërmjet miqësisë së urtësisë²⁹ u dallove, o atë, si pa mish.

Tirani ishte i pacipë, mirëpo durimi yt ishte i pamposhtur! Prandaj nga njëra anë ti u lumërove, ndërsa nga ana tjetër tërëdinaku dështoi.

Ushtrohen tok me ty, o Maksim, dyshja e tërëpasur e nxënësve, meqë u kunguan me garat e tua; për këtë arritën çmime të barabarta.

Duke u ujitur me bollëk nga rrjedhja e gjakut tënd Kisha e Krishtit, lulëzon nga fara jote e hyjshme dogmën e dhënë nga Etërit, o oshënar.

Hyjlindësore

Meqenëse me lindjen tënde u çliruar nga borxhi i mëkatit, o e Tërëpaqortueshme hyjnuse, të drejtojmë himn falënderues.

I martirit I njëjti

Turma të panumërta duke soditur paqortueshmërinë e jetës sate dhe pathyeshmërinë e mendjes sate, i erdhën Perëndisë, o martir i lavdishëm.

I udhëzuar prej Shpirtit Hyjnor,³⁰ mbërrite dhe banove në mal, dhe duke u ushqyer nga një engjëll, u pe i barabartë me engjëjt.

Pasi pranove ligje të hyjnueshme të shkruara, o i denjë për admirim, i përmbushe pa vonuar duke u futur nën lodhjet e asketizmit.

Me dhembshuri shpërndave, u dhe të varfërve, si u urdhërove, o i lumur, duke fituar në vend të tyre ato që mbeten në jetët.³¹

Hyllindësore

O Perëndilindëse, e linde Përmbipe-rëndinë që për hir të pasurisë së mirësisë³² u varfërua vullnetarisht, sepse i erdhi keq për varfërinë tonë.³³

Ode V

I oshënarit: Orthrizontes voomen si

Maksimi që grumbulloi dijen e tokësoreve dhe të qielloreve, drejtësisht quhet filozof.

O Maksim i kënduar, u pe imitues i tërëshkëlqyer i Krishtit,³⁴ me anën e dashurisë më të mirë për urtësinë.²⁹

Për shkak të manisë së tiranit u internove, por e gjete Jisunë si ngushëllim, o i lumur.

Hyllindësore

Ata që nuk të njohin si Perëndilindëse, nuk do të sodisin dritën që lindi prej teje, o hyjnënë e tërëkulluar.

I martirit: Ina ti me aposo

Meqenëse i mbushe me mistere të parrëfyeshme, o i vyer për admirim, marshove drejt garave burrërore të paravëna³⁵ të atletizmit, duke mos u frikësuar nga torturat, as nga vdekja, o dëshmor Neofit.

Me providencën sekrete të atij që i drejtonte ecjet³⁶ e tua, o i lavdishëm, engjëj të hyjshëm mbërritën dhe të

tërhiqnin nga mali drejt stadiumit, pors i një tjetër Moisi të lavdëruar në fytyrë me shkëlqime hyjnore.³⁷

Duke pasur fjalë të gjallë³⁸ në zemër, o martir Neofit i tërëkënduar, trim në moral, u thërrisje përndjekësve: I vetëftuar jam tani pranë jush që më kërkoni, që të kritikoj pafuqinë e idhujve tuaj.

Hyllindësore

Misteri hyjnor i fshehur para jetëve,³⁹ o Vajzë e tërëpaqortueshme, me anën tënde u njoh anëmbanë: Biri dhe Fjala e Perëndisë që u bë mish⁴⁰ dhe e hyjnizoi njeriun, o Virgjëreshë.

Ode VI

I oshënarit: Hitona mi parasku

Ti Perëndisë silli përgjërimit* të pae-pur, të më çlirojë nga prishja, dëm* vesesh trupi edhe shpirti, hyjmbajtës at'.

Ja, çdo burim i baltë, herezi* thahet,⁴¹ o Maksim i kënduar, se me fuqin'* që ka gjuha, fjala jote, blloko-het krejt.

I miri Krisht, i vetmi, mëshirom',* dhe në zemrën time gufomë burim hiri* përmes lutjeve të shenjtit tënd oshënar.

Hyllindësore

Të lutemi, çliroji nga çdo kurth* nga

armikut shpirtrat, o Zonjë, e vetmja ti* që në bark e kishe Fjalën përmes fjale.⁴²

I martirit: Tin dhéisin ekheó

I ngritur lart,* o i lumur, përmbi dru* thellë çaheshe me hekur në brinjë* pa mëshir', pra* kritikon dhe e shqyen* zemrën prej guri tiranit që urdhëron* të bësh fli perëndish të rrem',* të mohosh të pavdekshin ti Perëndi.

Kur lidheshe* dhe poshtrembëroheshe,* o martir, e lidhe fort ti mashtrimin;* i shfaqe pra* me forcimin e Shpirtit*⁴³ të asgjësuaru udhët e satanas',* armikut; pranë Krishtit rri*^{27a} me kurorë, si rende në qiell lart.

Të joshi ty* bukuri e Zotit Krisht* dhe u ngjite pranë tij duke thirrur:* Vullnetarisht* për ty them, o Fjalë* e Perëndis' e flijuar; dhe imitoj* qart' vuajtjet, pësimin tënd* të nderuar, hyjnor, shpëtimtar për ne.

Hyjlindësore

U shfaqe fort* fron plot drit' për mbretin Zot* qiellor, o Virgjëreshë e pastër,* ku me vullnet,* me mish si ne ish prehur* dhe hoqi lodhjen e shumtë që na rëndon,* me mirëdashje vuri ky* sipër fronit të Atit njeri-un lart.⁴⁴

Irmosi: Tin dhéisin ekheó

»**D**o derdh lutjen* para Zotit Perëndi* dhe atij do t'i tregoj hidhërimet* »që kam,⁴⁵ sepse* shpirti im është »mbushur* me çdo të keqe dhe jeta »po shkon në Hadh;*^{45a} pra si Jonai »lutem un':* Jetën time nga prishja, »ti ngrije, Zot.⁴⁶

Kontaqi

Ting. Tërth. IV Ti ipermaho

Të madhin Maksim* dhe të dashurin e Shën Trinis',* që na mësoi* me fuqi besimin krejt hyjnor,* që të lavdërojmë Krishtin në dy natyra,* me veprime dhe vullnete të dyfishta tok,* o besnikë, siç ka hije ta lëvdohet me ne* duke thirrur fort:* G'zohu, shpallës i beses drejt.⁴⁷

Shtëpia

Çelmi buzët, o Perëndi, Shpëtimtari im, dhe bëmë të tërheq⁴⁸ hir hyjnor që ta himnoj në mënyrë të vyer atë që të predikoi, o Krisht, me dy natyra, më të shkëlqyshëm se të gjithë; atij i thërras fjalë të tilla:

Gëzohu, o ndriçues që shkëlqen botën,⁴⁹/ gëzohu, o liman i atyre që janë në shtrëngatën e jetës.

Gëzohu, o kandil tepër i kthjellët i murgjve,/ gëzohu, o lavdia dhe mbështetja e martirëve.

Gëzohu, o zbukurim me të vërtetë dhe stolia e Kishës,/ gëzohu, bazamenti i besimit dhe themeli i patundur.

Gëzohu, sepse e rrafshove arrogancën e herezive,/ gëzohu, sepse me gatishmëri pritësh në gjymtyrë për Krishtin.

Gëzohu, o ngazëllim i atyre që të nderojnë besërisht,/ gëzohu ti, që i mbush me hare ata që për ty kanë mall.

Gëzohu ti, që çlirove shumë veta nga beljari,/ gëzohu ti, që i ofrove Perëndisë besimtarë.

G'zohu, shpallës i beses drejt.⁴⁷

Sinaksari

Më 21 të të njëjtin muaj, kujtimi i atit tonë oshënar Maksim Omologjeti.

Vargje: Dhe pse pa dorë, pa gjuhë, mbin dorë dhe gjuhë,/ o Maksim, dhe e jep shpirtin në duart e Perëndisë.⁵⁰ Në të njëzetënjëtën vdekje mbuloi famën e Maksimit.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirit të shenjtë Neofit.

Vargje: Neofitin e çrrënjos nga dheu shtizë/ si gjelbërim tepër të bukur të një bime të re.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atit tonë oshënar Zosimi, episkopi i Sirakuzës në ishullin e Siçilisë.

Vargje: Zosimi gjeti largjim nga jeta, ai për të cilin/ dhe përpara tij, jeta e tërë ishte shpërngulje.

Në të njëjtën ditë, atletizmi i martirëve të shenjtë Evgjëni, Valeriani, Ka-

ndidi dhe Akila.

Vargje: Evgjënin, së bashku me tre bashkatletë/ i vret shpata për shkak të fisnikërisë shpirtërore.

Në të njëjtën ditë, Mbledhja e shën Irenës në Kishën tepër të shenjtë që është pranë detit, dhe kujtimi i martires së shenjtë Agnia.

Vargje: Më shumë se një viç të ri, siç thotë Davidi,⁵¹/ të pëlqente ty, o Fjalë, Agnia që digjej.

Në të njëjtën ditë, katër martirët e shenjtë në Tiro, mbarojnë me shpatë.

Vargje: Një ishte zëri i katër atletëve të qëndrueshëm:/ Për ne vdekja prej shpate është kënaqësi.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i oshënarit Maksim Greku, ndriçues i rusëve.

Në të njëjtën ditë, oshënar Neofiti, që dëgjoi zërin e Virgjëreshës prej ikonës së saj (në Vatopedhi), mbaron me paqe.

Me ndërmjetimet e shenjtorëve të tu, o Krisht Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII

I oshënarit: I ek tis Iudheas

The një natyrë të Triadhës, një vullnet, një energji, ndërsa shpalle dy natyra, vullnete, energji të Perëndisë të mishëruar, duke thirrur: I bekuar je, o Perëndi i etërve.⁵²

Proklamove, jo dy vullnete që ndahen për shkak të kundërshtimit të mendimit, por më shumë që ndryshojnë për sa i përket cilësisë së natyrës, o atë, duke thirrur: I bekuar je, o Perëndi i etërve.⁵²

Duke mbajtur, o atë, fjalët e tua të perëndishme si përmendore Orthodhoksie, adhurojmë njërin nga Trinia në dy esenca dhe vullnete duke i thirrur: I bekuar je, o Krisht.

Pasi njohim dy energji të Perëndisë të mishëruar nga dhembshuria, dhe mësuam prej teje vullnete të dyfishta, të vetëpushtetshme, këndojmë: I bekuar je, o Perëndi i etërve.⁵²

Hyjlindësore

Ushfaqe për shpëtimin tonë⁵³ i mishëruar nga mitra virgjërore; për këtë ne duke e ditur nënën tënde Perëndilindëse, thërrasim me ëndje: I bekuar je, o Perëndi i etërve.⁵²

I martirit: Pedhes Evreon

Kur bëri i paligjshmi një furrë jetëdjegëse, të mbyll brenda saj për tri ditë, por nuk u dogje fare, o Neofit, duke thirrur: O Perëndi, je i bekuar.

Kur qëndroje në mes të flakës, o i lumur, këndohej paradoksalisht një himn, sepse vesa e Perëndisë të freskonte,⁵⁴ o martir që thërrisje: O Zot Perëndi, je i bekuar.

Ajo që ndodhi në ty është një çudi tepër e madhe, që habit çdo mendje, sepse zjarri, edhe pse nuk të dogji fare, o hyjmendës, pasi u derdh për qark, i dogji⁵⁵ krejtësisht trashëgimtarët e zjarrit.

Hyjlindësore

Upe më eprore se engjëjt kur linde engjëll vendimi të madh,⁵⁶ o Perëndilindëse e kulluar; atij të gjithë i psalim: I bekuar je, o Zot Perëndi, në jetët.

Ode VIII

I oshënarit: Nikité tiranu

Meqë e dëshirove totalisht atë që dëshiroi fuqishëm gjininë njerëzore, e ngrite kryqin tënd⁵⁷ dhe tok me të, o i lumur, u bashkëkryqëzove⁵⁸ duke psalur: E bekoni ju, o vepra, Zotin dhe e përmbilartësoni në jetët.⁵⁹

Pasi u bëre i huaj për çdo kënaqësi vdekjeprurëse, e skalite veten tënde të tërë si pasqyrë të shenjtë, pa njollë,⁶⁰ o i lumur, duke psalur: E bekoni ju, o vepra, Zotin dhe e përmbilartësoni në jetët.⁵⁹

Nuk u hutove nga ashpërsia besëkeqe e tiranit të egër, por qëndroje si kullë e papërkulur dhe e patundur e Orthodhoksisë, duke thirrur: E bekoni ju, o vepra, Zotin dhe e përmbilartësoni në jetët.⁵⁹

U pe të pranosh dritë jetëprurëse nga një Hyjni trihipostate, diell për të humburit në errësirë, duke psalur: E bekoni ju, o vepra, Zotin dhe e përmbilartësoni në jetët.⁵⁹

Hyllindësore

Nga njëra anë u pe, o Virgjëreshë, bija e Adamit të rënë, nga ana tjetër, nëna e Perëndisë që e ripërtëriti esencën time; atë e himnojmë gjithë ne veprat, si Zot dhe e përmbilartësojmë në jetët.

I martirit: Eptaplasios káminon

Me trup të ri dhe mendim të përsosur,⁶¹ o i tërëlumur, e shfarose dinakërinë e të ligut nga fillimi, pasi mbive si bimë shumë e bukur në avllitë⁶² e atij që mbiu prej rrënjës së Jeseut;⁶³ thërret drejt tij pa pyshim: O priftërinj përhimnoni, o popull përmbilartësoni në gjithë jetët.

O athlofor, në stadium u erdhi turp bishave prej teje, si Danielit të hyshëm më parë,⁶⁴ sepse të njohën dëshmorin e pësimeve të Krishtit; duke e pohuar atë, i durove torturat e pashërueshme duke thirrur: O priftërinj e bekoni, o popull e përmbilartësoni Krishtin në jetët.

Luani kolosal që më parë të njohu në mal, o Neofit, sillet dhe lëshohet për dënim, kur ishe në stadium, o atlet; dhe sapo të njohu, të falej me

frikë i përzier me turp dhe duke derdhur prekshëm burime lotësh me kataniks, o i hyllumur.

Hyllindësore

Oe tërëkulluar, linde fëmijë të ri, atë që mbiu nga Ati pa shpjegim para çdo krijese; atij pra përgjeroju që të më ripërtërisë tani mua që u vjetërova përmes shkeljesh⁶⁵ dhe që të më shpëtojë mua që thërras: O Djem e bekoni, o priftërinj e përhimnoni, o popull e përmbilartësoni Krishtin në jetët.

Irmosi: Eptaplasios káminon

»**E** dogji furrën shtatë her'* në
»Kalde një tiran i saj* me mani për
»Djemtë* që nderonin Perëndi;*⁶⁵
»por kur të shpëtuar krejt* i pa nga
»një fuqi më e fort',* thirri ky kë-
»shtu:* Po Çlirimtarin Ndërtues* ju
»Djema, e bekoni,*⁶⁶ priftërinj, e hi-
»mnoni,* ju popull, lartësoni atë për
»gjithë jetët.

Ode IX

I oshënarit: Ton prodhilothenta en ori

O Maksim vigan dhe i tërëlum, gjaku yt, pra* porsi gjaku i Abelit, dhe dogma, fryma jote* e shenjt' me zë të madh⁶⁷ predikon fort* ende* dhe në jet' te Kisha e Krishtit.

Upre dora jote, por shkruan me gisht të hyshëm* si me penë boj'⁶⁸ besimin krejt orthodhoks në zemra;* po

e shkruan përmes gjuhës sate* të prer'* dhe me gjakun tënd të çmuar pra.

Mbi dhé po këndohet guximi i perëndishëm* edhe zjarri brenda zemrës i dashurisë hyjnore;* o Maksim oshënar, ti pësove* derdhje* gjaku plot me zell për hir të saj.

Para podiumit hyjnor rri tok me martirët,* se kungove ti prej zellit të tyre për besimin;*⁶⁹ na familjarizon tok me Zotin,* edhe* imituesit e tu na bën.⁷⁰

Hyjlindësore

Ti je, o Hyjlindëse, arma dhe muri ynë,* ti je ndihma e atyre që rendin shpejt drejt teje;* në lëvizje të vëmë për lutje* ne, që* të shpëtojmë nga armiqtë tan'.

I martirit: 'Efrikse pasa akoi

Rrije si qengj për therje ti* dhe qëndroje me vullnet⁷¹ para ndjekësve* të hidhur, Neofit,* të cilët po të vrisnin dhe shponin keq* dhe brinjen tënde përmes shtize;⁷² more mbarim të lum,* o athlofor me nam,* tepër trim, o shenjt martir, lavd i Kishës je.

Si sakrificë dhe kurban,* si theror i bukur fort, i nderuar ti,* blatë e pastër krejt* për kish' të shenjtë, si harabel i mir',* i zgjedhur, viç i çmuar, bim' e re e Parajsës lart* u

solle, o i lum,* tek Jisui, Zoti ynë dhe Perëndi.

Sipas pësimeve je bër'* i njëllajtë me atë që pësoi keq* me mirësi për ne,* me barazin' e shtizës⁷² vërtet, martir,* u lavdërove dhe banon në qiej me rreth në kok'* tani me bukuri* nga fitorja dhe me gaz që s'shteron mbushesh.

Lindi kujtimi plot me drit'* dhe i mbushur me lavdi i ushtrimit tënd;* më fort se dielli,* ky mendjet e besnikëve, o martir,* i llamburit; në të të përgjërhem i na çliro* nga çdo larmi vesesh,* errësire dhe rreziqe të hidhura.

Hyjlindësore

Si mashë, o hyjnuse, ti* sjell thëngjillin qiellor,⁷³ ndaj shkumbo tani* tekat që unë kam* në zemër, veset, dhe më çliro mua* nga zjarri i Gjehenës,⁷⁴ përgjërhem, ty të lëvdoj,* të paqortueshmen,* që je shpresa e besnikëve, ndihma jon'.

Irmosi: 'Efrikse pasa akoi

»**F**rika ka zënë çdo dëgjim* nga de-
»njimi i pashprehshëm i Zotit Krisht;*
»pra si i Larti krejt* vullnetarisht
»zbret deri në trup pasi* u bë njeri
»prej barku virgjëror dhe pa cen
»aspak;* prandaj Hyjlindësen* e
»panjollshme, ne besnikët e madhë-
»rojm'.

*Dërgimësore e oshënarit
Tis mathitës sinélthomen*

Hyjshfaqës atë shën Maksim* i tërëlumur, shpalle,* theologove një natyr',* vullnet dhe energji tok* për shën Trinin', por pohove* dy energji, vullnete* dhe dy natyra për Zotin* Krisht që u mishërua, ndaj hodhe posht'* herezi luftuese ndaj Hyjnisë;* u pe martir, sepse t'u pre* si dora edhe gjuha.

E martirit E ngjashme

Pasi u pe, o Neofit,* çuditërisht, e ngrite* nënën që të kish lindur ty* kur vdiq; ti na u shfaqe* si shërbëtori i Krishtit* me nam, çudi e madhe!* Tani që pranë tij qëndron,*^{27a} o hyjmendës, kurorë mban; mos pusho* që të ndërmjetosh për sa të himnojnë* dhe e nderojn' kujtimin tënd,* o athlofor, martir shenjt.

Hyjlindësore

Misteri që nuk ka shpjegim,* është hyjnor, i huaj,* i lindjes sate pa cënim,* po i mahnit çdo engjell,* koret e njerëzve bashkë,* Vajzë e virgjër nënë,* se Perëndi në barkun tënd* pa far' u mishërua dhe pa trazim,* pra i paafrueshmi na u pa k'shtu* si i afrueshëm, - çudi! -,* me Hyjnin' më bashkoi.

Pasvargje të Oktoihut

Lavdi Ting. Tërth. II

Pasi e stolise jetën tënde me filozofi, e shkëlqeve veten me hyjurtësi; pra duke pasur sukses në të dyja, me omologjinë e mirë⁷⁵ i vulose të dyja, o Maksim tri herë i pasur; ndaj meqenëse ke guxim para Krishtit Perëndi, lyp gjerësisht për shpirtrat tanë.

Tani Hyjlindësore

Askush që përik te ti nuk largohet i turpëruar nga ti, o e Virgjër Hyjlindëse e kulluar, por kërkon hirin dhe merr dhuratën sipas interesit dhe kërkesës.*

*ose Kryghyjlindësore
Triimeros anestis Hristé*

Sapo të pa të varesh mbi kryq,* vajtonte e dëlira krejt* porsi nënë,* duke thënë: Biri im,* o Perëndi dhe Zot, o fëmijë fort i ëmbël,* si po duron pësim të turpshëm ti.

Dhe të tjera si zakonisht.

CITIME

¹ Fja. Urt. 6.14; 12.20; 14.22; Sirak 27.22

² I Tim. 2.8

³ Ps. 44(45).2

⁴ II Kor. 3.3

⁵ Eks. 17.6 etj.

⁶ Ps. 18(19).5

⁷ Matth. 5.12; Lluk. 6.23,35

⁸ Jonai 1.4-2.11

- ⁹ Lluk. 2.35
¹⁰ Is. 40.3; Matth. 3.3; Mark. 1.3;
 Lluk. 3.4; Joan 1.23; Vep. 13.10
¹¹ Vep. 20.19; Rom. 14.18; Kol. 3.24
¹² Kol. 2.15
¹³ Is. 27.1; Joan 8.44
¹⁴ I Petr. 5.8
¹⁵ Ps. 57(58).7
¹⁶ Lev. 4.1-4 etj.
¹⁷ I Kor. 9.25
¹⁸ Is. 10.16-17; 33.12-14
¹⁹ Is. 1.31; 5.24
²⁰ Kënga 5.16
²¹ Lluk. 10.42
²² Amos 9.13; Joel 4(3).18
²³ I Tim. 2.6-7
²⁴ Vep. 16.17
²⁵ I Mbret [Sam.] 2.2; Ps. 17(18).3; 70(71).3
²⁶ Ps. 111(112).4; Lluk. 1.79; Rom. 2.19
²⁷ Urt. Sol. 5.16
^{27a} III [I] Mbret. 18.15; IV [II] Mbret. 3.14
²⁸ Ps. 37(38).5
²⁹ Urt. Sol. 8.2
³⁰ Joan 16.13
³¹ Ps. 111(112).9; II Kor. 9.9
³² Rom. 2.4
³³ II Kor. 8.9
³⁴ I Kor. 11.1; Ef. 5.1; I Thes. 1.6
³⁵ Hebr. 12.1
³⁶ Ps. 5.9 etj.
³⁷ Eks. 34.29-35; II Kor. 3.7
³⁸ Joan 6.68
³⁹ Kol. 1.26
⁴⁰ Joan 1.14
⁴¹ Jer. 28(51).36
⁴² Lluk. 1.31
⁴³ Rom. 15.13
⁴⁴ Mark. 16.19
⁴⁵ I Mbret. [Sam.] 1.15; Ps. 1(142).3
^{45a} Ps. 87(88).4
⁴⁶ Jona 2.2-7
⁴⁷ I Tim. 2.7
⁴⁸ Ps. 118(119).131
⁴⁹ Fil. 2.15
⁵⁰ Lluk. 23.46
⁵¹ Ps. 68(69).32
⁵² Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 28
⁵³ Tit. 2.11
⁵⁴ Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 26-27
⁵⁵ Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 22-25
⁵⁶ Is. 9.6
⁵⁷ Matth. 16.24; Mark. 8.34; 10.21; Lluk. 9.23
⁵⁸ Gal. 2.20
⁵⁹ Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 34
⁶⁰ Urt. Sol. 7.26
⁶¹ I Kor. 14.20
⁶² Ps. 91(92).14
⁶³ Is. 11.1; Rom. 15.12
⁶⁴ Dan. 6.18
⁶⁵ Suz. 52
⁶⁶ Dan. 3.25
⁶⁷ Gjen. 4.10
⁶⁸ III Joan 13
⁶⁹ Fil. 6
⁷⁰ I Kor. 4.16
⁷¹ Is. 53.7
⁷² Joan 19.34
⁷³ Is. 6.6
⁷⁴ Matth. 5.22 etj.
⁷⁵ I Tim. 6.12



MË 22 TË TË NJËJTIT MUAJ

Kujtimi i apostullit të shenjtë Timothe dhe i oshënarit martir të shenjtë Anastas persiani.

NË MBRËMËSORE

*Thirrtoje të apostullit
Ting. I Panëfimi mártires*

Me rrezet nga Shpirt i Shenjtë qart* duke feksur dritë fort,* o Timothe shenjt hyjshfaqës, u tregove ndriçimtar* shumë i spikatur* dhe përshkove dhenë,¹ duke shndritur, llamburitur, me hir; tani pra përgjërohu ti* t'u dhurohet paqe shpitrave,* o apostull, si dhe përdëllim i madh.^{1a}

E pive, hyjmenës Timothe,* ti përroin me shijim*² dhe i vadite hyjnisht me njohuri prej Perëndis'*³ sa e dëshironin,* imitoje Krishtin⁴ tënd, për-krah të cilit shkove me gaz dhe e sodit lavdinë fort* të mbindritshme edhe paqen krejt* të fuqishme, pa skaj të Trinisë Shenjt.

I fortë⁵ në mendje, Timothe* o hyjmenës dhe i lum,* përmes sëmundjesh të shpeshta,⁶ dobësish trupore ti* shpartallove lehtë* forcën dhe pushtetin e mashtrimit me fuqinë e Krishtit, i fortifikuar mir',* dhe na shpalle me fjalim madhor* ti Ungjillin krejt hyjnor të paqes,⁷ shenjt.

Të martirit Të ngjashme

Çdo anë e botës po këndon,* çudibërës Anastas,* tani çuditë e tua, sepse Krishti, Zoti yt* të stolisi bukur* me shpërblime mrekullish, sepse për të durove tortura, dhe pas vdekjes të ka bër'* ty të denjë për lavdi që s'vdes* si edhe për lumturi përjetë lart.

O mburrje martirësh, ngrite lart* përmendore dhe trofe* kundër mashtrimit; lavdi ke sipas emrit tënd, dhe nam* ke kudo, i lumur,* se konsiderohesh fitimtar i fortë, o Anastas; tani na ngri nga rënia posht'* nga mëkate, ne që besërisht* e nderojmë, madhërojm' kujtimin tënd.

Si ngrite trofe me çdo shkëlqim,* Anastas, martir dhe murg,* kundër mashtrimit, fitove një kurorë të dyfisht'* për asketizimin* dhe atletizimin e qëndrueshëm, se deri në vdekje rezistove; Krishti Zot* ty të ka dhuruar denjësisht* energji për mrekulli si dhe lavdi.

Lavdi

Ting. Tërth. IV I Studhitit

I paracaktuar i Perëndisë dhe i mësuar pranë Pavlit të urtë, i mësove misteret e shenjtja, pasi jetove mirë; dhe meqë e përqafove qartazi dhe pa dyshim besimin deri në gjak,⁸ u dallove kryepriest i besuar për Perëndi-

në,⁹ o Timothe apostull; prandaj kur i kritikove idhujtarët maniakë, i torturuar me çomange dhe gurë, arrite kurora të martirizimit; për këtë, o i tërëlumur, ndërmjeto për ne që me besë kremtojmë kujtimin tënd të gjithënderuar.

Tani *Hyjlindësore*

O tu paradhoksu thávmatos

O hyjnuse virgjëreshë, ki gaz, gaz ki, shpresë për ne,* për besnikët, gëzohu pra,* je për botën ti pastrim,* nga çdo dhimbje, ankth na çliron* ne shërbëtorët e tu, gëzohu Zonj',* rrëzim i vdekjes, o Vajzë ti gëzo,* Parajs' që jetë sjell,* ndihmë je për sa të ftojnë, ngazëllo,* ki gaz mal i shenjt',¹⁰ shtëpi hyjnore për Zotin.

ose Kryqhyjlindësore

«**O** habi paradoksale krejt, mister i frikshëm, guxim* arrogant!», tha e Virgjëra,* sapo ty të pa ajo,* që pa dhimbje të kish në bark* çuditërisht, midis dy kusarëve* në kryq të varesh. Me lot thërriste k'shtu:* «Mjerë, o biri im* kaq i dashur, si të ngul mbi dru plot tmerr,* frikshëm, populli i keq, mosmirënjohës fort.»

Pasvargje të Oktoihut

Pastaj psalim Idhiomelin

Ting. I

Varg: Në gjithë dheun doli zëri i tij dhe në skajet e botës fjalët e tij.

Ndriçuesin e besimtarëve dhe apo-

stullin që u dallua në Ungjill, Timotheun, ejani, o popuj, ta himnojmë duke thënë: Gëzohu, o lule e hijshme e besimit, e birësimit të Pavlit të hyjnueshëm, gëzohu, o kalibër i nderuar i virtyteve, goja tepër e urtë e Fjalës, gëzohu, o ngazëllim i besës dhe përforcimi i Kishës.

Lavdi *Ting. II*

E madhërove, o Krisht, si në Jude ashtu dhe në Babiloni, fuqinë e kryqit të çmuar, sepse e mësuan me anën e tij të kremten jetëbërëse të Ngjalljes; dhe robi në mes tyre u bë çlirimtar nga mania e idhujve dhe dëshmitar i pashlyeshëm i mrekullive, atleti që tani lartësohet, Anastasi i lavdishëm, që kërcen së bashku me engjëjt dhe ndërmjeton për shpirtrat tanë.

Tani *Hyjlindësore*

Ote ek tu ksilu se

Vetëm* ti pa dhimbje Perëndin* e panxënshëm mbajte në bark pa u ngurtësuar aspak,* kur, e Tërështë, mirësisht u bë njeri,* ndaj të lyp, o hyjnuse, më çliro nga e keqja* që më ngushtëson, që pasi ta përshkoj drejt un'* udhën krejt të ngushtë,¹¹ të vij shpejt* brenda prehjes dhe gjerësisë* që ka lumëria e atjeshme pra.

ose Kryqhyjlindësore

Kur pe* Krijimtarin botëror* të du-

ronte sharje të shumta, të ngrihej lart përmbi kryq,* krejt e pacenuar, the me psherëtimë vaj:* Biri im, Zot dhe Perëndi i përmbihimnuar,* si po mban çnderim në mish, se do që të nderosh* ti gatimin tënd, njeridashës?* Lavdi dhembshurisë së shumë* edhe bashkëzbritjes sate, Shpëtimtar.

Përlëshore e apostullit

Ting. IV

Pasi mësove mirësinë dhe ishe me gatishmëri në të gjitha, duke veshur ndërgjegje të mirë,¹² të denjë për një rifit, nxore nga ena e zgjedhur¹³ të parrefyeshmet; dhe pasi ruajte besimin, ke bërë udhën¹⁴ e drejtë,¹⁵ o apostull Timothe; ndërmjeto tek Krishti Perëndi, që të shpëtohen shpirtrat tanë.

Tjetër për të njëjtin

Ting. III Thias písteos

Bir autentik* i Pavlit me nam,* bashkëpunëtor* të prezanton ty* dhe të dashur në çdo gjë; u dallove pra,* o Timothe, përmes fjalës së Hirit Shenjt'* u lartësove në gara, o apostull;* ndërmjeto ti pranë Zotit që të lëvdoi fort* të na dhurojë përdëllim të madh^{1a} dhe hir.

Lavdi *I oshënarit martir*

Ting. I

Ty, lavdinë e martirëve, mburrjen e oshënarëve dhe thesarin e Persisë,

Anastasin e urtë, përkrahësin e madh të besimtarëve dhe predikuesin e besës sonë, të lartësojmë me himnime engjëllore duke thënë: Lavdi atij që të ka dhënë fuqi, lavdi atij që të ka kurorëzuar, lavdi atij që përmes teje u kryen shërime të gjithëve.

Tani *Hyllindësore*



NË MËNGJESORE

Stihologjia e zakonshme dhe Kanunet e Oktoihut në 8 tropare dhe të shenjtoreve në 6.

Ode I

Kanuni i apostullit, që ka Akrostihidhë: "Me këto këngë e lavdëroj Timotheun apostull". I Theofanit.

Ting. I

Su i tropeúhos dheksiá

O hyshfaqës dhe i lum, shpërbë* me ndërmjetimin tënd dhe me hir shndritës krejt* papasionërie, kryengritjen pra* që sjellin veset dhe shpërnda* errësirën e injorancës, të të himnoj tani.

Zoti paranjohës kur e pa,* o Timothe, bukurin' e mendimit tënd,* ty të denjësoi si bashkëmeshtar* tok me apostujt shenjt hyjnisht,* se, o shenjt, për ne me urti kujdeset, me providenc'.

Një pushtet mbi çdo esencë dim',* i cili ka përkujdesjen e çdo gjëje* se një grek, apostull me ndriçim dhe me hir* nga Krishti, tok me Pavlin shenjt* dhe të hyjshëm bashkërendohet, shën Timotheu pra.

*Kanuni i martirit
Tingull dhe Irmos të njëjtë*

Duke shndritur dritë me agim* të feksur shumë prej Ngjalljes ai që kish* emrin e saj, o Krisht, kur prej Lindjes larg* sulmoi pors dielli,* Kishën e shkëlqen¹⁶ me çudi tani dhe e ngazëllon.

Kur me dashuri hyjnore ti* u mbushe, o Anastas, i durove fort,* o martir, torturat me vendosmëri,* dhe iu ofrove Krishtit tënd* me stoli të bukur asketizimi, me gaz si fli.

Hyjlindësore

Fjalën Zot që linde, o Hyjnën',* i cili erdhi te ne mishërisht, i lyp* që të bëhet dashamir për çdo besnik,* i butë, se të kemi ty* mbrojtje, strehë edhe shpëtim që na ngushëllon gjithnjë.

Ode III

I apostullit: O monos idhós

Uderdh, o i lum, me mbushulli* mbi buzën tënde hir¹⁷ i madh,* buroi pra lumenj dogmash, Kisha jon'* me ta ujitet; me pjellori prodhon* fryt, apostull Timothe* o hyjmendës

dhe me nam* predikues, që shpallje fort Krishtin Zot.

Sipas profecisë, o i lum,* stolisen këmbët e tua* me bukuri, sepse Shpëtimtarin Zot* të Gjithësisë, pra paqen¹⁸ më të lart'* se çdo mendje,¹⁹ o i urt',* që qëmoti zgjidhi krejt* luftën tonë,²⁰ e ungjillëzove ti.

Gjymtyrët e mishit vrave ti*²¹ dhe mendjes ia nënshtrove krejt,* dhe parësi iu dhe më të mirave* e më të poshtmeve, o shën Timothe,* veset, zotërove²² fort,* hijeshove shpirtin tënd* me mësimet e Pavlit sistemoheshe.

I martirit I njëjti

Përshkove të ngushtën udhë¹¹ ti* më parë me asketizim* dhe ece drejt lavdis' në martirizim,* dhe me tortura ke gjetur plot shijim,* duke korrur, o martir* Anastas, kënaqësi* qiellore përmes lodhjes me mundim.

Mbi tërë dhen' doli,²³ o martir,* fuqia në martirizim* që e dëshmove fort të pamposhtur ti;* deri në gjak rezistove me sukses* kundër fajit burrërisht,* fitimtar u bëre, pra* të stolisi kurorë fitoreje.

Hyjlindësore

Prej teje na mbiu lulja, Zonj',* që s'vyshket, por lëshon mirëz,* për njerëzinë mbarë aromë ka* natyra

e shenjt', e bashkëpafillim* tok me Atin, dhe u bë,* o e Virgjër pa qortim,* brenda kohës kur lindi nga ti²⁵ ai.

Irmosi: O monos idhós

»I vetmi që dobësinë njuh* e thelbit
»njerëzor, o Krisht,* dhe dhembshu-
»risht e more si formë ti,* më ngjesh
»me forcë nga lart²⁶ që të thërras:*
»Je i shenjtë, Perëndi,* Zoti i lavdisë
»je,*²⁷ mirësi që nuk imagjinohet dot.

Ndenjësove e apostullit

Ting. IV Tahí prokatálave

Karizma të hyjshëm ty të lavdëro-
nin, kështu* stolise, apostull ti, mitro-
polin' e shkëlqyer fort të Efesit pra*
dhe u pe predikues* tok me Pavlin
e hyjshëm,* kur fjalën shpëtimtare
parathe²⁸ te të gjithë;* kremtojm'
panairin e kujtimit tënd, o zëmadh.

Lavdi I martirit

Upe i nderuar me lavdin' e përsosmë-
ris',* i plotë, se shndriteshe në mend
nga shndritja hyjnore; njohe fuqin' që
ka* kryqi, o Anastas shenjt* oshënar
ndër asketë,* edhe martir në gjak ti
u dallove, hyjmendës;* buron pra në
ty hir mrekullish Krishti, Zoti yt.

Tani Hyjlindësore

Eripërtërite përmes lindjes sate të
shenjt'* substancën e vdekshme
krejt të të dhélindurve, që u prish
në pasione keq;* na ngrite ne prej
vdekjes* për jetësë pa prishje;*²⁹

ndaj ty të lumërojmë denjësisht që
të gjithë,* sipas profecisë sate, o
Virgjërsh³⁰ me nam.

ose Kryqhyjlindësore

Onënë e Zotit Krisht, o Virgjërshë
pa cen,* një shpatë përshkoi shpir-
tin tënd³¹ të shenjt' fort, kur pe tët
Bir edhe Perëndi* mbi dru të kryqë-
zohej* me vullnetin e vet ky;*^{31a} o e
bekuar, mos pusho së luturi atë,* që
të na dhurojë ndjesë, o e panjollshme
krejt.

Ode IV

I apostullit: Oros se ti háríti

Oi tërëlumur, predikues i madh,
hyjmendës Timothe, meqenëse
preferove të garosh ligjërisht,³² me
vetëpërmbytje të skajshme, ia
nënshtrove mendjes shtrëngatat e
pasioneve, dhe e pushtove majën e
virtyeve.

OTimothe hyjshfaqës, kur feksi si
diell Pavli, të dërgoi porsi rreze ve-
zulluese që e shkëlqente si pishtar
kozmosin me dritë të bollshme për
drejtimin dhe sigurimin tonë.

Meqenëse e dëshirove ngrohtësisht
majën e më të dëshirueshmeve dhe
u lidhe me të nëpërmjet dashurisë,
përshkove përherë me mallëngjim
një jetë të përshtatshme, duke e so-
ditur dashurinë tënde dhe duke u
mbushur me teorinë e tij, o hyzënë.

I martirit Injëti

Asgjë nuk të ndau nga dashuria e Krishtit, as prerja e gjymtyrëve, as kërcënimi i torturave, as shpatë, as vdekje, as zjarr, as uri,³³ o Anastas, që je po në atë tendë me korin qiellor.

Pasi e ngrite fuqishëm mbi supë kryqin tënd, i ndoqe absolutisht porosinë shpëtimtare të Krishtit,³⁴ dhe meqë u bërë imitues i tij⁴ deri në vdekje, o i tërëshkëlqyer, shijon tani shkëlqimin e tij.

Hyjlindësore

Kur kryegjenerali mbërriti nga qielli të ungjillëzoi, o e kulluar, qartazi një hare, duke thënë: Perëndi do të dalë prej teje me mish, o Virgjëreshë e tërëpapakëluar, për shpëtimin³⁵ e atyre që të himnojnë me mallëngjim.

*Ode V**I apostullit: Theós on irinis*

Duke llamburitur si prej pishtari nga rrezatimet e palëndshme të dritës së parë dhe shkaktares së të gjithave, e hijeshove botën me predikim të respektuar, dhe u tregove sheshit ndriçuesi¹ i shpresëtarisë, duke pasur ti fjalë jete,³⁶ o hyjmist i tërëlumur.

Nxënësi i qëndrueshëm i Pavlit të hyjnueshëm shkon pas gjurmëve³⁷ të mësuesit, duke mbjellë te të gj-

thë besnikët mësimdhëniet e tij. Si u udhëhoqëm nëpërmjet tyre drejt dritës së shpresëtarisë, duke mënguar qëmenatë³⁸ të lavdërojmë, o Njeri-dashës.

Pasi u duk Pavli si shkëlqim i dytë, që i shërbente shkëlqimit të parë, na ndriçoi tejprtej me njohurinë e saktë të saj. Bashkushtar i tij u tregua Timotheu, kur u fortifikua si fitimtar me armatimin e tij.

I martirit Injëti

Ai që mburrej pa masë³⁹ më parë, kundërshtari i Perëndisë, që kërcënonte se do ta pushtonte dhenë⁴⁰ dhe më kot tërbohej se do ta zhdukte detin përnjëherë, me bëmat e tua shkelet, o Anastas dëshmor i urtë.

Martiri i Krishtit Anastas, pasi bëri atletikë ligjërisht³² dhe i fitoi çmimet e arritjeve, e merr qartas energjinë e çudive, sepse shëron sëmundje dhe dëbon demonë,⁴¹ duke bërë mrekulli me fuqinë e Krishtit.

Hyjlindësore

Oe Virgjër, me anën e lindjes sate, si e linde për botën bekimin, Krishtin, e asgjësove mallkimin e Evës,⁴² nënës së të gjithëve; për këtë të lumërojmë të ngazëlluar, duke të pohuar me gojë dhe me gjuhë kryesisht si Perëndilindëse.

*Ode VI**I apostullit: Splahnon Ionán*

Oshën Timothe,* si karrocë Zoti ti*⁴³ u shfaqe, sepse para tiranëve* atei-stë krejt* mbaje emrin e tij^{43a} hyjnor, o i hyzën',* duke mos iu trembur egërsisë pra aspak,* sepse* ishe veshur me fuqi* të pamposhtur prej Krishtit Zot⁴⁴ Shpëtimtar.

Prite, Timothe,* një kuror' të hijshme nur,* apostull hyjmen-dës, plot i pasur ti;* ke në kreun tënd* denjësisht krejt një rreth mbretërie⁴⁵ edhe,* o i lumur, pranë fronit zotëror qëndron*^{45a} duke* pasur gaz me Pavlin tok* brenda tendësh në qiell me çdo shijim.

Kur nuhate thell'* miron shpirtërore krejt* të Krishtit të zmbra-psur⁴⁶ mishërisht për ne,*⁴⁷ e kungove ti* kundërmimin e tij; e përçove pa-staj* tek ata që rendin pranë teje me besim* edhe* e shpërndave mendërisht,* Timothe shenjt, mist i të pathënave.

I martirit Injëjti

Dole fitimtar* në luftim, tiranin mund,* i feksur urtisht me lavd që kryqi ka* dhe shpërbëre pra* errësi-rë mashtrimi dhe more me gaz,* o i gjithëlavdëruar Anastas martir* i urt',* ti trofe dhe po kërcen* me ushtri qiellore dëshmorësh lart.

Hyjlindësore

Çdo kor profetik* me hyjfrymëzim nga lart* prej Zotit e kishte parathë-në drejt* gjith' misterin tënd,* pra të zënies hyjnore që nuk shprehet dot;* zure Fjalën Perëndi, o Virgjëreshë-nën',* se ti* na zbulove një mendim,* pra vendimin e lashtë dhe të vërtet'.⁴⁸

Irmosi: Splahnon Ionán

»**S**i profeti shën Jona, pasi u gëlltit
»në det prej peshkut të madh doli
»dhe nuk u nga, gjithashtu tani,
»edhe Fjala e q'ellit Jisuj shpëtimtar
»shkoj nga gjir' i Virgjëreshës dhe
»Hyjlindëses, se u mishërua pa pësim
»edhe nënën e la të pac'nueshme.*

Kontaqi

Ting. I Horós angjelikós (=Ton tafon su Sotír)

Çdo besimtar himnim* t'i ofrojë ko-legut* në udhë, nxënësin mjaft të hyjshëm të Pavlit,* dhe tok me të ta lavdërojm' Anastasin e urtë ne;* feksi porsi yll* kur nga Persia na lindi;* veset, çdo pasion* në shpirt, si edhe sëmundjet* trupore na i dëbon.

Shtëpia

Si një peshkatar me përvojë shumë të madhe Pavli, apostulli i madh, shtriu më parë rjetat e Hirit dhe e tërhoqi si gjah të shenjtë Timotheun hyjfolës; dhe së bashku me të duke rrethuar anët e kozmosit, hoqi nga fa-

ringu i djallit ata që pranuan fjalën e besimit,⁴⁹ midis të cilëve ishte edhe Anastasi trim; sepse sapo besoi, la mashtrimin e tërë të persianëve dhe e mbajti mbi supe emrin e Krishtit,^{43a} pra veset, çdo pasion në shpirt, si edhe sëmundjet trupore na i dëbon.

Sinaksari

Më 22 të të njëjtit muaj, kujtimi i apostullit të shenjtë Timothe, nxënës i apostullit të shenjtë Pavël.

Vargje: Nga dashuria për kurora hyjnore, Timotheu,/ kur u rrah me shkopinj, ngjyrosi dheun me gjak. Më njëzet e dy u lartësua fryma e Timotheut.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i oshënarit martir të shenjtë Anastas persiani.

Vargje: Anastasi zbukurohet duke mbajtur/ lakun në qafë si varëse të shkëlqyer.

Më njëzet e dy Anastasi vuajti lakun.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirëve të shenjtë, Manueli, Gjergji, Petro, Leoni, Sioniu, Gabrieli, Joani, Leoni, Parodhi dhe 377 të tjerë.

Vargje: Shpatë e pret në dy pjesë Manuelin,/ që nderonte dy esenca të paprera të Krishtit.

Gjergjin dhe Petron që kishin adhurim të përbashkët,/i presin bashkarisht për hir të Zotit të përbashkët.

Leoni e kishte gatishmërinë të parrëfyeshme,/ kur shpata e çante barkun

e tij.

Kur u shtri shpatë afër qafës,/ frika ishte larg nga Gabrieli dhe larg nga Sioniu.

Joani dhe Leoni, trima me të vërtetë, ishin gjeneralë/ që nuk e kishin frikë shpatën.

Kur u qëllua Parodhi me gurë nga shumë duar,/ kaloi me kënaqësi udhën e jetës.

Kur shpatë vrau triqindëshin,/ i bashkoi ata me 77 persona.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atit tonë oshënar Josif Samaku i Shenjtëruar.

Me ndërmjetimet e tyre të shenjta, o Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII

I apostullit: Se noitín Theotoqe

O hyjmist i lumur Timothe, meqenëse ubëredenjesisht bashkëlodrues me rendin qiellor, bashkëdëfrehesh me hare duke u mbushur me lavdi dritëdhënëse dhe e manifeston Perëndinë e himnueshëm dhe të përmbilavdëruar.

Duke e celebruar Ungjillin⁵⁰ e Krishtit nga lartësia e viryeteve, Pavli tejet i hyjshëm të dërgoi i ngazëlluar letra të hyjshkruara ty, si nxënës, o Timothe, duke manifestuar Perëndinë e himnueshëm dhe të përmbilavdëruar.

Dobësinë e mishit⁶ e forconte nervi i shpirtit, sepse pasi u solle si pa trup mbi tokë, u bëre martir duke u thyer në kokë, o celebrues i hyjlumur i mistereve të Perëndisë.

I martirit Injëti

Atleti, duke treguar shembull të qartë trimërinë e vet, i nxit besimtarët që të imitojnë tani pësimin hyjnor vullnetar që duroi për ne Perëndia i himnueshëm dhe i përmbilavdëruar.

Prej dashuruesve të shpresëtarisë Trinia besohet e barabartë në fuqi, sepse atletët trima luftuan për hirin e saj duke derdhur gjakrat, duke bërë mundje martirike, duke dorëzuar shpirtrat qartësisht dhe duke u vrrarë.

Hyllindësore

Gëzohu, o e thjeshtë, gëzofi i Adamit nga doli Bariu⁵¹ i përmbilartësuar kur me të vërtetë më veshi mua, njeriun e tërë, nga dhembshuria e pakuptueshme, Perëndia i himnuar dhe i përmbilavdëruar i etërve.

Ode VIII

I apostullit: Thávmatos iperfiús

U tregove i denjësuar për qëndrim engjëllor, o Timothe i lumur, sepse kur i njohe mistikisht dhe përmbinatyrshëm rreshtimet e qiejve, e imitove shkëlqimin e tyre, o i urtë; me ta këndon duke dëfryer: Le ta

bekojë Krijesa e tërë Zotin dhe le ta përmbilartësojë në gjithë jetët.

U pe si apostull, o hyjmenës, i veshur nga lart²⁶ me fuqinë që u erdhi në një mënyrë të huaj nxënësve, dëshmitarëve okularë të Fjalës,⁵² o Timothe; me ta këndon duke u ngazëlluar: Le ta bekojë Krijesa e tërë Zotin dhe le ta përmbilartësojë në gjithë jetët.

Meqenëse arrite në majën më të skajshme të të mirave, plotësive dëshirën faqeza, o Timothe i tërëlumur, gjithmonë hyjpredikues, duke llamburitur fuqishëm prej dritës së Trinisë; dhe tani këndon duke dëfryer: Le ta bekojë Krijesa e tërë Zotin dhe le ta përmbilartësojë në gjithë jetët.

I martirit Injëti

O martir Anastas, nga toka fluturove i kurorëzuar drejt qiejve, pasi u arratisë nga gjithë mashtrimi i demonëve dhe shkele adhurimet e idhujve; për këtë dhe tani duke ngazëlluar thërrret: Le ta bekojë Krijesa e tërë Zotin dhe le ta përmbilartësojë në gjithë jetët.

O dëshmor i tërëpasur Anastas, e ngjyrose me gjakrat e tu martirikë mantelin tënd, dhe duke mbajtur si skeptër simbolin e kryqit, mbretëron së bashku me Krishtin⁵³ në jetët;

dhe tani duke dëfryer këndon: Le ta bekojë Krijesa e tërë Zotin dhe le ta përmbilartësojë në gjithë jetët.

Hyjlindësore

Fjala e pasur që lavdërohet me himnime kryeengjëllore, u varfërua për ne⁵⁴ kur të zgjodhi ty nënë, bukurinë e Jakovit;⁵⁵ për këtë duke të përhimnuar thërrasim: Le ta bekojë Krijesa e tërë Zotin dhe le ta përmbilartësojë në gjithë jetët.

Irmosi: Thávματος iperfiús

»**F**urra vesëplotë na tregoj një she-
»mbull të çudisë që shkeli natyrën;
»se ajo s'i dogji Tre Djemat që priti,
»ashtu dhe zjarri i qiellit s'e ngau
»Virgjëreshën aspak. Pra, le ta hi-
»mnojm' e le t'i falemi, e bekonit të
»gjithë Zotin me zë të madh dhe e
»lartësoni përmbi të gjithë jetët.⁵⁶*

Ode IX

I apostullit: Tipon tis agnís lohias su
Thënia* e Davidit mbret u mbush:*
Në botë si rrufe u duke⁵⁷ edhe shkël-
qen,* o shën Timothe,* i fortkënduar,
shenjtor i lum,* anëmbanë planetit,
ndaj pa pushim* të madhërojm',
hyjshfaqës,* si dhe nderojmë predi-
kimin tënd.

Mbusur* ishe me lavdi që vjen,*
i tërëurt' hyjmist, nga drita e parë
ti;* ke qen' qartësisht* brenda

shkëlqimit tridiellor* me pushtet Pe-
rëndie; sa të himnojn',* nga terri, o
i lumur,* i shkëlqeve shpëtoji, shenjt
me nder.

Duke* u mbështetur, o Krisht
Zot,* në mësimdhëniet e apostujve
të mëdhenj,* të Pavlit hyjnor,* që
predikoi ekonomin',* gjithashtu të
hyjmendësit Timothe,* me të drejt'
të mendojmë* të barabart' me Atin
dhe Shpirtin.

I martirit I njëjti

Shove* me rrëke nga gjaku yt,*
o i lavdishëm, gjith' mashtrimin e
idhujve,* tërësisë pra* të Kishës so-
në i dhe gëzim;* për atë pa pushim
lype Zotin Krisht,* o i shkëlqyer shu-
më,* që të të lumërojmë gjithë ne.

Sa lavd* përmbi fjalë, sa shkëlqim*
të parrëfyeshëm, të hyjshëm, që ke
vërtet;* garove në të* si fitimtar,
Anastas, kështu* pranë Zotit Krisht
rri;^{45a} përgjëroju ti,* lutju tani për ne
pra,* që të nderojmë thellësisht me
himm.

Hyjlindësore

Cila* Virgjëresh' Hyjlindëse,* është
çudia jote, se Perëndinë Fjal'* pa
fare shpjegim* e linde dhe na zbulo-
ve ti* një mister që ish fshehur që
në fillim,* para çdo brezi, kohe*⁵⁸ në
Zotin, Bërësin e kozmosit.

Irmosi: Tipon tis agnis lohias su

»Barrën* tënde të kulluar ja*
»si tip na dha një ferr' e zjarrtë që
»s'digjej dot;*⁵⁹ kërkujmë tani* të
»shuash furrën e ngasjeve,* se ajo
»egërsohet keq kundër nesh,* që të
»të madhështojmë* gjithmonë pa
»pushim, Hyjlindëse.

Dërgimësore

Jinekes akutisthite

Si dritë dyshja na u shfaq* dhe sot
shkëlqen me vezullim,* po llamburit
çdo Krijesë* më hijshëm se nga
dielli:* Shën Timothe apostulli,* i
bashk'fronshëm me Nxënësit* dhe
Anastas i hyjshëm tok,* gëzim i mur-
gjeve, me plot lavd,* nder i martirëve,
mburrje.

Hyjlindësore

Hyjnënë pa qortim aspak,* jehonë
dhe dëgjim i madh* je për apostujt,
martirët,* profetët dhe oshënarët;*
Birin dhe Perëndinë tënd* zbutë të
ketë dhembshuri* për ne shërbyesit
e tu,* Hyjlindëse, kur të ulet* të na
grykojë⁶⁰ siç duhet.

Pasvargje të Oktoihut

Pastaj psalim Idhiomelin

Ting. I

Varg: I çuditshëm është Perëndia në
shenjtorët e tij.

Atletin trim Anastas, që luftoi mirë
për shpresëtarinë, ejani, o popuj, që

ta himnojmë duke thënë: Gëzohu,
o luftëtari i qëndrueshëm i besimit
sipas profetëve dhe apostujve; gëzo-
hu, ti që duke pasur Krishtin brenda
vetes e imitove Pavlin⁴ në vepër;
gëzohu, limani i padimëruar i të mu-
nduarve; gëzohu, krenaria jonë dhe
ngazëllimi i botës.

Lavdi

Ting. Tërth. I I Studhimit

O atë oshënar, u bërë fitimtar
midësh dhe kaldejsh mendorë, kur
e rrëzove mashtrimin e tërë të Babi-
lonisë me fuqinë e kryqit; nuk u tër-
hoqe nga kënaqësitë e lëmuara, nuk
u frikësive nga zjarri i ngasjeve; për
këtë Krishti Perëndia ynë të kurorë-
zoi me kurora fitimtare; dhe tani
duke qëndruar bashkë me engjëj,
përgjëroju Zotit, duke i kërkuar për
kozmosin paqe dhe për shpirtrat ta-
në përdëllimin e madh.^{1a}

Tani *Hyjlindësore*

Hëris askitikón

G'zohu, o pëllumbeshë me hir,*
krahëpruar⁶¹ virgjërisë,⁶² o turtu-
llesh',* e bukur, dhe dallëndyshe e
zgjedhur dhe harabel* krejt i pastër,
⁶³ shqerrë që në shtatzëni* në mitër
e kishe ti* qengjin e Perëndisë
Zot,*⁶⁴ mëshqerr' hyjnore,* mbajte
fort zgjedhën e atij* që mban përg-
gjithnjë* fajin tonë,⁶⁵ je dhe har-
dhi* tepër e frytshme që po mbin
bistakun e shprestaris',* i cili verë të

hyjshme martirizimi na e buron;* atë lyp t'u jepet* përdëllim i madh^{1a} dhe hir shërbëtorëve të tu.

ose Kryqhyjlindësore

Kur pranë Kryqit tënd, o Jisu,* qëndroi nëna jote thërriste me vajtim* dhe klithma: O Bir, s'duroj kur të shoh të ngulesh mbi dru,* unë që të linda; se pa pasur burr'* në lindje shpëtova krejt* nga çdo dhimbje; dhe si tani* shtrëngohem, heq keq* nga çdo vuajtje, shqyhem krejt* brenda zemrës un'* që qortim nuk kam; tashmë pra* fjala që Simeoni tha përmbushet se shpat' kalon* dhe depërton zemrën time.³¹ Por ti, o Bir, ngjallu dhe shpëto* sa të përhimnojnë,* e lëvdojnë dhembshurinë, mëshirën që ti ke.

Dhe të tjera si zakonisht.

CITIME

¹ Fil. 2.15

^{1a} Num. 14.19 etj.

² Ps. 35(36).9

³ II Petr. 1.2

⁴ I Kor. 11.1; Ef. 5.1; I Thes. 1.6

⁵ II Kor. 12.9

⁶ I Tim. 5.23

⁷ Ef. 6.15

⁸ Hebr. 12.4

⁹ Hebr. 2.17

¹⁰ Ps. 2.6; II Petr. 1.18 etj.

¹¹ Matth. 7.13-14

¹² I Tim. 1.19

¹³ Vep. 9.15

¹⁴ II Tim. 4.7

¹⁵ Is. 40.3; Matth. 3.3; Mark. 1.3; Lluk. 3.4; Joan 1.23

¹⁶ Ps. 18(19).6-7

¹⁷ Ps. 44(45).3

¹⁸ Naum 2.1(1.15); Is. 52.7; Rom. 10.15

¹⁹ Fil. 4.7

²⁰ Rom. 5.10; II Kor. 5.18

²¹ Gal. 5.24; Kol. 3.5

²² IV Makk. 7.18; 16.2

²³ Ps. 18(19).5

²⁴ Hebr. 12.4

²⁵ Gal. 4.4

²⁶ Lluk. 24.49

²⁷ I Mbret. [Sam.] 2.2; II Mbret. [Sam.] 7.22; I Kor. 2.8

²⁸ Vep. 13.5; 15.36; 16.17

²⁹ II Tim. 1.10

³⁰ Lluk. 1.48

³¹ Lluk. 2.35

^{31a} Joan 10.15,17-18

³² II Tim. 2.5

³³ Rom. 8.35,39

³⁴ Matth. 16.24; Mark. 8.34; 10.21; Lluk. 9.23

³⁵ Lluk. 1.26-35

³⁶ Fil. 2.16

³⁷ I Petr. 2.21

³⁸ Is. 26.9

³⁹ II Kor. 10.13,15

⁴⁰ Is. 10.14

⁴¹ Matth. 10.8

⁴² Gjen. 3.16

⁴³ Ps. 67(68).18

^{43a} Vep. 9.15; Apok. 2.3

⁴⁴ Ef. 6.10-11

- ⁴⁵ Urt. Sol. 5.16
^{45a} III [I] Mbret. 18.15; IV [II] Mbret. 3.14
⁴⁶ Kënga 1.3
⁴⁷ Fil. 2.7
⁴⁸ Is. 25.1
⁴⁹ I Tim. 4.6
⁵⁰ Rom. 15.16
⁵¹ Matth. 26.31; Mark. 14.27; Joan
10.11; Hebr. 13.20; I Petr. 2.25; 5.4
⁵² Vep. 2.2
⁵³ II Tim. 2.11-12
⁵⁴ II Kor. 8.9
- ⁵⁵ Ps. 46(47).5
⁵⁶ Dan. kap.3 Lutja e Azarias 25-26
⁵⁷ Ps. 76(77).19; 96(97).4
⁵⁸ Kol. 1.26
⁵⁹ Eks. 3.2-5
⁶⁰ Dan. 7.9-10
⁶¹ Kënga 2.10,13,14; 5.2; 6.8
⁶² Ps. 67(68).14
⁶³ Jer. 8.7
⁶⁴ Is. 53.7; Joan 1.29,36; Vep. 8.32;
I Petr. 1.19
⁶⁵ Is. 53.4



MË 25 TË TË NJËJTIT MUAJ

Kujtimi i atit tonë ndër shenjtorët Grigor Theologut.

Tipikon

1. Nëse bie në një nga të dielat para Triodhit:

Të shtunë në Mbrëmësore, Thirrtores: 6 ngjallësore dhe 4 të shenjtit (3 të parat, duke përsëritur të parën). Lavdi i shenjtit. Tani Hyjlindësore dogmatike e tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimëni. Leximet. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi i shenjtit. Tani ngjallësor (Virgjëresh' e panusëruar). Përlëshoret: ngjallësore dhe të shenjtit.

Të diel, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmi 50, Kanuni Triadik, Litia e shenjtit dhe Himne Triadike. Trishenjtë. Përlëshorja e shenjtit. Në Mëngjesore, Ndenjësores ngjallësore. Pas Polieleit, Ndenjësores (pas Polieleit) e shenjtit. Bekimtores. Ipakoia. Shkallesat dhe Proqimëni i tingullit. Kanunet: ngjallësor dhe një i shenjtit. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia ngjallësore, dhe Ndenjësores e shenjtit. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e shenjtit, dhe Sinaksari. Zbritësoret Fundin edhe burimin; dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor. Më të nderuarën. Dërgimësoret: ngjallësore, e dyta e shenjtit dhe Hyjlindësorja e tij. Lavdërimet: 4 ngjallësore dhe 4 të shenjtit. Lavdi i shenjtit. Tani E përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji, Tipiket. Lumërimet: 4 të tingullit dhe 4 nga Ode VI e shenjtit. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore, e shenjtit dhe e kishës. Kontaqi Ti që e shenjtërove. Apostulli i shenjtit dhe Ungjilli i së dielës. Kungatore Lavdëroni.

2. Nëse bie të Dielën e Tagrambledhësit dhe të Fariseut:

Të shtunën në Mbrëmësore, Thirrtores: 4 ngjallësore, 2 të Triodhit dhe 4 të shenjtit (3 të parat duke përsëritur të parën). Lavdi i Triodhit. Tani Hyjlindësore dogmatike e tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimëni. Leximet e shenjtit. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi i shenjtit. Tani i Triodhit. Përlëshoret: ngjallësore dhe të shenjtit.

Të dielën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmi 50, Kanuni Triadik, Litia e shenjtit dhe Himne Triadike. Trishenjtë. Përlëshorja e shenjtit. Në Mëngjesore, Ndenjësores ngjallësore. Pas Polieleit, Ndenjësores (pas Polieleit) e shenjtit. Bekimtores. Ipakoia. Shkallesat dhe Proqimëni i tingullit. Kanunet: ngjallësor, i Triodhit dhe i pari i shenjtit. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia ngjallësore, dhe Ndenjësores e shenjtit. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e Triodhit, dhe Sinaksari i shenjtit si dhe i Triodhit. Zbritësoret Fundin edhe burimin; dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor. Më të nderuarën. Dërgimësoret: ngjallësore, e Triodhit, e dyta e shenjtit dhe Hyjlindësorja e tij. Lavdërimet: 3 ngjallësore, 2 të Triodhit dhe 3 të shenjtit. Lavdi i Triodhit. Tani E

përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji, Tipiket. Lumërimet: 4 të tingullit dhe 4 nga Ode VI e Triodhit. Pas Hyrjes Përlëshoret: ngjallësore, e shenjtit dhe e kishës. Kontaqi Ti që e shenjtërove. Apostulli i shenjtit dhe Ungjilli i së dielës. Kungatore Lavdëroni.



NË MBRËMËSOREN E VOGËL

6 Thirrtores

Ting. IV Os jeneon en mártisin

O Grigor Theolog, me gojën dhe me gjuhën tënde theologe e zbulove Perëndinë e bashkëqenshëm që himnohet në Trini, Atin, Birin dhe Shpirtin e Shenjtë, dhe e thave marrëzinë dhe gënjeshtrenë e grekëve, duke predikuar të vërtetën me fjalët e tua hyjfolëse.

Edhe pamja jote është e çmuar, edhe paraqitja e respektuar, o Grigor i hyjshëm; për këtë të nderojmë me melodi të gëzueshme dhe themi: Gëzohu, o yll mendor që shkëlqen anembanë me llamburitjen e fjalëve të tua të urta; gëzohu, o trumbetë që ia shpalle kozmosit porositë e Jisuit.

Instrumentin me shumë zë, kitarën muzikore, harpën melodioze dhe të këndshme, më të lartin e hierarkëve, mësuesin e madh të Kishës së Krishtit le ta lartësojmë duke kënduar: Gëzohu, o thellësia e Hirit hyjnor, gëzohu, o lartësi kuptimesh qiellore, o

ati i Etërve Grigor.

O i hyjfrymëzuar, me hobënë e fjalëve të tua të perëndishme qëllëve fuqishëm si ujk Ariosin, o i tërëlavdishëm, dhe e dëbove larg nga kopeja e Krishtit ti, bariu i gjithëshkëlqyer, duke u kujdesur për delet e tua në kullotën¹ e Trinisë; për këtë të nderojmë, o bariu i barinjve Grigor.

Me ç'fjalë lavdërimesh, o i barabartë me engjëjt, të të kurorëzojmë ty që jetove mbi dhë përmbi çdo njeri, predikuesin e Fjalës Perëndi, mikun e sinqertë të së Virgjërës së kulluar, të bashkëfronshmin me apostujt, bukurinë e martirëve dhe oshënarëve, adhuruesin hyjnor të Hyjnisë pa fillim, o kryepriift tepër i shenjtë?

Kur u ngjite në mbretëritë e larta siç aspirove, more tani shpërblimet e mundimeve të tua nga Krishti tërëmbret, o Grigor i gjithëlumur; para tij duke qëndruar^{1a} kujtona ne që kremtojmë kujtimin tënd të përmbishkëlqyer, që të denjësohemi për to edhe ne që e adhurojmë Krishtin Pe-

rëndi.

Lavdi *Ting. Tërth. II*

Kryetarin e hierarkëve, lavdinë e patriarkëve, mistin e dogmave dhe të kuptimeve të Krishtit, mendjen e skajshme, duke u mbledhur, o hyjmendës, le ta himnojme me lavdërime shpirtërore duke thënë: Gëzohu, o burim thelogjie, lumë urtësie dhe krua diturie hyjnore; gëzohu, o yll tepër i ndritshëm, se e shkëlqen tërë rruzullin² me dogmat e tua; gëzohu, përluftar i madh i besës së mirë dhe dëbuesi trim i keqbesimit; po, o i gjithurtë Theolog Grigor, mos pusho së ndërmjetuari pranë Krishtit Perëndi për ata që me besë dhe mall e kremtojnë gjithmonë kujtimin tënd të perëndipëlqyeshëm dhe të nderuar.

Tani *Hyjlindësore*

O Hyjlindëse, ti je hardhia e vërtetë,^{2a} që nxore frytin e jetës; të lypim ndërmjeto, o Zonjë, bashkë me hierarkun dhe me gjithë shenjtoret, që të mëshirohen shpirtrat tanë.

Pasvargje

Ting. II Ikos tu Efrathá

Ejani, o të dashuruar pas urtësisë³ së perëndishme, ta himnojme Theologun e hyjshëm duke thirrur: Gëzohu, o Grigor i urtë.

Varg: Goja ime do të flasë urtësi dhe

studimi i zemrës sime mençuri.

Gojën e hyjshme, gjuhën theologe, mendjen e shenjtë të Grigorit të urtë le t'i himnojme të gjithë, o hyjmendës.

Varg: Dëgjoni këto gjithë kombet.

Tryezën mistike të fjalëve të tij të hyjihshme e hijeshoi⁴ për të gjithë Grigori i madh. Ejani, o besëmirë, të shijojmë.

Lavdi *Ingjashëm*

Theologu i hyjshëm na mësoi të besojmë Trininë e nderuar, Atin, Fjalën, Shpirtin, një Perëndi të pandarë.

Tani *Hyjlindësore*

Theologu i madh na mësoi të të besojmë si nënë Perëndie, ndërsa Birin tënd si Perëndi, o Mari nënëvirgjëreshë.

Përlëshore

Fyelli baritor i thelogjisë.



NË MBRËMËSOREN E MADHE

*Pas Qëndrimit të parë të Psaltritit
(Lum ai njeri),*

Thirtore

Ting. I Panëfimi mártires

O atë Grigor, s'mbuloi dot* varri që humb në harrim,* buzët e tua, se gojë theologe ti u pe* publikisht për

dogmat* e shpresëtarisë dhe tani ia thua botës me zë të madh; ndaj përgjërohu ti* të dhurohet paqe dhe mëshir',* hir për shpirtrat tanë, përdëllim i madh.^{4a}

O atë Grigor, u shmange ti* urtësisht nga tinëzi,* armiqësia e mishit dhe kur hipe mbi karroc'* katër kuajsh pra lart,* mbi virtytet⁵ tër' drejt së pashprehshme bukuri fluturove;⁶ me të mbushesh, dhe tani,* o i shenjtë, shpirtrave u jep* ndjesë, paqe edhe përdëllim të madh.^{4a}

O atë Grigor, u bëre ti* ndërmjetues besëtar* me hir midis njerëzve dhe Perëndisë;⁷ dhe tani,* pasi Krishtin, Zotin* ta kesh zbutur ti me lutjen tënde plot fuqi, mos pusho së ndërmjetuari, o shenjt* oshënar, t'u jepet shpirtrave* ndjesë, paqe edhe përdëllim i madh.^{4a}

Thirrtoje të tjera

Ting. II Piis efimión

Çdokush* me melodi të hyjshme* ta lëvdojë hyjfolësin, syrin* aq të shpejt' të Hirit, gojën e urt'* të Shpirtit, ndriçuesin si yll* të planetit,² dhe dëgjimin e madh* në Kish',* krenarinë krejt të admirueshme* për ne* orthodhoksët, kroin e teologjis',* lumin e pashtershëm kurrrë,* që gjithnjë rrjedh dogmat* e hyjnueshme, burimin,* i cili gufon

rrëke* hyjnore, ushqimin zotëror.

Sot ne* me mallëngjim shpirtëror* ta himnojm' hierarkun që ishte* në jet' si apostujt, luftues pra* për fe të drejt', oqean i madh* të doktrinave hyjnore, rryma,* rrëke* kaq e ëmbël e mësimdhënies së shenjt'* edhe* siguri e fjalëve fort të larta,* buzët që si bubullima* na gjëmojnë, gjuha* që fryn zjarr, thesari i madh* urtiplot, stoli për ne* besnikët, që na shpall ne Fjalën.

Gjith' ne* ta lavdërojmë me himn* Theologun, sipas detyrimit,* rojen e kopesë së Krishtit Zot,* të urtin gjah-tar të ujqërve,* shkulësin e egjrave të dëmshme,* si dhe* të çuditshmin mbjellës të dogmës së drejt',* që shporr* me hov heretikët, shumëzoi pra* me vigjilencë të hyjshme* dhe vërtet siç duhej,* çdo talent⁸ që i dha Krishti;* na shndriti planetin mbar'* me shndritje hyjnore në mësim.

Lavdi

Ting. Tërth. IV I Anatoliut

Gjuha jote e shpejtë për mësimdhënie jehon në veshët e zemrave dhe i ngre shpirtrat e përtacëve; dhe nëpërmjet fjalëve hyjfolëse gjendet si shkallë që i lartëson drejt qiellit⁹ ata që janë nga toka; për këtë, o Grigor Theolog, mos pusho së ndërmjetuari pranë Krishtit Perëndisë, që të shpëtohen nga rreziqet shpirtrat tanë.

Tani *Hyllindësore*

Mmbret i qiejve u duk mbi dhé nga njeridashja dhe u shoqërua me njerëzit;¹⁰ se duke marrë trup prej Virgjëreshës së pastër lindi prej saj me këtë mishërim; dhe është një bir i dypalëshëm nga natyra, por jo nga substanca, prandaj duke e lëçitur Perëndi perfekte dhe njeri perfekt, me të vërtetë rrëfejmë Krishtin, Perëndin' tonë; atij lutju, o nën' e panusëruar të mëshirohen shpirtrat tanë.*

Hyrje. O dritë gazmore. Proqimëni i ditës dhe Leximet.

Këndimi i Fjalëve të Urta
(10.6-7; 3.13-16; 8.35 etj.)

Kujtimi i të drejtit është me lavdërimi dhe bekimi i Zotit mbi kryet e tij. Lum njeriu që gjeti urtësi dhe i vdekshmi që njohu mençuri; sepse është më mirë ta tregtosh atë, se thesare ari dhe argjendi. Dhe është më e vyer se gurët e çmuar; dhe çdo gjë e çmuar nuk është e barasvlefshme me të; sepse nga goja e saj del drejtësi, ndërsa ligj dhe mëshirë mban në gjuhë. Prandaj më dëgjoni, o fëmijë, sepse do të them *gjëra* modeste; dhe lum njeriu që do të ruajë udhët e mia; sepse daljet e mia *janë* dalje jete dhe përgatitet vullnet nga Zoti. Prandaj ju lutem dhe u lëshoj zërin tim bijve të njerëzve; se unë, urtësia, bëra mendim dhe

dituri, dhe kuptim unë thirra. I imi është mendimi dhe siguria, e imja mençuria, e imja edhe fuqia. Unë ata që më duan i dua, ndërsa ata që më kërkojnë do të gjejnë hir. Kuptoni pra, o të patëkeq, zgjuarsi dhe ju, o të paedukuar, futeni zemrën. Më dëgjoni përsëri, sepse do të them *gjëra* modeste dhe nga buzë *unë* hap *gjëra* të drejta. Sepse do të studioj *një* të vërtetë laringu im, ndërsa të neveritshme janë para meje buzë të gënjeshtërtë. Me drejtësi *janë* gjithë fjalët e gojës sime, brenda këtyre *s'ka* asgjë të shtrembër, as të zhdrejtë. Të gjitha janë të drejta për ata që kuptojnë dhe korrekte për ata që gjejnë dituri; sepse ju mësoj *gjëra* të vërteta, që të bëhet në Zotin shpresa juaj dhe që të mbusheni me shpirt.

Këndimi i Urtësisë së Solomonit
(4.7-15)

I drejti, nëse do të arrijë të vdesë, do të jetë në prehje; se pleqëria e çmuar nuk është pleqëria shumëvjeçare, as u mat me numër vitesh. Dhe thinjat janë mençuri te njerëzit dhe mosha e pleqërisë është jetë e panjollësor. Meqë u bë i pëlqyeshëm te Perëndia, u dashurua, dhe ndërsa jetonte në mes mëkatarësh, u transferua. U rrëmbye, që e keqja të mos ndryshojë mençurinë e tij ose dinakëria të mos mashtrrojë shpirtin e tij. Sepse joshja e së keqes errëson

të mirat dhe ëndja e dëshirimit e ndryshon mendjen e patëkeq. Duke u përsosur në pak kohë, mbushi vite të gjata. Se shpirti i tij ishte i pëlqyeshëm në Zotin, prandaj vrapoi nga mesi i ligësisë. Por popujt duke parë dhe duke mos kuptuar, as duke mos vënë në mendje një gjë të tillë; sepse *ka hiri dhe mëshirë ndër të zgjedhurit e tij dhe mbikëqyrje ndër oshënarët e tij.*

Këndimi i Urtësisë së Solomonit

(Përzgjedhje)

Goja e të drejtit pikon urtësi, ndërsa buzë burrash dinë hire. Goja e të urtëve studion urtësi dhe drejtësia i shpëton nga vdekja. Pasi mbaroi një burrë i drejtë, nuk humbet shpresë, sepse lindet bir i drejtë për në jetë dhe në të mirat e tij do të vjelë fryt drejtësie. Dritë *do të jetë* te të drejtët përgjithmonë dhe nga Zoti do të gjejnë hiri dhe lavdi. Gjuha e të urtëve di të mira dhe në zemrën e tyre do të prehet urtësi. I do Zoti zemrat oshënares dhe të pranueshëm prej tij *janë* gjithë të paqortueshmit në udhë. Urtësi Zoti ndriçon fytyrë të mençuri; sepse arrin tek ata që e dëshirojnë para se të njihet dhe me lehtësi vëzhgohet nga ata që e duan. Ai që mëngoi për atë nuk do të lodhet dhe ai që nuk fjeti për atë, shpejt do të jetë pa merak; sepse ajo lëviz rreth e rrotull duke kërkuar të denjë për atë, dhe në rrugë u shfaqet atyre me

dashamirësi. Asnjëherë nuk do të mbizotërojë mbi urtësinë ndonjë e keqe. Prandaj dhe u bëra i dashuruar pas bukurisë së saj dhe e desha, dhe e kërkova që prej rinisë sime, dhe kërkova ta marr nuse për veten time; sepse Zoti i të gjithave e deshi atë; sepse është njohëse e mistereve të diturisë së Perëndisë dhe zgjedhëse e veprave të tij. Lodhjet e saj janë virtyte dhe ajo *na* mëson mençuri dhe urtësi, drejtësi dhe burrëri, nga të cilat asgjë *tjetër* nuk është më e vlefshme në jetë për njerëzit. Dhe nëse dikush aspiron eksperiencë të shumtë, di të lashta dhe të supozojë të ardhshmet. Di me saktësi strofa fjalësh dhe zgjidhje enigmash. Paranjeh çudi dhe mrekulli, dhe përfundime kohërash dhe motesh. Dhe për të gjithë është këshilltar i mirë; sepse ka pavdekësi në të dhe lavdi në shoqërinë e fjalëve të saj. Prandaj shkova te Zoti dhe iu luta, dhe thashë me gjithë zemrën time: O Perëndi i etërve dhe Zot i mëshirës, që i bëre të gjitha me fjalën tënde dhe që me urtësinë tënde e bëre njeriun që të zotërojë mbi krijesat që u bënë prej teje dhe që të drejtojnë botën me oshënarë dhe drejtësi, jepmë mua urtësinë që ulet pranë froneve të tua dhe mos më shpërfill nga shërbëtorët e tu; sepse unë *jam* shërbëtori yt dhe biri i shërbëtores sate. Dërgoje atë nga banesa jote e shenjtë dhe nga froni i lavdisë sate,

që duke qenë bashkë me mua të më mësojë se çfarë është e pëlqyeshme para teje, dhe që të më udhëheqë në dituri dhe të më ruajë në lavdinë e saj; sepse mendimet e të vdekshmëve janë të gjitha frikacake dhe të pasigurta idetë e tyre.

Në Liti Idhiomele

Ting. I Të Anatoliut

Me punë të perëndishme, pasi i pastrove që më parë ligjërisht trupin tok me shpirtin, iu afrove malit të thelogjisë duke i mësuar misteret hyjnore, o hyjshfaqës Grigor; dhe kur u fute nën errësirën e paperëndueshme, e pranove legjislacionin e hyjshtypur, shkrimin¹¹ për Trininë e bashkëqenshme, të cilës i falemi me anën tënde dhe themi duke përhimnuar: Njësi që njihesh në Triadhë, mëshirona.

Injëti

Kur e çele gojën tënde për fjalën e Perëndisë, e tërhoqe Shpirtin¹² e urtësisë, dhe pasi u mbushe me hir,¹³ gjëmove dogmat hyjnore, o Grigor i trillumur; dhe kur i mësove misteret hyjnore tok me ushtritë engjëjlore, e shpalle dritën e trifishtë dhe të pandarë; për këtë, të feksur prej fjalëve të tua të hyjshme, i falemi Trinisë që njihet në një Hyjni, për shpëtimin e shpirttrave tanë.

Injëti

Me gjuhën tënde të zjarrtë, o hyjfolës Grigor, i dogje lloomotitjet e here-tikëve kundër Zotit; me të vërtetë u dallove si gojë e hyjshme që foli në Shpirt madhështitë e Perëndisë¹⁴ dhe që hartoi me germa esencën e bashkëfuqishme të Triadhës së fshehur në mistere; dhe e shkëlqeve në mbarë rruzullin dritën tridiellore; dhe ndërmjeton pa pushim për shpirtat tanë.

Lavdi Ting. I

Me punë të perëndishme (*Tropari i parë i Litisë*)

Tani Hyjlindësore

Meqë pranon lutjet e mëkatarëve dhe nuk shpërfill rënkimin e të pikëlluarve, ndërmjeto tek ai që lindi nga barku yt i dëlirë, që të shpëtohemi, o Hyjlindëse e virgjër.

Pasvargje

Ting. Tërth. I Heris askitikón

G'zohu, burim plot thelogji,* bane-së je për teorinë e lartë ti* që si e hetove fundin e sipërm në thellësi*¹⁵ me mendim besnik krejt predikove fort,* u shpalle të gjithëve* ti një dritë në unitet* tridiellor pra* është një dritë në Hyjni,* por që bëhet tri* në personat që ne nderojm';* ndaj me shkëlqim në fjalë dhe me jetë të pastër krejt* po na mëson adhurimin e Shën Trinisë që s'ndahet kurr';* lyp

që prej saj, atë,* të dërgohet përdëllimi i madh^{4α} për shpirtrat tan'.

Varg: Goja ime do të flasë urtësi dhe studimi i zemrës sime mençuri.

Ti me ndriçim plot heologji* që the, shpërndave herezitë si mjegulla,* sepse me mendim shprestar dhe të perëndishëm, o at'* theolog, arrite në burim hyjnor* që ka vezullime mjaft,* u kungove me to, meqë* e bëre mendjen* si pasqyrë të pastrer krejt,* pa njoll';¹⁶ prite pra* me shkëlqim dritën e trefisht'* dhe të pandarë të Hyjnisë, more me pasuri* rrezen unike që nuk ka shprehi; asaj përgjëroju ti* tani, të dhurohet* falja edhe përdëllimi i madh^{4α} për shpirtrat tan'.

Varg: Goja e një të drejti do të studiojë urtësi dhe gjuha e tij do të flasë gjykim.

G'zohu, o lumi i Perëndis'* që i dëfren qytetet mbarë të mbretit Krisht*¹⁷ me fjalë dhe mësimdhënie të perëndishme, sepse* ti ke ujë hiri me bollëk gjithnjë;* përrua shijimi¹⁸ je,* det pa fund që nuk ka shterim,* roje ligjor dhe* i përpiktë i dogmave,* luftëtar i zjarrt'* i Triadhës dhe instrument,* vegla e Shpirtit, gjuhë, zë dhe mendje me kthjelltësi* që thellësinë e Shkrimeve me sukses e interpreton;* tani lypj Krishtit* që të japë përdëllimin e madh^{4α} për shpirtrat tan'.

Lavdi

Ting. Tërth. IV I Anatoliut

Duke kultivuar me gjuhën tënde zemrat e besëmirëve, o Grigor, nxore në to për Perëndinë fruta gjithmonë të gjelbëruara të shpresëtarisë, pasi i preve nga rrënja herezitë e gjembta, dhe i zbukuron mendimet me pastërti; për këtë, duke pranuar lavdërimet tona, o Grigor, lira hyjnore, syri vigjilent, bariu i barinjve, gjuetari i ujqërve, ndërmjeto gjerësisht te Fjala për shpirtrat tanë.

Tani *Hyjlindësore*

Ti imás kalésomen

Ndhimë për të gjithë, e Virgjër, je,* ndaj një pikë nga mëshira jote më dërgo nga lart* dhe më jep një dorë ndihmë* mua që zhytem gjithnjë* pra thellë në shtrëngata jete në rrezik* dhe shkundem nëpër terrin e mjerimeve;* o e dëlirë, përkrahje je,* në krah të drejtësh, të zgjedhurish* më vë, o nën',* që avushën dhembshurisht linde.

Përlëshore

Ting. I

Fyelli baritor i thelogjisë sate i mundeni trumbetat e oratorëve, sepse meqë i hetove thellësitë e Shpirtit, t'u shtuan edhe bukuritë e të folurit; po ndërmjeto pranë Krishtit Perëndisë, o atë Grigor, që të shpëtojnë shpirtrat tanë.

Tani *Hyllindësore*

Gabrieli kur të tha, Virgjëreshë: “Gëzohu!”, bashkë me zërin mishërohej Zot’ i Gjithësisë te ty, arka e shenjtë, siç tha David’ i drejtë; u rrëfeve më e gjerë se qiejtë, duke mbajtur Krijuesin tënd; lavdi atij që ndenji te ti; lavdi atij që lindi prej teje; lavdi atij që na çliroi me lindjen tënde.*



NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësore
Ting. III Thias pïsteos*

Një ndriçim hyjnor* si short tërhoqe,* jetë të palënd’* ti praktikove,* sipas emrit u dallove në priftëri,* se shpalle dogmat me forcë dhe madhështi,* mbështete fort besën tonë orthodhoksisht;* Krishtin Perëndi lyp, o atë oshënar me nam,* të na dhurojë ne mëshirën e madhe.^{4a}

Lavdi *I njëjti*

Tani *Hyllindësore*

Kur në barkun tënd* mish zuri Krishti,* kurrë nuk u nda* pra nga Hyjnia,* Perëndi i njerëzuar ka mbetur ky* dhe të ka ruajtur nënë të virgjëry,* të paqortueshmen pas lindjes, siç ishe* para lindjes, se është’ Zoti i vetëm; lyp atë* gjithnjë të na dhurohet përdëllim i madh.^{4a}

*Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësore
Ting. Tërth. I Ton sinánarhon Logon*

Ti syçelët për fjalën e së Vërtetës Krisht* e shpalle, theologove fuqin’ e Shën Trinis’ pra,* dhe vithise herezinë e paligjshme krejt* dhe besëthyer, se ke qen’* triumfues, luftëtar për shpresëtar dhe shndrite* ti të fjeturit brenda terri paditurie, hierark famëmadh.

Lavdi *I njëjti*

Tani *Hyllindësore*

Veset plot me mundime të shpirtit tim fatkeq* edhe sëmundjet e trupit shëroji shpejt, dhe ndalo* devijimet e mendimit, o Hyllindëse;* më denjëso që t’i blatoj,* qetësisht, o Zonjë pa qortim, mbretit të krijesës* lutje dhe adhurim të pastër dhe t’i kërkoj un’ ndjesë shkeljesh atij.

*Pas Polieleit, Ndenjësore
Ting. Tërth. IV Tin sofian qe Logon*

E qortove mashtrimin krejt besëkeq,* perëndishëm e hape Shkrimin;¹⁹ Grigor,* dërgove, o Theolog,* dogma që ëmbëlsojnë qart’* më shum’ se mjalti²⁰ zemrat e gjithë besnikëve* të adhurojn’ Trini në Njësi të Hyjnisë pra,* o i admirueshëm, ke vën’ para pamjen* e Zotit tënd Shpëtimtar* në ikon’, që relativisht* njerëzia* ta puth atë;* ndërmjeto te Zoti yt Krisht,* të na dhurojë ky ndjesën* e fajeve* ne që bëjmë kujtimin

tënd fort të shenjt' me mall.

Lavdi *I njëjti*

Tani *Hyjlindësor*

Gjithë kombet ju ejani për himnim,* ta nderojmë ne nënën e Zotit Krisht,* t'i themi: Gëzohu ti,* fron me formë të zjarrtë je* për tërëmbretin Zot të gjithçkaje Jisun', ki gaz,* se je e vetmja Zonjë e botës, gëzohu pra,* o e pacenuar, enë që njollë nuk ke,* e ndritshmja e Shën Trinis',* Atit, Birit dhe Shpirtit Shenjt,* o e virgjër* gjithnjë Mariam* nuse e himnuar, e thjesht'* e zbukuruar si diell,* ki Vajzë gaz;* je hare për himnuesit e tu, ki gëzim.

*Shkallesat. Antifoni i parë i Ting. IV
Proqimeni Ting. IV*

Goja ime do të flasë urtësi dhe studimi i zemrës sime mençuri.

Varg: Dëgjoni këto gjithë kombet.

Ungjilli. Psalmi 50.

Lavdi. Me ndërmjetimet e hierarkut. Tani. Me ndërmjetimet e Hyjlindësës. Përdëllemë, o Perëndi. *Dhe Idhiomeli.*

Ting. Tërth. II

O oshënar i trillumur, atë tepër i shenjtë, bariu i mirë²² dhe nxënës i kryebariut Krisht,²³ që vure shpirtin tënd për hir të deleve, ti dhe tani, o Theolog Grigor i tërëfamshëm, kërko me ndërmjetimet e tua që të na

dhurohet përdëllimi i madh.^{4α}

*Kanunet: i Hyjlindësës (shih fq. 197)
dhe dy të shenjtit.*

Ode I

*Kanuni i shenjtit, që ka Akrostihidhë:
"Këndoj të kënduarin, Grigorin hyjfolës".*

Poezi e Theofanit.

Ting. I

Hristós jenate

Ne Theologun e dytë, shtyllë drite qiellore²⁴ edhe trumbet'* urtie të Perëndisë Zot,* duke u mbledhur, ejani ta nderojm', o të dashuruar* me fjalimet e këtij, se është' hyjfolës ky.

O atë, Fjala pa nisje që kujdeset për çdo gjë porsì Perëndi* me forc' providence, o i lum,* kur hijeshoi mendjen tënde me plot mençuri dhe urti*²⁵ të dhuron si te një nën'²⁶ tek Kisha si dhurim.

E bëre frymën sunduese,²⁷ kështu përmbajte veset e mishit²⁸ ti,* u bëre pranues, mbajtës, en'* shndritjesh hyjnore, o Grigor, na shkëlqeve të adhurojmë* një Hyjni, një Perëndi në tre persona veç.

Hyjlindësore

Në mitrën tënde hirplote kur fuqshoi urtësia e Perëndis',* ndërtoi shtëpin' e saj;²⁹ u pe* pra si njeri kur u bashkua me të mbi mendim dhe

sipas* hipostazës, e dëlirë, që qortim nuk ke.

Kanun tjetër i shenjtit.

Poezi e shën Kozmait.

Ting. i njëjtë

Epenon o theoptis

Qëndroje duke flijuar më përpara gjak hyrrjedhur, që shpëton nga pësimi i lashtë³⁰ dhe nga pësimet tona,³¹ o Grigor i tërëurtë; dhe tani ne besnikëve na e ofron të butë Perëndinë.³²

Moisiu kur u fut nën errësirën dikur,¹¹ ngriti pllaka të hyvijëzuara,³³ por ti, pasi në mendje ngrite tryezë hyjpranuese, u kungove tërësisht me Perëndi.

Hyjlindësore

Me qenëse nga dhembshuria donte ta rithërriste nga vdekja dhe prishja natyrën e të dhélindurve Mbiperëndia, u strehua në mitrën tënde të pastër, o Virgjëreshë e tërëpaqortueshme.

Zbritësore: Herson avisotokon

Fundin edhe burimin (*shih fq. 354*)

Ode III

I shenjtit: To pro ton eonon

Kishe ti burimin* e urtis' që gufonte përherë bollëk,* i tërëlum; me mësimdhëniet* e hyjorta e mbushe* plot Kishën e Krishtit që thërret* te Perë-

ndia që është' mbi çdo gjë:* O Zot, je i shenjtë ti.

Theologu atë* me një zë krejt kumbues, i shquar, i madh* shpresëtarie, vë përpara* një thesar teorie* të pasur, theologjinë pra* dhe na shpërndan bujarisht pasuri* që nuk hiqet asnjëher'.

Oratori zëmadh,* i përflaktë dhe lira hyjfolëse* e Hirit, me hyjfrymëzimin* theolog dhe me fjalën* nga Zoti ushtoi plot shkëlqim;* për qenien me tre persona një himn* na këndoi hijesisht.

Hyjlindësore

Onën' Perëndie,* mbretëreshë e gjithë Krijesës, gjithnjë* dhe pa pushim ti përgjëroju* Krishtit që na ke lindur* për hir të shpëtimit njerëzor,* të na shpëtojë ne që përmbi dhé* të himnojmë ty me mall.

Tjetri: I ton pro silipseos

OKryetar të urtësh, "Gëzohu, o atë", thërrasim te ti, i cili duke sjellë emërtimin e denjë nga natyra, iu shfaqe që më parë lindëses, përmes rrëshqitjes së dukshme të barkut, o atë oshënar.

Oluftëtar besnikësh, "Gëzohu, o atë", të thërrasim të ngazëlluar ty, që para se të zgjidhje të këqija,³⁴ e more

me vizione hyjnore si bashkëshorte dhe bashkëpunëtores dëlirësinë hyj-pamëse dhe mençurinë.

Hyjlindësore

E ringrite rrëshqitjen e mëparshme të stërnënës Eva,³⁵ kur e pranove Fjalën e Atit që me pushtetin e pamposhtur i ringre të thyerit,³⁶ o Nënë-virgjëreshë.

Zbritësore: To steréoma **Zoti Krisht**

Ndenjësores

Ting. Tërth. IV Tin sofian qe Logon

Çele gojën për fjalën e Perëndis',* urtësinë e nxore³⁷ ti që shpall drit',* ke mbjellë mentalitet* të devotshëm në rruzullin;* vërtet kur aprovove krejt dogmat e Etërve* u pe luftues bese sipas Pavlit,³⁸ dhe prandaj* u dëftëve bashkëqytetari dhe shoku* i engjëjve, o Grigor* theolog, atë fort i lum;* ne të gjithë* të lutemi:* Ndërmjeto te Zoti yt Krisht,* të na dhurojë ky ndjesën* e fajëve* ne që bëjmë kujtimin tënd fort të shenjt' me mall.

Lavdi dhe Tani Hyjlindësore

Kur të vijë për gjyqin e dheut mbar'* Krijimtari³⁹ dhe Bërësi i çdokujt,* radhitmë me delet pra* djathtas,⁴⁰ mua që jam fajtor,* o e himnuar pa cen, Hyjlindëse; më rrëmbe* nga errësira tejet e jashtme,⁴¹ nga çdo

ndëshkim,* se jam shërbëtori yt pa vlerë, me gaz pra* të psal dhe të madhështoj* mirësin' që ke pa-surisht* të thërras fort* te ti me mall:* Ndërmjeto te Biri yt Zot,* që të më japë ky falje* të shkëlqeve,* shërbëtori yt i padenjë të ka shpresë.

Ode IV

I shenjtit: Ravdhos ek tis rizis

O oshënar i urtë, me t'u bërë mist i Trinisë, e ndriçove planetin me njohjen e saj të thellë, duke feksur vezullimet e dogmave të mësimdhënies sate të saktë; duke e studiuar atë përherë të përhimnojmë të gjithë me shpresëtar.

Pasi e pranove rrezen tridiellore, lindesi agim i ndritshëm devotshmërie dhe e shporre me shkëlqimin e mësimdhënies të tua të urta natën e errët të herezive besëkeqe, dhe i hijeshove shpirtat e besnikëve, o atë.

O i tërëlumur, duke theologuar përmes bubullimit theolog nga i Amshuari, na mësove besërisht Mendjen e përmbisubstancshme, burimin e Fjalës dhe të Shpirtit; e mësove këtë me anën e zbulimit prej vetë Hyjnisë së vërtetë, kryehyjnore dhe të kryendritshme.

U ngjite në mal virtytesh duke u shpërngulur nga të poshtmet dhe duke u distancuar nga veprat e

vdekura,⁴² dhe pranove pllaka të shkruara nga dora e Perëndisë,³³ dogmat e thelogjisë sate pa mangësi, o Grigor, mësues i mistereve të përmbibotshme.

Hyjlindësore

Adamin që më parë ra vullnetarisht³⁵ e ngrite, o e tërëpaqortueshme, kur jetën enipostate e linde nga mitra virgjërore, që u pastrua nëpërmjet Shpirtit dhe nga pasionet e risolle, o Zonjë, te shijimi më i hyjshëm dhe pa pasion.

Tjetri: Sin to thavmasio

Duke imituar batalionet plot të ndritshme, që janë afër Perëndisë, o i tërëurtë, duke lëvizur përçark me mendjen në gjëra më të larta nga ato, arrite në thellësi, në qëndrimin suprem, dhe prej andej u solle njerëzve pasuri që nuk hiqet.

Nuk u fute në errësirë të prekshme¹¹ dhe nuk e pe nga guri shpinën,⁴³ një natyrë të palëndët të përzier me të lëndët; u bëre sinjalizues i përzierjes pa trazim, o shërbyes i Krishtit; le ta sjellë atë të butë te ne shërbëtorët.

Hyjlindësore

Udallove ti si mal mendor, nga ku u pre pa u rrëfyer guri i çmuar që hollonte ikonën⁴⁴ e mashtrimit të errët dhe që llamburiste me ndriçimin e Hirit ata që thërrasin me be-

sim: O Zot, lavdi fuqisë sate.

Zbritësore: Ekálipsen uranús

Mbulove me virtyte

Ode V

I shenjtit: Theós on irinis

Zëri i hyjshëm i fjalëve të tua dhe hiri i perëndishëm i dogmave, me shpejtësi rrufeje përshkoi gjithë dheun,⁴⁵ duke na theologuar dhe na mësuar t'i falemi Trinisë në Njësi dhe Njësisë në Trini, o Theolog.

Udashurove pas urtësisë së vërtetë të Perëndisë dhe deshe bukurinë³ e fjalëve, dhe e preferove më shumë se të gjitha të këndshmet mbi tokë; për këtë të stolisi hijshëm me kurorën e hireve⁴⁶ dhe të bëri theolog, o i tërëlumur.

Ohyjfolës, aspirove tejet ta shikosh me kthjelltësi dhe dituri të Qenin,⁴⁷ si Moisiu qëmoti, dhe u denjësove, i mbuluar me gur, ta shikosh shpinën e tij,⁴³ dhe mësove mistikisht oqeanin e esencës hyjnore që shfaqet në mënyrë të pakonceptueshme.

Hyjlindësore

Ai që qëmoti e gatoi Evën,⁴⁸ nënën tënde, u trupëzua prej teje duke shëruar dukshëm dhe duke zgjidhur dënimin⁴⁹ dhe mosbindjen e saj³⁵ si i dhembshur dhe Zoti i të gjithave, o Perëndilindëse nënëvirgjëreshë.

Tjetri: Anthraka pirós

Pasi u zvarrite brenda zjarrit të tërë të shikimit të Perëndisë¹¹ me anën e pastërtisë së mendjes dhe shpirtit, o Grigor i tërëlumur, e nxore pa ngopje me vetë duart e tua, dritën e trishkëlqyer të barabartë në pamje.

U rrezatove të gjithëve rreze reflektuese, meqenëse u ngule në vezullimet e shkëlqimit tridiellor dhe u skuqe nga llamburitja, i feksur në mendje prej rrezeve hyjnore.

Hyllindësore

Sapo prite, o nënë e virgjër, dritën prej dritës, Fjalën e vetëmlindur pa fillim të Atit, u bëre qartazi portë drite, pasi u shkëlqeve të gjithëve diell drejtësie.⁵⁰

Zbritësore: Os idhen Isaias

Të pa shën Isaia

*Ode VI**I shenjtit: Splahnon Ionán*

O i tërëurt'* mendjen e Ariosit,* të çrregullt, të turbullt e ke thyer krejt* përmes dogmave* që po derdhin urti; dhe e ruajte ti,* qetësisht, larg mbytjes grigjën tënde si senduk,*⁵¹ por që* ish mendore dhe në të* vure far' bese, fjalë të bukura.

Që ta pasurosh* veten me shkëlqim, ndriçim* që vjen nga Triadha e nderuar fort,* e pastrove krejt* me-

ndjen, atë, pa njoll', si pasqyrë¹⁶ të re* që tani shkëlqen; e bëre me asketizim* të lart',* ndaj me shfaqje prej Hyjnis'* u dallove në trajtë porsì hyjnor.

Duke u përzier* me ndricim nga Shpirti, at',* i tëri u bëre vezullues ti* dhe ndricues pra, * anembanë² me çdo llamburitje shkëlqen* me çdo fjalë që the, o Grigor, o theolog,* edhe* mbledhjen e pëlqyeshme* të besnikëve po e përbush me hir.

O i tërëlum,* si një Samuel i ri* i dhënë prej Zotit ishe, dhe para* zënies, ti iu dhe* Perëndis'⁵² i stolitur me plot qashtërsi* gjithashtu me mençuri dhe zbukuroheshe* me petk* priftërie fort të shenjt',*⁵³ je ndërmjetës mes njerëzve-Bërësit.⁷

Hyllindësore

Që më par', Mari* nënë virgjëreshë ti* hyjnuse, u njohe tomos pa cenim* dhe i pastër krejt,* që tani po pret Fjalën që shkruhet,⁵⁴ dhe pse* nga Hyjnia është krejt i papërshkruar ky,* dhe çdo* profeci të njohu, se* në bark mbajte të pakufizuarin.

Tjetri: O dhiapóntion ipominas

Ti që nuk u mbyte në mendje kur hetove shpella hyjnore nënujore,¹⁵ nxore prej andej margaritar dhe bashkë me heshtjen tënde si fjalë ia

vure Zotit, o Grigor tepër i shkëlqyer.

Ti që me lutje të pastër qetësove det të egërsuar dhe nxore jashtë kripësirë fjalësh të huaja, si pikë qiellore⁵⁵ e bashkove me Zotin një popull besnik, o Grigor.

Hyjlindësore

Misteri i lehonisë sate të parrëfyeshme dhe të frikshme është i pakonceptueshëm për mendësitë një-rëzore, o nënë Perëndie, sepse ti, o Virgjëreshë, kur e linde Bërësin e të gjithave, mbete e virgjër.

Zbritësore: Evóisé si

Kur Simeoni

Kontaqi

Ting. III I Parthenos símeron

Atë, i lëvdur mjaft,* me gojë, gjuh' theologe,* shpartallove thurjet tër'* të oratorëve, teksa* Kishën ton'* e zbukurove ti me këmishë* që nga lart* orthodhoksisht endur⁵⁶ ish; e veshi* dhe me ne thërret: Gëzohu,* o mendje, maja e theologëve je.

Shtëpia

Nga urtësia jote theologe dhe e lartë mbushe mendjen time të varfër dhe të mjerë, që ta përhimnoj jetën tënde, o atë, sepse nuk do të mundem të të sjell ndonjë fjalë në qoftë se nuk do më japësh ti fjalë dhe njohuri, fuqi dhe mençuri, që të

të ofroj të tuat nga të tuat, dhe duke pasur shkaqe nga pasuria e virtyteve të tua të kurorëzohj kreun tënd të respektuar dhe të shenjtë, duke thirrur se bashku me besimtarët: Gëzohu, o mendje, maja e theologëve je.

Sinaksari

Më 25 të të njëjtit muaj, kujtimi i atit tonëndërshenjtorët Grigor Theologut, kryepiskopi i Konstandinopojës.

Vargje: Të krishterët kanë trashëgimi nga Grigori/ që të njohin orthodhoksisht esencë Perëndie.

Në njëzet e pesë vdiq Grigori hyjfolës.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atit tonë oshënar Pupli.

Vargje: Pupli kthen mbrapsht jetë të lëndët/ dhe e merr atë të palëndë dhe mendore.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atit tonë oshënar Mari.

Vargje: Meqë u distancua nga çdo dashuri tokësore,/ Mari arriti në lartësi të hyjshme të dashurisë hyjnore.

Në të njëjtën ditë, shën Medhula tok me shoqërinë e saj mbaron me zjarr.

Vargje: Medhula, shërbëtorja e Fjalës Perëndi,/ u pa në zjarr si bashkatlete me shërbëtorë të Perëndisë.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atit tonë oshënar Dhimitri, kujdestari i enëve të shenjta.

Në të njëjtën ditë, oshënar Apolosi, mbaron në paqe.

Vargje: Meqë jetoi deri në fund jetën e mirë,/ thërrmon Apolosi çdo arrogancë të dredharakut.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirit të ri Afksenti, i cili u martirizua në Konstandinopojë në 1720.

Me ndërmjetimet e tyre të shenjta, o Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII

I shenjtit: I Pedhes efsevia

O Grigor, fjala jote është e tëra dukshëm dëshirë dhe ëmbëlsim,⁵⁷ e tëra e dendur me ngazëllim dhe hijeshi duke i mbushur me ëndje ata që psalin besnikërisht: O Perëndi i etërve, je i bekuar.⁵⁸

Me mendje të ndriçuar arrite në burimin e llamburitjeve, dhe duke u ndezur nga shkëlqimet e atjeshme, dogje llafazanëritë e Evnomiut, duke i thirrur Trinisë: O Perëndi i etërve, je i bekuar.⁵⁸

Sapo i hape kataraktet e avushës së dogmave të tua të urta dhe i çele burimet e urtësisë sate, i përmyse⁵¹ kryetarët e mashtrimit i feksur prej dritës unike dhe tridiellore.

Hyllindësore

Kur si shi mbi shtëllungë zbriti⁵⁹

në barkun tënd, u mishërua lumi i paqes,⁶⁰ burimi i mirësisë, ai që numëron pika shiu,⁶¹ Perëndia i bekuar i etërve.⁵⁸

Tjetri: Ipilthon is nimfona

Duke qëndruar para podiumeve të hegjemonëve të padrejtë, o Grigor, heretikët që nxirrnin frymë me vrull më të furishëm se zjarri,⁶² i digjje me anën e shpresëtarisë, duke i thirrur Trinisë: O Perëndi i etërve, je i bekuar.⁵⁸

Me frymëzim të Triadhës, pasi gufove nga buzët e tua për tokën burimin e paturbulluar të dogmave besëmira, e ujite dhe të djerrën e tregove të lulëzuar. O Perëndi i etërve, je i bekuar.⁵⁸

Hyllindësore

Vdes paraati,⁶³ sepse e shijoi pa vend bimën; por ti, o e Virgjër Hyllindëse e kulluar dhe e bekuar, kur lulëzove jetën e pafundme,⁶⁴ e ringjalle atë që të banojë në Parajsë.

Zbritësore: Se ton en piri

Hodhe vesën

Ode VIII

I shenjtit: Thávmatos iperfiús

Duke e ditur identitetin dhe bashkimin esencial dhe natyror, na mësove besërisht Fjalën si të barabartë me Atin dhe me Shpirin sipas mirësisë

dhe mbretërisë; prandaj thërrisje duke u ngazëlluar: Le ta bekojë Krijesa e tërë Zotin dhe le ta përmbilartësojë në gjithë jetët.

U vlerësove për lavdi engjëllore, sepse si engjëll fekse në botë përmes Trinisë, o i gjithurtë, pasi e pastrove tërësisht me gatishmëri edhe shpirtin, edhe trupin, edhe intelektin; asaj tani i psal duke dëfryer: Le ta bekojë Krijesa e tërë Zotin dhe le ta përmbilartësojë në gjithë jetët.

Pasi do ta bësh të butë Zotin me lutjet e tua, kërko faljen e shkeljeve për ata që me besim kremtojnë kujtimin tënd të hyjshëm dhe të gjithëkremtueshëm; në të po psalim të ngazëlluar: Le ta bekojë Krijesa e tërë Zotin dhe le ta përmbilartësojë në gjithë jetët.

O i tërëlumur, pasi u bëre me anën e praktikës së virtyteve mist i monarkisë trihipostate dhe të Hyjnisë në Trini, u dallove si theolog triadik; dhe tani psal duke u ngazëlluar: Le ta bekojë Krijesa e tërë Zotin dhe le ta përmbilartësojë në gjithë jetët.

Hyjlindësore

Fjala e pasur, që lavdërohet nëpërmjet himnimesh engjëllore, u varfërua për ne,⁶⁵ kur të zgjodhi si nënë të bekuar ty, bukurinë e Jakovit;⁶⁶ prandaj duke përhimnuar po psalim: Le

ta bekojë Krijesa e tërë Zotin dhe le ta përmbilartësojë në gjithë jetët.

Tjetri: I mi ti trofi

O atë, i përmbilartësuar mbi flakën e Babilonisë⁶⁷ dhe më tepër, i ndezur me vetë shpresëtarinë, pasi u shfaqe predikues trinisor dhe shëtitës brenda mistereve, thërret: E bekoni, ju veprat e Zotit, Zotin.⁶⁸

O atë, duke e shuar lehtësisht zjarrin e furrës së hekurt⁶⁹ dhe ngacmuese të shumëllojtë, dhe pasi u arratisë nga ngasjet, fluturove drejt qiellit duke thirrur: E bekoni, ju veprat e Zotit, Zotin.⁶⁸

Hyjlindësore

Kandili i praruar⁷⁰ e deklaronte simbolikisht lindjen tënde hyjnore, o e pacenuar modeste, sepse ti i shkëlqeve botës dritën e paafreshme,⁷¹ për hir të së ciles thërrasim: E bekoni, ju veprat e Zotit, Zotin.⁶⁸

Zbritësore: Astekto piri

Në flak' e në zjarr

Ode IX

I shenjtit: Tipon tis agnis lohias su

Të jep* Shën Triadha jet' pa cen,* se e theologove dhe priti luftërat,* që bëre për të* dhe mundjen tënde me dogmat tok;* dhe tani me Trinin' pushtetare je,* o atë ndërmjetues* i mrekullueshëm për rruzullin.

Duke* feksur me lavdi që vjen* që prej Hyjnis', por është trirrezatuese,* o hieromist* Grigor, shpëto sa të përhimnojm'* me besim, dhe me shndritjen e dogmave* plot me theologjinë* që formulove llamburitna ne.

Udhën* e së mirës kreve ti,*³⁸ duke luftuar me fuqi për Trininë Zot,* për forcën e par',* si theolog ke arritur pra* hyjnizim; e përmbushe me dinjitet* mallin tënd, dhe kungove* prej tij, o hijeshi e Kishave.

Hyjlindësore

Zonjë* Virgjëresh' Hyjlindëse,* çudia jote sa e frikshme ngjan, se mister* të fshehur gjithnjë* përpara brezave, jetëve,*⁷² në atë që ndërtoi Krijesën mbar',* Zotin, kur linde Fjalën* Krisht, pa shpjegim na e zbulove ti.

Tjetri: O ton ano vithón

O atë i gjithëlumur, të madhërojmë ty që e grise rrobën e pavlefshme të germës Ligjore,⁷³ dhe na shpalose bukurinë hyjnore mistike të Shkrimeve të hyjshme të Shpirtit, e cila gjendet brenda saj.

O atë i gjithëlumur, të madhërojmë; bëj lutje drejt Perëndisë për tufën tënde, ti që numërohesh bashkë me koret e sipërme, meqenëse tok me to shoqërohesh në jetë, o atë oshënar.

O atë i gjithëlumur, të madhërojmë ty që me frymëzim hyjnor dhe përmbi mendim i mësove hyjnore dhe për hir të dashurisë sate të papërmbajtur mistikërisht u përsose me anën e bashkimit të tyre që s'mund të mësohet dot, o atë oshënar.

Hyjlindësore

O e kulluar, ti u bërë mbi natyrë vendi i të panxënshmit hyjnor, sepse duke lindur pa farë ia dhe mishin si hua Perëndisë, i cili nuk e plasi mitrën tënde virgjërore; ty të madhërojmë.

Zbritësore: En nomo skiá qe grámati

O Hyjlindëse

dhe

Në Ligjën dhe Shkronjën

Dërgimësore

Tis mathitēs sinéltiomen

O i gjithurti Theolog,* Njësis' trihipostate* dhe të përkryerës Trini* në një Hyjni na thua* t'i falemi, na mëson pra* Atin si dritë,⁷⁴ bashkë* me Birin drit',⁷⁵ dhe Shpirtin drit',* por një drit' krejt pa ndarje dhe pa trazim,* sepse është një Perëndi; e shpalle* fuqishëm bashkëqenien ti,* o shën Grigor i lumur.

Tjetër E ngjashme

Me fjalë madhështore dhe* me dogma fort të urta* theologove me fuqi* fundin që dot nuk shprehet*

të mbar' misterit të Krishtit* dhe me gjuh' oratori* fitoret edhe jetët tok* të shenjtoreve, o theolog Grigor;* si zot në kungim me Hyjninë, atë,* tani shpëtomë, o i lum,* më prit në tendën tënde.

Hyjlindësore

Tok me hyjnënën Mariam* dhe me Vasilin zëmadh* qëndron në qiell me Trinin'* e paafuëshme pra,* ndaj ndërmjeto, o i lumur* dhe orator i Kishës,* për paqen në planetin mbar'* dhe që mbreti të ketë trofe, dhe ne* që të lavdërojmë tani, të kemi* shpëtim, o kryeprift Grigor,* goja e Fjalës, Zotit.

Lavdërime

Ting. IV O eks ipsistu klithís

Kur preve terrin e gërmës hyre brenda*¹¹ dritës më të lartë në shpirt dhe si prej andej* pranove derdhje shkëlqimi, drit'* theologjie* na pasurove të gjithë ne, Grigor,* o i tërëlumur, ndriçues i Kishës je;* me llamburitjet e fjalëve* na pakësove* retë e nxirra të herezive, pra* qëndron atje ku* ndihet zë i atyre, o mik i engjëjve, që kremtojn'*⁷⁶ pa pushim duke lypur* të shpëtohen shpirtat tanë ti.

Je theologu i dytë si dhe misti,* njohës i ndriçimit hyjnor edhe shkruesi* me hijeshi i Trinisë Shenjt,* që na mëson ne* me mrekulli për natyrën

pa shpjegim* dhe hyjnore; meqë më qartë tani shijon,* më dukshëm Krishtin tënd Perëndi,*⁷⁷ Grigor, kujtona,* se të lëvdojm', ji për Kishën luftëtar,* e sistemeve,* sepse zëri yt doli në gjithë anët e ruzullit,*⁴⁵ dhe mëson* të nderojmë* një Triadhë të njëqëshme pra.

Kur kultivove, hyjfolës, përmes gjuhës* gjithë tërësinë e Kishës ti, pasurisht* ke hedhur farë të hyjshme krejt* dhe theologe* të lartë, te brazdat pra të zemrave;* dhe me zjarr prej Shpirtit i dogje gjith' barërat* e egra⁷⁸ të herezive, se* ishe ushqyer* me dashuri për filozofi të sakt',* të perëndishme,* atë Etërish dhe barí i barinjve, Grigor i lum,* nder i besës, ndriçues* i klerikëve, lavdi mbi dhé.

Atë Grigor, ia afrove gojën tënde* kaq të çmuar kanës që vetë urtia ka* dhe nxore lëng të hyjnueshëm* theologjie,* pa e kursyer e ke përçuar pra* te besnikët, dhe rrjedhjen shpirtshkatërruese* plot blasfemi heretike fort* e ke bllokuar;* të gjeti Shpirti i Shenjt' si kapiten* që zbraps dhe zbon tej* si furinë e erës, vrull besëkeq dhe na predikon,* na lëçit Shën Trininë* në Njësi substance, një esenc'.

Lavdi

Ting. I I Anatoliut

Lirës së Shpirtit, draprit të herezive, kënaqësisë së orthodhoksëve, nxënësit të dytë që ra mbi gjoks⁷⁹ dhe që me anën e dogmave u bë dëshmitar okular i Fjalës, kryebariut²³ të urtë, ne delet e Kishës le t'i themi me himne theologjike: Ti je bariu i mirë²² që dhe veten tënde si Mësuesi Krisht për ne, o Grigor, që kërcen tok me Pavlin dhe ndërmjeton për shpirtrat tanë.

Tani Hyjlindësore

Meqë pranon lutjet e mëkatarëve dhe nuk shpërfill rënkimin e të pikëlluarve, ndërmjeto tek ai që lindi nga barku yt i dëlirë, që të shpëtohem, o Hyjlindëse e virgjër.

Dhoksologjia e Madhe.

Në Liturgji, Tipiket dhe nga Kanunet Odet III dhe VI. Kontaqi Ti që e shenjtërove (shih fq. 356). Kungatore Në kujtim të përjetshëm.

CITIME

¹ Ps. 22(23).1-2

^{1a} III [I] Mbret. 18.15; IV [II] Mbret. 3.14

² Fil. 2.15

^{2a} Joan 15.1

³ Urt. Sol. 8.2

⁴ Fja. Urt. 9.2

^{4a} Num.14.19 etj.

⁵ Urt. Sol. 8.7

⁶ IV [II] Mbret. 2.11

⁷ I Tim. 2.5

⁸ Matth. 25.16-17

⁹ Gjen. 28.12

¹⁰ Varuk 3.38

¹¹ Ligji i Dytë 4.11; 5.22-31; Sirak 45.5

¹² Ps. 118(119).131

¹³ Joan 1.14

¹⁴ Vep. 2.11

¹⁵ Ps. 106(107).24

¹⁶ Urt. Sol. 7.26

¹⁷ Ps. 45(46).5

¹⁸ Ps. 35(36).9

¹⁹ Lluk. 24.32

²⁰ Ps. 18(19).11

²¹ Jez. 1.13-26

²² Joan 10.11,14

²³ I Petr. 5.4

²⁴ Eks. 13.21-22; 14.24; Num. 14.14

²⁵ Lluk. 2.52

²⁶ Joan 19.26-27

²⁷ Ps. 50(51).14

²⁸ IV Makk. 7.18

²⁹ Fja. Urt. 9.1

³⁰ Gjen. 3.23

³¹ I Joan 1.7

³² II Kor. 5.18-19

³³ Eks. 31.18; Ligji i Dytë 9.10

³⁴ Is. 7.15

³⁵ Gjen. 3.6

³⁶ Ps. 144(145).14; 145(146).8

³⁷ Ps. 44(45).1

³⁸ II Tim. 4.7

³⁹ II Tim. 4.1

⁴⁰ Matth. 8.12;22.13;25.30

⁴¹ Matth. 8.12; 22.13; 25.30

⁴² Hebr. 6.1; 9.14

- 43 Eks. 33.22-23
44 Dan. 2.34-35
45 Ps. 18(19).5; 76(77).18; 96(97).4;
147(148).4(15)
46 Fja. Urt. 1.9
47 Eks. 3.14
48 Gjen. 2.22
49 Gjen. 3.16
50 Mal. 4.2(3.20)
51 Gjen. 7.6-23; I Petr. 3.20
52 I Mbret. [Sam.] 1.11,20
53 Eks. 35.18 etj.
54 Is. 8.1
55 Ps. 71(72).6
56 Joan 19.23
57 Kënga 5.16
58 Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 2
59 Gjyq. 6.37-38; Ps. 71(72).6
60 Is. 48.18
- 61 Jov 36.27
62 II Makk. 9.7; Urt. Sol. 11.18
63 Gjen. 3.19
64 I Joan 1.2; 5.20
65 II Kor. 8.9
66 Ps. 46(47).5
67 Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 22-23
68 Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 34
69 Ligji i Dytë 4.20; Jer. 11.4
70 Eks. 25.30; 38.13
71 I Tim. 6.16
72 Rom. 16.25; Ef. 3.9; Kol. 1.26
73 Rom. 2.27,29; 7.6; II Kor. 3.6
74 I Joan 1.5
75 Joan 1.1-4
76 Ps. 41(42).5
77 I Kor. 13.12
78 Matth. 13.30,40
79 Joan 13.25; 21.20



MË 27 TË TË NJËJTIT MUAJ

Transferimi i lipsanit të atit tonë ndër shenjtoret Joan Gojarti.

Tipikon

1. Nëse bie në një nga të dielat para Triodhit:

Të shtunën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 6 ngjallësore dhe 4 të shenjtit (3 të dytat, duke përsëritur të parën). Lavdi i shenjtit. Tani Hyjlindësore dogmatike e tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimëni. Leximet. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi i shenjtit. Tani ngjallësor (Zoti Krisht, bërësi). Përlëshoret: ngjallësore, e shenjtit dhe Hyjlindësorja e tij.

Të dielën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Kanuni Triadik, Litia e shenjtit dhe Himne Triadike. Trishenjtë. Përlëshorja e shenjtit. Në Mëngjesore, Ndenjësores ngjallësore. Pas Polieleit, Ndenjësoret (pas Polieleit) e shenjtit. Bekimtoret. Ipakoia. Shkallesat dhe Proqimëni i tingullit. Kamunet: ngjallësor dhe i pari i shenjtit. Pas Odes III, Kontakti dhe Shtëpia ngjallësore, dhe Ndenjësoret e shenjtit. Pas Odes VI, Kontakti dhe Shtëpia e shenjtit, dhe Sinaksari. Zbritësoret Fundin edhe burimin; dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor. Më të nderuarën. Dërgimësoret: ngjallësore dhe të shenjtit. Lavdërimet: 4 ngjallësore dhe 4 të shenjtit. Lavdi i shenjtit. Tani E përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji, Tipiket. Lumërimet: 4 të tingullit dhe 4 nga Ode VI e shenjtit. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore, e shenjtit dhe e kishës. Kontakti Ti që e shenjtërove. Apostulli i shenjtit dhe Ungjilli i së dielës. Kungatore Lavdëroni.

2. Nëse bie të Dielën e Tagrambledhësit dhe të Fariseut:

Të shtunën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 4 ngjallësore, 2 të Triodhit dhe 4 të shenjtit (3 të dytat në 4). Lavdi i Triodhit. Tani Hyjlindësore dogmatike e tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimëni. Leximet e shenjtit. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi i shenjtit. Tani i Triodhit. Përlëshoret: ngjallësore, e shenjtit dhe Hyjlindësorja e tij.

Të dielën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Kanuni Triadik, Litia e shenjtit dhe Himne Triadike. Trishenjtë. Përlëshorja e shenjtit. Në Mëngjesore, Ndenjësores ngjallësore. Pas Polieleit, Ndenjësoret (pas Polieleit) e shenjtit. Bekimtoret. Ipakoia. Shkallesat dhe Proqimëni i tingullit. Kamunet: ngjallësor, i Triodhit dhe i pari i shenjtit. Pas Odes III, Kontakti dhe Shtëpia ngjallësore, dhe Ndenjësoret e shenjtit. Pas Odes VI, Kontakti dhe Shtëpia e Triodhit, dhe Sinaksari i shenjtit si dhe i Triodhit. Zbritësoret Fundin edhe burimin; dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor. Më të nderuarën. Dërgimësoret: ngjallësore, e Triodhit dhe të shenjtit. Lavdërimet: 3 ngjallësore, 2 të

Triodhit dhe 3 të shenjtit. Lavdi i Triodhit. Tani E përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji, Tipiket. Lumërimet: 4 të tingullit dhe 4 nga Ode VI e Triodhit. Pas Hyrjes Përlëshoret: ngjallësore, e shenjtit dhe e kishës. Kontaqi Ti që e shenjtërove. Apostulli i shenjtit dhe Ungjilli i së dielës. Kungatore Lavdëroni.



NË MBRËMËSORE

*Pas Qëndrimit të parë të Psaltirit
(Lum ai njeri),
Thirrto*

Ting. IV Os jeneon en mártisin

Me himn melodikisht këndojm'* veglën plot me hyjfrymëzim,* trombën që na u farkëtua me flori,* det i pashtershëm besimi, dogmash, bazë për Kishën ton',* kupë ari që na rrjedh* lum' mësimesh si mjaltë pra,* që ujit gjithnjë* çdo krijesë, ndaj mburrim mendjen qiellore, majën e urtisë; le ta lëvdojmë të gjithë ne.

Yllin pa perëndim që shndrit* plot me rreze doktrinash fort* gjithë globin tonë, dhe predikuesin* pra të pendimit,¹ sfungjerin e pruar që thith për plot* lagështirën mbytëse* të brengosjes, dhe i freskon* zemrat që u shkrin'* nga mëkate,² Joanin Fjalëartë, ta nderojmë denjësisht, siç e meriton, me çdo lavdërim.

Dallëndyshen me zë me hir* dhe fjalëmbël, të barabart'* me martirët, engjëllin tokësor mbi dhé* edhe njeriun krejt qiellor, thesarin dhe arkën plot* me virtytet me lavdi,* gurin, shkëmbin që s'thyhet dot,* që jetoj drejt* si apostull dhe që njëlloj me engjëjt;³ me himnim ta madhërojmë shembullin tonë, Gojartin pra.

Të tjera

Ting. i njëjtë O eks ipsistu klithís

Le të formojmë një kor të hyjshëm shumë,* se kurorë ari e Kishës së Krishtit Zot* plot me lavdi mbretërore sot* vjen te qyteti* që mbretëron, nga Komana; dhe nga lart* shndrit me vezullime për kthimin e tij; na fut* në mbretëri të palëndët krejt* ne besimtarët,* me Tërëmbretin na familjarizon;* ndaj po thërrasim:* Sinonim je me arin, atë i shenjtë, o Krisostom,* Krishtin lyp t'i shpëtojë* dhe shkëlqejë shpirtrat tanë ky.

Porsi një qiell i shndritshëm nur

për Kishën,* o Gojart, pësove pa pikë mëshirë ti,* pra perëndimin në internim,* por sot me gaz lind* pa perëndim mbi Krijesën dhe na ngroh,* se me yll çudirash stolisesh, i tërëlum;* sjell Krishtin që shndrit si dielli* dhe feks tani fort* rikthimin tënd, ndaj thërrasim: Krisostom,* i tërëurtë,* i shkëlqyer ngado me fjalë që shndrit si flori, i lyp* Zotit që të shpëtojë* dhe shkëlqejë shpirtrat tanë ky.

Lodron tani me gaz qielli me engjëjt* bashkë me Krijesën, grupimet e njerëzve.* Ai që çdokënd mbi dhë e shfaq* hymmendës, shkallë* hyjnore bëri fjalën e tij të shenjt';* na tregon rikthim të shkallësve që na çojn'* te Zoti, si një Jakov i ri;*⁴ engjëj të hyjshëm* për transferimin e tij gëzohen fort,* ndaj po thërrasim:* O mik engjëjsh pa lëndë, atë i tërëlum fjalartë,* Krishtit ti përgjëroju* të shpëtojë shpirtrat tanë ky.

Lavdi

Ting. IV I Kozmait

Nuk duhej, o Gojart, pasi të kesh lënë qytetin mbretëror, të rrish në Komanë; ndaj pasi erdhi i nxitur nga Perëndia dëfrimi oborrtar, të riktheu përsëri në pallat perandorak, dhe dëfreu Kisha kur të pa dhe të mburri duke thënë: Le ta madhështojë lavdia ime Zotin⁵ që ma dha sërisht shkesin dhe mbështetjen e

besimit, përgjigjen e kërkesave të mia, prehjen e tëmthave të mi,⁶ lartësinë e përlësisë, thellësinë e lëmoshës, pasurinë e varfërisë sime dhe gjatësinë e pendimit. Ndaj të kërkojmë, o atë oshënar, kërko për shpirtrat tanë paqen dhe përdëllimin e madh.^{6a}

Tani *Hyjlindësore*

Profeti David që u bë hyjprinid me anën tënde, i parathirri melodikërisht atij që të madhështoi:^{6b} Qëndroi mbretëresha në të djalhtën tënde,⁷ se ty Perëndia që denjoj të bëhet njeri prej teje pa atë, të rrëfeu nënë shkaktare e jetëve, që të gatojë përsëri ikonën e tij⁸ të prishur prej pasioneve; dhe duke gjetur delen e arratisur nëpër malet, ta marrë mbi supet⁹ e t'ia shpjerë Atit; dhe me dëshirën e tij ta bashkojë me fuqitë qiellore dhe ta shpëtojë botën, o Hyjlindëse, Krishti që ka përdëllimin e madh^{6a} e të pasur.*

Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës dhe Leximet.

Këndimi i Fjalëve të Urta

(10.6-7; 3.13-16; 8.35 etj.)

Kujtimi i të drejtit është me lavdërimet dhe bekimi i Zotit mbi kryet e tij. Lum njeriu që gjeti urtësi dhe i vdekshmi që njohu mençuri; sepse është më mirë ta tregtosh atë, se thesare ari dhe argjendi. Dhe është

më e vyer se gurët e çmuar; dhe çdo gjë e çmuar nuk është e barasvlefshme me të; sepse nga goja e saj del drejtësi, ndërsa ligj dhe mëshirë mban në gjuhë. Prandaj më dëgjoni, o fëmijë, sepse do të them *gjëra* modeste; dhe lum njeriu që do të ruajë udhët e mia; sepse daljet e mia *janë* dalje jete dhe përgatitet vullnet nga Zoti. Prandaj ju lutem dhe u lëshoj zërin tim bijve të njerëzve; se unë, urtësia, bëra mendim dhe dituri, dhe kuptim unë thirra. I imi është mendimi dhe siguria, e imja mençuria, e imja edhe fuqia. Unë ata që më duan i dua, ndërsa ata që më kërkojnë do të gjejnë hir. Kuptoni pra, o të patëkeqë, zgjuarsi dhe ju, o të paedukuar, futeni zemrën. Më dëgjoni përsëri, sepse do të them *gjëra* modeste dhe nga buzë *unë* hap *gjëra* të drejta. Sepse do të studioj *një* të vërtetë laringu im, ndërsa të neveritshme janë para meje buzë të gënjeshtërtë. Me drejtësi *janë* gjithë fjalët e gojës sime, brenda këtyre *s'ka* asgjë të shtrembër, as të zhdrejtë. Të gjitha janë të drejta për ata që kuptojnë dhe korrekte për ata që gjejnë dituri; sepse ju mësoj *gjëra* të vërteta, që të bëhet në Zotin shpresa juaj dhe që të mbusheni me shpirt.

Këndimi i Urtësisë së Solomonit

(Përzgjedhje)

Kur lavdërohet i drejti, do të ngazë-

llohen popuj; sepse pavdekësi është kujtimi i tij; sepse njihet edhe nga Perëndia edhe nga njerëzit dhe është i pëlqyer prej Zotit shpirti i tij. Prandaj dëshirojeni, o burra, urtësinë dhe aspironi, dhe do të edukoheni; sepse fillimi i saj është dashuri dhe ruajtje ligjesh. Nderoni urtësinë që të mbretëroni përjetë. Do t'jua lajmëroj dhe nuk do t'jua fsheh misteret e Perëndisë; sepse ai është edhe udhëheqës i urtësisë edhe korrigjues i të urtëve; dhe në dorën e tij është çdo mençuri dhe njohuri punësh. Urtësia, mjeshtrja e të gjithave më mësoi; sepse ka në të shpirt mendor, të shenjtë, rrezatim drite të përhershme dhe ikonë e mirësisë së Perëndisë. Ajo bën miq Perëndie dhe profetë. Dhe është më e hijshme se dielli dhe mbi çdo vend yjesh. Duke u krahasuar me dritë, gjendet më me epërsi. Ata që i shërbyen asaj, ajo i shpëtoi nga mundime dhe i udhëhoqi në udhë të drejtë. U dha atyre njohje të shenjtë dhe i ruajti nga ata që kurthojnë, dhe u dha si çmim një luftë të fuqishme, që ta dinë të tërë se më e fortë se çdo gjë është shpresëtaria dhe se nuk do të mbizotërojë kurrë e keqja mbi urtësinë, dhe se nuk do t'i kalojë shkarazi të ligjtë, kur do të bëjë hetim gjykimi; sepse thanë me vete, duke mos menduar drejt: "Le ta tiranizojmë të drejtin, le të mos e kursejmë devotshmërinë e

tij, as të mos druhe mi nga thinjat shumëvjeçare të një plaku, dhe le të jetë fuqia jonë ligj. Dhe le të kurthojmë të drejtin, sepse na vështirëson në përdorim dhe u kundërvihet punëve tona, na qorton mëkatet e edukatës sonë. Deklaron se ka njohuri të Perëndisë dhe fëmijë Zoti e quan veten e tij. U bë për ne kritikë e mendimeve tona. I rëndë është edhe kur shikohet, sepse jeta e tij nuk është e ngjashme me të të tjerëve dhe *janë* të ndryshme udhët e tij. Fallco u konsideruam prej tij dhe distancohet nga udhët tona si nga papastërtitë, dhe lumëron mbarime të drejtësh. Le të shohim pra nëse fjalët e tij *janë* të vërteta dhe le të sprovijmë përfundimin e tij. Me sharje dhe tortura le ta shqyrtojmë atë që të njohim butësinë e tij dhe të provijmë mospasjen e mërisë së tij. Me vdekje të shëmtuar le ta dënojmë, sepse do të jetë mbikëqyrje nga fjalët e tij.” Këto menduan dhe u mashtruan, se i verbëroi ligësia e tyre. Dhe nuk njohën mistere Perëndie, as nuk gjykuan se ti je Perëndia i vetëm që ke pushtet jete dhe vdekjeje, dhe që shpëton në kohë pikëllimi dhe çliron nga çdo e keqe, ti, i dhembshuri dhe mëshiruesi, dhe që u jep oshënarëve të tu hir, dhe që me krahun tënd u kundërvihesh mendjemëdhenjve.

Këndimi i Urtësisë së Solomonit

(Përzgjedhje)

Goja e të drejtit pikon urtësi, ndërsa buzë burrash dinë hire. Goja e të urtëve studion urtësi dhe drejtësia i shpëton nga vdekja. Pasi mbaroi një burrë i drejtë, nuk humbet shpresë, sepse lindet bir i drejtë për në jetë dhe në të mirat e tij do të vjelë fryt drejtësie. Dritë *do të jetë* te të drejtët përgjithmonë dhe nga Zoti do të gjejnë hir dhe lavdi. Gjuha e të urtëve di të mira dhe në zemrën e tyre do të prehet urtësi. I do Zoti zemrat oshë-nare dhe të pranueshëm prej tij *janë* gjithë të paqortueshmit në udhë. Urtësi Zoti ndriçon fytyrë të mençuri; sepse arrin tek ata që e dëshirojnë para se të njihet dhe me lehtësi vëzhgohet nga ata që e duan. Ai që mëngoi për atë nuk do të lodhet dhe ai që nuk fjeti për atë, shpejt do të jetë pa merak; sepse ajo lëviz rreth e rrotull duke kërkuar të denjë për atë, dhe në rrugë u shfaqet atyre me dashamirësi. Asnjëherë nuk do të mbizotërojë mbi urtësinë ndonjë e keqe. Prandaj dhe u bëra i dashuruar pas bukurisë së saj dhe e desha, dhe e kërkova që prej rinisë sime, dhe kërkova ta marr nuse për veten time; sepse Zoti i të gjithave e deshi atë; sepse është njohëse e mistereve të diturisë së Perëndisë dhe zgjedhëse e veprave të tij. Lodhjet e saj janë virtyte dhe ajo *na* mëson mençuri dhe urtësi, drejtësi dhe burrëri, nga

të cilat asgjë *tjetër* nuk është më e vlefshme në jetë për njerëzit. Dhe nëse dikush aspiron eksperiencë të shumtë, di të lashta dhe të supozojë të ardhshmet. Di me saktësi strofa fjalësh dhe zgjidhje enigmash. Paranjeh çudi dhe mrekulli, dhe përfundime kohërash dhe motesh. Dhe për të gjithë është këshilltar i mirë; sepse ka pavdekësi në të dhe lavdi në shoqërinë e fjalëve të saj. Prandaj shkova tek Zoti dhe iu luta, dhe thashë me gjithë zemrën time: O Perëndi i etërve dhe Zot i mëshirës, që i bëre të gjitha me fjalën tënde dhe që me urtësinë tënde e bëre njeriun që të zotërojë mbi krijesat që u bënë prej teje dhe që të drejtë botën me oshënarí dhe drejtësi, jepmë mua urtësinë që ulet pranë froneve të tua dhe mos më shpërfill nga shërbëtorët e tu; sepse unë *jam* shërbëtori yt dhe biri i shërbëtores sate. Dërgoje atë nga banesa jote e shenjtë dhe nga fronti i lavdisë sate, që duke qenë bashkë me mua të më mësojë se çfarë është e pëlqyeshme para teje, dhe që të më udhëheqë në dituri dhe të më ruajë në lavdinë e saj; sepse mendimet e të vdekshmëve *janë* të gjitha frikacake dhe të pasigurta ide të e tyre.

Në Liti Idhiomele

Ting. I I Anatoliut

Ondriçues Joan, gojë me pamje ari, zbukurim i virtyteve hyjbërëse dhe

banesë Shkrimesh mistike, ti u bëre thesar i patëmetë i Shpirtit të Shenjtë të tërëpacenuar; prandaj e dëfrove gjithë Kishën me fjalën tënde shpëtimtare; pra meqenëse gjete guxim para Perëndisë në shijimin e trashëgimisë lart, ndërmjeto për ne, o atë tepër i shenjtë.

I njëjti

Uderdh hiri në buzët e tua, o atë oshënar, Joan Gojart; prandaj të leu ty Perëndia¹⁰ kryepriфт të popullit të tij, që ta kullosësh grigjën e tij¹¹ në devotshmëri dhe drejtësi;¹² kështu duke u ngjeshur me shpatën e të fortit,¹³ preve llafazanëritë e herezive; dhe tani mos pusho së ndërmjetuari, që ta paqësojë botën dhe t'i shpëtojë shpirtrat tanë.

Ting. II I Studitit

Ty, kryepriфтin e madh,¹⁴ bariun e patëkeq dhe oshënar,¹⁵ predikuesin e pendimit,¹ gojën e artë të Hirit, duke të lavdëruar me mallëngjim lutemi: Na transmeto nga ndërmjetimet e tua, o atë, shpërblimin për shpirtrat tanë.

I njëjti

I Gjergjit të Nikomidhisë

Kisha e stolisur me fjalët e tua të arta, si me zbukurim të artë, o Joan Gojart, e ngazëlluar si nuse¹⁶ të thërret ty: U mbusha me pijet¹⁷ e tua arburuese duke shkëlqyer

me rrjedhje të arta si dritë, të ëmbla mjaltë; sepse me nxitjet e tua të buta ngrihem nga praktika drejt teorisë dhe bashkohem me Krishtin, dhëndrin mendor,¹⁸ duke mbretëruar bashkë me të; prandaj dhe ne të mbledhur në kujtimin tënd thërrasim: Mos u lodh së lypuri për ne para Zotit, që të shpëtohen shpirtrat tanë.

Injëjti

E ke marrë, o hierark, filozofinë e tërëllartë dhe dole jashtë botës duke jetuar mbi të dukshmet dhe u dallove qartësisht si pasqyrë e panjollshme e Perëndisë; dhe duke qenë gjithmonë i bashkuar me dritë, merrje dritë¹⁹ dhe arrite me sukses më të fuqishëm në fund të lumur; ndërmjeto, o Krisostom, për shpirtrat tanë.

Ting. IV

Me fjalë shumë të ndritshme si ar, i vadite anët e botës qartësisht, duke pasur si shpirtin edhe trupin florirrrjedhës, o i tërëpasur; dhe pasi i veshe me ar të gjitha me fjalët e tua, o arpunues i dogmave të tua, dhe si shkrove libra të shkruar si me ar, fluturove në qiejt; prandaj të thërresim ty: Arburues dhe gojartë, përgjëroju Krishtit Perëndisë tonë, që të shpëtohen shpirtrat tanë.

Lavdi

Injëjti I Gjeranoit

Mbreterëshës së qyteteve i duhej të krenohej për Joanin si kryepriфт, pikërisht si zbukurim mbretëror dhe trumbetë e farkëtuar me ar, që kumton në gjithë anët dogmat shpëtimtare; dhe na mbledh në panair të gjithë, që të bashkërendisim këngë të vyera për Perëndinë; atij le t'i thërrasim: O fjalartë dhe gojartë, përgjëroju Krishtit Perëndi që të shpëtohen shpirtrat tanë.

Tani Hyjlindësore

Ty të kemi mur, o Hyjlindëse e pëcnuar, liman të paqtë dhe fortifikim; ndaj ne që dimërojmë në jetë, të lypim: Qeverisna dhe shpëtona.

Pasvargje

Ting. Tërth. I Heris askitikón

Kisha e Krishtit ka gaz të madh* kur sheh kandilin dritëprurës mbi kandiler* të shenjtë, që kishin zbri-tur armiqtë dhe kishin vën'* nën shi-nik²⁰ të heshtjes, atë oshënar,* dhe ty të nderon, sepse* je si mbi mal²¹ virtytesh ti* pishtar i hyjshëm,* që shndrit më shumë se dielli* ane-mbanë pra* me çudi; dhe si në mesdit'* fort të shkëlqyer drejtësinë tënde sot e tregon* nga lart vendimi që s'njeh korrupsion i Zotit tënd Perëndi,* dhe njerëzve mbi dhé* u jep paqen dhe mëshirën e madhe^{6a} me bekim.

Varg: Goja ime do të flasë urtësi dhe studimi i zemrës sime mençuri.

O Krisostom, kutia që mban* lipsanin tënd, si një kuti mirosh ngazëllon,* dhe rrjedhë çudish hyjnore buron mbi dhé, çdo shërim,* te sa të nderojmë miro derdh si çurk;* meqë pasurove fort* me aroma pa lëndë krejt,* pra me karizma* që jep Krishti, dhe ti dhuron* kundërmim të mir',* jetësor gjithnjë te sa vijm'* me vrap dhe me besim, shijojmë hiret e tua pra,* atë i urtë, dëfrejmë kur jemi pranë lipsanit tënd* të hijshëm, të pacen* dhe për shpirtrat besërisht lypim përdëllim të madh.^{6a}

Vargje: Goja e një të drejti do të studiojë drejtësi dhe gjuha e tij do të flasë gjykim.

Matës dhe dhënës gruri mbi dhé,* që me shijimin qiellor, shpirtëror ushqen* çdo zemër, s'vjen nga Egjipti, por si Josifi²² i ri* duket edhe çohet nga Komana larg,* pra përmes lipsaneve* të nderuara, dhe sot pret* me lutjet që bën* turbullimet e dhimbjeve,* detin²³ në stuhi,* ndaj Joanin ta lumërojm',* me besë t'i thërrasim, o vëllezër: I lumur at',* eja në mes të besnikëve që festojnë kujtimin tënd,* u jep pa kursyer* çdo shpëtim edhe mëshirën e madhe^{6a} pasurisht.

Lavdi *Ting. Tërth. II*

O oshënar tri herë i lumur, atë tepër

i shenjtë, bari i mirë²⁴ dhe nxënës i kryebariut Krisht,²⁵ që vure shpirtin për dhentë;²⁴ ti dhe tani, o Joan Krisostom i tërëfamshëm, kërko me ndërmjetimet e tua që të na dhurohet përdëllimi i madh.^{6a}

Tani *Hyjlindësore*

O Hyjlindëse, ti je hardhia e vërtetë^{25a} që nxore frytin e jetës; të lypim, ndërmjeto, o Zonjë, bashkë me hierarkun dhe gjithë shenjtorët, që të mëshirohen shpirtrat tanë.

Përlëshore

Ting. Tërth. IV

Hiri i gojës sate që shkëlqen si pishtar ndriçoi globin, i dorëzoi botës thesare të mosargjenddashjes, na tregoi lartësinë e përlësisë; ndaj duke edukuar me fjalët e tua, o atë Joan Gojart, ndërmjeto tek Fjala Krisht Perëndi, që të shpëtohen shpirtrat tanë.

Lavdi *dhe* Tani *Hyjlinësore*

Ti që linde për ne prej Virgjëreshës dhe durove kryqëzim, o i mirë, që plaçkove vdekjen me vdekje dhe rrëfeve ngjalljen si Perëndi, mos i zhvështro ata që gatove me dorën tënde, trego njeridashjen tënde, o mëshirëplot', prit Hyjlindësen që të lindi të ndërmjetojë për ne, dhe shpëto, o Shpëtimtari ynë, një popull të dëshpëruar.*



NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësore
Ting. I Ton tafon su Sotir*

Me rreze dogmash qart* llamburite mbi dhenë* si diell i stërmadh dhe e flake tej terrin* e injorancës, o Joan Krisostom; përgjërohëm pra* përmes lutjeve* të tua, nga errësira* e përjetshme ti* çliromë dhe denjëso-më* për shndritje shpëtimi, at'.

Lavdi *I njëjti*

Tani *Hyjlindësore*

Pa far' mbajte në bark* vetëm ti Krishtin tonë;* çudi përmbi mendim, si je nënë e virgjër?* Të falemi, të mburrim ty që ke lindur, Hyjlindëse,* Mbretin e lavdis',*²⁶ i lyp që ta paqësojë* botën, kozmosin* dhe shpirtrat të na shpëtojë,* o Zonja e qiejve.

*Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësore
Ting. IV O ipsothis en to stavro*

Si instrument, vegël* e hirshme, e hyjshme,* që po shkëlqen si ar* në Kishë, u fale* nga Krishti, o Gojart, je dallëndyshe me zë* mjalt' të ëmbël, gjithë ne na shndrit* si ar, o mendje me stoli* prej floriri, lira je* e pendimit në botë;* shpëto sa të nderojn' nga ngasje ti* me lutjen tënde;* barí, ty të admirojm'.

Lavdi *I njëjti*

Tani *Hyjlindësore*

Te ti, Hyjlindëse,* pas Zotit përik, rend,* te shtreha jote pra,* se është e shenjtë* dhe lyp i mjeri: O e qashtë, më mëshiro,* se mëkatet janë ngjitur lart,* më lart se koka ime²⁷ pra,* druhem, Zonjë, frikë kam,* nga dënimet; kërkoi* ti, o e thjeshtë, Birit tënd Jisu,* që të shpëtohem* prej tyre në gjyqin tim.

*Pas Polieleit, Ndenjësore
Ting. IV Kateplaji Iosif*

Me votim hyjnor je bër',* i admirueshëm, bari* denjësisht përmbi kopen'* e Krishtit, ke dëbuar tej* përmes hobesë së fjalës ti, porsi ujqë,* shkelësit që rreptë qortoje drejt* pa kursim, i urt', ndaj nga xhelozit* që patën u dëbove larg në udhë* për hir të Kishës, qëndrues fort;* mes rrugës vdiqe,* por erdhe prapë,* dhe dhunti na shpërdan ne.

Lavdi *I njëjti*

Tani *Hyjlindësore*

Josifi u çudit që përmbi natyrën kur pa, dhe at'herë merrte vesh k'të shiun përmbi lëmsh²⁸ në zënien tënde të pafarshme, o Hyjlindëse, ferrën që në zjarr ish e padjegshme,²⁹ shkopin e Aaronit që zu rrënj' e lulëzoj,³⁰ i fejuari yt, ruajtës dëshmoj e u thërriste prift'rinjve: Virgjëresha lind dhe pas lindjes mbetet prapë e virgjër.*

*Shkallesat, Antifoni i parë i Ting. IV
Proqimëni Ting. IV*

Goja ime do të flasë urtësi dhe studimi i zemrës sime mençuri.

Varg: Dëgjoni këto gjithë kombet.

Ungjilli. Psalmi 50.

Lavdi *Ting. II*

Sot kërcejnë në shpirt tërësi kryepriiftërinjsh, duke nderuar tok me ne kujtimin tënd, o hierark Gojart oshënar, ndriçues i Kishës.

Tani. Me ndërmjetimet e Hyjlindëses. Përdëllemë, o Perëndi. *Dhe Idhiomeli.*

Ting. Tërth. II

Trumbetë tingullartë u dëfteve, o fjalartë Gojart, si argjendar i punove zemrat e besimtarëve me mësimdhëniet e tua të punuara me ar; sepse profetikisht doli zëri i dogmave të tua, o atë oshënar, dhe ndriçoi anët e gjithë botës.³¹

*Kanunet: i Hyjlindëses së bashku me
Irmoset në 6 dhe të shenjtorit në 8.*

Ode I

*Kanuni i Hyjlindëses, që ka
Akrostihidhë: "Gëzohu, o tenda e
haresë, zgjidhja e trishtimit. Ode e
Joanit".*

Ting. Tërth. IV

Irmosi: Armatilatin Faraó

»**Q**ëmoti e përmyti Faraonin
»me karrocat çuditërisht* shkop i

»Moisiut* kur në formë kryqi e goditi
»detin që u nda;* Izraelin që ikte me
»këmbë pra e shpëtoi krejt,* ndaj
»një këngë psalte për Perëndin'.^{31a}

Gëzohu, o burim bekimi dhe çlirim mallkimi shumë të lasht',*³² ki gaz, nënë jete,* e rrafshove Hadhin, shfuqizove vdekje, ngazëllo,* zgjidhje je nga trishtimi dhe vend i gjërë me gaz, ki gaz,* o e përhimnuar Hyjlindëse.

Gëzohu, o e tërëpaqortueshme, karroc' mendore me shpirt* je për Fjalën, ki gaz,* o karrocë davidiane me mjaft emra, që u bë* prej shumë mijërash,³³ ki gaz, je më e lart' se çdo Keruvim* dhe se Serafimët pa krahasim.

E hyjshme je më shumë se fuqit' mendore, o Hyjnuse, gëzo,* ki gaz, më e lartë* se të gjith' krijimet që u bënë, gaz ki, o pallat* Perëndie, gëzohu, o fron si zjarr,³⁴ gaz ki, o kandil,*³⁵ gaz ki, Zonj' me mjaft emra, dritë je.

Oe panjollshme, shkop i mbir' nga rrënja e Jeseut,³⁶ ki gaz; më par'* fshehtas u përshkrove* thellësisht përmes filizit të purtekës plot mister* që e kish Aaroni, se lulëzove ti Krishtin Zot,* siç kish çelur kjo ara me çudi.³⁷

*Kanuni i shenjtit
Poezi e Theofanit*

Ting. i njëjtë

Asma anapémopsomen laí

Atë Krisostom, në shpirt kurseve pasurin' e Shpirtit Shenjt,* thesarin, që prej tij me fjalë pasurove* me shumë karizma ti* Kishën, që po kremton sot* denjësisht kthimin tënd krejt të hyjshëm.

O Gojart, me fjalë si ar zbukurove ti stoli dhe petk* të shenjtë fort të Kishës son', të cilën Krishti* e endi më par' me gjak,* ndaj denjësisht kremton kjo* kthimin tënd të hyjshëm, atë.

Guri i patundur, shtylla dhe mbështetja na u shfaqe ti* për Kishën që ndërtoi Krishti,³⁸ gur i qoshes,^{*39} mbi të ke ndërtuar fort* fjalët e shprestarisë,* hierark fort i urtë, si gurë.⁴⁰

Hyjlindësore

O Mari e thjeshtë, e kulluar Zonjë virgjëresh' gjithnjë* e vetmja pa martes', Hyjlindëse e zgjedhur,* e shquar që dominon* mbi çdo krijim, të gjithë* ne të kemi si shpres' ngushëllimi.

*Kanuni tjetër i shenjtit, që ka
Akrostihidhë: "I këndoj Gjuhartin
melodi të tretë. Josif".*

Ting. III

O ta ídhata pale

Ti, o gojë me fjal' të hyjshme, zëartë,* drit' thëniesh, shkëlqim, ndriço

mendjen time* me përgjërimit tënd që të himnoj, o Joan,* për kujtimin tënd dhe kthimin tënd, o atë, me emër,* me famë nga Hiri hyjnor dhe me hijesi.

Si një yll i mëngjesit, diell drit'prurës,* ndriçues shpresëtarie për botën,* kur perëndove ti nën dhé me ligj natyror,* linde përsëri dhe na dërgon ne bijve të tu ti* shkëlqime pa fund të çudive që bën, atë.

Dhenë mbushe përplot përmes gjuhës sate* arfolëse, o shenjt, me mësimdhënie,* me melodi të arta ke shkëlqyer çdo vend,* me ndriçim shërimesh që zhduk errësirë pasionesh* në kthimin tënd, o oshënar famëmadh me hir.

Hyjlindësore

Kur ti, o orator, shpjegove hyjnore,* na the se unike është' Zoti Fjalë* në hipostazë dhe pse i dyfishtë ky ish,* pasi mori mish nga e dëlira, që e bekojmë* pa reshtur dhe e lavdërojmë me bes', Gojart.

Zbritësore: Herson avisotokon

Fundin edhe burimin (*shih fq. 354*)

Ode III I Hyjlindëses

Irmosi: Uranias apsidhos

»Perëndi që apsidë bëre në q'ell si »çati,*⁴¹ ti që je ndërtues i Kishës,⁴² »mirë më siguro* në dashurinë

»që ke;* je maja e çdo dëshire,*
»njeridashës, edhe mbështetja për
»çdo besnik.

Armë krejt e fuqishme e besëmirëve
je,* Zonjë, ki gaz; mbrojtje e fortë, ki
gaz; përkrahje je* për mëkatarët të
gjith',* ki gaz, mur për sa të ftojnë;*
gazi dhe hareja e botës, gëzohu ti.

Je mbështetje e fortë shpëtimi për
njerëzit,* ki gaz, o rithirrje e Evës dhe
e Adamit tok;* e morën prapë me
ty* lavdin' e lashtë, gëzohu,* gazin e
Parajsës sërish çele, ki gëzim.

Ferr' e padjegshme,²⁹ ki gaz, karrocë
drite, gaz ki;* ki gaz, o katedra e
famshme dhe e dëgjuar gjer'* e
mbretit, Zonjë, ki gaz,* je re⁴³ e Die-
llit, ki gaz;* Krishti Zot i gjallë⁴⁴ të ka
si qytet⁴⁵ frymor.

Nënë pa dasmë, ki gaz, o e delirë,
gëzo,* ki gaz, Zonjë, dhé pa lërim,
që s'u kultivove dot,* që rrite brenda
në bark* pra bujkun e Gjithësisë;*
gaz ki, tokë që të vërtetën na linde ti.

I shenjtit: Uk estin ajios

Me mësim të arta e prarove, o atë
i urtë, kurorën e Kishës dhe e stolise
hijeshinë e saj me anën e bukurisë
së fjalëve të tua; për këtë të nderon
denjësisht.

Lëshojnë aromë porsì zambakët

e arës⁴⁶ avujt e lodhjeve të tua, o
hierark oshënar, nëpërmjet të cilave
i pëlqeve Perëndisë, pasi u ndeshe
me rreziqe, shtrëngime dhe tokë të
largët.

Si lule lëshojnë erë të mirë frytet e
fjalëve të tua, duke pikuar mendërisht
ëmbëlsinë e hyjnueshme të urtësisë,
o Gojart, duke na dhënë aromë tani
me virtyte praktike.

Hyjlindësore

Mbetë i pandarë, ndonëse veshe
për mua mish nga një Virgjëreshë;
për këtë të falem ty në dy esenca,
në dy vullnete dhe në dy energji, o
Krisht.

Tjetri: O ek mi onton ta panta

Në largësi internimi të fshehu ty,
kandilin e shndritshëm fort* mbretë-
resha e verbër krejt,* porse Krishti të
risjell* më lart, përmbi kandilerin²⁰
përsëri ty.

O atë, duke pikuar rrëke çudish si
dhe duke derdhur fort* lum' shëri-
mesh, o Krisostom,* erdhe tek sa e
nderojn',* Joan, kujtimin e kthimit
tënd me besë.

Si Nili që rrjedh ar pa fund, vadit plot
me çudi dhe me fjalë vjen* prap';
me besë po rendim pra,* me bollëk
të nxjerrim uj'* që pa kursim ne të
ngopemi të gjithë.

Hyjlindësore

Fuqi natyra e dheshme të të himnojë s'ka, se çdo engjëll ty* të psal, se i dhe Zotit mish,* por guxojm' me bes' dhe himn* të të lëvdojnë shërbyesit e tu pra.

Zbritësore: To steréoma ton epi si
Zoti Krisht

Ndenjësore

Ting. Tërth. IV Tin sofian qe Logon

Kur mësove nga Zoti lart urtësi* si edhe hir fjalimësh, na fekse drit'* mbi çdo qenie si flori* brenda furrës, dhe Shën Trinin'* e predikove si një Njësi, dhe qëlllove drejt* me fjalët si shigjetë mashtrimin e koprracis';* ndaj kur kritikove mbretëreshën me zell ti,* i lum, të dëbuan larg* dhe nga grigja padrejtësisht* ty të ndanë,* Gojart Joan;* ndërmjeto te Zoti yt Krisht,* të na dhurojë ky ndjesën* e fajeve* ne që bëjmë kujtimin tënd fort të shenjt' me mall.

Lavdi *Injëjti*

Tani *Hyjlindësore*

O e Virgjër, ke zënë një prej Trinis'* mbi natyrë, e linde çuditërisht* mbi çdo fjalë dhe koncept,* dhe natyrën e njerëzve* që ishte internuar qëmoti,⁴⁷ e bërë ti* që pjesë në natyrën hyjnore të marrë kjo;*⁴⁸ gjithë të shpëtuarit përmes lindjes sate* u mblodhëm dhe ndjekim pas* fjalën

tënde, të lumërojm'* siç e kemi* detyrë pra,* edhe Krishtit Zot i kërkujm'* që ndjesë të dhurojë,* të të lëvdojm'* porsi nënën e tij me besë, se s'ke qortim.

*Ode IV**I Hyjlindëses*

Irmosi: Si mu iskis Kirie

»Ti je, o Zot,* forca për mua, fuqia »je,* ngazëllimi* si dhe Perëndia »im, ti që s'e le* gjirin atëror*⁴⁹ »dhe e vizitove mjerimin ton',⁵⁰ ndaj »thërras te ti* së bashku me profetë »tin* Abakum: Njeridashës,* lavd »pushtetit, fuqis' sate, Zoti im.

Gëzohu, o Perëndilindëse, re⁴³ e lehtë^{50a} e gjallë, lindja e vezullimit atëror,⁵¹ Diellit që lindi nga Ati para yllit të mëngjesit,⁵² gëzohu, o nënë e virgjër; gëzohu, o e bekuar; gëzohu, o e lavdëruar e tërëpaqortueshme.

Ti je, o Zonjë, temjanica e artë⁵³ e thëngjillit të pakufizueshëm dhe të palëndët, ku dorëshkrimi⁵⁴ i mosbindjes adamiane⁵⁵ pasi u gris, u dogj; për këtë, "Gëzohu" të thërras ty, me anën e së cilës u dha hareja, shijimi dhe prehja.

Ti je lavdia, nderi dhe krenaria e vdekatarëve, kurorë dhe aureolë e engjëjve; për këtë dheu dhe qielli, pasi sistemuan një Kishë tërëharmone të thërrasin: Gëzohu, o Zonja e

botës; gëzohu, ndihma e gjithë njerëzve.

Gëzohu, o Virgjëreshë, shtrati i nderuar e i pruar i shenjtërimtë mendor, të cilin e parapërkroi Solomoni të rrethuar nga gjashtëdhjetë të fortë,⁵⁶ o mashë⁵⁷ hyjnore, gëzohu; gëzohu, o ferrë zjarrprurëse;²⁹ gëzohu, o portë,⁵⁸ shkallë⁴ dhe urë.

I shenjtit: Eks orus kataskiu

U tregove Abraham i ri meqenëse flijove një tjetër Isaak, jetën, dhe ofrove holokaust mistik në zjarrin⁵⁹ e ndërjegjes, o hierark.

Meqë e kishe zili Jakovin, o hyjprurës, u tregove shkallë⁴ jete praktike, duke vënë në zemrën tënde ngjitjet⁶⁰ e kuptimeve të tua të hyjshme.

Pasi e çave me një shkop mistik, me gjuhën, dhe përshkove avushën e tërë të Shkrimit, si Moisiu i transferove njerëzit²³ drejt njohjes së besimit, o tri herë i lumur.

Hyjlindësore

Gëzohu, o thesar i shpëtimit të të gjithëve; gëzohu, burimi mendor i shërimeve; gëzohu, mali i shenjtë⁶¹ që parapa profeti, o Hyjnënë.

Tjetri: Ethu pros imás

O të dashuruar pas fjalës, pasi të

qortojmë me urtësi fjalësh fjalë të kota llafazanërie, ejani ta nderojmë gëzueshëm e me fjalë të hyjshme zbukuruesin e madh të fjalëve, i cili u rikthe.

Na pasurove me pasuri mësimdhëniesh, o Krisostom, dhe ndalon me vendosmëri një dorë të mbushur me lakmi pasurisht, duke qortuar tepër fuqishëm dhe ligjërisht, përmes pasurisë së hirit të hyjshëm.

U thye hark të fuqishmish, arrogancë tirani, teksa ti, pasi jetove si engjëll në dobësi mishit,⁶² mbizotërove,⁶³ duke pasur si shërbëtorë përndjekësit e mëparshëm, o Gojart.

Hyjlindësore

Reshta mendore të psalin me himnime, o Vajzë, sepse atë që nuk kanë fuqi ta shikojnë,⁶⁴ e linde prej mitrës sate të kulluar, kur merrte mish pa ndryshuar, o Hyjnuse e tërë-dëlirë.

Zbritësore: Ekálipsen uranús

Mbulove me virtyte

Ode V

I Hyjlindësës

Irmosi: Ina ti me aposo

»**P**se, o Zot, më ke zmburur* nga »fytyra jote,⁶⁵ o shkëlqim^{65a} pa perëndim,* edhe u mbulova* un' i mjeri »prej territ të huaj krejt,* por, të lyp,

»drejt dritës së porosive^{65b} që the,
»kthemë* edhe udhët e mia drejtoji
»ti.^{65c}

Jepmë të kaloj pa trishtim në kohën
e daljes sime satrapin mendor dhe
kolonën tiranike në ajër, që të të
thërras ty me ngazëllim “Gëzohu”, o
Zonjë; gëzohu, o shpresa e paturpëru-
ar e të gjithëve.

Meqë zure hare, gëzohu, o e
mbipaqortueshme; gëzohu, o e për-
mbikulluar; gëzohu, o lule erëkë-
ndshme dhe e purpurt e dëlirësisë;
gëzohu, trëndafil i kuq i virgjërisë, i
ngjyrosur natyrshëm dhe aroma erë-
mirë e Perëndisë.

Gëzohu, o kuti mistike miroje, që
buron miron erëkëndshme; gëzohu,
krua hyjnor që gufon ujin e gjallë;⁶⁶
gëzohu, o Zonjë, hardhia e pakultivu-
ar, që jep frut bistakun e jetës.

Gëzohu, o portë e pakalueshme,
që e kaloi Krishti Zot;⁵⁸ gëzohu, ti që
hape me lindjen tënde porta Parajse;
gëzohu ti, me anën e së cilës gëzohet
qielli, toka kërcen dhe të sipërmet
bashkohen me të poshtmet.

I shenjtit: O ek niktós agnias

Meqenëse e zbukurove nur stolinë
tënde të hyjshme me arritjet e
mundimeve të tua, e tregove më të
shkëlqyer hierarkinë, o Gojart.

Përshkove trimërisht garë atletike,
o hieromist, duke u dërguar në qytete
të pabanuara dhe në syrgjynosje.

Me rrufenë e fjalëve, e ushtove
diturinë e përmbibotshme, o misti i
sekreteve, kur na hodhe shira dog-
mash.

Hyllindësore

O Hyjnënë, meqë pa prishje linde
birin tënd pa farë, u pe virgjëresha
e vetme që mbaje në gji një foshnjë.

Tjetri: Pros se orthrizo

U pe si pranverë që i aromatizoje
mistikisht nëpërmjet luleve të hireve
turmat e besnikëve, duke e zgjidhur
dimrin⁶⁷ e të këqijave me rikthimin
tënd, o atë.

U kthye rrëkeja e hyjshme, burimi
i karizmave. O të etur, ejani, nxirrni
me besë ujë jete, duke dëfryer⁶⁸
perëndishëm.

“**M**jerë unë, si rrodhe, o bukuria
ime, u fshehe, por në kohë m’u ri-
ktheve i mallëngjyer”, të thërret
Kisha e Krishtit, o atë, kur erdhe
përsëri.

Hyllindësore

Bëje të butë për mua atë që doli prej
barkut tënd, Fjalën mishprurëse, që
duke e mbajtur Simeoni në Tempull,
e madhështoi⁶⁹ si Ndërtues, o e

tërëpaqortueshme.

Zbritësore: Os idhen Isaia

Të pa shën Isaia

Ode VI

I Hyjlindësës

Irmosi: Tin dhéisin ekheó

»**D**o derdh lutjen* para Zotit
 »Perëndi* dhe atij do t'i tregoj hidhëri-
 »met* që kam,⁷⁰ sepse* shpirti im
 »është mbushur* me çdo të keqe
 »dhe jeta po shkon në Hadh;*⁷¹ pra
 »si Jonai lutem un':* Jetën time nga
 »prishja, ti ngrije, Zot.⁷²

Ki, Zonjë, gaz,* je gruask' e gjallë
 krejt* që me gjakun tënd të pacen
 ngjyrose* rrobë, mantel* ngjyrë
 purpur, të kuq flak',* për mbretin e
 Gjithësisë; gëzohu ti,* që zhveshjen
 e atit Adam⁷³* e mbulove krejt, o e
 himnuar fort.

Mbështet, përkrah* zemrat njerëzo-
 re krejt* dhe sipas natyrës buka⁷⁴
 shqisore,* por e forcon* emri yt aq
 i shenjtë* kur psalet, shpirtin e çdo
 i krishteri pra;* kështu me gaz çdo
 gjuh' thërret:* Dëfre, Vajzë, gëzo
 edhe ngazëllo.

Gëzohu ti,* o kandil që shndrit si
 ar,*³⁵ ark⁷⁵ që nxure Perëndi; ki gaz,
 tendë,*⁷⁶ i shejti mal,*⁶¹ ki gëzim,
 je qyteti* frymor i Zotit⁴⁵ të gjallë;⁴⁴
 gëzohu pra,* pallat i Krishtit, ki gë-

zim;* gaz ki, tempull hyjnor që plot
 dritë feks.

Gëzohu ti* e mbipaster pa qortim,*
 lulja më eprore brenda natyrës,*
 hiri që dha* Perëndia, ambicia* e
 shenjtë dhe e përbashkët e njerë-
 zve;* gëzohu, se nderove fort* për-
 mes lindjes natyrën ton' që u mpak.

I shenjtit: Os ton profitin eriso

Oi urtë, le si pasuri fjalët e tua, dhe
 na depozitove si thesare dogmat e
 tërëarta si flori nga minierat, nga
 thellësia e zemrës sate.

Populli duke kremtuar kujtimin
 tënd të tërëshenjtë, o Gojart, e lavdë-
 ron Zotin që të zgjodhi dhe të ftoi në
 tendat e amshuara.⁷⁷

Dhe pse i vdekun në varr, jeton në botë
 dhe predikon pendim,¹ o Krisostom,
 dhe shkruan duke garantuar ndjesë
 për ata që pendohen nxehtësisht.

Hyjlindësore

Le t'i falemi si Perëndi dhe Zot atij
 që ishte në duart e Virgjëreshës dhe
 rri në gji Ati,⁴⁹ atij që veshi mish dhe
 mbeti i pakthyesëm.

Tjetri: Avisos eskati

Duke të qortuar keq mbretëresh'
 paranojake* të pret nga Kisha e Kri-
 shtit,* por menjëher' pritët, teksa e
 qorton përjetë ti,* kur e bëre më pa-

rë prerjen e duhur fort.

O Gojart, u shfaqe si instrument i Shpirtit, bërës* i gjithçkaje, që tingëllon* melodi, ndërsa tirani shurdhet si nepërk' në këng' *⁷⁸ dhe shpaguhet me vdekje fatkeqe e mjerisht.

Shën Gojarti qart' u mësoi mbretërve se s'kish rast* të pësonte edhe pse vdiq,* se më parë urdhrave të tyre nuk iu bind aspak,* veçse erdhi prap' sipas lutjes së tyre ky.

Hyllindësore

Hodhi tej trazimin dhe ndarjen shën Joan Gorjarti,* sepse edhe si more mish* prej një Virgjëreshe, ishe i dyfishtë, ndonëse* vetëm një, Perëndinjeri, të kuptonte ty.

Zbritësore: Evóisé si

Kur Simeoni

Kontaqi

*Ting. I Horós angjelicós
(= Ton tafon su Sotír)*

Dëfreu mistikisht* Kisha jon' e nderuar* në transferimin tënd, të lipsanit të shenjtë;* e fshehu krejt si ar të çmuar dhe me ndërmjetimin tënd* u dhuron gjithnjë* atyre që të himnojnë,* hir shërimesh, ndjes'* si edhe falje mëkatesh,* o shën Krisostom Joan.

Shtëpia

Llambadha e punëve të mia është e vagët, o Joan Gojart, dhe druhem të mikpres lipsanin tënd të hyjshëm; por ti vetë udhëhiqmë dhe drejto rrugët e mia duke më dhënë kohë pendimi, o i tërëshenjhtë, si prediku-esi i saj¹ i perëndishëm, dhe fashit turbullimin e pasioneve të mia të shumëllojshme; dhe pasi të më rrëmbesh nga kurthet e beljarit, shpëtomë përfundimisht, që të himnoj denjësisht rikthimin tënd të hyjnueshëm, sikundër duke guxuar e lavdërova më parë edhe fjetjen tënde, o shën Krisostom Joan.

Sinaksari

Më 27 të të njëjtit muaj, transferimi i lipsanit të atit tonë ndër shenjtorët Joan Gojarti, kryepiskop i Konstandinopojës.

Vargje: I vdekur ulesh, o Joan në fron,/ por duke jetuar në Perëndinë thua: Paqe në të gjithë!⁷⁹

Në të njëzet e shtatën sollën trupin e artë pa frymë.

Në të njëjtën ditë, shën Markiana mbretëreshë, në kishën e Apostujve të shenjtë, mbaron në paqe.

Vargje: Krishti, mbreti i mbretërve,⁸⁰/ nxjerr nga jeta mbretëreshën Markiana.

Në të njëjtën ditë, oshënar Klaudini, mbaron në paqe.

Vargje: O Klaudin, kur i dashuruari pas shpitrave/ e pa të lartësuar bukurinë e shpirtit tënd, të merr ty.

Në të njëjtën ditë, oshënar Petro egjiptiani, pasi erdhi në pleqëri të thellë, mbaron në paqe.

Vargje: Si grurë i pjekur nga pleqëria, o Petro,/ mblidhesh në varr si në hambar.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atit tonë oshënar Klimi në Sagmata.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirit të ri Dhimitër verëshitësit, i cili u martirizua në Konstandinopojë në 1784.

Me ndërmjetimet e tyre të shenjta, o Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII

I Hyj lindëses

Irmosi: Theú singatávasin

»Dikur zjarri kishte turp* në Babilonë, kur bashkëzbriti pra Zot,*⁸¹
»brenda furrës ndaj Djemtë* si në
»lëndinë me këmb' të lumura fort*
»kërcenin lart duke psalur: O Perëndi* dhe Zot i etërve tanë, i bekuar
»je ti.⁸²

Gëzohu, o Zonjë, e vetmja që s'pate përvojë burri, e vetmja e paprishur, e virgjër dhe nënë që linde fëmijë pa dasmë, gëzohu, o mister i huaj dhe i

frikshëm; gëzohu, o shijimi i engjëjve; gëzohu, o ngazëllim i njerëzve.

Gëzohu, o Hyjnuse, Sioni për të cilin u folën lavdërime, qyteti i gjallë i mbretit⁴⁵ të mbretërve, Krishtit;⁸⁰ gëzohu, o shkallë, me anën e së cilës kalojmë nga toka te qielli⁴ dhe nga prishja te jeta.⁸³

U tregove, o Virgjëreshë, livadh i hyjmbjellë, kopsht i hyjmbirë dhe erëkëndshëm, që lulëzove lule padekësie; për këtë të thërrasim njëzëri: Gëzohu; gëzohu, o dhënëse gazi; gëzohu, o burim ëmbëlsimi.

O Zonjë e përmbinderuar, çliromë nga çnderim pasionesh,⁸⁴ që të të thërras me ngazëllim "Gëzohu"; gëzohu, o burim dëlirësie; gëzohu, o arkë e çdo pastërtie; gëzohu, o enë Perëndie; gëzohu, o vend i Krishtit.

I shenjtit: O tus Pedhas dhrosisas

U njohe hyjfolës i përpiktë dhe përkrahës i përbashkët i atyre që mëkatuan në botë, o oshënar, duke siguruar pendimin.

Kur u ndeze si ar në furrën e rreziqeve, o hierark, nuk u shkrive, nuk u dogje, se pasi u sprovove,⁸⁵ i tregove më autetike mundimet e tua.

Nuk re në dremitje në luftëra, nuk të erdhi turp nga pushtetarët, nuk

preferove padrejtësi në vend të drejtësisë, o oshënar, dhe për këtë dëshmon ara e vejushës.

Hyllindësore

O Perëndilindëse, gëzohu, o re⁴³ e lehtë;^{50a} gëzohu, o portë, të cilën e kaloi vetëm Perëndia⁵⁸ ynë, kur pa farë lindi bir pa ndryshuar prej teje me lindje të paprishshme.

Tjetri: Os pale tus efsevis

Gruaja që kishte guxim arrogant për të gjitha, e huaj për hirin e hyjshëm, sepse ishte e huaj për mësimet e tua të urta, të bën të huaj për qytetin mbretëror, meqë thoje se nuk do kishte falje për të, nëse vejusha do bëhej e huaj për pasjen e saj, o i urtë.

Por i këndshëm u ktheve, porsì diell që u fsheh nga re, o ndriçues shumë i madh, duke i llamburitur tepër me shkëlqimin mistik të dogmave të tua të arta gjithë të ndriçuarit, o Joan Gojart.

Duke kremtuar Kisha sot të thërret: O Krisostom, ngre pëllëmbët e mia për ty, që të të marr brenda mbulesës ty, mblesin, si dashurinë e përhershme, që vjen përsëri shkëlqyeshëm.

Hyllindësore

Drejt Tempullit vjen ti si mashë mistike, që mban thëngjillin⁵⁷ me-

ndor; o e tërëkulluar, Simeoni do të shkëlqejë kur ta presë në duar atë,⁶⁶ dhe do t'i profetizojë tepër qartazi simbolet e pësimit.⁸⁶

Zbritësore: Se ton en piri

Hodhe vesën

Ode VIII

I Hyllindëses

Irmosi: Evlojite Pedhes

»**E** bekonì Djema* si Trinia nga »numëri, Atin q'ellor, të vetëmin »Zot,* himnoni* Fjalën që mbi dhe- »në zbriti* dhe e bëri vesë zjarrin e »furrave,*⁸¹ dhe e lartësoni ju Shpirtin e Tërëshenjtë,* që u dhuroi që »të gjith've jetën.*

Gëzohu, o shkop që mbive nga rrënja e Jeseut;³⁶ gëzohu, ti që lulëzon pa vaditje një lule të bukur, Krishtin; gëzohu, o mal i majmë, gëzohu, o i tërëhijeshuar;⁸⁷ gëzohu, o mal Perëndie, ku Fjalës së gjithçkaje i pëlqeu para jetëve të banojë.⁸⁸

Me bastunin tënd të hekur⁸⁹ si ndihmës të fuqishëm, zmbropsi si qentë që lehin, si bisha që ulërijnë,⁹⁰ pasionet që e rrethojnë shpirtin tim të përulur dhe më qarkojnë në luftë, që të të thërras ty, o e Virgjër: Gëzohu!

U zbukurove e tëra, kur e linde Krishtin, të bukurin me hijeshi më

tepër se bijtë e njerëzve,¹⁰ o e bukur mes grash,⁹¹ për këtë të thërrasim me ngazëllim: Gëzohu; gëzohu, o Perëndilindëse e kulluar, Hirplote,⁹² gëzohu ti, më e lavdishme se Krijesa.

Gëzohu, o Hyjnënë, mal i palatuar që pa Danieli më parë, nga u pre gur⁹³ qosheje;³⁹ gëzohu, o hyjpranuese, mashë thëngjillmbajtëse,⁵⁷ gëzohu ti, më e shenjtëruar se engjëjt pa lëndë; gëzohu ti, më e çmuar se Krijesa.

I shenjtit: I teorímones Pedhes

Gjuha jote hyjfolëse, kur jehoi nga qielli në botë si trumbetë e farkëtuar me ar, o hierark i Krishtit, e dëboi nga sytë këmbët mashtrimin.

O celebrues i mistereve të parrëfyeshme, mist që lëviz në të larta dhe luftëtar i Trinisë, mos pusho së përgjëruari që të shpëtohet tufa jote.

Meqë adhuron Triadhën dhe rri tok me korin e engjëjve, o oshënar hierark, mos pusho së përgjëruari që të shpëtohen shërbëtorët e tu.

Hyjlindësore

Nxore lastar kur u ngjiz mbinatyrshëm në barkun tënd bistaku i pakultivuar, o Virgjërnënë, ndaj denjësisht të gjithë të thërrasim: Gëzohu!

Tjetri: Astekto piri

O atë oshënar, e mëkon me gji shpresëtarie Kishën që të ushquu, duke i kthyer si shpërblim asaj bukë të shtatëfishtë Hiri hyjnor shpenzimet e rritjes dhe duke derdhur bollshëm si pije mushtin e shërimeve, o i tërë-lumur Gojart.

Në tërë dheun arriti zëri³¹ i dogmave të tua, o atë, por mbretëresha paranojake mendoi se do të të kufizonte nga ana e vendit, por u gënjye, sepse ti si një gjigant që vrapoje lart, i ndriçon të gjitha me rrezet⁹⁴ e fjalëve.

Shkëlqe sot, o bashkësi e besnikëve duke e mikpritur me hare eprorin e mësuesve; sepse erdhi, arriti duke u shpërndarë të gjithëve Hirin pa kursim; le të mbushemi me të pasurisht të ngazëlluar.

Hyjlindësore

“Të shoh në kraharor nëne, por të njoh të paafrueshëm sipas natyrës së Hyjnisë; si, o Fjalë, mbahesh në duar, ti që e ke në dorë Krijesën e tërë?”,⁹⁵ – tha Simeoni, o Perëndinjeri, duke e lavdëruar⁶⁹ pushtetin tënd sekret.

Zbritësore: Astekto piri

Në flak’ e në zjarr

*Ode IX
I Hyjlindësore*

Irmosi: Efrikse pasa akoi

»Frika ka zënë çdo dëgjim* nga de-
 »njimi i pashprehshëm i Zotit Krisht;*
 »pra si i Larti krejt* vullnetarisht
 »zbret deri në trup pasi* u bë njeri
 »prej barku virgjëror dhe pa cen
 »aspak;* prandaj Hyjlindësen* e
 »panjollshme, ne besnikët e madhë-
 »rojm'.

Ja, si ti the profetkisht,* o Hyjnën',
 prej Shpirtit Shenjtë, të mburrim
 ty,*⁹⁶ gjithnjë të lumurën* dhe meqë
 linde gazin, thërrasim ne:* Gëzohu,
 o thesar i jetës; gaz ki, se krua je*
 që mjaltin na buron* shpirtërisht,
 prandaj gëzohu, hare je ti.

Shkarjen e rimëkëmbe ti* të Ada-
 mit paraatit⁵⁵ dhe ktheve krejt* bre-
 ngën e Evës nën'*⁹⁷ në gaz, ndaj si
 shkaktaren e gazit ton',* "Gëzohu"
 të thërrasim, o hare e besnikëve,*
 gëzohu, je gazim,* ngazëllim për të
 krishterët, gëzohu pra.

E meriton të të thërras* "Ki gëzim",
 se brenda teje fushoi mu* në thelb
 për ne harë,* që është gaz i amshuar,
 hyjnënë Vajz';* Parajsë plot shijim⁹⁸
 gëzohu, gaz ki burim i art'* i pavdekë-
 sisë ti;* rrjedh ushqim, nektar nga
 Zoti, gëzohu pra.

Malli yt shpon me ëmbëlsi* si shi-
 gjetë zemrën, o e himnuar fort,*
 më detyron gjithnjë* të të thërras:

Gëzohu, liman i qet';* gëzohu, se për-
 mbyte Faraonin²³ mendor, demon;*
 ti det i ëmbël je,* që përshkruhesh
 lehtësisht edhe lart na çon.

I shenjtit: Ton prodhilothenta

Si një tjetër lumë nga ari, u pe i
 artë,* atë, gjuha jote plot ëmbëlsi;
 dhe goja jote* si flori i vadisin për
 ngimje* zemrat* që u than', me
 oqean dogmash.

Si det i pashkelur dot ish Shkrimi,
 por e bëre* të lundrueshëm, o atë,
 për botën, kur e ngrite* fjalën tënde
 si vel dhe drejtove* mendjen* shpejt
 te njohja që nuk mbytet dot.

Pasi prej burimi që s'soset i nxore
 rrjedhat,* derdh në Kishë ti lumenjtë
 e dogmave; të gjithë* ne të eturit
 nxjerrim, Gojart shenjt,* rryma,*⁶⁸
 çurka ari, Krisostom zëmadh.

Hyjlindësore

Shihte para tij Moisiu qëmoti
 ferrën* që po ndizej, por nuk digjej,²⁹
 Hyjnënë Virgjëreshë;* qe simboli i
 barkut tënd që zjarr* priti* pra hyjni
 pa cen a dëm, Krishtin.

Tjetri: Kenón to thavma

Me ne gëzohen shoqëri profetësh,
 apostujsh, kor i shenjtë me martirë,*
 ushtri engjëjsh, kanë gaz me ne;*
 të gjith' marrin pjesë,* i tërëlumur,
 në festim edhe vlerësojn'* se hiri i

himneve të tua* është i tyre, se thithe jetën e tyre brenda ti.

Shkëlqeu shndritja e planetit, ja ku u shfaq pishtari yn' i tërëlartë,* hyjnor, deti plot me ëmbëlsi,* me hire të shenjta* si rrjedha, që të mbushemi me drit', ejani* vëllezër, të ngrohemi, dhe zemrat* ne t'i vaditim pra me himnin për Gojartin madhërisht.

Si dy të hollat ti pranoje këngën prej zemrës frikacake dhe të humbur,* vejusë⁹⁹ nga çdo të mirë pra* veçse kjo po sillet* me pasuri nga malli i devotshëm, o shenjt,* se ti, o i tërëlumur atë,* je imitim mirësie hyjnore; më shpërble me hir.

Hyjlindësore

Po dridhem duke ecur, —Simeoni⁶⁹ tha— por forcohem duke mbajtur birin* që, o Virgjëreshë, linde ti;* ai tërë dheun* kur e shikon e tund,¹⁰⁰ por na sjell një lajm të bardh'* me gaz, pra çlirim për sa në Hadh jan',* se u përmbush profecia, zgjidhem¹⁰¹ nga mishi, nga ky burg.

Zbritësore: En nomo skiá qe grámati

O Hyjlindëse Mari

dhe

Në Ligjën dhe Shkronjën

Dërgimësore

Jinekes akutísthite

Gëzohu, o qytet i madh,* pra mbreti i qyteteve,* lipsan të shenjtë po merr sot,* atë të kryebariut* plot mirësi,²⁴ që sistemon* e shpëton Gjithësin' me ty;* ky është Gojarti, Krisostom,* që na pikon mjaltë; ndaj himn* këndo me duartrokkitje.

Hyjlindësore

Mari e hyjstolisur krejt,* ti ke lavdi të frikshme,* mbrojtjen e ke të patundur* Hyjlindëse, në mbar' dhe-në;* ne tani mburremi në ty,* je për ne ndërmjetuese,* ndaj te Ndërtuesi yt Bir* gjithnjë për ne lyp shpëtimin* me lutjen tënde pa gjumë.

Lavdërime

Ting. IV 'Edhokas simíosin

Më shumë se ari vezullojn' mësimet e tua krejt* që na derdh, atë shën Gojart;* me to na po pasuron* çdo mendje të varfër* dhe dëbon larg mjegullën e pasionit, gjithashtu* dhe dimrin e argjenddashjes që tmerron* dhe hidhëron; detyrimisht të lumërojmë dhe pluhurin* e lipsanit tënd e nderojm'* si burim shenjtërimi ne.

Pa të drejt' nga grigja jote u dëbove në internim,* oshënar, përqafove ti* mjaft dhimbje dhe pikëllim* me largim të hidhur;* ndaj u denjësove krejt prej këtyre për mbarim* të lumur dhe për përsosje si atlet* fort

trim, që munde intrigantin djallëzor; Kisha pra gëzon* gjatë kthimit tënd, se urtisht* e stolise me dogma ar.

Shtyllë e përflakur,⁴³ lumë krejt i bollshëm me rrjedha plot,* ujë dogmash, e urta goj',* garanti i shkelësve,* mendja fort e lartë* e theologjisë, lëcitësi me shenjtërim* i metanisë,¹ ndriçuesi me nam,* i çiltër, i veçantë dhe njeri përmbiqëllor, zëmadh,* Krisostomi i lumur shenjt* sot të ketë prej nesh nderim.

Si stoli prej mbreti, o Gojart, qyteti që mbretëron* e ka pritur lipsanin tënd;* me të mburret, është' krenar* për të gjitha fjalët* që i the dhe fton kosmosin në gaz, të marrë pjes'*¹⁰² të hyjshme krejt në karizma dhe në hir* që jep ti, dhe thërret me zë të madh: Jisu Perëndi dhe Zot,* i përmbimire, je për ne* shërbëtorët e tu lavdi.

Lavdi

Ting. IV I Gjermanoit

O atë Gojart, pasi vrapove si lumë i hyjburuar që del nga Edeni mistikërisht, përshkove katër fillime, skajet e tokës¹⁰³ përmes fjalëve të tua, dhe vadite çdo besimtar me anën e mësimdhënies sate të tërëartë; për këtë, meqë qartas na e shkrove zyrtarisht rikthimin e lipsaneve të tua të hyjshme, ndërmjeton që të shpëtohen shpirtrat e atyre që të

përhimnojnë, o Joan.

Tani *Hyjlindësore*

Nga çdo lloj rreziku ruaji shërbëtorët e tu, o Hyjlindëse e bekuar, që të të lavdërojmë ty, shpresën e shpirtrave tanë.

Dhoksologjia e Madhe.

Në Liturgji, Tipiket dhe nga Kanunet e shenjtit, Odet III dhe VI. Kontaqi Ti që e shenjtërove (shih fq.356). Kungatore: Në kujtim të përjetshëm.

CITIME

¹ Is. 40.3; Matth. 3.23; Mark. 1.34; Lluk. 3.34

² Ps. 106(107).26

³ Lluk. 20.36

⁴ Gjen. 28.10-12

⁵ Ps. 29(30).13; 56(57).8; 107(108).2; Lluk. 1.47

⁶ Ps. 131(132).4

^{6a} Num. 14.19 etj.

^{6b} Lluk. 1.49

⁷ Ps. 44(45).10

⁸ Gjen. 1.26-27; 5.1; 9.6; Urt. Sol. 2.23; Sirak 17.3

⁹ Matth. 18.12-13; Lluk. 15.4-5

¹⁰ Ps. 44(45).3,8

¹¹ Vep. 20.28

¹² Lluk. 1.75; Ef. 4.24

¹³ Ps. 44(45).4

¹⁴ Hebr. 4.14

¹⁵ Hebr. 7.26

¹⁶ Is. 61.10

¹⁷ Kënga 5.1

- 18 Matth. 9.15; Mark. 2.19-20; Lluk. 5.34-35; Joan 3.28-29
 19 Urt. Sol. 7.26
 20 Matth. 5.15; Mark. 4.21; Lluk. 8.16; 11.33
 21 Matth. 5.14
 22 Gjen. 47.12-14
 23 Eks. 14.21-29
 24 Joan 10.11,14
 25 I Petr. 5.4
 25a Joan 15.1
 26 Ps. 23(24).7 etj.
 27 Ps. 37(38).5
 28 Gjyq. 6.37-38; Ps. 71(72).6
 29 Eks. 3.2-5
 30 Num. 17.23; Hebr. 9.4
 31 Ps. 18(19).5
 31a Eks. 14.15-15.21
 32 Gjen. 3.16-19
 33 Ps. 67(68).18
 34 Jez. 1.13-26
 35 Eks. 25.30-37; 35.16; 38.13; 40.22; Num. 4.9; 8.2
 36 Is. 11.1,10; Rom. 15.12
 37 Num. 17.23; Hebr. 9.4
 38 I Tim. 3.15
 39 Ps. 117(118).22; Is. 28.16; Ef. 2.20; I Petr. 2.6
 40 I Kor. 3.11-12
 41 Gjen. 1.7; Is. 40.22
 42 Ef. 2.20-21
 43 Eks. 13.21-22; 14.24; 16.10; 19.9; 34.5; Num. 9.15; 11.25; Ligji i Dytë 31.15
 44 Jis. N. 3.10 etj.; I Tim. 3.15
 45 Ps. 45(46).5; 47(48).1-2,9; 86(87).3; Hebr. 12.22; Apok. 3.12
 46 Matth. 6.28
 47 Gjen. 3.24
 48 II Petr. 1.4
 49 Joan 1.18
 50 II Kor. 8.9
 50a Is. 19.1
 51 Urt. Sol. 7.26; Hebr. 1.3
 52 Ps. 109(110).3
 53 Hebr. 9.4
 54 Kol. 2.14
 55 Gjen. 3.2-6
 56 Kënga 3.7
 57 Is. 6.6-7
 58 Jez. 44.1-4
 59 Gjen. 22.1-13
 60 Ps. 83(84).6
 61 Ps. 2.6 etj.; II Petr. 1.18
 62 Rom. 6.19; Gal. 4.13
 63 II Mbret. [Sam.] 2.4
 64 Is. 6.2
 65 Ps. 42(43).2; 73(74).1
 65a Joan 1.4,9; 3.19; 8.12; 9.5; 12.46
 65b Fja. Urt. 6.23
 65c Ps. 5.9; 118(119).5
 66 Gjen. 21.19; Joan 4.10
 67 Kënga 2.11-12
 68 Is. 12.3; 55.1
 69 Lluk. 2.25-28
 70 I Mbret. [Sam.] 1.15; Ps. 141(142).3
 71 Ps. 87(88).4
 72 Jona 2.6-7
 73 Gjen. 3.7
 74 Gjyq. 19.5,8; Ps. 103(104).15
 75 Eks. 25.9-20; 38.1; Ligji i Dytë 10.2; Ps. 131(132).8; Hebr. 9.4
 76 Eks. 25.8 etj.; Ps. 45(46).5; 131(132).5; Hebr. 9.2
 77 Lluk. 16.9

- ⁷⁸ Ps. 57(58).5-6
⁷⁹ I Petr. 5.14
⁸⁰ I Tim. 6.14-15; Apok. 17.14; 19.16
⁸¹ Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 25-26
⁸² Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 2,27-28
⁸³ Ps. 102(103).4
⁸⁴ Rom. 1.26
⁸⁵ Urt. Sol. 3.6
⁸⁶ Lluk. 2.35
⁸⁷ Abak. 3.3
⁸⁸ Ps. 67(68).16
⁸⁹ Ps. 2.9
⁹⁰ I Petr. 5.8
- ⁹¹ Kënga 5.9; (17)6.1
⁹² Lluk. 1.28
⁹³ Dan. 2.34-35
⁹⁴ Ps. 18(19).6
⁹⁵ Est. 4.17b; Ps. 94(95).4; Jov 9.19
⁹⁶ Lluk. 1.48
⁹⁷ Gjen. 3.16
⁹⁸ Gjen. 2.15; 3.24
⁹⁹ Mark. 12.42; Lluk. 21.2
¹⁰⁰ Ps. 103(104).32
¹⁰¹ Lluk. 2.29
¹⁰² Lluk. 15.9
¹⁰³ Gjen. 2.6,10



MË 30 TË TË NJËJTIT MUAJ

Kujtimi i Etërve tanë ndër shenjtorët dhe i Mësuesve Ekumenikë, Vasilit të Madh, Grigor Theologut dhe Joan Gojartit.

*Tipikon***1. Nëse bie në një nga të dielat para Triodhit:**

Të shtunën në Mbrëmësore, Thirrtores: 4 ngjallësore dhe 6 të shenjtorëve. Lavdi i shenjtorëve. Tani Hyjlindësore dogmatike e tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni. Leximet. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi i shenjtorëve. Tani ngjallësor (Tempull dhe derë). Përlëshoret: ngjallësore, e shenjtorëve dhe Hyjlindësorja e tyre.

Të dielën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Kanuni Triadik, Litia e shenjtorëve dhe Himne Triadike. Trishenjtë. Përlëshorja e shenjtorëve. Në Mëngjesore, pas Stihologjisë së parë dhe të dytë, nga një Ndenjësores ngjallësore dhe nga një e shenjtorëve bashkë me Hyjlindësoret e tyre. Pas Polieleit, Ndenjësores e shenjtorëve bashkë me Hyjlindësoret e tyre. Bekimtores. Ipakoia. Shkallsat dhe Proqimeni i tingullit. Kanunet: ngjallësor dhe të shenjtorëve. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia ngjallësore, dhe Ndenjësores e shenjtorëve bashkë me Hyjlindësoren e tyre. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e shenjtorëve, dhe Sinaksari. Zbritësoret Fundin edhe burimin; dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor. Më të nderuarën dhe më pas Ode IX Ngjallësore dhe të dy Kanunet e shenjtorëve bashkë me madhështimet e tyre. Dërgimësoret: ngjallësore dhe të shenjtorëve bashkë me Hyjlindësoren e tyre. Lavdërimet: 4 ngjallësore dhe 4 të shenjtorëve. Lavdi i shenjtorëve. Tani E përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji, Tipiket. Lumërimet: 4 të tingullit dhe 4 nga Ode VI e shenjtorëve. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore, e shenjtorëve dhe e kishës. Kontaqi Ti që e shenjtërovet. Apostulli i shenjtorëve dhe Ungjilli i së dielës. Kungatore Në gjithë dheun.

2. Nëse bie të Dielën e Tagrambledhësit dhe të Fariseut

Të shtunën në Mbrëmësore, Thirrtores: 4 ngjallësore, 2 të Triodhit dhe 4 të shenjtorëve. Lavdi i Triodhit. Tani Hyjlindësore dogmatike e tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni. Leximet e shenjtorëve. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi i shenjtorëve. Tani i Triodhit. Përlëshoret: ngjallësore, e shenjtorëve dhe Hyjlindësorja e tyre.

Të dielën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Kanuni Triadik, Litia

e shenjtoreve dhe Himne Triadike. Trishenjtë. Përlëshorja e shenjtoreve. Në Mëngjesore, pas Stihologjisë së parë dhe të dytë, nga një Ndenjësore ngjallësore dhe nga një e shenjtoreve bashkë me Hyjlindësoret e tyre. Pas Polieleit, Ndenjësore e shenjtoreve bashkë me Hyjlindësoret e tyre. Bekimtoret. Ipakoia. Shkallesat dhe Proqimeni i tingullit. Kanunet: ngjallësor, i Triodhit dhe i dyti i shenjtoreve. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia ngjallësore, dhe Ndenjësoret e shenjtoreve bashkë me Hyjlindësoren e tyre. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e Triodhit, dhe Sinaksari i shenjtoreve si dhe i Triodhit. Zbritësoret Fundin edhe burimin; dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor. Më të nderuarën dhe më pas Ode IX e Kanuneve: ngjallësor, i Triodhit dhe i dyti i shenjtoreve bashkë me madhështimet e tij. Dërgimësoret: ngjallësore, e Triodhit dhe të shenjtoreve bashkë me Hyjlindësoren e tyre. Lavdërimet: 3 ngjallësore, 2 të Triodhit dhe 3 të shenjtoreve. Lavdi i Triodhit. Tani E përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji, Tipiket. Lumërimet: 4 të tingullit dhe 4 nga Ode VI e Triodhit. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore, e shenjtoreve dhe e kishës. Kontaqi Ti që e shenjtërove. Apostulli i shenjtoreve dhe Ungjilli i së dielës. Kungatore Në gjithë dheun.



NË MBRËMËSOREN E VOGËL

Thirrto

Ting. IV Os jeneon en mártisin

O oshënar Vasil, kur u ngjite në lartësinë e dashurisë së Krishtit, sodite misteret e tij sekrete dhe hyjnore, të cilat i zbulove dhe ua shpalle popujve, si predikues i urtë shpresëtarie; për këtë ndërmjeto që të çlirohen nga prishja dhe rreziqe ata që ndjekin besërisht mësimdhëniet e tua.

O oshënar Grigor, shpërbëre lidhjet¹ e herezive, me urtësinë e fjalëve dhe

dogmave të tua dhe i mblodhe në një mendje për besimin orthodhoks dashamirësit që lavdërojnë Krishtin, të cilit përgjëroju që të çlirohen nga prishja dhe rreziqe ata që i mirëpresin besërisht dogmat e tua hyjfolëse.

O atë oshënar Gojart hyjfolës, Krishti të vuri themel mbështetës të paçarë te Kisha e tij, të cilën e ruan të patundur dhe të paluftueshme nga sulmet e armiqve; dhe ndërmjeton që të çlirohen nga pasionet shpirtprishëse ata që kanë etje për oqeanin e fjalëve dhe të kuptimeve të tua.

Le të lavdërojmë Joanin e madh tok me Grigor Theologun e hyjshëm dhe Vasilin lartmendës si të zgjedhur të Trinisë, lule erëkëndshme tepër të ëndshme, lëndinë pa cen, se janë rreze të Diellit mendor, të cilët e ndriçuan dheun me shkëlqimet e tyre të hyjshme.

Lavdi *Ting. Tërth. II*

Onjerëz të Perëndisë,² shërbyes besnikë,^{2a} meshtarë të Zotit,^{2b} burra dëshirash,³ enë të zgjedhura,⁴ shtylla dhe mbështetje të Kishës,⁵ trashëgimtarë të Mbretërisë,⁶ mos heshtni së thirruri për ne para Zotit.

Tani *Hyjlindësore*

OHyjlindëse, ti je hardhia e vërtetë,^{6a} që nxore frytin e jetës; të lypim ndërmjeto, o Zonjë, bashkë me hierarkët dhe me gjithë shenjtorët, që të mëshirohen shpirtrat tanë.

Pasvargje

Ting. Tërth. II Triimeros anestis

Hristé

Hiri triumfoi, besimi mbizotëroi, të gjitha u mbushën me dituri Perëndie⁷ me anën e apostujve, e Mësuesve; dhe u pasuriam me shpëtim.

Varg: Do të mburren oshënarët në lavdi.

Mistere qiellore, mësime njerëzore, grumbullim karizmesh të shumëllojshme, bashkë me arritje që tejkaloj-

në çdo fjalë i madhështuan tre shenjtorët.

Varg: Priftërinjtë e tu, o Zot, do të veshin drejtësi dhe oshënarët e tu do të ngazëllohen.

Vasili, mendja e perëndishme, Grigori, zëri hyjnor, Joani, ndriçuesi botëror,⁸ tre shërbyesit dhe meshtarët e Trinisë më të sipërme, le të bashkë-lavdërohen.

Lavdi *Ting. Tërth. II*

Ju lumtë, o shërbëtorë të mirë dhe besnikë,⁹ ju lumtë, o punëtorë të vreshtit të Krishtit; ju mbajtët edhe peshën e ditës¹⁰ edhe shumëfishuat talentin që u dha te ju¹¹ edhe nuk i patët zili ata që erdhën pas jush;¹² ndaj është hapur për ju portë qiejsh;¹³ hyni pra në harenë e Bërësit¹¹ dhe ndërmjetoni për ne, o mësues të shenjtë.

Tani *Hyjlindësore*

Askush që përik te ti, nuk largohet i turpëruar nga ti, o e Virgjër Hyjlindëse e kulluar, por kërkon Hirin dhe merr dhuratën sipas interesit dhe kërkesës.

Përlëshore

Tre ndriçuesit tepër të mëdhenj.



NË MBRËMËSOREN E MADHE

*Pas Qëndrimit të parë të Psaltirit
(Lum ai njeri),
Thirrto*

Ting. IV Os jeneon en mártisin

Instrumentet e Hirit Shenjt* dhe kitarat e Shpirtit Zot,* pra trumbetat me zë të qart¹⁴ për predikim* dhe bubullimat që me fuqi gjëmojnë nga lart me tmerr* Perëndinë me lavdi* dhe e njohin kudo mbi dhé* denjësisht të gjith'* me Joanin, Vasilin dhe Grigorin t'i nderojmë, predikues të Shën Trinisë së madhe krejt.

(2x)

Luftëtarët e Shën Trinis',* kullat e shprestarisë son',* tre apostujt pra pas të dymbëdhjetëve,* lumenj që ujë të gjallë nga Edeni po na burojnë* dhe vadisin gjallëri* me rrëke të hyjnueshme,* faqen e dheut,*¹⁵ elementet madhore që e lidhin besën si Krijesën mbarë, t'i mburrim siç u ka hije na.

(2x)

Është shkruar: S'ka thënie, fjal'* që s'dëgjohe dot zë i saj,* se vrapuan fjalët në çdo det dhe stere,*¹⁶ pra të Mësuesve mjaft të urtë, të perëndishëm krejt* të Krijesës, ndaj çdo vend* permbi botë u lidh edhe* plot fuqi qëndron* në të vetmen Orthodhoksi shkëlqyeshëm me legji-

slacionin e tyre fort të hyjnueshëm.

Instrumentet e Shpirtit Shenjt,* e vërteta i ka bori,* oratorët famëmëdhenj të Fjalës Krisht,* le t'i lëvdojnë me himn e zë, sa shkojnë pas dogmave* që formuan besërisht* dhe t'i lypin, se kan' guxim* para Zotit ton'* të kërkojnë gjithnjë për botën paqe të qëndrueshme, ndërsa për të gjithë ne falje, përdëllim.

Lavdi

*Ting. Tërth. II I Gjergjit të
Nikomidhisë*

Trumbetat mistike të Shpirtit, Etërit hyjmbajtës, le t'i lëvdojmë, ata që kënduan në mes të Kishës melodi harmonike theologjike, një Triadhë pa asnjë ndryshim në substancë dhe hyjni, rrëzuesit e Ariosit dhe mbrojtësit e orthodhoksëve, që ndërmjetojnë gjithmonë te Zoti, që të shpëtohen shpirtrat tanë.

Tani *Hyjlindësore*

Cili s'do të të lumërojë, o Hyjlindëse Virgjëreshë? Cili s'do të të përhimnojë lindjen tënde të kulluar? Se biri yt i vetëmlindur,¹⁷ që shkëlqeu prej Atit pa mot, gjith' ai lindi prej teje së pastrës i mishëruar pa tregim, duke qenë prej natyre Perëndi dhe duke u bërë për ne njeri prej natyre; i pandarë në dy fytyra, por i njohur me dy natyra papërzier. Atij lutju, o Zonj' e lumur, të mëshirohen shpirtrat tanë.*

Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës dhe Leximet.

Këndimi i Ligjit të Dytë
(1.8-10; 15-17)

U tha Moisiu bijve të Izraelit: “Shikoni, e dorëzova para jush dheun; pasi të futeni, trashëgoni dheun, për të cilin Zoti iu betua etërve tanë, Abrahamit, dhe Isaakut, dhe Jakovit, se do t’ua jepte atyre dhe farës së tyre pas këtyre. Dhe iu fola juve në atë kohë, duke thënë: ‘Nuk do të mundem t’ju sjell unë vetëm. Zoti, Perëndia ynë ju shumoi dhe ja, jeni sot si yjet e qiellit për sa i përket numrit. Zoti, Perëndia i etërve tanë ju shtoftë juve, si jeni, një mijë herë dhe ju bekoftë, sikundër ju foli juve.’ Dhe mora prej jush burra të urtë, dijetarë dhe të mençur, dhe i vura që të udhëheqin mbi ju, kryemijësha dhe kryeqindësha, dhe kryepesëdhjetësha, dhe kryedhjetësha, dhe prokurorë te gjykatësit tuaj. Dhe i porosita gjykatësit tuaj në atë kohë duke u thënë: ‘Dëgjoni midis vëllezërve tuaj dhe gjykoni drejt midis burrit dhe midis vëllait të tij dhe midis proslimitit të tij. Nuk do të njohësh fytyrë në gjykim. Sipas të voglit dhe sipas të madhit do të gjykos. Nuk do të ulësh fytyrë njeriu, sepse gjykimi është i Perëndisë.”

Këndimi i Ligjit të Dytë
(10.14-18; 20-21)

U tha Moisiu bijve të Izraelit: “Ja, i Zotit, Perëndisë tënd është qielli dhe qielli i qiellit, dheu dhe të gjitha sa janë në të. Por Zoti parapëlqeu që t’i dojë etërit tanë dhe zgjodhi nga të gjitha kombet farën e tyre pas këtyre, juve, në këtë ditë. Dhe do rrethpritni zemërngurtësinë tuaj, dhe qafën tuaj nuk do ta ashpëroni më. Sepse Zoti, Perëndia juaj, ky Perëndi perëndish dhe Zot zotërisht, Perëndia i madh, i fuqishëm dhe i frikshëm, i cili nuk admiron fytyrën, që nuk do të marrë dhuratë, që bën gjykim për proslimitin dhe jetimin, dhe të venë, dhe e do proslimitin, ka për t’i dhënë atij bukë dhe veshje. Zotin, Perëndinë tënd do ta kesh frikë dhe atë vetëm do të adhurosh dhe tek ai do të ngjitesh dhe në emrin e tij do të betohesh. Ai do të jetë krenaria jote dhe ai do të jetë Perëndia yt, që të bëri gjëra të mëdha dhe të lavdishme, këto që i panë sytë e tu.”

Këndimi i Urtësisë së Solomonit
(3.1-9)

Shpirtat e të drejtëve janë në dorë Perëndie dhe nuk do t’i prekë torturë. U dukën në sytë e të pamendëve se vdiqën dhe u konsiderua keqtrajtim dalja e tyre dhe ecja nga ne dërrmim, por ata janë në paqe; sepse edhe nëse para faqes së njerëzve do të ndëshkohen, shpresa e tyre është

plot pavdekësi; dhe pasi do të edukohen me pak *mundime*, do të fitojnë mirëbërje të mëdha, sepse Perëndia i provoi dhe i gjeti të denjë për veten. Si ar në shkritore i provoi ata dhe si holokaust flijimi i pranoi ata; dhe në kohën e shqyrtimit të tyre do të ndriçojnë dhe si shkëndija në kallam do të vrapojnë. Do të gjykojnë kombe dhe do të sundojnë popuj, dhe do të mbretërojnë në ata Zoti ndër shekuj. Ata që kanë besim në të do të kuptojnë të vërtetën dhe besimtarët me dashuri do të qëndrojnë me durim pranë tij, sepse ka hir dhe mëshirë ndër oshënarët e tij dhe mbikëqyrje mbi të zgjedhurit e tij.

*Në Liti Idhiomele
Të Nilit Ksanthopuli
Ting. II*

Ejani, o adhures të Trinisë qiellore, le ta murrin treshen tokësore të hierarkëve të hyjshëm, Grigorin, sinonimin e thelogjisë, Vasilin, me emrin e mbretërisë dhe Joanin, me epitet vërtet të hirshëm, thellësitë e urtësisë, rrjedhatoqeaniketë Shpirtit, burimet që gjithnjë gufojnë ujin e gjallë¹⁸ që kërcen,¹⁹ margaritarët e kulluar, ndriçuesit tokësorë,⁸ timonet e Kishës, pemët me fruta të lavdëruara, administratorët e Hirit,²⁰ goja e Krishtit tim dhe luftëtarët e Triadhës, të cilët ndriçohen prej saj drejtpërdrejt dhe ndërmjetojnë pa pushim për shpirtat tanë.

I njëjti

Qymyret që u ndezën nga zjarri i pambulueshëm,²¹ le t'i lavdërojmë shpresëtarisht ne që u ndriçuem me anën e tyre; sepse ata, pasi u skuqën përmes bashkimit me të, u bënë ndriçuesit e botës,⁸ duke qenë fuqi jetike për të varfrit dhe duke shpallur besërisht Atin, Birin dhe Shpirtin e Shenjtë; tek ata le të themi edhe ne: Gëzohu, o treshja e hyjurtë e Trinisë.

Ting. Tërth. II

Hobenë²² e tripleksur²³ të Davidit, litarin e kuq të Solomonit,²⁴ vregën e trithurur të Fjalës,²⁵ hierarkët e urtë, Vasilin e Madh, Grigorin e hyjshëm dhe Joanin Gojart, le t'i lartësojmë besërisht; sepse kur e rrëzuan përmes gurit të qoshes²⁶ Goliathin²⁷ mendor, e drejtuan besimin në unitet mendjeje, pasi e rrethuan si me mur me gjakun e kuq të Krishtit, dhe kryeheretikët që tregtonin Hyjninë, i dëbuan me fjalët larg vathës së kopesë së hyjshme të Krishtit dhe e mbështesin besën²⁸ deri dhe tani, dhe ndërmjetojnë pranë Zotit që të shpëtohen shpirtat tanë.

Ting. Tërth. IV

Na u shfaq Hiri i Perëndisë të gjithë ne njerëzve, duke na mësuar²⁹ me anën e Mësuesve të ndriçohemi në mendje me shkëlqim hyjnjoheje si të zbukurohemi në moral dhe të përmirësohemi në sjellje; prandaj

le të thërrasim: O Trini e Shenjtë, zotëruese e gjithçkaje, me lutjet e tre barinjve të tu këtë grigjë tënden ruaje në paqe³⁰ me siguri dhe pa trishtim, dhe shpëtoje si njeridashëse.

Ting. Tërth. II

O Trini e Shenjtë që të falemi, lavdi providencës sate të urtë, sepse u dhurove njerëzve tre ndriçues të mëdhenj të marrë nga njerëzit,⁸ të cilët me dritën e njohjes sate udhëzojnë si me llambadhe dhe shkëlqejnë me llamburitjen e vullneteve të tua shpëtimtare dhe të respektuara; me anën e tyre kozmosi duke u pasuruar me dritë diturie, feks nga lavdia jote dhe shpejton drejt mbretërisë sate të lumur, dhe na bind të dëgjojmë mësimdhëniet e tyre të hyjnueshme; pra ti, si Perëndi i tërëdhembshur, dëgjoji lutjet për ne dhe shpëtoji shpirtrat tanë si njeridashës.

Lavdi *Injëjti*

Hierarkët e Krishtit, lavdinë e Etërve, përgjet e besimit, Mësuesit dhe rojet e besimtarëve, o kremtimdashës, duke u mbledhur, le t'i himnojmë me lavdërime këngësh duke thënë: Gëzohu, o Vasil i urtë, ndriçues i Kishës⁸ dhe shtyllë e papërmbysur. Gëzohu, o Grigor Theolog, mendja qiellore, kryepriфт tepër i madh. Gëzohu, o fjalartë Joan i tërëpruar, predikues me zë të lartë i pendimit.³¹

Pra, o Etër të trillumur, mos pushoni së ndërmjetuari përherë pranë Krishtit për ata që me besë dhe mallëngjim bëjnë panairin tuaj të tërëhyjshëm dhe të shenjtë.

Tani *Hyllindësore*

Injëjti

Bukurinë e virgjëreshave, harene e Mendjeve, Perëndilindësen e vetme dhe fortifikimin pa plasaritje të besëmirëve, o kremtimdashës, duke u mbledhur le ta himnojmë me lavdërime këngësh duke thënë: Gëzohu, o nënëvirgjëreshë e kulluar, kandil arndriçues³² dhe portë qiellore;³³ gëzohu, o tendë shenjtërimi,³⁴ që e nxure në mitrën tënde Perëndinë, o e tërëpacenuar; gëzohu, më eprore pa krahasim se koret qiellore të gjitha; për këtë, o Zonjë, nënë pa burrë, mos resht së ruajturi shërbëtorët e tu që të përhimnojnë gjithmonë me besim dhe aspiratë, dhe i falen lindjes sate të pafarshme.

Pasvargje

Të Nilit Ksanthopuli

Ting. Tërth. I Heris askitikón

G'zohu, trini kryepriфтërinjsh,* se jeni përgjet e mëdha pra për Kishën ton'* dhe shtyllat e shpres'tarisë, mbështetja për çdo besnik,*⁵ heretikët bien poshtë përmes jush;* kullotët ju popullin* e Jisuit, barinj me zell,* me anë dogmash* krejt

hyjnore, e rritët mjaft* me virtytësi* të hyjnueshme, shpallët fort* Hirin, o udhëzues drejt të lartave, vutë dhe* i ekspozuat sistemit të Krishtit ligjet; Parajsa lart* ju ka porta; Krishtit* i kërkoni të dërgojë pra përdëllim të madh.^{34a}

Varg: Do të mburren oshënarët në lavdi. **G**'zohu, trini kryepriiftërinjsh,* o engjëj që lëvizni lart, engjëj përmbi dhé,* shpëtimi i botës, gazi i njerëzve, në planet* jeni ju Mësues, trimat luftëtar'* të Fjalës, o mjekë ju,* shkencëtar' të sëmundjeve* si shpirtërore* dhe trupore, lumenj me çurg* të vazhdueshme* që nga Shpirti³⁵ vaditni plot* faqen e mbarë tokës,¹⁵ theologjë me zë si ar* të perëndishmit dhe bazë, lypni, kërkoni prej Krishtit Zot,* që shpirtëve tanë* t'u dërgojë përdëllimin e madh^{34a} dhe mirësi.

Varg: Priiftërinjtë e tu, o Zot, do të veshin drejtësi dhe oshënarët e tu do të ngazëllohen.

G'zohu, trini kryepriiftërinjsh,* ju jeni dielli i qiellit tokësor,* ndriçim nga shkëlqimi tridiellor dhe rreze të tre,* rishikim për sa jan'* thellësisht në terr,*³⁶ o lule aromëplot,* në Parajsë të bukura,* o Theolog at',* shën Vasil plot me mençuri,* tok me ta, Gojart,* pllaka mbar' të hyshkruara,*³⁷ jeni kutit' e Shpirtit, dhe buroni si shishe, gjinj,* qumësht

të pastër shpëtimi, o lavd urtie, ndaj Krishtit Zot* i lypni t'u japë* përdëllimin e madh^{34a} shpirtëve si dhe hir nga lart.

Lavdi *Ting. Tërth. I*

Letëtrumbetojmë me boriekëngësh; le të kërcejmë në mënyrë festive dhe le të hidhemi përpjetë duke u ngazëlluar në panairin mbarëpopullor të Mësuesve tanë. Mbretër dhe arkondë, le të bashkëvrapojnë dhe le të duartrokasin hierarkët me himne, se buruan lumenj gjigantë dogmash, pra tre lumenjtë bukurrrjedhës të Shpirtit, të cilët jetojnë përherë. O barinj dhe mësues, duke u mbledhur, le të murrin tre hieromistët e Triadhës së respektuar. Filozofët le të lavdërojnë të urtët, priiftërinjtë barinj, mëkatarët mbrojtësit, të varfrit pasuruesit, të trishtuarit ngushëlluesit, udhëtarët shoqëruesit, sa janë në det kapitenët, të gjithë ne, kryepriiftërinjtë e hyjshëm që shpejtojnë nxehtësisht kudo, le t'u themi kështu duke i lartësuar: O Mësues të tërëshenj, nxitoni që të nxirrni besimtarët nga skandalet e jetës dhe që të na çlironi ne nga dënimet e përrjetshme.

Tani *Hyjlindësore*

Ty të lumërojmë, o Hyjlindëse e virgjër, dhe të lavdërojmë ne besnikët siç të ka hije ty, qytetin e paturndshëm dhe murin që s'çahet dot,

mbrojtjen e pathyeshme dhe strehën e shpirtrave tanë.

Përlëshore
Ting. I

Tre ndriçuesit tepër të mëdhenj të Hyjnisë tridiellore, që llamburitën rruzullin⁸ me rreze dogmash hyjnore, lumenjtë mjaltërrjedhës të urtësisë, të cilët vaditën bollshëm tërë Krijesën¹⁵ me rrjedha hyjnohjeje, Vasilin e Madh dhe Theologun Grigor tok me Joanin e lavdishëm e arfolës nga gjuha, të gjithë ne të dashuruar pas fjalëve të tyre, duke u mbledhur le t'i mburrim me himne, sepse ata gjithmonë ndërmjetojnë për ne pranë Trinisë.

[Në Mëngjesore, pas Perëndia është Zoti, psalet edhe Përlëshorja e dytë:

Lavdi *Ting. IV*

Duke qenë të njëjtë në sjellje me apostujt dhe Mësuesit e kozmosit, ndërmjetoni pranë Zotit të të gjithave, që t'i dhurohet planetit paqe dhe shpirtrave tanë përdëllimi i madh.^{34a}

Tani *Hyjlindësore*

Misteri i fshehur prej jete dhe i panjohur ndër engjëjtë, u shfaq ndër të dheshmit me anën tënde o Hyjlindëse, Perëndia që u mishërua me bashkim të papërzier dhe denjoi kryq për ne duke dashur, me të cilin ngjalli të parëgatarin dhe shpëtoi prej vdekjes shpirtrat tanë.*]

Lavdi *dhe Tani*

Hyjlindësore

Gabrieli kur të tha: “Virgjëreshë, gëzohu!”, bashkë me zërin mishërohej Zot’ i Gjithësisë te ty arka e shenjtë siç tha David i drejtë; u rrëfeve më e gjerë se qiejtë, duke mbajtur krijuesin tënd; lavdi atij që ndenji te ty, lavdi atij që lindi prej teje; lavdi atij që na çliroj me lindjen tënde.*



NË MËNGJESORE

Pas Perëndia është Zoti, të dyja Përlëshoret dhe Hyjlindësorja e tyre. Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësore Ting. IV Tahi prokatálave

Ndriçues ju jeni dhe Kishën zndrisni me nur* përmes mësimdhënieve shkëlqyet botën,⁸ me hir, o Etër me hyjurti;* shkritë pra herezitë* të gjith’ besëkëqijve,* shojtët edhe trazime blasfemish të përfakta;* ndaj si hierarkë, lutuni të shpëtohemi.

Lavdi *I njëjti*

Tani *Hyjlindësore*

O nënë e Krishtit Zot, e Virgjër pa burrë krejt,* Mari e himnuar fort, hyjnuse, ndihma e shpresëtarëve, ti çliro* nga çdo rrezik e derti* dhe nevoje, o Zonjë* Hyjlindëse, e vetmja e dëlirë, sa rendim* me besë

dhe mall nën strehën tënde dhe na shpëto.

*Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësove
Ting. IV Kateplaji Iosif*

Në livadh të Shkrimeve,* si bletë fluturonit ju,* dhe i mbloodhët me sukses* së bashku, vutë para nesh* tër' lulet më të shkëlqyeshme edhe mjalitin* pra të mësimdhënieve tuaja,* dhe dëfrenjë gjithë besnikët tok,* të urtë, ndaj çdokush që ëmbëlsohet* thërret me gaz: Edhe pas vdekjes* qëndroni prapë,* të shumëlumur,* pranë nesh që ju mburrim.

Lavdi *I njëjti*

Tani *Hyjlindësore*

Dimëroj keq në mjerim,* i pandërgjegjshëm nga stuhi* e pasioneve, thërras,* o e dëlirë, nxehtësisht:* Mos më shpërfill të humbas un' i shkreti, meqë* linde ti avushën e dhembshuris',* nuk kam tjetër shpresë përveç teje,* ndaj un' që kam besim në ty të mos jem* gaz dhe përqeshje armiqsh,³⁸ tallje,* fuqi ke të bësh* sa do, se nëna* je e Zotit të botës.

*Pas Polieleit, Ndenjësove
Ting. IV Epefanis simeron*

Profesorët mjaft të urt'* të mbarë botës,* që lëvduan Perëndin'* mbi dhé³⁹ me fjalë dhe veprim,* të madhështohen sot, se ata* janë

shkaktarë shpëtimi për njerëzit.

Lavdi *Ingjashëm*

Tre Mësuesit me nam* e përforcuan* Kishën përmes dogmave* të hyshme që formuan drejt,* prandaj ajo po kremton me lavd* sot panairin e tyre me shumë nder.

Tani *Hyjlindësore*

Mbrojtje që s'luftohet je* për nevojtarët,* ndërmjetim i gatshëm pra* për sa besim kanë te ti* prej çdo rreziku çliromë shpejt,* mos më shpërfill se, je ndihmë për gjithë ne.

*Shkallesat. Antifoni i parë i Ting. IV
Proqimeni Ting. IV*

Priftërinjtë e tu, o Zot, do të veshin drejtësi dhe oshënarët e tu do të ngazëllohen.

Varg: Goja ime do të flasë urtësi dhe studimi i zemrës sime mençuri.

Ungjilli. Psalmi 50.

Lavdi. Me ndërmjetimet e Mësuesve.
Tani. Me ndërmjetimet e Hyjlindësës.
Përdëllemë, o Perëndi. *Dhe Idhiomeli.*

Ting. Tërth. II

Uderdh hiri në buzët tuaja,⁴⁰ o Etër oshënarë, dhe jeni bërë barinj të Kishës së Krishtit⁴¹ duke i mësuar dhentë e logjikshëm, që të besojnë në Trininë e bashkëqenshme në një Hyjni.

*Kanunet: i Hyjlindëses në 6 bashkë me
Irmoset dhe të dy të shenjtoreve në 8.*

Ode I

*Kanuni i Hyjlindëses, që ka
Akrostihidhë (pa Irmoset): "Shpëto, o
e Virgjër, ata që përikin te ti".*

Poezi e Joanit të Efhaitëve.

Ting. II

Irmosi: Dhefte laí

»Popuj të gjith',* ejani që t'i
»këndojm' Perëndis'* pra Krishtit,
»që si ndau detin, udhëhoqi popullin
»që e çlirroi* nga zgjedha e Egjiptit,
»se u lëvdua fort.

O e pacen,* unë, që si Perëndilindë-
sen* e vetmen, të dëlirë, të pohoj me
bes', shpëtomë nga fajet, rreziqet,*
sëmundjet e vështira që kam në
shpirt dhe trup.

Dim' se në ty* shtrihet avusha për
çdo dhurëti,* ndaj, o Perëndilindëse,
duke përikur drejt strehës sate të
hyjshme,* meqë e gatshme je, shpë-
tona të gjithë ne.

Me përgjërim,* fort e Dëlirë, për sa
të himnojm'* iu lut atij që mori mish
prej gjakut tënd të çmuar, pa cen, të
shpëtojmë* nga shkeljet dhe sëmu-
ndjet tepër të hidhura.

Të kemi ne,* gjithë besnikët pra
ty krenari,* shpëtim, përikje, gaz,
mbështetje, bazë shpirtrash, mur,

forcë, fortifikim tok* dhe shpresë,
Hyjhirplote Perëndilindëse.

Kanuni i shenjtoreve, që ka

*Akrostihidhë: "Dritë tridiellore ndezi
tre diej".*

Poezi i të njëjtit Joan

Ting. dhe Irmosi të njëjtë

Çfarë shpërblim,* çfarë shpagim
të përshtatshëm nga ne,* o njerëz,
mirëbërësve tan' t'u ofrohet, se
udhëhiqemi saktë* përmes atyre
drejt një jete të mirë krejt.

Metodë, art,* gjuh' oratori edhe
çdo fuqi* për fjalët për k'të punë
të mobilizohen tok, t'u shpërblejnë
nderimin* tani atyre që na kanë
nderuar ne.

S'duronin dot* tre qiellmendësit
mbi dhé këtu* që pronësi të zotëro-
nin,⁴² roje edhe mbrojtës u shfaqën
te çdokush,* nga populli për himne
të denjësohen pra.

Hyjlindësore

Të lavdërojm'* o bujari e përbashkët
për ne* dhe për natyrën tonë, o e pa-
qortueshme, me një gojë e buzë*
të gjithë⁴³ dhe formuam një simfoni
me zë.

Kanun tjetër i shenjtoreve

Poezi i të njëjtit Joan

Ting. Tërth. IV

Armatilatin Faraó

Arritje pune njerëzore s'është kjo përpjekje dhe tentativ',* por bashkëpunoftë* urtësia që mbi fron rri pranë teje;⁴⁴ hir për fjal'*⁴⁵ të më jepet prej saj, që të mundem pra t'i himnoj ata* që lëvdoi më par', i miri Zot.

Si nga një kanë rrodhi mirëdashja jote kaq e shumtë, o Zot,* edhe pasuria,* njeridashja jote, është derdhur dhe përshkoi tej,* ndaj i bëri si engjëj të tjerë, njerëz me mish si k'ta* që tani i mburrim për lavdërim.

Duhej prej qiellit të kishin qielloret lavdërim, sepse* u përket himn engjëjsh* perëndive prej kungimit, që të vetmin Perëndi* të vërtet'⁴⁶ nga natyra, të gjallë brenda e kanë⁴⁷ pra* dhe u flet në shpirtra atyre ky.

Hyjlindësore

Me lavdërim po kremton kujtim të drejtësh⁴⁸ tërësi besëmir',* kor hyjmendës; ndër ta* tok lëvdohet natyrisht, dhe pjesë merr në lartësim* nën' e Zotit, sepse plotësim, përmbushje edhe fillim,* fund dhe mes i tyre është gjithnjë.

Zbritësore: Herson avisotokon
Fundin edhe burimin (*shih fq. 354*)

Ode III
I Hyjlindëses

Irmosi: Steréoson imás

»**F**orcona, sigurona, o Zot, në »ty,^{*48a} pra ti që ke vvarë mbi dru »mëkatin,^{*48b} edhe frikën tënde na e »mbill* në zemrat tona, që të la- »vdërojnë ty.

Të butë, e dëlirë, shfaq Perëndin'* që linde, përmes ndërmjetimit tënd ti,* rendim ne shërbyesit e tu* nën strehën tënde; i falemi Birit tënd.

Dëgjo, e Virgjër, fjalët e shpirtit tim,* i cili trazohet mjerisht, shpëtoje* nga rreziqe përgjithnjë, pasi* ta qetësosh, o Mari e himnuar fort.

Të gjithë jetën time e udhëhiq,* e Virgjër gjithnjë, shpresa, mbrojtja ime,* kur të më shpëtosh përherë ti* nga cdo shtrëngim dhe ngacmim dhe peripeci.

Urtin' enipostate të Perëndis',*⁴⁹ që mban, o Hyjlindëse, në pëqi lut* të çlirohen prej mashtrimit dhe* prej injorancës sa të përhimnojnë ty.

I shenjtoreve: Tis pisteos en petra me
Kandil që shndrit* planetin⁸ dhe predikues* që mban çdo skaj* të botës me zë, trumbeta* e rëndë e mbar' Kishës, që ka një emër të madh, Vasili, na e sistemoi drejt* këtë panair të shkëlqyer me lavdi.

I shndritur fort* nga jeta edhe nga

faktet,* praron si ar* nga fjalët edhe nga dogmat,* shkëlqen më tepër se cilido, si dielli feks më shum' se yjet, Theologu shenjt,* lumërohet sot pra prej besëmirëve.

Ja, feks drita* e botës⁵⁰ përmbi⁵¹ planetin;* ja, dheun po* e nginj kripa e mbar' tokës;*⁵² ja, fryta të pavdekshme nxjerr edhe pemën e jetës⁵³ na shfaq shën Joani me prarim;* ejani, shijoni sa s'doni vdekje më.

Hyjlindësore

Krijuesi* që bëri çdo gjë nga hiçi,*⁵⁴ natyr' u dha* të gjithëve që gatoi,* ai di t'i ndërrojë siç do natyrat që vetë ky u dha; prandaj dëgjohet kjo:* Virgjëreshë lind; cili s'do çuditet fort?

Tjetri: O stereosas kat' arhás

Aministrues shpirtëror'* dhe korrigjues morali,* shpëtimtarë të përbashkët u bënë,* na treguan shembuj fjalësh dhe veprimesh dhe në jet'* na edukojnë shenjtët* plot me shkëlqim; t'i lëvdojm' me nder.

Vasilin Shpirti Perëndi* e mbushi me shkencë,⁵⁵ ndërsa* një nga gjuhët e përflakta, Grigori* kish dhe nxirrte frymë zjarr⁵⁶ pra fjalë fort të lartë ky* dhe te Joani fliste* goja e Krishtit, hyjfolësi.

Urtinë që ky shekull ka,* e cila

qartë sfaroset,* e ka mposhtur dhe e bëri si skllave* që shërben rëndom marria pra e predikimit⁵⁷ drejt,* se Hiri oratorë* dhe predikues të urtë shfaq.

Hyjlindësore

Fushoi Zoti në një bark* të qashter prej Virgjëreshe* dhe bën shpirtrat e hyjprurësve të shenjt'* si banesa dhe me gojët e atyre na shpjegon* neve misteret që kan'* lidhje me nënën e tij pa cen.

Zbritësore: To steréoma

Zoti Krisht

Ndenjësoore

Ting. Tërth. IV Tin softian qe Logon

Kullat, pìrgjet pa çarje të Kishës son'* që shkëlqyen, ndrìçuesit⁸ dhe kolos'* me një zë le t'i himnojm',* se shijuam nga ta çdo gjë* të mirë, tok me fjalët dhe hìrin e tyre, pra* Fjalartin mjaft të urtë, Vasilin e Madh vërtet* dhe me shën Grigorin Theologun e shquar;* me shpirt dhe nga zemra ne* t'u thërrasim: O hierark',* të mëdhenj ju* tri her', me nam,* ndërmjetoni te Zoti Krisht,* të na dhurojë ky ndjesën* e fajeve* ne që bëjmë kujtimin tuaj të shenjt' me mall.

Lavdi Ingjashëm

Kur e morët urtinë prej Perëndis',*⁵⁸ si apostuj të tjerë të Krishtit Zot*

formuat për ne te tre* me fjal' njo-
hjeje⁵⁹ dogmat drejt,* që më par'
peshkatarë⁶⁰ me dije dhe me fuqi*
nga Shpirti⁶¹ përmes fjalësh të
thjeshta na dhanë ne;* duhej që
besimi yn' i thjeshtë përmes jush,* o
ju të nderuar fort,* të fitonte sistem
unik;* ju thërresim* të gjithë pra:*
Ndërmjetoni te Zoti Krisht,* të na
dhurojë ky ndjesën* e fajeve* ne
që bëjmë kujtimin tuaj të shenjt' me
mall.

Tani *Hyllindësore*

Shpirtin tim të përlur, e Virgjër
krejt,* që tani turbullim ngasjesh
jete ka,* dhe mbytet pa kapiten* në
furtunë, dhe duket qart'* se është
mbingarkuar me peshë mëkatesh
ky,* dhe rrezikon të bjerë në fundin
e Hadhit⁶² posht',* shpejt arri, Hylli-
ndëse, dhe me ndërmjetimin* e
ngroht' që bën, më shpëto* në të
paqmin limanin tënd,* që me besë*
të të thërras:* Ndërmjeto tek Biri yt,
Zot,* që të më japë faljen* e fajeve;*
shërbëtor i padenjë jam, shpresë ty
të kam.

Ode IV

I Hyllindësës

Irmosi: Isakíkoa Kírie

»Dëgjova, o Zot, dëgjimin e eko-
»nomisë sate, dhe të lavdërova, o i
»vetëm njeridashës.

O Zonjë, që linde Perëndi, m'i shëro

traumat e shpirtit dhe sëmundjet e
trupit.

O e Virgjër, me shpresë dhe besë
më siguro mua që lëkundem në
pasione, mendime dhe shtrëngatë
jete.

Me përgjërimit e tua, më çliro nga
peripecia, turbullimi dhe rreziqet,
o nënë e Perëndisë, e vetmja e
tërëhimnuar.

Më rrëmbe mua të dimëruarin në
furtunën e jetësoreve dhe më drejto
te limani yt.

I shenjtoreve: Elilithas ek Parthenu

Pasi u bëtë të mençur në saje të
urtësisë së poshtme, o të lavdishëm,
fituat qeverisje prej urtësisë hyjnore;
prandaj e nënshtruat tërëurtësisht
të parën si shërbyese të së dytës.

O filozofë, nëse i doni të urtët,
urtësohuni dhe mësoni të folurit të
gjithë ju që admironi fjalët, duke
ushtruar prej tyre përpikëri praktike
dhe teorike.

Hyllindësore

Si shi i mëvonshëm Krijuesi i
mëparshëm⁶³ i ujërave⁶⁴ dhe she-
kujve,⁶⁵ pikoi në fund në mitrën
tënde, o e tërëpaqortueshme, duke
lehtësuar në kohën e duhur ata që
shterohesin.

Tjetri: Si mu iskís Kirie

Si shtyllë zjarri u pe, o Vasil i Madh, që paraprin një popull besimtar⁶⁶ dhe i përvëlton armiqtë e besimit, ndërsa fiset që vijnë pas i shpëton me siguri. Le të ketë kurajë dhe le të fitojë Kisha e Krishtit, meqë u pasurua me një luftëtar të tillë.

Fjala jote, o Grigor, u bë shijim gjuhe, pëlqimi për çdo dëgjim, manë jete,⁶⁷ vesë ëmbëlsie, mjaltë prej gurit,⁶⁸ bukë qiellore⁶⁹ engjëjsh,⁷⁰ që i bind pjesëmarrësit të mbushen me kënaqësi dhe i kum me ëndje.

Lumi i karizmave të Shpirtit u mbush⁷¹ deri në derdhje dhe si prej goje të artë vadit faqen e mirë të dheut¹⁵ si përrua shijimi,⁷² duke dëfryer dhe plehëruar çdo qytet të Krishtit me vrullet⁷³ e valëve të hyshme.

Hyjlindësore

Kur tre dogmaticienët hyjmbajtës njohën të dyfishtin në natyrë, me dy vullnete dhe energji të dyfishtë, pohuan për Birin tënd, o Zonjë, një natyrë të thjeshtë, që duroi kombinim dhe u shfaq më e lartë se trazimi.

Zbritësore: Ekálipsen uranús

Mbulove me virtyte

*Ode V**I Hyjlindëses**Irmosi: O tu fotós horigós*

»**T**i, Zoti, dhënësi i dritës⁷⁴ dhe »endësi i shekujve,⁶⁵ na udhëzo në »dritën e urdhrave të tu,⁷⁵ sepse veç »teje nuk njohim tjetër Perëndi.⁷⁶

Ne që të dimë ty Hyjlindëse të kulluar, duke të pasur armë të pamposhtur kundër ngasjesh të shumëllojshme, çlirohemi gjithmonë nga çdo ndikim të keqdashësve.

O përmbushje e Ligjit, më e lartë se Keruvimet, ke lindur Birin e vetëmlindur të Perëndisë, që u mishërua¹⁷ prej teje; atë zbutë për shërbëtorët e tu.

Duke mbajtur në prehrin tënd, o e kulluar, Bërësin e gjithçkaje, na e jep të butë neve që me zemër përikim drejt teje tani.

Të ofroj unë i shkreti lutje nga ngushtësia e shpirtit tim të vuajtur ty, lindësen e vetme të Fjalës, shkaku i dhembshurive; si të më dhembshurosh, shpëtomë.

I shenjtoreve: O fotismós

Onjeridashës, u ke dhënë shenjtoreve tërë burimin e karizmave të tu që ta pinin; nuk u pakësua fare nga boshatisja, ndërsa e ndevi mbarë botën me anën e rrjedhjeve të hyshme nga barku i tyre.³⁵

Ç'janë për mua ar, pasuri, lavdi dhe pushtet? Tymra që kalojnë në ajër. Le të ikin të gjitha; le t'i marrë era. Për mua pasuri tepër e dashur është një: treshja oratorike e Mësuesve.

Rrjedh një lumë ambrosí dhe nektar, rrjedh për të uriturit, ushqim të pavdekshëm dhe për të eturit pije paprishjeje, ujë të gjallë¹⁸ për jetët dhe që i mban të gjallë ata që pijnë. Të gjithë mbushuni me jetë vërshuese.

Hyllindësore

E keqja pati fuqi kundër nesh, por jo përfundimisht, sepse u dobësua pas Virgjëreshës që ka lindur të fortin në pushtet,⁷⁷ që u fut nën dobësi mishi dhe e vrau të fortin për të keqen.

Tjetri: Ina ti me aposo

Le t'i shpërblejmë me zëra falënderues shkencëtarët e urtë të gjërave hyjnore dhe njerëzore, të cilët na shqyrtuan me vërtetësi natyrat e qenieve dhe na bënë të njohur të gjithëve Ndërtuesin e tyre aq sa lejohet.

Shëruesit e hyjshëm të shpitrave hidhërimin dhe athëtinë e ilaçeve për shpëtim e ëmbëlsuan me anën e këndimit melodik të fjalëve, arteve dhe hireve të urta; të gjithë ju besimtarë, joshuni dhe duke dëfryer shpëtoni.

Hesht çdo fjalë kur hyjpredikuesit flasin hyjnore, dhe mbizotëron mbi Dhiatën e Vjetër e Reja, duke manifestuar pllakat e drunjta, të respektueshme të atyre që vënë ligjet në të, nëpërmjet të cilëve sistemohet çdo bashkësi besëmirësh.

Hyllindësore

Natyra e vdekshme e tejkaloi në shenjtërim natyrën e pavdekshme, dhe një Vajzë e virgjër parapriu engjëjt pa trup, sepse lindi Perëndi, mbretin e engjëjve, të cilin e kanë të pamundur ta vështronë.⁷⁸

Zbritësore: Os idhen Isaias

Të pa shën Isaia

Ode VI

I Hyllindëses

Irmosi: En aviso ptesmaton

»Një avushë mëkatesh po më
»rrethon,* ndaj thërras un' mirësinë
»tënde që s'ka fund* e cila s'gjurmë-
»sohet dot;* lutem, nxirrmë nga pri-
»shja, o Zoti im.⁷⁹

Si liman për shpëtim, Zonjë, ty të njoh,* kur lundroj në det të jetës që ka derte plot,* tallaze, ndaj po të thërras* që të jesh kapitenia e shpirtit tim.

Oe Virgjër gjithnjë nënë, me stoli* marrëzie veshur jam, i keqtrajtuar shumë,* por ti që linde Perëndi* më

shpërble me këmishën e gazit,⁸⁰ pra.

Un' i mjeri nga jeta e shenjtë rash'* përmes plogështisë, e dëlirë fort, më kthe,* o e bekuar; më ftillo* nëpërmjet porosive të Birit tënd.

Ti në bark mbajte Fjalën e dhe-mbshur krejt,* ndaj më denjëso për dhembshuri hyjnore, Zonj';* ky i shpëtoi njerëzit* nga çdo prishje me gjakun e tij unik.

I shenjtorëve: Avisos amartimaton

Theologoni bashkë veçori të trefishta në Trininë, palindjen e Atit, lindjen e Birit dhe daljen vetëm të Shpirtit.

Sot në këtë shtëpi realizohet shpëtim⁸¹ i shquar, sepse ku janë dy dhe tre të mbledhur në emrin e tij, Krishti duke i nderuar është i pranishëm mes tyre.⁸²

Fundi i tokës s'ka krahasim me lartësinë qiellore, mirëpo dashuria qiellore i ngriti shenjtorët nga toka përtej qiejve.

Hyjlindësore

Tre hyjfolësit duke të pasur burim të ri dhe shkak misteresh, o Virgjëreshë, çështjeve të reja u përshtatën shprehje të re.

Tjetri: Ilásthiti mi Sotir

Trinin' unike të shenjt'* që na e mësuan Etërit theologojmë kështu,* Njësin' triadike përhimnojmë, siç na u dha;* morëm edhe falje* e Hyjnis' trihipostate, Zot.

Me Atit tok në fillim* ish Fjala e bashkëpafillim⁸³ dhe Shpirti ishte me të,* me Fjalën, porse nga Prindi, siç predikuesit* than', Hyjnia është* e njëqenshme, një natyrë thjesht.

Sa ndahen por bashkërisht* i ndaj dhe bashkoj, kuptoj pra një që s'ndahet, tre i mendoj* dhe tre profesorët që i mban Perëndia yn'* i pranoj, sepse k'ta* krejt më bindin të besoj kështu.

Hyjlindësore

Përpara mishit, pa nën';* pas mishit, pa Atë; është' Bir Ati edhe nëne ai,* kështu karakterizohet. Mbi mend të dyja jan';* i takojnë Zotit* mrekulli paradoksale krejt.

Zbritësore: Evóisé si

Kur Simeoni

Kontaqi

Ting. II Tus asfalís

Për prehjen dhe shijimin e të mirave* të tua more predikuesit e shenjt'* dhe hyjfolës; ndër Mësuesit, Zot, janë majë, se pranove fort* mundimet edhe lodhjet që kan' bër',

përmbi* se gjitha holokaustet, se vetëm ti* shenjtorët e tu i lavdëron gjithnjë.

Shtëpia

Kush është i aftë t'i çelë buzët dhe ta lëvizë gjuhën⁸⁴ përballë atyre që nxjerrin frymë të zjarrtë⁵⁸ me fuqi fjale dhe shpirti?⁶¹ Veçse do guxoj të them vetem, se të tre e tejkaluan natyrën njerëzore nëpërmjet karmave të shumta dhe të mëdha, duke u lartësuar në praktikë dhe teori mbi të shkëlqyerit në të dyja; prandaj i denjësove për dhurata tepër të mëdha ata, si shërbyesit e tu besnikë, ti, i vetmi që shenjtorët e tu i lavdëron gjithnjë.

Sinaksari

Më 30 të të njëjtit muaj, kujtimi i Etërve tanë ndër shenjtorë dhe Mësuesve Ekumenikë, Vasilit të Madh, Grigor Theologut dhe Joan Gojartit.

Vargje: Është e drejtë të respektojmë së bashku tri yje mëngjesi,/ që buruan dritë të trishkëlqyer në jetë.

Është e drejtë t'ua ofrojmë himnin e përbashkët/ atyre që u derdhën të gjithëve hirin e përbashkët.

Nuk e sjell pranverën një dallëndyshe,/por tre bilbilat sjellin pranverën e shpirtave.

Natyrën mendore e shkëlqen Trinia,/ndërsa kjo triadhë, sigurisht natyrën e dukshme.

Të vjetrit pa mend humbën adhurim

Perëndie/ për shkak të diellit dhe të hënës;

Sepse pasi admiruan bukurinë dhe shpejtësinë e tyre,/ u sillnin padrejtësisht adhurim si perëndi.

Por prej këtyre tre ndriçuesve/ përsëri ne u ngjitëm në adhurim Perëndie;

Sepse me bukuri jete dhe bindje fjalësh/ i bindin të gjithë që ta adhurojnë Ndërtuesin e vetëm.

Këtë Krijesë të dukshme e përbëjnë/ zjarr, ajër, ujë dhe natyra e tokës;

Por ata që përbëjnë botën e madhe/ dhe besimin te Perëndia si një Krijesë tjetër,/ mbajnë ikonë Trinie themeluese;

Sepse nuk u intereson asgjë nga tokësoret/ dhe nuk patën asnjë mendje tokësore në fjalë;

Sepse mendja grigoriane fjalën si zjarr e nxjerr me frymë,⁸⁵ e cila bind çdokënd që të vrapojë prapë drejt lartësisë.

Nga ana tjetër, fjalët e Vasilit janë si frymëmarrje/ për ata që u ra të fikët nga pasionet.

Dhe i arti i vetëm në zemër dhe në gjuhë,/ duke imituar rrjedhjen e ujërave,/ i freskon të treturit nga pasionet.

Kështu tërë natyrën e vdekatarëve e sjellin/ nga toka drejt lartësisë me fjalët e tyre.

Feksi në të tridhjetën shkëlqim i artë tridiellor.

Në të njëjtën ditë, atletizmi i hieromartirit Ipoliti, papa i Romës, dhe i atyre që ishin me të, Qensurini, Savaini, Hrisia dhe të tjerët.

Vargje: Me guxim Ipoliti futet në det, si kalë,⁸⁶ që gërmon me thundër në fushë⁸⁷ të butë.

Duke shtrirë qafën në shpatë, Qensurini/ ishte për bashkatletët si grihë për brisk.

Flakërojnë me llambadhe të përbrendshmet e Savainit/ fëmijët gjithëdinake të padhembshurisë.

Kur Hrisia u hodh në thellësi,/ erdhi tek nusërorja e qiellit si nuse e sapolarë.

Rryma deti vrau Ipolitin në të tridhjetën.

Në të njëjtën ditë, atletizmi i martirit të shenjtë Theofili i Ri.

Vargje: Theofili pritet në kokën e dashur,/ sepse nuk dëshironte të donte perëndi barbarësh.

Me ndërmjetimet e tre hierarkëve dhe të gjithë shenjtoreve, o Krisht Perëndia ynë, mposhti rebelimet e herezive, na ruaj ne në unitet dhe gjendje paqësore, dhe na vlerëso për mbretërinë qiellore,⁸⁸ se i bekuar je në jetët të jetëve. Amin.

Ode VII

I Hyjlindëses

Irmosi: Ikonos hrisis

»Kur adhurohej një ikonë e artë në

»fushën Dheira,⁸⁹ të Tre Djemtë e »tu shpërfillën urdhër tepër të pafe, »dhe kur u vunë mu në mes të zjarrit, »duke u freskuar⁹⁰ psalnin: I bekuar »je, o Perëndi i etërve tanë.⁹¹

Kur i trupëzuari prej teje, o Perëndilindëse, u ngul në kryq, e grisi dorëshkrimin e Adamit;⁹² atij përgjëroju tani, o e tërëpaqortueshme, që të çlirohen nga rreziqet të gjithë ata që thërrasin me besë: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.⁹¹

Je, o Zonjë, shpresë e mirë dhe pritje besëmirësh; dhe tani lutemi që t'u dhurohet oqeani i mirësisë sate gjithë atyre që kanë besim te ti dhe i thërrasin Birit tënd: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.⁹¹

Irrethuar nga errësira e vështirë e jetës, nuk pata afër atë që i vinte keq⁹³ dhe ndiente dhimbje bashkë me mua; o Virgjëreshë, me shkëlqimin tënd zgjidhe mjegullën e shkeljeve dhe më llamburit mua që psal: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.⁹¹

Unë i mjeri e nxiva përmes indiferencës stolinë e bukur të porosive shpëtimtare që e veshja me pagëzimin; por tani drejt teje vrapoj, o Virgjëreshë, duke kërkuar që të vesh sërish përmes teje këmishën e mençurisë.

Edhe pse Adami ra më parë nga jeta e pacen, shpëtoi; dhe tani me Birin tënd, o e tërëkulluar, mua që mbahem në sëmundje, shpëtomë pasi të më forcosh, o Vajzë, dhe denjësomë që të psal: E bekuar je ti që kishe në bark Perëndi me mish.

I shenjtoreve: Antitheon próstagma

Otë lumur, po humb dhe po arratiset arroganca e mëparshme e pabazë e herezive, ndërsa çdo dogmë e zvetënuar që sulmon kundër fjalëve tuaja të frymëzjarrta, shfaqet si qiri që shkrin nga faqja e zjarrit.⁹⁴

Nga njëra anë iu shmangën llafazanërisë gënjeshtare të grekëve, por nga ana tjetër zgjodhën bindjen, kryetaren e vetme të njerëzve; që të tre, pasi e forcuan me këtë të vërtetën, kapin dhe bindin me fjalë tërë bashkësinë e besnikëve.

Hyllindësore

Në ty u preh dhe mbaroi çdo parathënie që çudiste ata që e thoshin, o e kulluar, ndërsa prej teje burojnë mrekullitë më të shkëlqyera se profecitë, të cilat i dëftejnë të urtë ata që i shpjegojnë.

Tjetri: Theú singatávasin

Shtatore virtyti dhe urtësie u bënë hyjfolësit, edhe kur heshtnin, edhe kur brohorisnin, edhe kur shikoeshin, edhe kur dëgjoheshin, duke

nxitur me punë dhe me fjalë të thërrisnin: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.⁹¹

Otë urtë, duke pranuar zërat tuaj si zëra Perëndie nga lart që na kumbojnë mrekullisht, dhe si predha rrufesh,⁹⁵ këndojmë melodikisht dhe psalim tok me ju: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.⁹¹

Kur të dalë përpara ndonjë nga fjalamanët që nuk flet drejt, do të hidhen breshëri nga gjuhët që godasin me gur,⁹⁶ duke thërrmuar dogmat e kalbura. I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.⁹¹

Hyllindësore

Ai që shkëmben elemente banoi te ti që ishe e virgjër, o hyjnënë Mari e tërëpacenuar, dhe pas lindjes të la të virgjër; drejt tij thërrasim tok me ty, o e tërëpaqortueshme: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.⁹¹

Zbritësore: Se ton en piri

Hodhe vesën

Ode VIII

I Hyllindëses

Irmosi: Ton en kamino tu pirós

»**A**të që zbriti në kamin',* që të ishte tok me Djemtë⁹⁷ e hebrejve,* »Perëndinë që ktheu në vesë flakë »dhe zjarr,*⁹⁰ himnojeni vepra, se »është Zot,* përmbilartësoni atë në

»gjitha jetët.⁹⁸

Mendja ime dobësohet tani, sepse ra në thellësinë e çnderimit,⁹⁹ kështu u ngul në lloj-lloj të këqijash,¹⁰⁰ por ti, o e Virgjër, shëromë duke më mbështjellë me dritën e papasionshmërisë.

Duke të pasur me besë kullë të sigurt fuqie,¹⁰¹ bazament, roje dhe mbrojtje, o e Tërëdëlirë, shpëtojmë tani duke e himnuar Birin tënd dhe duke e përmbilartësuar në gjithë jetët.

Të dimë burim të kulluar pavdekësie, o Perëndilindëse, sepse e linde Fjalën e Atit të pavdekshëm, e cila i çliron nga vdekja¹⁰² të gjithë që e përmbilartësojnë në jetët.

O e dëlirë e pacenuar, gjithmonë na buron rrëke shërimesh neve besimtarëve, dhe duke nxjerrë tani prej saj hirin e bollshëm, e himnojmë Birin tënd dhe e përmbilartësojmë në gjithë jetët.

I shenjtorëve: Indhálmatos hrisú

Kuptojmë besërisht dhe lavdërojmë një natyrë të bashkënderuar, Njësi dhe Trini të fuqishme pa kufi, që i qeveris të gjitha këto me mendimet më të mira, sepse kështu garantojnë të besojmë tre hyjprurësit; i falemi asaj tok me ta në jetët.

U bashkuan tre hyjpredikuesit duke bashkuar Trininë dhe meqenëse e ruajtën pandashmërinë e natyrës hyjnore në të gjitha, u shpëblyen prej saj me një lavdi të pandarë, që i bashkëfton për një mburrje ata që e përmbilavdërojnë në jetët.

Hyjlindësore

Pasi mori Mirëbërësi natyrën tonë dhe e shpërbleu me të tijën, vetëm veproji, por nuk pësoi, o Virgjërëshë, sepse hyjnizon por nuk shpërngulet në prishje, ose më mirë, dhe duke pësuar vullnetarisht, me anën e pësimit i zgjidh pasionet, siç na mësojnë mistikisht tre Etërit.

Tjetri: Eptaplasios káminon

Ata që Perëndia i bashkoi në bashkim të bashkënderuar, asnjë lavdërues të mos i ndajë, por duke i konsideruar të barabartë në të njëjtët karizma, duke kënduar le t'i denjësojë edhe për himne të barabarta. O Djem e bekoni, priftërinj e përhimnoni, popull e përmbilartësoni në gjithë jetët.

Aleatët e fortë dhe të paluftueshëm të Hyjnisë dhe mbrojtësit e pagënjeshhtërt të së vërtetës, pasi hulumtuan mirë thellësitë e Shpirtit,¹⁰³ prej andej prezantojnë kuptimet e hyjduhura rreth Perëndisë dhe na mësojnë të psalim: O popull e përmbilartësoni Krishtin në jetët.

Nga një anë globin e ndriçojnë nga qielli ndërsjellas dy kandila shumë të mëdhenj, por nga ana tjetër, nga toka shkëlqejnë më dukshëm Gjithësinë së bashku tre ndriçues përmbi çdo masë,⁸ duke feksur tok me njëritjetrin dhe duke psalur bashkë: O popuj e përmbilartësoni Krishtin në jetë.

Hyllindësore

Për ne u krye mishërimi dhe pësimet e çmuara; për ne u bë tok me të vdekurit Perëndia, që duke qenë i lirë nga pasionet,¹⁰⁴ nuk shijoi vdekje, ndërsa përmes kungimit me mishin e vdekshëm thuhet se mori pjesë dhe në pësim, dhe në vdekje. Atë e përmbilartësojmë në gjithë jetët.

Zbritësore: Astekto piri

Në flak' e në zjarr

Ode IX

I Hyllindëses

Irmosi: Ton ek Theú Theón

»Ta madhështojmë me një zë,
»o besnikë, me himne* Fjalën e
»Perëndisë, Zotin⁸³ Krisht,* që parrë-
»fyeshëm mori për ne* mish nga
»Nëna e virgjër, e shenjtë; vjen të
»rinovojë pra* krejt Adamin, që kur
»hëngri,^{104a} ra në prishje mizorisht.

Të dorëzoj, e hyllum Vajz', shpresën time të tërë* zellshëm, gatishmë-

risht; shpëtomë ti,* nëna e jetës vërtet¹⁰⁵ je dhe lyp,* e dëlirë, të mbushem ngaherë me shijim, i mjeri un',* që ty të madhështoj përmes himnesh me besim dhe mall.

Pasi të shfaqesh, e Virgjër, ma shndrit terrin e shpirtit* nëpërmjet vezullimeve pa lënd'* prej dritës sate, o port'¹⁰⁶ drite ti;* denjëso të çlirohëm nga zjarri i përjetshëm,¹⁰⁷ e dëlir',* mua që me besim dhe me mall të madhështoj me himn.

Shikon, o Zonjë ti, se kemi sëmundje në trup ne* si dhe në shpirt, dhe jemi shtrirë keq* brenda pësimesh të tmerrshme, shëro* dhe përmes dhembshurisë ti zgjidhna nga trishtimet që tani* na ngacmojn', që me himn të të madhështojm' të gjith' gjithnjë.

Në barkun tënd kur fushoi Biri, që para jetësh* Ati prej barkut e ka lindur¹⁰⁸ pra,* ishte njeri i përsosur vërtet,* o Hyjnënë; të shfaqti te ne burim karizmesh, besërisht* lindjes sate që s'shprehet i falemi kështu me nder.

I shenjtoreve: Anarhu jenitoros

O shpirt, madhështoji* tre ndriçuesit tan'* të mëdhenj midis hierarkëve të shenjtë.

Ja ara¹⁰⁹ dhe grigja juaj për të cilën që të tre* keni hequr mundime të

shumta, të mëdha,* është mbledhur tok, dhe si ju morën pra në gji* kanë si himnim të përbashkët bashkimin mbar'* plot me gaz që e formuat ju.

O shpirt, madhështoji* tre ndriçuesit tan' në Kishën e Jisuit.

Ju shfaq Hiri thik' jo me dy presa, por me tri presa*¹¹⁰ ndaj armiqve të tij, shpatën e fërkuar lart* pra në qiell, që ka tre tehe të mprehtë brisk,* që në front të parë lufton përgjithnjë për hir* të Trinis' së trishkëlqyeshme.

O shpirt madhështoji* sa kanë stolisur mir' Kishën e Jisuit.

Në qiej, o zëmëdhenj, atje atdheun kishit ju,*¹¹¹ kur akoma me mish pa cen ishit veshur mir';* meqë po banoni në to çiltërsisht tani,* për të dheshmit ju ndërmjetoni që të mendojm'* e punojmë për të lartat¹¹² ne.

Hyjlindësore

O shpirt, madhështoje* Zonjën më të çmuar,* dhe të lavdëruar se çdo ushtri eprore.

O Zonj', gjerësia e çudive që bën më ngushton,* ma mbyl fjalën, se janë të dendura, kështu* me habi po ndodh që të ndihem i varfër krejt* nga kjo pasuri dhe prandaj madhështoj atë* që aq fort të madhëroi ty.

Tjetri: Eksesti epi tuto

O shpirt, madhështoji tre barinj të e

Trinisë së Tërëshenjtë.

Virtyti i Triadhës u ngrit fort lart* dhe i mbushi të gjitha me lavd,¹¹³ dhe ka shtrirë mbi dhé* një shkëlqim krejt ndryshe trefish kudo,* si vezullim prej vetë saj,*¹¹⁴ mistët, Profesorët tan' qiellor',* ata na udhëzojnë* te teoria sakte* e saj hyjnore ne që kemi bes'.

O shpirt, madhështoji tre ndriçuesit e mëdhenj, që janë nga Hyjnia tridiellore.

Në treshen s'ka të dytë në vlerësim,* se çdonjëri prej tyre i pari është', sado që ngjan* se të bashk'nderuarit i kalon.* Por si të tijën ky e pret* me hare fitoren e shokëve,* pa fare arrogancë,* zili që shkatërron krejt* bashkimin në mentalitet e shpirt.

Lavdi

O shpirt, madhështoje pushtetin e Hyjnisë trihipostate dhe të pandarë.

Të parëlindurit e saj besa jon'* i tregoi si Etër, fëmijë lind kjo me ata* krejt autentikë dhe pa qortim;* përsosen pra prej Shpirtit Zot* që u foli jetën në zemër thell';* kjo i kërkon që paqen* ta ruajë gjithmonë,* pra paqen që na trashëguan ne.

Tani *Hyjlindësore*

O shpirt, madhështoje më të çmuarën se ushtritë e sipërme.

O nënë Perëndie, e shpalli drejt* Birin tënd pors i Birin e Zotit të gjall',¹¹⁵

Perëndi,* maja e Mësuesve fort të urt';* s'ua mësoi mish, as gjak*¹¹⁶ por zbulim mistik që nga Ati lart;* ndaj nënë të mësoi,* Hyjlindëse të virgjër,* të madhështoi pra me nder gjithnjë.

Zbritësore: En nomo skiá qe grámati

O Hyjlindëse Mari

dhe

Në ligjën dhe shkronjën

Dërgimësore

O uranón tis astris

Rrufet' e shndritshme, enët* e dritës t'i lëvdojm' tani* gjithë ne Vasilin e Madh* dhe Theologun shën Grigor,* me ta Joanin Gojartë,* të tre Mësuesit tanë.

Tjetër E ngjashme

O Atë, Bir dhe Shpirt tok,* Hyjni unike, mos më ndaj* nga lavdia jote, o Zot,* me lutjet e së qastëres* Hyjlindëses dhe Vasilit,* Grigorit edhe Joanit.

Hyjlindësore

Ti, o kështjell' e florinjhtë, me dymbëdhjetë fortesa, o fron i ndritshëm si diell, ku rri si mbret i madh Krishti. Ti, o çudi e mahnitshme, si mban e i jep gjë Zotit!*

Lavdërime

Ting. II Püs efimión

Me çfar'* kurorëzim lavdi ne*

Profesorët t'i kurorëzojmë?* Ishin të veçuar në tre trupa,* por ishin lidhur përmes Shpirtit,* krerët e hyjprurësve të hyjshëm;* meqë* kishin të tre numrin e Trinis' së Shenjt';* asaj* i shërbyen tre ndriçuesit mbi dhé,*⁸ shtyllat e Kishës,⁵ që Krishti* Perëndi, i cili* ka mëshirën e madhe^{34a} krejt,* u vuri kurorë, lavd* të denjë,¹¹⁷ se dolën fitimtar'.

Me çfar'* psalmim të bukur dhe himn* te hyjprurësit kuror' të vëmë,* mistët qiellorë, lëçitësit* pra të besimit ton' orthodhoks,* theologët tanë mjaft të pastër,* të tre,* shën Vasili, hyjshfaqësi i madh tok* dhe me* shën Grigorin hyjfolësin e Trinis'* si dhe Joanin, kolosin* dhe gjuhëpruar.* Denjësisht pra i lëvdoi* Triadha, Zot Perëndi;* ajo ka mëshirën e madhe.^{34a}

Cilat* fjalime lavdërimi* hierarkët do t'i lartësojmë?* jan' të barabartë me apostujt* dhe si këta patën plot dhunti,* prishësit e pabesisë, japin* shpëtim,* dhe me fjalë, me punë udhëzojnë,* barinj* që përmes besimit imitojn' Krishtin,* engjëj mbi dhé, njerëz q'ellor';* i nderoi Krishti,* Perëndia i lavdit,¹¹⁸ Zot* i tërëfuqishëm, se* ai ka mëshirën e madhe.^{34a}

Me çfar'* fjalime lavdërimi,* ne Fjalartin ta kurorëzojmë,* bashkë

me Vasilin, Grigorin shenjt,* tre luftëtarë të besës son',* enët e nderuara të Shpirtit?* Se jan'* shtyllat që mbështesin besnikët, Kishën,*⁵ si dhe* ngushëllim i ngrohtë për mëkatarët.* Janë burimet që nxjerrin* rrjedhë; kur e marrim,* shumë gaz në shpirt ne kemi* dhe lypim, kërkojmë ndjes'* gabimesh, mëshirën e madhe.^{34a}

Lavdi

Ting. i njëjti Símeron o Hristós

Sot çdo shpirt njeriu* po lartësohen përmbi tokësoret,* bëhet qiellor sot në kujtimin* e shenjtorëve tanë,* sepse ngrihen lart portat¹¹⁹ krejt të qiejve* dhe mësojmë ne misteret e Zotit pra;* fjalimet sot fjalët i predikojn'* edhe gjuhët këndojn' mrekulli, çudi,* ndërsa ne te Shpëtimtari thërrasim:* Lavde Krishtit Zot Perëndi,* se përmes tyre erdhi* paqe ndër ne besimtarët.

Tani *Hyjlindësore*

I ngjashëm

Sot ofrohet Krishti* si foshnj' në Tempull.¹²⁰ Sot nën ligjin futet* Zoti që i dha Moisiut shenjt* Ligjin.¹²¹ Janë hutuar* lart ushtrit' engjëjlore kur pan' të mbahet* në gji plaku Zoti që mban gjithçka; prandaj* i mbushur me gaz dhe devotshmëri* Simeoni thërriste: Më përlëshon* tani, Shpëtimtar, nga jeta që prishet,* që të shkoj drejt fundit të mir'* që

s'plaket, se të pashë* dhe dëfreva shumë unë.¹²²

Dhoksologjia e Madhe.

U jepet dhe vaj të shenjtë vëllezërve.

Në Liturgji, Tipiket dhe nga Kanunet e shenjtorëve, Odet III dhe VI. Kontakti Ti që e shenjtërove (shih fq. 356). Kungatore: Në kujtim të përvjetshëm.

CITIME

¹ Is. 58.6

² Gjyq. 13.6 etj.; II Tim. 3.17; II Petr. 1.21

^{2a} Hebr. 3.5

^{2b} Is. 61.6

³ Dan. 9.23

⁴ Vep. 9.15

⁵ I Tim. 3.15

⁶ Jak. 2.5

^{6a} Joan 15.1

⁷ Kol. 1.9

⁸ Fil. 2.15

⁹ Matth. 25.21-23; Lluk. 19.17

¹⁰ Matth. 20.2,12

¹¹ Matth. 25.14-17

¹² Matth. 20.11

¹³ Vep. 7.56

¹⁴ Num. 31.6; II Kron. 13.12; I Makk. 4.40; 7.45

¹⁵ Gjen. 2.6

¹⁶ Ps. 18(19).4-5

¹⁷ Joan 1.14,18; 3.16,18; I Joan 4.9

¹⁸ Gjen. 21.19 etj.; Joan 4.10 etj.

¹⁹ Joan 4.14

²⁰ I Petr. 4.10

²¹ Ligji i Dytë 4.24; 9.3; Is. 6.6

- ²² I Mbret. [Sam.] 17.40,50
²³ Kishtari 4.12
²⁴ Kënga 4.3; 6.7
²⁵ Joan 2.15
²⁶ Ps. 117(118).22; Is. 28.16; Ef. 2.20;
 I Petr. 2.6
²⁷ I Mbret. [Sam.] 17.49-51; Sirak 47.4
²⁸ Lluk. 22.32
²⁹ Tit. 2.11-12
³⁰ Ef. 4.3
³¹ Matth. 3.1-2; Mark. 1.4; Lluk. 3.2-3
³² Eks. 25.30-37; 35.16; 38.13(37.17);
 40.22(24); Num. 4.9; 8.2; Hebr. 9.2
³³ Gjen. 28.17
³⁴ Ps. 45(46).5
^{34a} Num.14.19 etj.
³⁵ Joan 7.38-39
³⁶ Matth. 11.5
³⁷ Eks. 31.18; Ligji i Dytë 9.10
³⁸ Sirak 6.4; 18.31; 42.11
³⁹ Joan 17.4
⁴⁰ Ps. 44(45).3,8
⁴¹ Vep. 20.28
⁴² Vep. 4.32
⁴³ Gjen. 11.1,6
⁴⁴ Urt. Sol. 9.4
⁴⁵ Lluk. 4.22; Vep. 14.3; 20.32
⁴⁶ Joan 17.3
⁴⁷ Gal. 2.20
⁴⁸ Fja. Urt. 10.7
^{48a} Ps. 17(18).3; 70(71).3
^{48b} I Petr. 2.24
⁴⁹ I Kor. 1.30
⁵⁰ Joan 8.12; 9.5
⁵¹ I Joan 2.8
⁵² Matth. 5.13
⁵³ Gjen. 2.9; Fja. Urt. 3.18; Is. 65.22;
 Apok. 2.7; 22.2,14,19
⁵⁴ Rom. 4.17
⁵⁵ Is. 11.2-3
⁵⁶ Vep. 2.3
⁵⁷ I Kor. 1.20-21
⁵⁸ I Kor. 2.7
⁵⁹ I Kor. 12.8
⁶⁰ Matth. 4.18; Mark. 1.16; Lluk. 5.2
⁶¹ Lluk. 4.14; Rom. 15.13,19
⁶² Ps. 17(18).15; Fja. Urt. 14.12
⁶³ Jak. 5.7
⁶⁴ Gjen. 1.6,9
⁶⁵ Hebr. 1.2
⁶⁶ Eks. 13.21-22
⁶⁷ Eks. 16.31-35; Num. 11.6-9; Ligji i Dytë
 8.3,16; Joan 6.31; Hebr. 9.4; Apok. 2.17
⁶⁸ Ps. 80(81).17
⁶⁹ Ps. 77(78).24; Joan 6.31-32,41,50,58
⁷⁰ Ps. 77(78).25
⁷¹ Ps. 64(65).10
⁷² Ps. 35(36).9
⁷³ Ps. 45(46).5
⁷⁴ Jak. 1.17
⁷⁵ Is. 26.9; Ps. 118(119).35
⁷⁶ Is. 26.13
⁷⁷ Jov 36.5
⁷⁸ Is. 6.2
⁷⁹ Jona 2.7
⁸⁰ Is. 61.10
⁸¹ Lluk. 19.9
⁸² Matth. 18.20
⁸³ Joan 1.1-2
⁸⁴ Jov 32.20; Ps. 50(51).17
⁸⁵ II Makk. 9.7
⁸⁶ Abak. 3.15
⁸⁷ Jov 39.21
⁸⁸ Matth. 3.2 etj.

- ⁸⁹ Dan. 3.1
⁹⁰ Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 26
⁹¹ Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 28
⁹² Kol. 2.14
⁹³ Ps. 68(69).21
⁹⁴ Ps. 67(68).3
⁹⁵ Urt. Sol. 5.21
⁹⁶ Urt. Sol. 5.22
⁹⁷ Dan. kap. 3. Lutja e Azarias 25
⁹⁸ Dan. kap. 3. Lutja e Azarias 34
⁹⁹ Rom. 1.26
¹⁰⁰ Jak. 1.2
¹⁰¹ Ps. 60(61).4
¹⁰² Osea 13.14
¹⁰³ I Kor. 2.10
¹⁰⁴ Joan 8.46
^{104a} Gjen. 3.1-6
¹⁰⁵ Joan 11.25; 14.6; Kol. 3.4; I Joan 1.2;
5.12,20
¹⁰⁶ Jez. 44.1-4
¹⁰⁷ Matth. 18.8; 25.41
¹⁰⁸ Ps. 109(110).3
¹⁰⁹ I Kor. 3.9
¹¹⁰ Hebr. 4.12
¹¹¹ Fil. 3.20
¹¹² Kol. 3.2
¹¹³ Ps. 71(72).19; Abak. 3.3
¹¹⁴ Urt. Sol. 7.26
¹¹⁵ Jis. N. 3.10 etj.; I Tim. 3.15
¹¹⁶ Joan 1.13
¹¹⁷ I Petr. 5.4
¹¹⁸ I Kor. 2.8
¹¹⁹ Ps. 23(24).7,9
¹²⁰ Gal. 4.4
¹²¹ Lev. 26.46 etj.
¹²² Lluk. 2.22-38





MË 2 TË TË NJËJTIT MUAJ

Ipapandia (Paraqitja në Tempull) e Zotit dhe Perëndisë, dhe Shpëtimtarit tonë Jisu Krisht.

Tipikon

1. Nëse bie në një nga të dielat para Triodhit:

Të shtunën në Mbrëmësore, pas Kathismës së parë të Psaltirit, Thirrtores: 4 ngjallësore dhe 6 të së kremtes. Lavdi dhe Tani i së kremtes. Hyrje. O ditë gazmore. Leximet. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi dhe Tani i së kremtes. Përlëshoret: ngjallësore dhe e së kremtes (2x).

Të dielën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Kanuni Triadik, Litia e së kremtes dhe Himnet Triadike. Trishenjtë. Përlëshorja e së kremtes. Në Mëngjesore, Ndenjësores ngjallësore dhe nga një Ndenjësores të së kremtes në vend të Hyjlindësoreve. Pas Polieleit (Psalmi 44), Ndenjësores e së kremtes (2x). (Nuk thuhet Bekimtores). Përsëri dhe përsëri. Se i bekuar është emri yt. Ipakoia dhe Shkallesat e tingullit. Proqimëni i së kremtes. Çdo frymë. Ungjilli i së kremtes. Ne që pamë ngjalljen. Psalmi 50 hima. Lavdi etj. të së kremtes. Kanunet: ngjallësor dhe i së kremtes me varg “E përmbishenjtë Hyjlindëse, shpëtona” (në dy troparet e fundit Lavdi dhe Tani, si zakonisht). Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia Ngjallësore. Ndenjësores e së kremtes një herë. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e së kremtes dhe Sinaksari. Zbritësoret e së kremtes. Në vend të Më të nderuarën, Ode IX [ngjallësore dhe] e së kremtes bashkë me Madhështimet e saj.

Dërgimësoret: ngjallësore dhe e së kremtes (2x). Lavdërimet: 4 ngjallësore dhe 4 të së kremtes. Lavdi i së kremtes. Tani E përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji Antifonet e së kremtes, Hyrtorja e së kremtes, por Shpëtona..., që u ngjalle prej së vdekurish. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore dhe e së kremtes. Kontakti i së kremtes. Apostulli dhe Ungjilli i së kremtes. Në vend të Të meriton, O Hyj lindëse, Në Ligjën. Kungatore Kupë shpëtimi. Pamë dritën. Përlëshimi: Ai që denjoi të mbahet në kraharorin e Simeonit të drejtë për shpëtimin tonë dhe u ngjall prej së vdekurish, Krishti Perëndia ynë.

2. Nëse bie të dielën brenda Triodhit:

Të shtunën në Mbrëmësore, pas Kathismës së parë të Psaltirit, Thirrtoret: 4 ngjallësore, 2 të Triodhit dhe 4 të së kremtes. Lavdi i Triodhit. Tani i së kremtes. Hyrje. O dritë gazmore. Leximet. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi i Triodhit. Tani i së kremtes. Përlëshoret: ngjallësore dhe e së kremtes (2x).

Të dielën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmi 50, Kanuni Triadik, Litia e së kremtes dhe Himnet Triadike. Trishenjti. Përlëshorja e së kremtes. Në Mëngjesore, Ndenjësore ngjallësore dhe nga një Ndenjësore të së kremtes në vend të Hyj lindësoreve. Pas Polieleit (Psalmi 44), Ndenjësorja e së kremtes (2x). (Nuk psalen Bekimtoret). Përsëri dhe përsëri. Se i bekuar është emri yt. Ipakoia dhe Shkallesat e tingullit. Proqimeni i së kremtes. Çdo frymë. Ungjilli i së kremtes. Ne që pamë ngjalljen. Psalmi 50 hima. Lavdi etj. të së kremtes. Kanunet: ngjallësor, i Triodhit dhe i së kremtes me varg “E përmbishenjti Hyj lindëse, shpëtona” (në dy troparet e fundit Lavdi dhe Tani, si zakonisht). Pas Odes III, Kontakti dhe Shtëpia Ngjallësore. Ndenjësorja e Triodhit dhe e së kremtes. Pas Odes VI, Kontakti dhe Shtëpia e Triodhit, Sinaksari i së kremtes dhe i Triodhit. Zbritësoret e së kremtes. Në vend të Më të nderuarën, Ode IX [ngjallësore dhe] e së kremtes bashkë me Madhështimet e saj [dhe e Triodhit], Dërgimësoret: ngjallësore, e Triodhit dhe e së kremtes. Lavdërimet: 4 ngjallësore dhe 4 të së kremtes Lavdi i Triodhit. Tani i së kremtes. Sot erdhi.

Në Liturgji Antifonet e së kremtes, Hyrtorja e së kremtes, por Shpëtona..., që u ngjalle prej së vdekurish. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore dhe e së kremtes. Kontakti i së kremtes. Apostulli i së kremtes dhe Ungjilli i së Dielës. Në vend Të meriton, O Hyj lindëse, Në Ligjën. Kungatore Kupë shpëtimi. Pamë dritën. Përlëshimi Ai që denjoi të mbahet në kraharorin e Simeonit të drejtë për shpëtimin tonë dhe u ngjall prej së vdekurish, Krishti Perëndia ynë.



NË MBRËMËSOREN E VOGËL

*Thirrto**Ting. I Ton uranion tagmaton*

Fjalën e papërshkruar dhe të përbisubstancshme, që ulet me lavdi mbi frone qiellore¹ e pranon në kraharor Simeoni duke thirrur: Tani përlëshomë sipas fjalës sate, o Shpëtimtar, shpëtimi dhe shijimi i besnikëve.

Thërriste Simeoni i mahnitshëm duke të parë ty foshnjë, Fjalën e parajetshme që lindi prej Atit: Frikësohem dhe dridhem të të përqafoj me duart e mia, o Zot, por kërkoj të më përlëshosh në paqe tani mua shërbëtorin tënd, si i dhembshur.

Le të hapet tani porta qiellore. Fjala Perëndi,² që lindi nga Ati pa mot, lindi nga një e Virgjër pasi mori mish, duke dashur të rithërrasë natyrën njerëzore si i mirë dhe ta vendosë në të djathtën e Atit.³

Lavdi *dhe* Tani*Ting. IV I Andreas të Kretës*

Sot nëna e hyjshme dhe më e lartë se Hierorja mbërriti në Hierore, duke i paraqitur botës Bërësin e saj⁴ dhe dhënësin e Ligjit. Sapo e priti atë në kraharor Simeoni plak, thërriste duke lavdëruar: Tani përlëshon shërbëtorin tënd, sepse të pashë ty, Shpëtimtarin e shpirtrave tanë.

*Pasvargje**Ting. II Ikos tu Efrathá*

Sot Shpëtimtari u soll si foshnjë në Tempullin e Zotit dhe e pranon plakun në duar të vjetra.

Varg: Tani përlëshon shërbëtorin tënd, o Zot, sipas fjalës sate, në paqe, se sytë e mi panë shpëtimin tënd, të cilin ti e përgatite faqe gjithë popujve. **T**hëngjilli që u pa më parë nga Isaia i hyjshëm,⁵ Krishti, i jepet tani plakut me duart e Perëndilindëses si me mashë.

Varg: Dritë për ndriçimin e paganëve dhe për lavdi të popullit tënd Izrael. **D**uke pasur në kraharor Simeoni Zotin, me frikë dhe me hare kërkonte përlëshim jete duke himnuar Hyjnënën.

Lavdi *dhe* Tani

E tërëkulluara thërriste: Prano, o Simeon, në kraharor si foshnjë Zotin e lavdisë⁶ dhe shpëtimin e botës.

*Përlëshore***Gëzohu, o Hyjlindëse.**

NË MBRËMËSOREN E MADHE

*Pas Qëndrimit të parë të Psaltirit
(Lum ai njeri),
Thirrto Idhiomele*

Ting. I I Gjermanoit patriark

Thuaj, Simeon, për cilin ngazëllohesh në Tempull duke e mbajtur në kraharor? Cilit i thërret dhe i këlthet: “Tani u çlirova, sepse pashë Shpëtimtarin tim”? Ai është i linduri prej një virgjëreshe; ai është Fjala Perëndi² prej Perëndie, i cili u mishërua për ne dhe shpëtoi njeriun, atij le t’i falemi.

(2x)

Prit, o Simeon, atë që parapa Moisiu në Sina nën furtunë të vendoste Ligj,⁷ të bëhet foshnjë dhe t’i nënshtrohet Ligjit.⁸ Ai është folësi përmes Ligjit, ai është i foluri nga profetë, i mishëruari për ne dhe që shpëtoi njeriun, atij le t’i falemi.

(2x)

Ejani dhe ne le të takojmë me këngë të perëndishme Krishtin dhe le ta mikpresim atë, shpëtimin e të cilit e pa Simeoni. Ai është i shpalluri prej Davidit,⁹ është ai që foli nëpërmjet profetëve, i mishëruari për ne, dhe flet në Ligj, atij le t’i falemi.

(2x)

Lavdi *dhe* Tani*Ting. Tërth. II I Joan Monakut*

Le të hapet porta e qiellit sot, sepse Fjala e pamoçme e Atit, si mori fillim kohor, pa u larguar nga Hyjnia e tij, ofrohet vullnetarisht në Tempullin Ligjor nga nëna e virgjër

si foshnjë dyzet ditore; dhe e pret atë në kraharor plaku, duke i thirrur shërbëtori Zotërisë: “Përlëshomë, sepse sytë e mi e panë shpëtimin tënd”. Ti që erdhe në botë të shpëtosh gjini njerëzish,¹⁰ o Zot, lavdi më ty.

Hyrje. O dritë gazmore. Proqimëni i ditës dhe Leximet.

Këndimi i Eksodit

(12.51; 13.2-3 etj.)

Foli Zoti drejt Moisiut në atë ditë, në të cilën nxori bijtë e Izraelit nga dhé Egjipti duke thënë: “Më shenjtëro çdo të parëlindur, fëmijë të parë, që hap çdo mitër ndër bijtë e Izraelit”. Dhe Moisiu tha drejt popullit: «Kujtoni këtë ditë, në të cilën dolët nga dheu i Egjiptit, nga shtëpia e skllavërisë, sepse me dorë të fuqishme ju nxori Zoti prej këtej. Dhe do të ruani Ligjin e tij. Dhe do të ndodhë, kur do të të futë Zoti Perëndi në tokën e Kananeasve, sepse iu betua etërve të tu, dhe do të veçosh çdo fëmijë që çel mitrën, meshkujt, për Zotin. Dhe nëse do të pyesë pastaj biri yt duke thënë: ‘Ç’është kjo?’ dhe do t’i thuash se: ‘Me dorë të fuqishme na nxori Zoti nga dheu i Egjiptit, nga shtëpia e skllavërisë. Dhe kur u ashpërsua Faraoni që të mos na dërgonte, Zoti vrau çdo të parëlindur në dhé Egjipti, që nga të parëlindurit e njerëzve, deri në të parëlindurit e kafshëve. Për këtë, çdo fëmijë

që çel mitër, meshkujt, unë ia flijoj Zotit, dhe çdo të parëlindur nga bijtë e mi do të shpërblej'. Dhe do të jetë si shenjë mbi dorën tënde dhe e patundur para syve të tu, sepse kështu tha Zoti i Tërëpushtetshëm se: 'Të parëlindurit nga bijtë e tu do të m'i japësh mua. Dhe do të ndodhë, çdokush që do të bëhet me fëmijë mashkull në ditën e tetë do të rrethpresë mishin e lafshës së tij. Dhe për tridhjetë e tri ditë nuk do të hyjë në shenjtëroren e Perëndisë drejt priftit, derisa të mbushen ditët e pastrimit. Dhe pas këtyre do t'i sjellë Zotit qengj njëvjeçar pa njollë për holokaust dhe një zog pëllumbeshë ose turtulleshe, mbi derën e Tendës së Dëshmisë drejt priftit; ose në vend të tyre do të sjellë përballë Zotit dy zogj pëllumbeshash ose dy turtuj. Dhe prifti do të më zbutë për atë, sepse m'u dhanë si shpërblim nga të gjithë bijtë e Izraelit, dhe i kam marrë, dhe i shenjtërova për vete, në vend të të parëlindurve të egjiptianëve, në ditën kur godita çdo të parëlindur në dhë Egjipti, që nga njeriu deri te kafsha', tha Perëndia i Shumëlartë, i shenjtë i Izraelit.»

Këndimi i profecisë së Isaias

(6.1-12)

Në vitin kur vdiq Ozia mbret pashë Zotin të ulej mbi një fron të lartë dhe të ngritur; dhe ishte e mbushur shtëpia e lavdisë së tij. Dhe Serafime

qëndronin përreth tij, *ishin* gjashtë krahë tek njëri dhe gjashtë krahë tek njëri, dhe nga një anë me të dyja mbulonin plotësisht fytyrat e tyre, dhe nga ana tjetër mbulonin plotësisht këmbët dhe me të dyja fluturonin. Dhe thërrisnin drejt njëritjetrit dhe thoshin "Shenjt, Shenjt, Shenjt, Zoti Sabaoth, është mbushur e gjithë toka nga lavdia e tij". Dhe u ngrit korniza e sipërme e derës nga zëri që thërrisnin dhe shtëpia u mbush me tym. Dhe thashë: "O i mjeri unë! Se u dërrmova, se ndonëse jam njeri dhe kam buzë të papastra, mes populli që ka buzë të papastra unë banoj, dhe mbretin Zot Sabaoth e pashë me sytë e mi". Dhe u dërgua drejt meje një nga Serafimet dhe në dorën e tij kishte thëngjill që me mashë e mori nga altari. Dhe e preku gojën time dhe tha: "Ja ku preku kjo buzët e tua dhe do t'i heqë paligjësitë e tua, dhe mëkatet e tua do t'i pastrojë rreth e qark". Dhe e dëgjova zërin e Zotit që thoshte: "Cilin të dërgoj? Dhe kush do të shkojë drejt këtij populli?". Dhe thashë: "Ja, unë jam, më dërgo". Dhe tha: "Ec dhe thuaji këtij populli: 'Me dëgjim do të dëgjoni dhe nuk do të kuptoni, dhe duke parë do të shihni dhe nuk do të shikoni;' sepse u trash zemra e këtij populli dhe dëgjuan me veshë të rënduar dhe mbyllën sytë e tyre, mos ndoshta të shikojnë me sy dhe me veshët të dëgjojnë,

dhe me zemrën të kuptojnë, dhe të rikthehen dhe t'i shëroj". Dhe thashë: "Deri kur, o Zot?". Dhe tha: "Derisa të shkretohen qytete, sepse nuk do banohen dhe shtëpi, sepse nuk do të ketë njerëz; dhe toka do të lihet e shkretë". Dhe pas këtyre do t'i shtrijë Perëndia njerëzit dhe do të shumëfishohen të braktisurit mbi tokën.

Këndimi i Profecisë së Isaias

(19.1,3-4,12,16,19-21)

Ja, Zoti rri mbi një re të lehtë, dhe do të shkojë në Egjipt, dhe do të lëkunden punët e duarve në Egjipt para faqes së tij dhe zemra e tyre do të humbasë brenda tyre. "Dhe do të trazohet shpirti i tyre përbrenda dhe mendimin e tyre do ta shpërndaj, dhe do ta dorëzoj Egjiptin në duar zotërinjsh të ashpër", këto thotë Zoti. "Dhe do të pinë egjiptianët ujin që është pranë detit, ndërsa lumi do të shterohet dhe do të thahet", këto thotë Zoti. Ku janë tani të urtët e tu? Dhe le të të njoftojnë dhe le të thonë çfarë ka menduar Zoti Sabaoth ndaj Egjiptit. Në atë ditë do të jenë egjiptianët si gra, me frikë dhe me tmerr nga faqja e dorës së Zotit Sabaoth, të cilën ai do ta vendosë mbi ta. Dhe do të ketë një altar për Zotin në vend egjiptianësh dhe shtyllë afër kufirit të saj për Zotin. Dhe do të ketë përjetë si shenjë për Zotin në vend Egjipti, sepse do të thërrasin drejt Zotit dhe

do t'u dërgojë një njeri, i cili do t'i shpëtojë. Dhe i njohur do t'u jetë Zoti egjiptianëve; dhe do ta njohin egjiptianët Zotin në atë ditë dhe do të bëjnë flijim, dhe do t'i luten me lutje Zotit dhe do ta shpërblejnë.

Në Liti Idhiomele

Ting. I I Anatoliut

Ivjetri i ditëve,¹¹ që edhe Ligjin qëmoti në Sina ia dha Moisiut,⁷ sot foshnjë shihet, dhe sipas Ligjit, si Bërësi i Ligjit, duke përmbushur Ligjin,⁸ i sillet Tempullit dhe plakut i jepet. Dhe sapo e priti Simeoni i drejtë dhe pa të kryer përfundimin e porosive, thërriste i gëzuar: E panë sytë e mi misterin e fshehur prej jete të zbulohet¹² në këto ditë të fundme, dritë që shpërndan natën e errët dhe lavdi e Izraelit të sapombledhur; prandaj përlësho shërbëtorin tënd nga pranga e këtij trupi të varfër, drejt jetës së paplakur, të mrekullueshme dhe pa mbarim, ti që i jep botës përdëllimin e madh.^{12a}

I njëjti I Joan Monakut

Sot, ai që qëmoti Moisiut në Sina i dha Ligj,⁷ nënshtrohet në Kanunet Ligjore,⁸ pasi u bë për ne i dhembshur. Tani Perëndia i pastër si fëmijë i shenjtë, që hapi mitër të papikëluar, i sillet vetes së tij si Perëndi,¹³ duke çliruar nga mallkimi i Ligjit¹⁴ dhe duke i ndriçuar shpirtrat tanë.

Ting. II I Andrea Pirit

Atë që shërbyesit e sipërm e bëjnë litani me tmerr, poshtë tani Simeoni duke e pranuar në kraharor lëndor shpallte se Hyjnia bashkohej me njerëzit; dhe duke e parë si njeri Perëndinë qiellor dhe duke ikur nga tokësoret, thërriste i ngazëlluar: Ti që u zbulon atyre që janë në errësirë dritën¹⁵ e paperëndueshme, o Zot, lavdi më ty.

Injëjti I Gjermanoit

Sot Simeoni mikpret në kraharor Zotin e lavdisë,⁶ të cilin më parë Moisiu e pa nën furtunën⁷ t'i jepte pllaka në malin Sina.¹⁶ Ky është ai që flet në profetët dhe bërësi i Ligjit. Ky është ai që e proklamoi Davidi,⁹ i frikshëm për të gjitha,¹⁷ që ka përdëllimin e madh^{12a} dhe të pasur.

*Injëjti I Gjermanoit**ose sipas të tjerëve i Joan Monakut*

Të shenjtin Virgjëresha e shenjtë ia çoi të shenjtit në Shenjtërore; dhe pasi i shtriu krahet Simeoni, e priti duke u ngazëlluar dhe thirri: Tani përlëshon shërbëtorin tënd sipas fjalës sate në paqe, o Zot.

Injëjti I të njëjtit

Ndërtuesi i qiellit dhe i dheut, në kraharor mbahej prej shën Simeonit plak sot, sepse ai në Shpirt të Shenjtë thoshte: Tani jam çliruar, se e pashë Shpëtimtarin tim.

*Injëjti I Anatoliut**ose sipas të tjerëve i Andrea**Jerusalemasit*

Sot Simeoni plak hyn në Tempull duke ngazëlluar në shpirt, që ta pranojë në prehër ligjëdhënësin e Moisiut⁷ dhe përmbushësin e Ligjit;⁸ sepse ai përmes furtune⁷ dhe zëri të lehtë¹⁸ u denjësua për hyjshikues¹⁹ dhe me faqe të mbuluar i qortoi zemrat e pabesa të hebrenjve;²⁰ ndërsa ky e mbajti Fjalën e parajetshme të Atit që u trupëzua dhe zbuloi Dritën e kombeve, Kryqin dhe Ngjalljen; dhe Ana dallohet si profeteshë duke shpallur Shpëtimtarin, Çliruesin e Izraelit. Atij le t'i thërresim: O Krisht, Perëndia ynë, me anën e Hyjlindëses mëshirona.

Ting. IV I Andreas të Kretës

Sot nëna e hyjshme dhe më e lartë se Hierorja mbërriti në Hierore, duke i paraqitur botës Bërësin e saj⁴ dhe dhënësin e Ligjit. Sapo e priti atë në kraharor Simeoni plak, thërriste duke lavdëruar: Tani përlëshon shërbëtorin tënd, sepse të pashë ty, Shpëtimtarin e shpirtave tanë.

Lavdi

Ting. Tërth. I I të njëjtit

Hulumtoni Shkrimet, siç tha në Ungjijtë Krishti,²¹ Perëndia ynë, sepse në këto e gjejmë atë të lindet dhe të mbështillet me shpërgën, të mëndet dhe të ushqehet me qu-

mësht, të pranojë rrethprerje dhe të mbahet prej Simeonit, jo me mënyrë imagjinare, as fantastike, veçse iu shfaq botës me të vërtetë; atij le t'i thërresim: O Perëndi i parajetshëm, lavdi më ty.

Tani *Injëti*

I Gjermanoit, ose sipas të tjerëve i Anatoliut

I vjetri i ditëve,¹¹ pasi u bë foshnjë në mish, prej nëne të virgjër Hierores i sillet duke përmbushur⁸ porosinë e Ligjit të vet.¹³ Atë si e pranoi Simeoni, thoshte: Tani përlëshon në paqe shërbëtorin tënd sipas fjalës sate, sepse panë sytë e mi shpëtimin tënd, o Zot.

Pasvargje Idhiomele

Ting. i Rëndë I Kozma Monakut

Zbukuro nusëroren tënde, Sion, dhe mikprit mbretin Krisht; përshëndet Mariamën, portën²² qiellore; sepse ajo u dallua fron keruvik,¹ ajo mban mbretin e lavdisë.²³ Virgjëresha është re drite,²⁴ duke sjellë në mish Bir para eosforit.²⁵ Atë pasi e mori Simeoni në kraharorin e tij, u shpalli popujve se ai është Zoti i jetës dhe i vdekjes, dhe Shpëtimtari i botës.

Varg: Tani përlëshon shërbëtorin tënd, o Zot, sipas fjalës sate, në paqe, se sytë e mi panë shpëtimin tënd, të cilin ti e përgatite faqe gjithë popujve. **A**të që shndriti para jetëve nga

Ati,²⁶ ndërsa në fund nga një mitër virgjërore, e sillte në Tempull nëna pa dasmë, sepse i bindej urdhëresës Ligjore⁸ ai që vuri Ligj në malin Sina;⁷ e sillte te një prift plak dhe të drejtë, i cili kishte marrë orakull se do ta shihte Krishtin Zot. Sapo e priti atë Simeoni në kraharorin e tij u gëzua duke thirrur: Ky është Perëndi i bashkëpërrjetshëm me Atin dhe Çlirimtari i shpirtrave tanë.

Varg: Dritë për ndriçimin e paganëve dhe për lavdi të popullit tënd Izrael.

Të hipurin në karrocë keruvike¹ dhe të himnuarin me këngë serafimike,²⁷ duke e mbajtur në kraharor Maria Perëndilindëse, si u mishërua prej saj pa dasmë, atë, Ligjdhënësin e Ligjit⁷ që përmbushte rend Ligji,⁸ ua jepte duarve të një prift të moshuar. Dhe ndonëse mbante Jetën,²⁸ kërkonte zgjidhje jete duke thënë: O Zot, tani më përlësho, që t'i njoftoj Adamit se pashë një foshnjë të pandryshuar, Perëndi të parajetshëm dhe Shpëtimtar të botës.

Lavdi *dhe* Tani

Ting. Tërth. IV I Andreas të Kretës

Ai që lëviz hipur mbi Keruvime¹ dhe himnohet prej Serafimesh,²⁷ sot që i ofrohet sipas Ligjit¹³ Hierores së hyjshme, fronëzohet në kraharor plaku; dhe nga Josifi pranon dhurata siç i duhet Perëndisë, si çift turtujsh, Kishën e papikëluar dhe popullin e

sapombledhur të kombeve, ndërsa dytë vegjël pëllumbeshash si Kryetari i së Vjetrës dhe i së Resë. Dhe si pranoi Simeoni fundin e orakullit që i ishte dhënë, duke e bekuar Marinë Hyjlindëse virgjëreshë, paratha simbolet e pësimit të atij që lindi prej saj. Dhe kërkon nga ai përlëshimin duke thirrur: Tani më përlëshon, o Zot, sikundër më premtove më parë, se të pashë ty, dritën²⁹ e parajetshme dhe Shpëtimtarin Zot të popullit me emrin e Krishtit.

Përlëshore

Ting. I

Gëzohu, o Hyjlindëse Virgjëreshë Hirplote, se prej teje lindi Krishti, Perëndia yn', dielli i drejtësisë,³⁰ që ndriçon ata që ndodhen n'errësisë;¹⁵ gëzohu dhe ti, o plak i drejtë, që prite në pëqi Çlirimtarin e shpirtave tanë, që na fal ngjalljen.

(3x)

Përlëshim: Ai që denjoi të mbahej në kraharorin e Simeonit të drejtë për shpëtimin tonë, Krishti, Perëndia ynë i vërtetë.



NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësore
Ting. I Horós angjelikós
(=Ton tafon su Sotír)*

Kor engjëjsh me çudin'* të habitet, ndërsa ne* të vdekshmit të thërrasim me zë himn, se shohim* pashprehshëm bashkëzbritjen e Perëndisë, sepse atë* që e druajnë* fuqitë mbarë në qiejt,* Njeridashësin* e vetëm, e përqafojnë* tani duar plaku fort.

Lavdi dhe Tani

I njëjti

Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësore

Ting. I Ton tafon su Sotír

Ai që rri përmbi* fron të shenjtë më Atin,*³¹ kur erdhi përmbi dhé prej së Virgjërës lindi* dhe foshnj' u bë, dhe pse në mot nuk përshkruhet; në kraharor* Simeoni kur e priti, thoshte me gaz plot:* Shërbëtorin tënd si e dëfteve tani ti,* i dhembshur, e përlëshon.

Lavdi dhe Tani

I njëjti

Pas Polieleit (Psalmi 44), Ndenjësore

Ting. IV Kateplaji Iosíf

Foshnjë vjen për hirin tim* i Lashti Zot i ditëve,*¹¹ pjesë merr pra në pastrim* dhe pse i pastër është krejt,* të vërtetojë tek un' mish e trup që mori* nga një virgjëresh'; e mëson këtë* mistikisht dhe njih shenjtin Simeon* të njëjtin Perëndi të shfaqur me trup.*³² E puth si jetë²⁸ dhe me hare* si plak thërriste: Meqë

të pashë,* lërmë, jeta e botës.

Lavdi *dhe* Tani
I njëjti

Shkallesat. Antifoni i parë i Ting. IV
Proqimeni Ting. IV

Do ta kujtoj emrin tënd në gjithë brezat e brezave.

Varg: Nxori zemra ime fjalë të mirë.

Ungjilli. Psalmi 50.

Lavdi. Me ndërmjetimet e Hyjlindëses.
Tani *I njëjti*
Përdëllemë, o Perëndi. *Dhe Idhiomeli.*

Ting. Tërth. II I Joan Monakut

Le të hapet porta e qiellit sot, sepse Fjala e pamoçme e Atit, si mori fillim kohor, pa u larguar nga Hyjnia e tij, ofrohet vullnetarisht në Tempullin Ligjor nga nëna e virgjër si foshnjë dyzet ditore; dhe e pret atë në kraharor plaku, duke i thirrur shërbëtori Zotërisë: “Përlëshomë, sepse sytë e mi e panë shpëtimin tënd”. Ti që erdhe në botë të shpëtosh gjini njerëzish,¹⁰ o Zot, lavdi më ty.

Kanuni, që ka Akrostihidhë: “Një plak e përqafton Krishtin i ngazëlluar”.

Poezi e Kozma Monakut

Në 6 (pa vargje, por si zakonisht në dy të fundit Lavdi dhe Tani).

Ting. III
Ode I

Irmosi: Herson avisotokon

»**F**undin edhe burimin e avushave
»dielli një her’ e pa, se si mur u bënë
»valët edhe shkoj Izraeli më këmbë
»nëpërmes të detit përtej; me këng’
»e brohori le ta këndojmë Zotin të
»lavdëruar me lavdi.^{33*}

Retë le të pikojnë ujë,³⁴ Krishti Zot* erdhi brenda Tempullit* si një foshnj’ duke lëvizur* porsi diell i hipur* mbi re të lehtë,³⁵ ndërmjet llërëve pa cen, o besnikë, pra* Zotit le t’i këndojmë, se u lëvdua lavdërisht.³³

Duar të Simeonit të këputura* që prej pleqërisë pra,* fuqizohuni, ju këmbë*³⁶ plaku pa forc’, lëvizni* drejt pritjes së Jisuit Krisht. Të krijojm’ me të patrupët kor* që t’i këndojmë Zotit, se u lëvdua lavdërisht.³³

Qiej të shtrirë³⁷ mençurisht, gëzohuni,* o dhé, ki hare³⁸ dhe gaz;* la gjitë mbiperëndishëm*³⁹ mjeshtri⁴⁰ Krisht edhe erdhi;* nga nëna krejt e virgjër, jepet tek Ati Perëndi si foshnj’* dhe pse është më parë se bota edhe ka lavdi.

Zbritësore: Herson avisotokon

Fundin edhe burimin

Ode III

Irmosi: To steréoma

»**Z**oti Krisht⁴¹ që i mbron besnikët
»shpresëplotë, forcoje dhe mbroje

»Kishën⁴² e bekuar, që e mbolle me
»vojte dhe me gjakun tënd.^{43*}

Para jetëve* i parëlindur' i Atit,*⁴⁴
Adamit at'* duart i shtrin kur u shfaq
foshnj'* nga një vajzë* pa cen, i
parëlinduri.

Fjala Perëndi*² u shfaq si foshnj',
që Adamin* që foshnj' u bë* ky në
mendje⁴⁵ prej mashtrimi,* ta ringri-
nte,* pra të parëgatuarin.

Pandryshim u pa* si foshnj' Gatuesi;
e shfaq* natyrën ton',* bijë dheu,⁴⁶
që u kthye* prap' drejt tokës,*⁴⁷ me
Hyjni e bën të ngjashme.⁴⁸

Zbritësore: To steréoma
Zoti Krisht që i mbron

Ndenjëso
Ting. IV Kateplaji Iosif

Kur i pa në mal Sina* qëmoti
shpinën Perëndis'* Moisiu¹⁹ dhe u
bë* i denjë, pra dëgjoi leht'* një zë
hyjnor në stuhi dhe në errësirë,*⁷
ndërsa Simeoni e përqafo* Perë-
ndinë që pa ndryshim për ne* u
mishërua; ndaj nxiton të ikë* me
ngazëllim drejt, përtej në jet'* të
amëshuar, kështu thërret: Zot,*
përlësho shërbëtorin tënd.

(1x)

Ode IV

Irmosi: Ekálipsen uranús

»**M**bulove me virtyte qiellin, o
»Zoti⁴⁹ Krisht kur linde prej nënën
»virgjëreshë dhe⁵⁰ u shpure në Ki-
»shën⁵¹ si foshnjë në pëqi, dhe »i
mbushe të gjitha me lavdi⁴⁹ dhe
»brohori.*

Perëndilindësja thërriste: O Simeon,
misti i sekreteve, përqafo i ngazëlluar
atë për të cilin u lajmërove shumë
më parë me orakull prej Shpirtit
të Shenjtë, Krishtin Fjalë, që u bë
foshnjë, dhe thirri atij: U mbushën të
gjitha nga himnimi yt.⁴⁹

O Simeon, ngushëllimin e Izraelit
hyjnor, bashkëmoshatarin me fo-
shnja, bërësin dhe Zotin e Ligjit,
Krishtin, pranoje i ngazëlluar të pë-
rmbushë rendin e Ligjit⁸ dhe thirri: U
mbushën të gjitha nga himnimi yt.⁴⁹

Duke parë Simeoni Fjalën pa mot,
shkakun e ekzistencës së të gjitha-
ve,⁴⁰ si foshnjë me mish të lëvizte
hipur mbi një Virgjëreshë si mbi fron
keruvik,¹ u çudit dhe i thërriste: U
mbushën të gjitha nga himnimi yt.⁴⁹

Zbritësore: Ekálipsen uranús
Mbulove me virtyte qiellin

Ode V

Irmosi: Os idhen Isaias

»**T**ë pa shën Isaia simbolërisht mbi
»fron të lartë si Perëndi në Parajsën

»të rrethuar prej engjëjve,²⁷ dhe
 »thoshte i mjeri me tmerr:⁵² Ja e
 »pashë Perëndinë si njeri, Zotin
 »Shpëtimtarin, që na ndrit dhe na
 »paqëson.^{53*}

Plaku i hyjshëm sapo kuptoi lavdinë
 që u parashfaq qëmoti nga profeti,²⁷
 duke parë Fjalën të mbahet në duar
 të një nëne, thërriste: O, gëzohu,
 o modeste, sepse si fron e nxë
 Perëndinë¹ që zotëron dritë të pape-
 rëndueshme dhe paqe.⁵³

Plaku pasi u përkul dhe preku
 perëndishëm shputat e Hyjnënës pa
 dasmë, tha: O e kulluar, mban zjarr;⁵
 frikësohem të përqafoj si foshnjë
 Perëndi që zotëron dritë të paperë-
 ndueshme dhe paqe.⁵³

Plaku i thërriste Hyjnënës: Pastrohët
 Isaia duke pritur thëngjillin e Serafi-
 mit;⁵⁴ ti më shkëlqen duke më dhënë
 në duar si me mashë atë që po
 mban, i cili zotëron dritë të paperë-
 ndueshme dhe paqe.⁵³

Zbritësore: Os idhen Isaias

Të pa shën Isaia

Ode VI

Irmosi: Evóisé si

»**K**ur Simeoni të mori në krahët
 »dhe pa shpëtimin për popullin, i
 »gëzuar thirri:^{54a} Ti je Zot i madh e ti
 »je Krishti.*

Si gur pengese* edhe skandali*⁵⁵
 për të pabindurit në Sion* ti u vure,⁵⁶
 ndërsa* për besnikët shpëtim pa
 mpakje.

Tani ke veshur* njeriun pa forc*
 nga dhembshuria, dhe pse e ke*
 vërtet karakterin* e atij që të lindi²⁶
 pa mot.

Të falem, o Fjal'* e Fort të Lartit,*
 je bir i Vajzës së virgjër ti,* Perëndi
 fëmijë,* ndaj tani lëshomë në paqe.

Zbritësore: Evóisé si

Kur Simeoni

Kontaqi

Ting. I

Ti që e shenjtërove mitrën virgjërore
 me lindjen tënde dhe bekove duart
 e Simeonit siç i kishte hije; arrite
 dhe tani dhe na shpëtove, o Krisht
 Perëndi; por paqesoje shtetin në
 luftëra dhe forcoji mbretërit që
 deshe, o i vetëm njeridashës.

Shtëpia

Le të rendim pranë Hyjlindëses ne
 që duam të shikojmë birin e saj, i
 cili sillet drejt Simeonit; duke e parë
 atë të patrupët nga qielli habiteshin
 duke thënë: Sodisim tani gjëra të
 çuditshme, paradoksale, të pakuptu-
 eshme, të parrëfyeshme. Ai që krijoi
 Adamin mbahet si foshnjë; i panxëni
 nxihet në krahërorin e plakut; ai

që është në gjirin e Atit të tij³⁹ pa u përshkruar, vullnetarisht përshkruhet në mish jo sipas Hyjnisë, i vetëm njeridashës.

Sinaksari

Më 2 të të njëjtit muaj, Ipapandia (Paraqitja në Tempull) e Zotit tonë Jisu Krisht, në të cilën Simeoni i drejtë e pranoi në gji të tij.

Vargje: Duart e Simeonit, të cilat të mbajnë,/ o Krishti im, ikonizojnë gjirin e Atit tënd.³⁹

Në të dytën Simeoni e pranoi Krishtin në Tempull.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirit të shenjtë Agathodhori.

Vargje: I dhuroj Agathodhorit që iu dha Perëndisë përmes gjakrash,/ një dhuratë nga fjalët e mia.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirit të ri Jordan.

Vetë Perëndisë lavdia dhe pushteti në jetët. Amin.

Ode VII

Irmosi: Se ton en piri

»Hodhe vesën përmbi zjarr⁵⁷ për Tre
»Djemtë, Shpëtimtar, edhe⁵⁸ linde
»virgjërisht prej Hyjllindëses Perëndi
»edhe Fjalë,² besërisht të këndojmë,
»se i bekuar je ti, o Perëndi edhe
»Zot.^{59*}

Simeoni thërriste duke kërcyer bashkë me profetët: Shkoj që t'i paraqes e t'i sjell ungjillëzimet Adamit që rri në Hadh dhe Evës. I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.⁵⁹

Perëndi deri në Hadh do të mbërrijë,⁶⁰ që të çlirojë gjini të baltë, t'u japë të gjithë robërve falje dhe rishikim të munduarve,⁶¹ aq sa memecë të thërrasin: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.⁵⁹

Simeoni i paratha Perëndilindëses: Dhe një shpatë do ta depërtojë zemrën tënde, o e paprishshme, kur do ta shikosh në Kryq Birin, të cilit i thërrasim: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.⁵⁹

Zbritësore: Se ton en piri

Hodhe vesën

Ode VIII

Irmosi: Astekto piri

»Në flak' e në zjarr të bashkuar
»të Tre Djemat e bekuar të pangarë
»mu në mes të furrës të padjegur të
»këndonin me lavdi: E bekoni Zotin
»të gjithë me⁶² këngë dhe përjetë.*

O popull Izrael, duke parë lavdinë tënde, Emanuelin fëmijë nga Virgjëresha, kërcë tani para faqes së arkës hyjnore.⁶³ E bekoni, gjithë ju vepra, Zotin dhe e përmbilartësoni në gjithë jetë.⁶²

Simeoni thërriste: Ja, ky është shenjë debati, duke qenë Perëndi dhe fëmijë. Atij le t'i psalim besërisht: E bekoni, gjithë ju vepra, Zotin dhe e përmbilartësoni në gjithë jetë.⁶²

Perëndia Fjalë i foshnjëzuar, duke qenë ky jetë,²⁸ do të jetë për të pabindurit rënie, sikurse ngjallje²⁸ për të gjithë që psalin besërisht: E bekoni, gjithë ju vepra, Zotin dhe e përmbilartësoni në gjithë jetë.⁶²

Zbritësore: Astekto piri

Në flak' e në zjarr

Ode IX

Madhështime: Akatáliptón esti

Krejt e pakuptueshme,* nën' e virgjër e dëlir',* është për engjëjt, njerëzit* brenda teje çfarë ndodh.

Përqafton me duar sot* Simeon i drejti plak* Bërësin e Ligjit dhe* zotërin' e kozmosit.

Oe Virgjër e dëlir',* brenda mitrës sate rri* Bërësi, Adamin ky* deshte ta shpëtonte pra.

Gjithë fisi njerëzor* ty të qashtrën lumëron*⁶⁴ të lëvdon me besë si* nënën e të Lartit Zot.

Ejani dhe shihni ju* Krishtin Zot të Gjithësis';* Simeoni sot e mban* brenda Tempullit me gaz.

Kur hedh syn' mbi dhé, e bën* që të dridhet⁶⁵ fort; ndaj si* plak i lodhur, pa fuqi* përmbi duart ty të mban?

Si jetoi vitet plot* Simeoni Krishtin

pa;* i thërriste: Po kërkoj* përlëshim tani nga ti.

Masha je mistikërisht,* që thëngjillin⁵ Zotin Krisht,* zure mu në gjirin tënd,* Zonj' e Shenjtë Mariam.*

I parapakohshmi Zot* njerëzohesh me vullnet,* i ofrohesh Tempullit* në mosh' dyzet ditësh ti.

Priti Simeoni prift* Zotin e të gjithave,* kur nga qielli ai* zbriti përmbi tokën ton'.

Dritën dhe shikim shqisor* edhe shpirtin ma ndriço,* të të shoh me kthjelltësi,* të të shpall si Perëndi.

Dhe Irmosi: En nomo sqia qe grámati

»**N**ë Ligjën dhe⁶⁶ shkronjën⁶⁷ faqëza »shohim shembull të Zotit Krisht; çdo »djal' i parëlindur kish prej Zotit hir¹³ »edhe bekim, dhe ne pra Fjalën që » lindi si Bir i parë⁴⁴ në q'ell dhe djal' »i parë përmbi dhe^{67a} me këndim e »madhështojmë sot.*

Nën' e virgjër, e dëlir',* ç'po ofron tek Tempulli,* kur i jep një foshnj' të re* Simeonit ti në gji?

I njëjti

Përlëshim po të kërkoj,* o Gatuesi im Krisht,* se të pashë ty, ndriçim* shpëtimtar për mua je.

Një çift turtujsh ish më parë ligj* ose dy zogj shumë të vegjël pra.* Në vend të tyre plaku shenjt dhe Ana, profetesh' e shenjt',* e mençur duke shërbyer për Krishtin bir virgjëror,*

të madh si Bir i Atit, e madhështonin kur në Tempull qe.

Krishtit që lart engjëjtë* i bëjn' litani me tmerr,* posht' e përqafojnë tani* Simeoni në pëqi.

Injëjti

Lavdi

O Trini personash, por* në natyrë një Njësi,* ne shërbyesit e tu,* ruajna, ty të besojm'.

Thërriste shën Simeoni plak:* o Krisht, me gaz të shpëtimit tënd* më ke shpërblyer,⁶⁸ prite adhuruesin tënd që në hi*⁶⁶ u lodh, por që është tani mist dhe predikues i ri* i Hirit edhe të hyjnoreve, që të madhështon me himn.

Tani

O Hyjlindëse Mari,* shpres' e të krishterëve,* mbrona, ruajna se ti,* streha jon' e vetme je.*

Lëvdonte siç duhej Perëndin'* Ana e mençur profeteshë* dhe oshënare, i rrëfente Zotit qart' dhe haptazi* në Tempull dhe madhështonte Hyjlindësen tek të gjith,* te të pranishmit, duke e proklamuar me një zë të madh.

Zbritësore: En nomo skiá qe grámati

O Hyjlindëse

dhe

Në Ligjën dhe Shkronjën

Dërgimësore

En Pnévmati to ieró

Në Shpirt të Shenjtë plak i urt'* erdhi pranë dhe priti* në prehër Zotin që sundon* Ligjin, dhe i thërriste:* Tani lëshomë nga lidhja* pra nga mishi, në paqe,* siç the, se me sy kam parë* një zbulësë kombesh un'* dhe ndriçim për botën mbar',* për Izraelin shpëtimin.

(3x)

Lavdërimë

Ting. IV Edhokas simíosisin

Duke kryer Zoti njeridashës Ligjin⁸ në germë pra*⁶⁷ silltet tashmë te Tempulli:* E pret Simeoni plak* në pëqi të vjetër* dhe po i thërret: Më lëshon tani drejt lumturis'* përtej, se unë të pashë qartas sot* me mish të vdekshëm ty të jesh i veshur, ti që sundon gjithnjë* përmbi jetën dhe zotëron* vdekjen, o i fuqishmi Zot.

(2x)

O Zot, shfaqe dritë për zbulësë kombesh kur uleshe* përmbi re krejt të lehtë³⁵ ti,* o Diell i drejtësis',*³⁰ që përmbushje⁶⁹ hijen* që e kishte Ligji⁶⁶ dhe paraqisje një fillim* të Hirit pra krejt të ri, thërriste ndaj* kur të pa Simeoni: Përlëshomë mua nga prishja, Krisht,* sepse sot të sodita ty,* Shpëtimtarin e kozmosit.

Duke mos u ndarë në Hyjni nga gjiri i Prindit tënd,*³⁹ kur siç deshe u bërë

mish,* i mbajtur në kraharor* virgjëror gjithmonë* që me dorën tënde mban Gjithësinë mbar',⁷⁰ u dhe* në duar hyjmbajtësi shën Simeon;* prandaj me gaz thërriste: Përlëshon tani shërbëtorin tënd,* Zot, në paqe, sepse të pash',* Shpëtimtarin e kozmosit.

Lavdi *dhe* Tani

Ting. Tërth. II I Gjermanoit

Ti, o Krisht Perëndi, që deshe nga mirësia të shtrihesh ditën e sotme në duar plaku si mbi karrocë keruvike,¹ edhe ne që të himnojmë, duke na rithirrur nga tirania e pasioneve, çlirona dhe shpëto shpirtat tanë.

Në Liturgji, Antifonet

Antifoni i parë

Varg a): Nxori zemra ime fjalë të mirë. Me ndërmjetimet e Hyjlindëses.

Varg b): Gjuha ime është pendë e një shkruesi të shpejtë.

Me ndërmjetimet.

Varg c): U derdh hir në buzët e tua.

Me ndërmjetimet.

Varg d): Për këtë të bekoi Perëndia yt në jetë.

Me ndërmjetimet.

Lavdi *dhe* Tani

Me ndërmjetimet.

Antifoni i dytë

Varg a): Ngjeshe shpatën tënde rreth kofshës sate, o i fuqishëm.

Shpëtona, o i Bir i Perëndisë, që u mbajte në kraharorin e Simeonit të drejt'.

Varg b): Dhe tendos, dhe përparo, dhe mbretëro.

Shpëtona.

Varg c): Shigjetat e tua janë të mprehura, popuj poshtë teje do të bien.

Shpëtona.

Varg d): Shkop drejtësie shkopi i mbretërisë sate.

Shpëtona.

Lavdi *dhe* Tani

O i vetëmlindur.

Antifoni i tretë

Varg a): Dëgjo, o bijë, dhe shiko, dhe ule veshin tënd.

Gëzohu, o Hyjlindëse.

Varg b): Fytyrën tënde do ta bëjnë litani të pasurit e popullit.

Gëzohu, o Hyjlindëse.

Varg c): Do ta kujtoj emrin tënd në gjithë brezat e brezave.

Gëzohu, o Hyjlindëse.

Hyrtoja

E bëri të njohur Zoti shpëtimin e tij përballë gjithë kombeve. Shpëtona.

Pas Hyrjes, Përlëshorja e së kremtes dhe Kontaqi i saj. Në vend të Të meriton, O Hyjlindëse; Në Ligjën dhe Shkronjën. Kungatore: Kupë shpëtimi. Pamë dritën.

CITIME

- ¹ II Kron. 18.18; Is. 6.1; Jez. 1.13-26; 10.1; Dan. kap. 3 Lutja e Azariut 32
- ² Joan 1.1
- ³ Mark. 16.19
- ⁴ Joan 1.2
- ⁵ Is. 6.6
- ⁶ I Kor. 2.8
- ⁷ Eks. 20.21 e në vazhdim
- ⁸ Gal. 4.4
- ⁹ Ps. 71(72); Hebr. 1.5-6 etj.
- ¹⁰ Lluk. 9.56; Joan 12.47
- ¹¹ Dan. 7.9
- ¹² Rom. 14.24(16.25); Ef. 3.9
- ^{12a} Num.14.19 etj.
- ¹³ Eks. 13.2,12,15; 34.19; Num. 3.12; 8.16; 18.15
- ¹⁴ Gal. 3.13
- ¹⁵ Lluk. 1.79
- ¹⁶ Eks. 31.18; 34.1-4,28; Ligji i Dytë 4.13; 5.22(19); 9.9-11; 10.1-4
- ¹⁷ Ps. 88(89).8; 95(96).4
- ¹⁸ III [I] Mbret. 19.12
- ¹⁹ Eks. 33.19-23
- ²⁰ Eks. 34.30-35; II Kor. 3.7,13
- ²¹ Joan 5.39
- ²² Jez. 44.1-4
- ²³ Ps. 23(24).7-10
- ²⁴ Eks. 13.21-22; 14.24; 16.10; 19.9; 34.5; Num. 9.15; 11.25; Ligji i Dytë 31.15
- ²⁵ Ps. 109(110).3
- ²⁶ Hebr. 1.3
- ²⁷ Is. 6.1-3
- ²⁸ Joan 11.25; 14.6; Kol. 3.4; I Joan 1.2; 5.12,20
- ²⁹ Joan 1.4,9; 3.19; 8.12; 9.5; 12.46
- ³⁰ Mal. 4.2 (3.20)
- ³¹ Ps. 109(110).1; Matth. 22.44;
- Mark. 12.36; Lluk. 20.42; Hebr. 1.13
- ³² I Tim. 3.16
- ³³ Eks. 14.21-25 etj.
- ³⁴ Is. 45.8
- ³⁵ Is. 19.1
- ³⁶ Is. 35.3
- ³⁷ Ps. 103(104).2
- ³⁸ Ps. 95(96).11; Is. 44.23; 49.13
- ³⁹ Joan 1.18
- ⁴⁰ Joan 1.3
- ⁴¹ I Mbret. [Sam.] 2.1; Ps. 17(18).3; 70(71).3
- ⁴² Vep. 16.5
- ⁴³ Vep. 20.28
- ⁴⁴ Kol. 1.15; Hebr. 1.6
- ⁴⁵ I Kor. 14.20
- ⁴⁶ Gjen. 2.7
- ⁴⁷ Gjen.3.19; Kishtari 3.20; 12.7; I Makk. 2.63
- ⁴⁸ Fil. 3.21
- ⁴⁹ Abak. 3.3
- ⁵⁰ Eks. 25.9-20; 38.1; Ligji i Dytë 10.2; Ps. 131(132).8; Hebr. 9.4
- ⁵¹ Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 30
- ⁵² Is. 6.5
- ⁵³ Is. 9.6
- ⁵⁴ Is. 6.7
- ^{54a} Jona 2.3,10
- ⁵⁵ Is. 8.14; Rom. 9.32-33; I Petr. 2.8
- ⁵⁶ Is. 28.16
- ⁵⁷ Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 26
- ⁵⁸ Dan. 3.16-17
- ⁵⁹ Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 28
- ⁶⁰ I Petr. 3.19; 4.6
- ⁶¹ Is. 61.1; Lluk. 4.18
- ⁶² Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 34
- ⁶³ II Mbret. [Sam.] 6.14,20-21
- ⁶⁴ Lluk. 1.48
- ⁶⁵ Ps. 103(104).32

⁶⁶ Hebr. 8.5; 10.1

⁶⁷ Rom. 2.27,29; 7.5-6; II Kor. 3.6

^{67a} Math. 1.25; Lluk. 2.7

⁶⁸ Ps. 50(51).14

⁶⁹ Matth. 5.17

⁷⁰ Est. 4.17b; Ps. 94(95).4; Jov 9.19



E DIELA PAS IPAPANDISË

1. Para Triodhit:

Të shtunën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 6 ngjallësore dhe 4 Paskremtore. Lavdi i së kremtes (Hulumtoni Shkrimet, kërkoje në Lavdi të Litisë fq. 351). Tani Hyjlindësore dogmatike e tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi dhe Tani i së kremtes (1 vjetri i ditëve, kërkoje në Tani i Litisë). Përlëshoret: ngjallësore dhe e së kremtes.

Të dielën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Kanuni Triadik, Himne Triadike. Trishenjtë. Përlëshorja e së kremtes. Në Mëngjesore, Ndenjësoret ngjallësore dhe në vend të Hyjlindësoreve, Ndenjësoret e së kremtes (dy të parat). Bekimtoret. Ipakoia. Shkallesat dhe Proqimeni i tingullit të javës. Kanunet: ngjallësor dhe i së kremtes. Pas Odes III, Ndenjësoerja e së kremtes. Pas Odes VI, Kontaku dhe Shtëpia ngjallësore dhe Sinaksari. Zbritësoret: Fundin edhe burimin; dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor. Më të nderuarën. Dërgimësoret: ngjallësore dhe e së kremtes. Lavdërimet: 4 ngjallësore dhe 4 Paskremtore. Lavdi Eothinoni. Tani E përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji, Tipiket. Lumërimet: 4 ngjallësore dhe 4 nga Ode VI e së kremtes. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore, e së kremtes dhe e kishës. Kontaku i së kremtes (Ti që e shenjtërove shih fq. 356). Apostulli dhe Ungjilli i së dielës.

2. Brenda Triodhit:

Të shtunën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 4 ngjallësore, 3 të Triodhit dhe 3 Paskremtore. Lavdi i Triodhit. Tani Hyjlindësore dogmatike e tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi i Triodhit. Tani Paskremtor. Përlëshoret: ngjallësore dhe e së kremtes.

Të dielën, në Shërbesën e Mesnatës, në fund Përlëshorja e së kremtes. Në Mëngjesore, Ndenjësoret ngjallësore dhe në vend të Hyjlindësoreve, Ndenjësoret e së kremtes (dy të parat). Bekimtoret. Ipakoia. Shkallesat dhe Proqimeni i tingullit të javës. Kanunet: ngjallësor, i Triodhit dhe i së kremtes. Pas Odes III, Kontaku dhe Shtëpia ngjallësore, Ndenjësoret e Triodhit dhe në vend të Hyjlindësoreve së tij, e së kremtes. Pas Odes VI, Kontaku dhe Shtëpia e Triodhit, Sinaksari i ditës dhe i Triodhit. Zbritësoret: Fundin edhe burimin; dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor. Më të nderuarën. Dërgimësoret: ngjallësore, e Triodhit dhe në vend të Hyjlindësoreve, Paskremtore (Në ty bashkohet pa ndryshim; kërkoje në 3 shkurt, fq. 372). Lavdërimet: 5 ngjallësore dhe 3 të Triodhit. Lavdi i Triodhit, Tani E përmbibekuar, Sot erdhi.

Në Liturgji, Antifonet e së kremtes. Hyrtoerja e saj, por Shpëtona...që u ngjalle prej së vdekurish (ose Tipiket. Lumërimet: 4 ngjallësore, 4 të së kremtes dhe 4 të Triodhit). Pas

Hyrjes Përlëshoret: njallësore, e së kremtes dhe e kishës. Kontakti i së kremtes. Apostulli dhe Ungjilli i së dielës. Të meriton. Kungatore: Lavdëroni.

MBYLLJA E SË KREMTES

- a) Nëse e kremtja bie në një nga ditët nga e Diela e Tagrambledhësit dhe e Fariseut deri edhe në të premtën pas asaj, Mbyllja bëhet në 9 shkurt.*
- b) Nëse e kremtja bie në një nga ditët nga e shtuna para Plangprishësit deri edhe në të martën pas kësaj, Mbyllja bëhet të premtën para të Shtunës së Shpirtrave, sepse shërbesa e Shpirtrave nuk transferohet.*
- c) Nëse e kremtja bie në një nga ditët nga e mërkura pas Plangprishësit deri edhe në të Shtunën e Shpirtrave, Mbyllja bëhet të martën e së Dielës të të Lidhurit të Mishit.*



MË 3 TË TË NJËJTIT MUAJ

Kujtimi i të drejtit shën Simeon Hyjmbajtës dhe i profeteshës Ana.

NË MBRËMËSORE

Thirrtoje Paskremtoje

Ting. II Ton uranion tagmaton

U soll në Tempull nga nëna e virgjër Bërësi* dhe Çlirimtar i botës*¹ dhe i njerëzve mbarë;* plaku si e mori me ngazëllim* po thërret: Përlëshon tani* siç të pëlqeu, shërbyesin, o i Mir'* Zot, në paqe për në jetën lart.

Në kraharorsin e mori nga Virgjëresha Zonj'* atë që lindi para* gjithë jetëve, Krishtin,* Zotin, Çlirimtarin, plaku i shenjt'* Simeoni thërriste pra:* Anët e panë ndriçimin e lavdit tënd,* o i mir', të pushë, më lëshon.

Atë që lindi në fund për shpëtim të njerëzve* në kraharor e mbante* Simeoni me plot gaz,* dhe thërriste: Dritën e kombeve* e kam parë si dhe lavdin'* e Izraelit; siç the, o Zot, urdhëro* të lëshohem nga ky dhé tani.

Të shenjtoreve

Ting. IV Edhokas simiosin

Ishe i përsosur dhe i drejtë, dhe i kënduar fort* në çdo gjë me hyj frymëzim;* ke pritur në duar ti* Perëndi të vetëm* të përsosur;

erdhi ta drejtësonte botën mbar'*^{1a} i mishëruar, ndaj u lëshove krejt* nga trupi duke thirrur: Përlëshon tani shërbëtorin tënd,* Njeridashës, me paqen sot,* se të pushë, o Zoti im.

Ishe i moshuar trupërisht, por ishe i ri në shpirt* kur pranove orakullin* të mos shihje vdekje ti* para se ta shohësh* foshnjë krejt të ri Perëndinë, Bërësin që është* përpara jetëve, që do merrte mish;* do varfërohej ky,² o Simeon, kërceve pra kur e pe* dhe kërkove me gaz lëshim;* shkove drejt tendave në q'ell .

Ana me hyj frymëzim dhe Simeoni i pasur fort* të ndriçuar me profeci* dhe të paqortueshëm,* të sprovuar në Ligj,* Dhënësin e Ligjit që si ne foshnjë ky u pa* tani e panë, i falen me hare.* Kujtimin e këtyre sot le ta kremtojmë me gaz të madh,* Njeridashësin Jisu Krisht* ta lëvdojmë ne denjësisht.

Lavdi *dhe* Tani

Ting. Tërth. I I Gjermanoit ose sipas të tjerëve I Anatoliut

Ivjetri i ditëve,³ pasi u bë foshnjë në mish prej nëne të virgjër, Hierores i silltet duke përmbushur⁴ porosinë e vetë Ligjit.⁵ Atë si e pranoi Simeoni, thoshte: Tani përlëshon në paqe shërbëtorin sipas fjalës sate, sepse panë sytë e mi shpëtimin tënd, o Zot.

*Pasvargje**Ting. II Ikos tu Efrathá*

Vjen Shpëtimtari sot* në Tempullin e Zotit* u soll si foshnjë Krishti;* një plak e pret në duar* të vjetra me hare dhe mall.

Varg: Tani përlëshon shërbëtorin tënd, o Zot, sipas fjalës sate, në paqe, se sytë e mi panë shpëtimin tënd, të cilin ti e përgatite faqe gjithë popujve. **S**ihet çuditërisht* i Vjetri i gjith' kohës*³ në mish sot si një foshnjë* edhe në Tempull sillet* Krijues dhe Zot mbi gjithçka.

Varg: Dritë për ndriçimin e paganëve dhe për lavdi të popullit tënd Izrael. **“O** Simeon, prano* në kraharor si foshnjë* Zotuesin e lavdit,*⁶ shpëtimin e gjith' botës”, thërriste e dëlira fort.

Lavdi *dhe* Tani*Ting. I I Anatoliut*

Ivjetri i ditëve³ që edhe Ligjin qëmoti në Sina ia dha Moisiut,⁷ sot foshnjë shihet, dhe sipas Ligjit,⁵ si Bërësi i Ligjit, duke përmbushur Ligjin,⁴ i sillet Tempullit dhe plakut i jepet. Dhe sapo e priti Simeoni i drejtë dhe pa të kryer përfundimin e porosive, thërriste i gëzuar: Panë sytë e mi misterin e fshehur prej jete të zbulohet⁸ në këto ditë të fundme, dritë që shpërndan natën e errët të kombeve të pabesa dhe lavdi e Izraelit të

sapombledhur; prandaj përlësho shërbëtorin tënd nga pranga e këtij trupi të varfër, drejt jetës së paplakur, të mrekullueshme dhe pa mbarim, ti që i jep botës përdëllimin e madh.

*Përlëshore e së kremtes**Ting. I*

Gëzohu, o Hyjlindëse Virgjëreshë Hirplote, se prej teje lindi Krishti, Perëndia yn', dielli i drejtësisë,^{8a} që ndriçon ata që ndodhen n'errësisë,^{8b} gëzohu dhe ti, o plak i drejtë, që prite në pëqi Çlirimtarin e shpirtrave tanë, që na fal ngjalljen.

(3x)



NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë, Ndenjëso**Ting. I Tu lithu s'frajstheutos*

Nën Ligjin hyre ti atëherë kur për mua* foshnjë kishe ardhur, thesari i jetëve dhe jeta* e botës;⁹ mbi pllaka në Sina* qëmoti e vijose Ligjin tënd;*¹⁰ na çlirove që të gjithë nga skllavëri* e Ligjit, o njeridashës;*¹¹ lavd dhembshurisë sate, Zoti yn',* lavd mbretërisë sate pra,* lavd ekonomisë sate, i vetmi Krisht shpëtimtar.

Lavdi *dhe* Tani*I njëjti*

Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësove Ting. Tërth. I Ton siná narhon Logon
 Duke kryer zakonet,⁵ në Tempull silleshe,* o Zot dhe Bërës ti, dhënësi që dhe Ligjin dikur,* për të gjithë frikë mbjell dhe tër' krijesën mban,*¹² por që të mbante ty në mish* Simeoni plak në kraharor, se nga mirëdashja* e durove këtë, dhe dritën na e zbulove ne të gjithëve.

Lavdi dhe Tani
 I njëjti

Kanunet: i së kremtes dhe i shenjtit, që ka Akrostihidhë: "Prano himnin, o Simeon Hyjprurës. Josif".

Ting. IV
 Ode I

Anikso to stoma mu

Banon me gëzim në tendat e të drejtëve,¹³ o i drejt',* nga Zoti i drejtë¹⁴ ti kërko, o shën Simeon,* o i tërëlum,* ata që po kremtojnë* largimin tënd t'i drejtësojë, se kanë mall.

Kur ishe në Ligj ti celebrues,¹⁵ o i hyjnueshëm* hyjprurës, e pe atë që shpalli Ligji, si foshnj'* dhe pas vdekjes, se* natyra këtë ligj ka,* drejt jete pa vdekje ke shkuar me plot hare.

Atë që në dorë mban o i lum, anët e kozmosit,*¹² kur mbahej në duar Virgjëreshe vajzë, e pe* dhe e prite

ti* në kraharor të çmuar,* u shfaqe pra më i madh se Moisiu ti.

Hyjlindësore

I mbushuri zbrazet,¹⁶ zë fill Fjala e parajetshme Zot,* merr lëndë, Gatuesi gatuhet, mbahet në bark* i panxënshmi krejt,* përbrenda mitrës sate* tani që me trup bëhet, o e hyjhirshme Zonj'.

Ode III

Oti stira éteken

Si u ngrite, o hyjfolës, përmes veprash të hyjshme* u bëre si një shtyllë e ndritshme, e mbështetur qart'* tek Shpirt i Tërëshenjtë, të lëvdojmë pra* dhe të mburrim me hare.

Zotëruesin e Ligjit që u bë foshnjë me trup* kur mitrën virgjërore e çeli, o shën Simeon,* e pe të jepte e dhuronte ky çlirim,*¹⁷ falje tek të gjithë ne.

Si u mishërua Bërësi që me dor' na bëri,*¹⁸ në duar ti e mban, qartë, o i lum, të shenjtëron* dhe siç kërkove të lëshon të shkosh përtej,* për në jetën në amshim.

Hyjlindësore

Simeoni kur të pa porsi një mashë mendore,* që mbante një thëngjill¹⁹ krejt hyjnor, që mori mish nga ti,* e tërëpaqortueshme me plot gëzim* ty të lumëronte fort.

Irmosi: Oti stira éteken

»Meqë lindi shterpa bij, Kisha e
 »kombeve, nëna,* dhe Sinagoga plot
 »me fëmij' u dobësua²⁰ keq,* le t'i
 »thërrasim Zotit të çuditshëm fort:*
 »Je i shenjtë, Perëndi.

*Ndenjësove**Ting. III Tin oreótita*

Të priti me hare,* kur nga e Virgjëra*
 u mishërove, Krisht,* i hyshmi
 Simeon,* edhe thërriste: "Përlëshon
 tani shërbëtorin tënd, Zot";* profeta-
 sha Ana krejt* e lavdishme që s'kish
 qortim,* të ofronte lavdërim* edhe
 himn, teksa ne me zë* te ti thër-
 rasim, o Jetëdhënës:* Lavd ty që të
 pëlqeu kështu.

*Lavdi dhe Tani**I njëjti**Ode IV**O kathímenos en dhoksi*

Kishe pleqëri të thyer, por ishe i ri
 në besë, duke dashur të shikosh
 si foshnjë të re të Tërëpërsosurin
 të ripërtëriste botën që u plak për
 shkak të sulmit të armikut²¹ të vjetër,
 o Simeon.

Le ta lumërojmë me një zë Simeonin
 e lumur, se u denjësua ta shikonte
 Perëndinë e lumur, kur veshi mish
 që t'i bënte të lumtur ata që më parë
 ishin të mjerë.

O Zot i vetëm, Simeoni thërriste: Të
 njoh ty ligjdhënës, që u mishërove pa
 ligjet e natyrës, ti që na familjarizove
 me një ligj të ri; tani përlëshomë
 drejt jetës pa cen.

Hyjlindësore

Ai që i mban të gjitha në dorë¹² dhe
 mbahej në duart e Gjithmonëvirgjë-
 rës, e bëri atë më të lartë se Keruvi-
 met dhe Serafimet si lindësen e tij.
 Ajo le të himnohet dhe të lumërohet
 me shpresëtarë prej nesh.

*Ode V**Eksesti ta simpanta*

O i lumur, pasi i shërbeve si engjëll
 përmes qashtërsisë së mendjes
 Perëndisë²² të tërëpushtetshëm, e
 pastrove qëmoti popullin e Izraelit
 me flijime të përgjakshme, të cilat
 paradeklarorin fuqishëm gjakun
 shpëtimtar.

Me punë të perëndishme e bëre
 veten tempull të tërëshenjtë Perë-
 ndie,²³ o Hyjfolës; prandaj në Tempu-
 llin e hyshëm pe Perëndi me mish
 si foshnjë, i cili të transferonte drejt
 tendave hyjnore.

Duke kërcyer shpirtërisht sot le ta
 himnojmë të gjithë Simeonin hyjpru-
 rës dhe tok me të Anën e mençur, të
 cilët ishin profetë Perëndie dhe e pa-
 në kthjellët kur u bë foshnjë për ne.

Hyлиндësore

Oe vetmja më e shenjtë se Keruvimet, pa djegur mitrën tënde ai që është i pandryshueshëm nga natyra, u pa njeri duke lindur prej teje dhe shpëtoi të gjithë që u zbrapsën përmes prishjes, o Perëndinë e tërëpaqortueshme.

*Ode VI**Evóise protipón*

Kur pe Zotin* thirre: Siç ke premtuar, o Shpëtimtar,* përlëshoje* shërbëtorin tënd t'i lajmëroj tani* sa në Hadhin janë* mishërimin tënd krejt të hyjnueshëm.

Ibukur je* më shumë se Moisiu, më me shkëlqim,* se pranove,* Simeon plak, në gji ti të bukurin,*²⁴ Zotin Krisht të hijshëm,* që për ne u pa foshnjë dhe na shpëton.

Kur shkove ti,* Simeon plak, në shpellat e Hadhit tej,* kur të panë* me rrëke të hyjnueshme ty përplot,* me vesim^{24a} të hyjshëm* të burgosurit²⁵ poshtë u mbushën krejt.

Hyлиндësore

Përdit' kërkon* të më kapë i mbrapshti dinaku djall,* por të lutem,* më rrëmbe ti nga kurthet e tij, o Zonj',* dhe nën strehën tënde,* pra nën krahët e tu ruajmë pa cen.

Irmosi: Evóise protipón

»**V**arrimin tënd* të triditshëm e »paraskiconte qart'* duke thirrur,* »kur në një peshk të madh lutej, o »Jisu,* shën Jona profeti:*^{25a} Mbret »i forcave,^{25b} prej prishjes më çliro.²⁶

Kontaqi Ting. I

Ti që e shenjtërove mitrën virgjërore me lindjen tënde dhe bekove duart e Simeonit siç i kishte hije, arrite dhe tani dhe na shpëtove, o Krisht Perëndi; por paqesoje shtetin në luftëra dhe forcoji mbretërit që deshe, i vetëm njeridashës.

Sinaksari

Më 3 të të njëjtit muaj, kujtimi i shën Simeon hyjprurësit të drejtë dhe i profeteshës Ana, Mbledhja e të cilëve bëhet në Kishën e nderuar apostolike të Jakovit, vëllait të Perëndisë, e cila ndodhet në kishën e respektuar të Perëndilindëses së shenjtë afër Kishës së Madhe tepër të shenjtë.

Vargje: Një plak i lajmëroi të vdekurit, se Fjala Perëndi/ meqë u pa njeri, do të mbërrijë deri dhe tek ata.

Ana, bija e Fanuelit, nuk iku nga dheu,/ derisa e pa mbi të Perëndinë si foshnjë.

Në të tretën Simeoni u zgjidh nga pranga e jetës.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirëve të shenjtë Adriani dhe Evuli.

Vargje: Dora e xhelatit, e cila gëzohet në vrasje,/ pret Adrianin që gëzohet të pritët nga shpata.

O Evul, kur vdiqe nga shpata për hir të Zotit/ mësove sigurisht se vendimi yt ishte i pëlqyeshëm prej Zotit.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirit të shenjtë Vlashi, çoban lopësh.

Vargje: Më parë stallë lopësh e kishin Vlashin,/ ndërsa tani e kanë oborret e Zotit.²⁷

Në të njëjtën ditë, profeti Azaria, bir i Adout, mbaron në paqe.

Vargje: Kur jepte orakuj Azaria para vdekjes,/ heshtte Pithia që profetizonte shtrembër.

Në të njëjtën ditë, martirët Pavël dhe Simon mbarojnë nga shpata.

Vargje: Këtu duhet të shkruajmë edhe Pavlin, edhe Simonin,/ që të mos na shpëtojnë pasi u prenë në kokë.

Në të njëjtën ditë, shën Klaudi mbaron në paqe.

Vargje: Klaudi gëzohej kur gjeti fund jete/ si dikush kur gjen shumë plaçka lufte, sipas Psalmeve.²⁸

Martirët e rinj dhe vëllezër Stamati dhe Joani nga Speces si dhe Nikolla, bashkudhëtari i tyre, mbarojnë nga shpata në Hios në vitin 1822.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atit tonë ndër shenjtorët, Nikolla, Kryepiskopi i Japonisë.

Me ndërmjetimet e tyre të shenjta, o Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII

Uk elátrefsan

O i lumur, meqenëse u bërë me të vërtetë i drejtë dhe i paqortueshëm në Ligj, i shërbeve tejet ligjërishit Zotit¹⁵ të Tërëpushtetshëm; prandaj psalje: O Zot i etërve dhe Perëndi, i bekuar je.²⁹

Simeoni thërriste i ngazëlluar: Erdhi hareja e të trishtuarve, çlirimi i Izraelit³⁰ u pa me të vërtetë si foshnjë në Tempullin e tij, duke më lëshuar për në jetën e ardhshme.

Simeoni thërriste: Për shkak të dhembshurive³¹ të tua, o Shpëtimtar, mua, shërbëtorin tënd që u lodha në germën e Ligjit^{31a} dhe u kërrusa krejt nga pleqëria, përlëshomë se të pashë mbi dhé të veshur me mish.

Hyjlindësore

O e kulluar, pasi zbrazti më i ploti gjirin e pacenuar të Atit³² që e lindi, ulet si foshnjë në gjirin tënd, duke përgatitur qartësisht një fron të shenjtë për ata me të cilët deshi të ngajë,¹⁶ o e papikëlluar.

Ode VIII
Pedhas evajis

Ana e tërëfamshme vejushë, që shkëlqente me hir profecie, Përmbiperëndinë që erdhi ta stolisë si nuse botën që mbeti e ve nga lavdi hyjnor, e lavdëroi atë dhe u deklaronte të gjithë të pranishmëve shpërblesën e ardhshme hyjnore.³³

Ofrove flijime të përgjakshme që paralajmëronin nga larg gjakun shpëtimtar tepër të hyjshëm të qengjit,³⁴ që u derdh nga keqardhja e papërshkrueshme; meqë e mbajte atë kur trupëzohej, u lavdërove më shumë se Moisiu dhe gjithë profetët.

Sapo e pe të dëshiruarin, pësove zgjidhjen e trupit, o i lavdëruar i hyjfrymëzuar, dhe si grurë i pjekur shkove³⁵ tek etërit, pasi u ushqeve në pleqëri të mbarë,³⁶ për këtë festojmë me ngazëllim shpirti kujtimin tënd të gjithëkremtuar.

Hyjlindësore

Fjala e Përmbiperëndishme të këputi si zambak,³⁷ si trëndafil erëkëndshëm, si aromë hyjnore, o hyjnuse e tërëkulluar, dhe banoi në mitrën tënde duke aromatizuar natyrën tonë që u mbush me kundërmimin e mëkatit, o Mari Hyjlindëse.

Irmosi: Pedhas evajis

»**D**jemat e dënuar për t'u djegur »prej zjarrit i ka shpëtuar lindj' e Zotit

»Krisht, si simbol në lashtësi* dhe »si një veprim tani;* dhe tërë botën »po e mbledh për këng' e lavdërim.* »Himnojeni ju veprat e Zotit* dhe e »lartësoni përmbi të gjitha jetët.*

Ode IX

Eva men to tis parakoís

Të lëvdojmë denjësisht, hyjprurës, je i lum,* se vërtet me duart e tua* të shenjta preke ti gjymtyrët* hyjnore të atij, që kur prek male,* siç mbreti David psal, nxjerrin tym³⁸ tmerrësisht;* Hirin e more me bollëk, o plak.

Rrjedh, buron shërime për besnikët, o hyjmist* i nderuar, prej kutis' që mban* lipsanin tënd; kujtimi yt pra* fort është lumëruar dhe shndrit më shumë* se dielli, dhe shkëlqen shpirtat dhe na çon* drejt llamburitjes së hyjdijes ne.

Porsi dielli dhe hëna, mendërisht ndriçojn'* sferën Simeoni plak me nam* bashkë me Anën, profeteshën* e ve, e mençur; përmes tyre ti* shpengona nga errësira e fajeve,* o Njeridashës, Perëndi dhe Zot.

Hyjlindësore

Kur të pa ty që u shfaqe, o Hyjlindëse,* porsi nën' e Perëndisë Zot,* plaku i moçëm si profet tha:* Ja, Biri yt do jetë për ngritjen lart* dhe rënien e shumë njerëzve dhe si shenj'* që,

Zonjë, s' do kuptohet lehtësisht.

Irmosi: Eva men to tis parakoís

»Eva nga sëmundja e mosbindjes^{38a}
 »mori keq* si banues brenda saj
 »mallkim,*^{38b} por, o Hyjlindëse e
 »virgjër,* ti nëpërmjet lastarit të
 »shtatzënis'* për botën e lulëzove
 »bekimin krejt;* ndaj ne të gjith' të
 »madhështojmë ty.

Dërgimësore

Jinekes akutísthite

Në ty bashkohet pa ndryshim* me mish pa farë Fjala Zot* në hipostazë dhe bëhet* një foshnjë që ti mban në gji* porsí fron keruvik³⁹ tani,* dhe ia çon Atit Perëndi* dhe Simeoni plak e pret* me ngazëllim duke thirrur:* Të pashë, ndaj përlëshomë.

Pasvargje të Lavdërimeve

Ting. Tërth. II Triímeros anestis Hristé

Prano në duar, o Simeon,* Ndërtuesin e çdo gjëje,*⁴⁰ përqafo – thot' –,* o plak, Krishtin që pa far'* Vajza e virgjër lindi për gazin dhe harenë* e gjindjes sonë si dhe për shpëtim.

Varg: Tani përlëshon shërbëtorin tënd, o Zot, sipas fjalës sate, në paqe, se sytë e mi panë shpëtimin tënd, të cilin ti e përgatite faqe gjithë popujve. Të mblidhemi dhe ta përhimnojm',* o popuj, Perëndinë Zot* që e kanë* frikë gjithë engjëjt lart* të vetmin mirëbërës dhe Bërësin e Ligjit,* Ligj-

dhënësin që jep shpëtim në shpirt.

Varg: Dritë për ndriçimin e paganëve dhe për lavdi të popullit tënd Izrael.

Tani në paqe e lësho* shërbyesin tënd siç e the,* se të pashë* dritën para jetëve,* Krisht, për zbulësë kombesh* si dhe për Izraelin;* nga pranga mishërore më çliron.

Lavdi *dhe* Tani

Ting. II I Gjermanoit

ose sipas të tjerëve i Joan Monakut

Të shenjtin Virgjëresha e shenjtë ia çoi të shenjtit në Shenjtërore; dhe pasi i shtriu krahët Simeoni, e priti duke u ngazëlluar dhe thirri: Tani përlëshon shërbëtorin tënd sipas fjalës sate në paqe, o Zot.

Dhe të tjera si zakonisht.

Në Liturgji, Tipiket dhe Odet III dhe VI nga Kanuni.

CITIME

¹ Joan 1.3

^{1a} Rom. 3.24; I Kor. 1.30

² II Kor. 8.9

³ Dan. 7.9

⁴ Matth. 3.15; Gal. 4.4

⁵ Eks. 13.2,12,15; 34.19; Num. 3.12; 8.16; 18.15

⁶ I Kor. 2.8

⁷ Eks. 20.21 e në vazhdim

⁸ Rom. 14.24(16.25); Ef. 3.9

^{8a} Mal. 4.2(3.20)

- 8^b Lluk. 1.79
- 9 Joan 11.25; 14.6; Kol. 3.4; I Joan 1.2; 5.12,20
- 10 Eks. 31.18; 32.15-19; 34.1,28; Ligji i Dytë 4.13; 5.22(19); 9.9-11; 10.1-4
- 11 Gal. 3.13
- 12 Est. 4.17b; Ps. 94(95).4; Jov. 9.19
- 13 Ps. 117(118).15
- 14 Eks. 9.27 etj.
- 15 IV Makk. 7.8
- 16 Fil. 2.7
- 17 I Kor. 1.30; Ef. 1.7,14; Kol. 1.14
- 18 Gjen. 2.7-8,15; Ps. 118(119).73; 138(139).5; Jov 10.8-9; II Makk. 7.23
- 19 Is. 6.6
- 20 II Mbret. [Sam.] 2.5
- 21 Dan. Suz 52; Rom. 6.6; Ef. 4.22; Kol. 3.9
- 22 Dan. 7.10
- 23 I Kor. 3.16; 6.19; II Kor. 6.16
- 24 Ps. 44(45).3
- 24^a Lluk. 16.24
- 25 I Petr. 3.19
- 25^a Matth. 12.40
- 25^b Ps. 67(68).13
- 26 Jona 2.7
- 27 Ps. 83(84).3; Joan 10.16
- 28 Ps. 118(119).162
- 29 Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 2
- 30 Ps. 129(130).8; Lluk. 1.68; 24.21
- 31 Fil. 2.1; Kol. 3.12
- 31^a Rom. 2.27,29; 7.6; II Kor. 3.6
- 32 Joan 1.18
- 33 Mark. 10.45
- 34 Is. 53.7; Joan 1.29,36; Vep. 8.32; I Petr. 1.19
- 35 Jov 5.26
- 36 Gjen. 15.15
- 37 Kënga 6.2
- 38 Ps. 103(104).32
- 38^a Gjen. 3.4-7
- 38^b Gjen. 3.16-19
- 39 Jez. 10.1; IV [II] Mbret. 19.15
- 40 Sirak 24.8



MË 6 TË TË NJËTIT MUAJ

Kujtimi i atit tonë ndër shenjtorët Foti, patriarku i Konstandinopojës.

NË MBRËMËSORE

*Thirrtores Paskremtores**Ting. II Ton uranion tagmaton*

U soll në Tempull nga nëna e virgjër Bërësi* dhe Çlirimtar i botës,*¹ dhe i njerëzve mbarë* plaku si e mori me ngazëllim* po thërret: Përlëshon tani* siç të pëlqeu, shërbyesin, o i Mir'* Zot, në paqe për në jetën lart.

Në kraharor si e mori nga Virgjëresha Zonj'* atë që lindi para* gjithë jetëve, Krishtin,* Zotin, Çlirimtarin, plaku i shenjt'* Simeoni thërriste pra:* Anët e panë ndriçimin e lavdit tënd,* o i Mir', të pashë, më lëshon.

Atë që lindi në fund për shpëtim të njerëzve* në kraharor e mbante* Simeoni me plot gaz,* dhe thërriste: Dritën e kombeve* e kam parë si dhe lavdin'* e Izraelit; siç the, o Zot, urdhëro* të lëshohem nga ky dhé tani.

*Të shenjtit**Ting. IV Os jeneon en mártisin*

Instrumentin e Hirit si* dhe kitarën e Shpirtit Zot,* shtyllën e patundur të besës son' të drejt'* dhe profesorin

e madh, kryebariun me lavd dhe nam,* bazamentin e Kishës,* të ndriçuarin plot shkëlqim* të Jisuit Krisht,* përluftar të Orthodhoksisë, Fotin fort të shenjtë ta lëvdojmë me melodi të hyjnueshme.

Frymëzjarrtin dhe orator,* profesorin e rruzullit,* kryepriftin tepër të madh,² eprorin pra,* të perëndishmin e Konstandinopojës, bariun ton',* të shkëlqyer krejtësisht* që ka Kisha e Krishtit Zot,* Fotin me shkëlqim,* orthodhoksët të gjithë ta himnojmë njëzëri me himn të hyjshëm, patrikun e parëfronëshëm.

Urdhërim jashtë ligjit ty* të dëboi nga grigja larg;* vojte në tortura, shtrëngim edhe mundim* për hir të besës, o Foti i lëvduar me plot fuqi,* hierark me dritësim* dhe mbështetja e Kishës son',* shtyllë³ pa tundim;* të nderojmë të gjithë pra me shpirt, o i kënduar, profesor i Orthodhoksisë me lavd si mist.

Lavdi

Ting. Tërth. II

O oshënar tri herë i lumur, atë tepër i shenjtë, bariu i mirë⁴ dhe nxënës i kryebariut Krisht,⁵ që e vure shpirtin për delet,⁴ ti dhe tani, o fort i hyjshëm, Foti i tërëlavdëruar, kërko që me ndërmjetimet e tua të na dhurohet përdëllimi i madh.^{5a}

Tani

Ting. i njëjtë I Joan Monakut

Le të hapet porta e qiellit sot, sepse Fjala e pamoçme e Atit, si mori fillim kohor, pa u larguar nga Hyjnia e tij, ofrohet vullnetarisht në Tempullin Ligjor nga nëna e virgjër si foshnjë dyzet ditore; dhe e pret atë në kraharor plaku, duke i thirrur shërbëtori Zotërisë: “Përlëshomë, sepse sytë e mi e panë shpëtimin tënd”. Ti që erdhe në botë të shpëtosh gjini njerëzish,⁶ o Zot, lavdi më ty.

Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës dhe Leximet.

Këndimi i Fjalëve të Urta
(10.6-7; 3.13-16; 8.35 etj.)

Kujtimi i të drejtit është me lavdërimi dhe bekimi i Zotit mbi kryet e tij. Lum njeriu që gjeti urtësi dhe i vdekshmi që njohu mençuri; sepse është më mirë ta tregtosh atë, se thesare ari dhe argjendi. Dhe është më e vyer se gurët e çmuar; dhe çdo gjë e çmuar nuk është e barasvlefshme me të; sepse nga goja e saj del drejtësi, ndërsa ligj dhe mëshirë mban në gjuhë. Prandaj më dëgjoni, o fëmijë, sepse do të them *gjëra* modeste; dhe lum njeriu që do të ruajë udhët e mia; sepse daljet e mia janë dalje jete dhe përgatitet vullnet nga Zoti. Prandaj ju lutem dhe u lëshoj zërin tim bijve të njerëzve; se unë, urtësia, bëra mendim dhe

dituri, dhe kuptim unë thirra. I Imi është mendimi dhe siguria, e imja mençuria, e imja edhe fuqia. Unë ata që më duan i dua, ndërsa ata që më kërkojnë do të gjejnë hir. Kuptoni pra, o të patëkeqë, zgjuarsi dhe ju, o të paedukuar, futeni zemrën. Më dëgjoni përsëri, sepse do të them *gjëra* modeste dhe nga buzë unë hap *gjëra* të drejta. Sepse do të studioj një të vërtetë laringu im, ndërsa të neveritshme janë para meje buzë të gënjeshtërtë. Me drejtësi janë gjithë fjalët e gojës sime, brenda këtyre s’ka asgjë të shtrembër, as të zhdrejtë. Të gjitha janë të drejta për ata që kuptojnë dhe korrekte për ata që gjejnë dituri; sepse ju mësoj *gjëra* të vërteta, që të bëhet në Zotin shpresa juaj dhe që të mbusheni me shpirt.

Këndimi i Urtësisë së Solomonit

(Përzgjedhje)

Kur lavdërohet i drejti, do të ngazëllohen popuj; sepse pavdekësi është kujtimi i tij; sepse njihet edhe nga Perëndia edhe nga njerëzit dhe është i pëlqyer prej Zotit shpirti i tij. Prandaj dëshirojeni, o burra, urtësinë dhe aspironi, dhe do të edukoheni; sepse fillimi i saj është dashuri dhe ruajtje ligjesh. Nderoni urtësinë që të mbretëroni përjetë. Do t’jua lajmëroj dhe nuk do t’jua fsheh misteret e Perëndisë; sepse ai është edhe udhëheqës i urtësisë

edhe korrighues i të urtëve; dhe në dorën e tij është çdo mençuri dhe njohuri punësh. Urtësia, mjeshtrja e të gjithave më mësoi; sepse ka në të shpirt mendor, të shenjtë, rrezatim drite të përherëshme dhe ikonë e mirësisë së Perëndisë. Ajo bën miq Perëndie dhe profetë. Dhe është më e hijshme se dielli dhe mbi çdo vend yjesh. Duke u krahasuar me dritë, gjendet më me epërsi. Ata që i shërbyen asaj, ajo i shpëtoi nga mundime dhe i udhëhoqi në udhë të drejtë. U dha atyre njohje të shenjtë dhe i ruajti nga ata që kurthojnë, dhe u dha si çmim një luftë të fuqishme, që ta dinë të tërë se më e fortë se çdo gjë është shpresëtaria dhe se nuk do të mbizotërojë kurrë e keqja mbi urtësinë, dhe se nuk do t'i kalojë shkarazi të ligjtë, kur do të bëjë hetim gjykimi; sepse thanë me vete, duke mos menduar drejt: «Le ta tiranizojmë të drejtin, le të mos e kursejmë devotshmërinë e tij, as të mos druemi nga thinjat shumëvjeçare të një plaku, dhe le të jetë fuqia jonë ligj. Dhe le të kurthojmë të drejtin, sepse na vështirëson në përdorim dhe u kundërvihet punëve tona, na qorton mëkatet e edukatës sonë. Deklaron se ka njohuri të Perëndisë dhe fëmijë Zoti e quan veten e tij. U bë për ne kritikë e mendimeve tona. I rëndë është edhe kur shikohet, sepse jeta e tij nuk është e ngjashme me të të tjerëve dhe janë

të ndryshme udhët e tij. Fallco u konsideruam prej tij dhe distancohet nga udhët tona si nga papastërtitë, dhe lumëron mbarime të drejtësh. Le të shohim pra nëse fjalët e tij janë të vërteta dhe le të sprovojmë përfundimin e tij. Me sharje dhe tortura le ta shqyrtojmë atë që të njohim butësinë e tij dhe të provojmë mospasjen e mërisë së tij. Me vdekje të shëmtuar le ta dënojmë, sepse do të jetë mbikëqyrje nga fjalët e tij.» Këto menduan dhe u mashtruan, se i verbëroi ligësia e tyre. Dhe nuk njohën mistere Perëndie, as nuk gjykuan se ti je Perëndia i vetëm që ke pushtet jete dhe vdekjeje, dhe që shpëton në kohë pikëllimi dhe çliron nga çdo e keqe, ti, i dhembshuri dhe mëshiruesi, dhe që u jep oshënarëve të tu hir, dhe që me krahun tënd u kundërvihesh mendjemëdhenjve.

Këndimi i Urtësisë së Solomonit

(Përzgjedhje)

Goja e të drejtit pikon urtësi, ndërsa buzë burrash dinë hire. Goja e të urtëve studion urtësi dhe drejtësia i shpëton nga vdekja. Pasi mbaroi një burrë i drejtë, nuk humbet shpresë, sepse lindet bir i drejtë për në jetë dhe në të mirat e tij do të vjelë fryt drejtësie. Dritë do të jetë tek të drejtët përgjithmonë dhe nga Zoti do të gjejnë hir dhe lavdi. Gjuha e të urtëve di të mira dhe në zemrën e tyre do të prehet urtësi. I do Zoti

zemrat oshënare dhe të pranueshëm prej tij *janë* gjithë të paqortueshmit në udhë. Urtësi Zoti ndriçon fytyrë të mençuri; sepse arrin tek ata që e dëshirojnë para se të njihet dhe me lehtësi vëzhgohet nga ata që e duan. Ai që mëngoi për atë nuk do të lodhet dhe ai që nuk fjeti për atë, shpejt do të jetë pa merak; sepse ajo lëviz rreth e rrotull duke kërkuar të denjë për atë, dhe në rrugë u shfaqet atyre me dashamirësi. Asnjëherë nuk do të mbizotërojë mbi urtësinë ndonjë e keqe. Prandaj dhe u bëra i dashuruar pas bukurisë së saj dhe e desha, dhe e kërkova që prej rinisë sime, dhe kërkova ta marr nuse për veten time; sepse Zoti i të gjithave e deshi atë; sepse është njohëse e mistereve të diturisë së Perëndisë dhe zgjedhëse e veprave të tij. Lodhjet e saj janë virtyte dhe ajo *na* mëson mençuri dhe urtësi, drejtësi dhe burri, nga të cilat asgjë *tjetër* nuk është më e vlefshme në jetë për njerëzit. Dhe nëse dikush aspiron eksperiencë të shumtë, di të lashta dhe të supozojë të ardhshmet. Di me saktësi strofa fjalësh dhe zgjidhje enigmash. Paranjeh çudi dhe mrekulli, dhe përfundime kohësh dhe motesh. Dhe për të gjithë është këshilltar i mirë; sepse ka pavdekësi në të dhe lavdi në shoqërinë e fjalëve të saj. Prandaj shkova tek Zoti dhe iu luta, dhe thashë me gjithë zemrën time: O Perëndi i etërve dhe Zot i mëshirës,

që i bëre të gjitha me fjalën tënde dhe që me urtësinë tënde e bëre njeriun që të zotërojë mbi krijesat që u bënë prej teje dhe që të drejtojë botën me oshënari dhe drejtësi, jepmë mua urtësinë që ulet pranë froneve të tua dhe mos më shpërfill nga shërbëtorët e tu; sepse unë *jam* shërbëtori yt dhe biri i shërbëtores sate. Dërgoje atë nga banesa jote e shenjtë dhe nga fronti i lavdisë sate, që duke qenë bashkë me mua të më mësojë se çfarë është e pëlqyeshme para teje, dhe që të më udhëheqë në dituri dhe të më ruajë në lavdinë e saj; sepse mendimet e të vdekshmëve *janë* të gjitha frikacake dhe të pasigurta idetë e tyre.

Në Liti Idhiomele

Ting. I

Ngazëllohu në Zotin, o qyteti i Konstandinit dhe çdo qytet, ishull dhe vend, në kujtimin e respektuar të bariut të përbashkët, ndriçuesit dhe mësuesit të Kishës universale,⁷ të Fotit të lumur tri herë; sepse edhe kur ende jetonte, luftoi shumë për besimin e Ungjillit dhe tani shijon në qiejt çmimet e çmuara të mundimeve të tij, duke ndërmjetuar pa pushim pranë Krishtit Perëndi për shpëtimin e shpirtrave tanë.

Ting. II

O kryepriift i madh² dhe bari i patëkeq dhe oshënar,⁸ predikues

i besimit të mirë, goja e Shpirtit, e cila nxerr zjarr, duke të lavdëruar me aspiratë, ty të lutemi: Bëj që përmes ndërmjetimeve të tua të shpërblehen shpirtat tanë, o atë.

Ting. Tërth. II

Onjeri i Perëndisë⁹ dhe shërbëtor besnik,¹⁰ celebrues i Zotit, burrë dëshirash,¹¹ enë e zgjedhur,¹² shtyllë dhe mbështetje e Kishës,³ trashëgimtar mbretërie,¹³ mos resht së thirruri për ne drejt Zotit.

Lavdi

Ting. i njëjti I Sergjit

Të lumtë, o shërbëtor i mirë dhe besnik,¹⁴ të lumtë, o punëtor i vreshtit të Krishtit; ti mbajte edhe peshën e ditës¹⁵ edhe shumëfishove talentin që u dha tek ti¹⁶ edhe nuk i pate zili ata që erdhën pas teje;¹⁷ prandaj është hapur për ty portë qiejsh;¹⁸ hyr në harenë e Zotit tënd¹⁴ dhe ndërmjeto për ne, o shën Foti.

Tani

*Ting. Tërth. I I Gjermanoit
ose sipas të tjerëve i Anatoliut*

Ivjetri i ditëve,¹⁹ pasi u bë foshnjë në mish, prej nëne të virgjër Hierores i sillet duke përmbushur²⁰ porosinë e Ligjit të vet.²¹ Atë si e pranoi Simeoni, thoshte: Tani përlëshon në paqe shërbëtorin tënd sipas fjalës sate, sepse panë sytë e mi shpëtimin tënd, o Zot.

Pasvargje

Ting. Tërth. I Heris askitikón

G'zohu, o kryeprift zotëror,* gëzohu, mburrje, lavd i hijshëm i Etërve;* stoliseshe me praktikë dhe teori me shkëlqim,* pasuri virtytesh të hyjnueshme;* je tenda e butësis',* streha e lutjes pa pushim,* thesar i çmuar* dhe banes' e përlësis'* me hir, ishe si* diell në dallueshmëri,* shtëpi e dashurisë së dyfishtë për Perëndin'* dhe për të afërmin, tempull i paqes; lyp Krishtin Shpëtimtar* që të na dhurohet* ne dhe botës ndjesë shkeljesh dhe përdëllim i madh.^{5a}

Varg: Goja ime do të flasë urtësi dhe studimi i zemrës sime mençuri.

G'zohu, kanun kryepriftërinjsh* dhe mbrojtës emërmadh mësuesish shpirtëror';* je goja e theologëve brenda Kishës, shkëlqen* përmes fjalës sate si dhe dogmave;* barí, ty të admirojm',* si apostull jetove ti,* gjuha e mprehtë* që po priste çdo herezi* si një thikë brisk* me dy presa²² të mprehta fort;* o instrument me zë të ëmbël, mendja e qiellshme,* shtylla e Kishës së Krishtit dhe përforcim³ i besnikëve;* lyp Krishtin t'u japë* nga lart shpirtave mëshirë të madhe^{5a} edhe hir.

Varg: Goja e një të drejti do të studiojë urtësi dhe gjuha e tij do të flasë gjykim. **G**'zohu, stoli për çdo patriark,*

gëzohu, mburrje e të gjith' priftërinjve je,* burimi hyjnor për dogmat dhe shtyllë që fort qëndron,* bazament³ që s'zmbropset dhe kanun i sakt';* mistere ke shkruar, shenjt* Foti atë, urtisht dhe drejt,* për të vërtetën* je themel, ti o famëmadh,* i shkëlqyer yll,* fitimtar dhe njeri q'ellor,* engjëll mbi dhé, lavdi dhe nder i mbarë Orthodhoksis',* por dhe sëpatë për besën e keqe, që devijoi jasht'* doktrinës së mirë;* mos pusho t'i lypësh Krishtit për sa të mburrin ty.

Lavdi

Ting. IV I Gjermanoit

Mbreterëshës së qyteteve i duhej të krenohej për Fotin si kryepriift, pikërisht si zbukurim mbretëror dhe trumbetë me zë të ndritshëm, që kumton në gjithë anët dogmat shpëtimtare dhe na mbledh të gjithë që të bashkërendisim këngë të vyera për Perëndinë; atij le t'i thërrasim: O dritëfolës dhe sinonim me dritë, përgjëroju Krishtit Perëndi që të shpëtohen shpirtat tanë.

Tani *I së kremtes*

I njëjti I Andreas të Kretës

Sot nëna e hyjshme dhe më e lartë se Hierorja mbërriti në Hierore, duke i paraqitur botës Bërësin e saj^{22a} dhe dhënësin e Ligjit. Sapo e priti atë në kraharor Simeoni plak, thërriste duke lavdëruar: Tani përleshon shërbëtorin tënd, sepse të pashë ty,

Shpëtimtarin e shpirtave tanë.

Përlëshore

Ting. IV

Duke qenë i njëjtë në jetë me apostujt ti, edhe profesori i rruzullit, lypi Zotit të të gjithave, o Foti i shenjtë, t'i falë paqen botës, dhe shpirtave tanë përdëllimin e madh.^{5a}

Lavdi *dhe* Tani

I së kremtes

Gëzohu, o Hyjlindëse Virgjëreshë Hirplote, se prej teje lindi Krishti, Perëndia yn', dielli i drejtësisë,²³ që ndriçon ata që ndodhen n'errësirë;²⁴ gëzohu dhe ti, o plak i drejtë, që prite në pëqi Çlirimtarin e shpirtave tanë, që na fal ngjalljen.



NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësove

Ting. I Ton tafon su Sotir

Pranvera ime sot,* ja u shfaq, shndriti, o shpirt,* kujtimi krejt i hijshëm i Fotit të urtë,* të tërëlumurit patrik, ndaj dhe ne ta lëvdojm' të gjith',* se mbështeti fort* përmes fuqisë së Shpirtit* besën e vërtet',* Orthodhoksinë e saktë* dhe flakte të rremet tej.

Lavdi *dhe* Tani

I së kremtes

Horós angelikós (=Ton tafon su Sotír)

Kor engjëjsh me çudin* të habitet, ndërsa ne* të vdekshmit të thërrasim me zë himn, se shohim* pashprehshëm bashkëzbritjen e Perëndisë, sepse atë* që e druajnë* fuqitë mbarë në qiejt,* Njeridashësin* e vetëm, e përqafojnë* tani duar plaku fort.

Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësore

Ting. III Thias pisteos

More si në short* shkëlqim të hyjshëm,* praktikove jet'* të perëndishme,* sipas emrit u dallove në priftëri,* se mrekullueshëm ke shpallur dogmat ti* dhe e mbështete besimin orthodhoksisht;* lypi Krishtit Perëndi, atë oshënar me nam,* të na dhurohet neve përdëllim i madh.^{5a}

Lavdi dhe Tani *I së kremtes*

Ting. i njëjti Tin oreótita

Të priti me hare,* kur nga e Virgjëra* u mishërove, Krisht,* i hyjshmi Simeon,* edhe thërriste: “Përlëshon tani shërbëtorin tënd, Zot”;* profetesha Ana krejt* e lavdishme që s’kish qortim,* të ofronte lavdërim* edhe himn, ndërsa ne me zë* te ti thërrasim, o Jetëdhënës:* Lavd ty që të pëlqeu kështu.

Pas Polieleit, Ndenjësore

Ting. IV O ipsothis en to stavró

Vadit me hir mendje* besnikësh, meqë je* mësues famëmadh* i

Kishës, hyjfolës* i respektuar edhe hierark, ndërsa zhyt* mendje heretikësh dhe buron* hijesisht mrekulli, çudi,* po kështu pastron çdo njoll'* vesesh të shumëllojshme* vërtet, o Foti atë oshënar* tërë lavdije,* armik dogme herezish.

Tani *I së kremtes*

Ting. i njëjti Kateplaji Iosíf

Kur i pa në mal Sina* qëmoti shpinën Perëndis'* Moisiu²⁵ dhe u bë* i denj', dëgjoi ky disi* një zë hyjnor në stuhi dhe në errësirë,*²⁶ ndërsa Simeoni e përqafoi* Perëndinë që pa ndryshim për ne* u mishërua; ndaj nxiton të ikë* me ngazëllim drejt, përtej në jet'* të amëshuar, kështu thërret: Zot,* përlësho shërbëtorin tënd.

Shkallesat. Antifoni i parë i Ting. IV

Proqimeni Ting. IV

Goja ime do të flasë urtësi dhe studimi i zemrës sime mençuri.

Varg: Dëgjoni këto gjithë kombet.

Ungjilli. Psalmi 50

Lavdi. Me ndërmjetimet e hierarkut. Tani. Me ndërmjetimet e Hyjlindëses. Përdëllemë, o Perëndi. *Dhe Idhiomeli.*

Ting. Tërth. II

Uderdh hiri në buzët e tua,²⁷ o atë oshënar, dhe je bërë bari i Kishës së Krishtit duke i mësuar dhentë e logjikshëm,²⁸ që të besojnë në Trininë

e bashkëqenshme në një Hyjni.

Kanunet: i së krentes në 6 dhe i shenjtit në 4:

*Ting. IV
Ode I*

Anikso to stoma mu

Me dritën je sinonim, ndriçues që rrezaton hyjnisht,* dëbo atë, terrin nga mendimi im, më shkëlqej* me çdo vezullim* të shenjtë, llamburitje,* që t'i mburr arritjet e tua me plot lavdi.

Mbështetje e besës, shtyllë e patundur e dogmave,* mësues ti je, omologjet për Kishën³ e shenjt';* si ndriçuesin* me plot shkëlqim të Hirit,* si gojën që nxjerr zjarr të njohëm, o Foti, ty.

Sipas ligjit ke luftuar²⁹ në rreziqe, o famëmadh,* por si hierark besnik për predikimin hyjnor;* mbyte si një bish'* Nikollën rremëtarin* me kordën e dogmave, të admirojmë pra.

Hyllindësore

Të gjithë Marinë e pacenshme ejani ta himnojm';* ajo vetëm ka stolitur njerëzinë meqë* kishte Perëndi* në bark të mishëruar* dhe mbeti e virgjër pa prishje dhe pa dëmtim.

Zbritësore: Herson avisotokon

Fundin edhe burimin (*shih fq. 354*)

Ode III

Tus sus immologus

Kur tha blasfemi në lartësi³⁰ një dragua i marr' në Perëndim,* iu mbyll krejt goja përmes fjalëve të tua, o ndriçim* me formë drite, ndaj siç të ka hije ty të lëvdojmë ne.

O atë, me fjalët shumë të urta që the, ngordhi gjarpri heretik,* sikur të ish qëlluar me gur, u dërrmua në kryet,*³¹ ndaj Kisha ty të mburr siç e ka për detyrë, si dhe me gaz.

Guximshëm me prova që ke shfaqur nga Shkrimet³² faktove, o i urt',* se Hirin e përbashkët e ka Shpirti edhe quhet Shpirt,* dhe se del hipostaza e tij krejt hyjnore nga Ati³³ Zot.

Hyllindësore

Tani trupëzohet dhe zë fill, nga ti, o e dëlirë, Fjala Zot,* Biri i Atit pa mot; është më suprem se çdo pushtet,* por dhe nën kohë bëhet ky, që është përtej gjithë moteve.

Zbritësore: To steréoma

Zoti Krisht që i mbron

Ndenjësore

Ting. Tërth. IV Tin sofian qe Logon

Ti profetin Ili³⁴ kishe zili* gjithashtu Pagëzorin Joan,³⁵ prandaj* qortove me trimëri* mbretër që rëndë shkelën ligj* dhe fron hierarkie stoli-se siç Zoti do,* e pasurove botën me

plot mësimdhënie, at',* ndaj duke përdorur Shkrimet e tërëshenja* mbështete fort çdo besnik,*³⁶ të pabesë riktheve ti,* i mahnitshëm* shenjt hierark;* ndërmjeto te Zoti yt Krisht,* të na dhurojë ky ndjesën* e fajeve* ne që bëjmë kujtimin tënd fort të shenjt' me mall.

Lavdi *dhe* Tani

I së kremtes (I përkthyesit)

O Krisht, foshnjë për mua u bëre ti,* u nënshtrove²⁰ nën ligjin²¹ që vure vet',* kështu na dhe, o Jisu,* veten tënde si prototip* të ecim, sipas gjurmëve që i ke lënë³⁷ qart'.* Përlësia, udha e vetme hyjnore është,* që me dashurinë zotërore po lidhet;* ajo na e zbriti posht'* Shpëtimtarin e njerëzve,* për të cilin* thërrasin fort:* Himne dhembshuris' që u shfaq* kur more mish dhe trup, Fjalë* dhe Perëndi,* nga e Virgjëra, Zonja jonë pa cen aspak.

Ode IV

O kathímenos en dhoksi

Ke treguar në rini mençurinë, në pleqëri urtësinë, në tërë jetën durimin dhe zemërgjerësinë dhe dashurinë për të gjithë³⁸ që thërrasin: Lavdi, o Krisht, fuqisë sate.

Jeta jote tejet e shkëlqyer me çdo virtyt të hyjshëm u tregua si model tëpër i përpiktë në lutje, kreshmë,³⁹ agripni dhe përgjërime⁴⁰ drejt Krish-

tit njeridashës, o atë.

O atë hyjmbajtës, nuk u dhe dremi-tje qepallave të tua, derisa e ktheve veten tënde në shtëpi⁴¹ tepër të bukur për Zotin⁴² gjithëshikues, drejt të cilit thërrisje: Lavdi, o Krisht, fuqisë sate.

Hyjlindësore

Oe Tërëshenjtë, kur vdiqën njerëzit, i ringjalle, kur ranë për prishje, i ringrite pasi linde jetëdhënësin që çliron ata që thërrasin: Lavdi, o Krisht, fuqisë sate.

Zbritësore: Ekálipse uranús

Mbulove me virtyte

Ode V

Eksesti ta símpanta

Kur pranove Hirin e Shpirtit⁴³ të Tërëshenjtë, u shfaqe strehë hyjnore,⁴² duke na mësuar hyjnisht dritën e hydijes, o atë tepër i shenjtë, Foti i urtë, i gjithadmiruar, mbështetja e Kishës.

Gjuha jote u bë kallam i Ngushëllimtarit, i cili u jep shpejt⁴⁴ shpengimin atyre që mësuat qartas sundimin e tij dhe që frymëzon tek shpirtrat e tyre njohje mbiqiellore, o Foti tepër i hyjshëm.

Krishti të dalloi tek bota të shkëlqesh me dhunti fjalësh dhe

mësimdhëniesh, të zbrapsësh furi heretikësh dhe të ndriçosh shpirtrat e gjithë besëmirëve që të himnojnë ty, predikuesin e besës.

Hy lindësore

Një e Virgjër lindi Birin e parajetshëm, që veshi natyrën e njerëzve dhe që e shpëtoi, siç na mëson hierarku, nga prishja me pësimin e trupit, dhe kjo mbeti e virgjër.

Zbritësore: Os idhen Isaias

Të pa shën Isaia

Ode VI

Tin thian taftin

Ta psalim Fotin e Madh, trumbetën që e shpall fuqishëm burimin, daljen pra të Shpirtit Shenjt* nga Ati,³³ siç ungjillori tha,* theologoi, biri i bubullimës qart'.⁴⁵

Çdo arrogancë e herezisë ra, o i hyjnueshëm shumë, përmes fjalës sate, at',* ndaj mbledhja e besëmirëve* kujtimin tënd, shën Foti, me dritë e nderon.

Dëfren dhe hidhet çdo mbledhje orthodhokse e besnikëve, o shën Foti i lëvduar fort,* të sheh pasardhës vërtet me nder* i Krisostomit dhe i Grigorit Theolog.

Hy lindësore

Për zënien tënde himnoj, e psal dhe

lindjen tënde të pashpjegim, lëvdoj dhe strehën tënde, Vajz';* nga çdo dëmtim përmes saj shpëtoj,* drejt qetësisë sate vrapoj dhe gjej liman.

Zbritësore: Evóisé si

Kur Simeoni

Kontaqi

Ting. Tërth. IV Ti ipermaho

Me lule këngësh* lirës krejt hyjfolëse tani* kuror' i thurrim* udhëzuesit të hyjshëm shumë* të Orthodhoksisë, dritës së Kishës⁷ sonë,* që shkëlqen kudo; se ishte kundërshtarimadh,* i qëndrueshëm, armik për çdo herezi;* i thërrasim pra:* G'zohu, o Foti plot me nder.

Shtëpia

O atë oshënar, u tregove engjëll nga njerëzit, meqë arrite prej dheut drejt qielloreve; për këtë, duke të soditur të konkurrosh me kore pa trup, shtangem dhe me aspiratë të thërras shpresëtarisht këto:

Gëzohu ti, përmes të cilit adhurohet Trinia,/ gëzohu ti, me anën e të cilit përhimnohet Perëndia.

Gëzohu, kanun tepër i drejtë i orthodhoksëve,/ gëzohu ti që qorton tejet fuqishëm ata që bëjnë paligjësi. Gëzohu, o lartësi përulësie, ku shumë njerëz e kanë të vështirë të ngjiten,/ gëzohu, o thellësi dallueshmërie, që vdekatarët e kanë të vështirë ta shikojnë.

Gëzohu, se u bëre flijues i hyjshëm i Perëndisë,/ gëzohu, sepse i sjell Perëndisë të shpëtuar.

Gëzohu, o banues me martirët në të njëjtën tendë,/ gëzohu, o shok oshënarësh të respektuar.

Gëzohu ti, me anën e të cilit vithisen besëkëqijt,/ gëzohu ti, me anën e të cilit besimtarë sigurohen.

G'zohu, o Foti plot me nder.

Sinaksari

Më 6 të të njëjtit muaj, kujtimi i atit tonë ndër shenjtorët, të barabartë me apostujt Foti, patriarku i Konstandinopojës, omologjet.

Vargje: Feksi me fjalë Foti i madh/ dritë te besimtarët dhe zjarr që djeg kundërshtarët.

Në të gjashtë, Foti vrapoi në harkun qiellor.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atit tonë oshënar Vukoli, episkop i Smirnës.

Vargje: Bariu i Smirnës, Vukoli, flijues,/ ndonëse vdiq është roje i pafjetur grigjeje.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirit të shenjtë Julian në Emesë.

Vargje: Krishti u shpua me gozhdë në duar dhe këmbë,/ Juliani shton edhe në kokën.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martires së shenjtë Fausta dhe i atyre që ishin me të, Evilasi dhe Maksimi.

Vargje: Tre martirë pësojnë pesim peshqish,/ pasi u rastisi bashkarisht tigani si vegël.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirëve të shenjtë Fausti, Vasili dhe Siluani dhe të martirëve të shenjtë në vendin e Dhariut.

Vargje: Mbarimi ishte një, me shpatë, për tre bashkatletë,/ që e besonin Perëndinë një dhe tri.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atit tonë oshënar Varsanufi.

Vargje: Nga dheu u thur trupi⁴⁶ i Varsanufit,/ dhe u fut nën tokë, nëna e tij.⁴⁷

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atit tonë oshënar Joanit të mbiquajtur Profet, nxënës i shën Varsanufit.

Vargje: Është e drejtë, o Joan, të të vendos këtu,/ tok me mësuesin mik.

Në të njëjtën ditë, oshënar Joani në qytetin e Likosë mbaron në paqe.

Vargje: Po Joanin në Liko, ku duhet ta vendos/ veçse këtu së bashku me Joanin?

Me ndërmjetimet e tyre të shenjta, o Krisht Perëndi, mëshirona dhe shpëtona. Amin.

Ode VII

Uk elátrefsan

Shkove, o atë oshënar hyjmenës

drejt tendave qiellore dhe si iu afrove Perëndisë dhe u hyjnizove me kungim, u bëre i perëndishëm duke psalur: O Zoti i etërve dhe Perëndi, i bekuar je.⁴⁸

Duke u urtësuar falë fjalëve të tua mësojmë, o atë i tërëfamshëm, të besojmë Hyjni të pandarë, pa copëtim, në tre diej; asaj dhe i psalim: O Zoti i etërve dhe Perëndi, i bekuar je.⁴⁸

Sa e tërëhyjshme, e shenjtë dhe e perëndipëlqyer është omologjia jote! Se pasi u pastrove si ar, u bëre i pëlqyer për Zotin, duke u ngazëlluar me imitimim e pësimeve të Shpëtimtarit, o atë oshënar, tri herë i pasur.

Hyjlindësore

Iu shfaqe gjithë njerëzve shkaktare e çlirimit hyjnor, kur linde, o e tërëpaqortueshme, Çlirimtarin e gjithçkaje, të cilit i psalim: O i përmbihimnuar Zot i etërve dhe Perëndi, i bekuar je.⁴⁸

Zbritësore: Se ton en piri dhrosísanta

Hodhe vesën

Ode VIII

Pedhas evajís

Rrjedhin burimet e dogmave të tua dhe ujitën bollshëm Kishën mbarë, o Foti, atë i gjithadmiruar; prandaj të lavdërojmë si mbështetje orthodhoksësh dhe krenari, duke himnuar pa pushim Zotin dhe duke

e përmbilartësuar në gjithë jetët.

Ancorove në gji të qetë pasi zmbra-pse tallazet e jetës, sepse e kishe si kapiten që drejtonte gjithë lundrimin tënd Zotin, që me një shenjë i bën të gjitha, o Foti i tërurtë; atë e përmbilartësojmë në gjithë jetët.

Kur drita e trishkëlqyer e Trinisë së përmbiperëndishme fushoi në ty, të tregoi dritë të dytë, që nga një anë shkëlqente bashkësinë orthodhokse, ndërsa nga ana tjetër çmprehte kolonën heretike, o atë, dhe që thërriste: Zotin e himnoni dhe e përmbilartësoni në gjithë jetët.⁴⁹

Hyjlindësore

Kur Dhëndri yt, o Zonjë hyjnuse, të gjeti si trëndafil në gjemba⁵⁰ dhe lule tepër erëkëndshme në lugina, dhe zambakun⁵¹ e tërëpanjollshëm, fushoi nga lart në ty dhe e aromatizoi të gjithë botën, e cila të përmbilartëson në gjithë jetët.

Zbritësore: Astekto piri

Në flak' e në zjarr

Ode IX

Apas jijenís

Tërë veten time nën strehën tënde të hyjnueshme e sjell,* o i mre-kullueshëm;* pushtet prej Krishtit more të zgjidhësh krejt* si kryepriift mëkate;⁵² thyeje zinxhirin tim* prej

mëkatesh*⁵³ dhe me ndërmjetimin tënd* më shpëto, më shkëlqe me ndriçim hyjnor.

Shkove lart drejt dritës që s'perëndon, pasi ti tokësoret le* dhe shpëtove, at' me lavd,* dhe tok me rendet⁵⁴ që jan' atje qëndron* pran' të Tërëpushtetshmit Zot,⁵⁵ shkëlqim tridiellor,* o i trillum,* dritën që del prej andej* e shijon dhe na ndrit ne himnuesit.

Porsi fitimtar ti ke akuzuar herezi mashtruese,* mbroje me guxim hyjnor me zjarr Orthodhoksinë, o Foti at'* dhe predikues bashkë me Ignatin, që ndoqe* si pasardhës* dhe në jetë, dhe në fron;* ndërmjeton me të drejt Zotit Krisht për ne.

Hyjlindësore

Deshte Perëndia të hyjnizohesha i tëri unë pra* ndaj me ty bashkohet ky* i tëri dhe misteri që nuk kuptojm',* risia zë fill: Lind pa prishje Virgjëresha, Zot* duket në mish;*⁵⁶ të himnojm' tani Marjam,* siç profetizove të lumërojm'.⁵⁷

Zbritësore: En nomo skiá qe grámati

O Hyjlindëse Mari

dhe

Në Ligjën dhe Shkronjën

Dërgimësore

Jinekes akutísthite

Të ka, o atë, mbrojtës ty* të zjarhtë flakë Kisha jon'* dhe profesorin e ndritshëm,* ndaj për kujtimin tënd po bën* një panair me hijeshi* duke thirrur: Mbuloje* dhe ruaje pa dëm gjithnjë* prej herezish grigjën tënde,* o kryepriifti i Zotit.

Dhe e së kremtes

En Pnévmati to ieró

Në Shpirt të Shenjtë plak i urt'* erdhi pranë dhe priti* në prehër Zotin që sundon* Ligjin, dhe i thërriste:* Tani lëshomë nga lidhja* pra nga mishi, në paqe,* siç the, se me sy kam parë* një zbulesë kombesh un'* dhe ndriçim për botën mbar',* për Izraelin shpëtimin.

Lavdërime

Ting. I Ton uranion tagmaton

Ta mburrim ne kryepriiftin e madh të Kishës son',* mësuesin e hyjshëm,* predikuesin me lavd,* Fotin që ka shpallur fjalën vërtet,* të mahnitshmin, të barabart'* krejt me apostujt; kujtimi i tij me nder* erdhi dhe dëfren çdo besimtar.

Të quajm' enë virtyti, o Foti, se ti je* i lumur, mik i paqes,* monument mençurie,* arkë për shërime dhe punëtor* dashurie, si dhe shtëpi* e lutjes dhe përgjërimit, që s'vidhet dot,* ndërmjetues për sa të himnojm'.

Tok me apostujt ke qenë i barabartë pra,* me ta bashkohesh meqë* fisi i Bullgarisë* dhe të tërë sllavët te Krishti yt,* predikues, i prure ti,* me pagëzimin hyjnor i rilinde, at';* në Orthodhoksinë ruaji.

Kur eosfori i dhëshëm prej egoizmit ferr* u fry dhe shumë më lart,* përmbi yjet e vuri* fronin e tij,⁵⁸ ti i pari me zell* thirre, o i lavdishëm fort* si Mihaeli: Të gjithë të rrinim mir'* në traditat e të parëve.

Lavdi *Ting. Tërth. I*

Kudo që do thirret emri yt, o emërmadh, prej andej fuqia e djallit dëbohet, se nuk duron të shikojë drejt dritës sate eosfori që ra,⁵⁹ prandaj të kërkojmë, shigjetat e tij zjarrprurëse⁶⁰ që lëvizin kundër nesh shuaji, duke na çliruar me ndërmjetimin tënd nga skandalet e tij, o Foti hierark, që meriton të himnohesh.

Tani *I së kremtes*
Ting. i njëjtë

Hulumtoni Shkrimet, siç tha në Ungjijtë Krishti,⁶¹ Perëndia ynë, sepse në këto e gjejmë atë të lindet dhe të mbështillet me shpërgënj, të mëndet dhe të ushqehet me qumësht, të pranojë rrethprerje dhe të mbahet prej Simeonit, jo me mënyrë imagjinare, as fantastike, veçse iu shfaq botës me të vërtetë; atij le t'i thërresim: O Perëndi i parajetshëm,

lavdi më ty.

Dhoksologjia e Madhe
Në Liturgji, Tipiket dhe nga Kanuni i së kremtes Ode III dhe i shenjtorit Ode VI. Kondaqi i së kremtes. Apostulli dhe Ungjilli i 13 nëntorit. Kungatore: Në kujtim të përjetshëm.

CITIME

- ¹ Joan 1.3
- ² Hebr. 4.14
- ³ I Tim. 3.15
- ⁴ Joan 10.11,14
- ⁵ I Petr. 5.4
- ^{5a} Num.14.19 etj.
- ⁶ Lluk. 9.56; Joan 12.47
- ⁷ Fil. 2.15
- ⁸ Hebr. 7.26
- ⁹ Gjq. 13.6 etj.; II Tim. 3.17; II Petr. 1.21
- ¹⁰ Hebr. 3.5
- ¹¹ Dan. 9.23
- ¹² Vep. 9.15
- ¹³ Matth. 25.34; Jak. 2.5
- ¹⁴ Matth. 25.21,23; Lluk. 19.17
- ¹⁵ Matth. 20.2,12
- ¹⁶ Matth. 25.14-17
- ¹⁷ Matth. 20.11
- ¹⁸ Vep. 7.56
- ¹⁹ Dan. 7.9
- ²⁰ Gal. 4.4
- ²¹ Eks. 13.2,12,15; 34.19; Num. 3.12; 8.16; 18.15
- ²² Hebr. 4.12
- ^{22a} Joan 1.2
- ²³ Mal. 4.2 (3.20)

- 24 Lluk. 1.79
25 Eks. 33.19-23
26 Eks. 20.21 e në vazhdim
27 Ps. 44(45).3
28 Vep. 20.28
29 II Tim. 2.5
30 Ps. 72(73).8
31 Gjen. 3.15
32 Vep. 18.28
33 Joan 15.26
34 III [I] Mbret. 18.18; 20.20-26
35 Matth. 14.4; Mark. 6.18; Lluk. 3.19
36 Vep. 14.22; 15.32,41; 18.23
37 I Petr. 2.21
38 Ef. 1.15; Kol. 1.4
39 Matth. 17.21; Mark. 9.29
40 Lluk. 2.37
41 Ps. 131(132).4-5
42 Joan 14.23
- 43 II Kor. 6.1
44 Ps. 44(45).2
45 Mark. 3.17
46 Gjen. 2.7
47 Gjen. 3.19; Sirak 40.1; Jov 10.9
48 Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 2
49 Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 34-65
50 Kënga 2.2
51 Kënga 2.1
52 Matth. 16.19; 18.18
53 Fja. Urt. 5.22
54 II Kron. 18.18; Dan. 7.10
55 IV [II] Mbret. 3.14
56 I Tim. 3.16
57 Lluk. 1.48
58 Is. 14.13
59 Is. 14.12
60 Ef. 6.16
61 Joan 5.39



MË 10 TË TË NJËJTIT MUAJ
Kujtimi i hieromartirit të shenjtë Harallamb.

Tipikon

1. Nëse bie në një nga të dielat para Triodhit:

Të shtunën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 4 ngjallësore dhe 6 të shenjtit. Lavdi i shenjtit. Tani Hyjlindësore dogmatike e tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimëni. Leximet e shenjtit. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi si dhe Tani të shenjtit. Përlëshoret: ngjallësore, e shenjtit dhe Hyjlindësorja e tij.

Të dielën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmi 50, Kanuni Triadik. Litia e shenjtit dhe Himnet Triadike. Trishenjtë. Përlëshorja e shenjtit. Në Mëngjesore, në Stihologjitë, në dy të parat, nga një Ndenjësores ngjallësore dhe e shenjtit me Hyjlindësoret e tij. Pas Polieleit, Ndenjësores e shenjtit dhe Hyjlindësorja e tij. Bekimtoret. Ipakoia. Shkallesat e tingullit. Proqimëni. Kanunet: ngjallësor dhe të shenjtit. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia ngjallësore. Ndenjësores e shenjtit dhe Hyjlindësorja e tij. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e shenjtit, dhe Sinaksari. Zbritësoret Ja gojën e çel tani; dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor. Më të nderuarën. Dërgimësoret: ngjallësore, e shenjtit dhe Hyjlindësorja e tij. Lavdërimet: 4 ngjallësore dhe 4 të shenjtit. Lavdi Eothinoni. Tani E përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji, Tipiket. Lumërimet: 4 të tingullit dhe 4 nga Ode VI e Kanunit të parë të shenjtit. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore, e shenjtit dhe e kishës. Kontaqi Mbrojtje e paturpëruar. Apostulli i shenjtit. Ungjilli i së dielës. Kungatore Lavdëroni.

2. Nëse bie në një nga të dielat e Triodhit:

Të shtunën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 4 ngjallësore, 3 të Triodhit dhe 3 të shenjtit. Lavdi i Triodhit. Tani Hyjlindësore dogmatike e tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. Leximet e shenjtit. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi i shenjtit. Tani i Triodhit. Përlëshoret: ngjallësore, e shenjtit dhe Hyjlindësore e tij.

Të dielën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmi 50, Kanuni Triadik, Litia e shenjtorit. [Lavdi dhe Tani të Litisë së Triodhit, nëse ekziston, ndryshe edhe Lavdi dhe Tani të Litisë së shenjtit]. Himne Triadike. Trishenjtë. Përlëshorja e shenjtit. Në Mëngjesore, Ndenjësores ngjallësore. Pas Polieleit, Ndenjësores (pas Polieleit) e shenjtit. Bekimtoret. Ipakoia. Shkallesat dhe Proqimëni i tingullit. Kanunet: ngjallësor, i Triodhit dhe i shenjtit. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia ngjallësore, dhe Ndenjësores e shenjtit dhe e Triodhit me Hyjlindësoren e tij. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e Triodhit, Sinaksari i shenjtit dhe i Triodhit. Zbritësoret e Triodhit; dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor i Triodhit. Më të nderuarën. Dërgimësoret: ngjallësore, e Triodhit, e shenjtit

dhe Hyjlindësorja e tij. Lavdërimet: 3 ngjallësore, 2 të Triodhit dhe 3 të shenjtit. Lavdi i Triodhit. Tani E përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji, Tipiket. Lumërimet: 4 të tingullit dhe 4 nga Ode VI e Triodhit. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore, e shenjtit dhe e kishës. Kontaqi i Triodhit. Apostulli i shenjtit dhe Ungjilli i Triodhit. Kungatore Lavdëroni.

3. Nëse bie të Shtunën e Shpirtrave:

Shërbesa e shenjtit psalet një ditë më parë së bashku me Mbylljen e Ipapantisë: Të enjte në Mbrëmësore, pas Qëndrimit të parë të Psaltirit (Lum ai njeri), Thirrtoret: 3 të së kremtes, dhe 3 të shenjtit. Lavdi i shenjtit. Tani i së kremtes. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni dhe Leximet e shenjtit. Pasvargjet e së kremtes. Lavdi i shenjtit. Tani i së kremtes. Përlëshoret: e së kremtes, e shenjtit dhe përsëri e së kremtes. Të premtën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmi 50, Litia e shenjtit. Trishenjtji. Përlëshorja e së kremtes. Në Mëngjesore, Ndenjësoret e shenjtit, por në vend të Hyjlindësoreve, Ndenjësoret e së kremtes. Pas Polieleit, Ndenjësores e shenjtit dhe Hyjlindësorja e tij. Shkallesat. Proqimeni dhe Ungjilli i shenjtit. Psalmi 50 hima etj. Kanunet: i së kremtes dhe një i shenjtit. Pas Odes III, Ndenjësores e shenjtit dhe e së kremtes. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e shenjtit dhe Sinaksari. Zbritësoret Fundin edhe burimin. Nuk psalet Më të nderuarën, por Ode IX e së kremtes me Madhështimet e saj si në ditën e së kremtes. Dërgimësoret: e së kremtes, e shenjtit dhe përsëri e së kremtes. Lavdi i shenjtit. Tani i së kremtes. Pas Dhoksologjisë Përlëshorja e së kremtes. Në Liturgji, Antifonet dhe Hyrtorja e së kremtes. Pas Hyrjes, Përlëshoret: e së kremtes dhe e shenjtit. Kontaqi i së kremtes. Në vend të Të Meriton, O Hyjlindëse; Në Ligjën dhe shkronjën. Kungatore: Kupë shpëtimi. Pamë dritën.



NË MBRËMËSOREN E VOGËL

Thirrtores

Ting. I Ton uranion tagmaton

Meqë dëshirove bukuritë e qiellore-ve dhe që të jesh me Krishtin¹ bashkë me engjëjt e shenjtë, pësore me qëndrueshmëri gjithfarë torturash dhe egërsi tiranësh; dhe pasi u

martirizove me trimëri për Krishtin, dëfren tok me koret e dëshmorëve, o i lëvduar.

(2x)

O Harallamb i lumur, duke feksur me vezullime të pacen të Diellit mendor, u tregove martir i tërëndritshëm i Krishtit dhe prift tepër Ligjor; për

këtë duke qenë bashkë me Krishtin në qiej, ndërmjeto për gjithë botën.

O tri herë i lumur, duke ndenjtur në qiejt tok me koret e athloforëve dhe duke qëndruar pranë Trinisë Hyjnore pa fillim, kujto ata që festojnë kujtimin tënd dhe i falën shpresëtarisht dhe me besë kokës sate të tërënderuar.

Lavdi *Ting. II*

Sot Kisha bën panair mistikisht, pasi veshi një stoli të re, gjakun e athloforit Harallamb, si purpur dhe mëndafsh; sepse si e rriti atë me besën e mirë, ia solli Krishtit si flijim pa qortim, të mirëpritur dhe të pëlqyeshëm;² prandaj, o Krisht Perëndi, që e tregove fitimtar mbi të paligjshmit, që e kurorëzove dhe e lavdërove, me ndërmjetimet e tij dërgona nga lart përdëllimin e madh.^{2a}

Tani *Hyjlindësore*

Gjith' shpresën time e besoj tek ti, o nën' e Perëndis', ruajmë nën strehën tënde.

Pasvargje

Ting. II Ikos tu Efrathá

O Greqi e tërë, ngazëllohu perëndishëm, duke zotëruar në gjirin tënd kokën e nderuar të hieromartirit.

Varg: I çuditshëm është Perëndia në

shenjtorët e tij.

O çudi e frikshme! O ndodhi kolo-sale dhe e huaj! Ja, ku kockat e dëshmorëve kryejnë shërime dhe mrekulli paradoksale.

Varg: I drejti si palma do të lulëzohet dhe si kedër në Liban do të shumëfishohet. **T**ani, o tërësi e besimtarëve dhe bij të Greqisë, puthni me zell kokën e nderuar të Harallambit të hyjshëm.

Lavdi *dhe* Tani

Hyjlindësore

O arkë e tërëartë³ dhe shtambë manapurëse,⁴ Mari Perëndilindëse, përgjeroju Birit tënd që t'i shpëtojë shpirtrat tanë.

Përlëshore

Si shtyll' e patundur.



NË MBRËMËSOREN E MADHE

Pas Qëndrimit të parë të Psaltirit

(Lum ai njeri)

Thirrto

Ting. Tërth. II Olin apothémeni

Meqë nga rinia ti* iu dedikove i tëri* Zotit dhe e deshe fort,* dhe i ndoqe gjurmët e tij,⁵ u lave drit'* nga çdo njollë dhe ves,* ndaj u pasurove* plot me hirin e shërimeve mrekullibërëse* të çuditshme, o athlofor martir;* qëndrove pa asnjë

tundim,* kur sulmonin vrulle dënimesh tmerr,* se e kishe forcën e Krishtit, të flijuarit në Kryq;* pra përgjëroju atij gjithnjë,* gjerësisht për shpirtrat tan’.

Trupi yt i lumur fort* dhe i durueshëm shumë* kur me gozhdë ngulej ky,* mbeti i pamposhtur, ndërsa ti ruaje* shpirtin pa zbrapsje krejt,* mendjen të pavjedhur* edhe pse dërrmoheshe, se dashuri hyjnore, zjarr* pasurisht përbrenda të flakte ty,* të nxiste dhe që të durosh* çdo lloj torturimi ty, athlofor,* o martir, që more pjes’ në pësimet e Jisuit Krisht;*⁶ pra përgjëroju me plot guxim* të shpëtohen shpirtrat tan’.

More si trashëgimi* për atletizmin tënd lavdin* mbi çdo lavd me nder, hare* përmbi çdo shkëlqim, dhe gaz në përjetësi,*⁷ oshënar, prift, atlet* i nderuar dhe ushtar* tepër trim, që rreshtat dhe ushtritë e dragoit djall* me rrëket’ e gjakut tënd dhe me hir* i mbyte thellë, gjithashtu* me komunikim të hyjnueshëm* ti vërtet i ngjalle të vdekurit dhe lutesh me guxim* për shpirtrat tanë dhe për shpëtim,* o i lartësuar fort.

Të tjera

Ting. IV Edhokas simósin

Trupin tënd e dhe ti në mundime, o i kënduar fort,* ndërsa shpirtin e ruajte* pa cen dhe pa zvetënim* nga

të gjitha fajet* dhe nga keqbesimi i torturuesve pa ligj,* lart mendjen tënde e ngrite, Harallamb* i tërëpasur shenjt, drejt Zotit Bërës dhe u denjove pra* në shtëpi qiellore dhe* nusërore të rrish gjithnjë.

O Zot, shërbëtorëve të tu u dhe shërbëtorin tënd,* Harallambin, me shumë nder,* shërues, dhe jo dështak,* në çdo lloj sëmundje* dhe rrafshues plot famë i mashtrimit, mburrim pra,* ekonomin’ tënde njeridashëse,* o Zot i tërëdhembshur, Shpëtimtar i shpirtrave tanë, Krisht* Perëndi, kryepriift i Madh,* lavd ty në qiell dhe mbi dhé.

Hirin që përmbi mendim nga Perëndia e more ti,* athlofor Harallamb i shenjt’,* të gjithëve na e shfaq* hiri për shërimet* që bën, dhe shumica e mrekullive pa kufi* i shpall karizmat e tu që përnjëmend* mbi fjalë si dhe mbi logjikë i pranove prej Krishtit tënd,* Shpëtimtarit Zot, o zëmadh,* krenari e martirëve.

Lavdi *Ting. IV*

I flijove Perëndisë therore himnimi⁸ duke i celebruar si prift tepër Ligjor Zotit dhe Ndërtuesit tënd; u bëre dhe imitues i pësimit të tij,⁶ o Harallamb hyjmendës, sepse veten tënde ia solle si blatë të mirëpritur² atij që për hirin tënd ia solli veten si flijim Perëndisë Atë; për këtë ngazëllohesh bashkë

me të në tenda qiellore, në Kishën e të parëlindurve;⁹ dhe ndërmjeton pranë tij pa ndërprerë që të çlirohemi nga zemërimi dhe shtrëngimi ne që lavdërojmë kujtimin tënd tërëfestiv, dhe që me mallëngjim të nxehtë i falemi kokës sate që buron çudi pa kufi, zmbrops vrik epidemi dhe na jep bujarisht shpëtim dhe shërim.

Tani *Hyjlindësore*

Profeti David që u bë hyjprind me anën tënde, i parathirri melodikërisht atij që të madhështoi: “Qëndroi mbretëresha në të djathtë tënde,”¹⁰ se ty Perëndia që denjoi të bëhet njeri prej teje pa atë, të rrëfeu nënë, shkaktare jete, që të gatojë përsëri ikonën e tij¹¹ të prishur prej pasioneve; dhe duke gjetur delen e arratisur nëpër malet, ta marrë mbi supe¹² e t’ia shpjerë Atit, dhe me dëshirën e tij ta bashkojë me fuqitë qiellore dhe ta shpëtojë botën, o Hyjlindëse, Krishti që ka përdëllimin e madh^{2a} e të pasur.*

Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës dhe Leximet

Këndimi i profecisë së Isaias

(43.9-14)

Këto thotë Zoti: «Gjithë kombet u mblodhën së bashku dhe do të mbli-dhen arkondë nga ato. Kush do t’i njoftojë këto? Ose gjërat që nga fillimi kush do t’ju njoftojë? Le t’i

sjellin dëshmitarët e tyre, dhe le të drejtohen, dhe le të dëgjojnë, dhe le të thonë të vërteta. Bëhuni dëshmitarët e mi dhe unë dëshmitar», thotë Zoti Perëndia, «dhe fëmija im që zgjodha; që të njihni dhe të besoni, dhe të kuptoni se unë jam. Përpara meje nuk u bë Perëndi tjetër dhe pas meje nuk do të jetë. Unë Perëndia dhe veç meje nuk është ndonjë që shpëton. Unë lajmërova dhe shpëtova, talla dhe nuk ishte në mes jush i huaj. Ju, dëshmitarë për mua dhe unë, Zoti Perëndia, ende nga fillimi dhe nuk ka njeri që të shpëtojë nga duart e mia. Do të bëj, dhe kush do ta kthejë mbrapsht këtë?» Kështu thotë Zoti, Perëndia, që ju çliron, i Shenjti i Izraelit.

Këndimi i Urtësisë së Solomonit

(3.1-9)

Shpirtrat e të drejtëve janë në dorë Perëndie dhe nuk do t’i prekë torturë. U dukën në sytë e të pamendëve se vdiqën dhe u konsiderua keqtrajtim dalja e tyre dhe ecja nga ne dërrmim, por ata janë në paqe; sepse edhe nëse para faqes së njerëzve do të ndëshkohen, shpresa e tyre është plot pavdekësi; dhe pasi do të edukohen me pak mundime, do të fitojnë mirëbërje të mëdha, sepse Perëndia i provoi dhe i gjeti të denjë për veten. Si ar në shkritore i provoi ata dhe si holokaust flijimi i pranoi ata; dhe në kohën e shqyrtimit të

tyre do të ndriçojnë dhe si shkëndija në kallam do të vrapojnë. Do të gjykojnë kombe dhe do të sundojnë popuj, dhe do të mbretërojnë në ata Zoti ndër shekuj. Ata që kanë besim në të do të kuptojnë të vërtetën dhe besimtarët me dashuri do të qëndrojnë me durim pranë tij, sepse ka hir dhe mëshirë ndër oshënarët e tij dhe mbikëqyrje mbi të zgjedhurit e tij.

Këndimi i Urtësisë së Solomonit

(5.15-23; 6.1-3)

Të drejtët jetojnë përjetë dhe në Zotin është paga e tyre, dhe përkujdesja e tyre pranë të Shumëlartit. Për këtë do ta marrin mbretërinë e hijeshisë dhe kurorën e bukurisë nga dorë Zoti, sepse me të djathtën do t'i mbulojë dhe me krahun do t'i mbrojë. Do të marrë si armatim zellin e tij dhe do të mobilizojë me armë Krijesën për mbrojtje armiqsh. Do të veshë si korracë drejtësi, dhe do të veshë si helmetë gjykim pa hipokrizi. Do të marrë si mburojë të pamposhtur oshënarit dhe do të mprehë zemërim të prerë për shpatë; dhe do të bashkëluftojë me atë bota kundër të marrëve. Do të ecin suksesshëm tek qëllimi predha rrufesh, dhe si nga një hark i plotë rrethi nga retë do të hidhen në shenjë dhe nga zemërimi që hedh gurë do të hidhen breshëri të plota. Do të indinjohet kundër tyre ujë deti, ndërsa lumenj do të përmytin papritur. Do t'u

kundërvihet atyre erë fuqie dhe si stuhi do t'i ajrojë ata si grurë, dhe do të shkretojë gjithë dheun paligësi dhe keqbërje do të përmbysë frone dinastish. Dëgjoni, pra, o mbretër, dhe bëhuni të mençur, mësoni, o gjykatës të anëve të dheut. Vëreni veshin, ju që sundoni shumicë dhe që jeni mburrur mbi turma kombesh, se ju dha nga Zoti sundimi dhe dinasti nga i Shumëlarti.

Në Liti Idhiomele

Ting. I

Gëzohuni më Zotin,¹³ o qytetet e Greqisë, dhe hidhuni duke u ngazëlluar meqë zotëroni në gji si thesar të pashlyer dhe që kushton shumë talanta, kokën e Harallambit, martirit të madh. Tok me ta dhe ne duke nxjerrë prej saj përditë rrjedhat e shërimeve, çlirohemi nga murtaja epidemike, duke falënderuar Perëndinë, Kujdestarin dhe Shpëtimtarin e shpirtrave dhe të trupave tanë.

I njëjti

Meqenëse luftove mirë ndeshjen e hyjshme,¹⁴ o martir Harallamb, u bëre banues i mbretërisë së qiejve dhe ndërmjeton për botën, o i tërëkënduar; ndërsa trupin tënd tepër të durueshëm e lë në tokë si shërim shpëtimtar për ata që i afrohen dhe e prekin me mall; ndërsa kryen tënd të tërënderuar e zotëroi Greqia si pasuri të pasosur

dhe visar të çmuar; përmes saj arrin të dëshiruarat me të vërtetë dhe çlirohet nga kundërshtarët me anën e përmbihijeshimit të hirit të shenjtë që është në ty.

Injëti

Kur u ndeze nga besimi dhe aspirata që vlonte për Zotin tënd dhe si e përdore si shkallë martirizimit për Krishtin, u ngjite drejt lëndinave qiellore; dhe prej andej në saje të hirit që u dha tek ti prej Hyjnisë, mbikëqyr ata që kremtojnë kujtimin tënd të respektuar, lartësojnë luftërat e tua dhe e puthin me mall kokën tënde të tërënderuar, o martir Harallamb.

Injëti

O i shenjtë, i çmprehe shigjetat e mprehta të dinakut¹⁵ nëpërmjet kundërpeshës së arritjeve të tua dhe e turpërove rëndë gjarprin e lig nga fillimi¹⁶ dhe veglën e tij, Sevirin tepër të pabesë; sepse, i mbështetur me mendje të palëkundur¹⁷ mbi gurin e besës, mbete i patundur; për këtë fjalimet kundërshtuese të ateizmit nuk arritën të prapësojnë shpresëtarinë tënde të qëndrueshme; si shpërblim kërcen në qiej me engjëj dhe ndërmjeton pa ndërprerë për ata që me besim dhe dëshirë të zjarrtë nderojnë me këngë kryen tënd të tërërespektuar.

Injëti

O martir i madh, atlet i Krishtit, Harallamb tejet trim, si i shpërfille me moral të fuqishëm të tanishmet si të përkohshme, Perëndinë e vërtetë e shpalle në stadium me zë të lartë; dhe tani në qiej duke u ngazëlluar tok me koret e engjëjve, Krishtit, të cilin e pohove hapur si Bir Perëndie, lypi që ta paqesojë botën dhe të dëbojë nga njerëzit sëmundjen epidemike, shkatërrimtare, dhe të na çlirojë gjithmonë nga rreziqe të llojllojshme, ne që me besim dhe mallëngjim puthim kokën tënde të nderuar dhe kremtojmë kujtimin tënd të shenjtë.

Injëti

O i mrekullueshëm, i fortifikuar me fuqi në mendje, torturat e të pabesëve i konsiderove si hiçgjë duke u hedhur burrisht drejt arenave; dhe i ndriçuar në arsye nga Shpirti Hyjnor, qortove një mbret tepër të jashtëligjshëm, dhe e përforcove besimin orthodhoks; dhe tani në qiej duke marrë çmimet e mundimeve të tua, e lavdëron pa pushim Trininë e Shenjtë dhe ndërmjeton për ata që me besë e mall nderojnë kokën tënde të respektuar.

Lavdi *Ting. Tërth. I*

Ejani, o martirëdashës që të gjithë, le të dëfremë në panairin e tërënderuar të athloforit dhe le të

kremtojmë shpirtërisht; sepse sot na mbledh e kremtja fort e respektuar e hierodëshmorit Harallamb, duke na shtruar si tryezë arritjet e mundjeve dhe kokën e tij të tërëfamshme, se buron gurrë shërimesh tek të gjithë që i afrohen shpresëtarisht dhe nxjerrin prej saj shëndoshje, edhe shpirtrash, edhe trupash, çlirimimin nga fatkeqësi dhe përdëllimin e madh.^{2a}

Tani *Hyjlindësore*

Të përgjrohemi si nënë Perëndie të bekuar, ndërmjeto që të shpëtojmë.

Pasvargje

Ting. I Panëfimi märtires

E shpalle ti Krishtin si njeri* edhe Perëndi në mes* të stadiumit, o Harallamb, martir i famshëm fort* dhe atlet i Zotit,* pra luftove fort ndaj kundërshtarëve me forcën e Shpirtit dhe kurorën e ke marr’;* për këtë të gjithë kryen tënd* e nderojmë dhe e respektojmë thell’.

Varg: I drejti si palma do të lulëzohet dhe si kedër në Liban do të shumëfishohet. **G**reqia, vend mbarë i krishter’* mburret sot se zotëron* pra kokën tënde si një burim që nxjerr rrëke pa fund,* me shërime si dhe* me një pasuri që s’oset dhe me hir që nuk zbrazet asnjëherë, dhe dëbon gjithnjë* nga sa po të lumërojnë ty* çdo sëmundje dhe epidemi që prish.

Varg: Tek shenjtorët që janë në tokën e tij bëri mrekulli Zoti.

Të vdekurin kur e ngjalle ti* përmes lutjes, morën tmerr* gjith’ të pabesët, prandaj ia solle shumë nga ata* Krishtit, o i pasur,* dhe kur menjëher’ shërove të demonizuarin, nxore prej mashtrimit satanik* mbretëreshën, shën Galinën, dhe* me kuror’ martirësh Zotit tënd ia sjell.

Lavdi *Ting. IV*

Le ta mburrim, o vëllezër, diamantin mendor të durimit, atletin tepër trim, të kurorëzuarin me dy rrethe, priftërie dhe atletizmi, prej dorës së djathtë të Perëndisë¹⁸ tërëmbret, Harallambin, më të madhin mes martirëve; sepse ky si e mundi të ndyrin, ngriti një trofe të madh kundër mashtrimit; dhe tani në qiej kërkon nga Perëndia të na jepet ndjesë mëkatesh dhe lirim prej sëmundjeve të shumëllojshme neve që nxehtësisht vrapojmë drejt tij dhe e puthim me shpresëtarin kryen e tij të shenjtë, dhe kremtojmë kujtimin e tij të përvitshëm me mallëngjim, dhe kërkojmë prej Perëndisë nëpërmjet tij zbutje dhe përdëllimin e madh.^{2a}

Tani *Hyjlindësore*

Nga çdo lloj rreziku ruaji shërbëtorët e tu, o Hyjlindëse e bekuar, që të të lavdërojmë ty, shpresën e shpirtrave tanë.

*Përlëshore**Ting. IV Tahi prokatálave*

Si shtyll' e patundur dot e Kishës¹⁹ së Krishtit tënd* u shfaqe, porsì kandil që shndrit planetin, o Harallamb i urtë, i lum;* fekse në botën mbarë* përmes martirizimit,* zgjidhe edhe furtunën idhujtare, ndaj lutu* guximshëm pran' Krishtit, ndërmjeto të shpëtohemì.

Tani Hyjlindësore

Misteri i fshehur prej jete dhe i panjohur ndër engjëjtë u shfaq ndër të dheshmit me anën tënde, o Hyjlindëse, Perëndia që u mishërua me bashkim të papërzier, dhe denjoi kryq për ne duke dashur, me të cilin ngjalli të parëgatuarin dhe shpëtoi prej vdekjes shpirtat tanë.*



NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësore**Ting. III Thias písteos*

Ke ndriçuar fort* me vepra bese,* shove ti mashtrim* kakodhoksie,* si ushtar i Krishtit,²⁰ o Harallamb me nam;* i turpërove kolonat që s'kishin fe,* ndaj trofeprurës u bëre, i urtë shenjt,* o martir i lavdëruar; nga Zoti Krisht kërko* të na dhurojë neve përdëllim të madh.^{2a}

Lavdi dhe Tani Hyjlindësore

Nënë virgjëresh'* çudi e madhe!* Si e mbajte ti* në gji atë që* në pëllëmbë mban të gjitha,²¹ dhe si me gji* dhe qumësht mënnde Gatuesin tonë Krisht,* që furnizon dhe natyrës i jep jetë;* o e fortdëlirë Vajzë, lyp, përgjërroju gjer'* të na dhurohet përdëllim i madh^{2a} dhe hir.

*Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësore**Ting. IV Epefanis símeron*

Linde si ndriçues ti* në Kish' prej Lindjes,* shndrite besëmirët pra* me rrezatimet nga çudit',* o Harallamb hieromartir,* ndaj i nderojmë lipsanet e tua ne.

Lavdi Ingjashëm

Hieromartir i urt',* Shpirti Hyjnor Zot* të tregoi ty hyjnisht* si një flijim hyjnor, pa cen* që o i hyjshëm, iu soll blatim* Fjalës Hyjnore, që të dha ty lavd hyjnor.

Tani Hyjlindësore

Moisiu ferrën pa* që nxirrte flakë,* ty që mbaje zjarrin tër',* që shpirtat i shkëlqen, i ndrit* porse s'u dogje;²² përkundrazi,* o e pacen, ves' e Hirit të mbushi plot.

*Pas Polieleit, Ndenjësore**Ting. III Tin oreótita*

Dëllirësinë dhe* shkëlqimin nur që kish* martirizimi yt* i admiroi fort* Greqia; shtanget dhe ndaj të thërret

me dëfrim: O martir,* sot nderojmë kryen tënd* të nderuar; dërrmoje cop'* çdo tërbim armiqësor* dhe çlirona nga çdo rrezik* dhe nga sëmundje ne që të mburrim* dhe të himnojme ty nga zemra.

Lavdi dhe Tani *Hyjlindësore*

Nënën e Zotit Krisht,* që s'njohu dasmë dot* dhe të panxënshmin Zot* mbajti në miter, bark* edhe ushqyesin e botës mbarë me qumësht mëndi,* vetëm kjo fuqinë kish* ta çlirojë gjininë ton'* prej mallkimit atëror,*²³ Zonjën pra të pacen aspak,* me një zë ta himnojm' duke thirrur:* Ki gaz, hirplote²⁴ Virgjëreshë.

*Shkallesat. Antifoni i parë i Ting. IV
Proqimeni Ting. IV*

I drejti si palma do të lulëzohet dhe si kedër në Liban do të shumëfishohet.
Varg: I mbjellë në shtëpinë e Zotit, në oborret e Perëndisë tonë do të lulëzojë.

Ungjilli. Psalmi 50.

Lavdi. Me ndërmjetimet e athloforit. Tani. Me ndërmjetimet e Hyjlindësës. Përdëllemë, o Perëndi. *Dhe Idhiomeli.*

Ting. Tërth. II

O martirëdashës, ejani ta nderojmë kolonën e hyjkurorëzuar të një dëshmorit me pamje drite, e cila u flijua me gatishmëri për Krishtin, aleancën e mbledhur shenjtërisht të

hieromartirit Harallamb, dhe si kryem shpirtërisht panairin e kujtimit të tij të tërëhyjshëm, le t'i thërrasim: Çliroje popullin tënd besëmendës nga kërcënimi epidemik dhe shpen-gona prej çdo peripecie.

*Kanunet: i Hyjlindësës së bashku me
Irmoset në 6 (shih fq. 197) dhe të dy të
shenjtit në 8:*

Ode I

Ting. Tërth. II

Irmosi: Os en ipiro pezefsas

»Si në sterë Izraeli kaloi leht'* dhe »më këmbë, duke par'* Faraonin, »ndjekësin* mbrapa gjurmëve të »tij,* të zhytej; thërriste: Zotit t'i kë- »ndojm' këng' mundëse.

Duke kërcyer në tendat e qiellshme,* shpirtërore, o i urt',* me hare i feksur fort* dhe me drit' që s'perëndon,* çliromë me ndërmjetimin tënd nga veset, të të psal.

Kujtimi yt dritëprurës lëshon rreze* diellore, hire pra;* llamburit çdo besimtar* që në të ty të nderon* me bes', o martir me emër gazi dhe shkëlqim vërtet.

Me pika gjaku përmbyste detin me krip',* pabesinë, dhe pastaj* na u bëre pors lum'* besëmir' i Krishtit Zot;* ngaherë ti Kishën e vadit vërtet, o Harallamb.

Hyllindësore

Shtrëngatë fajesh dhe dallgë mendimesh plot,* kundërshtarë dhe sulmim* vesesh, o Hyllindëse,* kan' kaluar mbi mua;*²⁵ o Zonjë, shpëto-më përmes ndërmjetimit tënd të fort'.

*Tjetri**Ting. IV Anikso to stoma mu*

Meqë dëshiroj që ta himnoj un' kokën e shenjtë krejt,* o Zot, edhe mundjet e shërbyesit tënd kërkoj* dritësim hyjnor* nga lart, me të do mundem* t'i psal, ta lëvdoj me zë, këngë dhe melodi.

Sevirin pa fe, luanin ulërak²⁶ e vithise posht'* dhe Krispin e pamend e qortove, o Harallamb,* sepse kishin fe* të rremë, ndaj prej dorës* së Bërësit tënd ti u kurorëzove,¹⁸ shenjt.

Stoli mbretërore të ka Kisha edhe përndjekës ty* të djallit, o Harallamb i hyjshëm me shumë hir,* që i shporr prej nesh* sëmundje të larmishme,* prandaj po kremtojmë kujtimin tënd, o martir.

Hyllindësore

Marinë pa cen ne le ta përhimnoj-më, Hyllindësen,* kjo mali i shenjtë,²⁷ është shtamba e tërëart'* mbajti manën⁴ krejt* hyjnore nga natyra,* që ne besimtarët gjithnjë na ushqen me hir.

Zbritësore: Anikso to stoma mu (shih fq. 449)

Ja gojën e çel tani

*Ode III**Irmosi: Uk estin ájios os si*

»**N**uk ka të shenjtë pra si ty* o Perë-
»ndia im, Zot,* që e ngrite lart bririn
»e besnikëve të tu* dhe na forcove²⁸
»të gjith',* o i mir', mbi gurin e
»pohimit²⁹ tënd.

E mundur s'është të dëftej,* o athlofor i shenjtë* çudibërës, morin' e mrekullive që ke bër'* kur ishe ende në jet'* si dhe kur drejt Zotit u shpërngule ti.

I përforcuar me fuqi* të hyjshme e rrëzove* si luftues i fortë arrogancën e dobët* e të paligjshmëve ti,* Harallamb atlet, ushtar në rresht hyjnor.

Nga trupi yt rrodhën rrekë* gjakra-sh, të cilat shuan* flakën, zjarrin përpirës plot me tmerr të pabesis',* ndërsa shkaktuan tek ti* një përrua me shijim³⁰ edhe dëfrim.

Hyllindësore

E Tërëshenjtë, linde ti* Zotin Krisht më të shenjtë* se çdo shenjt, se u shfaqe strehë pastërtie krejt* me shenjtëri, portë je* ku kaloi vetëm Krishti Shpëtimtar.³¹

Tjetri: Tus sus imnologus

U mblodhën himnuesit e tu, o

hyjprurës, në kishë me besim* t'i falen kokës sate të nderuar, të hyjnueshme;* ti ruaji dhe mbroji nga skandalet e kundërshtarit djall.

E ngjalle të riun që kish vdekur, u shfaqe dëbues, zbrapsës djajsh,* ke shtangur turma njerëzish edhe ia solle Krishtit Zot* me gjak martirësh pasi i rrëmbeve nga dorë dragoi.¹⁶

Ti, o tërësi, që po mban emrin e Krishtit Zot, eja me besim* që ta himnosh martirin, kokën e tij ta kuro-rëzosh* me këngë shpirtërore, që të gjesh shpejt zgjidhjen e shkeljeve.

Hyjindësore

Në bark more, nënë virgjëreshë, të Birin e Perëndisë, Fjalën Zot,*³² që nuk e nxë e tërë bota, por e mbajte ti në gji,* o streh' e të krishterëve, e pacenuar Hyjindëse.

Zbritësore: Tus sus innologus

O Zonjë dhe nënë

Ndenjëso

Ting. III Thias pisteos

Shtyllë pa tundim* për Kishën¹⁹ tonë,* dhe kandil mbi dhé* që s'shuhet kurrë* u tregove, athlofor Harallamb martir;* si fekse më hije-sisht ti se dielli,* furtunë idhujsh ke flakur, o shenjt me nam;* lypi Krishtit Perëndisë të na dhurojë ne* mëshirë, përdëllim të madh si edhe hir.

Lavdi

Ting. I Ton tafon su Sotir

Të mbledhur besërisht* tërësi shpresëtarësh* ta mburrim denjë-sisht Harallambin, martirin* e madh të Krishtit, luftëtar si diamant për besimin ton',* që vithisi posht'* besim të rremë dhe shpalli* si Zot Perëndi* të Gjithësis' Krishtin tonë,* njeri edhe Perëndi.

Tani *Hyjindësore*

Na ngri se ramë ne* në humner' dëshpërimi,* në tmerre, në trishtime dhe shkelje, o Vajzë,* shpëtim për mëkatarë je, ndihmë, mbrojtje me plot fuqi;* ndaj dhe na shpëton* ne shërbëtorët e tu ti,* Zonjë shën Mari,* o enë e respektuar* e Zotit Krisht Perëndi.

Ode IV

Irmosi: Hristós mu dhínamis

»**F**uqia ime, Krishti Perëndia »është',*³³ psal me mendje të pastër »edhe thërret* siç e meriton pra Zoti, »Kisha jon' e vyer fort* dhe feston në »Krishtin me hare.

U stolise kur u leve në gjakun e dëshmimit të nderuar dhe shkëlqeve me bukuritë e tij, o Harallamb, hije-shia dhe mbështetja e atletëve.

O athlofor, me burrërinë tënde i dërrmove statujat e drunjtat të demonëve, pasi e tregove veten tempull të

Shpirtit të Shenjtë,³⁴ shembull dhe përmendore durimi të pagënjeshhtërt.

O i lavdishëm, duke ngritur duart mbrojtësit e errësirës, shqyenin brinjët e tua me thonj, duke të shkaktuar shijimin e vërtetë të përjetshëm.

Hyllindësore

Është fuqi dhe himnim Krishti Zot,³⁵ që lindi si diell prej teje, o e Tërëkulluar, nga hiperbola e mirësisë dhe na çliroi nga shkelja e lashtë.

Tjetri: O kathímenos en dhoksi

Ai që ulet në lavdi mbi fronin e Hyjnisë³⁶ të pranoi si pëllumb me flatra të arta kur fluturoje drejt tendash qiellore si luftëtar i pathyer dhe i lavdëruar.

Indriçuar nga llamburitja e Perëndisë, o martir i lavdëruar, qëndrove i padëmtuar para podiumeve të të paligjshmëve dhe predikove lirisht Krishtin si Perëndi të përsosur, që veshi natyrë njerëzish.

Koka jote e nderuar, o Harallamb i panështruar, u tregua me të vërtetë thesar i madh dhe tepër i pasur, që dëbon me fuqinë e Shpirtit sëmundjet e shumëllojshme si dhe atë të murtajës.

Hyllindësore

Le ta himnojmë Marinë e tërëpëcnuar Hyllindëse, që lindi Diellin e drejtësisë,³⁷ portën qiellore,³⁸ që në mbretëritë e Perëndisë i fut ata që e lavdërojnë.

Zbritësore: O kathímenos en dhoksi

Ti që rri midis lavdisë

Ode V

Irmosi: To thio fegji su agathé

»**M**e drit' hyjnore, i mirë ti,* shpirt
»trat e atyre që po mëngojnë^{38a} me
»mall për ty shndrit, – të lyp –,* të
»të njohin, Fjalë e Perëndis', Zot³²
»vërtet,* që rithërret nga mjegulla e
»mëkateve.

Meqë imitove me qëndrueshmëri, o martir i Krishtit, pësimin hyjnor të atij që duroi për ne pësime, duron me duresë të madhe mbërthimet e gozhdëve në tërë trupin, o i lavdëruar.

O i tërëurtë, Fjala e panisshme bashkë me Atin, duke korrigjuar pamendësinë e përndjekësve, u fut qartazi arsye të palogjikshmëve, të cilët urdhërojnë të të zgjidhin nga prangat.

I shpuar me thumba e plagose zemrën e armikut të frikshëm të të dhëlindurve, me shtizën e burrërisë dhe durueshmërisë sate, o athlofor hyjmendës i admirueshëm.

Hyjlindësore

Me ndriçimin tënd, o e Mirë, shkëlqejë shpirtin tim të errësuar nga kënaqësitë dhe udhëzoje drejt udhë shpëtimiti ti, e vetmja që kishe në bark Krishtin Shpëtimtar.

Tjetri: Eksesti ta simpanta

Shtangen të gjithë në lavdinë tënde të hyjshme, sepse koka jote e tërënderuar shporr sëmundje, dëbon demonë, u dhuron shërime e çlirim nga fatkeqësitë të gjithë besimtarëve që vrapojnë pranë saj.

Kur i falemi kryes sate të hyjshme dhe e lavdërojmë me nderim, pushojnë sëmundje trupash dhe shpirtash, o Harallamb, se Krishti na e falë si ilaç dhe mbrojtje ndaj tmerreve.

Ushtangën demonë dhe grekët e pabesë kur panë duart e dukës gojëlëshuar dhe arrogant të jenë të prera dhe të varen frikshëm nga trupi yt; por ti si imitues i Krishtit e shëndoshe prapë.

Hyjlindësore

Oe tërëpaqortueshme, Fjala enipostate e Perëndisë, zbriti si shi mbi shtëllungë³⁹ në barkun tënd dhe shpëtoi mbarë natyrën e të vdekshmëve, tharë nga djegësira e rënies, o e pacenuar.

Zbritësore: Eksesti ta simpanta

Të gjith' i habite ti

*Ode VI**Irmosi: Tu viu tin thálasan*

»**J**a detin e jetës tash* e shikoj
»të ngrihet prej furtune ngasjesh
»ashpërsisht,* te limani yt shumë
»i qetë rend pra dhe të thërras: Ma
»ngri* shpirtin tim, o mëshirëplot,
»nga prishja pra.⁴⁰

Ndriçues i madh ke qen',* që shkëlqejë anëmbanë⁴¹ dritën e arritjeve,* athlofor i çuditshëm i Zotit, që përpara tiranëve* e pohove ti emrin e Jisuit Krisht.⁴²

Indezur prej dashurisë* së përfllaktë shove zjarr, mani besëkëqijsh plot tmerr* përmes vesës së besës kur shfaqë mrekullitë e Krishtit Zot* tek të pabesët, o i admirueshëm.

Meqë dëshirove ti* jetën e pavdekshme, vrave çdo lëvizje dhe pasion* mishëror⁴³ dhe me lutje të vdekurit i ngjalle, o Harallamb,* duke psaluar atë që të lëvdoi fort.

Hyjlindësore

Nga sulmet e veseve* kundërshtare tundem, po forcomë, o Hyjlindëse,* ti që linde burimin e papasionshmëris', se te ti përik*, te ti streha e madhe e gjith' njerëzve.

Tjetri: Tin thian taftin

Kremtojmë festën e tërërespektuar dhe të hyjshme të shenjtit fort të lum, pra ejani* kokën e tij të nderuar fort* ta puthim dhe të marrim çlirim ne në mjerim.

O Harallamb, duke pasur si burim shërimesh kryen tënd tepër të nderuar, rendim ne* me zjarr pra që ne t'i falemi* dhe të himnojmë Zotin që të lëvdoi ty.

Fitove hir të stërmadh prej Perëndisë, o atlet Harallamb shenjt, sypatrembur me guxim,* se bëri Zoti krejt kryen tënd* qart' edhe dukshëm kroin e gjith' shërimeve.

Hyllindësore

Oe dëlirë, zjarr i Hyjnis' në ty fushoi dhe s'e shkrumboi mitrën tënde të pacen;* por, o Hyjnuse, e vyer je* për lumërim, e shndriti dhe e freskoi ky.

Zbritësore: Tin thian taftin

Këtë të kremte

*Kontaqi**Ting. IV Epefanis simeron*

Si thesar të çmueshëm,* o Harallamb shenjt* hieromartir atlet* dhe trofeprurës, Kisha jon'* ka kokën tënde, gëzohet pra,* duke lëvduar Ndërtuesin, Zotin Krisht.

Shtëpia

Duke u mbledhur le ta mburrim luftuesin e qëndrueshëm, ushtarin e Krishtit²⁰ dhe të madhin ndër martirët, Harallambin e tërëlavdishëm; sepse kreu ndeshje të shkëlqyer për Krishtin dhe për të vërtetën,⁴⁴ deklaroi fuqishëm besimin orthodhoks, pushoi mashtrimin e idhujve, qortoi një mbret tepër të paligjshëm dhe u pre në kokë duke ngazëlluar hareshëm; për këtë mori dhe kurorën nga e djathta e të Shumëlartit¹⁸ dhe u bë bashkëqytetar engjëjsh; prandaj Kisha e orthodhoksëve duke puthur me mall kryen e tij të tërënderuar dhe duke e kurorëzuar me lavdërime, çlirohet nga shumë peripeci dhe sëmundje; gëzohet pra duke lëvduar Ndërtuesin, Zotin Krisht.

Sinaksari

Më 10 të të njëjtit muaj, kujtimi i hieromartirit të shenjtë Harallamb.

Vargje: U denjësove, o Harallamb, nga shpata/ si për llamburitje edhe për harenë e martirëve.

Në të dhjetën, o Harallamb, u preve në qafë.

Në të njëjtën ditë, martirët e shenjtë Vapti dhe Porfiri, që ndëshkonin shën Harallambin, mbarojnë me shpatë.

Vargje: Porfiri dhe Vapti ngjyrojnë një purpur të përbashkët/ në saje të shpatës së përbashkët të atletizmit.

Në të njëjtën ditë, të tria gratë e shenjta që besuan, mbarojnë me shpatë.

Vargje: Numri mashkullor tre, i bën të njohura/ tri gratë burrërore ndaj shpatës.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martireve të shenjta dhe të virgjëra, Enatha dhe Valentina, si dhe i Pavlit.

Vargje: Dhëndri tek dy vajzat virgjërore/ jep si nishan fejeje guxim para flakës.

I prerë në fyt nga malli i Krishtit,/ është Pavli, mik i Krishtit.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atit tonë ndër shenjtorët Anastasi, kryepiskop i Konstandinopojës.

Vargje: Anastasi duke u tendosur përpara në udhë,⁴⁵/ pasi u ngrit nga dheu, vrapon drejt të Shumëlartit.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atit tonë oshënar Zinoni.

Vargje: Meqenëse Zinoni kërkonte vetëm të ngazëlluarat e Edenit,/ e kishte si gëzim zgjidhjen nga mishi.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i mbretëreshës, Ana suedezja.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atit tonë oshënar, Prohori i Lavrës së Shpellave të Kievit.

Me ndërmjetimet e tyre të shenjta, o

Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII

Irmosi: I pedhes en Vaviloni

»**T**re Djemtë në Babilonë* s'u frikësuan në flakë, zjarr,* por të hedhur në mesin e furrës* të freskuar po psalnin pra:* O Perëndi i etërve,* i bekuar je, o Zot i madh.⁴⁶

Duke kumtuar me torturat dhe duke u plehëruar me zjarr, o athlofor i Krishtit, u bëre më i pastër se ari dhe dhuratë e hyjshme vërtet.

Me vesën e lutjeve u shua plotësisht kamina e të paligjshmëve dhe shpëtove, o i urtë, duke i psalur Bërësit: I bekuar je, o Zot, Perëndi i etërve tanë.⁴⁶

Me zgjatjen e ndeshjeve u duke pemë e lartë që u bën hije nga mëkati i flaktë besnikëve që thërrasin: I bekuar je, o Zot, Perëndi i etërve tanë.⁴⁶

Hyjlindësore

O Perëndilindëse e kulluar, që pranove harenë në barkun tënd të tërëdëlirë, mbush me ngazëllim zemrën time⁴⁷ duke dëbuar zymtësinë e pasioneve, o e gjithmonëvirgjër.

Tjetri: Uk elátrefsan

Duke të përhimnuar thërrasim: Gëzohu, o martir i lavdëruar Harallamb, sepse na dhurove ti kokën

tënde të hyjshme si krua që buron pasuri që s'vidhet, që dëfren shpirtrat e atyre që të lavdërojnë besërisht.

Madhështojmë arritjet dhe ndeshjet e tua, o i mrekullueshëm, martir i madh i Krishtit; sepse rrëzove tempuj idhujsh dhe e pushove trimërisht kryelartësinë e demonëve, o i gjithëkënduar.

Na lindi si ndriçues i shkëlqyer përherë koka jote, e cila na nxjerr nga mashtrimi i errët, rreziqet dhe shtrëngimet, dhe na çliron nga sëmundjet shkatërruese dhe na dhuron shëndetin.

Hyllindësore

Dielli i madh dhe i paperëndueshëm lindi për mbarë njerëzit nga mitra jote dhe shkëlqeu me dritën e diturisë të gjithë që thërresin: I bekuar është fryti i barkut tënd, o e Tërëkulluar.

Zbritësore: Uk elátrefsan

Nuk u faleshin

Ode VIII

Irmosi: Ek flogós tis osiis

»**V**es' burove prej flakës tek oshëna-
»rët ti,*⁴⁸ dhe e dogje flijimin e
»një të drejti⁴⁹ shkumb;* vetëm
»me vullnetin tënd, o Krisht, bën
»çdo gjë^{49a} ti;* ne në gjithë jetët të
»përbilartësojmë.

Istolisur me bukurinë e shenjave të traumave, i hijeshuar hirshëm me kurorën fitimtare,¹⁸ u paraqite pranë Perëndisë,⁵⁰ duke pikuar akoma rrjedhjet e gjakut, o martir.

Shumica e sflitjeve nuk e mbuluan burrërinë dhe trimërinë tënde, o martir; fuqia e përndjekësve nuk e errësoi durimin tënd tejet të shkëlqyer, o hyjmenndës.

Prift dhe martir i pamposhtur, ushtar trim, shtyllë e patundur, mbështetje¹⁹ besëmirësh dhe kundërshtar i pabesisë u tregove me të vërtetë, o athlofor hyjmenndës.

Hyllindësore

Ai që i bëri të gjitha me vullnet hyjnor, me dëshirën e vet banoi në barkun tënd, o e pacenuar, duke dashur të na rigatonte ne që rrëshqitëm; atë e përbilartësojmë në gjithë jetët.

Tjetri: Pedhas evajís

Përkrahës i madh i orthodhoksëve dhe çlirimtar nga rreziqet u tregove, o Harallamb i tërëurtë, sepse shpëton përherë të gjithë sa rendin pranë kokës sate të nderuar dhe kërkojnë zgjidhjen e të këqijave, dhe e përbilartësojnë Krishtin në jetët.

Në stadiumin e Sevirit qëndrove si diamant i fortë dhe shtyllë që

s'përmbysset, o Harallamb i lum e i lavdishëm, dhe e shpalle Krishtin si Perëndi dhe njeri, dhe nuk iu përkule fare përkëdheljeve shpirtshkatërruese të vrasësve.

Zgjidh vargjet e shkeljeve⁵¹ të mia, se e himnoj kokën tënde që gufon përherë rrëke shërimesh, o Harallamb, duke më dhuruar ndjesë mëkatesh dhe çlirim sëmundjeje të vështirë mua që të mburr në gjithë jetët.

Hyjlindësore

Meqë të gjeti trëndafil në gjemba, lule tepër erëkëndshme në lugina dhe zambak⁵² të tërëpapakëluar, o Zonjë hyjnuse, dhëndri yt fushoi nga lart tek ti dhe aromatizoi botën mbarë, e cila të përmbilartëson në gjithë jetët.

Zbritësore: Pedhas evajis

Djemat e dënuar

Ode IX

Irmosi: Theón anthrópis

»**N**uk munden Zotin ta shohin njerë-
»zit,*⁵³ që rreshta engjëjsh s'kan'
»guxim ta shohin,^{53a} veçse nga ti,* e
»dëlirë, njerëzve u duk ky njeri* Fjala
»e mishëruar;⁵⁴ e madhështojmë
»ne,* dhe të lumërojmë me ushtritë
»engjëllore tok.

As zjarr, as shpatë, as vdekje, as ngushtim,* as shpikje torturimesh të

çdollojshme dhe as uri,* as përndjekje, as shtrëngim edhe as rrezik* s'munden vërtet që të të ndanin prej dashuris'*⁵⁵ së atij që të krijoi; o atlet të admirojm'.

Nga shqyerje thonjsh këmishë vdekjeje*⁵⁶ e zveshe dhe e zbukurove veten, o athlofor,* me stoli prej gjakrash, me guxim pra qëndron* i ngazëlluar pranë Krishtit ton' Perëndi,* Zotit të gjithçkaje, o martir që s'u përkule kurr'.

Kujtimi yt që gaz dhe hare na jep* si dhe shkëlqim vërtet të hyjshëm lindi mbi rruzullin* dhe flak dimër veshsh, ne të gjithë na shndrit;* duke kremtuar për atë, le të përfitojm'* falë përgjërimeve të tua ndjesë, mirësi.

Hyjlindësore

Fortunë vesesh më shkund dhe më përmbyt,* e Tërëpaqortueshme, shtrëngatat e tmerreve,* ti që kapitenin Krisht e kishe në bark,* shtri dorën ndihmëse, shpëtomë se vetëm ti* mbrojtje je për sa të lumërojnë me besim dhe mall.

Tjetri: Apas jjenís

Pranë kokës së nderuar fort të martirit gjithë ne të vijm',* o besnikë, se Zoti* i Gjithësisë⁵⁷ dha hir të madh te kjo,* prandaj dëbon demonë dhe pushon sëmundje helm,* çdo njeri pra* që e prek i fal mëshir'*

dhe shëndet, si dhe forcë me gjallëri.

Qielli dhe dheu sot me çuditë e martirit kaq të madh* shtangen,⁵⁸ meqë shporren larg* hordhi demonësh edhe forcim në trup* u jepet të sëmureve. Pushon epidemi* kur thjesht preket* koka jote, o martir* famëmadh trofeprurës dhe athlofor.

Të qëndrojmë në shtëpinë e Perëndisë⁵⁹ ton' me përkushtim,* kokës së nderuar krejt* t'i falemi, se është e hyjshme fort,* vërtet e vyer për lëvdim, se u ngjyros me gjak* të martirit,* bën çudi mahnitëse,* meqë dora e Zotit i dha kuror'.

Hyjlindësore

Prit prej nesh himnim, o nënë hyjnuse e hyjhirshme e Zotit,* na shpërble me hirin tënd,* se ne shërbyesit e tu psalim tok* shpresëtarisht për hirin tënd; për neve zbuteti* Krishtin tonë,* që e linde pa shpjegim,* pa rrëfyer, o Vajzë e virgjër krejt.

Zbritësore: Apas jijenís

Gjithë njerëzit

Dërgimësore

Jinekes akutsthithe

I ndezur perëndishëm ti,* o Harallamb, me mallëngjim* për tërëmbretin, e hodhe* me burrëri gjarprin poshtë* edhe Sevirin çnjerë-

zor,* pra tiranin e çmendur,* o i lum, e qortove prer'* edhe e more shpërblimin* nga Zoti i Gjithësisë.

Hyjlindësore

Mbulo shërbyesit e tu* pa cen, pa plagë ruaji* nga çdo dëmtim, o Mari ti,* o streh' e të krishterëve,* je mburrja jonë, na çliro* nga çdo peripeci, rrezik* me ndërmjetimet që po bën* përpara Birit tënd Zotit,* për ne që me mall të lusim.

Lavdërime

Ting. I Ton uranion tagmaton

Tani, o bij të Ballkanit, vraponi, ejani,* të gjithë puthni kryen* e nderuar të shenjtit* Harallamb të hyjshëm, që shpalli fort* Krishtin tonë në stadium* dhe demaskoi mashtrimin e pabesis',* madhëroi dhe Ndërtuesin.

(2x)

U numërove me engjëjt tani në qiell ti,* rri pranë Shën Trinisë,* o i lum përgjërrohesh;* lyp, për ne që respektojmë me bes'* kryen tënd të nderuar fort* dhe po kërkojmë çlirim nga çdo rrezik,* nga sëmundje dhe peripeci.

Lindi në tërë Greqinë plot me ndriçim dhe lavd* kujtimi yt festiv fort,* Harallamb shenjt i hyjshëm,* ndaj shkëlqyeshëm kremton, se e ka* kryen tënd të nderuar shum',*

që predikoi fuqishëm Jisuin Krisht*
Zotin tonë Perëndinjeri.

Lavdi *Ting. Tërth. I*

Si alabastër i mbushur koka jote e çmuar, o i mahnitshëm, derdh shërimet, diçka si miro⁶⁰ tejet të çmuar, dhe i aromatizon në mënyrë të mrekullueshme shpresëtarët, i shpengon nga të gjitha mjerimet ata që i afrohen me besim; dhe duke pushuar mashtrimin erëkeq, sëmundje të larmishme dhe murtajën epidemike, u dhuron të gjithëve shëndet, paqe dhe përdëllim të madh.

Tani *Hyjlindësore*

Ty të lumërojmë, o Hyjlindëse e virgjër, dhe të lavdërojmë ne besnikët siç të ka hije ty, qytetin e patundshëm dhe murin që s'çahet dot, mbrojtjen e pathyeshme dhe strehën e shpirtrave tanë.

Dhoksologjia e Madhe

Në Liturgji, Tipiket dhe nga Kanunet e shenjtit, Odet III dhe VI. Kondaqi Mbrojtje e paturpëruar Kungatore: Në kujtim të përjetshëm.

CITIME

¹ Fil. 1.23

² Lev. 1.3; 9.2-3; 22.19,21; Num. 28.31 etj.; Rom. 12.1; Fil. 4.18

^{2a} Num. 14.19 etj.

³ Eks. 25.9-20; 38.1; Ligji i Dytë 10.2; Ps. 131(132).8; Hebr. 9.4

⁴ Eks. 16.33; Hebr. 9.4

⁵ I Petr. 2.21

⁶ II Kor. 1.7

⁷ Is. 61.7

⁸ Ps. 49(50).14,23; 106(107).22; 115(116).8 (116.17); Hebr. 13.15

⁹ Hebr. 12.23

¹⁰ Ps. 44(45).10

¹¹ Gjen. 1.26-27; 5.1; 9.6; Urt. Sol. 2.23; Sirak 17.3

¹² Matth. 18.12; Lluk. 15.4-5

¹³ Joel 2.23

¹⁴ II Tim. 4.7

¹⁵ Ef. 6.16

¹⁶ Apok. 12.9; 20.2

¹⁷ IV Makk. 6.7

¹⁸ Urt. Sol. 5.16

¹⁹ I Tim. 3.15

²⁰ II Tim. 2.3

²¹ Ps. 94(95).4

²² Eks. 3.2-5

²³ Gjen. 3.17-19

²⁴ Lluk. 1.28

²⁵ Ps. 41(42).8; 87(88).17-18

²⁶ I Petr. 5.8

²⁷ Ps. 2.6 etj.; II Petr. 1.18

²⁸ I Mbret. [Sam.] 2.1-2

²⁹ Matth. 16.16-18

³⁰ Ps. 35(36).9

³¹ Jez. 44.1-4

³² Joan 1.1

³³ Abak. 3.19; Joan 20.28

³⁴ I Kor. 3.16; 6.19

³⁵ Ps. 117(118).14

³⁶ Jez. 1.26

- ³⁷ Mal. 4.2 (3.20)
³⁸ Gjen. 28.17
^{38a} Is. 26.9
³⁹ Gjq. 6.37-38; Ps. 71(72).6
⁴⁰ Jona 2.7
⁴¹ Fil. 2.15
⁴² Matth. 10.32; Lluk. 12.8
⁴³ Gal. 5.24; Kol. 3.5
⁴⁴ Sirak 4.28
⁴⁵ Fil. 3.14
⁴⁶ Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 28
⁴⁷ Ps. 15(16).11; Vep. 2.28
⁴⁸ Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 26
⁴⁹ III [I] Mbret. 18.38
- ^{49a} Hebr. 1.3
⁵⁰ III [I] Mbret. 17.1; 18.15; IV [II]
Mbret. 3.14; 5.16
⁵¹ Fja. Urt. 5.22
⁵² Kënga 2.1-2
⁵³ Eks. 33.20; Joan 1.18
^{53a} Is. 6.2
⁵⁴ Joan 1.14
⁵⁵ Rom. 8.35
⁵⁶ Gjen. 3.21
⁵⁷ I Kron. 29.11; Urt. Sol. 12.16
⁵⁸ Jer. 2.12
⁵⁹ I Kron. 22.1-2 etj.; Lluk. 6.4
⁶⁰ Matth. 26.7; Mark. 14.3; Lluk. 7.37



MË 11 TË TË NJËJTIT MUAJ

Kujtimi i hieromartirit të shenjtë Vlash.

NË MBRËMËSORE

*Thirrtores**Ting. I Ton uranion tagmaton*

Si mbive në asketizëm, o oshënar shën Vlash,* me lavd, nder priftërie* si feniksi i drejtë,* o i lumur lulëzove¹ ti frut* martirik e të hyjshëm krejt;* i solle Zotit rrënim idhujsh, njerëz pra* i ke bërë familjar me të.

(2x)

Në baritim u dallove, o hieromartir* i Krishtit, si durove* trimërisht atletizëm,* ndeshje; edhe me të dyja ke marr'* një kurorë, stolisesh ti* dhe me të dyja: me lodhje në drejtësi* dhe me gara; ndërmjeto për ne.

Me zell të hyjshëm për besën gratë e forta mjaft* nëpërmjet atletizmit* plot me nder, për dëshminë* krejt të mirë,² tok me foshnjat kuror'* morën, - o sa çudi! - se mall* për Krishtin që është kreu³ kishin, me të* u martuan, kur u pren' në kok'.

Si kujdestar për të gjithë, për qenie me logjik'* dhe kafshë pa arsye* të sëmura, o shën Vlash,* të himnojme, se ke forcë,⁴ shëron,* bën të mira te tërë ne* me besë; ke edhe hir

Shpirti dhe shpërndan* mrekulli, o shërbëtor Zoti.

Ushfaq se Krishti që jeta për ty edhe fitim* vërtet e kishe vdekjen* përmes besës, si Pavli* emërmadh besonte,⁵ i tërëlum* Vlash hyjmendës, sepse për të* gatishmërisht vdiqe dhe mbretëron me të*⁶ përgjithnjë në jetë pa mbarim.

Lavdi

Ting. Tërth. II I Studitit

Meqë mbive si vllastar në asketizmin e virtyteve të hyjshme, o Vlash, sipas emrit lulëzove si feniks në avllitë e Zotit dhe si kedër u shumëfishove në arritje sipas Davidit;¹ dhe si vresht pjellor në shtëpi⁷ Perëndie duke u krasitur në kohën e martirizimit me dënime sfilajtësh, na burove nga fruti i garave të tua verë mendore, që kur pimë prej saj mbushemi në zemër me ngazëllim të perëndishëm dhe të mbledhur me një shpirt në kujtimin e nderuar të mbarimit, të përsosjes sate, të mburrim duke të lumëruar, dhe kërkujmë të marrim me anën tënde paqen dhe përdëllimin e madh.^{7a}

Tani *Hyjlindësore*

Enjuhëm Perëndinë që u mishërua prej teje, o Hyjlindëse Virgjëreshë, atij përgjëroju që të shpëtohen shpirtat tanë.

ose Kryqhyjlindësore
Triimeros anestis Hristé

Sapo të pa të varesh mbi kryq,* vajtonte e dëlira krejt* porsì nënë,* duke thënë: Biri im,* o Perëndi dhe Zot, o fëmijë fort i ëmbël,* si po duron pësim të turpshëm ti.

Pasvargjet e Oktoihut

Lavdi

Ting. IV I Bizantit

Si trajner i zoti dhe mësues i besës së mirë, me energjinë dhe fuqinë e fjalëve të tua të hyjshme përgatite për ndeshje martirike gra perëndidashëse, duke forcuar në Krishtin dobësinë e natyrës së tyre; meqenëse e kreve me to mirë udhën⁸ e asketizmit, bashkëngazëllohesh me hijeshi në nusërore qiellore, i mburrur me kurorën e dyfishtë të lavdisë hyjnore, dhe kërkon tok me to që të na dhurohet paqja dhe përdëllimi i madh.^{7a}

Tani *Hyjlindësore*
Os jeneon en mártisin

Mendjen ti ëmbëlsoma fort* me shi hiri prej Shpirtit Shenjt,* sepse pikën, Krishtin Zot Perëndi, në bark* e mbajte, Zonjë e tërëpacenuar, me dhembshuri* fshin mëkatin njerëzor,* ti burimin e veseve* ma përmbys, ma zduk* dhe përmes ndërmjetimit tënd gjithnjë jetik më denjëso të pi nga përroi plot me shijim⁹ dhe gaz.

ose Kryqhyjlindësore

Kur të pa përmbi Kryqin ty* nëna jote e virgjër, Zot,* që të varesh, thoshte duke vajtuar keq* me zi e klithma: Ata pra që shijuan dhurata plot* nga ti, ty ç'shpërblim të dhan'* Perëndia dhe Zoti im,* por të lutem shumë':* Mos më lër vetëm pra në këtë botë, por nxito të ngjallesh, duke i ngjallur dhe paraetërit.

Përlëshore
Ting. IV

Shok i mënyrave, mëkëmbës i froneve, u shfaqe kor' e dishepujve, zbatove me vepërim kudo, çdo teori edhe predikim; prandaj të vërtetën e lëçite prerë e drejt,¹⁰ dhe për besën luftove gjer në gjak, si një dëshmor o shën Vlash; lutju Zotit Krisht Perëndi, të shpëtohen shpirtat tanë.*

Tjetër

Ting. Tërth. I Ton sinánarhon Logon

Pasi mbive si pemë frutdhënëse, o Vlash,* prodhove fryte martiri për botën, o hierark* i lavdishëm, dhe buron mori dhuratash ti,* pra mre-kulli te sa vrapojn'* drejt përkrahjes që jep ndërmjetimi yt, o i shenjtë,* atë dhe hierodëshmor që ke lulëzuar sipas emrit tënd qart'.

Lavdi dhe Tani *Hyjlindësore*

Gëzohu, o der' e Zotit e pashkuar; gëzohu, o mur dhe mbrojtje e atyre që ikin te ti; gëzohu, o liman i

padimëruar dhe e pamartuar, ti që linde trupërisht bërësin tënd dhe Perëndi, mos resht së ndërmjetuari për ata që përhimnojnë dhe adhurojnë Birin tënd.*



NË MËNGJESORE

Stihologjia e zakonshme dhe Kanunet e Oktoihut dhe i shenjtit, që ka Akrostihidhë: “Të duartrokas me himne besërisht, o martir. Josifi”.

Ting. Tërth. IV

Ode I

Asma anapépsomen laí

Ke guxim, o hieromartir ndaj Krishtit dhe Ndërtuesit,* pra mendjen time shndrite me shkëlqim të shumtë,* teksta të lëvdoj tani* plot me besim dhe himne* atletizmin tënd krejt dritëprurës.

Kur pohove një Trini në tre persona flake mjegulla* politeizmi dhe u pe agim besimi* që shndriti sa mbahe-shin,* o hieromartir at’,* brenda në errësirë mashtrimi.

Natën ateiste pakësive përmes vërtetimeve* të predikimit tënd të shenjtë, ndaj u shfaqe* ndriçues ti me stoli* shndritjeje me çudi dhe* me shkëlqim martirik feks në botë.¹¹

Hyjlindësore

Që të na çlironte nga mashtrimi, nën’ e virgjër, e dëlir’,* fushoi brenda mitrës sate kur të gjeti* të tërëkulluar ty* Krishti i pastër, Zoti,* mori mish,¹² por pa kurrfarë faji.¹³

Ode III

Estereoithi i kardhia mu

Sa brenda gjembave të botës gjithnjë po mbyten,*¹⁴ me draprin e ndërmjetimit tënd, Vlash,* nga çdo rast i keq pastrohen kur ty të ftojn’* si mbrojtës me dhembshuri dhe mall.

Duke soditur tërësisht drejt Hyjnisë lart ti,* durove dallgët e keqtrajtimit;* kur po shqyhej mishi yt, si të vuante* dikush tjetër po mendoje pra.

Si hierark dhe athlofor i pamposhtur zëmadh,* si i stolitur me lavd të hyjshëm,* je pran’ të dëshiruarës më të lart’* tani, lyp për tufën tënde ti.

Hyjlindësore

Të lumërojnë gjeneratat¹⁵ e njerëzisë* me himne, meqenëse u shfaqe* më e lart’ se çdo krijim, se je më e shenjt’,* e vyer për lumërim hyjnor.

Irmosi: Estereoithi i kardhia mu

»**U** siguraa zemra ime në Perëndi-në,* m’u lartësua në Zotin briri.*
»Goja ime u zgjerua përmbi armiq*

»dhe kisha gaz për shpëtimin tënd.^{15a}

Ndenjëso

Ting. Tërth. IV Tin sofian qe Logon

Si një pemë e pasur me gjelbërim* në shtëpinë e Zotit, o meshëtar,* ke mbirë¹ dhe mbolle shumë* njerëz mbi dheun¹⁶ shpëtimtar* dhe udhëhoqe mirë si dash para grigjës ti,* u kape dhe u there, u bëre flijim për të* që nga dhembshuria si një qengj ishte therur;*¹⁷ dhe rende lart tek ai* me gëzim, ati ynë Vlash,* ndaj drejt teje* thërrasim ne:* Ndërmjeto te Zoti yt Krisht,* të na dhurojë ky ndjesën* e fajeve* ne që bëjmë kujtimin tënd fort të shenjt' me mall.

Hyjlindësore

Si stoli e qendisur e ruzullit,* zbukurim për ushtrit' engjëllorë je,* e mbajte në bark mbi dhé* zbukuruesin botëror,* sepse më parë s'kish bukuri meqë nuk kish rast* ta shihnin Zotin njerëzit; ndaj me të dyja k'to* si stoli e bukur, o e Virgjër hyjnënë,* u shfaqe me lindjen ti* e stolitur, se me këtë* hijeshove* nur kozmosin* me stolin' e lashtë që kish* dhe zbukuron hijeshinë* e engjëjve* në mënyrë magjepse, o shpëtimtare krejt.

ose Kryqhyjlindësore

Çlirimtarin, Bariun¹⁷ dhe Qengjin¹⁸ Krisht,* kur e shihte në kryq shqerra, me vajtim,* me lot dhe me hi-

dhërim* i thërriste: "Gëzohet fort* e tërë bota, se pret çlirimin, por un' me zjarr* përbrenda flakërohem kur shoh kryqëzimin tënd,* që duron për hir të përdëllimit tënd, o Zot* i mbi-miri Perëndi,* që nuk mban kurrë zemërim".* T'i thërrasim* asaj me bes':* Virgjëreshë na dhembshuro* dhe na dhuro ndjesë fajesh,* se me besim,* po u falemi ne pësimeve të atij.

Ode IV

Eks orus kataskiu

Duke shkëlqyer në shpirt hijesisht me ndriçim të palëndët, o martir dhe barí, qëndrove burrisht para podiumeve gjykuese duke pohuar mishërimin e Perëndisë.

O martir Vlash, u njohe në Kishë si prift mist, dëshmor i kurorëzuar, shtyllë e paepur, bazë shpresëtarie dhe mbështetje e së vërtetës.¹⁹

Kullote me oshënari qengja të arsyeshëm dhe ia solle Zotit si flijim i pranueshëm që digjej plotësisht²⁰ me qymyre martirizimi, o hieromist i tërënderuar.

Me thënien e buzëve të tua të urta u mbyllën buzë djallëzore që flisnin blasfemi ndaj Zotit dhe Mbretit të të gjithave, o hyjpredikues i vyer për admirim.

Hyjlindësore

Profeti të parapa si tomos të ri që kishte të shkruar²¹ Fjalën e Perëndisë, e cila grisi dorëshkrimin e mëkatit²² të stëretërve, o Vajzë.

*Ode V**Ton zofon tis psihis mu*

O i kënduar, barí i admirueshëm, durove burrërisht mundimet e mishit dhe kur plagoseshe frikshëm, plagosje mashtrimin dhe turbulloje armiq me anën e lartësimit drejt Perëndisë.

Duke ikonizuar në pësimin tënd të mbërthyerin në kryq, o i lumur, duroje trimërisht dhimbjet e mishit dhe pasi u bëre fitimtar, u numërove denjësisht me ushtritë e martirëve.

Duke përmbushur me zemër tepër bashkëvuajtëse kërkesën e gruas besnike, o atë Vlash, me fshikullime të lutjeve të tua dhe me besim të perëndishëm, shtype një bishë që të villte gjahun që kapi padrejtësisht.

Hyjlindësore

Të himnojmë, o Mari e tërëkulluar, ty që e hyjnizove brumin e njerëzve me shtatzëninë tënde përmbi mendim dhe që na rigatove ne që u prishëm së tepërmi dhe u dërrmuam me mashtrimin e gjarprit.²³

*Ode VI**Ilásthiti mi Sotír*

Undeshën bashkë me ty* një kor grash fort të nderuara, o i kënduar, meqë* me forcën e kryqit²⁴ thyen kokën e gjarprit djall* krejt dinak²⁵ dhe thurën* një kuror' fitoreje me lavd.

Me forcë edhe me hir* nga Zoti u fuqizua dobësia, se me fuqi* rinore fituan me triumf gratë, shkelën posht'* gjarprin që qëmoti* flaku Evën nga Parajsa larg.²³

Statuja, idhuj pa shpirt* të djallit dinak, o gra, vithisët, sollët veten tuaj* porsi një thesar frymor te tempulli qiellor*²⁶ dhe e hijeshuat* Kishën e të parëlindurve.²⁷

Hyjlindësore

Ofron i Zotit, i lart'* më shumë se Keruvmët,²⁸ reja me shkëlqim, vezullim,*²⁹ ndriço syt' e shpirtit tim dhe zemrën pastroje krejt,* o e Tërëshenjtë,* prej çdo terri të pasioneve.

Irmosi: Ilásthiti mi Sotír

»**M**ëkate shumë un' kam,* ndaj »le të të vijë keq, o Zot,* për »mua; lutem, më nxirr* nga fundi i »vrereve, sepse thirra fort tek ti*^{29a} »dhe dëgjomë mua,* Perëndia i »shpëtimit tim.

*Kontaqi**Ting. II Ta ano zitón*

Me gazin tënd mbush* sa festën tënde po kremtojn'* me besë, o Vlash* hyjmendës, dega fort e shenjt',* lulja që nuk vyshket dot, dhe hardhia shum' frytdhënëse* brenda vreshtit të Krishtit Zot,*³⁰ prandaj ndërmjeto për ne të gjith' pa pushim.

Shtëpia

Meqë u forcove me fuqi Perëndie, o hyjmendës, si hierark i urtë dhe meshëtar i tij, u dallove në punë të hyjshme: në koret e athloforëve u pe athlofor dhe i kurorëzuar; si mist i Krishtit u ngrite më lart se flijimi i Aaronit;³¹ gjaku i hyjshëm i bërtet Perëndisë tok me Abelin për therjen tënde;³² dhe duke qëndruar së bashku me rreshtimet e engjëjve pranë fronit të hyjnueshëm të Ndërtuesit,³³ ndërmjeto për ne të gjith' pa pushim.

Sinaksari

Më 11 të të njëjtit muaj, kujtimi i hieromartirit të shenjtë Vlash, kryepiskop i Sevastisë.

Vargje: Meqë Vlashi u pre në fyt me shpatë,/ largon të ftohurat nga korenti prej fyteve që dhëmbin.

Në të njëmbëdhjetën bronz i ashpër preu qafën e Vlashit.

Në të njëjtën ditë, dy fëmijët e shenjtë që u ndeshën tok me shën

Vlashin dhe shtatë gratë, mbarojnë me shpatë.

Vargje: O, sa guxim kanë djemtë! Së bashku nxitojnë,/ kush do të arrijë të pritët i pari.

Shpata vret shtatë gratë e nderuara/ që nuk i kapi frika femërore.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i gjetjes së lipsanit të profetit të shenjtë Zaharia, i ati i Pararendësit të çmuar.

Vargje: Si nga dheu u shfaq lipsani i Zaharias/ u buron besnikëve të gjallë hir pa kursim.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i mbretëreshës Theodhora, që përforcoi Orthodhoksinë.

Vargje: Mbreti Krisht e denjëson për kurorë të hyjshme/ Theodhorën, mbretëreshën tepër shpresëtare.

Me ndërmjetimet e tyre të shenjta, o Perëndi, mëshirona. Amin.

*Ode VII**Ton haldheon i káminos*

Si fitove zemër të mbushur me ndriçim hyjnor, tejkalove pa pengesë ngecat e mashtrimit, pasi në praninë tënde vure stërkëmbës te hapat e armiqve, o i urtë.

Me spërkatjen e gjakut tënd u shua flakë mashtrimi; me rrezatimin e fjalëve të tua Krijesa u ndriçua duke thirrur, o Vlash: I bekuar je, o Perëndi

i etërve tanë.³⁴

Nuk e shikon as në hije,³⁵ as në enigma atë që aspirove, por faqe më faqe, pasi u asgjësuan pasqyrat,³⁶ dhe këndon i ngazëlluar: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.³⁴

Hyjlindësore

Me qenëse u kapa nga dremitja e përtacisë, o Virgjëreshë e kulluar, më zuri gjumë vdekjeprurës mëkati; prandaj zgjomë për agim jetëprurës pendimi dhe shpëtomë.

Ode VIII

O stegazon en idhasi

Iu solle Qengjit të flijuar¹⁷ për çlirim tonë, si dash vetëflijues, si the-
rore e mirëpritur,²⁰ si qengj pa të metë,³⁷ dhe u bashkove me shoqëri martirësh, duke kënduar tok me engjëj himnimit tepër të hyjshëm, o i tërëlumur.

O martir, me pikat e gjakut tënd thave fund ateizmi, i burove botës rrëke shërimesh që pushojnë vapën e pasioneve të ndryshme të atyre që me besim përikin te ti dhe e përmbilartësojnë Krishtin në jetët.

Kori i lumur i grave të shenjta thërriste: “Nuk e mohojmë Zotin, Perëndinë mbi të gjitha”.³⁸ Prandaj duke u shqyer dhe duke kumtuar me zjarr, dhe kur ua prisnin me hekur

kokat, gëzoheshin duke himnuar Krishtin në jetët.

Hyjlindësore

Zëra të paralajmëruan ty, o Virgjërenënë, vajzë, se do bëheshe përmbi natyrë ushqyesja e shenjtë e Bërësit tënd, duke pasur zënie të huaj dhe lindje të parrëfyeshme; prandaj të himnojmë në gjithë jetët.

Irmosi: O stegazon en idhasi

»**T**i të lartat e tua po strehon në ujëra
»lart,*³⁹ vure rërë si kufirin e detit*⁴⁰
»dhe e mban Gjithësin’;*⁴¹ dielli të
»himnon,* të lëvdon edhe hëna;*⁴²
»çdo krijesë pra tek ti ofron himn*
»në tër’ jetët, se je ti Krijimtari i saj.

Ode IX

Ton prodhilothenta

Me gjak si me shkallë mahnitëse⁴³ hipe, o Vlash,* dhe mbërrite në bane-
sa⁴⁴ lart si u pe i bukur,* o martir,
me lavdinë e garës* pranë* Zotit që
të dha kurorë rri.

Grat’ që kishin mall për ty, diellin e shkëlqyer,* dhe nuhatën miron të-
nde pra erëkëndshme,⁴⁵ o Krisht,*
me pësimin, pësimin tënd shfaqën*
dhe u* denjësuan për pavdekësi.

Si yll që si ditë shkëlqen dhe me koret lart rri,* lypim, sa lëvdojnë’ kujtimin tënd dritëprurës, o Vlash,* ti shpëtoji nga fajet e rënda* plot terr,* o shenjt, përmes ndërmjetimit tënd.

Hyllindësore

Mban në kraharor Krishtin Zot, që mban mbarë botën*³⁹ në pëllëmbë ti, o nënë e virgjër e kulluar,* si Ndërtuesin tënd edhe Birin,* lype* t'i shpëtojë sa të përhimnojm'.

Irmosi: Ton prodhilothenta

»**B**irin e Gjithnjëvirgjëreshës e »deklaruar,* që më parë përmes »ferrës me zjarr tek një ligjvënës* »mbi një mal⁴⁶ për shpëtim besëmi- »rësh,* Krishtin,* pa pushim e ma- »dhështojm' me himn.

*Dërgimësore**En Pnévmati to ieró*

Të njohim porsi zbukurim* për martirët edhe lavd,* o Vlash, për piftërinjtë ty,* se si fli veten solle,* o hierark, dhe u there* për atë që me dëshir'* ka ardhur për ty në therje* me vullnet që s'shprehet dot,* o i tërëpasur shenjt,* nga mirësia e shumtë.

Tjetër: Tis mathitës sinélthomen

Sot ejani të gjithë tok* t'i japim lavde Krishtit;*⁴⁷ se Perëndia ynë Zot* e lavdëroi Vlashin,* martirin dhe hierarkun,* me mrekulli të ndryshme,* paradoksale, me çudi;* ne që bëjm' panairin e tij hyjnor* e nderojm' dëshmorin e tërëurtë,* çlirohemi nga çdo mëkat* me përgjërimet e tij.

Hyllindësore

Gatuesi im Perëndi* në barkun tënd pa prishje* hyri, o Vajzë pa cenim,* se më kërkonte mua,* pra delen në faj të humbur*⁴⁸ dhe si në sup më mori,* më ngriti⁴⁹ për në qiej lart,* më nderoi me ndenjjen me Atin tok;* dhembshurin' e tij që nuk kapërcehet* me ty hyjnënën, ju lëvdoj* si dhe ju falem unë.

*Dhe të tjera si zakonisht.**CITIME*¹ Ps. 91(92).13-14² I Tim. 3.7³ Ef. 1.22; 4.15; 5.23; Kol. 1.18⁴ Fil. 4.13⁵ Fil. 1.21⁶ II Tim. 2.12⁷ Ps. 127(128).3^{7a} Num. 14.19 etj.⁸ II Tim. 4.7⁹ Ps. 35(36).9¹⁰ II Tim. 2.15¹¹ Fil. 2.15¹² Joan 1.14¹³ Joan 8.46¹⁴ Matth. 13.7,22; Mark. 4.7,19; Lluk. 8.7,14¹⁵ Lluk. 1.48^{15a} II Mbret. [Sam.] 2.1¹⁶ Eks. 15.17¹⁷ Joan 10.11,14¹⁸ Is. 53.7; Vep. 8.32; Apok. 5.6,12; 13.8¹⁹ I Tim. 3.15²⁰ Lev. 1.3; 17.4; Is. 56.7

- 21 Is. 8.1
22 Kol. 2.13-14
23 Gjen. 3.1-19
24 I Kor. 1.18
25 Gjen. 3.15
26 Apok. 11.19; 14.17; 15.5; 16.17
27 Hebr. 12.23
28 Jez. 10.1
29 Eks. 13.21-22; 14.24; Num. 9.15
29a Jona 2.2
30 Joan 15.1,5
31 Eks. kap. 29 etj.
32 Gjen. 4.10
33 II Kron. 18.18
34 Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 28
35 Kol. 2.17; Hebr. 8.5; 10.1
36 I Kor. 13.12
37 Jer. 11.19
38 Rom. 9.5
39 Ps. 103(104).3
40 Jov 38.10
41 Est. 4.17b; Ps. 94(95).4; Jov 9.19
42 Ps. 148.3; Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 39
43 Gjen. 28.12-17
44 Joan 14.2
45 Kënga 1.4
46 Eks. 3.2-5
47 Apok. 11.13; 14.7; 19.7
48 I Petr. 2.25
49 Matth. 18.12; Lluk. 15.4-5



MË 24 TË TË NJËTIT MUAJ

Gjetja e Parë dhe e Dytë e kokës së shenjtë të Pararendësit.

*Tipikon***1. Nëse bie të Shtunën e Shpirtrave:**

Shërbesa psalet një ditë më parë, bashkë me shërbesën e shën Polikarpit, sepse shërbesa e Shpirtrave psalet detyrimisht të shtunën.

2. Nëse bie e Diela e të Lidhurit të Mishit ose të Djathit:

Të shtunën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 4 ngjallësore, 3 të Triodhit dhe 3 të Pararendësit. Lavdi i Triodhit. Tani Hyjlindësore dogmatike e tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi i Pararendësit. Tani i Triodhit (d.m.th. Lavdi i tij si zakonisht). Përlëshoret: ngjallësore, e Pararendësit dhe Hyjlindësore ngjallësore (Misteri i fshehur).

Të dielën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Kanuni Triadik. Lavdi dhe Tani i Litisë së Triodhit. Himne Triadike. Trishenjtë. Përlëshorja e Pararendësit. Në Mëngjesore, Ndenjësore ngjallësore dhe pas Polieleit, Ndenjësorja (pas Polieleit) e Pararendësit me Hyjlindësoren e tij. (Nuk lexohet Ungjilli i Mëngjesit i Pararendësit). Bekimtoret. Ipakoia. Shkallesat dhe Proqimëni i tingullit. Kanunet: ngjallësor, i Triodhit dhe i Pararendësit. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia ngjallësore, dhe Ndenjësorja e Pararendësit dhe e Triodhit me Hyjlindësoren e tij. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e Triodhit, Sinaksari i ditës dhe i Triodhit. Zbritësoret e Triodhit; dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor i Triodhit. Më të nderuarën. Dërgimësoret: ngjallësore, e Triodhit dhe e Pararendësit me Hyjlindësoren e tij. Lavdërimet: 3 ngjallësore, 2 të Triodhit dhe 3 të Pararendësit. Lavdi i Triodhit. Tani E përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji, Tipiket. Lumërimet: 4 të tingullit dhe 4 nga Ode VI e Triodhit. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore, e Pararendësit dhe e kishës. Kontaqi i Triodhit. Apostulli i Pararendësit dhe Ungjilli i Triodhit. Kungatore Lavdëroni.

3. Nëse bie të shtunën para së Dielës të të Lidhurit të Djathit:

Të premtën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 3 të Pararendësit dhe 3 të oshënarëve. Lavdi i Pararendësit. Tani Hyjlindësore Dogmatike e tingullit të javës (që po kalon). Hyrje. O dritë gazmore. Proqimëni i ditës. Pasvargjet e Pararendësit (Sot ju besimtarë; kërkoni mu në fund të shërbesës së sotme, shih fq. 437) me Vargje në të dy të fundit: a) Atje do të lind bri për Davidin, përgatita kandil për të lyerin tim; dhe: b) Kujto, o Zot, Davidin dhe gjithë butësinë e tij. Lavdi i Pasvargjeve të oshënarëve (Turmat e murgjve). Tani O Zonjë, prit lutjet e shërbëtorëve të tu edhe çlirona ne nga çdo nevojë dhe pikëllim.

Përlëshoret: e Pararendësit, e oshënarëve dhe Hyjlindësore ngjallësore (Misteri i fshehur).

Të shtunën në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Lavdi Koka e çmuar e Pagëzorit, (kërkoje në Pasvargjet e Lavdërimeve, shih fq. 436). Tani O Hyjlindëse, ti je hardhia e vërtetë, që nxore frytin e jetës; të lypim ndërmjeto, o Zonjë, bashkë me Pararendësin dhe me gjithë shenjtorët, që të mëshirohen shpirtrat tanë. Trishenjtë. Përlëshorja e Pararendësit. Në Mëngjesore, Ndenjësoret e Pararendësit si dhe i gjithë rendi i Ungjillit të tij të Mëngjesit. Kanunet: i Hyjlindësës (shih fq. 197), i Pararendësit dhe i oshënarëve. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e oshënarëve. Ndenjësoret e Pararendësit dhe të oshënarëve (dy të fundit, d.m.th. Lavdi si dhe Tani i tyre). Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e Pararendësit. Sinaksari i ditës dhe i oshënarëve. Zbritësoret Ja gojën e çel tani. Dërgimësoret: e Pararendësit dhe të oshënarëve. Lavdërimet: 3 të Pararendësit dhe 3 të oshënarëve. Lavdi i Pararendësit. Tani O Hyjlindëse, ti je hardhia e vërtetë, që nxore frytin e jetës; të lypim ndërmjeto, o Zonjë, bashkë me Pararendësin dhe me gjithë shenjtorët, që të mëshirohen shpirtrat tanë. Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja e Pararendësit.

Në Liturgji, Tipiket dhe nga Kanuni i Pararendësit Ode III dhe i oshënarëve Ode VI. Pas Hyrjes, Përlëshoret: e Pararendësit, e oshënarëve dhe e kishës. Kontaqi Mbrojtje e paturpëruar. Apostulli i Pararendësit, Ungjilli i oshënarëve. Kungatore: Në kujtim të përjetshëm.

4. Nëse bie të hënën e Javës së Parë të Kreshmëve:

Shërbesa psalet më përpara, pra të Dielën e të Lidhurit të Djathit, pikërisht si më sipër: §2.

5. Nëse bie të martën e Javës së Parë të Kreshmëve:

Të hënën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 3 të Triodhit dhe 3 të Pararendësit. Lavdi dhe Tani Ty të lumërojmë, o Hyjlindëse e virgjër dhe të lavdërojmë ne besnikët siç të ka hije ty, qytetin e patundshëm dhe murin që s'çahet dot, mbrojtjen e pathyeshme dhe strehën e shpirtrave tanë. (Pa Hyrje). O dritë gazmore. Leximet e Triodhit. Pasvargjet e Triodhit. Tani përlëshoje, etj. të Triodhit.

Të martën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Lavdi Koka e çmuar e Pagëzorit, (kërkoje në Pasvargjet e Lavdërimeve, shih fq.436) dhe Hyjlindësorja e tij. Në fund, Përlëshorja e Pararendësit. Në Mëngjesore, pas Perëndi është Zoti, Përlëshorja e Pararendësit (2x) dhe Hyjlindësorja ngjallësore (Misteri i fshehur). Ndenjësoret e Pararendësit dhe i gjithë rendi i Ungjillit të tij të Mëngjesit. Kanunet: i Hyjlindësës (shih fq. 197) dhe i Pararendësit. Zbritësoret Ja gojën e çel tani. Dërgimësoret e Pararendësit.

Lavdërimet e Pararendësit. Lavdi i tij. Tani O Hyjlindëse, ti je hardhia e vërtetë, që nxore frytin e jetës; të lypim ndërmjeto, o Zonjë, bashkë me Pararendësin dhe me gjithë shenjtoret, që të mëshirohen shpirtat tanë. Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja e Pararendësit. Në Orët (e Thjeshta), Përlëshorja dhe Kontaqi i Pararendësit. Në Orën IX, pas Lumërimeve: Kori qiellor etj. Besoj në një Perëndi. Urata: O Perëndi, lër, fal. Ati ynë, Se jotja është. Kontaqi i Pararendësit. Mëshiro, o Zot (40x). O Krisht Perëndi, që adhurohesh. Më të nderuarën. Beko, o atë. Perëndia na dhembshuroftë. Tri metani të mëdha. Trishenjtë. Mëshiro, o Zot (12x). Urata: O Trini e Tërshenjtë, që je pushteti. Përlëshimi dhe fillon Liturgia e të Parashenjtëruarave.

Të martën në Mbrëmësore. Thirrtoret: 3 të Triodhit (Idhiomeli 2x dhe Martiriku të Pasvargjeve), dhe 3 të Pararendësit (Sot ju besimtarë; kërkoi mu në fund të shërbesës së sotme, shih fq.437). Lavdi Koka jote, kjo enë (në po të njëjtin vend), Tani Kryqhyjlindësore e tij. Hyrje me Ungjillin. O dritë gazmore. Leximet. Le të drejtohet. Apostulli dhe Ungjilli i Pararendësit dhe Liturgia e të Parashenjtëruarave. Kungatore: Në kujtim të përjetshëm.

6. Nëse bie të mërkurën e Javës së Parë të Kreshmëve:

Të martën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 3 të Triodhit dhe 3 të Pararendësit. Lavdi dhe Tani Ty të lumërojmë, o Hyjlindëse e virgjër dhe të lavdërojmë ne besnikët siç të ka hije ty, qytetin e patundshëm dhe murin që s'çahet dot, mbrojtjen e pathyeshme dhe strehën e shpirtave tanë. (Pa Hyrje). O dritë gazmore. Leximet dhe Pasvargjet e Triodhit.

Të mërkurën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmi 50, Lavdi Koka e çmuar e Pagëzorit, (kërkoje në Pasvargjet e Lavdërimeve, shih fq. 437) dhe Hyjlindësorja e tij. Në fund, Përlëshorja e Pararendësit. Në Mëngjesore, pas Perëndi është Zoti, Përlëshorja e Pararendësit (2x) dhe Hyjlindësorja ngjallësore (Misteri i fshehur). Ndenjësoret si dhe i gjithë rendi i Ungjillit të Mëngjesit të Pararendësit. Kanunet: i Hyjlindëses (shih fq. 197) dhe i Pararendësit. Pas Odes III, Ndenjësoret e Pararendësit. Pas Ode VI, Kontaqi dhe Shtëpia e Pararendësit dhe Sinaksari. Zbritësoret Ja gojën e çel tani. Dërgimësoret e Pararendësit. Lavdërimet e Pararendësit. Lavdi dhe Tani i Pararendësit. Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja e Pararendësit. Në Orët (e Thjeshta), Përlëshorja dhe Kontaqi i Pararendësit. Në Orën IX, pas Lumërimeve: Kori engjëllor etj. Besoj në një Perëndi. Urata: Lër, ndje, fal, o Perëndi. Ati ynë, Se jotja është. Kontaqi i Pararendësit. Mëshiro, o Zot (40x). O Perëndi, që adhurohesh. Më të nderuarën. Beko, o atë. Perëndia na dhembshuroftë. Tri metanitë e mëdha. Trishenjtë. Mëshiro, o Zot (12x). Urata: O Trini e Tërshenjtë, që je pushteti. Përlëshimi dhe fillon Liturgia e të Parashenjtëruarave.

Të mërkurën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 6 të Triodhit dhe 4 të Pararendësit. Lavdi si

dhe Tani të Pararendësit. *Hyrje me Ungjillin*. O dritë gazmore. *Leximet e Triodhit*. Le të drejtohet. *Apostulli dhe Ungjilli i Pararendësit dhe Liturgia e të Parashenjtëruarave*. *Kungatore*: Në kujtim të përjetshëm.

7. Nëse bie të enjten e Javës së Parë të Kreshmëve:

Të mërkurën në Mbrëmësore, *Thirrtoret*: 6 të Triodhit dhe 4 të Pararendësit. *Lavdi dhe Tani Ty të lumërojmë*, o Hyjlindëse e virgjër dhe të lavdërojmë ne besnikët siç të ka hije ty, qytetin e patundshëm dhe murin që s'çahet dot, mbrojtjen e pathyeshme dhe strehën e shpirtrave tanë. *Hyrje*. O dritë gazmore. *Leximet*. Le të drejtohet dhe *Liturgia e të Parashenjtëruarave*.

Të enjten, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmi 50, Lavdi Koka e çmuar e Pagëzorit tënd, (kërkoje në Pasvargjet e Lavdërimeve, shih fq. 436) dhe Hyjlindësorja e tij. Në fund Përlëshorja e Pararendësit. Në Mëngjesore, pas Perëndi është Zoti, Përlëshorja e Pararendësit (2x) dhe Hyjlindësorja ngjallësore (Misteri i fshehur). Ndenjësoret e Pararendësit dhe i gjithë rendi i Ungjillit të tij të Mëngjesit. Kanunet: i Hyjlindëses (shih fq. 197) dhe i Pararendësit. Zbritësoret Ja gojën e çel tani. Dërgimësoret e Pararendësit. Lavdërimet e Pararendësit. Lavdi i tij. Tani O Hyjlindëse, ti je hardhia e vërtetë, që nxore frytin e jetës; të lypim ndërmjeto, o Zonjë, bashkë me Pararendësin dhe me gjithë shenjtorët, që të mëshirohen shpirtrat tanë. Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja e Pararendësit. Në Orët (e Thjeshta), Përlëshorja dhe Kontaqi i Pararendësit. Në Orën IX, pas Lumërimeve: Kori engjëllor etj. Besoj në një Perëndi. Urata: Lër, ndje, fal, o Perëndi. Ati ynë, Se jotja është. Kontaqi i Pararendësit. Mëshiro, o Zot (40x). O Perëndi, që adhurohesh. Më të nderuarën. Beko, o atë. Perëndia na dhembshuroftë. Tri metanitë e mëdha. Trishenjtë. Mëshiro, o Zot (12x). Urata: O Trini e Tërshenjtë, që je pushteti. Përlëshimi dhe fillon Liturgia e të Parashenjtëruarave.

Të enjten në Mbrëmësore, *Thirrtoret*: 3 të Triodhit (Idhiomeli 2x dhe Martiriku të Pasvargjeve), dhe 3 të Pararendësit (Sot ju besimtarë; kërkoji mu në fund të shërbesës së sotme shih fq. 437). *Lavdi Koka jote, kjo enë (në po të njëjtin vend), Tani Kryqhyjlindësore e tij. Hyrje me Ungjillin*. O dritë gazmore. *Leximet*. Le të drejtohet. *Apostulli dhe Ungjilli i Pararendësit dhe Liturgia e të Parashenjtëruarave*. *Kungatore*: Në kujtim të përjetshëm.

8. Nëse bie të premtën e Javës së Parë të Kreshmëve:

Të enjten në Mbrëmësore, *Thirrtoret*: 3 të Triodhit dhe 3 të Pararendësit. *Lavdi dhe Tani Ty të lumërojmë*, o Hyjlindëse e virgjër dhe të lavdërojmë ne besnikët siç të ka hije ty, qytetin e patundshëm dhe murin që s'çahet dot, mbrojtjen e pathyeshme dhe strehën e shpirtrave tanë. O dritë gazmore. *Leximet, etj. të Triodhit*.

Të premtën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Lavdi Koka e çmuar e Pagëzorit tënd, (kërkoje në Pasvargjet e Lavdërimeve shih fq. 436) dhe Hyjlindësorja e tij. Në fund, Përlëshorja e Pararendësit. Në Mëngjesore, pas Perëndi është Zoti, Përlëshorja e Pararendësit (2x) dhe Hyjlindësorja ngjallësore (Misteri i fshehur). Ndenjësoret e Pararendësit dhe i gjithë rendi i Ungjillit të tij të Mëngjesit. Kanunet: i Hyjlindësës (shih fq. 197) dhe i Pararendësit. Zbritësoret Ja gojën e çel tani. Dërgimësoret e Pararendësit. Lavdërimet e Pararendësit. Lavdi i tij. Tani O Hyjlindëse, ti je hardhia e vërtetë, që nxore frytin e jetës; të lypim ndërmjeto, o Zonjë, bashkë me Pararendësin dhe me gjithë shenjtoret, që të mëshirohen shpirtrat tanë. Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja e Pararendësit. Në Orët (e Thjeshta), Përlëshorja dhe Kontakti i Pararendësit. Në Orën IX, pas Lumërimeve: Kori engjëllor etj. Besoj në një Perëndi. Urata: Lër, ndje, fal, o Perëndi. Ati ynë, Se jotja është. Kontakti i Pararendësit. Mëshiro, o Zot (40x). O Perëndi, që adhurohesh. Më të nderuarën. Beko, o atë. Perëndia na dhembshuroftë. Tri metanitë e mëdha. Trishenjtë. Mëshiro, o Zot (12x). Urata: O Trini e Tërëshenjtë, që je pushteti. Përlëshimi dhe fillon Liturgia e të Parashenjtëruarave.

Të premtën në Mbrëmësore. Thirrtoret: 6 të Triodhit dhe 3 të Pararendësit. Lavdi i Pararendësit. Tani Hyjlindësore dogmatike e tingullit të javës (që po kalon). Hyrje me Ungjillin. O dritë gazmore. Leximet. Le të drejtohet. Apostulli dhe Ungjilli i Pararendësit dhe Liturgia e të Parashenjtëruarave. Kungatore: Në kujtim të përjetshëm.

9. Nëse bie të shtunën e Javës së Parë të Kreshmëve (e Shën Theodorit):

Të premtën në Mbrëmësore. Thirrtoret: Idhiomeli i Triodhit (2x), 4 të Pararendësit dhe 4 të shën Theodorit (nga Triodhi). Lavdi i Triodhit. Tani Hyjlindësore dogmatike e tingullit të javës. Hyrje me temjanicë. O dritë gazmore. Leximet. Le të drejtohet dhe Liturgia e të Parashenjtëruarave. Kungatore: Shijoni dhe shihni.

Të shtunën në Mëngjesore, pas Perëndi është Zoti, Përlëshoret: e Pararendësit, e shën Theodorit dhe Hyjlindësore ngjallësore (Të gjitha përmbi mendim). Ndenjësoret: pas Stihologjisë së parë, Ndenjësoret e Pararendësit: Joan Pararendës Lavdi Çuditërisht si prej minierës Tani Nuk do pushojmë. Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësoret e shën Theodorit. Pas Polieleit, Ndenjësoret (pas Polieleit) dhe i gjithë rendi i Ungjillit të Mëngjesit të Pararendësit. Kanunet: i Pararendësit dhe i pari i shën Theodorit. Pas Odes III, Kontakti dhe Shtëpia e shën Theodorit dhe Ndenjësoret: dy të parat të Pararendësit (pa Lavdi), Lavdi i pari i shën Theodorit. Tani Hyjlindësorja e tij. Pas Odes VI, Kontakti dhe Shtëpia e Pararendësit. Sinaksari i ditës dhe i Triodhit. Zbritësoret Ja gojën e çel tani. Dërgimësoret: e Pararendësit dhe të dyja të shën Theodorit. Lavdërimet 6 (duke filluar nga Kjo lavdi do të jetë): 3 të Pararendësit dhe 3 nga Triodhi. Lavdi i Pararendësit. Tani O Hyjlindëse, ti je hardhia e vërtetë, që nxore frytin e jetës; të lypim

ndërmjeto, o Zonjë, bashkë me Pararendësin dhe me gjithë shenjtorët, që të mëshirohen shpirtrat tanë. *Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja e Pararendësit.*

Në Liturgji, Tipiket dhe nga Kanunet e Pararendësit Ode III dhe të shën Theodorit Ode VI. Pas Hyrjes, Përlëshoret: e Pararendësit, e shën Theodorit dhe e kishës. Kontaqi Mbrojtje e paturpëruar. Apostulli i shën Theodorit dhe Ungjilli i Pararendësit. Liturgjia e shën Joan Gojartit. Kungatore: Në kujtim të përjetshëm. Pas uratës mbrapa amvonit, bekimi i grurit të shenjtit. Emri i Zotit dhe Përlëshim.

10. Nëse bie të Dielën e Parë të Kreshmëve (e Orthodoxosisë):

Të shtunën në Mbrëmësore, pas Kathismës së Parë të Psaltirit, Thirrtoret: 4 ngjallësore, 3 të Triodhit dhe 3 të Pararendësit. Lavdi i Triodhit. Tani Hyjlindësore dogmatike e tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi i Pararendësit. Tani i Triodhit (d.m.th. Lavdi i tij si zakonisht). Përlëshoret: ngjallësore, e Triodhit, e Pararendësit dhe Hyjlindësore ngjallësore (Misteri i fshehur).

Të dielën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmi 50, Kanuni Triadik, Litia e Triodhit dhe Himne Triadike. Trishenjtë. Përlëshorja e Triodhit. Në Mëngjesore, Ndenjësores ngjallësore. Pas Polieleit, Ndenjësoret (pas Polieleit) e Pararendësit (Nuk lexohet Ungjilli i Mëngjesit i Pararendësit). Bekimtoret. Ipakoia. Shkallesat dhe Proqimeni i tingullit. Kanunet: ngjallësor, i Triodhit dhe i Pararendësit. Pas Ode III, Kontaqi dhe Shtëpia ngjallësore dhe Ndenjësoret: një e Triodhit, një e Pararendësit dhe Hyjlindësorja e tij. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e Triodhit. Sinaksari i ditës dhe i Triodhit. Zbritësoret Formonte me duar Moisiu; dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor i Triodhit. Dërgimësoret: ngjallësore, e Triodhit dhe e Pararendësit bashkë me Hyjlindësoren e tij. Lavdërimet: 2 ngjallësore, 3 të Triodhit dhe 3 të Pararendësit. Lavdi i Triodhit. Tani E përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji, Tipiket. Lumërimet: 4 ngjallësore, 4 nga Oda III e Triodhit dhe 4 nga Oda VI e Pararendësit. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore, e Triodhit, e Pararendësit dhe e kishës. Kontaqi Përlufteshës. Apostulli dhe Ungjilli i Triodhit dhe në vazhdim Liturgjia e Vasilit të Madh.

11. Nëse bie të hënën e Javës së Dytë të Kreshmëve:

Të dielën në Mbrëmësoren (kataniktike), në Thirrtoret nuk psalen Tropare kataniktike, por 3 të Triodhit dhe 3 të Pararendësit. Lavdi i Pararendësit. Tani O Hyjlindëse, ti je hardhia e vërtetë, që nxore frytin e jetës; të lypim ndërmjeto, o Zonjë, bashkë me Pararendësin dhe me gjithë shenjtorët, që të mëshirohen shpirtrat tanë. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i Madh. Pasvargjet e Triodhit. Lavdi i Pararendësit. Tani Hyjlindësorja e tij. Tani përlëshoje. Përlëshorja e Pararendësit dhe

Hyjlindësore ngjallësore (Misteri i fshehur). (Nuk psalen 4 troparet Gëzohu, o hirplote, etj, por Përlëshorja e Pararendësit, sepse të nesërmen do të bëhet Liturgjia e të Parashenjtëruarave).

Të hënën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Lavdi Koka e çmuar e Pagëzorit tënd, (kërkoje në Pasvargjet e Lavdërimeve shih fq. 436) dhe Hyjlindësorja e tij. Në fund Përlëshorja e Pararendësit. Në Mëngjesore, pas Perëndi është Zoti, Përlëshorja e Pararendësit (2x) dhe Hyjlindësorja ngjallësore (Misteri i fshehur). Ndenjësoret e Pararendësit dhe i gjithë rendi i Ungjillit të tij të Mëngjesit. Kanunet: i Hyjlindësës (shih fq. 197) dhe i Pararendësit. Zbritësoret Ja gojën e çel tani. Dërgimësoret e Pararendësit. Lavdërimet e Pararendësit. Lavdi i tij. Tani O Hyjlindëse, ti je hardhia e vërtetë, që nxore frytin e jetës; të lypim ndërmjeto, o Zonjë, bashkë me Pararendësin dhe me gjithë shenjtoret, që të mëshirohen shpirtat tanë. Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja e Pararendësit. . Në Orët (e Thjeshta), Përlëshorja dhe Kontakti i Pararendësit. Në Orën IX, pas Lumërimeve: Kori engjëllor etj. Besoj në një Perëndi. Urata: Lër, ndje, fal, o Perëndi. Ati ynë, Se jotja është. Kontakti i Pararendësit. Mëshiro, o Zot (40x). O Perëndi, që adhurohesh. Më të nderuarën. Beko, o atë. Perëndia na dhembshuroftë. Tri metani të mëdha. Trishenjtë. Mëshiro, o Zot (12x). Urata: O Trini e Tërëshenjtë, që je pushteti. Përlëshimi dhe fillon Liturgjia e të Parashenjtëruarave.

Të hënën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 3 të Triodhit (Idhiomeli 2x dhe Martiriku të Pasvargjeve), 3 po të Triodhit dhe 3 të Pararendësit. Lavdi i Pararendësit. Tani Hyjlindësore Ty të lumërojmë, o Hyjlindëse e virgjër dhe të lavdërojmë ne besnikët siç të ka hije ty, qytetin e patundshëm dhe murin që s'çahet dot, mbrojtjen e pathyeshme dhe strehën e shpirtave tanë. Hyrje me Ungjillin. O dritë gazmore. Leximet e Triodhit. Le të drejtohet. Apostulli dhe Ungjilli i Pararendësit dhe në vazhdim Liturgjia e të Parashenjtëruarave. Kungatore: Në kujtim të përjetshëm.

12. Nëse bie të martën e Javës së Dytë të Kreshmëve:

Të hënën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 3 të Triodhit dhe 3 të Pararendësit. Lavdi dhe Tani Ty të lumërojmë, o Hyjlindëse e virgjër dhe të lavdërojmë ne besnikët siç të ka hije ty, qytetin e patundshëm dhe murin që s'çahet dot, mbrojtjen e pathyeshme dhe strehën e shpirtave tanë. (Pa Hyrje). O dritë gazmore. Leximet e Triodhit. Pasvargjet e Triodhit. Tani përlëshoje etj. të Triodhit.

Të martën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Lavdi Koka e çmuar e Pagëzorit tënd, (kërkoje në Pasvargjet e Lavdërimeve shih fq. 436) dhe Hyjlindësorja e tij. Në fund Përlëshorja e Pararendësit. Në Mëngjesore, pas Perëndi është Zoti, Përlëshorja e Pararendësit (2x) dhe Hyjlindësorja ngjallësore (Misteri i fshehur). Ndenjësoret e Pararendësit dhe i gjithë rendi i Ungjillit të tij të Mëngjesit. Kanunet: i Hyjlindësës (shih

fq. 197) dhe i Pararendësit. Zbritësoret Ja gojën e çel tani. Dërgimësoret e Pararendësit. Lavdërimet e Pararendësit. Lavdi i tij. Tani O Hyjlindëse, ti je hardhia e vërtetë, që nxore frytin e jetës; të lypim ndërmjeto, o Zonjë, bashkë me Pararendësin dhe me gjithë shenjtoret, që të mëshirohen shpirtrat tanë. Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja e Pararendësit. Në Orët (e Thjeshta), Përlëshorja dhe Kontakti i Pararendësit. Në Orën IX, pas Lumërimeve: Kori engjëllor etj. Besoj në një Perëndi. Urata: Lër, ndje, fal, o Perëndi. Ati ynë, Se jotja është. Kontakti i Pararendësit. Mëshiro, o Zot (40x). O Perëndi, që adhurohesh. Më të nderuarën. Beko, o atë. Perëndia na dhembshuroftë. Tri metani të mëdha. Trishenjtë. Mëshiro, o Zot (12x). Urata: O Trini e Tërshenjtë, që je pushteti. Përlëshimi dhe fillon Liturgjia e të Parashenjtëruarave.

Të martën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 3 të Triodhit (Idhiomeli 2x dhe Martiriku të Pasvargjeve), dhe 3 të Pararendësit (Sot ju besimtarë; kërkoji mu në fund të shërbesës së sotme shih fq. 437). Lavdi Koka jote, kjo enë (në po të njëjtin vend), Tani Kryqhyjlindësore e tij. Hyrje me Ungjillin. O dritë gazmore. Leximet. Le të drejtohet. Apostulli dhe Ungjilli i Pararendësit dhe Liturgjia e të Parashenjtëruarave. Kungatore: Në kujtim të përtjetshëm.

13. Nëse bie të mërkurën e Javës së Dytë të Kreshmëve:

Të martën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 3 të Triodhit dhe 3 të Pararendësit. Lavdi i Pararendësit. Tani Kryqhyjlindësorja e tij. O dritë gazmore. Leximet e Triodhit. Pasvargjet e Triodhit etj. të Triodhit.

Të mërkurën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Lavdi Koka e çmuar e Pagëzorit tënd, (kërkoje në Pasvargjet e Lavdërimeve, shih fq. 436). Tani O Hyjlindëse, ti je hardhia e vërtetë, që nxore frytin e jetës; të lypim ndërmjeto, o Zonjë, bashkë me Pararendësin dhe me gjithë shenjtoret, që të mëshirohen shpirtrat tanë. Trishenjtë. Përlëshorja e Pararendësit. Në Mëngjesore, pas Perëndi është Zoti, Përlëshorja e Pararendësit (2x) dhe Hyjlindësore ngjallësore (Misteri i fshehur); Ndenjësoret e Pararendësit dhe i gjithë rendi i Ungjillit të Mëngjesit të Pararendësit. Kanunet: i Hyjlindëses (shih fq. 197) dhe i Pararendësit etj. Zbritësoret Ja gojën e çel tani. Dërgimësoret e Pararendësit. Lavdërimet e Pararendësit. Lavdi i tij. Tani O Hyjlindëse, ti je hardhia e vërtetë, që nxore frytin e jetës; të lypim ndërmjeto, o Zonjë, bashkë me Pararendësin dhe me gjithë shenjtoret, që të mëshirohen shpirtrat tanë. Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja e Pararendësit. Në Orët (e Thjeshta), Përlëshorja dhe Kontakti i Pararendësit. Në Orën IX, pas Lumërimeve: Kori engjëllor etj. Besoj në një Perëndi. Urata: Lër, ndje, fal, o Perëndi. Ati ynë, Se jotja është. Kontakti i Pararendësit. Mëshiro, o Zot (40x). O Perëndi, që adhurohesh. Më të nderuarën. Beko, o atë. Perëndia na

dhembshuroftë. *Tri metani të mëdha. Trishenji. Mëshiro, o Zot (12x). Urata: O Trini e Tërëshenjtë, që je pushteti. Përlëshimi dhe fillon Liturgia e të Parashenjtëruarave.*

Të mërkurën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 6 të Triodhit dhe 4 të Pararendësit, d.m.th. të tria, duke përsëritur të parën (Sot ju besimtarë; kërkoji mu në fund të shërbesës së sotme shih fq. 436). Lavdi Koka jote, kjo enë (në po të njëjtin vend), Tani Hyjllindësore e tij. Hyrje me Ungjillin. O dritë gazmore. Leximet e Triodhit. Le të drejtohet. Apostulli dhe Ungjilli i Pararendësit. Kungatore: Në kujtim të përjetshëm.



NË MBRËMËSORE

*10 Thirrtoret: Idhiomeli i ditës (2x)
dhe Martiriku i tij, 3 po të Triodhit
dhe 4 të Pararendësit:*

Ting. Tërth. I Heris askitikón

G'zohu, o kokë që dritë sjell,* e shenjtë je edhe nderuar prej engjëjve;* qëmoti të preu shpatë,¹ por me qortimin e prer'* ke ndërprerë turpe kurvërie ti,*² burim je që me çudi* i vadit besimtarët krejt* dhe shpalle ardhjen* shpëtimtare të Zotit Krisht,*³ dhe e njohe qart'* fluturimin e Shpirtit Shenjt* që mbi atë banoi,⁴ ndërsa ti ishe pikërisht* mes Hirit pra të së Vjetrës dhe të së Resës;⁵ Jisuin lyp* që shpitrave tanë* t'iu dhurohet përdëllimi i madh^{5a} me dhembshuri.

(2x)

Koka e Pagëzorit Joan* dikur qe fshehur në një shtambë, por doli jasht'* nga barku i dheut haptas edhe

buron si rrëke* plot shërime, me që brenda ujit krejt* i ka larë kryet kjo* të atij që strehon tani* shtresat e larta* përmes ujit⁶ dhe hedh si shi* përmbi njerëzit* ndjesën, faljen hyjnore pra;* ta lumërojmë kokën, se vërtet e kënduar është'* dhe të kremtojmë për gjetjen e saj me gaz, se te Krishtit Zot* lyp dhe përgjërohet* të dhurohet përdëllimi i madh^{5a} mbi rruzullin.

Lindi si diell koka mbi ne,* e cila shpalli se u shfaq si njeri me mish,*⁷ pra Qengji i Perëndisë;⁸ dhe udhët e metanis'* shpëtimtare na i siguroi fort* me fjalë të hyjshme krejt;*⁹ më përpara qortoi rrept'* paligjësinë* e Irodhit,² ndaj dhe u pre*¹ dhe për shumë koh'* fsheheje thellë pësoi kjo;* si diell lindi me ndriçim të plotë dhe na thërret:* Shkoni tek Zoti dhe shtohuni¹⁰ me pendim⁹ dhe me kataniks* në shpirt; tek të gjithë* po dhuron dhe përdëllimin e madh^{5a} me dhembshuri.

Lavdi

Ting. Tërth. II I Anatoliut

Si thesar dhuratash hyjnore lindi kryeja jote që ruhet nga Perëndia, nga barku i dheut, o Prodhrom; pasi e nxorëm ne me besim dhe i falemi, pasurohemi falë teje, o Pagëzor i lavdëruar i Krishtit, me çuditë paradoksale dhe ndjesën e shkeljeve.

Tani *Hyjlindësore*

Ndryshim i të hidhëruarve, çlirim i të sëmurëve je, o Hyjlindëse Virgjëreshë; shpëto qytetin dhe popullin, o paqja e atyre që luftohen, qetësia e atyre që jan' në dimër, mbrojtje e vetme e besnikëve.*

ose Kryqhyjlindësore
Triimeros anestis Hristé

Kur shihte që po varej në dru* Hyjlindësja që s'kish qortim,* jetën tonë,* po thërriste me vajtim* si nënë: O im Bir edhe Perëndia im Zot, shpëto ata që të himnojn' me mall.

Leximet e Triodhit

Pasvargjet e Triodhit, por:

Lavdi

Ting. II I Anatoliut

Koka jote, kjo enë e tërënderuar e kuptimeve hyjnore, që parashikoi fuqishëm misterin e esencës së parrëfyeshme,⁴ lindi sot nga arkat e tokës si nga barku nënor, o Joan

i tërëfamshëm, dhe aromatizoi planetin mbarë duke derdhur miroshenjtërimi, duke predikuar mendërisht udhë¹¹ pendimi⁹ dhe duke ndërmjetuar pranë Shpëtimtarit të të gjithave për shpirtrat tanë.

Tani *Hyjlindësore*

Gëzohu, o shpresa jonë, Hyjlindëse e pacenuar; gëzohu ti, që me anën e engjëllit pranove "Gëzohu-n";¹² gëzohu ti, që linde vezullimin e Atit;¹³ gëzohu, o e bekuar e thjeshtë, Virgjëreshë e Tërëshenjtë, e vetmja e tërëhimnuar; të lavdëron gjithë Krijesa ty, nënën e dritës.¹⁴

ose Kryqhyjlindësore
Ote ek tu ksilu se nekrón

Kur pe* që po varej përmbi dru,* ti o e kulluar, bistaku i pjekur me ëmbëlsi,* që pa kultivim në mitër e ke mbajtur, Vajz',* me vajtime thërrisje dhe me klithma: O im Bir,* mirëbërës Krisht, piko musht dhe me të dehje* vesesh do të hiqet, kështu pra* dhembshuria jote do shfaqet* përmes meje që të linda, Zoti im.

Përlëshore

Ting. IV Tahí prokatálave

Pasi na ka lindur që nga dheu koka e shenjt'* e shën Pararendësit, tek besimtarët lëshon plot rreze që s'prishen dot,* edhe shërime; lart mbledh* tërësin' engjëllore,* po-

shtë gjininë tonë njerëzore e fton tok* me një zë lavd Krishtit Perëndi t'i drejtojmë ne.

Dhe Hyllindësore



NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësore
Ting. IV Tahí prokatálave*

Joan Pararendës, profet, thesarin hyjnor* të fshehur në dhé na e zbuloi Krishti yt, kokën tënde; të mbledhur tok* gjithë për gjetjen e saj* me psalmim, himn hyjfolës* e përhimnojmë Zotin Shpëtimtar që nga prishja* gjithnjë na shpëton me ndërmjetimin tënd, Pagëzor.

Lavdi *dhe* Tani
Hyllindësore

Arri ti shpejt, para se të skllavërohe- mi ne* nën zgjedhë armiqsh që ty të blasfemojnë dhe kërcënojnë, o Zoti yn'* dhe asgjëso me Kryqin* gjithë sa na luftojnë;* ta dinë si mund besa orthodhokse e fortë,* o Krisht, për- mes ndërmjetimeve të Hyllindësës.

*Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësore
Ting. IV O ipsothis en to stavró*

Çuditërisht si prej* minierës së- rish del* si ari kryeja* e shenjtë nga poshtë,* prej tokës, pasuron të gjith' sa rendin me mall* gjatë gjetjes së

asaj edhe* madhështojnë Ndërtue- sin,* Shpëtimtarin, që u jep përmes teje atyre,* o Pagëzor i lum i Krishtit Zot,* ndjesë mëkatesh,* mëshirë të pasur fort.

Lavdi *dhe* Tani
Hyllindësore

Nuk do pushojmë ne,* Hyllindëse, kurrë* që të himnojm' me gaz* nga zemra, o Zonjë,* ne shërbëtoret e tu përdëllimet që ke,* duke thirrur pra me zë të madh:* E fortshenjtë e virgjër,* ti arri dhe na çliro* nga ar- miq të padukshëm* dhe nga nevojat dhe çdo kërcënim,* se ti je shtreha,* përkrahja dhe ndihma jon'.

*Pas Polieleit, Ndenjësore
Ting. IV Epefanis símeron*

Pagëzor, Irodhi mbret* paligjesisht² pret* kryen tënd të çmueshëm* me shpatë¹ tmerrshëm si i marr'* nga epshi,² më kot i mjeri ky,* ne besim- tarët me mall puthim kryen tënd.

Lavdi *dhe* Tani
Hyllindësore

Moisiu ferrën pa* të ndezur, pra ty,* që e mbajte zjarrin Krisht,* i cili shpirtrat i ndriçon* dhe nuk u dogje,¹⁵ përkundrazi,* me vesë Hiri u mbushe, o e pacen.

*Shkallesat. Antifoni i parë i Ting. IV
Proqimëni Ting. IV*

Atje do të lind bri për Davidin, përga-

tita kandil për të lyerin tim.

Varg: Kujto, o Zot, Davidin dhe gjithë butësinë e tij.

Ungjilli. Psalmi 50.

Lavdi. Me ndërmjetimet e Pagëzorit tënd. Tani. Me ndërmjetimet e Hyjlindëses. Përdëllemë, o Perëndi. *Dhe Idhiomeli.*

Ting. II I Anatoliut

Koka jote, kjo enë e tërënderuar e kuptimeve hyjnore, që parashikoi fuqishëm misterin e esencës së parrëfyeshme,⁴ lindi sot nga arkati e tokës si nga barku nënor, o Joan i tërëfamshëm, dhe aromatizoi planetin mbarë duke derdhur miroshenjtërimi, duke predikuar mendërisht udhë¹¹ pendimi⁹ dhe duke ndërmjetuar pranë Shpëtimtarit të të gjithave për shpirtrat tanë.

Kanuni i Pararendësit bashkë me Imoset në 6 dhe i Triodhit si zakonisht.

Kanuni i Pararendësit

Ting. Tërth. II

Ode I

Irmosi: Os en ipiro pezefsas

»**S**i në sterë Izraeli kaloi leht'* dhe »më këmbë, duke par'* Faraonin, »ndjekësin* mbrapa gjurmëve të »tij,* të zhytej; thërriste: Zotit t'i »këndojm' këng' mundëse.¹⁶

Zërin që rend para Fjalës,¹¹ o besi-

mtar',* ejani ta mburrim ne* me himninin shpirtëror*¹⁷ dhe me buzë pa cenim* me gjuhë lëvduese, e fuqizuar prej Shpirtit.

Është në gjendje të paqtë dhe qetësi*, me çuditë pa kufi,* Kisha¹⁸ e Jisuit Krisht* edhe kjo qëndrueshëm* kullohet, dhe të thërret për vit, Joan, me zë këngë.

O tërësi e besnikëve, ta nderojm'* denjësisht me këngë, himn,* kokën krejt hyjprurëse* të Joanit Pagëzor;* nga Zoti u dha tek ne si një thesar që s'vidhet dot.

Hyjlindësore

Meqë Gatuesin prite, o e dëlir',* siç e deshi mbi mendim,* kur po mishërohej ky* pafarisht nga barku yt,* u duke vërtet ti Zonja e gjithë krijesave.

Zbritësore: Anikso to stoma mu
Ja gojën e çel tani (*shih fq. 449*)

Ode III

Irmosi: Uk estin ajios os si

»**N**uk ka të shenjtë pra si ty* o Perë- »ndia im, Zot,* që e ngrite lart bririn »e besnikëve të tu* dhe na forcove¹⁹ »të gjith',* o i mir', mbi gurin e pohi- »mit²⁰ tënd.

Ty barku shterp te Zoti Krisht* dhe

Perëndi vërtet, Zot,* Dhëndër, të solli si lastar të hyjshëm plot me hir* për Kishën e kombeve,*²² porsimbles²³ që e fejove me atë.

O Pararendës shën Joan,* shkelësja fort mizore* e kurorës s'e ndali as me shpatë zërin tënd* hyjfolës,¹ se na e shfaq* kryen tënd të hyjshëm që nën dheun ish.

Qyteti që ka mall për ty* bën panair me plot gaz* dhe dëfren se ka gjetur kryen tënd si pasuri* mistike dhe si burim* të pasosur me shërime, o Prodhrom.

Hyjindësore

Çdo rregull të natyrës son'* e tejkalon çudia,* e dëlirë, e lindjes sate, se në bark ke zën'* mbi mendje Zot Perëndi* dhe pas lindjes mbetesh Virgjëresh' gjithnjë.

Zbritësore: Tus sus imnologus

O Zonjë dhe nën' e Perëndisë

Ndenjësore

Ting. IV To prostahthén mistikós

Depozitohej porsim thesar në arkë,* po ruhej koka* e Prodhromit, kur në shtambë* u fsheh zëri i Fjalës;*¹⁶ si grur' që u fut thell'* në tokë, u ngrit dhe solli me begati,* si frut²⁴ jetën krejt të hyjshme;* tok gjithë ne* ta nderojm' gjetjen e asaj, ta mburrim Krishtin Zot që i dha hir të burojë

çurg* si shërime edhe bekim.

Lavdi Ingjashëm

Në shtambë koka e shenjt' e Pa-gëzorit* qe fshehur nën dhé* si margëzitar, por që feks* si kandil hyjndriçues* me lavd tërë botën;* çudi bën, me hijeshi lindi si agim;* porsim Pararendës para* Diellit Krisht,* dhe me dritë që s'perëndon, na lajmëron përsëri edhe thërret: Shikoni, ja* ky është' Qengji i Perëndis'.⁸

Tani Hyjindësore

Si mori vesh porosin' e perëndishme, engjëlli zbriti në banesën e Josifit, dhe ia pruri Marisë menjëherë lajmin; anoi me bashkëzbritjen qjellin²⁵ mbi dhé, kur hyri i pandryshuar në gjirin tënd, dhe atë kur e shoh me sy të mishëruar si rob²⁶ çuditem dhe thërres me zë: Gëzohu, o Nuse e panusëruar.^{12*}

Ode IV

Irmosi: Hristós mu dhínamis

»Fuqia ime është Krishti Perëndi,*²⁸
»psal me mendje të pastër dhe i thë-
»rret* Kisha jonë e nderuar Zotit siç
»e meriton* dhe feston në Krishtin
»me hare.

U bëre dukshëm vula e Dhiatës së Vjetër dhe mbarim profetësh, o Pararendës²⁹ i tërëpasur, por edhe përgatitësi i nderuar i nuses,²³ të së Resë.

O Pararendës, durove të mbulohej thjeshtësisht koka jote e çmuar dhe famëmadhe me rrecka të leshta,³⁰ duke u ngazëlluar ti si me robë, mantel mbretëror.

O Prodhrom i urtë, ndërmjeto për qytetin që të nderon përherë, të hijeshohet me shkëlqimin e Shpirtit Hyjnor dhe të ngazëllohet së bashku me engjëj në kujtimin tënd.

Hyjlindësore

Shijimi i drurit më tregoi të vdekur,³¹ kurse druri i jetës³² kur u duk prej teje, o e Tërëkulluar, më ringriti dhe më bëri trashëgimtar të Parajsës së shijimit.

Zbritësore: Tin aneksihniaston thian vulin

Të pagjurmësuarin plan

Ode V

Irmosi: To thio fegji su Agathé

»**M**e drit' hyjnore, i mirë ti,* shpirt-
»trat e atyre që po mëngojnë³³ me
»mall për ty shndrit, – të lyp –,* të
»të njohin, Fjalë e Perëndis', Zot³⁴
»vërtet,* që rithërret nga mjegulla e
»mëkateve.

O Pagëzor, nuk ishe kallam që lëkundeshe sakaq nga filladet³⁵ ngasëse të keqdashësit, po pirg i patundur i popullit të hyjnueshëm, sepse u pe me fuqinë dhe shpirtin e Ilias.³⁶

Drejtësisht dëbohet nga oborret e hyjshme ai që mohon Hyjninë dhe pakëson lavdinë e Krishtit, që u pagëzua prej teje, dhe përvetëson hirin tënd hyjnor.

O Pagëzor i kënduar, e hape për ne që të himnojmë me aspiratë portën e burimit të pakursyer të Hirit të hyjshëm, i cili gufon rrjedhje dhe rrëke shërimesh, që i dëfrejnë të gjithë.

Hyjlindësore

O modeste, duke u veshur me stolinë mendore të shpirtit tënd tejet të bukur, u bëre nuse Perëndie, e vulosur fort me virgjëri duke hijeshuar kozmosin me dritën e dëlirësisë.

Zbritësore: Eksesti ta simpanta

Të gjith' i habite ti

Ode VI

Irmosi: Tu viu tin thálasan

»**J**a detin e jetës tash* e shikoj
»të ngrihet prej furtune ngasjesh
»ashpërsisht,* te limani yt shumë i
»qetë rend edhe të thërras: Ma ngri*
»shpirtin tim, o mëshirëplot, nga
»prishja pra.³⁷

Të tha i Vërteti Krisht* ty profet, dhe më të lart'* përmbi profetët, o Joan*³⁸ Pagëzor, Pararendës³⁹ i jetës son',*⁴⁰ sepse pe atë, që than'* që më parë profetët edhe Ligji tok.

S'duronte të fshihej dot,* o profet dhe Pagëzor,* dhe Pararendës, kreu yt* i kënduar, burimi i mrekullis',* thesari i Hirit Shenjt,* ndaj u duk edhe derdh shërime si burim.

Si mburrje me pasuri,* si lavdi me hijeshi,* mburoja shpëtimtare krejt,* ky qyteti yt krishtdashës, famëmadh,* tregon kryen tënd të shenjt'* të nderuar, o Pararendës Pagëzor.

Hyllindësore

O nënë e virgjër krejt,* Moisiu madhështor* midis profetëve, më par'* të përshkroi si arkë,⁴¹ kandil,⁴² tryez'*⁴³ dhe shtambë⁴⁴ simboli-kisht;* mishërimin e Zotit nga ti shfaqte pra.

Zbritësore: Tin thian taftin

Këtë të kremte

Kontaqi

Ting. II Ta ano zitón

Pasi gjetëm ne* prej tokës si një trëndafil* të hyjshëm me gaz,* pra kokën tënde, o profet* i Jisuit Zotit, o Pararendës Hiri, shërime plot* gjithnjë marrim, se si më par'* në botë pendim⁹ dhe korrigjim predikon.

Shtëpia

Kur e more prej Zotit dëshminë, o Joan i tërëfamshëm, tri herë i pasur, u bërë më i lartë se të gjithë vdeka-

tarët;⁴⁵ ndaj kam frikë të të ofroj lavdërimet e mburrjeve; mirëpo, më që u shtrëngova nga mallëngjimi, guxova dhe tentova të thur oden; për këtë mos shpërfill të më bëhesh bashkëpunëtor, që të arrij t'i kurorëzoj kryet e tu të shenjtë, sepse në botë pendim⁹ dhe korrigjim predikon.

Sinaksari

Më 24 të të njëjtit muaj, kujtimi i gjetjes së kokës së çmuar të profetit të shenjtë, Pararendës dhe Pagëzor Joanit.

Vargje: Nxjerr në pah prej dheut Prodhromi kokën e nderuar,/ duke na nxitur përsëri të bëjmë fryte të vyerë.⁴⁶

Ti që më përpara pagëzove turma në burime ujërash,/ si u duke nga dheu, pagëzo me burime çudish.

Rreth njëzet e katrës u shfaq krye e Pararendësit.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atit tonë oshënar, Erazmi i Lavrës së Shpellave të Kievit.

Me ndërmjetimet e Prodhromit tënd dhe të oshënarit, o Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII

Irmosi: Dhrosovolon men tin káminon

»**E**ngjëll furrën vesëprurëse e bëri
»për Djemt' oshënarë, ndërsa kal-
»denjt'* me një urdhër që* Perëndia

»dha, u dogjën krejt.*⁴⁷ Tirani u
»bind, ndaj të thërret:* Je i bekuar
»ti, o Perëndi⁴⁸ i etërve tan'.

Lastari i Virgjëreshës të quajti për-
mbi të gjithë ata që lindën prej
grash,⁴⁵ sepse si një i patrup dhe i
barabartë me engjëj, u solle mbi dhë
për hirin e tij, duke thirrur: I bekuar
je, o Perëndi i etërve tanë.⁴⁸

Nga mitra shterpe²¹ njohe atë që
fushoi në mitrën e së Virgjërës, dhe
pasi përdore zërin nënor, duke u he-
dhur⁴⁹ i thërrisje, o Pararendës: I
bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.⁴⁸

Me të vërtetë u lumërua mes qytete-
ve ky qytet që të ka tani mbrojtës, o
Pararendës i tërëkënduar i Krishtit;
për këtë duke kremtuar thërret: I
bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.⁴⁸

Hyjlindësore

Me anën tënde, o Nënë e virgjër e
tërëkulluar, i lindi dritë e hijshme rru-
zullit mbarë, sepse ti linde Perëndinë,
Ndërtuesin e të gjithave,⁵⁰ kërkoi atij
që të na dërgojë poshtë neve shpre-
sëplotëve përdëllimin e madh.^{5a}

Zbritësore: Uk elátrefsan

Nuk u faleshin

Ode VIII

Irmosi: Ek flogós tis osiis

»**V**es' burove prej flakës tek oshëna-
»rët ti,*⁴⁷ dhe e dogje flijimin e
»një të drejti⁵¹ shkrumb;* vetëm
»me vullnetin tënd, o Krisht, bën
»çdo gjë⁵² ti;* ne në gjithë jetët të
»përmbilartësojmë.

U dërgua Pararendësi, zëri i njërit
që thërret, duke shartuar zemrat e
shkreta¹⁶ me besimin e mirë të Birit
të Perëndisë, të Perëndisë të vërte-
të,³⁴ të cilin e përmbilartësojmë në
gjithë jetë.

Thotë dhe tani Prodhromi: Përgati-
sni udhën e Zotit¹¹ nëpërmjet she-
njtërimit, sepse ai duke ardhur së
bashku me Atin dhe me Shpirtin, do
të banojë në zemrat⁵³ tuaja në jetë.

Kur Joan Pararendësi vuri mbi ty
dorën, o Krisht, u mbush hyjnisht në
dëgjim përmes zërit të Prindit, në sy
përmes pamjes së Shpirtit Hyjnor
dhe i tëri përmes prekjës.⁵⁴

Hyjlindësore

Kandil dritartë⁴² të paraikonizoi ty,
që pranove në mënyrë të parrëfye-
shme dritën¹⁴ e paafruar,⁵⁵ që me
njohjen e saj feks tejet Gjithësinë;
për këtë të himnojmë, o e kulluar, në
jetë.

Zbritësore: Pedhas evajís

Djemat e dënuar

*Ode IX**Irmosi: Theón anthropis*

»Nuk munden Zotin ta shohin njerë-
 »zit,⁵⁶ që rreshta engjëjsh s'kan'
 »guxim ta shohin,⁵⁷ veçse nga ti,* e
 »dëllirë, njerëzve u duk ky njeri* Fjala
 »e mishëruar,⁵⁸ e madhështojmë
 »ne,* dhe të lumërojmë me ushtritë
 »engjëllore tok.

O Pararendës u bëre ruajtës,*
 mbrojtës i dhjetë porosive haptas, se
 kishe forc',* ndaj siç duhej Krishti të
 nderoi me lavd* dhe me dhjetë dhu-
 nti tani pra të dimë ty* si mist edhe
 mik të Fjalës²³ dhe të lumërojmë ne.

U bëre engjëll, apostull dhe profet*
 i Krishtit,¹¹ Pagëzor, martir besnik,
 Pararendësi* para mishërimit krejt
 hyjnor³⁹ dhe për sa* ishin në Hadh
 një predikues, si dhe kanun* mur-
 gjish për sa virgjërinë mbajnë, fryt
 në shkretëtir'.

Dënohet rrept' mosbesimi shpirtë-
 ror* i priftit, që përmes çudisë pra
 dora krejt iu tha,* por që iu shëndosh
 atij sërish me besim* se, o i lumur,
 kur u shfaq koka jote prap',* mori
 gjallëri pëllëmba që më parë ish me
 cen.

Hyllindësore

Le të vrapojmë të nxjerrim pra
 shërim* për çdo sëmundje brenda
 kishës zëmadhe, se atje* janë të

pranishme kore engjëjsh pa trup,*
 shpirtra të drejtësh edhe Zonja e
 Gjithësis',* që me Pagëzorin shën
 Joan shpërndan shërime plot.

*Zbritësore: Apas jijenís***Gjithë** njerëzit*Dërgimësore**Tis mathitēs sinélt homen*

O Pagëzor profet Prodhrom,* nga
 gjiri i nëndheut* linde shkëlqyer
 kryen tënd* tepër të çmuar, se je*
 kandil i dritës⁵⁹ pa lëndë;* duke
 kremtuar me mall* për gjetjen e
 saj, lypim ne* që të gjejm' zgjidhje
 tmerresh dhe të kalojm'* lehtë
 periudhën pra të përmbajtjes* me
 ndërmjetimin tënd, Joan* me nam i
 Shpëtimtarit.

Hyllindësore

O e dëllirë, të nderon* me besë të
 himnon ty* Hyllindësen e vetme
 Zonj'* mbledhja jon' shpresëtare,*
 edhe dëfren; ndërmjeto ti* që ta
 mbarojmë stadin* për Zotin tonë
 denjesisht,* udhën e ngusht' të
 kreshmës, ta puthim ne* kryqin fort
 të çmuar si dhe pësimit* krejt shpë-
 timtar të Birit tënd* t'i falemi me
 mall ne.

*Lavdërime**Ting. IV 'Edhokas simíosisn*

Koka jote çeli hyrjen e përmbajtjes,
 të kreshmës pra,* o zëmadh, edhe

shtroi drejt* përpara të gjithëve* një shijim të ëmbël* me dhunti të hyjshme që kur kungojmë me besim* e ëmbëlsojm' kreshmën që ka ashpërsi* dhe të lëvdojmë besërisht edhe thërrasim te Krishti Zot:* I fuqishëm je, o Jisu,* Shpëtimtari i shpirtrave.

(2x)

Koka e Prodhromit po pikon gjithnjë miro si rrëke;* mbi tryezë mistike krejt* të hyjshme sot u vendos,* aromatizon pra* mendërisht dhe flak neveritje tmerresh dhe shtrëngim,* dhe mbush me gaz çdo njeri që plot me mall* lëvdon profetin më të madh edhe nga zemra thërret kështu:* I fuqishëm je, o Jisu,* Shpëtimtari i shpirtrave.

Koka jote si një shpat' brisk krerët e kundërshtarëve* të paudhë i preu⁶⁰ fort,* ndërsa për ata që rrojn'* ligjërisht, buroi* rrjedhë me karizma të hyjshëm, ndaj ne besërisht* të lavdërojmë si Pararendësin* dhe mikun²³ e Ndërtuesit, dhe i thërrasim kudo, Joan:* I fuqishëm je, o Jisu,* Shpëtimtari i shpirtrave.

Lavdi *Ting. Tërth. II*

O Zot njeridashës, pasi e nxorëm me zë himnimi⁶¹ besërisht kokën e tërënderuar të Pagëzorit tënd, e cila u shfaq sot nga dheu, ne shërbëtorët e tu fajtorë, duke e sjellë për ndërmjetim, kërkojmë që më anën e saj të arrijmë prej teje në ditë

gjykimi⁶² zbutjen tënde dhe përdëllimin e madh.^{5a}

Tani *Hyjlindësore*

Triimeros anestis Hristé

O Mirëdashës Zot Shpëtimtar,* shpëto shërbyesit e tu* prej llahtarësh* dhe peripecive ti* me lutjet, ndërmjetimet e nënës sate edhe* të shën Prodhromit dhe gjith' shenjtëve.

Në Pasvargjet, Idhiomeli i Triodhit

(2x) dhe Martiriku. Pastaj:

Lavdi *Ting. Tërth. II*

Koka e çmuar e Pagëzorit tënd, o Zot, që më parë qortoi mbi pjatë⁶³ neveritjen ilegale të Irodhit, porsa iu predikoi të gjithë shpresëplotëve pendimin,⁹ pasi u duk prapë nga arkat e dheut, qëndron para atyre që i afrohen me besim, e prekin me frikë dhe i falen me aspiratë në shpirt, dhe jep si çmim zgjidhje shkeljesh, dhe dhuron shpëtimtaret që kërkojnë dhe përdëllimin e madh.^{5a}

Tani *Hyjlindësore*

O Hyjlindëse, ti je hardhia e vërtetë, që nxore frytin e jetës; të lypim ndërmjeto, o Zonjë, bashkë me Pararendësin dhe me gjithë shenjtoret, që të mëshirohen shpirtrat tanë.

Dhe të tjera me tri metanitë e mëdha si zakonisht. Në Orët (e Thjeshta), Përlëshorja dhe Kontaqi i Pararendësit.



NË MBRËMËSOREN E SË NJËJTËS DITË

10 Thirrtoret: Idhiomeli i Triodhit (2x) dhe Martiriku, 3 të Triodhit dhe 4 të Pararendësit:

Ting. II Ote ek tu ksilu se nekrón

Sot ju* besimtarë, ejani* ta nderojmë kokën e çmuar të Pagëzorit Joan,* që e preu shpata;¹ le ta mburrim plot me mall* ne në gjetjen e saj, ta mirëpresim me këngë,* se na derdh plot hir shërimesh; e ka prerë pra* mbret mjeran, Irodhi, kur epshe* kishte të bashkohej qëmoti* me Irodhiadhën imorale krejt.²

(2x)

Siç feks* nga miniera kur ar del,* ja ku vezulloi nga nëndheu koka brenda në shtamb',* kryet e Prodhromit, dhe fuqishëm flet, qorton* mbret Irodhin për shkeljen e kuro-rës² dhe vrasjen;*¹ mendjet tona i shkëlqen me shndritje dhe me hir,* sot pra ta nderojmë me himne* edhe me besim le ta puthim,* se pran' Perëndisë ndërmjeton për ne.

Koka* e Joanit Pagëzor* fshihej në një shtambë qëmoti në dhé porsi një thesar* krejt i hyjshëm, por zbulohet për besnikët sot.* Pasuri është, derdh burim kurimesh, shëron pra* trupat nga sëmundjet dhe shndrit shpirtrat, ndaj dhe ne* hir euforie të plotë* duke e shijuar, me himne* e devotshmëri ta lavdërojm' atë.

Lavdi

Ting. II I Anatoliut

Koka jote, kjo enë e tërënderuar e kuptimeve hyjnore, që parashikoi fuqishëm misterin e esencës së parryfeshme,⁴ lindi sot nga arkat e tokës si nga barku nënor, o Joan i tërëfamshëm, dhe aromatizoi planetin mbarë duke derdhur miroshenjtërimi, duke predikuar mendërisht udhë¹¹ pendimi⁹ dhe duke ndërmjetuar pranë Shpëtimtarit të të gjithave për shpirtrat tanë.

Tani *Hyjlindësore*

Ote ek tu ksilu se nekrón

Frika* e tundimeve çdo lloj* si edhe shtrëngata nevojash më sjellin dimrin tani,* po fundosem, më mbulon thell', ankth e dëshpërim,* dhe stuhia e fajeve që kam më trazon tmerr,* shpejt arri, çliromë mua që tronditem fort,* ti je qetësia e vetme* e besnikut edhe lart futmë,* në limanin e të shenjtit trashëgim.

ose Kryqhyjlindësore

Vvajzë,* po lotoje me vajtim* dhe pësoje dhimbje të shumta, rënkoje thellë në shpirt* kur po kryqëzohej Biri yt dhe Perëndi,* fort e shenjtë e pacen, thoshe: "Mjer', Bir i ëmbël,* si padrejtësisht po vuan, varesh përmbi dru,* ti që dheun mbarë e mbush plot*"⁶⁴ Ndaj të lypim, Zonjë, me besë* zbutë ti atë me dhembshuri për ne.

Hyrje me Ungjillin. O dritë gazmore. Leximet e ditës. Le të drejtohet dhe menjëherë Apostulli dhe Ungjilli i Pararendësit dhe Liturgjia e të Parashenjtëruarave.

CITIME

¹ Matth. 14.10; Mark. 6.28; Lluk. 9.9
² Matth. 14.3-4; Mark. 6.17-18; Lluk. 3.19
³ Matth. 3.11; Mark. 1.7; Lluk. 3.16
⁴ Matth. 3.16; Mark. 1.10; Lluk. 3.22
⁵ Joan 1.16-17
^{5a} Num. 14.19 etj.
⁶ Ps. 103(104).3
⁷ I Tim. 3.16
⁸ Is. 53.7; Joan 1.29,36; Vep. 8.32; I Petr. 1.19
⁹ Matth. 3.2; Mark. 1.4; Lluk. 3.3
¹⁰ Jov 32.13; Vep. 11.24
¹¹ Is. 40.3-4; Matth. 3.3; Mark. 1.2-3; Lluk. 3.4; Joan 1.23
¹² Lluk. 1.28
¹³ Urt. Sol. 7.26; Hebr. 1.3
¹⁴ Joan 1.4,9; 3.19; 8.12; 9.5; 12.46
¹⁵ Eks. 3.2-5
¹⁶ Eks. 15.1-19
¹⁷ Ef. 5.19
¹⁸ Vep. 9.31
¹⁹ I Mbret. [Sam.] 2.1-2
²⁰ Matth. 16.16-18
²¹ Lluk. 1.7,18
²² Lluk. 3.12-13
²³ Joan 3.29
²⁴ Joan 12.24-25
²⁵ II Mbret. [Sam.] 22.10; Ps. 17(18).10; 143(144).5
²⁶ Fil. 2.7
²⁷ I Kor. 1.24

²⁸ Abak. 3.19; Joan 20.28
²⁹ Matth. 11.13
³⁰ Matth. 3.4; Mark. 1.6
³¹ Gjen. 3.6-19
³² Gjen. 3.22
³³ Is. 26.9
³⁴ Joan 1.1
³⁵ Matth. 11.7; Lluk. 7.24
³⁶ Lluk. 1.17
³⁷ Jona 2.7
³⁸ Matth. 11.9; Lluk. 7.26
³⁹ Lluk. 1.24-26
⁴⁰ Joan 11.25; 14.6 ; Kol. 3.4; I Joan 1.2; 5.12,20
⁴¹ Eks. 25.9-20; 38.1; Ligji i Dytë 10.2; Ps. 131(132).8; Hebr. 9.4
⁴² Eks. 25.30-37; 35.16; 38.13; 40.22; Num. 4.9; 8.2; Hebr. 9.2
⁴³ Eks. 25.29; 39.18; 40.20; Lev. 24.6; Hebr. 9.4
⁴⁴ Eks. 16.33; Hebr. 9.4
⁴⁵ Matth. 11.11; Lluk. 7.28
⁴⁶ Matth. 3.8; Lluk. 3.8
⁴⁷ Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 24-26
⁴⁸ Dan. 3.28
⁴⁹ Lluk. 1.41-44
⁵⁰ Joan 1.3
⁵¹ III [I] Mbret. 18.33-38
⁵² Gjen. 1.3,6,9,11,14,20,24; Ps. 148.5
⁵³ Joan 14.23
⁵⁴ Matth. 3.13-17; Mark. 1.9-11; Lluk. 3.21-22; Joan 1.32-34
⁵⁵ I Tim. 6.16
⁵⁶ Eks. 33.20; Joan 1.18
⁵⁷ Is. 6.2
⁵⁸ Joan 1.14
⁵⁹ Joan 5.35

⁶⁰ Ps. 67(68).22; 88(89).24

⁶¹ Ps. 25(26).7; 65(66).8

⁶² Matth. 10.15; 11.12,24; 12.36; II
Petr. 2.9; 3.7; I Joan 4.17

⁶³ Matth. 14.8-11; Mark. 6.25-28

⁶⁴ Ef. 1.23; 4.10

⁶⁵ Joan 15.1



MË 26 TË TË NJËJTIT MUAJ
Kujtimi i martires së shenjtë Fotini
dhe i atyre që ishin me të.*

NË MBRËMËSORE

Thirrtores

Ting. I Ton uranion tagmaton

E barabartë me engjëjt shën Fotinia sot* na mblodhi ta himnojmë* dhe ta marrim si shembull* shndritjeje, pendimi me dashuri* për dëshminë e Krishtit Zot,* që është drita¹ dhe jeta² për çdo njeri,* që në dritë qiellore çon.

I plotfuqishmi Krisht rrinte i raskapitur kështu* në pusin e Jakovit* por synonte, ndërmend kish,* si gjah mëkatoren ky ta rrjetoj* për shpëtim dhe ia doli mban',* se është drita e botës,¹ nga terri nxjerr* dhe në dritën qiellore çon.

O Fotini, më mëso që në dritë un' të dal,* nga terri i mëkatit* dhe të të imitoj ty;* dua të pendohen si ti me shpirt,* të jem mbi kandilmbajtësen,* jo nën shinikun³ e errët të fajit pus,* të punoj siç do Jisui yt.

Lavdi dhe Tani

Hyjlindësore

O nëna jonë e dhembshur, tek Biri yt dhe Zot* ti ke guxim, o Zonjë,* ndërmjeto për të gjithë* se ne jemi

* Krijim i përkthyesit (përveç Sinaksarit).

brenda peripecish* që si shkak kanë fajin ton';* kështu do dalim prej natës, do ecim drejt,* errësira s'do na ndjekë pas.

ose Kryqhyjlindësore

Kur nëna jote e virgjër të shihte, Krisht, mbi dru,* thërriste: Si po shuhesh,* jeta,² drita¹ e botës?* Thellë po helmohem në errësir',* Biri im fort i ëmbël ti,* por do shpëtosh njerëzinë nga çdo mëkat;* lavde dhembshurisë sate, Zot.

Përlëshore

Ting. IV Tahî prokatálave

Ju mburrim, o motra të shën Fotinisë me të,* o Fotë, Anatoli, Parashqevi, Kirjaki, Fotidhë dhe bijt' e saj,* pra ju Josi, Fotini,* tok lëvdojm' Sevastianin* dhe Theoklitin që qe magjistar; se të gjithë* u bëtë martirë, kur e shpallët Jisuin Krisht.



NË MËNGJESORE

Stihologjia e zakonshme dhe Kanuni i shenjtoreëve, që ka Akrostihidhë: "Fotini, ma ndrit terrin, që të të himnoj. Ju."

Ting. Tërth. IV

Ode I

Irmosi: Igran dhiodhefsas

»**P**asi kish kaluar det si steré* edhe »u shpëtua nga inati egiptian,* me

»zë Izraeli po thërriste:* Le t'i kë-
»ndojm' Perëndis', Çlirimtarit Zot.

Feks, o Fotini, predikimi yt,* kur
nga Lindja rende porsi diell në Perë-
ndim,*⁴ që të predikosh dhe të ndrì-
çosh ti* ata që ishin të verbër në
pabesi.

Oe barabartë me Nxënësit,* udha
jote ka shkëlqyer si drit' me drejtë-
si,*⁵ siç u shkrua, udhën që ke bërë*
me predikim solli shumë tek Krishti
yt.

Ti dritën dikur e urreje fort,* meqë
mëkatore kishe jetën dhe veprat
ferr,* ndaj kërkoi që të mos qorto-
hen* prej dritës,⁶ por si llambadhe u
bën' më pas.

Hyllindësore

I Tërëfuqishmi që s'ka kufi* zvo-
gëlim pëson në mitrën tënde, o e pa-
cen;* deshte të shpëtonte samari-
tët* edhe paganët dhe botën e tërë
tok.

Ode III

Irmosi: Uranias apsidhos

»Perëndi që apsidë bëre në q'ell si
»çati,*⁷ ti që je ndërtues i Kishës,⁸
»mirë më siguro* në dashurinë
»që ke;* je maja e çdo dëshire,*
»njeridashës, edhe mbështetja për
»çdo besnik.

Ndërmjetimin tënd lypim ne, o fa-
milje plot drit',* Fota, Fotini, Qirjaqi,
Fotidha, Parashqevi,* Fotíni edhe
Josi,* Anatoli tok me magun* Theo-
klit edhe Sevastianin që ishte duk.

I ke sjellë ti jo vetëm familjarët e
tu* pranë Krishtit, por shumë veta
pra në Afrikën larg,* përpara se të
shkosh drejt* në Romë që ta dësh-
mosh fort* Zotin, të garosh për atë,
Fotini me nam.

Më par' syri yt ishte i lig se qe
imoral,* pra dhe qenia jote e tërë
ishte e errët krejt,* siç thot' Mësuesi
Krisht,*⁹ por me pendim e pastrove*
syrin dhe u bëre ndrìçuese përmbi
dhé.

Hyllindësore

Askush s'është' më i madh nga ti,
o e Tërëdëlir',* kush veç teje pati
një nder të tillë që s'e kuptojn'* as
engjëjt, as njerëzit:* Ke mbajtur ti
brenda barkut* Krijimtarin e dheut
edhe të qiellit.

Irmosi: Uranias apsidhos

Perëndi që apsidë

Ndenjëso

Ting. III Thias písteos

Me të gjetur rast* shpejt e rrëmbe-
ve* pranë pusit ti* dhe bisedove*
me Mesian, Fotini dashamirëse;*
shpirtin e kishe të gjer' dhe pse pa

moral,* interesoheshe fort për besim të drejt*,* ndaj dëgjove të vërtetat e padëgjua,* se Zoti adhurohet shpirtërisht si frym’.

Tani *Hyjlindësore*

Oe Virgjër, je* tendë e hyjshme*¹⁰ për Krisht Fjalën Zot,* e vetmja pa cen,* epërsin’ në qashtërsi e ke mbi engjëjt;* i ndyrë jam më shumë se gjithë njerëzit,* plot me mëkate mi-shore,¹¹ pastromë pra,* me rrëke të ndërmjetimeve pranë Birit tënd;* më jep ti përdëllimin e madh,^{11a} o e thjesht’.

ose Kryghyjlindësore

Shqerra e panjoll* e Fjalës, Zotit,* Virgjërnëna krejt* e pacenuar,* duke parë që të varej mbi kryq ai,* të cilin kish lulëzuar pa dhimbje kjo,* siç bëjnë nënat thërriste me klithmë, vaj:* Mjerë, Biri im, si vuan, se do që të shpëtosh* njeriun nga pasione mjaft të turpshme¹² ti.

Ode IV

Irmosi: Isakíkoa Kírie tis ikonomias su

»**K**am dëgjuar misterin qart’* të »ekonomis’ sate dhe kuptova krejt* »vepra që ke bërë¹³ dhe prandaj* »lavdërova un’ hyjninë tënde, Zot.

Në shtëpinë e samaritanes ata që rrinin dhe jetonin në errësirë panë një dritë të madhe, feksi mbi ta llamburitje siç parapa profeti.¹⁴

Dy kurora morët, o të lavdishëm, një për apostullimin dhe një për martirizimin sipas rezistencës suaj heroike në tortura.

Rendët, jo vetëm ecët si bij drite,¹⁵ në urdhrat e Zotit, të cilët janë dritë,¹⁶ dhe lëvizët si dritë për zbulimin dhe llamburitjen e kombeve.¹⁷

Hyjlindësore

Itërëurti, vezullimi i dritës së përjetshme,¹⁸ të vuri ty, nënën e tij si dritë kombesh,¹⁹ si dritë ngushëllimi për ata që janë në errësirë.

Ode V

Irmosi: Fótison imás

»**N**dritna ti, o Zot,* përmes urdhrave »të tua¹⁶ ne,* si dhe me krahun tënd »fuqiplot, të lart’,*²⁰ o njeridashës, »na jep paqen tënde²¹ përgjithnjë.

Të vuri, o Fotini, si dritë kombesh Krishti, që u vu si dritë kombesh,¹⁹ që ato që dëgjove në fillim fshehtazi, t’i thuash në dritë.²²

Të drejtësoi pendimi yt, o samaritane, të pastroi, të ndriçoi dhe tok me të tija u kthuet te bijtë e dritës dhe ditës,²³ në shkëlqimin e shenjtorëve.²⁴

“**E**jani të ecim në dritën e Zotit”,²⁵ i thoshte martirja familjes së saj,

“dhe do të jetë Zoti për dritë të përjetshme”;²⁶ dhe kështu doli si llamburitje drejtësia e saj.²⁷

Hyлиндësore

Rregullat e natyrës u përmbysën në ty, o Zonjë; pakuptueshëm burove ujin që kërcen²⁸ dhe shuan vapën e mëkateve dhe etjen e paditurisë.

Ode VI

Irmosi: Tin dhëisin ekheó

»**D**o derdh lutjen* para Zotit
»Perëndi* dhe atij do t'i tregoj
»hidhërimet* që kam,²⁹ sepse*
»shpirti im është mbushur* me
»çdo të keqe dhe jeta po shkon në
»Hadh;*³⁰ pra si Jonai lutem un':*
»Jetën time nga prishja, ti ngrije, Zot.

I shndriti krejt* Krishti Zot të fshehurat*³¹ e jetesës sate, o Fotini, Shenjt;* qysh atëher'* edhe deri tani je* në drit' shenjtorësh,³² pra siç Shpëtimtari tha,* ju jeni drita e botës;*³³ ndërmjetoni gjithnjë pranë tij për ne.

Në pagëzim* u shërua në shikim* Sevastiani duka, ndaj u ndriçua* dhe shpirtërisht,* u bë dritë në Krishtin*¹⁵ kështu si ti, Fotini, dhe si kori yt* duroi keqtrajtimit dhe pa* brenda dritës së Zotit ndriçim të madh.³⁴

Që të dëgjosh* që Hyjnia është frym',* dhe pse Shpirti s'kishte

mbetur në ty më,* se ishe mish,*³⁵ në pus shkove, martire,* dhe nga atëher' himnon jeta jote fort* në dritë Perëndinë³⁶ Krisht,* se të nxori në dritë³⁷ prej territ pus.

Hyлиндësore

Ësht', Zoti im,* mrekulli që s'merret dot* me mend shndritja jote prej Vajze nënë;* ti që me drit'* si me pekt vishesh,³⁸ mua* më veshe që edhe unë të të vesh ty* në pagëzim,^{38a} prandaj ndriço* syt' e mi të mos fle gjumë vdekjeje.³⁹

Irmosi: Tin dhëisin ekheó

Do derdh lutjen

Kontaqi

Ting. II Ta ano zitón

Martirja me nam* dhe sinonime me ndriçim,* me motrat dhe bijt',* pasi dhuratën prej Hyjnis'* e pranuan te pusi, predikuan dhe i ndriçuan krejt* shumë njerëz që thurën psalm:* Vërtet Shpëtimtar i botës Krishti Zot është'.

Shtëpia

Le ta himnojmë të barabartën me apostujt, të kënduarën në Palestinë, në Afrikë, në Romë dhe kudo, për veprimtarinë në fjalën e Perëndisë, që ushtroi me të afërmit. Tok me Sevastianin dhe me ish magjistarin që s'arriti t'i helmonte, pra Theoklitin, u torturuan frikshëm nga luani⁴⁰

çnjerëzor, të nxitur nga luani që kërkon të gëlltisë besimtarët.⁴¹ Para ekzekutimit pësuan për tre vjet edhe rrahje, djegie, verbim, kërcënime nga gjarpërinjtë, prerje, kryqëzim, ndonëse shpesh mbeteshin pa u dëmtuar dhe deklarorin: Vërtet Shpëtimtar i botës Krishti Zot është’.

Sinaksari

Më 26 të të njëjtit muaj, kujtimi i martires së shenjtë Fotini samaritane, të cilës i foli Krishti në pus, dhe i shoqërisë së saj.

Vargje: E hedhin samaritanen në pus,/ atë që bisedoi me ty pranë pusit, o Fjalë.

Në të njëzet e gjashtë mbaron kryetarja e grupit të saj hierapostolik.

Në të njëjtën ditë, shenjtorja Anatalia, motra e saj, mbaron me shpatë.

Vargje: Anatalia guximtare kur u pre,/ gjeti lindjen mendore.

Në të njëjtën ditë, shenjtorja Fota, motra tjetër e saj, mbaron me shpatë.

Vargje: Si prikë të vlefshme për dhjetëra mijë talantash/ Fota të blaton kokën ty, o atë i dritave.⁴²

Në të njëjtën ditë, shenjtorja Fotidha, motra tjetër e saj, mbaron pasi u lidh në dy pemë dhe u nda në dysh.

Vargje: O Fjalë e Perëndisë, Fotidhës, atletes në pemë,/ do t’i japësh si

çmim pyllin e kënaqshëm të Edenit.

Në të njëjtën ditë, shenjtorja Parashqevi, motra tjetër e saj, mbaron me shpatë.

Vargje: Parashqevia e kishte qafën/gati dhe të tendosur para shpatës.

Në të njëjtën ditë, shenjtorja Qirjaqi, motra tjetër e saj, mbaron me shpatë.

Vargje: As frika e shpatës nuk e nxjerr jashtë/ frikën e hyjshme të Qirjaqisë për Zotin.

Në të njëjtën ditë, martiri i shenjtë Josi, biri i shën Fotinisë, mbaron me shpatë.

Vargje: Prerësi i qafave, xhelati, e zhveshte shpatën,/ por qafa e Josit nuk i frikësohet shpatës.

Në të njëjtën ditë, shën Fotini, biri tjetër i saj, mbaron me shpatë.

Vargje: Ç’është ky avull nga gjakra të nxehtë?/ Fotinit sapo ia prenë kokën.

Në të njëjtën ditë, shën Sevastiani dukë mbaron me shpatë.

Vargje: Sevastianit do t’i them këtë fjalë:/ Të nderoj ty, të prerin në krye.

Në të njëjtën ditë, shën Theokliti, ish magjistar, mbaron me shpatë i pari nga të gjithë.

Vargje: Theoklit, para therjes i dogje

librat e djallit,^{43/} se gjete Krishtin që dërrmoi satanin nën këmbët e tua.⁴⁴

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atit tonë oshënar Porfiri, episkopi i Gazës.

Vargje: Oh! Kush do të anashkalojë, do të shpërfillë Porfirin,/ ndonëse iku nga jeta?

Trupin e vdekur të Porfirit e fshehu toka në të njëzet e gjashtë.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirit të ri, Joan muratori.

Me ndërmjetimet e tyre të shenjta, o Perëndi, mëshirona dhe shpëtona. Amin.

Ode VII

Irmosi: I ek tis Iudheas

»**T**re Djem që nga Judea* përfunduan si robër në Babilonë dikur,* me »besën e Triadhës kan' shkelur flakë »furre duke psalur me gaz e hir:* O »Perëndi atëror,* o Zot je i bekuar.

Të denjësuat për veshjen e Krishtit⁴⁵ ata që rropën lëkurën tënde, lëkurën që na veshi Perëndia për shkak të mosbindjes së lashtë,⁴⁶ kështu u ngrite në gjendjen para rënies dhe psalje: I bekuar je, o Perëndi përjetë.

Ënjtje e pasioneve që deri në shekuj nuk do shohë dritë⁴⁷ u çënjt kur takoi Mesian, sytë e të cilit janë të ndritshëm më shumë se dhjetëra mijëra herë,⁴⁸ dhe e errësuar thirri:

Do të ma ndriçosh terrin,⁴⁹ se i bekuar je, o Perëndi, përjetë.

Të nderojmë, o Fotini famëmadhe ty, që shijove se porosia e Zotit shkëlqen larg,⁵⁰ dhe e vure ligjin e tij si kandil në këmbët e tua dhe si ndriçim në udhët e tua⁵¹ të gjata, që kombet të ecnin në dritën e faqes së Zotit⁵² duke thirrur: I bekuar je përjetë.

Hyllindësore

Ëmbëlsia e gjinisë sonë je, o Perëndi-lindëse e bekuar, se linde të vetmin që bëri drita të mëdha përtej qiellit, diellin, hënën dhe yjet,⁵³ por dhe në tokë, si Fotininë dhe familjen e saj dritëpurëse; ty të himnojmë përherë.

Ode VIII

Irmosi: Ton Vasilea ton uranón

»**M**bretin në qiejt,* që e himnojnë »ushtritë* engjëjlore edhe ju himnoni,* dhe e lartësoni gjithnjë në tërë »jetët.

Hiri i Shpirtit të shndërroi, se është Zoti i vërtetë që të lartësoi dhe i ndriçoi sytë e tu dhe që të dha shërim⁵⁴ gjatë torturave, o atlete që psalje: I bekuar je, o Perëndi.

I veshur me armët e dritës,⁵⁵ kori i shenjtë predikoi se Perëndia është dritë⁵⁶ që nxjerr në dritë sa janë në hije vdekjeje.⁵⁷

Motrat, djemtë, duka, xhelati dhe magjistari këndonin psalmikisht: U shënua mbi ne drita e fytyrës sate, o Zot,⁵⁸ prandaj e shpërndajmë duke psalur: I bekuar je, o Perëndi.

Hyjlindësore

Ne me mall dhe himne të lartësojmë, o reja dhe shtylla e ndritshme,^{58a} që na linde Birin tënd dhe Perëndi, neve që po thërrasim: Zoti është ndriçimi im.⁵⁹ I bekuar je, o Perëndi.

Irmosi: Ton Vasilea ton uranón

Mbretnin në qiejt

Ode XI

Irmosi: Kirios Theotokon

»**H**yllindëse të themi,* të pohojmë
»ne që* shpëtuam, o e kulluar e vir-
»gjër me ty,* me koret e të patrupve
»të madhështojmë tok.

Omologjia jote* para pushtetarit,* të solli natë mundimi, o shën Fotini,* por i thërrisje: Mos ki gaz, se Zoti më ndriçon.⁶⁰

Ju fisi i bekuar* dritëdhënës, thohit:* Jerusalem ti ndriçohu, ndriçohu dhe ti* o Samari, se ju erdhi drita, Jisui Krisht.

Ju, o shenjtorët tanë,* brenda mbretërisë* së tërëndritshme të Zotit shkëlqeni tani;* të dal un' që ju himnova nga terri, lypni ju.

Hyjlindësore

U shfaqe, Virgjëreshë,* nëna e shkëlqimit* atje ku s'kishte ndriçim,⁶¹ tëk të gjithë pra the:* Me Birin tim do të keni dritë në udhë ju.⁶²

Irmosi: Kirios Theotokon

Hyllindëse të themi

[Himnet që vijojnë më pas psalen në panaiuret e kishave që mbajnë emrin e shenjtores].

Tis mathitēs sinélt hōmen

Të kemi shembull, Fotini,* të gjithë për pendimin* të pastër, rrënjësor, sepse* jo vetëm veten tënde* ia solle Krishtit dhe fisin* edhe bashkatdhetarët,* por edhe shum' në vende larg,* ndaj je e barabart' me apostujti* dhe devotshmëria që ke treguar* në masakrimin tënd çudit* dhe na mëson guxim.

Hyjlindësore

Me ngazëllim dhe me hare* thërrasim, o e virgjër,* o e dëlir' Hyjlindëse,* ne që jemi çliruar* nga faji, nëma e lashtë,*⁶³ nëpërmjet lindjes sate,* "Gëzohu"-n kryeengjellor,*⁶⁴ themi: Gaz ki çlirimi adamian,*⁶⁵ o e thjeshtë, nga vdekja na çlirove;* gëzohu, se ne mbretëri* gjetëm me ty në qiell.

Lavdërime

Ting. IV Edhokas simíōsin

Kot mendoje se do fshihje jetën

tënde të shthurur ferr* nga Jisui që njeh çdo gjë;* gaboje siç Psalmi thot',* kur ti the se "Terri* do të më mbulojë dhe natën do ta kem shijim,» por errësira e errët s'është kurr'* përpara Perëndisë, se për të ndriçimi i plotë është;*⁶⁶ Fotini e hyjnueshme,* ndërmjeto të ndriçohemi.

O martire, kthesa e jetesës sate po na çudit,* prej pushtetit të natës ferr,*⁶⁷ prej botësunduesit* shpirtëror,⁶⁸ prej djallit,*⁶⁹ u shkëpute dhe hodhe tej të fshehtat në pusi*⁷⁰ me neveri për çdo pun' në terr⁵⁵ për faj;* sipas këshillës së Jisuit sa dëgjove në errësir',* pra ti vetëm, i shpalle gjer'* si në dritë dhe haptazi.⁷¹

O kor predikues edhe martirik, fitimtar me lavd,* me kuror' të dyfishtë pra,* arrite në hyjnizim',* kur të ftoi Krishti* Shpëtimtar nga terri⁷² dhe hodhe epushet plot mëkat* i bindur se erdhi si ndriçim mbi dhé* të mos qëndrojë n'errësirë çdo person që beson në të;*¹ ndërmjeto të mos humbim ne* brenda territ të jashtëm krejt.⁷³

O e tërëurtë, famëmadhe, o Fotini me lavd,* lutju Zotit që deshe fort,* kur njohe se ish ai* Shpëtimtar Mesia,* lypi që të kthehemi nga mëkati në shpëtim,*⁶⁹ të mos pushtohemi më prej tij⁷⁴ në luft',* se

pranë Krishtit ke guxim, se mirësia e tij të ka* si trofe: nga fajtoresh ti* predikuese shfaqesh pra.

Lavdi *Ting. Tërth. I*

O atlete Fotini, shkëlqen në qiell tok me shoqërinë tënde dritëprurëse, sepse nga errësira e mëkatit dhe nga furtuna e panjohurisë u bëtë ndriçues, që sollët shumë te Krishti; ndonëse u martirizuat frikshëm dhe u vratë tmerrësisht nuk ia doli mbanë armiku i errët dhe nuk perëndoi shkëlqimi juaj; lutemi të ndërmjetoni që t'ju imitojmë në pendim, të bëhemi dritë dhe të përhapim dritën e Zotit, që të shpëtohen shpirtrat tanë.

Tani *Hyjlindësore*

Ty të lumërojmë, o Hyjlindëse e virgjër dhe të lavdërojmë ne besnikët siç të ka hije ty, qytetin e patundshëm dhe murin që s'çahet dot, mbrojtjen e pathyeshme dhe strehën e shpirtrave tanë.

Dhe të tjera si zakonisht.

CITIME

¹ Joan 1.4,9; 3.19; 8.12; 9.5; 12.46

² Joan 11.25; 14.6; Kol. 3.4; I Joan 1.2,5; 5.12,20

³ Lluk. 8.16

⁴ Ps. 18(19).6-7

⁵ Fja. Urt. 4.18

- ⁶ Joan 3.19-20
⁷ Gjen. 1.7; Is. 40.22
⁸ Ef. 2.20-21
⁹ Matth. 6.23; Lluk. 11.34
¹⁰ Ps. 131(132).5; Hebr. 9.1-2
¹¹ Juda 23
^{11a} Num. 14.19 etj.
¹² Rom. 1.26
¹³ Abak. 3.1-2
¹⁴ Is. 9.2; Matth. 4.16
¹⁵ Ef. 5.8
¹⁶ Is. 26.9
¹⁷ Lluk. 2.32
¹⁸ Urt. Sol. 7.26
¹⁹ Is. 42.6; 49.6; Vep. 13.47
²⁰ Eks. 32.11
²¹ Is. 9.6; Joan 14.27
²² Matth. 10.27
²³ I Thes. 5.5
²⁴ Ps. 109(110).3
²⁵ Is. 2.5
²⁶ Is. 60.19-20
²⁷ Is. 62.1
²⁸ Joan 4.14
²⁹ I Mbret. [Sam.] 1.15; Ps. 141(142).3
³⁰ Ps. 87(88).4
³¹ I Kor. 4.5
³² Kol. 1.12
³³ Matth. 5.14
³⁴ Ps. 35(36).10
³⁵ Gjen. 6.3
³⁶ Jov 33.30
³⁷ Mik. 7.9
³⁸ Ps. 103(104).2
^{38a} Gal. 3.27
³⁹ Ps. 12(13).4
⁴⁰ II Tim. 4.17
⁴¹ I Petr. 5.8
⁴² Jak. 1.17
⁴³ Vep. 19.19
⁴⁴ Rom. 16.20
⁴⁵ Gal. 3.27
⁴⁶ Gjen. 3.21
⁴⁷ Ps. 48(49).20
⁴⁸ Sirak 23.19
⁴⁹ Ps. 17(18).29
⁵⁰ Ps. 18(19).9
⁵¹ Ps. 118(119).5
⁵² Ps. 88(89).16
⁵³ Gjen. 1.16; Ps. 135(136).7-9
⁵⁴ Sirak 34(31).17
⁵⁵ Rom. 13.12
⁵⁶ I Joan 1.5
⁵⁷ Jov 12.22
⁵⁸ Ps. 4.7
^{58a} Eks. 13.21-22; 14.24; Ligji i Dytë 31.15
⁵⁹ Ps. 26(27).1
⁶⁰ Mik. 7.8
⁶¹ Jov 10.22
⁶² Jov 29.3
⁶³ Gjen. 3.16-17
⁶⁴ Lluk. 1.28
⁶⁵ Gjen. 3.15
⁶⁶ Ps. 138(139).11-12
⁶⁷ Lluk. 22.53; Kol. 1.13
⁶⁸ Ef. 6.12
⁶⁹ Vep. 26.18
⁷⁰ I Kor. 4.5
⁷¹ Matth. 10.27
⁷² I Petr. 2.9
⁷³ Matth. 8.12; 22.13; 25.30
⁷⁴ Joan 12.35



*Zbritesore: Ja gojën e çel tani**Ting. IV**Ode I**Anikso to stoma mu*

»Ja gojën e çel tani, i frymëzuar prej
 »Shpirtit Shenjt' * dhe këngë do t'i
 »këndojo nënës së madhe mbi fron; *
 »dhe do ta kremtoj * me valle buzëqë-
 »shur, * me zë do t'i shpall kudo gjithë
 »çudit' e saj. *

*Ode III**Tus sus innologus*

»O Zonjë dhe nën' e Perëndisë, bu-
 »rim i pasosur jetësor, * ti siguroji
 »gjith' ata që të këndojnë plot me
 »zell; * dhe lart në q'ell ku mbretëron
 »kurorëzoi me çdo lavdi. *

*Ode IV**Tin aneksihniaston*

»Të pagjurmësuarin plan perëndor, *
 »që po mishërohet i larti Zot * prej
 »Virgjëreshës, * Abakumi si profet e
 »pa dhe tha me zë të madh: * O Zot i
 »fuqishëm, lavdi më ty. *

*Ode V**Eksesti ta simpanta*

»Të gjith' i habite ti me një çudi dhe
 »një lavdi, * ti, o Virgjëresh' e pamar-
 »tuar; * Zotin e jetës që mbretëron
 »lart në q'ell si një bir e mbajte në
 »pëqi, * dhe shpëtim që lartazi * u
 »dhurove besnikëve. *

*Ode VI**Tin thian taftin*

»Këtë të kremte e lusim sot, për
 »Zonjën edhe nënën Hyjlindëse,
 »gjithë hyjmendësit, * eni trokisni pra
 »duartë * dhe lavdëroni Zotin që lindi
 »prej asaj. *

*Ode VII**Uq elátrefsan*

»Nuk u faleshin krijesave hyjmendë-
 »sit, por Kryetarit lart * dhe kërcë-
 »nimin me zjarr * e shkelën me tri-
 »mëri, psalnin me brohori: * Zot,
 »lavdi më ty, o Perëndi i etërve, * ti je
 »vetëm i bekuar. *

*Ode VIII**Pedhas evajís*

»Djemat * e dënuar për t'u djegur,
 »prej zjarrit i ka shpëtuar lindj' e Zotit
 »Krisht, si simbol në lashtësi; * dhe
 »si një veprim tani, * dhe tërë botën
 »po e mbledh për këng' e lavdërim: *
 »Himnojeni ju veprat e Zotit * dhe e
 »lartësoni përmbi të gjitha jetët. *

*Ode IX**Apas jijenís*

»Gjithë njerëzit, kërceni me ngazë-
 »llim tek drit' e Shpirtit Shenjt', *
 »eni lavdërojeni, * engjëjt e q'ellit eni
 »kremtojeni * këtë të shenjtë panair
 »të kryezonjës Mari * dhe thërrisni: *
 »Ti je më e lumura, * Virgjëresh' e ku-
 »lluar Hyjlindëse. *

Përmbajtja

MUAJI JANAR

1 Janar

Rrethprerja e Zotit tonë Jisu Krisht dhe kujtimi i atit tonë
ndër shenjtorët Vasili i Madh 3

E Diela para Theofanisë 24

2 Janar

Parakremtja e Theofanisë dhe kujtimi i atit tonë ndër shenjtorët
Silvestër, papa i Romës, dhe i atit tonë oshënar Serafim në
Sarov 26

5 Janar

Parakremtja e Theofanisë dhe kujtimi i martirëve të shenjtë
Theopempti dhe Theonai, dhe i oshënares Singlitiqia 47

THEOFANIA

Orët e Mëdha

Ora e Parë 68

Ora e Tretë 72

Ora e Gjashtë 76

Ora e Nëntë 81

6 Janar

Mbrëmësorja e Madhe dhe Liturgjia e shën Vasilit të Madh . . . 90

Shërbesa e Ajazmës 98

Në Mëngjes 107

Në Mëngjesore 109

Shërbesa e bekimit të ujërave (Hedhja e Kryqit) 120

7 Janar

Mbledhja e profetit të çmuar, të lavdëruar, Pararendësit dhe
Pagëzorit Joan..... 125

E Diela pas Theofanisë 137**8 Janar**

Kujtimi i atit tonë oshënar Gjergji Hozeviti dhe i nënës sonë
oshënare Domnika..... 137

11 Janar

Kujtimi i atit tonë oshënar Theodhos Qinoviarkut..... 150

12 Janar

Kujtimi i martires së shenjtë Tatjana 164

14 Janar

Kujtimi i Avave të shenjtë në Sina dhe Raithó..... 173

16 Janar

Falja e zinxhirit të çmuar të apostullit të shenjtë dhe të
tërëfamshëm Petro..... 175

17 Janar

Kujtimi i atit tonë oshënar dhe hyjprurës Andonit të Madh... 189

18 Janar

Kujtimi i etërve tanë të shenjtë, kryepiskopëve të mëdhenj
të Aleksandrisë, Athanasit dhe Kirilit..... 210

20 Janar

Kujtimi i atit tonë oshënar Efthimi i Madh 228

21 Janar

Kujtimi i atit tonë oshënar Maksim Omologjeti dhe i martirit
të shenjtë Neofit 246

22 Janar

Kujtimi i apostullit të shenjtë Timothe dhe i oshënarit martir të shenjtë Anastas persiani 259

25 Janar

Kujtimi i atit tonë ndër shenjtorët Grigor Theologut 272

27 Janar

Transferimi i lipsanit të atit tonë ndër shenjtorët Joan Gojarti . . 293

30 Janar

Kujtimi i Etërve tanë ndër shenjtorët dhe i Mësuesve Ekumenikë, Vasilit të Madh, Grigor Theologut dhe Joan Gojartit 318

MUAJI SHKURT**2 Shkurt**

Ipapandia (Paraqitja në Tempull) e Zotit dhe e Perëndisë, dhe Shpëtimtarit tonë Jisu Krisht 345

E Diela pas Ipapandisë 363

Mbyllja e së kremtes 364

3 Shkurt

Kujtimi i të drejtit shën Simeon Hyjmbajtës dhe i profeteshës Ana 365

6 Shkurt

Kujtimi i atit tonë ndër shenjtorët Foti, patriarku i Konstandinopjës 374

10 Shkurt

Kujtimi i hieromartirit të shenjtë Harallamb 389

11 Shkurt

Kujtimi i hieromartirit të shenjtë Vlash 410

24 Shkurt

Gjetja e Parë dhe e Dytë e kokës së shenjtë të Pararendësit. 419

Në Mbrëmësoren e së njëjtës ditë 437

26 Shkurt

Kujtimi i martires së shenjtë Fotini dhe i atyre që ishin me të . . 440

Shtojcë 449

